RAPORTI PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

"AUDITIM PËRPUTHSHMËRIE"

TIRANË 2026

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	**3-8**
1.	Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit	3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4-6
3.	Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	7-8
II.	**HYRJA**	**8-12**
1	Objektivat dhe qëllimi	8-9
2	Identifikimi i çështjes	9
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	9-10
4	Përgjegjësitë e audituesve	10
5	Kriteret e vlerësimit	10-11
6	Standardet e auditimit	11
7	Metodat e auditimit	11
8	Dokumentimi i auditimit	12
III.	**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**	**12-303**
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	12
2	Rezultatet e auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	12-303
2.1	Planifikimi, zbatimi dhe monitorimi i buxhetit. Programimi PBA dhe buxhetit vjetor, çelja e fondeve vjetore dhe ndryshimet sipas akteve normative, saktësia e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.	12-22
2.2	Planifikimi dhe zbatimi i procedurave të prokurimit publik si dhe zbatimi i kontratave për punë, mallra dhe shërbime deri në marrjen në dorëzim.	22-65
2.3	Mbi auditimin e procedurave për dhënie mendimi për lejet Mjedisore dhe Licencave.	65-108
2.4	Mbi auditimin e procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) paraprake dhe të thelluara.	108-163
2.5	Mbi auditimin e procedurave të kryerjes së inspektimeve nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Agjencitë Rajonale të Mjedisit, marrjen e masave përkatëse dhe ndjekjen e tyre.	163-303
IV	**REKOMANDIME**	**304-336**

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, si dhe bazuar në Programin e Auditimit nr. 769/54 prot., datë 14.10.2025, i ndryshuar, Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) për periudhën 01.01.2023-31.12.2025 dhe katër Agjencitë Rajonale të Mjedisit (ARM), për periudhën 01.01.2021 deri me datën 31.12.2025.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ajo organizohet në dy nivele: në nivel qendror, përmes Drejtorisë së Përgjithshme dhe nivel rajonal, nëpërmjet 4 (katër) Agjencive Rajonale të Mjedisit (ARM) për zbatimin e ligjshmërisë në fushën e inspektimit, si dhe dhënien e mendimeve për leje të Tipit A dhe B, mendime për Vlerësimet e Ndikimit në Mjedis (VNM) paraprake dhe të thelluara. Fondet buxhetore miratohen nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij

Rëndësia e auditimit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe në Agjencitë Rajonale të Mjedisit qëndron në garantimin e ligjshmërisë, eficiencës, efektivitetit dhe transparencës së veprimtarisë së tyre, veçanërisht në fushën e inspektimit mjedisor. Auditimi siguron që procedurat administrative dhe teknike të zbatohen në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Auditimi i këtyre institucioneve është fokusuar në çështje të posaçme që lidhen me vlerësimin e procedurave për dhënie mendimi për lejet Mjedisore dhe Licencave, procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) paraprake dhe të thelluara, procedurave të veprimtarisë inspektuese dhe dokumentimit të tyre në portalin unik "E-Inspektim". Në këtë këndvështrim, auditimi përbën një mekanizëm thelbësor për forcimin e qeverisjes së mirë, rritjen e llogaridhënies institucionale dhe garantimin e një administrimi më efektiv të politikave mjedisore në nivel kombëtar dhe rajonal.

c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e kryerjes së veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për periudhën 01.01.2023-31.12.2025 dhe katër Agjencive Rajonale të Mjedisit për periudhën 01.01.2021-31.12.2025.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Planifikimi, zbatimi dhe monitorimi i buxhetit. Programimi PBA dhe buxhetit vjetor, çelja e fondeve vjetore dhe ndryshimet sipas akteve normative, saktësia e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.
- Planifikimi dhe zbatimi i procedurave të prokurimit publik si dhe zbatimi i kontratave për punë, mallra dhe shërbime deri në marrjen në dorëzim.
- Mbi auditimin e procedurave për dhënie mendimi për lejet Mjedisore dhe Licencave.
- Mbi auditimin e procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) paraprake dhe të thelluara.
- Mbi auditimin e procedurave të kryerjes së inspektimeve nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Agjencitë Rajonale të Mjedisit, marrjen e masave përkatëse dhe ndjekjen e tyre.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes së të dhënave

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera, me qëllim arritjen e objektivave të auditimit në bazë të vlerësimit të riskut.

Në këtë auditim janë përzgjedhur metoda, metodologji apo teknika auditimi dhe shtrirje të procedurave të auditimit, për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:
-*Intervistimi* - duke komunikuar dhe marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;
-*Raporte dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve, informacioneve relevante dhe që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimet e auditimit;
-*Verifikimi në sistemet e Agjencisë* - me përzgjedhje i çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;
-*Teknikat me ndihmën e kompjuterit* - për procedura të programuara, për të bërë testimet ose për nxjerrjen të dhënave për testim të mëtejshëm;
-Verifikim transaksionesh – me përzgjedhje i çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;
-*Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.
Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

e. Paraqitja e gjetjeve kryesore

1. Mangësi të evidentuara në zbatimin e kuadrit ligjor për vendosjen, shqyrtimin dhe ndjekjen e masave administrative, përfshirë shfuqizimin e pajustifikuar të gjobave, zëvendësimin e tyre me masa "paralajmërim" në kundërshtim me parashikimet ligjore. Konkretisht:
- Shfuqizim i pajustifikuar i gjobave në vlerën 10,490 mijë lekë.
- Vendosja e masës "paralajmërim" në vend të gjobës për shkelje të lejeve mjedisore nga vlera 11,600 mijë deri në vlerën 20,000 mijë lekë.
- Mos aplikimi i sanksioneve për shkelje në fushën e burimeve ujore nga vlera 2,000 mijë deri në vlerën 4,000 mijë lekë.
- Zëvendësimi i gjobave me "paralajmërim" në fushën e menaxhimit të mbetjeve nga vlera 6,800 mijë deri në vlerën 11,500 mijë lekë.
- Mos vendosja e gjobave për shkelje në mbrojtjen e mjedisit nga vlera 3,000 mijë deri në vlerën 6,000 mijë lekë.
- Mos ndjekja dhe mos arkëtimi i gjobave administrative në vlerën 70,207 mijë lekë.

2. Ndryshimet në ligjin e ri të inspektimit (nr. 99/2024) krijojnë mospërputhje me legjislacionin mjedisor, pasi vendosin paralajmërimin si masë kryesore edhe kur ligjet e posaçme parashikojnë sanksione të drejtpërdrejta. Kjo sjell paqartësi në zbatim dhe rrezik për mosaplikim korrekt të masave administrative në fushën e mjedisit.

3. Ekziston mospërputhje midis ligjit dhe akteve nënligjore për afatet e shqyrtimit të ankimimeve. Kjo krijon paqartësi procedurale, rrezik për interpretime të ndryshme dhe mund të cenojë të drejtat e subjekteve.

4. Në shqyrtimin e lejeve mjedisore nga AKM janë konstatuar mangësi në dokumentacion dhe në verifikimin e tij nga strukturat përgjegjëse. Si pasojë, vendimmarrja mund të bazohet në të dhëna të paplota ose të pasakta, duke rrezikuar cilësinë e vlerësimit mjedisor.

5. Mungon një databazë e saktë dhe e unifikuar për evidencën e subjekteve dhe detyrimeve financiare, me pasaktësi dhe dublikime në të dhëna. Kjo cenon besueshmërinë e informacionit dhe rrezikon monitorimin efektiv të pagesave dhe zbatimin e masave ligjore.

6. Administrimi i raporteve të vetëmonitorimit nuk është i standardizuar dhe kryhet në mënyrë të fragmentuar. Kjo dobëson gjurmueshmërinë, analizën e riskut dhe planifikimin efektiv të inspektimeve.
7. Nga verifikimi i procedurave të inspektimeve për periudhën objekt auditimi, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencitë Rajonale të Mjedisit, u konstatuan mangësi procedurale nga trupa inspektuese, në kundërshtim me kërkesat e kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi.
8. Sektori përgjegjës nuk administron dhe nuk verifikon siç duhet informacionin mbi menaxhimin e mbetjeve, duke mos përmbushur detyrimet funksionale. Kjo krijon mungesë gjurmueshmërie dhe dobëson mekanizmat e kontrollit institucional.
9. Regjistrat e licencave III.2.B janë të pasaktë dhe të pastrukturuar, me mospërputhje dhe dublikime të kodeve unike. Kjo cenon identifikimin e saktë të subjekteve dhe dobëson kontrollin dhe vendimmarrjen.
10. Raportimi i transfertave të mbetjeve nga subjektet është i ulët dhe nuk shoqërohet me inspektime apo ndjekje nga AKM. Kjo dobëson ndjeshëm monitorimin, gjurmueshmërinë dhe zbatimin e detyrimeve ligjore.
11. Databazat e lejeve mjedisore nuk janë të unifikuara dhe përmbajnë të dhëna të papërditësuara dhe të mbivendosura. Kjo krijon pasaktësi në identifikimin e lejeve aktive dhe dobëson administrimin dhe kontrollin e aktiviteteve me ndikim në mjedis.
12. Procesi i VNM dhe Deklaratave Mjedisore karakterizohet nga mungesë mendimesh nga institucionet, verifikime të pakta në terren dhe pjesëmarrje e ulët në konsultime publike. Si pasojë, vendimmarrja mbetet shpesh formale dhe jo e bazuar në vlerësim të plotë.
13. Rezultatet laboratorike me tejkalime të normave nuk ndiqen me inspektime apo masa administrative, për shkak të mungesës së koordinimit institucional. Si pasojë, dobësohet reagimi ndaj ndotjes dhe rritet rreziku për ndikim negativ në mjedis dhe shëndet publik.
14. Auditimi evidentoi raste ku Komisioni i Shqyrtimit të Ankimimeve ka shfuqizuar gjoba administrative të vendosura nga trupat inspektuese pa analizuar në thelb provat dhe shkeljet e konstatuara në terren, duke u bazuar vetëm në pretendime procedurale.
15. Auditimi gjeti se nuk ekziston një sistem i centralizuar për masat administrative, me mospërputhje ndërmjet të dhënave rajonale dhe qendrore, si dhe gjoba të paarkëtuara duke rritur riskun për mosarkëtim dhe humbje të të ardhurave buxhetore.

f. Paraqitja e rekomandimeve kryesore

1. Ministria përgjegjëse për mjedisin, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për inspektimin, të marrë masa për rishikimin dhe harmonizimin e dispozitave të ligjit nr. 99/2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" me legjislacionin e posaçëm mjedisor në fuqi.
2. Drejtoria e Shqyrtimit dhe Monitorimit të Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve, në bashkëpunim me Komisionin për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisore pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, të marrë masa për verifikimin e plotë dhe të dokumentuar të dokumentacionit të paraqitur nga subjektet gjatë shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore, duke siguruar që praktikat e aplikimit të jenë të plota, të përditësuara dhe në përputhje me kërkesat ligjore, përpara paraqitjes së tyre për vendimmarrje në komision.
3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa për krijimin dhe funksionimin e një databaze të plotë, të unifikuar dhe të integruar për administrimin e lejeve mjedisore të tipit A dhe B.
4. Sektori i Monitorimit të Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve, të marrë masa për administrimin dhe evidentimin e plotë të dokumentacionit dhe raporteve të vetëmonitorimit të subjekteve të pajisura me leje mjedisore, duke siguruar regjistrimin dhe gjurmueshmërinë e tyre në përputhje me

procedurat dhe rregulloren e brendshme të institucionit.
5. Strukturat përgjegjëse në AKM të marrin masa për sigurimin e raportimit të plotë dhe të saktë të informacionit mbi transfertat e mbetjeve nga subjektet e pajisura me licencë III.2.B., si dhe për ndjekjen e rasteve me mangësi në raportim përmes planifikimit dhe realizimit në kohë të inspektimeve përkatëse.
6. Struktura përgjegjëse për monitorimin dhe inspektimin e menaxhimit të mbetjeve të marrë masa për verifikimin e subjekteve me raportime të paplota ose mungesë raportimi, duke kërkuar plotësimin e dokumentacionit, kryer kontrolle në terren dhe duke aplikuar masa administrative në rastet e mos përmbushjes, me qëllim sigurimin e gjurmueshmërisë së mbetjeve dhe zbatimit të kushteve të lejes mjedisore.
7. Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marri masa për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, duke kërkuar në mënyrë të detyrueshme dhënien e mendimeve nga institucionet e përfshira, duke u bazuar në një analizë të riskut për projektet e propozuara, të udhëzojë Agjencitë Rajonale të Mjedisit për rritjen e numri i verifikimeve në terren, për të siguruar që vendimet të mbështeten në fakte praktike dhe jo vetëm në referenca ligjore.
8. Struktura përgjegjëse të ndërmarrë masa të menjëhershme për rishikimin dhe sistemimin e plotë të regjistrit të licencave III.2.B dhe të kodeve unike, duke eliminuar përsëritjet, duke verifikuar statusin real të subjekteve dhe duke siguruar që çdo subjekt të pajiset me një kod unik të vetëm, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
9. Strukturat përgjegjëse për funksionin e monitorimit dhe inspektimit të marrin masa për ndjekjen sistematike të rezultateve laboratorike, duke i përdorur ato si bazë për inicimin e inspektimeve dhe aplikimin e masave administrative të përshtatshme sipas nivelit të shkeljes, si dhe të sigurojnë koordinim efektiv ndërmjet laboratorit dhe strukturave të inspektimit për garantimin e reagimit në kohë ndaj rasteve me ndotje.
10. Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa për të siguruar që Komisioni i Shqyrtimit të Ankimimeve të kryejë një analizë të plotë juridike dhe faktike të çdo ankimi administrativ, duke vlerësuar në mënyrë të argumentuar provat dhe konstatimet e trupës inspektuese para marrjes së vendimit për shfuqizimin ose lënien në fuqi të masave administrative.
11. Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa që Komisioni i Shqyrtimit të Ankimimeve, gjatë shqyrtimit të ankimeve administrative, të vlerësojë në thelb konstatimet e trupës inspektuese dhe provat e administruara gjatë inspektimit, duke mos bazuar vendimmarrjen për shfuqizimin e masave administrative vetëm në pretendime për parregullsi procedurale lidhur me mënyrën e zhvillimit të inspektimit në sistemin "e-inspektimi", pa argumentuar konkretisht natyrën dhe ndikimin e tyre në vlefshmërinë e procedurës së inspektimit, në përputhje me kërkesat ligjore.
12. Institucioni përgjegjës për funksionin e inspektimit mjedisor të marrë masa për krijimin dhe mirëmbajtjen e një databaze të unifikuar për evidentimin dhe monitorimin e masave administrative me gjobë, si dhe për rakordimin periodik të të dhënave ndërmjet nivelit qendror dhe atij rajonal, me qëllim sigurimin e saktësisë së informacionit dhe ndjekjen efektive të tyre për arkëtim.

1.1. Opinioni i auditimit

Opinion për auditimin e përputhshmërisë i kundërt[1]:

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për periudhën 01.01.2023-31.12.2025 dhe Agjencive Rajonale Mjedisore, për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2025, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve mbi të cilat këto struktura realizojnë misionin e tyre. Gjatë auditimit në terren janë marrë të dhëna, dokumentacion dhe evidenca të mjaftueshme, të cilat mundësojnë dhënien e opinionit.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e kërkuar dhe të vënë në dispozicion, në veprimtarinë e Agjencive janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e "*Bazës për Opinionin*", që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale cilësore dhe të përhapura që justifikojnë dhënien e një opinioni të kundërt.

Baza për opinionin mbi përputhshmërinë:

Nga evidencat e marra dhe të shqyrtuara për veprimtarinë e AKM dhe ARM-ve kanë rezultuar problematikat si në vijim:

1. Mangësi të evidentuara në zbatimin e kuadrit ligjor për vendosjen, shqyrtimin dhe ndjekjen e masave administrative, përfshirë shfuqizimin e pajustifikuar të gjobave, zëvendësimin e tyre me masa *"paralajmërim*" në kundërshtim me parashikimet ligjore. Konkretisht:

- Shfuqizim i pajustifikuar i gjobave në vlerën 10,490 mijë lekë;
- Vendosja e masës "*paralajmërim*" në vend të gjobës për shkelje të lejeve mjedisore nga vlera 11,600 mijë deri në vlerën 20,000 mijë lekë;
- Mos aplikimi i sanksioneve për shkelje në fushën e burimeve ujore nga vlera 2,000 mijë deri në vlerën 4,000 mijë lekë;
- Zëvendësimi i gjobave me "*paralajmërim*" në fushën e menaxhimit të mbetjeve nga vlera 6,800 mijë deri në vlerën 11,500 mijë lekë;
- Mos vendosja e gjobave për shkelje në mbrojtjen e mjedisit nga vlera 3,000 mijë deri në vlerën 6,000 mijë lekë.
- Mos ndjekja dhe mos arkëtimi i gjobave administrative në vlerën 70,207 mijë lekë.

2. Mospasja e një sistemi të integruar dhe të besueshëm për administrimin e të dhënave dhe evidencës së subjekteve ka sjellë pasaktësi dhe mospërputhje në informacionin e administruar, duke mos garantuar një bazë të saktë për identifikimin e detyrimeve dhe ndjekjen e tyre, si dhe duke kufizuar efektivitetin e kontrollit të bazuar në risk.

3. Procesi i shqyrtimit dhe miratimit të lejeve mjedisore nuk ka garantuar verifikim të plotë dhe të mjaftueshëm të dokumentacionit të paraqitur nga subjektet, duke rezultuar në vendimmarrje të bazuar në informacion të paplotë ose jo të verifikuar.

4. Procesi i monitorimit ka paraqitur mangësi në standardizimin, gjurmueshmërinë dhe ndjekjen e detyrimeve të pa arkëtuara, për shkak të përdorimit të sistemeve manuale dhe mungesës së koordinimit ndërmjet strukturave përgjegjëse,duke dobësuar ndjeshëm funksionin parandalues dhe kontrollues të institucionit.

5. Shfuqizimi i masave administrative është kryer pa një vlerësim të plotë të shkeljeve materiale dhe provave përkatëse, duke cenuar ligjshmërinë e vendimmarrjes dhe dobësuar efektivitetin e

[1] **Opinion i kundërt:** *Audituesi duhet të shprehë një opinion të kundërt: kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku,* ***janë materiale dhe të përhapura****.*

masave administrative.
6. Mangësi të theksuara në procesin e inspektimit, konkretisht në dokumentimin e veprimeve inspektuese, mospërputhje ndërmjet akteve administrative, mungesë të provave mbështetëse dhe mosrespektim të kërkesave procedurale. Veçanërisht, mos ndjekja sistematike e shkeljeve të konstatuara, përmes mosrealizimit të ri-inspektimeve dhe mos aplikimit të masave përshkallëzuese, si dhe praktika e marrjes në konsideratë të dokumentacionit të paraqitur pas konstatimit të shkeljes, kanë cënuar efektivitetin, objektivitetin dhe qëndrueshmërinë e vendimmarrjes administrative. Këto veprime kanë dobësuar ndjeshëm efektin ndëshkues dhe parandalues të inspektimit, duke krijuar kushte për përsëritje të shkeljeve dhe shmangie të përgjegjësisë nga subjektet.
7. Mungesë koordinimi ndërmjet funksioneve të monitorimit, inspektimit dhe analizave laboratorike, ku rezultatet e evidentuara për tejkalime të normave mjedisore nuk janë ndjekur në mënyrë të qëndrueshme me veprime konkrete administrative apo inspektuese. Paralelisht, mangësitë në administrimin e regjistrave dhe licencave, përfshirë mungesën e përditësimit, mbivendosjet dhe pasaktësitë në identifikimin e subjekteve, kanë cënuar integritetin e sistemit dhe kanë dobësuar mekanizmat e kontrollit institucional.
Në tërësi, natyra, shtrirja dhe përhapja e gjerë e mangësive të konstatuara tregojnë për dobësi të konsiderueshme në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe në zbatimin e kuadrit rregullator, duke ndikuar në mënyrë materiale në aftësinë e institucionit për të përmbushur funksionet e tij mbikëqyrëse në mënyrë efektive dhe të besueshme. Këto mangësi janë të përhapura dhe ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në proceset e audituara, duke krijuar pasiguri të lartë mbi saktësinë, plotësinë dhe besueshmërinë e informacionit dhe mbi efektivitetin e veprimeve administrative të ndërmarra. Në këto kushte, duke marrë në konsideratë natyrën materiale dhe përhapjen e gjerë të mangësive të konstatuara, vlerësohet se efektet e tyre janë të tilla që cenojnë në mënyrë të konsiderueshme përputhshmërinë, efektivitetin dhe besueshmërinë e proceseve të audituara, duke përbërë bazë për dhënien e një opinioni të kundërt.

HYRJE

Mbështetur në ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 769/54 prot., datë 14.10.2025, i ndryshuar, nga data 14.10.2025 deri më datë 09.02.2026, u krye auditimi me objekt përputhshmërinë e veprimtarisë në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (këtu e në vijim AKM) për periudhën 01.01.2023-31.12.2025 dhe në 4 (katër) Agjencitë Rajonale të Mjedisit (Tiranë, Berat, Lezhë dhe Fier/këtu e në vijim ARM), për periudhën nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2025, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. E. H, Përgjegjëse grupi
2. A. Ç, Anëtar
3. K. N, Anëtar
4. E. K, Anëtar
5. A. M, Anëtar.

1. Objektivat, fushëveprimi dhe metodologjia

Objektivat dhe qëllimi i auditimit është përputhshmëria e veprimtarisë së subjektit, AKM dhe ARM me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë këtu veprimtarinë në lidhje me procedurat për dhënie mendimi për lejet Mjedisore dhe Licencave, procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) paraprake dhe të thelluara, procedurat e kryerjes së inspektimeve nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Agjencitë Rajonale të Mjedisit, marrjen e masave përkatëse dhe ndjekjen e tyre.
Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur,

mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve të aktivitetit të subjektit për periudhën e aktivitetit të audituar.

2. Identifikimi i çështjes

Raporti Përfundimtar synon të identifikojë përmbushjen e rolit dhe të përgjegjësive të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat nënligjore në fuqi. Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së AKM-së dhe ARM-ve, në përputhje me aktet ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni.

Në bazë të kritereve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat. Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar

Strukturat drejtuese të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit kanë përgjegjësi për: *sigurimin e performancës mjedisore; kërkimin mjedisor; vlerësimin e impaktit mjedisor dhe licencimin; si dhe inspektimin dhe kontrolli tematik për respektimin e kërkesave ligjore e të kushteve mjedisore.*

-Sigurimin e performancës mjedisore: në përcaktimin e standardeve, kritereve mjedisore dhe metodologjive/udhëzuesve për mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit; vlerësimin e vazhdueshëm të statusit mjedisor, rolit të aktivitetit njerëzor e natyror mbi mjedisin si dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi rëndësinë e mjedisit.

-Kërkimin dhe dijen mjedisore: kryerjen e kërkimeve, analizave e bashkëpunimeve shkencore dhe propozimin e metodave e të teknikave inovative për rritjen e efektshmërisë së sektorit të mjedisit, projektimin, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin e sistemit të integruar të informacionit si dhe të regjistrave mjedisorë, nëpërmjet të cilëve sigurohet informacioni në sektorin e mjedisit;

-Vlerësimin e impaktit mjedisor dhe licencimin: vlerësimin e ndikimit në mjedis të shkaktuar nga projekte, aktivitete të subjekteve të ndryshme dhe fenomene natyrore/klimaterikë etj., duke mundësuar një mjedis brenda standardeve dhe parametrave të kërkuar dhe në përputhje me kërkesat ligjore, për jetë cilësore dhe të shëndetshme të qytetarëve; përgatitjen e projektdeklaratave mjedisore për programe, plane, strategji, projekte; hartimin e databazës së lejeve mjedisore ku të reflektohen të gjitha aplikimet për leje të bëra nga subjekte të ndryshme; përgatitjen e formatit standard të kërkesës për leje mjedisi; pranimin e aplikimeve për leje mjedisore dhe realizimin e procedurës së vlerësimit të dokumentacionit ligjor dhe teknik për pajisjen me leje (A, B).

- Inspektimin dhe kontrollin tematik për respektimin e kërkesave ligjore e të kushteve mjedisore: përgatitjen dhe ndjekjen e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit; sigurimin e kontrollit shtetëror të mbrojtjes së mjedisit siç parashikohet në legjislacionin në fuqi; kryerjen e inspektimeve dhe kontrolleve përmes një programi tematik mbi bazë risku, të miratuar nga ministri përgjegjës për mjedisin, për respektimin e kërkesave ligjore e të kushteve mjedisore, siç parashikohet në ligj dhe në legjislacionin e posaçëm në fuqi; sigurimin e zbatimit dhe kontrollin e zbatimit të akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë në fushën e inspektimit të mjedisit dhe ujërave;

shqyrtimin e ankesave për masat administrative dhe gjobat e vendosura ndaj subjekteve në kuadër të aplikimit të përgjegjësive mjedisore, detyrimeve monetare të subjekteve të gjobitura etj.

4. Përgjegjësia e audituesve të KLSH

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit në të gjithë llojet e auditimit, kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 *"Parimet themelore të auditimit të sektorit publik"*, paragrafi 44-51.

Përveç standardeve të ISSAI, ne aplikuam edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese. Gjithashtu ne: Identifikuam dhe përpunuam riskun e anomalive materiale, për shkak të gabimeve apo mashtrimeve, planifikuam, realizuam procedura auditimi sipas risqeve të identifikuara, dhe grumbulluam evidencë të mjaftueshme e të përshtatshme për formulimin e opinionit tonë.

Krijuam një konkluzion final nëse çështjet rutinë të raportimit të të dhënave janë kryer në mënyrën e duhur dhe u bazuam në evidencën e marrë nga auditimi, për ekzistencën e ndonjë dyshimi material mbi ngjarjet apo kushtet që mund të çonin në një dyshim edhe më të madh mbi aftësinë e institucionit për të funksionuar normalisht.

Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit.

5. Kriteret e vlerësimit

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

- Ligji nr. 154/2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*;
- Ligji nr. 10448, datë 7.14.2011 *"Për Lejet e Mjedisit'"* i ndryshuar;
- Ligji nr. 10440, datë 07.07.2011 *"Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis"* i ndryshuar;
- Ligji nr. 10463, datë 9.22.2011 *"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"* i ndryshuar;
- Ligji nr. 10433, datë 06.16.2011 *"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë";*
- Ligji nr. 9115, datë 24.7.2003 *"Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura"* i ndryshuar;
- Ligji nr. 128/2020, datë 22.10.2020 *"Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis";*
- Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 *"Për mbrojtjen e mjedisit";*
- Ligji nr. 111, datë 15.11.2012 *"Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar;*
- VKM nr. 419, datë 25.6.2014 *"Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja";*

- VKM nr. 686, datë 29.7.2015 *"Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore";*
- VKM nr. 229, datë 23.04.2014 *"Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme";* etj.

6. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), përkatësisht në: Nivelin e parë "Parimet INTOSAI-t" ku përfshihet: ISSAI-P-1 "Deklarata e Limës", ISSAI-P-10 "Deklarata e Meksikos"; Nivelin e dytë "Standardet e INTOSAI-t" ku përfshihen: ISSAI 100 - Parimet bazë në auditimin e sektorit publik; ISSAI 200-299 "Parimet bazë të auditimit financiar", ISSAI 400-499 "Parimet bazë të auditimit të përputhshmërisë".
Gjithashtu janë zbatuar dhe aplikuar standardet si më poshtë:
ISSAI-140 "Sigurimin e cilësisë"
ISSAI 130 "Kodin Etik"
ISSAI 2315 "Risku"
ISSAI 2320-2450 "Materialiteti"
ISSAI 2500 "Dokumentimi".

7. Metodat e auditimit

Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efiçencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku.
Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:
-*Konfirmim nga të tretët*. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.
-*Kontrolli sipas një treguesi*. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël si mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.
-*Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.
-*Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit të subjektit që auditohet.
-*Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.
-*Pyetësorët* - grupi i auditimit ka përdorur pyetësor për vlerësimin dhe testimin e drejtimeve të auditimit.
-*Verifikimi në sistemet e Agjencisë* - me përzgjedhje i çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;
-*Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.
Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

8. Dokumentimi i auditimit

Është mbështetur në kërkesat e Manualit të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 "Dokumentimi i Auditimit", i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve dhe në përgatitjen e këtij Raport Përfundimtar Auditimi.

III. PËRSHKRIM I AUDITIMIT

Informacion i përgjithshëm

Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) u krijua në mbështetje, të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 *"Për mbrojtjen e Mjedisit"* dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 568 datë 17.07.2019 *"Për krijimin, mënyrën e organizmin dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit"*. Agjencia Kombëtare e Mjedisit është një institucion qendror publik në varësi të ministrit përgjegjës për mjedisin, që ushtron juridiksionin e vet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, përmes zyrës qendrore të AKM-së dhe 4 Agjencive Rajonale të Mjedisit. Agjencitë Rajonale të Mjedisit në katër Rajonet me qendër në Tiranë, Lezhë, Fier dhe Berat, kryejnë veprimtarinë e tyre referuar referuar kuadrit ligjor në fuqi duke raportuar mbi veprimtarinë e tyre pranë AKM-së.

2. Rezultatet e auditimit, sipas drejtimeve të auditimit

2.1 Planifikimi, zbatimi dhe monitorimi i buxhetit. Programimi PBA dhe buxhetit vjetor, çelja e fondeve vjetore dhe ndryshimet sipas akteve normative, saktësia e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) është një institucion publik qendror, në varësi të Ministrisë së Mjedisit, që ushtron kompetencat funksionale në të gjithë Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet strukturës qendrore dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit (ARM). Financimi i saj realizohet nga Buxheti i Shtetit, si dhe nga të ardhurat e krijuara nga burime të veta.

Programi Buxhetor Afatmesëm

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është instrument operacional për menaxhimin e shpenzimeve publike dhe një komponent i Sistemit të Planifikimit të Integruar. Ky dokument përdoret për të informuar Kuvendin e Shqipërisë dhe publikun e gjerë lidhur me planet e shpenzimeve të qeverisë për tre vitet e ardhshme, të cilat do të çojnë në arritjen e objektivave politike të qeverisë. Ai përcakton kontekstin afatmesëm të buxhetit vjetor. Kërkesat buxhetore të institucionit hartohen në bazë të programit buxhetor afatmesëm, në mënyrë që shpërndarjet e fondeve buxhetore të reflektojnë qëllimet e politikës dhe iniciativat e përcaktuara në programin e qeverisë gjatë një periudhe 3-vjeçare, në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* të ndryshuar, Udhëzimit të MFE nr. 7 datë 28.02.2018, *"Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm".* Planifikimi i zërave të shpenzimeve për "*Fondin e pagave & sigurimeve shoqërore*" (llog 600 dhe 601), është bazuar në nivelin aktual të punonjësve dhe strukturës së miratuar për secilin program

buxhetor të pagave sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Llogaritja për shpenzime të tjera korrente (llog 602-606) është bazuar në kërkesat e institucioneve të varësisë së këtij institucioni, tavaneve të miratuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë limiteve të shpenzimeve të periudhave paraardhëse dhe realizimi i pritshëm të vitit.

Buxheti i vitit 2023

AKM, me shkresën nr. 6573 prot., datë 24.08.2022, në kuadër të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2023–2025, faza teknike, ka përcjellë pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit kërkesat buxhetore, brenda afatit të parashikuar në VKM nr. 22, datë 17.01.2024 *"Për miratimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike për vitin 2023".*

Për vitin 2023 u ngrit Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), me anë të Urdhrit të DP nr. 84 datë 18.04.2023 *"Për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik".* Ky grup është kryesuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe 7 anëtar sipas funksioneve si vijon: Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Buxhetit, Drejtor i Regjistrave Mjedisor, Inovacionit dhe Analizave Laboratorike, Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit dhe Edukimit Mjedisor, Drejtor i Drejtorisë së Inspektim Kontrollit, Drejtor i Drejtorisë së Lejeve Mjedisore dhe VNM, Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Marrëdhënieve Ligjore, Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse. Sa i përket takimeve që GMS duhet të zhvilloj në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, i ndryshuar rezultoi se:

- Për vitin 2023, sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion janë realizuar 4 takime të GMS për të cilat është mbajtur dhe procesverbali respektiv. Takimet e datave 27.04.2023 dhe 25.08.2023 kanë pasur fokus hartimin dhe miratimin e Programit të Buxhetit Afatmesëm 2024 - 2026. Takimi i zhvilluar më datë 16.06.2023 ka pasur qëllim miratimin e regjistrit të riskut dhe planit të menaxhimit të riskut për AKM për vitin 2023. Takimi i zhvilluar më datë 02.10. 2023 ka pasur qëllim raportimin e monitorimit të buxhetit periudha Janar - Gusht 2023.

Në zbatim të Ligjit nr. 84/2022, datë 24.11.2022 *"Për buxhetin e vitit 2023"* dhe Udhëzimit të MFE-së nr. 9, datë 20.03.2018 *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"* me shkresën nr. 487/1 prot., datë 30.01.2023 të MTM është përcjellë detajimi i fondeve buxhetore për shpenzimet korente për vitet 2023 - 2025.

Tabela nr. 1: Programi Buxhetor *në mijë lekë*

Kodi buxhetor	Programi Buxhetor	Kërkesa PBA 2023 – 2025	Buxheti Vjetor Plani fillestar Viti 2023	Buxheti i Rishikuar Viti 2023	Diferenca (Buxhet i rishikuar- PBA)
05320	Programi i Mjedisit	229,511	182,400	193,535	204,130

Burimi: *Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të AKM*

Për vitin 2023, është planifikuar në PBA 2023-2025, shuma prej 229,511 mijë lekë dhe deri në fund të vitit 2023, pas rishikimit të buxhetit, janë alokuar 193,535 mijë lekë, pra 35,976 mijë lekë më pak se plani në PBA.

Buxheti i akorduar gjatë vitit 2023 sipas llogarive specifikohet si vijon:

Tabela nr. 2: Buxheti i akorduar gjatë 2023 *në mijë lekë*

Emërtimi	Kërkesa në PBA 2023-2025	Plan Fillestar Viti 2023	Buxheti i rishikuar Viti 2023	Diferencë Buxhet i alokuar- PF	Realizimi 2023
Llogaria 600 *Pagat*	106,098	110,000	116,365	6,365	116,261
Llogaria 601 *Kon & sig shoq.*	17,718	18,400	18,450	50	18,409
Llogaria 602 *Mallra dhe Shërbime*	90,395	44,000	48,200	4,200	42,764
Llogaria 604 *Të tjera trans. korrente të brendsh.*	10,000	10,000	10,000	0	6,754
Llogaria 606 *Transf. për buxhet. fam. & ind*	5,300	0	520	520	520
Totali i shpenzimeve	**229,511**	**182,400**	**193,535**	**11,135**	**184,708**

Burimi: *Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të AKM*

Sipas tabelës së mësipërme buxheti fillestar i akorduar për 2023 paraqitet në vlerën 182,400 mijë lekë. Ndryshimet nga buxheti fillestar te ai i rishikuar janë kryesisht për zërat me natyrë operacionale dhe shpenzimet e personelit. Artikulli 600 "Pagat" ka pësuar rritje nga 110,000 mijë në 116,365 mijë. Realizimi në vlerën 116,261 mijë lekë është shumë afër buxhetit të rishikuar, duke treguar planifikim dhe administrim efektiv pasi u krye rishikimi buxhetor. Gjithashtu, në llogarinë 601 rritja minimale prej 50 mijë lekësh tregon përafrim automatik me ndryshimin e fondit të pagave. Realizimi në vlerën 18,409 mijë lekë është brenda nivelit të rishikuar prej 18,450 mijë lekë, pa devijime të dukshme. Këto ndryshime janë kërkuar me shkresën nr. 4512/1 prot., datë 24.07.2023 të MTM, protokolluar në AKM me nr. 5556 prot., datë 19.07.2023 është bërë shtesë fondi në artikullin 600 dhe 601, kjo me hyrjen në fuqi të VKM nr. 325, datë 31.05.2023 *"Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike"*, Vendimit nr. 323, datë 31.05.2023 *"Për miratimin e strukturës së pagës dhe të niveleve të pagave të pozicioneve koordinator, të rrjetit të koordinatorëve kundër korrupsionit në disa institucione të administratës shtetërore"*, VKM nr. 326/2023 *"Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike"* dhe miratimit për përfitimin e shkallës së vështirësisë për 12 vende laboratori, 5 vende pune punonjës mbështetës dhe 1 pozicioni antikorrupsion. Me Aktin Normativ nr. 6, datë 14.12.2023 është bërë pakësim fondi në llogarinë 600 shuma 2,000,000 lekë dhe llogarinë 601 në shumën 1,000,000 lekë.

Për llogarinë 602 "Mallra dhe shërbime" është kërkuar shtesë fondi me shkresën nr. 4895 prot., 29.06.2023 në shumën 4,200,000 lekë për shpenzime operative dhe kërkesa është miratuar me shkresën nr. 4895/1 prot., datë 24.07.2023. Kjo shtesë është kërkuar për zërat:
- Kërkesë për shlyerjen e vendimeve gjyqësore në shumën prej 2,000,000 lekë;
- Kërkesë për mbështetje në zërin Dieta jashtë vendit në shumën prej 500,000 lekë;
- Kërkesë për publikimin, dizenjimin dhe printimin e Raportit të Gjendjes së Mjedisit për vitin 2022 dhe broshura informuese mbi gjendjen e mjedisit në shumën prej 1,100,000 lekë;
- Kërkesë për shërbim transporti të qeseve të sekuestruara në vlerën 600,000 lekë.

Për këtë zë vihet re një diferenca më e madhe: kërkesa në PBA ishte 90,395 mijë lekë, ndërsa plani fillestar në vlerë 44,000 mijë lekësh, duke treguar nën-planifikim fillestar. Rishikimi e rriti buxhetin në 48,200 mijë lekë, por realizimi është 42,764 mijë lekë, 5,436 mijë lekë më i ulët se buxheti i rishikuar.Për llogarinë 604 "Të tjera: transferta korrente të brendshme", nuk ka patur ndryshim midis planit fillestar dhe atij të rishikuar.
Për llogarinë 606 "Transferta për individë" nuk ka pasur planifikim fillestar, por gjatë vitit u alokuan 520 mijë lekë, të cilat u realizuan plotësisht. Kjo lidhet me dalje në pension, që nuk ishte parashikuar me saktësi në PBA.
Në zbatim të VKM nr. 795, datë 28.12.2023 *"Për shpërblimin e punonjësve të Qeverisjes Qëndrore në procesin e shqyrtimit analitik të ACQUIS (SCREENING) në kuadër të procesit të negociatave me BE"*, shkresës së MFE nr. 139 prot., datë 05.01.2024 dhe asaj nr. 84 prot., 04.01.2024, ka pasur shtesë fondi në artikullin 600 në shumën 1,365,000 lekë, për shpërblimin e 9 punonjësve për pjesëmarrje fizike në takimet bilaterale BE, Kapitulli 27 dhe kontribuese online në kapitullin 33.
Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vitin 2023.

Tabela nr. 3: *Realizimi i buxhetit për vitin 2023 në mijë lekë*

Kod produkti	Emërtimi i produktit	Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2023	Shpenzime Faktike të Periudhës/Progresive	Diferenca Plan/Fakt	% e realizimit
	Totali i Shpenzime Korente				
600 AB	Shpenzime paga	48,165	48,164	1	99
600 AC	Shpenzime paga	46,800	46,800	0	100
600 AD	Shpenzime paga	21,400	21,297	103	99
601 AB	Sigurime shoqërore	7,820	7,820	0	100
601 AC	Sigurime shoqërore	7,820	7,820	0	100
601 AD	Sigurime shoqërore	2,810	2,769	41	98
602 AB	Materiale dhe shërbime	8,200	8,199	1	99
602 AC	Materiale dhe shërbime	37,000	31,567	5,433	85
602 AD	Materiale dhe shërbime	3,000	2,998	2	99
604 AC	Transferime Korrente	10,000	6,754	3,246	67
606	Shpenzime fondi i veçantë	520	520	0	100
	Totali i Shpenzime për Investime	0	0	0	0
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm				
	Totali i Shpenzimeve të Programit	**193,535**	**184,708**	**8,827**	**95**

Burimi: *Të dhënat AKM përpunuar nga grupi punës*

Tabela e mësipërme paraqet të dhënat mbi planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve sipas artikujve ekonomikë për vitin 2023. Shuma totale e planifikuar është 193,535 mijë lekë, ndërsa realizimi faktik është 184,708 mijë lekë që korrespondon me 95% realizim. Diferenca e papërdorur është 8,827 mijë lekë. Shpenzimet për paga (600 AB, 600 AC, 600 AD) me realizim 99-100% tregon se pagesat e personelit janë kryer normalisht dhe pa devijime të rëndësishme. Sigurimet shoqërore kanë realizim 100% duke treguar përmbushje të plotë të detyrimeve ligjore për kontributet shoqërore. Përsa i përket shpenzimeve korrekte materiale dhe shërbime, artikulli 602 AB ka realizim më të ulët prej 85% gjë që tregon se një pjesë e mallrave/shërbimeve nuk është kryer. Transferimet korente janë realizuar në masën 67% me një diferenë prej 3,264 mijë lekë, diferencë që vjen për shkak të ndryshimit të nevojave gjatë vitit buxhetor. Për fondin e veçantë realizimi është në masën 100%, pra fondi është përdor sipas destinacionit specifik.

Për vitin 2023:
- Totali i shpenzimeve nga 182,400 (plan fillestar) u rrit në 193,535 (pas rishikimit);
- Realizimi final ishte 184,708, pra 8,827 mijë lekë më pak sesa buxheti i rishikuar.

Ekzekutimi i shpenzimeve total është në vlerën 95%, duke treguar menaxhim të qëndrueshëm të buxhetit. Problematika kryesore identifikohet te mallrat dhe shërbimet, ku disa procese prokurimi nuk janë realizuar.

Shpenzimet e kryera sipas artikujve për vitin 2023 rezultojnë:

Tabela nr. 4: *Shpenzime për vitin 2023* *në mijë lekë*

Artikulli	Institucioni: AKM	Plan	Fakt	Diferenca	% realizim
600	Paga	116,365	116,261	104	99
601	Sigurime shoqërore	18,450	18,409	41	99
602	Mallra, shërbime të tjera	48,200	42,764	5,436	88
6020	Materiale dhe shërbime	2,957	2,563	394	86
6021	Materiale speciale	3,222	3,221	1	99
6022	Shërbime	7,105	6,131	974	86
6023	Shpenzime transporti	9,911	9,282	629	93
6024	Shpenzime udhëtimi	11,900	10,435	1,465	87
6025	Mirëmbajtje të zakonshme	4,880	4,860	20	99
6027	Vendime gjyqësore	6,000	4,237	1,763	70
6029	Shpenzime operative të tjera	2,225	2,023	202	90
604	Transferime korrente	10,000	6,754	3,246	67
606	Shpenzime nga fondi i veçantë	520	520	0	100

Burimi: *Të dhënat AKM*

Sa më sipër, shpenzimet kryesore si paga dhe sigurime realizohen pothuajse plotësisht, duke treguar stabilitet financiar. Kategoria e mallra shërbimeve ka realizim të pjesshëm, që sugjeron

nevojën për planifikim më të saktë të blerjeve dhe monitorim më të saktë të procedurave. Realizimi më i ulët te transfertat (67%) tregon ndryshim të prioriteteve ose nevojë për rishikim të politikës së shpërndarjes.

Tabela nr. 5: *Lista e projekteve të investimeve të planifikuara në PBA 2023 - 2025* *në mijë lekë*

Nr.	Kod investimi	Objekti i investimit	PBA 2023 - 2025	Plani fillestar 2023	Plan i rishikuar 2023	Fakt 2023	Diferenca midis PBA dhe Realizim
1	231	Pajisje kompjuterike	3,000	0	0	0	3,000
2	231	Blerje pajisjesh laboratorike	4,000	0	0	0	4,000
3	231	Pajisje dhe pjesë këmbimi për stacionet e monitorimit te ajrit	10,000	0	0	0	10,000
4	231	Blerje 3 stacione monitorimit të ajrit	94,023	0	0	0	94,023
		Total	**111,023**	**0**	**0**	**0**	**111,023**

Burimi: *Të dhënat AKM, përpunuar nga grupi i auditimit*

Tabela më sipër paraqet projektet e investimeve të parashikuara në PBA 2023-2025. Të total janë parashikuar 4 projekte investimi nën kodin 231, që lidhet me blerje pajisjesh dhe investimesh materiale për funksionimin institucional. Shuma totale e parashikuar për periudhën është 111,023 mijë lekë. Edhe pse vlera totale e projekteve figuron në PBA për periudhën 2023-2025, në kolonën e Planit fillestar 2023 paraqitet vlerë 0 për të gjitha projektet. Kjo tregon planifikim në nivel afatmesëm, por pa alokim buxheti vjetor për vitin 2023, duke e bërë të pamundur nisjen e procedurave të prokurimit gjatë vitit. Gjithashtu, vihet re mungesa e rishikimit buxhetor brenda vitit buxhetor 2023 për të mundësuar fillimin e projekteve. Diferenca midis planifikimit dhe realizimit është 100%, pra 111,023 mijë lekë fonde të pa investuara. Nga analiza vihet re se, edhe pse investimet janë planifikuar, ato nuk kanë kaluar në fazën e zbatimit, për shkak të mungesës së fondeve të alokuara në buxhetin vjetor. Kjo situatë tregon mungesë koherence midis planifikimit afatmesëm dhe buxhetimit vjetor operativ, duke sjellë si rezultat mosrealizimin e plotë të projekteve të investimeve për vitin 2023.

Për vitin 2023, AKM ka mbledhur të ardhura dytësore në vlerën 12,451,406 lekë.

Tabela nr. 6: *Të ardhurat dytësore të vitit 2023*

Kodi Inst.	Klasif. buxhetor	Përshkrimi	Të ardhura progresive	Pjesa e Institucionit	Rritje e autorizuar	Derdhur në buxhet	Mbeten për tu trashëguar
1026060	7113099	Të ardhura nga tarifat	1,015,632	0	0	10,151,632	8,729,178
	7211100	Të ardhura nga grantet	2,299,774	2,299,774	2,299,774		
Totali			**12,451,406**	**2,299,774**	**2,299,774**	**10,151,632**	

Burimi: *Të dhënat AKM, shkresa e rakordimit me thesarin*

Referuar të dhënave të mësipërme, të ardhurat dytësore për vitin 2023 janë krijuar nga: tarifat në vlerën 1,015,632 lekë dhe nga grantet në vlerën 2,299,774 lekë. Vlera e të ardhurave derdhur në buxhet është 10,151,632 lekë.

Raportet e monitorimit

Sa i takon raporteve të monitorimit, konstatohet se për vitin 2023 AKM ka hartuar raportet e monitorimit 4 mujore, për të ndjekur realizimin e produkteve të buxhetit, për të garantuar përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit, ndjekjen dhe arritjen e qëllimit dhe objektivave të synuara, sipas deklaratës së politikës së programit, si dhe krahasimin e treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktik. Me shkresën nr. 3459/1 prot., datë 19.05.2023 është dërguar në MTM raporti i monitorimit të buxhetit për periudhën Janar-Prill 2023. Me shkresën nr. 7243/1 prot., datë 02.10.2023 është dërguar raporti i monitorimit të buxhetit për

periudhën Janar-Gusht 2023 dhe me shkresën nr. 624/1 prot., datë 08.02.2024 është dërguar raporti i monitorimit të buxhetit për vitin 2023. Këto raporte janë hartuar në përputhje me afatet e përcaktuara në udhëzimin nr. 9860/1 prot., datë 30.05.2023 "*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore*".

Buxheti i vitit 2024

AKM me shkresën nr. 6759 prot., datë 28.08.2023, ka përcjellë pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit "*Projekt Buxheti Afatmesëm 2024–2026*", në kuadër të fazës teknike, në përputhje me afatin e përcaktuar në Udhëzimin plotësues nr. 22, datë 07.07.2023 *"Për përgatitjen e PBA 2024–2026".* Nga auditimi konstatohet se AKM në të dy fazat e PBA-së, ka përcjellë dokumentacionin përkatës të shoqëruar me relacionet shpjeguese, në përputhje me kërkesat e pikës 8 të Udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm*".Me shkresën nr. 3346 prot., datë 02.05.2023, AKM ka përcjellë pranë Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit "*Projekt Buxhetin Afatmesëm 2024-2026*", faza strategjike.

Janë përcjellë kërkesat buxhetore, pasqyrat plotësuese të projektbuxhetit të vitit 2024 dhe relacioni shoqërues. Sipas afatit të përcaktuar në pikën 9/a të Udhëzimit plotësues nr. 5, datë 28.02.2023 "*Për përgatitjen e PBA 2024-2026*".

Me shkresën nr. 6759 prot., datë 28.08.2023, AKM ka përcjellë pranë Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit "*Projekt Buxhetin Afatmesëm 2023-2025*", faza teknike.Të dyja fazat e PBA-së janë përcjellë me relacionet shoqëruese përkatëse në përputhje me pikën 8 të udhëzimit nr. 7, datë 28.2.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm"*.

Për vitin 2024 u ngrit GMS, me anë të Urdhrit të DP nr. 5 datë 15.01.2024 *"Për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik".* Urdhri pësoi disa ndryshime me urdhrin e brendshëm nr. 137, datë 14.06.2024 dhe urdhrin e brendshëm nr. 228, datë 09.10.2024 duke reflektuar ndryshimet e anëtarëve pjesë të GMS, si pasojë e lëvizjeve/shkëputjeve të marrëdhënieve të punës. Sa i përket takimeve që GMS duhet të zhvilloj në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, i ndryshuar rezulton se janë realizuar 4 takime të GMS për të cilat është mbajtur dhe procesverbali respektiv.

Në zbatim të Ligjit nr. 97/2023 *"Për buxhetin e vitit 2024"* dhe Udhëzimit të MFE-së nr. 9, datë 20.03.2018 *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"*, me shkresë nr. 133/4 prot., datë 12.02.2024 është përcjellë nga ana e MTM detajimi i fondeve buxhetore për shpenzimet korente për vitet 2024-2026.

Tabela nr. 7: *Programi Buxhetor* *në mijë lekë*

Kodi buxhetor	Programi Buxhetor	Kërkesa PBA 2023 – 2025	Buxheti Vjetor Plani fillestar Viti 2023	Buxheti i Rishikuar viti 2023	Diferenca (Buxhet i rishikuar- PBA)
05320	Programi i Mjedisit	229,511	182,400	193,535	204,130

Burimi: *Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të AKM*

Për vitin 2024, janë planifikuar në PBA 2024 - 2026, shuma prej 301,908 mijë lekë dhe deri në fund të vitit 2024 pas rishikimit të buxhetit, janë alokuar 189,382 mijë lekë, pra 19,718 mijë lekë më pak se plani në PBA.

Buxheti i akorduar gjatë vitit 2024 sipas llogarive specifikohet si vijon:

Tabela nr. 8: *Buxheti i akorduar gjatë 2024* *në mijë lekë*

Emërtimi	Kërkesa në PBA 2024 – 2026	Plan Fillestar Viti 2024	Buxheti i rishikuar Viti 2024	Diferencë Buxhet i alokuar- PF	Realizimi 2024
Llogaria 600 *Pagat*	216,942	138,000	120,500	(17,500)	118,578
Llogaria 601 *Kontribute & sigurime shoqërore*	36,229	23,100	20,300	(2,800)	19,691
Llogaria 602 *Mallra dhe Shërbime*	43,000	43,000	42,960	(40)	37,713
Llogaria 604 *Të tjera trans. korrente të brendsh.*	5,000	5,000	5,000	0	4,045
Llogaria 606 *Transf. për buxhet. fam. & indi*	737	0	622	622	595
Totali i shpenzimeve	**229,511**	**182,400**	**193,535**	**11,135**	**184,708**

Burimi: *Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të AKM*

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2024 janë kryer transferime buxhetore në total në shumën 19,718 mijë lekë. Janë kryer pakësime fondesh në programin e pagave në shumën 17,500 mijë lekë, në programin e kontributeve të sigurimeve shoqërore në shumën 2,800 mijë lekë, mallra dhe shërbime në shumën 40 mijë lekë.

Vihet re se në vitin 2024 ka pasur ulje të ndjeshme të buxhetit gjatë procesit të rishikimit, sidomos për fondin e pagave dhe sigurimeve shoqërore, ndërsa artikulli për transfertat ndaj individëve (llogaria 606) është shtuar gjatë vitit. Këto ndryshime kanë ardhur nga kërkesa për rialokim fondi nga llogaria 602 në llogarinë 606 me shkresën nr. 545/1 prot., datë 31.01.2024, në shumën 40,000 lekë për kompensimin e funksionarit përfitues të telefonisë celulare sipas lidhjes nr. 5, miratuar me shkresën nr. 1340/2 prot., datë 11.03.2024, protokolluar në AKM me shkresën nr. 545/2 prot., datë 13.03.2024. Gjithashtu, është kërkuar për rialokim fondi në llogarinë 606 me shkresën nr. 10374 prot., datë 07.10.2024, kërkesë e miratuar me shkresën nr. 6317/1 prot., datë 23.10.2024, protokolluar ne AKM me nr. 10374/1 prot., datë 24.10.2024.

Daljet në pension vazhdojnë të mos parashikohen, duke krijuar shtesa brenda vitit në llogarinë 606.

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vitin 2024:

Tabela nr. 9: *Realizimi i buxhetit për vitin 2024* *në mijë lekë*

Kod produkti	Emërtimi i produktit	Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2024	Shpenzime Faktike të Periudhës/Progresive	Diferenca Plan/Fakt	% e realizimit
	Totali i Shpenzime Korente				
600 AB	Shpenzime paga	55,200	54,522	678	98
600 AC	Shpenzime paga	55,200	54,400	800	98
600 AD	Shpenzime paga	10,100	9,656	444	95
601 AB	Sigurime shoqërore	9,300	9,300	0	100
601 AC	Sigurime shoqërore	9,300	8,787	513	94
601 AD	Sigurime shoqërore	1,700	1,604	96	94
602 AB	Materiale dhe shërbime	4000	27	3,973	1
602 AC	Materiale dhe shërbime	35,960	34,686	1,274	96
602 AD	Materiale dhe shërbime	3,000	3,000	0	100
604 AC	Transferime Korrente	5,000	4,045	955	80
606	Shpenzime fondi i veçantë	622	595	27	95
	Totali i Shpenzime për Investime	0	0	0	0
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm				
	Totali i Shpenzimeve të Programit	**189,382**	**180,622**	**8,760**	**95**

Burimi: Të dhënat AKM, përpunuar nga grupi i auditimit

Referuar tabelës, shuma totale e planifikuar për vitin 2024 është 189,382 mijë lekë. Shpenzimet faktike të realizuara janë 180,622 mijë lekë, pra një realizim 95% i planit. Diferenca e papërdorur rezulton 8,760 mijë lekë.

Shpenzimet korrente (pagat, sigurimet shoqërore dhe materialet/shërbimet) përbëjnë pjesën më të madhe të buxhetit dhe kanë një nivel realizimi te lartë (95-100%) duke treguar për menaxhim të qëndrueshëm të shpenzimeve operacionale. Artikulli 602 AB ka realizim vetëm 1%, ku janë shpenzuar 27 mijë lekë nga 4,000 mijë të planifikuara, një realizim shumë i ulët, që tregon anulim

të shërbimeve apo vonesa në procedurat e prokurimit. Ndërkohë, artikujt 602 AC dhe 602 AD kanë realizim të lartë, 96% dhe 100% që tregon përdorim efektiv të fondeve për këto artikuj. Transferimet korente janë me realizim 80%, pra mbeten të papërdorura rreth 955 mijë lekë. Shpenzimet për investime janë 0, që tregon se gjatë vitit 2024 nuk janë kryer shpenzime kapitale dhe fondet janë fokusuar në shpenzimet korrente. Realizimi i buxhetit prej 95% tregon menaxhim të qëndrueshëm financiar dhe kontroll të shpenzimeve.

Tabela nr. 10: *Lista e projekteve të investimeve të planifikuara në PBA 2024-2026* *në mijë lekë*

Nr	Kod investimi	Objekti i investimit	PBA 2024 - 2026	Plani fillestar 2025	Plan i rishikuar 2025	Fakt 2025	Diferenca midis PBA dhe Realizim	% e realizimit
1	230	Krijimi i RSHTN	2,000	0	0	0	2,000	0
2	231	Pajisje kompjuterike	8,431	0	2,000	0	8,431	0
3	231	Blerje 3 stacione monitor të ajrit	120,000	0	0	0	120,000	0
		Totali	**130,431**	**0**	**2,000**	**0**	**130,431**	**0**

Burimi: *Të dhënat AKM, përpunuar nga grupi i auditimit*

Për vitin 2024 nuk ka pasur planifikim/realizim të asnjë prej objekteve të investimit. Diferenca midis PBA-së dhe realizimit është e plotë, pra 130,431 mijë lekë, që do të thotë se edhe pse janë planifikuar në fazën e PBA-së, ato nuk janë çelur, dhe si rezultat nuk janë realizuar.
Për investimin "Pajisje kompjuterike" nuk janë parashikuar fonde në planin fillestar të 2025, por është bërë rishikim i tij në vlerën 2,000 mijë lekë në këtë zë në planin e rishikuar 2025. Brenda periudhës së auditimit nuk ka shpenzime faktike për këtë zë. Sa më sipër, niveli i realizimit 0% për investimet e parashikuara në PBA 2024 - 2026 sinjalizon mungesë fondesh të disponueshme në kohë.
Për vitin 2024, AKM ka mbledhur të ardhura dytësore në vlerën 5,693,825 lekë.

Tabela nr. 11: *Të ardhurat dytësore të vitit 2024*

Kodi Inst.	Klasif. buxhetor	Përshkrimi	Shuma e trashëguar nga viti i mëparshëm	Të ardhura progresive	Pjesa e Institucionit	Rritje e autorizuar	Derdhur në buxhet	Mbeten për tu trashëguar
1026 060	7113099	Të ardhura nga tarifat	565,000	1,884,800	0	0	1,884,800	0
	7211100	Të ardhura nga grantet		3,809,025	3,809,025	3,809,025		63,415,112
Totali				**5,693,825**	**3,809,025**	**3,809,025**	**1,884,800**	**63,415,112**

Burimi: *Të dhënat AKM, shkresa e rakordimit me thesarin*

Referuar të dhënave të mësipërme, të ardhurat dytësore për vitin 2024 janë krijuar nga: tarifat në vlerën 1,884,800 lekë dhe nga grantet në vlerën 3,809,025 lekë. Vlera e të ardhurave derdhur në buxhet është 1,884,800 lekë.

Raportet e monitorimit

Për vitin 2024 janë hartuar 3 raporte monitorimi, përkatësisht me shkresat: nr. 5570 prot., datë 21.05.2024 për periudhën Janar-Prill, nr. 9696 prot., datë 18.09.2024 për periudhën Janar - Gusht dhe nr. 687/1 prot., datë 12.02.2025 për periudhën Janar-Dhjetor. Këto raporte janë hartuar në përputhje me afatet e përcaktuara në udhëzimin nr. 9860/1 prot., datë 30.05.2023 "*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore*".

Buxheti i vitit 2025

Me shkresën nr. 4866 prot., datë 28.04.2024, AKM ka përcjellë pranë Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit *"Projekt Buxhetin Afatmesëm 2025-2027"*, faza strategjike dhe relacioni shoqërues, duke respektuar afatin për dorëzimin e kërkesave buxhetore. Me shkresën nr. 8658 prot., datë 16.08.2024, AKM ka përcjellë pranë Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit *"Projekt Buxhetin*

Afatmesëm 2025-2027", faza teknike dhe relacioni shoqërues, duke respektuar afatin për dorëzimin e kërkesave buxhetore.

Për vitin 2025 u ngrit GMS, me anë të Urdhrit të DP nr. 22 datë 23.01.2025 *"Për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik",* ndryshuar më tej me urdhrin nr. 85, datë 15.04.2025 dhe me urdhrin nr. 105, datë 03.06.2025.

Sa i përket takimeve që GMS duhet të zhvilloj në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, i ndryshuar rezultoi se janë realizuar 4 takime të GMS për të cilat është mbajtur dhe procesverbali respektiv.

Takimet e kryera janë të dokumentuara në të gjitha rastet, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, i ndryshuar, neni 27, pika 1 dhe me Udhëzimin nr. 16 të MFE, datë 20.07.2016 *"Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike"*, pika nr. 3, paragrafi 2.2.4 *"Roli i GMS në sistemin e MFK",* e cila përcakton se: *"GMS duhet të mblidhet të paktën katër herë në vit"*.

Në zbatim të Ligjit nr. 115/2024 *"Për buxhetin e vitit 2025"* dhe Udhëzimit të MFE-së nr. 9, datë 20.03.2018 *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"*, me shkresën nr. 17548/55 prot., datë 13.01.2023, MFE dërgon në DPT detajimin e shpenzimeve korente 2025-2027.

Tabela nr. 12: *Programi Buxhetor* *në mijë lekë*

Kodi buxhetor	Programi Buxhetor	Kërkesa PBA 2025 – 2027	Buxheti Vjetor Plani fillestar Viti 2025	Buxheti i Rishikuar viti 2025	Diferenca (Buxhet i rishikuar- PBA)
05320	Mbrojtja e Mjedisit	628,064	240,670	221,915	(406,149)

Burimi: *Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të AKM*

Për vitin 2025, janë planifikuar në PBA 2025-2027, shuma prej 628,064 mijë lekë dhe deri në fund të vitit 2025, pas rishikimit të buxhetit, janë alokuar 221,915 mijë lekë, pra 406,149 mijë lekë më pak se plani në PBA.

Buxheti i akorduar gjatë vitit 2025 sipas llogarive specifikohet në tabelë më poshtë:

Tabela nr. 13: *Buxheti i akorduar gjatë 2025* *në mijë lekë*

Emërtimi	Kërkesa në PBA 2025-2027	Plan Fillestar Viti 2025	Buxheti i rishikuar Viti 2025	Diferencë Buxhet i alokuar- PF	Realizimi 2025
Llogaria 600 *Pagat*	140,240	143,400	125,600	(17,800)	123,651
Llogaria 601 *Kontribute & sig. Shoq*	23,420	24,270	20,970	(3,300)	20,562
Llogaria 602 *Mallra dhe Shërbime*	42,960	68,000	67,960	(40)	53,575
Llogaria 604 *Të tjera trans. korrente të brendsh.*	5,000	5,000	5,000	0	4,246
Llogaria 606 *Transf. për buxhet. fam. & ind*	400	0	385	385	302
Llogaria 231 *Shpenzimeve Kapitale / Inves*	542,044	0	2,000	2,000	0
Totali i shpenzimeve	**628,064**	**240,670**	**221,915**	**(18,755)**	**202,336**

Burimi: *Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të AKM*

Sipas tabelës së mësipërme, buxheti fillestar i akorduar për AKM paraqitet në vlerën 240,670 mijë lekë. Gjatë vitit 2025 janë kryer transferime buxhetore në total në shumën 18,755 mijë lekë. Janë kryer pakësime fondesh në programin e pagave në shumën 17,800 mijë lekë dhe në programin e mallra dhe shërbime në shumën 40 mijë lekë. Niveli i realizimit është rreth 91% të buxhetit të rishikuar, më i ulët se normat e realizimit të viteve të mëparshme (rreth 95%).

Gjatë 4 mujorit të parë është kërkuar rialokim fondi nga llogaria 602 në llogarinë 606 me shkresën nr. 2433 prot., datë 04.03.2025, në shumën 40,000 lekë për kompensimin e funksionarit përfitues të telefonisë celulare sipas lidhjes nr. 5. Kërkesa është miratuar me shkresën nr. 2371/1 prot., datë 28.03.2025, protokolluar në AKM me nr. 2433/1 prot., datë 03.04.2025. Numri i punonjësve buxhetor i miratuar në Ligjin e Buxhetit Vjetor, Urdhrin e Kryeministrit Nr. 194, datë 04.10.2024 është 101+8 punonjës me kontratë. Numri faktik i punonjësve është 94 punonjës në strukturë dhe 8 punonjës jashtë strukture, diferenca e numrit të punonjësve të planifikuar me numrin faktit vijnë si rezultat i vakancave, të punonjësve me leje lindje, të punonjësve me raporte afatgjata qe paguhen

nga sigurimet shoqërore dhe të punonjësve me leje pa të drejtë page.
Gjatë vitit 2025 realizimi i shpenzimeve krahas planit të rishikuar arrin në 91%.

Tabela nr. 14: *Realizimi i buxhetit për vitin 2025* *në mijë lekë*

Kod produkti	Emërtimi i produktit	Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2025	Shpenzime Faktike të Periudhës/Progresive	Diferenca Plan/Fakt	% e realizimit
	Totali i Shpenzime Korente				
600	Paga	125,600	123,651	1,949	98
601	Sigurime shoqërore	20,970	20,562	408	98
602	Materiale dhe shërbime	67,960	53,575	14,385	78
604	Transferime Korrente	5,000	4,246	754	84
606	Shpenzime fondi i veçantë	385	302	83	78
231	**Total Shpenzime për Investime**	**2,000**	**0**	2,000	0
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm				
	Totali i Shpenzimeve të Programit	**221,915**	**202,336**	**19,579**	**91**

Burimi: *Të dhënat AKM / Përpunuar nga grupi i auditimit*

Totali i shpenzimeve të planifikuara është 221,915 mijë lekë, ndërsa shpenzimet faktike të kryera ishin 195,579 mijë lekë, me një diferencë prej 19,579 mijë lekësh. Edhe pse që prej PBA 2023 janë parashikuar fonde për investime, realizimi vazhdon të jetë 0. Në 2023 dhe 2024, gjithashtu nuk është kryer asnjë shpenzim kapital, duke treguar mungesë fillimi të projekteve investuese të planifikuara. Investimet kapitale nuk janë realizuar për tre vite radhazi (2023-2025), megjithëse janë përfshirë në PBA çdo vit.

Në krahasim me periudhat e mëparshme:

- Në vitin 2023, realizimi i përgjithshëm është i lartë (mbi 95%), duke reflektuar efikasitet më të madh buxhetor;
- Në vitin 2024, niveli i realizimit ra në rreth 83–85%, si pasojë e reduktimit të fondeve gjatë rishikimit buxhetor dhe shtyrjes së disa shpenzimeve;
- Në vitin 2025, niveli i realizimit u rrit në rreth 91%.

Për vitin 2025, AKM ka mbledhur të ardhura dytësore në vlerën 27,766,742 lekë.

Tabela nr. 15: *Të ardhurat dytësore të vitit 2025*

Kodi Inst.	Klasifikimi buxhetor	Përshkrimi	Shuma e trashëguar nga viti i mëparshëm	Të ardhura progresive	Pjesa e Institucionit	Rritje e autorizuar	Derdhur në buxhet	Mbeten për tu trashëguar
1026 060	7113099	Të ardhura nga tarifat		22,005,000	0	5,761,742	22,005,000	0
	7211100	Të ardhura nga grantet	63,415,112	5,761,742	5,761,742			3,709,044
Totali			**63,415,112**	**27,766,742**	**5,761,742**	**5,761,742**	**22,005,000**	**3,709,044**

Burimi: *Të dhënat AKM, shkresa e rakordimit me thesarin*

Referuar të dhënave të mësipërme, të ardhurat dytësore për vitin 2025 janë krijuar nga: tarifat në vlerën 22,005,000 lekë dhe nga grantet në vlerën 5,761,742 lekë. Vlera e të ardhurave derdhur në buxhet është 22,005,000 lekë. Vlera e mbledhur nga tarifat kryhen në përputhje me VKM nr. 417, datë 25.06.2014 *"Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit",* ku përcaktohen tarifat që paguhen nga subjektet për pajisjen me leje mjedisore dhe për detyrimin vjetor që lidhet me këto leje. Vendimi synon të rregullojë pagesat administrative për shqyrtimin e kërkesave për leje të tipit A, B dhe C, si edhe tarifat që paguhen çdo vit nga instalimet që ushtrojnë veprimtari me ndikim në mjedis. Sipas këtij vendimi, përveç tarifës fillestare për aplikim ose për ndryshim të kushteve të lejes, subjektet që janë të pajisura me leje mjedisore kanë detyrimin të paguajnë një tarifë vjetore. Kjo tarifë ndryshon sipas kategorisë së instalimit: për tipin A është 10,000 lekë, për tipin B është 5,000 lekë dhe për tipin C është 2,000 lekë.

Kjo VKM ka pësuar ndryshime në vitin 2023, konkretisht me VKM nr. 462, datë 26.07.2023 pika 5 citon: *Në pikën 7, emërtimi "Ministrisë së Mjedisit" zëvendësohet me fjalët "... ministrisë përgjegjëse për mjedisin ...*", u kthyen në llogari të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Me ndryshimin e Ligjit nr. 108/2024 datë 07.10.2024 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, "Për lejet e Mjedisit", i ndryshuar: Neni 2: citohet:
Në nenin 25 bëhen këto ndryshime: 1. Pikat 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë: "2. Tarifat për lejet e mjedisit të tipave A dhe B paguhen në llogarinë e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. 3. Operatorët e instalimeve të tipave A dhe B paguajnë çdo vit një tarifë vjetore në llogarinë e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, duke u identifikuar nëpërmjet numrit të lejes (PN-së) përkatëse, duke përcjellë gjithmonë një kopje të mandatit të pagesës pranë AKM-së dhe ARM-së ku ndodhet instalimi.

Raportet e monitorimit

Për periudhën Janar-Shtator 2025 janë hartuar 3 raporte monitorimi, përkatësisht me shkresat: nr. 5596/1 prot., datë 26.05.2025 për periudhën Janar-Prill, dhe nr. 9801/1 prot., datë 15.09.2025 për periudhën Janar-Gusht dhe nr. 1949/1 prot., datë 19.02.2026 për periudhën Janar-Dhjetor. Këto raporte janë hartuar në përputhje me afatet e përcaktuara në udhëzimin nr. 9860/1 prot., datë 30.05.2023 "*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore*".

Për periudhën objekt auditimi janë kryer rishikimet si vijon:

Tabela nr. 16: *Rishikimit gjatë periudhës së auditimit*

Viti	**2023**	**2024**	**2025**
Me Akt Normativ	1	2	2
Me VKM	1	0	0
Nr. i transferimeve buxhetore	6	5	3
Prekur artikujt 600, 601,602	5	3	1
Prekur artikulli 606 *"Transferta për buxhetet familjare e individë"*, dalje në pension	1	2	1
Total	**8**	**7**	**7**

Burimi: *Përpunuar nga grupi i auditimit, sipas të dhënave të AKM*

Nga grupi i auditimit u konstatua se për periudhën objekt auditimi nga AKM janë kryer në total 19 rishikime buxhetore. Nga tabela e mësipërme vihet re se viti 2025 ka numrin më të lartë të rishikimeve me Akte Normativ. Numri i transfertave buxhetore ka një trend ulës nga viti 2023 në 2025, çka tregon për një përmirësim të planifikimit fillestar që ka sjellë uljen e nevojës për rialokime gjatë vitit. I vetmi ndryshimi bërë me VKM është ai i vitit 2023, për zbatimin e VKM-së nr. 795, datë 28.12.2023 *"Për shpërblimin e punonjësve të qeverisjes qendrore në procesin e shqyrtimin analitik të acquis (screening), në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian"*.

Konkluzion

Nga auditimi i procesit të programimit PBA, buxhetimit vjetor, rishikimeve buxhetore, realizimit të treguesve dhe raportimit të monitorimit për periudhën 2023-shtator 2025, rezulton se AKM ka vepruar në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, duke zbatuar procedurat dhe afatet për çeljen, rishikimin dhe raportimin e buxhetit. Raportet e monitorimit janë hartuar dhe dërguar në afatet e përcaktuara dhe pasqyrojnë saktë të dhënat financiare. Megjithatë, konstatohet se problemi kryesor mbetet planifikimi fillestar, veçanërisht në fazën e PBA-së. Ekzekutimi i buxhetit korent për vitet 2023 dhe 2024 paraqitet në nivele të kënaqshme, me një normë realizimi rreth 95%. Ndërkohë, për vitin 2025 konstatohet një rënie në nivelin e realizimit, i cili arrin rreth 91% të buxhetit të rishikuar. Gjithashtu, vihet re mungesë koherence midis planifikimit afatmesëm (PBA) dhe buxhetimit vjetor, sidomos për projektet e investimeve, të cilat parashikohen në PBA, por nuk marrin alokim vjetor dhe për rrjedhojë nuk zbatohen.

2.2 Planifikimi dhe zbatimi i procedurave të prokurimit publik si dhe zbatimi i kontratave për punë, mallra dhe shërbime deri në marrjen në dorëzim.

2.2.1 Parashikimi i prokurimeve.

- Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve. Nga ana e AK, janë respektuar afatet ligjore për përgatitjen dhe dorëzimin e regjistrit vjetor të parashikimeve për prokurimet, në përputhje me formën dhe mënyrën, që është parashikuar në udhëzimet e APP-së. Shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve janë botuar, në formë elektronike, në faqen e app.gov.al.

Për periudhën objekt auditimi Agjencia kombëtare e Mjedisit ka programuar sipas nevojave të njësisë, Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimit, duke parashikuar procedura prokurimi për vitet 2023, 2024, 2025, përkatësisht:

-Për vitin 2023 sipas regjistrit të parashikimit të prokurimeve, rezulton se nevojat e AKM-së janë programuar, duke parashikuar për t'u kryer prokurime për 23 procedura prokurimi me fond limit 23,578,083 lekë (pa tvsh);

-Për vitin 2024 sipas regjistrit të parashikimit të prokurimeve, rezulton se nevojat e AKM-së janë programuar, duke parashikuar për t'u kryer prokurime për 9 procedura prokurimi me fond limit 5,741,000 lekë (pa tvsh);

-Për vitin 2025 sipas regjistrit të parashikimit të prokurimeve, rezulton se nevojat e AKM-së janë programuar, duke parashikuar për t'u kryer prokurime për 17 procedura prokurimi me fond limit 38,546,354 lekë (pa tvsh);

-Regjistri parashikimit 2023 *në lekë*

Nr.	Lloji i procedurës së prokurimit	Lloji i regjistrit të prokurimit	Numri prok.	Fondi Limit i Elementit të Regjistrit
1	Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar	Marrëveshje Kuadër	1	6,500,000
2	Procedurë e hapur - e thjeshtuar	Procedurë Prokurimi	2	9,566,666
3	Sistem dinamik	Procedurë Prokurimi	2	1,381,670
4	Blerje vogël	Procedurë Prokurimi	10	5,346,414
5	Blerje nen vlerën 100,000 leke	Procedurë Prokurimi	8	783,333
			23	**23,578,083**

Burimi: Regjistri Parashikimit të Prokurimeve, përpunoi KLSH

Për vitin 2023: Të dhënat tregojnë se gjatë periudhës së analizuar u parashikuan gjithsej 23 procedura prokurimi, me një fond limit të parashikuar në total prej 23,578,083 lekësh.

AKM ka parashikohet blerje karburanti me Marrëveshje Kuadër, (Minikontratë) me fond limit më të lartë prej 6,500,000 lekësh.

Shumica e procedurave të tjera lidhet me prokurime për mallra dhe shërbime të ndryshme, përmes procedurave të hapura të thjeshta dhe procedurave me blerje vlerë të vogël.

Për procedurë e hapur e thjeshtuar, janë parashikuar 2 procedura prokurimi, në vlerë 9,566,666 leke për shërbimin e pajisjeve të monitorimit të cilësisë së ajrit dhe blerje materiale dhe reagent për laboratorin e AKM-së.

Për Blerjet e vogla u parashikuan gjithsej 10 procedura në vlerë 5,346,414 lekë për blerje pjesë këmbimi dhe shërbimi për automjetet e institucionit, blerje pjese këmbimi dhe shërbimi për pasjet elektronike, materiale pastrimi, bojëra printeri, siguracion, TPL, karton jeshil, etj.

Prokurimet e realizuara për blerjen e biletave të udhëtimit u parashikua fond me vlerë 783,333 lekë.

-Regjistri parashikimit 2024 *në lekë*

Nr.	Lloji i procedurës së prokurimit	Lloji i prokurimit	Numri prok.	Fondi Limit
1	Procedurë e hapur mbi kufirin e larte monetar	Marrëveshje Kuadër	-	-
2	Procedurë e hapur - e thjeshtuar	Procedurë Prokurimi	1	2,391,000
3	Sistem dinamik	Procedurë Prokurimi	1	500,000

4	Blerje e vogël	Procedurë Prokurimi	6	2,750,000
5	Blerje nën vlerën 100,000 lekë	Procedurë Prokurimi	1	100,000
			9	**5,741,000**

Burimi: Regjistri Parashikimit të Prokurimeve, përpunoi KLSH

Për vitin 2024: Të dhënat tregojnë se gjatë periudhës së analizuar janë parashikuar gjithsej 9 procedura prokurimi, me një fond limit të parashikuar në total prej 5,741,000 lekësh.
Shumica e procedurave të tjera lidhet me prokurime për mallra dhe shërbime të ndryshme, përmes procedurave të hapura të thjeshta dhe procedurave me blerje vlerë të vogël.
Për procedurën e hapur të thjeshtuar, janë parashikuar 1 procedura prokurimi, në vlerë 2,391,000 leke blerje materiale dhe reagent për laboratorin e AKM-së.
Për Blerjet e vogla u parashikuan gjithsej 6 procedura në vlerë 2,750,000 lekë për blerje pjesë këmbimi dhe shërbimi për automjetet e institucionit, blerje pjesë këmbimi dhe shërbimi për pajisjet elektronike, materiale pastrimi, bojëra printeri, siguracion, TPL, karton jeshil, etj.
Prokurimet e realizuara për blerjen e biletave të udhëtimit u parashikua fond me vlerë 500,000 lekë.
Në këtë fazë nuk janë planifikuar procedura prokurimi mbi kufirin e lartë monetar.

-Regjistri parashikimit 2025

Regjistri parashikimit 2024 *në lekë*

Nr.	Lloji i procedurës së prokurimit	Lloji prokurimit	Numri prok.	Fondi Limit
1	Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar	(Minikontratë)	1	291,020
2	Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar	Procedurë Prokurimi	1	30,000,000
3	Procedurë e hapur - e thjeshtuar	Procedurë Prokurimi	1	2,800,000
4	Sistem dinamik	Procedurë Prokurimi	1	500,000
5	Blerje vogël	Procedurë Prokurimi	8	4,455,334
6	Blerje nën vlerën 100,000 lekë	Procedurë Prokurimi	5	500,000
			17	**38,546,354**

Burimi: Regjistri Parashikimit të Prokurimeve, përpunoi KLSH

Për vitin 2025: Sipas Regjistrit të Parashikimeve për Prokurimet e vitit 2025, janë planifikuar gjithsej 17 procedura prokurimi, me një fond limit total prej 38,546,354 lekë. Krahasuar me vitin 2024, ky parashikim tregon një rritje të shpenzimeve financiare dhe numrit të procedurave.
Pjesën më të madhe të shpenzimeve të parashikuara e zë procedura e hapur mbi kufirin e lartë monetar, me fond limit 30,000,000 lekë, që përfaqëson rreth 78% të totalit vjetor. Përveç saj, parashikohet edhe një minikontratë për mallra, me vlerë 291,020 lekë dhe 8 procedura blerje të vogla për mallra dhe shërbime përkatësisht me fonde 4,455,334 lekë. Gjithashtu, janë planifikuar edhe 5 procedura blerje te ndryshme nën vlerën 100,000 lekë, që mbulojnë nevojat për shpenzime operative vjetore.

2.2.2 Realizimi i prokurimeve.

Për vitin 2023:

Realizimet e prokurimeve viti 2023 *në lekë*

Nr.	Lloji i procedurës së prokurimit	Numri prokurimeve	Fondi Limit (pa tvsh)	Vlera Fituese (pa tvsh)
1	Procedurë e hapur - e thjeshtuar	2	9,531,157	9,385,100
2	Sistem dinamik	8		696,710
3	Blerje vogël	12	4,806,095	4,142,841
		22	**14,337,252**	**14,224,651**

Burimi: Regjistri Realizimit të Prokurimeve 2023, përpunoi KLSH

Sipas Regjistrit të Realizimit të Prokurimeve, janë zhvilluar gjithsej 22 procedura prokurimi, me një fond limit total prej 14,337,252 lekë (pa tvsh) dhe një vlerë kontratash të lidhura prej 14,224,651 lekë (pa tvsh), që përfaqëson rreth 99% të fondit limit të planifikuar.
Prokurimet e realizuara të tipit "E hapur e Thjeshtuar" përbëjnë një pjesë të rëndësishme të totalit, për prokurime blerje reagent dhe materiale laboratorike për AKM parashikuar me fond limit 9,531,157 lekë, me vlerë fituese 9,385,100 lekë ose 98% e fondit të parashikuar.
Procedura "Blerje me vlerë të vogël", u parashikuan 3,438,399 lekë për blerje pjesë këmbimi dhe shërbimi për automjetet e institucionit, blerje pjesë këmbimi dhe shërbimi për pajisjet elektronike, materiale pastrimi, bojëra printeri, siguracion, TPL, karton jeshil, etj, u parashikuan 4,806,095 lekë dhe u realizuan 4,142,841 lekë ose 90%.
Prokurimet e realizuara për blerjen e biletave te udhëtimit janë realizuar përmes 8 procedurave të sistemit dinamik, për 8 procedura me vlerë 696,710 lekë.

Për vitin 2024:

Realizimet e prokurimeve viti 2024 *në lekë*

Nr.	Lloji i procedurës	Numri prokurimeve	Fondi Limit (pa tvsh)	Vlera Fituese (pa tvsh)
1	Procedurë e hapur - e thjeshtuar	1	2,363,617	2,130,660
2	Sistem dinamik	2		241,800
3	Blerje vogël	11	3,438,399	2,233,086
		14	**5,802,016**	**4,605,546**

Burimi: Regjistri Realizimit të Prokurimeve 2023, përpunoi KLSH

Sipas Regjistrit të Realizimit të Prokurimeve, janë zhvilluar gjithsej 14 procedura prokurimi, me një fond limit total prej 5,802,016 lekë (pa tvsh) dhe një vlerë kontratash të lidhura prej 4,605,546 lekë (pa tvsh), që përfaqëson rreth 79 % të fondit limit të planifikuar.
Prokurimet e realizuara përbëjnë një pjesë të rëndësishme të totalit, me disa procedura të tipit "E hapur e Thjeshtuar" për prokurime blerje reagent dhe materiale laboratorike për AKM parashikuar me fond limit 2,363,617 lekë, me vlerë fituese 2,130,660 lekë ose 90% e fondit të parashikuar.
Procedura "Blerje me vlerë të vogël", u parashikuan 3,438,399 lekë për blerje pjesë këmbimi dhe shërbimi për automjetet e institucionit, blerje pjesë këmbimi dhe shërbimi për pasjet elektronike, materiale pastrimi, bojëra printeri, siguracion , TPL, karton jeshil, etj.. dhe u realizuan 2,233,086 lekë ose 90%.
Prokurimet e realizuara për shërbimet blerjen e biletave të udhëtimit janë realizuar përmes procedurave të sistemit dinamik, me vlerë 241,800 lekë.
Procedurat e prokurimit "*marrëveshje kuadër*", janë kryer nga Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara (ASHPP) për blerje karburanti, kontratë në vazhdim nga viti 2023.

Për vitin 2025:

Realizimet e prokurimeve viti 2025 *në lekë*

Nr.	Lloji i procedurës së prokurimit	Numri prokurimeve	Fondi Limit (pa tvsh)	Vlera Fituese (pa tvsh)
1	Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar	1	29,874,560	29,627,900
2	Procedurë e hapur - e thjeshtuar	-	-	
3	Sistem dinamik	-	-	74,800
4	Blerje vogël	4	1,694,000	1,343,400
		5	**31,568,560**	**31,046,100**

Burimi: Regjistri Realizimit të Prokurimeve 2023, përpunoi KLSH

Sipas Regjistrit të Realizimit të Prokurimeve, janë zhvilluar gjithsej 5 procedura prokurimi, me një fond limit total prej 31,568,560 lekë (pa tvsh) dhe një vlerë kontratash të lidhura prej 31,046,100 lekë (pa tvsh), që përfaqëson rreth 98% të fondit limit të planifikuar.
Prokurimet e realizuara të tipit "Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar" për prokurime mirëmbajtje dhe riparim i pajisjeve të rrjetit të të dhënave të stacioneve të monitorimit të ajrit për AKM u parashikuan me fond limit 29,874,560 lekë, me vlerë fituese 29,627,900 lekë ose 99% e fondit të parashikuar.
Prokurimet e realizuara të tipit "E hapur e Thjeshtuar" nuk pati.
Procedura "Blerje me vlerë të vogël", u parashikuan 4 procedura me fond të parashikuar 1,694,000 lekë për mirëmbajtje e pajisjeve të rrjetit të të dhënave, shërbim për krijim programesh për ëeb server, pjesë dhe aksesorë të aparaturave fotokopjuese, Vajra motorike, bateri për automjete, etj.. dhe u realizuan 1,343,400 lekë ose 79%.
Prokurimet e realizuara për shërbimet blerjen e biletave të udhëtimit janë realizuar përmes 1 procedura të sistemit dinamik, me vlerë 74,800 lekë.
Procedurat e prokurimit "*marrëveshje kuadër*", janë kryer nga Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara (ASHPP) për blerje karburanti, kontrate ne vazhdim nga viti 2023

Auditimi u krye mbi bazë risku duke përzgjedhur si kampion dosjet me procedurë e hapur e thjeshtuar mbi kufirin e lartë monetar dhe procedurë e hapur e thjeshtuar.

Viti 2023

Tenderi me objekt me objekt "*Blerje reagentësh dhe materiale laboratori* ", nr. REF-65408-04-07-2023, për subjektin K., me NIPT K.....A, me fond limit 2,700,090 lekë pa TVSH.

a. Blerje reagentësh dhe materiale laboratori		
1. **Urdhër Prokurimi Nr.13, datë 23.02.2023**		
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: Procedurë e hapur e thjeshtuar për mallra;	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: Urdhër Prokurimi Nr. 13/2023, Prot. 1327, datë 23.02.2023 A. Z (Kryetar); A. A (Anëtar) K. T (Anëtar),	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Urdhër Nr. 14/2023, prot.1328, datë 23.02.2023 I. H (Kryetar) I. K (Anëtar) Xh. G (Anëtar),
5. Fondi Limit: 2,700,000 lekë (pa TVSH)	6. Oferta fituese "K": 2,585,100 lekë (pa TVSH)	7.Diferenca me fondin limit 114,900 lekë (pa TVSH)
8. Data e hapjes së tenderit: 11.04.2023	9. Burimi Financimit Buxheti Shtetit	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender: (katër) OE b)Skualifikuar: 3 (tre) OE
11. Ankimime AK (s'ka) APP (s'ka) KPP (s'ka)	12. Përgjigje Ankesës: nga AK : (s'ka)	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP: (s'ka)
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e **kontratës:** **Nr. 1327/3, datë 05.06.2023**	15. Vlera e kontratës 3,102,120 lekë (me TVSH)	16. Likuiduar: në shumën **3,102,120** Lekë (me Tvsh) Pa likuiduar (**zero**) Lekë.
17- Situacioni Përfundimtar…	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar =30 ditë; Zbatuar = 30 ditë	19. Zgjatja e kontratës (jo)
- FT nr. 916/2023, dt. 19.06.2023 vlerë 1,443,180 lekë (me Tvsh). - FT nr. 916/2023, date 19.06.2023, vlerë 1,658,940 lekë (me Tvsh).		
Sigurim kontrate: Nr. 0019936, dt. 15.05.2023	23.**Akt i marrjes në dorëzim** - PV marrje ne dorëzim malli nr.1329/1 Prot., datë 19.6.2023 - PV marrje ne dorëzim malli nr.1329/2 Prot., datë 29.06.2023	**24. Fletë Hyrja** Nr. 6, dt. 19.06.23 Nr. 8, dt. 29.06.2023

Planifikimi i nevojave për këtë procedurë prokurimi është parashikuar në PBA 2023-2025, dërguar në MTM me shkresë nr. 6573 datë 24.08.2022 në zbatim të Vendimit nr. 130, datë 02.03.2022 "Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të PBA 2023-2025", si dhe Udhëzimit të MFE nr. 09, datë 28.02.2022 "Për përgatitjen e PBA 2023-2025" për vitin 2023 në zërin "materiale dhe pajisje laboratorike të shërbimit publik" janë parashikuar shpenzime në vlerë 2,094,000 lekë.
Nga auditimit rezultoi njësia e shpenzuese për vitin 2023 ka planifikuar shpenzime për blerje materiale dhe pajisje laboratorike të shërbimit publik 2,094,000 lekë. Në regjistrin e parashikimeve për vitin 2023 në vlerën 2,733,333 lekë (pa tvsh) ose 3,280,000 lekë (me tvsh), ose parashikuar më tepër 1,186,000 lekë, pa argumentuar arsyet rritjes së shpenzimeve në regjistrin e parashikimit dërguar në Degën e Thesarit Tiranë me shkresë nr. 63/1 Prot., datë 22.01.2023, konform nenit 3, pika 4, e VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 me ndryshime.
Fondi limit i parashikuar nuk ka pësuar ndryshime të mëvonshme nga ato të publikuara në regjistrin e parashikimeve.

Ngritja e Komisioneve për procedurën e prokurimit "Blerje reagentësh dhe materiale laboratori"
-Komisioni të Testimit të Tregut dhe llogaritjes së fondit limit, i ngritur me Urdhër nr. 3, datë 11.01.2023 (vjetor), i përbërë nga:
S. H (Kryetar); me detyrë inspektor, Sektori i Inspektimit Mjedisor
D. H (Anëtar); me detyrë specialist, Sektori i Financës, Buxhetit, Mbledhjes së Tarifave dhe Identifikimit të Debitorëve
O. T (Anëtar), me detyrë inspektor, Sektori i Asgjësimit dhe Përgjegjësive Mjedisore.
Njësia e prokurimit për Hartimin e Specifikimeve Teknike dhe llogaritjen e fondit limit me përfshirjen e specialistit të fushës ngritur me Urdhër nr. 07, datë 23.02.2023:
V. P (Kryetar);
K. Ç (Anëtar)
B. P (Anëtar)
Njësia e Prokurimit e ngritur me Urdhër Prokurimi nr. 13, datë 23.02.2023 me përbërje :
A. Z (Kryetar)
A. A (Anëtar)
K. T (Anëtar)
Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i ngritur me Urdhër nr. 14, datë 23.02.203 me përbërje;
I. H (Kryetar) me detyrë specialist, Sektori i Analizave Laboratorike dhe Monitorimit të Kontratave.
I. K (Anëtar) me detyrë specialist, Sektori i Analizave Laboratorike dhe Monitorimit të Kontratave.
Xh. G (Anëtar), me detyrë specialist, Sektori i Analizave Laboratorike dhe Monitorimit të Kontratave.
Grupi i punës për zbatimin e kontratës i ngritur me Urdhër nr. 15, datë 23.02.203 me përbërje:
V. Gj (Kryetar);
S. P (Anëtar);
Sh. B (Anëtar)
Llogaritja e fondit limit:
Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse i është drejtuar Titullarit me kërkesë nr. 1168 prot., datë 20.02.2023 për kryerjen e procedurës së prokurimit për blerjen e reagentëve dhe materialeve sipas kërkesës nr. 5, datë 17.02.2023 paraqitur nga Sektori i Laboratorëve, Teknologjisë dhe Infrastrukturës Mjedisore për zbatimin e programeve të Monitorimit nr. 191, datë 12.02.2023 dhe nr. 192, datë 12.02.2023.

Sektori Juridik dhe Marrëdhënieve Ligjore me shkresë nr. 1168/1 prot., datë 20.02.2023 i është drejtuar titullarit me kërkese për përllogaritjen e saktë të fondit limit për prokurim duke kërkuar ngritjen e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike, ngritjen e njësisë së prokurimit me përfshirjen e specialistit të fushës, komisionin i vlerësimit të ofertave dhe komisioni i marrjes në dorëzim.
Titullari me Urdhrin nr. 3, datë 11.01.2023, ka urdhëruar ngritjen e "*Komisionit për testimin e tregut dhe përllogaritjen e fondit limit*" , i cili do të funksionojë gjatë gjithë vitit 2023.
Komisioni i testimit të tregut ka mbajtur Proces Verbal për Testimit e Tregut nr. 1168/2 prot., datë 23.02.2023, bazuar në produktet e kërkuara, specifikimet teknike, njësinë dhe sasinë e kërkuar.
Nga studimi i tregut, bazuar në çmimet e blerjes pa tvsh, sipas ofertave të paraqitura me çmim blerje pa tvsh nga subjekti K në vlerë 2,617,800 lekë; E në vlerë 2,700,000 lekë dhe E ne vlerë 2,782,470 lekë dhe çmimeve të ofertave të paraqitura nga këto subjekte, mbështetur në mesataren e tyre llogariti fondin limit pa tvsh 2,700,090 lekë.
Të dhënat për studimin e tregut dhe llogaritja e fondit limit

Nr.	Emërtimi	Çmimi i blerjes pa tvsh			Vlera totale pa tvsh
		K	E	E	
1	Blerje reagentësh dhe materiale laboratori	2,617,800	2,700,000	2,782,470	**2,700,090**

Titullari i AK me Urdhrin Nr.07, datë 23.02.2023, Prot. Nr. 1326, date 23.02.2023, ka urdhëruar ngritjen e "Komisioni për Hartimin e Specifikimeve Teknike" për procedurën e prokurimit i përbërë nga:
Komisioni për Hartimin e Specifikimeve Teknike, i ngritur me urdhër nr. 1326 Prot., datë 23.02.2023, për procedurën e prokurimit, me objekt "blerje reagent dhe materiale laboratori", me proces verbal (shkrese) nr. 1326/2 Prot., datë 23.02.2023, ka hartuar specifikimet teknike referuar, për 45 artikuj, nenit 36 te Ligjit 162/2020, i ndryshuar dhe nenit 2 të VKM 285/2021, i ndryshuar.
Komisioni i Hartimit të Specifikimeve Teknike, në këtë shkresë ka përcaktuar se në ditën e lëvrimit të mallit, data e skadencës duhet të jetë jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës, ose jo më pak se 1 vit nga data e lëvrimit të mallit,
Anëtarët e Komisioni për Hartimin e Specifikimeve Teknike kanë hartuar individualisht deklaratën e konfliktit të interesit , date 23.02.2023.

Hartimi i dokumenteve të tenderit/kriteret e veçanta për kualifikim-

Titullari me Urdhër Prokurimi nr. 13/2023, prot., 1327, datë 23.02.2023 ka urdhëruar zhvillim e procedurës së prokurimit "*Procedurë e hapur e thjeshtuar-mallra*", me fond buxhetor 2,700,000 lekë pa tvsh, për blerje reagentësh dhe materiale laboratori, duke ngritur dhe ngarkuar Njësinë e Prokurimit për hartimin e dokumenteve standard të tenderit sipas nenit 73, VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar.
Njësia e Prokurimit e ngarkuar për hartimin e dokumenteve standard të tenderit ka mbajtur Proces verbalin nr. 1327/1 prot., datë 07.04.2023 dhe DST duke argumentuar dhe miratuar specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim.
Specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit i janë referuar nenit 21 pika 2 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe neni 2;2/c;78 pika 2 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.
Në hartimin e dokumenteve standard të tenderit, grupi i specifikimeve teknike ka përcaktuar:
- Në pikën 2.2 "kapaciteti ekonomik dhe financiar" se OE duhet të paraqesin kopje të bilanceve 2020, 2021,2022 , të shoqëruara me raportet e auditimit ligjore të pasqyrave financiare, të kryera nga audituesligjore ose shoqëri audituese;
- Për të provuar përputhshmërinë me veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, OE duhet të paraqesë:

ISO 9001:2015 mbi "Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë", lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akreditуar nga organizimi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues , të njohura nga RSH, Certifikata duhet të jetë e vlefshme gjatë kohës së zhvillimit të tenderit.
ISO 14001:2015 mbi "Sistemet e Menaxhimit të Mjedisit" lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akreditуar nga organizimi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues , të njohura nga RSH, Certifikata duhet të jetë e vlefshme gjatë kohës së zhvillimit të tenderit.
Grupi hartimit të DST përcakton se OE duhet të ketë në stafin e vet, të paktën 1(një) inxhinier elektronik/informatik/telekomunikacion dhe 1(një) kimist ose inxhinier mjedisi, të certifikuar/ trajnuar për shërbimin e pajisjeve objekt prokurimi, të vërtetuara me certifikatës së trajnimit të lëshuar nga kompani prodhuese të stacioneve të monitorimit apo moduleve përbërës të tyre. Kërkesat duhet të vërtetohen me kontratë pune të vlefshme deri në fund të vitit 2023, diploma përkatëse për specialitet ose diplomë e huaj, të njësuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin, certifikata trajnimi për servisin e pajisjeve objekt prokurimi.
Etj.,

Nga Auditimi rezulton se:
Proces verbali nr. 1327/1 prot., datë 07.04.2023 "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta për kualifikim*", si dhe në Dokumentet Standarde të Tenderit (DST), lidhur me kriteret e veçanta rezulton se specifikimet teknike përgjithësisht janë përshkruar në mënyrë të qartë, pa referenca tregtare, por pa përdorur shprehjen "ose ekuivalent", veprim në kundërshtim me neni 36.3.c, të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
Proces verbali nr. 1327/1 prot., datë 07.04.2023 "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta për kualifikim*", si dhe në Dokumentet Standarde të Tenderit (DST), lidhur me kriteret e veçanta grupi hartimit të DST , **nuk ka përcaktuar se në ditën e lëvrimit të mallit,** data e skadencës duhet të jetë jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës, ose jo më pak se 1 vit nga data e lëvrimit të mallit kërkuar edhe nga Komisioni i Hartimit të Specifikimeve Teknike, veprim në kundërshtim me neni 36.3.c, të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Vlerësimi i Ofertave:
- Titullari më Urdhër i Brendshëm nr. 14/2023, prot., 1328, datë 23.02.2023 ka urdhëruar krijimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO) referuar nenit 73, VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar të përbërë nga:

Në përfundim të procesit të vlerësimit të dokumentacionit, KVO në datën 24.04.2023, ora 10:00, në SPE ka mbyllur procesin e dorëzimit të ofertave dhe ka hapur ofertat e paraqitura në sistem. Anëtarët e KVO kanë konstatuar se janë paraqitur 4 (katër) oferta, nga të cilat janë s'kualifikuar ofertuesit:
E. shpk;
A. shpk;
A. shpk.
Në përfundim të procesit të vlerësimit të dokumentacionit, KVO konstatoi se oferta ekonomike që plotëson të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe DST, dokumentacionin e kërkuar në kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të DST, është oferta e operatorit K. shpk, e kualifikuar si fitues me vlerë 2,585,100 lekë pa tvsh. Oferta nuk rezulton anomalisht e ulët dhe dorëzuar sipas kërkesave dhe specifikimeve të përcaktuara në DST.

KVO mbyll vlerësimin në SPE ne datën 02.05.2023, dhe shpall fitues OE K. shpk, i kualifikuar si fitues, i cili dorëzoi dokumentacionin ligjor dhe teknik, në protokoll arkivën e AKM-së me shkresën me nr. 3373 prot., datë 03.05.2023.
KVO ka mbyllur procesin e vlerësimit paraprak dhe i propozon titullarit miratimin e "Formularit të Njoftimit të Fituesit (paraprak)" sipas Shtojcës 10 të DST, publikuar në SPE.
Në datën 15.05.2023 KVO ka hartuar raportin përmbledhës me nr. 1328/3 prot., datë 15.05.2023. Duke iu referuar procedurës së prokurimit, oferta e paraqitur nga K. shpk, me vlerë të përgjithshme 2,558,100 lekë pa tvsh, është kualifikuar si oferta e suksesshme, për të cilën OE njoftohet nëpërmjet SPE të paraqesë sigurimin e kontratës, si parashikohet në DST, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të njoftimit të fituesit.
KVO ka mbyllur procesin e vlerësimit dhe ka dërguar "Formularit të Njoftimit të Fituesit" datë 15.05.2023 sipas Shtojcës 11 të DST, publikuar në SPE, duke kërkuar dorëzimin e sigurimit të kontratës, brenda 5-ditëve nga dita e marrjes/publikimit.
OE ka paraqitur Sigurimin e Kontratës me dok "Policë Sigurimi Kontrate" në protokollin e AMK me nr. 3695, datë 17.05.2023, për procedurën e prokurimit me Ref-65408-04-07-2023, datë 15.05.2023, në shumën 310,212 lekë e vlefshme nga 15.05.2023 deri 30.08.2023 nga shoqëria Ansig.
Lidhja e kontratës
AK ka lidhur Kontratë Furnizimi nr. 1327/3 prot., datë 05.06.2023 me K. shpk, për furnizim me mallra për blerje reagentësh dhe materiale laboratori, në përputhje me specifikimet teknike, afatin e lëvrimit të mallit dhe DST të miratuar.
Grafiku i ekzekutimit të Kontratës do të realizohet për lëvrimin e mallit brenda 30 (tridhjetë) ditëve, nga data e lidhjes së kontratës.
Me shkresë nr. 4160/1 prot., datë 07.06.2023 është dërguar tek OE "Plani zbatimit të Kontratës". nënshkruar AK dhe EK me shkresë nr. 4160 prot., datë 05.06.2023. Në pikën B.1.3. "Kushtet e lëvrimit/ dorëzimit të mallrave", përcaktohen kushtet e dorëzimit, datat dhe vendet e dorëzimit në përputhje me Grafikun e Dorëzimeve të parashikuar në kontratë. Në pikën B.2 përcaktohet dokumentacioni që do të administrohet nga palët gjatë zbatimit të kontratës dhe faza në të cilën duhet të hartohet ky dokumentacion.
Zbatimi i kontratës
- Urdhër i Brendshëm nr. 15/2023, prot., 1329, datë 23.02.2023 ka urdhëruar ngritjen e Grupit të Punës për Zbatimin e Kontratës, sipas VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, dhe Udhëzimit të APP nr. 2, datë 18.03.2022 "Mbi Raportimin e zbatimit të Kontratës" .
Grupi i punës për zbatimin e kontratës për marrjen në dorëzim të mallit ka mbajtur proces verbal për marrjen në dorëzim të mallit me nr. 1329/1 prot., datë 19.06.2023.
Dokumentacionin marrjes në dorëzim të mallit.

PV marrje ne dorëzim	Dokumentacion shoqërues	Fature Tatimore	Vlera e tatueshme	TVSH	Totali
PV marrje ne dorëzim malli nr. 1329/1 Prot., datë 19.6.2023	Akt Dorëzimi nga OE me date 19.06.2023	FT nr. 916/2023, date 19.06.2023	1,202,650	240,530	1,443,180
PV marrje ne dorëzim malli nr. 1329/2 Prot., datë 29.06.2023	Akt Dorëzimi nga OE me date 29.06.2023	FT nr. 916/2023, date 19.06.2023	1,658,940	-	1,658,940
Totali			**2,861,590**	**240,530**	**3,102,120**
Urdhër –Blerje nr. 174, date 19.07.2023					**3.102.120**
Pa paguar					**0**

Burimi: Përpunoi KLSH
Grupi i punës për zbatimin e kontratës për kontratën e furnizimit me nr. 1329/3 prot., datë 21.07.2023 ka hartuar dhe nënshkruar në datën 21.07.2023 Raport Përmbledhës për Zbatimin e

Kontratës me nr. 1329/3 prot., datë 21.07.2023 për blerjen dhe marrjen në dorëzim të reagentëve për materiale laboratorike.
Ne këtë raport grupi i marrjes në dorëzim sqaron se me proces verbalet nr. 1329/1 prot., datë 19.06.2023 dhe nr. 1329/2 prot., datë 29.06.2023 është verifikuar dhe është marrë në dorëzim malli sipas kërkesës së AK. Gjatë zbatimit të kontratës grupi shprehet se nuk ka pasur asnjë problematikë. Sipas urdhrit të shpenzimit nr. 174, datë 19.07.2023 praktika është dërguar dhe konfirmuar në degën e thesarit për likuidim fature. Raporti Përmbledhës për Zbatimin e Kontratës është miratuar dhe nënshkruar nga Titullari i institucionit.

Nga auditimi rezulton se:
Proces verbali-et e marrjes në dorëzim të mallit me nr. 1329/1 prot., datë 19.06.2023 dhe Akti Marrjes në dorëzim datë 19.06.2023, PV marrje në dorëzim malli nr. 1329/2 prot., datë 29.06.2023 dhe Akt Dorëzimi nga OE me datë 29.06.2023, **nuk përmbajnë asnjë të dhënë lidhur me dokumentacionin për procedurat e pranimit të mallit si certifikatat e origjinës së mallit, testimet dhe analizat e mallrave, certifikatat e cilësisë se materiale /mallrave, veprim në kundërshtim me nenin 13 (Paketimi dhe dokumentet), nenin 16 "Inspektimet dhe testet"** në pjesën Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPK) Kontratës nr. 1327/3, datë 05.06.2023 dhe **nenin 3** (Inspektimet dhe Testet), **neni 8** (Paketimi dhe Dokumentet), në kundërshtim me në pjesën Kushte të Veçanta të Kontratës (KVK) të Kontratës nr. 1327/3, datë 05.06.2023.

Tenderi me objekt: "*Shërbimi i mirëmbajtjes së pajisjeve të instaluara në stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit urban në qytetet: Durrës, Shkodër, Korçë, Elbasan, Fier, stacioni i lëvizshëm në Tiranë dhe stacioni i DSHP Tiranë*", nr. REF-65249-04-06-2023, për subjektin "K", me NIPT K.....A me fond limit 6,831,067 lekë pa tvsh, me të dhënat:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Shërbimi i mirëmbajtjes së stacioneve të monitorimit të cilësisë së ajrit urban"		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 16, Datë 06.04.2023		
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: *"Procedurë e hapur e thjeshtuar-shërbime"*	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit (**NJP**) : Urdhër Nr. 16, dt.06.04.2023 A. Z (Kryetar) A. K (Anëtar); I. K (Anëtar);	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 17, datë 06.04.2023 S. P (Kryetar); A. B (Anëtar) Xh. G (Anëtar)
5. Fondi Limit (pa TVSH) **6,831,067** lekë	6.Oferta fituese "K" shpk 6,800,000 lekë (pa TVSH)	7.Diferenca me fondin limit 31,067 lekë (pa TVSH)
8. Data e hapjes së tenderit: Dt. 24.04.2023 ora	9. Burimi Financimit Buxheti i shtetit	10. Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër 1 (një) OE b)Shkualifikuar 0 (zero) OE
11. Ankimime (jo)	12. Përgjigje Ankesës: (jo)	13. Përgjigje Ankesës (jo)
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës: **Nr. 2713/3, dt. 02.05.2023**	15. Vlera e kontratës **8,160,000** lekë (me TVSH)	16. Likuiduar deri dt. 03.05.2024, në shumën 8,160,000 lekë Pa likuiduar 0 (**zero**) Lekë
	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar =1 vit /365 ditë; **Zbatuar = 1 vit/365 ditë**	19. Zgjatja e kontratës (jo)

Planifikimi i nevojave për këtë procedurë prokurimi nuk është parashikuar në PBA 2023-2025, dërguar në MTM me shkresë nr. 6573 datë 24.08.2022 në zbatim të Vendimit nr. 130, datë 02.03.2022 "Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të PBA 2023-2025", si dhe Udhëzimit të MFE nr. 09, datë 28.02.2022 "Për përgatitjen e PBA 2023-2025" për vitin 2023 në zërin "Materiale dhe pajisje laboratorike të shërbimit publik".
Fondi limit u parashikua në regjistrin e parashikimeve për vitin 2023 në zërin "shpenzime për mirëmbajtjen e aparateve dhe pajisjeve teknike" në vlerën 6,833,333 lekë pa tvsh, ku fondi limit i parashikuar nuk ka pësuar ndryshime të mëvonshme nga ato të publikuara në regjistrin e parashikimeve dërguar në Degën e Thesarit Tiranë me shkresë Nr. 63/1Prot., datë 28.01.2023, konform nenit 3, pika 4, e VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 me ndryshime.

Ngritja e Komisioneve.
- Komisioni të Testimit të Tregut dhe llogaritjes së fondit limit, i ngritur me Urdhër nr. 3, datë 11.01.2023 (vjetor), i përbërë nga:
S. H (Kryetar), me detyre inspektor, Sektori i Inspektimit Mjedisor
D. H (Anëtar) me detyrë specialist, Sektori i Financës, Buxhetit, Mbledhjes së Tarifave dhe Identifikimit të Debitorëve
O. T (Anëtar) me detyre inspektor, Sektori i Asgjësimit dhe Përgjegjësive Mjedisore
Njësia e Prokurimit e ngritur me Urdhër Prokurimi nr. 16/2023, prot., 2713, datë 06.04.2023, të përbërë nga:
- A. Z (Kryetar), me detyrë përgjegjëse, Sektori Juridik dhe i Çështjeve Gjyqësore.
- A. K (Anëtar) me detyrë përgjegjëse në Sektorin e Vlerësimit të Gjendjes në Mjedis,
- I. K (Anëtar), me detyre specialiste në Sektorin e Mostrimit dhe Analizave.

Njësia e prokurimit ka nënshkruar "Deklaratën e Konfliktit të Interesit", datë 06.04.2023.
Grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe termat e referencës i ngritur me Urdhër nr. 08, datë 10.03.2023, prot., 1763, data 10.03.2023, i përbërë nga:
I. H, specialist, Sektori i Laboratorëve dhe Infrastrukturës Mjedisore, Drejtoria e kërkimit dhe Dijes Mjedisore në AKM;
K. T, specialist, Sektori i Informacionit, GIS dhe Regjistrave Mjedisorë,, Drejtoria e kërkimit dhe Dijes Mjedisore në AKM;
B. P, specialist, Sektori i Laboratorëve dhe Infrastrukturës Mjedisore, Drejtoria e kërkimit dhe Dijes Mjedisore në AKM;
-Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO) ngritur ne Urdhër i Brendshëm nr. 17/2023, me 2714 prot., datë 06.04.2023 i përbërë nga:
S. P (Kryetar) me detyrë specialiste laboratori, DMIA Laborator.
A. B (Anëtar) me detyrë inspektore, Sektori i Inspektimit në Mjedis.
Xh. G (Anëtar), me detyrë specialist, Sektori i Analizave Laboratorike dhe Monitorimit të Kontratave.
- Grupit të Punës për Zbatimin e Kontratës ngritur me Urdhër nr. 20/2023, prot., 3406, datë 04.05.2023, ndryshuar me shkresë nr. 3406/3 Prot., datë 06.09.2023, përbërë nga:
I. H (Kryetar); specialist, Sektori i Laboratorëve dhe Infrastrukturës Mjedisore, Drejtoria e kërkimit dhe Dijes Mjedisore në AKM;
B. P (Anëtar), specialist, Sektori i Laboratorëve dhe Infrastrukturës Mjedisore, Drejtoria e kërkimit dhe Dijes Mjedisore në AKM;
I. K (Anëtar) zëvendësuar me M.S me detyre specialiste në Sektorin e Mostrimit dhe Analizave.
Llogaritja e Fondit Limit:
Sektori i Laboratorëve, Teknologjisë dhe Infrastrukturës Mjedisore me shkresën nr. 1336 prot., datë 23.02.2023, i është drejtuar Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, me kërkesë për mirëmbajtjen e stacioneve të monitorimit të cilësisë së ajrit urban, për të siguruar funksionimin normal të pajisjeve të ajrit, dukë konsideruar të domosdoshme mirëmbajtjen e vazhdueshme dhe kalibrimin e pajisjeve , duke e konsideruar kërkesë si prioritet.
Znj A. Z përgjegjëse e Sektorit Juridik dhe Marrëdhënieve Ligjore me shkresë nr. 1336/1 prot., datë 03.03.2023, i është drejtuar Titullarit me kërkesë për përllogaritjen e saktë të fondit limit për prokurim duke kërkuar ngritjen e grupit te punës për hartimin e specifikimeve teknike, ngritjen e njësisë së prokurimit me përfshirjen e specialistit të fushës, komisionin i vlerësimit të ofertave dhe komisioni i marrjes në dorëzim. Lidhur me testimin e tregut për përllogaritjen e fondit Limit do të kryhet nga Komisioni për përllogaritjen e fondit limit të kontratës, i krijuar me Urdhrin nr. 3, datë 11.01.2023.

Komisionin Testimit të Tregut dhe llogaritjes së fondit limit, i ngritur me Urdhër nr. 3, datë 11.01.2023, ka nënshkruar "*Deklaratën e Konfliktit të Interesit*", në datë 30.03.2023 në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Komisionin Testimit të Tregut dhe llogaritjes së fondit limit, ka mbajtur Proces Verbal për Testimit e Tregut nr. 1336/2 prot., datë 30.03.2023, bazuar në shërbimet e kërkuara të listuar sipas moduleve te pajisjeve të monitorimit ne stacionet e monitorimit, ka testuar tregun për çmimet e blerjeve sipas ofertave (bashkëlidhur) nga subjektet dhe mbështetur në mesataren e tyre llogariti fondin limit (pa tvsh).

Nga studimi i tregut, bazuar në çmimet e blerjes pa tvsh, sipas ofertave te paraqitura me çmim blerje pa tvsh nga subjekti K ne vlerë 6,800,000 lekë; Enë vlerë 6,571,100 lekë dhe I në vlerë 7,122,200 lekë dhe çmimeve të ofertave të paraqitura nga këto subjekte, mbështetur në mesataren e tyre llogariti fondin limit pa tvsh 6,831,067 lekë.

Të dhënat për studimin e tregut dhe llogaritja e fondit limit

Nr.	Emërtimi	Sasia	Çmimi i blerjes pa tvsh			**Vlera totale pa tvsh**
			K	E	I	
1	Shërbimi i mirëmbajtjes së pajisjeve të instaluara në stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit urban në qytet: Durrës, Shkodër, Korçë, Elbasan, Fier, stacioni i lëvizshëm në Tiranë dhe stacioni i DSHP Tiranë.	1	6,800,000	6,571,000	7,122,200	**6,831,067**

Hartimi i dokumenteve të tenderit/kriteret e veçanta për kualifikim-

Titullari me Urdhër nr. 08, datë 10.03.2023 ka urdhëruar ngritjen e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe termat e referencës, për shërbimin për prokurimin publik me objekt "*Shërbimi i mirëmbajtjes së pajisjeve të instaluara në stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit urban në qytetet: Durrës, Shkodër, Korçë, Elbasan, Fier, stacioni i lëvizshëm në Tiranë dhe stacioni i DSHP Tiranë*."

Grupi i punës ka nënshkruar "Deklaratën e Konfliktit të Interesit", datë 10.03.2023,

Grupi i Punës për Hartimin e Specifikimeve Teknike, i ngritur me Urdhër nr. 08, datë 10.03.2023, në shkresën nr. 2713/1 prot., datë 06.04.2023 "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta për kualifikim*", ka hartuar, argumentuar dhe miratuar specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim referuar nenit 21.2 të ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 2 .2.c të VKM 285/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Grupi i punës përcakton se mirëmbajtja do të kryhet sipas grafikut të shërbimit. Shërbimi i mirëmbajtës do të kontraktohet vetëm për pajisjet që janë në gjendje pune, të cilat nuk kërkojnë dërgimin e modulit jashtë vendit dhe arrijnë të japin të dhënat e domosdoshme për raportim, të përcaktuara nga grupi i ekspertëve të AKM-së.

Hartimi i specifikimeve teknike është referuar në manualet e përdorimit të pajisjeve të monitorimit të cilësisë së ajrit urban.

Nga auditimi rezulton se:

Komisioni Testimit të Tregut dhe llogaritjes së fondit limit, ka mbajtur Proces Verbal për Testimit e Tregut nr. 1336/2 prot., datë 30.03.2023, bazuar në shërbimet e kërkuara të listuar sipas moduleve të pajisjeve të monitorimit në stacionet e monitorimit, ka testuar tregun për çmimet e blerjeve sipas ofertave (bashkëlidhur) nga subjektet dhe mbështetur në mesataren e tyre llogariti fondin limit pa tvsh 6,831,067 lekë, për gjithë pajisjet e instaluara në stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit urban.

Grupi i Punës për Hartimin e Specifikimeve Teknike, i ngritur me Urdhër nr. 08, datë 10.03.2023, në shkresën nr. 2713/1 prot., datë 06.04.2023 "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta për kualifikim*", ka kërkuar se shërbimi i mirëmbajtës do të

kontraktohet vetëm për pajisjet që janë në gjendje pune, të cilat nuk kërkojnë dërgimin e modulit jashtë vendit dhe arrijnë të japin të dhënat e domosdoshme për raportim, të përcaktuara nga grupi i ekspertëve të AKM-së.
Kjo nënkupton se për pajisjet e instaluara në stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit, për të cilat parashikohet ofrimi i shërbimit të mirëmbajtjes, nuk disponohet informacion i saktë mbi gjendjen e tyre funksionale. Për rrjedhojë, në përcaktimin e fondit limit pa TVSH në vlerën 6,831,067 lekë, Autoriteti Kontraktor nuk ka kryer më parë vlerësimin e gjendjes së aktiveve, veprim ky në kundërshtim me paragrafin 102 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
Sipas këtij paragrafi, nëpunësi zbatues i njësisë, bazuar në gjendjen faktike të aktiveve të evidentuar nga inventarizimi, normat e amortizimit, afatin e skadencës, vitin e vënies në përdorim, vlerën e shtuar ndër vite, mundësitë e riaftësimit në raport me koston dhe përfitimin, si dhe informacionin zyrtar mbi dobishmërinë e aktiveve të marrë nga drejtuesit e programeve buxhetore dhe punonjësit e tjerë të njësisë, përcakton gjendjen e aktiveve dhe harton listën e atyre që do t'i nënshtrohen vlerësimit.

Komisioni për Testimit të Tregut në hartimin e specifikimeve teknike referon se është bazuar në manualet e përdorimit të pajisjeve të cilësisë së ajrit urban. Grupi i auditimit konstaton se në Proces Verbal për Testimit e Tregut nr. 1336/2 prot., datë 30.03.2023 nuk ka përcaktuar emërtimin Manualit mbi të cilin vlerësohet frekuenca e shërbimit dhe riparimit të pajisjes, veprim në kundërshtim me nenin 36, pika b) dhe/ose c) të ligjit nr. 162/2020 'Për Prokurimin Publik', i ndryshuar, b) sipas të cilit specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve; dhe /ose c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale.
Nxjerrja e Urdhër Prokurimit
Njësia e Prokurimit e ngritur me Urdhër Prokurimi nr. 16/2023, prot., 2713, datë 06.04.2023.
Titullari me Urdhër Prokurimi nr. 16/2023, prot., 2713, datë 06.04.2023 ka urdhëruar zhvillim e procedurës së prokurimit "*Shërbimi i mirëmbajtjes së pajisjeve të instaluara në stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit urban në qytet: Durrës, Shkodër, Korçë, Elbasan, Fier, stacioni i lëvizshëm në Tiranë dhe stacioni i DSHP Tiranë*", me fond buxhetor 6,831,067 lekë pa tvsh, për procedurë prokurimi publik "*Procedurë e hapur e thjeshtuar-shërbime*" për shërbimet e mirëmbajtjes së pajisjeve të instaluara në stacionet e monitori mit të cilësisë së ajrit urban, duke ngritur dhe ngarkuar Njësinë e Prokurimit për hartimin e dokumenteve standard të tenderit
Njësia e Prokurimit e ngarkuar argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve te veçanta për kualifikim ka mbajtur Proces verbalin nr. 2713/1 prot., datë 06.04.2023 duke argumentuar dhe miratuar specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim.
Specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit i janë referuar nenit 21 pika 2 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe neni 2;2/c;78 pika 2 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Grupi i punës në piken 4 te dokumentit nr. 2713/1 prot., datë 06.04.2023 ka përcaktuar se për të garantuar se zotëron burimet e nevojshme njerëzore dhe teknike për realizimin e kontratës OE duhet të këtë në stafin e tij:
1 (një) inxhinier elektronik/informatikë/telekomunikacion;
1 (një) kimist ose inxhinier mjedisi.
Kërkesat për personelin duhet të vërtetohen me paraqitjen e dokumenteve përkatës si: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së realizmit të kontratës deri në fund të vitit 2023; Diploma përkatëse për specialistët ose diplomë e huaj e njësuar nga ministria përgjegjëse për arsimimin; Certifikatë/ta trajnimi për shërbimin e pajisjeve objekt prokurimi, të lëshuara nga kompani prodhuese të stacioneve të monitorimit apo moduleve përbërës të tyre, sipas rastit.
Argumentimi grupit të punës referon në nenin 77.4 të ligjit 162/2020 dhe nenit 41 pika 4.b të VKM 285/2021. Nëpërmjet këtij kriteri AK kërkon që OE të dëshmojnë që në stafin e tij ka, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Gjithashtu kërkesa e AK për inxhinierë të certifikuar/trajnuar, lidhet me domosdoshmërinë për prezencën në stafin e OE të profesionistëve që janë përgjegjës për ndjekjen e të gjithë ciklit të procesit. (AK sjell në vëmendje se nga përvoja e mëparshme e procedurave të prokurimit të iniciuara nga AKM me të njëjtin objekt kontrate, ka rezultuar se OE nuk kanë staf të certifikuar dhe trajnuar nga kompanitë prodhuese dhe kanë dështuar në realizimin me sukses të kontratës)
Nga auditimi rezultoi se:
Në Procesverbalin nr. 2713/1 prot., datë 06.04.2023, "Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta për kualifikim", si dhe në Dokumentet Standarde të Tenderit (DST), lidhur me kriteret e veçanta për provimin e deponimit të burimeve të nevojshme njerëzore dhe teknike për realizimin e procedurës së prokurimit, Njësia e Prokurimit ka përcaktuar se operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) inxhinier elektronik dhe/ose informatikë dhe/ose telekomunikacioni, si dhe 1 (një) kimist ose inxhinier mjedisi, duke kërkuar paraqitjen e kontratave të punës, diplomave përkatëse, si dhe certifikatave apo trajnimeve të lëshuara nga prodhuesit e pajisjeve objekt prokurimi.
Grupi i auditimit vlerëson se kërkesa për disponimin e burimeve njerëzore, duke e cilësuar si të detyrueshme zotërimin nga operatori ekonomik të profileve profesionale të sipërcituara, nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 41 të VKM nr. 285/2021, të ndryshuar. Sipas këtij përcaktimi, për kontratat e shërbimeve, autoriteti/enti kontraktor, në kuadër të vlerësimit të kapaciteteve teknike dhe profesionale për ushtrimin e veprimtarisë, duhet të referohet në kriteret e licencimit profesional të nevojshme për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, të lëshuara nga autoritetet shtetërore kompetente, dhe/ose në paraqitjen e një liste të personelit kryesor të domosdoshëm për zbatimin e objektit të prokurimit, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Më tej mbetet në përgjegjësinë e tij për të vlerësuar nëse profili profesional i deklaruar nga OE përputhet plotësisht me natyrën e shërbimit objekt kontrate.
Në Proces verbalin nr. 2713/1 prot., datë 06.04.2023 "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta për kualifikim*", është firmosur në çdo faqe, por në të konstatohet mungesa e emrave të anëtarëve të grupit të punës, hartues të proces verbalit të ngritur me Urdhër Titullari nr. 08, datë 10.03.2023, nr. prot., 1763, datë 10.03.2023.
Vlerësimi i Ofertave:
Titullari më Urdhër i Brendshëm nr. 17/2023, me 2714 prot., datë 06.04.2023 ka urdhëruar krijimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO) referuar nenit 75, VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar.
KVO me Proces Verbal nr. 2714/1 prot., datë 20.04.2023, ka mbyllur procesin e dorëzimit të ofertave në SPE në datën 19.04.2023, ora 11:00.

KVO ka konstatuar në SPE është paraqitur vetëm një ofertë nga OE "K".
KVO ka shqyrtuar dokumentacionin tekniko-ligjor-financiar të paraqitur në SPE dhe pas shqyrtimit të tij ka vlerësuar se kandidati ofertues, plotëson të gjitha kriteret e përgjegjshme dhe të veçanta të përcaktuara në DST-it dhe oferta kualifikohet e vlefshme.
KVO bazuar në pikën 2 të nenit 96 të ligjit nr. 162/2020 "për prokurimin publik", i ndryshuar, argumenton se periudha e pritjes nuk zbatohet , pasi në SPE rezultoi vetëm një ofertë e paraqitur, e cila konsiderohet e vlefshme.
Në përfundim të procesit të vlerësimit të dokumentacionit, KVO konstatoi se oferta ekonomike që plotëson të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe DST, dokumentacionin e kërkuar në kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të DST, është oferta e vetme e operatorit "K" shpk, e kualifikuar si fitues me vlerë 6.800.000 lekë (pa tvsh). Oferta nuk rezulton anomalisht e ulët dhe dorëzuar sipas kërkesave dhe specifikimeve të përcaktuara në DST.
KVO ka mbyllur procesin e vlerësimit paraprak dhe i propozon titullarit miratimin e "Formularit të Njoftimit të Fituesit (paraprak)" sipas Shtojcës 11të DST, publikuar në SPE. Në përfundim KVO konfirmon se është dakord me zhvillimin e procedurës. Të gjithë anëtarët e KVO kanë nënshkruar proces verbalin.
KVO ka mbyllur vlerësimin në SPE dhe shpall fitues OE "K" shpk, i kualifikuar si fitues, i cili dorëzoi dokumentacionin ligjor dhe teknik, në protokoll arkivin e AKM-së me shkresën me nr. 3172 prot., datë 25.04.2023.
KVO ka mbajtur proces verbalin (përfundimtar) të vlerësimit nr. 2714/2 prot., datë 25.04.2023, për dokumentacionin e dorëzuar në zyrën e protokoll arkivës së AKM-së, duke vlerësuar përputhshmërinë me dokumentacionin e dorëzuar në SPE, dhe vlerësuar përfundimisht se OE plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta në DST, dhe oferta kualifikohet e vlefshme. Për këto arsye KVO, mbyll procesin e vlerësimit dhe i dërgon OE fitues njoftimin për lidhjen e kontratës.
Në datën 27.04.2023 KVO ka hartuar Raportin Përmbledhës me nr. 2714/3 prot., datë 27.04.2023, miratuar nga Titullari.
Duke iu referuar procedurës së prokurimit, oferta e paraqitur nga "K" shpk, me vlerë të përgjithshme 6,800.000 lekë pa tvsh, është kualifikuar si oferta e suksesshme, për të cilën OE njoftohet nëpërmjet SPE të paraqesë sigurimin e kontratës, si parashikohet në DST, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të njoftimit të fituesit.
AK dhe OE kanë lidhur Kontratë Shërbimi nr. 2713/3 prot., datë 02.05.2023, në vlerë totale 6.800.000 lekë (pa tvsh) ose 8.160.000 lekë (me tvsh).
AK dhe OE kanë nënshkruar Planin e Zbatimit të Kontratës me akt nr. 2713/4 prot., datë 08.05.2023. Me shkresë përcjellëse nr. 2713/6 prot., datë 10.05.2023 është njoftuar APP me planin e zbatimit të Kontratës,
OE ka paraqitur Sigurimin e Kontratës me dok "Police Sigurimi Kontrate" ne protokollin e AMK me nr. 3172/1, date 27.04.2023, për procedurën e prokurimit me Ref-65249-04-06-2023, date 27.04.2023, në shumën 816,000 lekë e vlefshme nga 27.04.2023 deri 31.05.2024 nga shoqëria "A".
Nga auditimi rezulton se:
Njësia e Prokurimit e ngarkuar argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve te veçanta për kualifikim ka mbajtur Proces verbalin nr. 2713/1 Prot., datë 06.04.2023. Në pikën 2 të specifikimi "1.3 Kapaciteti teknik" për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale ka përcaktuar se OE duhet të paraqesë Certifikatë ISO 9001:2015 mbi "Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë", dhe Certifikatë ISO 14001:2015 mbi "Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit", të lëshuar nga një organ i vlerësimit të

konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga RSH. Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Dokumentet e paraqitura nga OE përkatësisht Certifikatë ISO 9001:2015 mbi "Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë", lëshuar nga C. Ë B. l, e vlefshme deri 29.01.2025 dhe Certifikatë ISO 14001:2015 mbi "Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit", lëshuar nga C. Ë B. l, e vlefshme deri 30.03.2025.

Grupi i auditimit konstaton se, KVO në vlerësimin e ofertave të paraqitura, sipas PV nr. 2714/1, datë 20.04.2023 dhe PV përfundimtar nr. 2714/2 Prot., datë 25.04.2023, subjekti "K" sh.p.k. ka paraqitur certifikatat ISO 9001:2015, të vlefshme deri më 29.01.2025, dhe ISO 14001:2015, të vlefshme deri më 30.03.2025, të lëshuara nga "L" .Në përmbajtjen e këtyre dokumenteve përcaktohet se: "*Kjo certifikatë është lëshuar elektronikisht dhe mbetet pronë e* C. Ë B. l *dhe lidhet me kushtet e kontratës. Kopjet e printuara mund të bëhen të vlefshme me kërkesë. Për të verifikuar autenticitetin dërgoni e-mail në info@certië.com ose skanoni QR Code SIA "*C. Ë B" .

KVO nuk është shprehur mbi verifikimin e autenticitetit të certifikatave të paraqitura nga OE, sipas përcaktimeve në vetë përmbajtjen e tyre. Pra, KVO nuk ka vlerësuar nëse certifikatat e lëshuara nga C. Ë B. l përbëjnë certifikata të lëshuara nga një organ i pavarur i njohur nga sistemet ndërkombëtare të standardizimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), apo nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, veprime në kundërshtim me nenin 79 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe me nenin 44 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

ZBATIMI I KONTRATËS

- Urdhër nr. 20/2023, prot., 3406, datë 04.05.2023, titullari ka urdhëruar ngritjen e Grupit të Punës për Zbatimin e Kontratës, ndryshuar me shkresë nr. 3406/3 prot., datë 06.09.2023, për ndryshimin e grupit duke zëvendësuar Izabela Kuka më Majlinda Sulollari.

AK dhe OE kanë lidhur Kontratë Shërbimi nr. 2713/3 prot., datë 02.05.2023, në vlerë totale 6.800.000 lekë (pa tvsh) ose 8.160.000 lekë (me tvsh) si dhe Planin e Zbatimit të Kontratës me akt nr. 2713/4 prot.., datë 08.05.2023.

AK me shkresë nr. 2713/5 prot., datë 10.05.2023 ka njoftuar APP mbi planin e zbatimit të kontratës.

AK me shkresë nr. 5745/1, datë 29.05.2024 ka njoftuar APP mbi zbatimin e kontratës nëpërmjet "Formularit të raportimit për Zbatimin e Kontratës".

Me Urdhrin nr. 20/2023, prot., 3406, datë 04.05.2023, titullari ka urdhëruar znj. A. Z të vërë në dispozicion të grupit të punës dokumentacionin e nevojshëm të procedurës së prokurimit ka urdhëruar ngritjen e Grupit të Punës për Zbatimin e Kontratës.

Grupi i Punës për Hartimin e Specifikimeve Teknike, i ngritur me Urdhër nr. 08, datë 10.03.2023, në shkresën nr. 2713/1 prot., datë 06.04.2023 "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta për kualifikim*", ka hartuar, argumentuar dhe miratuar specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim referuar nenit 21.2 të ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 2 .2.c të VKM 285/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Grupi i punës ka përcaktuar se mirëmbajtja do të kryhet sipas grafikut të shërbimit.

Shërbimi i mirëmbajtjes së stacioneve të monitorimit të ajrit, do të kryhet në afatet e caktuara dhe sipas specifikimeve teknike bazuar në manualet e përdorimit të pajisjeve, që kanë nevojë për shërbime dhe mirëmbajtje të rregullt. Përpara lidhjes së Kontratës, OE fitues së bashku me grupin e ekspertëve të AKM-së do të kryejë inspektimin e gjithë pajisjeve të instaluara. Shërbimi i mirëmbajtës do të kontraktohet vetëm për pajisjet që janë ne gjendje pune, të cilat nuk kërkojnë dërgimin e modulit jashtë vendit dhe arrijnë të japin të dhënat e domosdoshme për raportim të përcaktuara nga grupi i ekspertëve të AKM-së.

Komisioni i marrjes në dorëzim të shërbimit në zbatim të Urdhrit 20/2023 dhe programit të punës nr. 3528 prot., datë 09.05.2023 me objekt "*Shërbimi i mirëmbajtjes së pajisjeve të instaluara në stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit urban në qytet Durrës, Shkodër, Korçë, Elbasan, Fier, stacioni i lëvizshëm në Tiranë dhe Stacioni i Institutit të Higjienës* ", ka marrë në dorëzim kryerjen e mirëmbajtjes së pajisjeve të monitorimit të ajrit në qytete Durrës, Shkodër, Korçë, Elbasan, Fier, Stacioni i lëvizshëm në Tiranë dhe Stacionoonit i Institutit të Higjienës.
OE ka depozituar Proces verbal për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes për periudhën 02.05.2023 deri 01.06.2023, protokolluar në AKM nr. 4133 prot., datë 02.06.2023 për kryerjen e gjithë shërbimet dhe pjesët e këmbimit për realizmin e kryerjes së shërbimit të kontraktuar. Me këtë Proces Verbal grupi zbatimit të kontratës të pranon të se të gjitha shërbimet e mësipërme (tabela bashkëlidhur) janë kryer në përputhje me kërkesat e kontratës dhe të gjithë pjesët e këmbimit që u përdorën u dorëzuan bashkë më këtë proces verbal pranë AKM. Proces verbali është firmosur nga grupi zbatimit të kontratës znj. I. K, znj. I. H, z. B. P dhe përfaqësuesi nga përfaqësuesi OE z. E. Q.
Grupi i zbatimit të kontratës i ka dërguar Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse shkresat (Titulluar Proces- verbal): nr.41332/1 prot., datë 02.06.2023 për Stacioni Instituti Higjienës Tiranë; nr. 41332/2 prot., datë 02.06.2023 për Stacioni Tirana Mobile; nr. 41332/3 prot., datë 02.06.2023 për Stacioni Durrës; nr. 41332/4 prot., datë 02.06.2023 për Stacioni Elbasan; nr. 41332/5 prot., datë 02.06.2023 për Stacioni Fier; nr. 41332/6 prot., datë 02.06.2023 për Stacioni Korçë; nr. 41332/7 prot., datë 02.06.2023 për Stacioni Shkodër me të cilat konfirmon se në zbatim të kontratës, kompania ka kryer të gjitha shërbimet në përputhje më DST, specifikisht Shtojca 5 dhe Shtojca 7 (bashkëlidhur tabela/at për secilin stacion).
Proces verbalet e dërguara dërguar Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse janë firmosur nga grupi zbatimit të kontratës znj. I. K, znj. I. H, z. B. P dhe përfaqësuesi dhe miratuar nga Drejtori regjistrave Mjedisorë z. N. P.
Pagesa me Urdhër Shpenzim nr. 143, datë 22.06.2023, sipas FT. nr. 830/2023, datë 05.06.2023.

Nga auditimit rezulton se:
AK ka miratuar *si dokument standard Planin e Zbatimi të Kontratës nr. 2713/4 prot., datë 08.05.2023, por ky plan nuk përmban grafikun e zbatimit të kontratës sipas specifikimeve teknike për shërbimet që do të kryhen dhe periodicitetin e realizimit të tyre,* në kundërshtim me nenin 74 pika 4 germa "d" të Ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar,sipas të cilit specialisti i fushës ose struktura e posaçme kryen detyrat e mëposhtme, sipas rastit përcaktimin e çdo informacioni tjetër specifik të nevojshëm për objektin e prokurimit ku përfshihet dhe grafiku i shërbimit. Mos përcaktimi i grafikut të shërbimit është në kundërshtim me DST si dhe nenin 3 pika 5 të Kontratës së Shërbimit **nr. 2713/3 Prot., datë 02.05.2023, sipas të cilës pagesa do të bëhet me faturë tatimore , në varësi të shërbimit të kryer sipas grafikut të ekzekutimit dhe të miratuar nga grupi i punës për zbatimin e kontratës.**
Nga auditimi u konstatua se AK me shkresë nr. 5745/1, datë 29.05.2024 ka njoftuar APP mbi zbatimin e kontratës nëpërmjet "**Formularit të raportimit për Zbatimin e Kontratës**" firmosur nga Titullari. Grupi i punës konstatoi se Komisioni për zbatimin e Kontratës së Shërbimit nr. 2713/3 Prot., datë 02.05.2023 **nuk ka hartuar Raport Përmbledhës për Zbatimin e Kontratës**, në kundërshtim me kreun II, neni 2 germa "ll", VKM 285/2011 sipas të cilit për çdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë Raportin për zbatimin e kontratës, sipas parashikimeve në LPP.
Në procesverbalet e marrjes në dorëzim konfirmohet kryerja e shërbimit, si dhe dorëzimi i të gjitha pjesëve të përdorura. Referuar urdhër-shpenzimit për pagesën e shërbimit të mirëmbajtjes dhe dokumentacionit vërtetues bashkëlidhur tij, **nuk rezulton asnjë Fletë-Hyrje në magazinë për**

pjesët e këmbimit të hequra dhe të zëvendësuara me pjesë të reja, për të vijuar më pas me procedurat e inventarizimit dhe/ose asgjësimit të tyre. **Procesverbalet për pranimin e shërbimit mbahen në të njëjtën datë për çdo muaj**, pavarësisht distancës së objekteve ku është realizuar shërbimi, çka nuk garanton pasqyrimin real dhe të verifikueshëm të kryerjes së tij në kohë dhe vend. Gjithashtu, **këto procesverbale nuk janë nënshkruar nga përfaqësuesi i Operatorit Ekonomik**, duke cenuar vlefshmërinë e aktit si dokument dypalësh pranimi.
Më tej, procesverbalet **nuk pasqyrojnë numrin e kopjeve të hartuara** dhe **nuk mbajnë numër protokolli hyrës** në institucionin e AKM-së, përveç numrit dhe datës së protokollit me të cilin janë përcjellë për pagesë Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.
Mungesa e këtyre elementeve përbën mosrespektim të elementeve formale të mbajtjes së aktit administrativ, duke kufizuar gjurmueshmërinë, transparencën dhe kontrollueshmërinë e dokumentacionit, në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit në fuqi për dokumentimin e veprimeve administrative dhe financiare, si dhe me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

Grupi i punës për zbatimin e kontratës për pranimin e shërbimit të mirëmbajtjes së stacioneve të monitorimit të ajrit ka mbajtur proces verbal/e për Zbatimin e Kontratës Shërbimit nr. 2713/3 Prot., datë 02.05.2023, si më poshtë vijon:
Zbatimi Kontratës Shërbimi nr. 2713/3 prot., datë 02.05.2023

PV marrje ne dorëzim	Periudha	U_SH	Fature Tatimore	Vlera e tatueshme	TVSH	Totali
Nr.4133 Prot.., dt. 02.06.2023	2023-05	nr. 143, dt.. 22.06.2023	Nr. 830/2023, dt. 05.06.2023	566,667	113,333	680,000
Nr.5140 Prot.., dt. 07.07.2023	2023-06	nr. 175, dt.. 27.07.2023	Nr. 1279/2023, dt. 16.08.2023	566,667	113,333	680,000
Nr.5919/5 Prot.., dt. 04.08.2023	2023-07	nr. 199, dt.. 21.08.2023	Nr. 1275/2023, dt. 04.08.2023	566,667	113,333	680,000
Nr.7054, Prot. dt. 01.09.2023	2023-08	nr. 230, dt.. 14.09.2023	Nr. 1369/2023, dt. 01.09.2023	566,667	113,333	680,000
Nr.8305 Prot., dt. 06.10.2023	2023-09	nr. 277, dt.. 20.10.2023	Nr. 1542, dt. 04.10.2023	566,667	113,333	680,000
Nr. 917 Prot., 7, dt. 03.11.2023	2023-10	nr. 295, dt.. 09.11.2023	Nr. 1748/2023, dt. 02.11.2023	566,667	113,333	680,000
Nr. 10115/3 Prot., , dt. 05.12.2023	2023-11	nr. 330, dt.. 11.12.2023	Nr. 1943/2023, dt. 04.12.2023	566,667	113,333	680,000
Nr. 29 Prot.., dt. 03.01.2024	2023-12	nr. 06, dt.. 24.01.2024	Nr. 2/2024, dt. 04.01.2024	566,667	113,333	680,000
Nr. 942 Prot.., dt. 29.01.2024	2024-01	nr. 28, dt. 13.02.2024	Nr. 217/2024, dt. 05.02.2024	566,667	113,333	680,000
Nr. 2651 Prot.., dt. 04.03.2024	2024-02	nr. 52, dt. 11.03.2024	Nr. 140/2024, dt. 05.03.2024	566,667	113,333	680,000
Nr.3874 Prot.., dt. 03.04.2024	2024-03	nr. 96, dt. 16.04.2024	Nr. 337, dt. 03.04.2024	566,667	113,333	680,000
Nr. 2651 Prot.., dt. 04.03.2024	2024-04	nr. 123, dt. 14.05.2024	Nr. 505/2024, dt. 03.05.2024	566,667	113,333	680,000
Paguar				**6,800,000**	**1,360,000**	**8,160,000**
Kontrata shërbimit nr. 2713/3, dt. 02.05.2023				**6,800,000**	**1,360,000**	**8,160,000**
Pa paguar				-	-	-

Për vitin 2024

3- **Tenderi me objekt me objekt " Blerje reagentësh dhe materiale laboratori ", nr. REF-22960-10-07-2024, për subjektin "K", me NIPT K.....A;**

a. Blerje reagentësh dhe materiale laboratori		
1. **Urdhër Prokurimi Nr.10, datë 26.09.2024**		
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: Procedurë e hapur e thjeshtuar për mallra;	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: Urdhër Prokurimi Nr.10, datë 26.09.2024 A. Z (Kryetar) A. A (Anëtar) B. S (Anëtar),	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Urdhër Nr. 221, dt 26.02.2024, i ndryshuar me Urdhër nr.232, dt 18.10.2024 I. H (Kryetar) I. K (Anëtar) D. B (Anëtar),
5. Fondi Limit: 2,363,616 lekë (pa TVSH)	6. Oferta fituese "K": 2,130,660 lekë (pa TVSH)	7.Diferenca me fondin limit 232,956 lekë (pa TVSH)
8. Data e hapjes së tenderit : 27.09.2024	9. Burimi Financimit Buxheti Shtetit	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender: 2 (dy) OE b)Skualifikuar: 1 (një) OE
11. Ankimime AK (s'ka) APP (s'ka) KPP (s'ka)	12. Përgjigje Ankesës: nga AK : (s'ka)	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP: (s'ka)
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e **kontratës:** nr. 10022/2 Prot., datë 19.11.2024	15. Vlera e kontratës 2,556,792 lekë (me TVSH)	16. Likuiduar: në shumen **2,556,792** Lekë (me Tvsh)

		Pa likuiduar (**zero**) Lekë.
17 …	*18. Afati i kontratës në dite Parashikuar =40ditë;* *Zbatuar = 35 ditë*	19. Zgjatja e kontratës (jo)
FT nr. 1833, date 05.12.2024 ne shumën 1,038,312 lekë me tvsh *FT nr. 1953, date 24.12.2024 ne shumën* 1,518,480 lekë me tvsh		
Sigurim kontrate: Nr. 0021761, dt. 11.11.2024	23.**Akt i marrjes në dorëzim** - PV marrje ne dorëzim malli nr. 10024/1 Prot., datë 05.12.2024 PV marrje ne dorëzim malli nr. 10024/2 Prot., datë 24.12.2024	24. Fletë Hyrja F-H nr. 11, datë 05.12.2024 F-H nr. 13, datë 24.12.2024

Planifikimi i nevojave për prokurim: AKM me shkresë nr. 6759 Prot., datë 29.08.2023 ka dërguar në MTM projekt buxhetin afat mesëm PBA 2024-2026 faza teknike së bashku me relacion shoqërues bashkëlidhur tij. Në parashikim buxhetor për vitin 2024 në programin kombëtar të monitorimit të mjedisit parashikohet financimi për kryerjen e shërbimit "Kryerje Analizash për tregues mjedisore" me vlerë 2.100.000 (pa tvsh) dhe 2,520,000 lekë (me tvsh).

Në regjistrin e parashikimeve për vitin 2024 fondi limit i parashikuar u në vlerën 2,733,333 lekë pa tvsh, ku nuk ka pësuar ndryshime të mëvonshme nga ato të publikuara në regjistrin e parashikimeve dërguar në Degën e Thesarit Tiranë me shkresë Nr. 357/1 Prot., datë 15.01.2024, konform nenit 3, pika 4, e VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 me ndryshime.

Ngritja e Komisioneve për procedurën e prokurimit "*Blerje reagentësh dhe materiale laboratori*"

Komisioni të Testimit të Tregut dhe llogaritjes së fondit limit, i ngritur me Urdhër nr. 176, datë 01.08.2024 (vjetor), i përbërë nga:

M. P (Kryetar);

K. M (Anëtar);

O.T (Anëtar),

Komisioni për Hartimin e Specifikimeve Teknike me përfshirjen e specialistit të fushës ngritur me Urdhër nr. 109, datë 14.05.2024:

V. P (Kryetar) përgjegjës, Sektori i Analizave Laboratorike dhe Inovacionit, DMDM.

S. P (Anëtar) specialist, Sektori i Analizave Laboratorike dhe Inovacionit, DMDM.

B. P (Anëtar) specialist, Sektori i Analizave Laboratorike dhe Inovacionit, DMDM.

Njësia e Prokurimit e ngritur me Urdhër Prokurimi nr. 10, nr. 10022 prot., datë 26.09.2024 me përbërje :

A. Z (Kryetar),

A. A (Anëtar)

B. S (Anëtar)

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i ngritur me urdhër nr. 221, nr. 10832 Prot., datë 26.09.2024, i ndryshuar me Urdhër nr. 232, 10832 Prot., datë 18.10.2024 me përbërje;

I. H (Kryetar);

I. K (Anëtar)

A. D (Anëtar) deklaron konflikt interesi dhe zëvendësohet me D. B (Anëtar)

Grupi i punës për zbatimin e kontratës i ngritur me Urdhër nr. 10024 Prot., datë 26.09.2024 me përbërje:

S. S (Kryetar);

E. F (Anëtar);

M. S (Anëtar)

Llogaritja e Fondit Limit:

AK ka parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimit publike për vitin 2024, prokurimin me objekt "Blerje reagentëve dhe materiale laboratori", me fond limit të llogaritur 2.391.000 lekë (pa tvsh)

Me kërkesë nr. 02, datë 09.01.2024 Drejtoria e regjistrave Mjedisorë, Sektori i Mostrimit dhe Analizave Laboratorikë, me shkresë nr. 02,datë 09.01.2024, ka kërkuar kryerjen e proceduarve të prokurimit për blerje reagentëve dhe materiale laboratori (50 artikuj), për zbatimin e programeve vjetorë të Monitorimit nr. 110 prot dhe nr. 111 prot., datë 08.01.2024

Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse i është drejtuar Titullarit me kërkesë nr. 3895 Prot., datë 04.04.2024 për kryerjen e procedurës së prokurimit për blerjen e reagentëve dhe materialeve sipas kërkesës nr. 2, datë 09.01.2024 paraqitur nga Sektori i Mostrimit dhe Analizave Laboratorike për zbatimin e programeve të Monitorimit nr. 191, datë 12.02.2023 dhe Nr. 192, datë 12.02.2023.

Znj. A. Z, përgjegjëse e Sektorit Juridik dhe Çështjeve Ligjore, në cilësisë e personit përgjegjës për prokurimet, me shkresë nr. 3895/1 prot., datë 13.05.2024 i është drejtuar titullarit me kërkese për ngritjen e grupit te punës për hartimin e specifikimeve teknike, ngritjen e njësisë së prokurimit me përfshirjen e specialistit të fushës, komisionin i vlerësimit të ofertave dhe komisioni i marrjes në dorëzim.

Komisionin testimit të tregut ka mbajtur Proces Verbal për Testimit e Tregut nr. 8189/2 prot., datë 25.09.2024, bazuar në produktet e kërkuara, specifikimet teknike, njësinë dhe sasinë e kërkuar. Komisioni i testimit te tregut ka vlerësuar çmimet e blerjeve sipas ofertave dhe mbështetur në mesataren e tyre llogariti fondin limit (pa tvsh)

Anëtaret e Komisionit të testimit të tregut kane nënshkruar formularin e deklarimit për konfliktin e interesit

Nga studimi i tregut, bazuar në çmimet e blerjes pa tvsh, sipas ofertave te paraqitura me çmim blerje pa tvsh nga subjekti "K" ne vlerë 2,563,300 lekë[2]; "L. Ch. D" në vlerë 2,641,650 lekë dhe "T" ne vlerë 2,673,320 lekë dhe çmimeve të ofertave të paraqitura nga këto subjekte, mbështetur për çmimin mesatar për artikull llogariti fondin limit pa tvsh 2,363,616 lekë.

Te dhënat për studimin e tregut dhe llogaritja e fondit limit

Nr.	Emërtimi	Çmimi i blerjes pa tvsh			**Vlera totale pa tvsh**
		K.	L. Ch. D.	T.	
1	Blerje reagentësh dhe materiale laboratori	2,563,300	2,641,650	2,673,320	**2,363,616**

Komisioni për Hartimin e Specifikimeve Teknike, për procedurën e prokurimit, me objekt "Blerje reagent dhe materiale laboratori", me proces verbal nr. 5327/2 prot., datë 12.08.2024, dhe proces verbal nr. 5327/3, datë 04.09.2024 ka hartuar specifikimet teknike referuar, për 48 artikuj, nenit 36 të ligjit 162/2020, i ndryshuar dhe nenit 2 të VKM 285/2021, i ndryshuar.

Grupi i punës së testimit të tregut, ka mbajtur proces verbal për testimin e tregut, nr. 8189/2 prot., datë 25.09.2024, sipas çmimit të blerjeve të ofertave të OE (3 oferta) dhe mbështetur në mesataren e tyre llogariti fondin limit në vlerë 2,363,616 lekë (pa tvsh).

Komisioni i testimit të tregut dhe llogaritjes së fondit limit me memo nr. 8189/1 prot., datë 23.09.2024, ka njoftuar Titullarin rezultatet e testimit te tregut dhe llogaritjen e fondit limit.

Anëtarët e Komisioni për Hartimin e Specifikimeve Teknike kanë hartuar individualisht deklaratën e konfliktit të interesit, datë 14.05.2024

Hartimi i dokumenteve të tenderit/kriteret e veçanta për kualifikim-

Titullari me Urdhër Prokurimi nr. 10/2024 , prot., 10022, datë 26.09.2024 ka urdhëruar zhvillim e procedurës së prokurimit "*Procedurë e hapur e thjeshtuar-mallra*", me fond buxhetor 2,363,616 lekë pa tvsh, për blerje reagentësh dhe materiale laboratori, duke ngritur dhe ngarkuar Njësinë e Prokurimit për hartimin e dokumenteve standard të tenderit sipas nenit 73, VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar Njësia e Prokurimit e ngarkuar për hartimin e dokumenteve standard të

[2] *Me shkresë datë 01.10.2024 "Kthim Përgjigje" APP konfirmon se ka marrë vendim për përjashtim të operatorit ekonomik K...., me NIPT K.....A, nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik ne periudhat 02.08.2024 – 22.08.2024*.

tenderit ka mbajtur Proces verbalin nr. 10022/1 prot., datë 27.09.2024 duke argumentuar dhe miratuar specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim.
Specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit i janë referuar nenit 21 pika 2 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe neni 2;2/c;78 pika 2 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.
Në hartimin e dokumenteve standard të tenderit, grupi i specifikimeve teknike ka përcaktuar:
Në pikën 2.2.b "kapaciteti ekonomik dhe financiar" se OE duhet të paraqesin kopje të bilanceve 2021-2022-2023 , të shoqëruara me raportet e auditimit ligjore të pasqyrave financiare, të kryera nga audituesligjore ose shoqëri audituese;
Në pikën 2.3.b "Kapaciteti teknik" grupi hartimit të DST përcakton se OE duhet të ketë në stafin e vet , të paktën 1(një) kimist/ biolog/ bioteknik/ inxhinier (ose fusha të ngjashme) të vërtetuara me CV, diplomë, kontratë që është brenda vlerës kufi të përcaktuar nga legjislacioni. Në arsyetimin e tij, grupi i hartimit të DST përcakton se kjo kërkesë është vendosur në përputhje me specifikimet teknike për këtë procedurë si dhe ky kriter lidhet me kapacitetet teknike dhe aftësitë profesionale të OE.
Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten katalogë origjinal;
OE duhet të paraqesë deklaratë në formë tabele, ku të plotësohet emri i kompanisë prodhuesve , vendi i ushtrimit të aktivitetit dhe origjina e mallit;
OE duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori zyrtar i autorizuar.
OE duhet të paraqesë një deklaratë, ku të deklarojë se data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe datës së skadencës, ose jo më pak së një vit nga data e lëvrimit të mallit;
OE merr përsipër transportin e artikujve
Për të provuar përputhshmërinë me veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, OE duhet të paraqesë:
ISO 9001:2015 mbi "Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë", lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akreditуar nga organizma kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues , të njohura nga RSH, Certifikata duhet të jetë e vlefshme gjatë kohës së zhvillimit të tenderit.
ISO 14001:2015 mbi "Sistemet e Menaxhimit të Mjedisit" lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akreditуar nga organizëm kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues , të njohura nga RSH, Certifikata duhet të jetë e vlefshme gjatë kohës së zhvillimit të tenderit.
- NJP në DST ka përcaktuar se për të garantuar se OE zotëron burimet e nevojshme njerëzore dhe teknike për realizimin e kontratës duhet të këtë në stafin e tij 1(një) inxhinier kimist/ biolog/bioteknolog/inxhinier në fusha të ngjashme, të vërtetuara me CV, diplomë, kontratë individuale pune të vlefshme në momentin e hapjes së ofertave përfshirë dhe afatin e zbatimit të kontratës.
Etj...

Nga auditimi rezultoi se:
Njësia e Prokurimit e ngarkuar argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve te veçanta për kualifikim ka mbajtur **PV nr. 10022/1 prot., datë 27.09.2024 dhe DST** "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta për kualifikim*", si dhe në Dokumentet Standarde të Tenderit (DST), lidhur me kriteret e veçanta **nuk ka përdorur**

shprehjen "ose ekuivalent", veprim në kundërshtim me neni 36.3.c, të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
Në Procesverbalin **PV nr. 10022/1 prot., datë 27.09.2024** "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta për kualifikim*", si dhe në Dokumentet Standarde të Tenderit (DST), lidhur me kriteret e veçanta për provimin e deponimit të burimeve të nevojshme njerëzore dhe teknike për realizimin e procedurës së prokurimit, **Njësia e Prokurimit ka përcaktua**r se operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) inxhinier elektronik dhe/ose informatikë dhe/ose telekomunikacioni, si dhe 1 (një) kimist ose inxhinier mjedisi, duke kërkuar paraqitjen e kontratave të punës, diplomave përkatëse, si dhe certifikatave apo trajnimeve të lëshuara nga prodhuesit e pajisjeve objekt prokurimi.
Grupi i auditimit vlerëson se kërkesa për deponimin e burimeve njerëzore, duke e cilësuar si të detyrueshme zotërimin nga operatori ekonomik të profileve profesionale të sipërcituara, nuk është në përputhje **me pikën 4 të nenit 41 të VKM nr. 285/2021**, të ndryshuar. Sipas këtij përcaktimi, për kontratat e shërbimeve, autoriteti/enti kontraktor, në kuadër të vlerësimit të kapaciteteve teknike dhe profesionale për ushtrimin e veprimtarisë, **duhet të referohet në kriteret e licencimit profesional të nevojshme për realizimin e shërbimeve** objekt kontrate, të lëshuara nga autoritetet shtetërore kompetente, dhe/ose në paraqitjen e një liste të personelit kryesor të domosdoshëm për zbatimin e objektit të prokurimit, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Më tej mbetet në përgjegjësinë e tij për të vlerësuar nëse profili profesional i deklaruar nga OE përputhet plotësisht me natyrën e **shërbimit** objekt kontrate.

Vlerësimi i Ofertave:
- Titullari më Urdhër i Brendshëm nr. 222/2024, prot., 10832 datë 18.10.2024 ka urdhëruar krijimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO) referuar nenit 73, VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar .

Anëtarët e KVO para fillimit të procedurës së vlerësimit të ofertave , kanë nënshkruar formularin e deklarimit të konfliktit të interesit datë 18.10.2024
KVO ka mbajtur :
1. Proces Verbalin e vlerësimit të Ofertave nr.1, protokolluar në institucion me nr. 10832/1 prot., datë 18.10.2024, më të cilin konstaton se dokumentacioni tekniko ligjor dhe financiar është paraqitur në SPE, dhe komisioni kërkon kohën e nevojshme sipas afateve ligjore për vlerësimin e tij.
2. Proces Verbalin e vlerësimit të Ofertave nr.2, protokolluar në institucion me nr. 10832/2 prot., datë 30.10.2024 në të cilin konstaton se
Në datën 18.10.2024, ora11:00, në SPE ka mbyllur procesin e dorëzimit të ofertave dhe ka hapur ofertat e paraqitura në sistem. Anëtarët e KVO kanë konstatuar se janë paraqitur 2 (oferta) oferta, përkatësisht ofertuesit:
"K" shpk;
"A" shpk;
Nga pjesëmarrësit u skualifikua OE "A" shpk me arsyetimin mospërputhje më DST pika 42; 39;38;37;34;32;31;29;27;12, mungesë autorizim nga prodhuesi ose distributor zyrtar i autorizuar nga prodhuesi, mungese vërtetim zyrtar nga MERCK për të provuar se është distributor i këtij prodhuesi, OE nuk ka paraqitur CV-në e inxhinier kimist,
Në përfundim të procesit të vlerësimit të dokumentacionit, KVO konstatoi se oferta ekonomike që plotëson të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe DST, dokumentacionin e kërkuar në kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të DST, është oferta e operatorit "K" shpk, e kualifikuar si fitues me vlerë 2.130.660 lekë pa tvsh. Oferta nuk rezulton anomalisht e ulët dhe dorëzuar sipas kërkesave dhe specifikimeve të përcaktuara në DST.

KVO mbyll vlerësimin në SPE ne datën 02.05.2023, dhe shpall fitues OE "K" shpk, i kualifikuar si fitues, i cili dorëzoi dokumentacionin ligjor dhe teknik, ne protokoll arkivën e AKM-së me shkresën me nr. 3373 Prot., datë 03.05.2023.
KVO ka mbyllur procesin e vlerësimit paraprak në SPE në datën 23.10.2024 dhe i propozon titullarit miratimin e "Formularit të Njoftimit të Fituesit (paraprak)" sipas Shtojcës 10 të DST, publikuar në SPE.
Ne datën 07.11.2024 KVO ka hartuar Raportin Përmbledhës me nr. 10832/3 Prot., datë 07.11.2024. Duke iu referuar procedurës së prokurimit, oferta e paraqitur nga "K" shpk, me vlerë të përgjithshme 2.130.660 lekë pa tvsh, është kualifikuar si oferta e suksesshme, për të cilën OE njoftohet nëpërmjet SPE të paraqesë sigurimin e kontratës, si parashikohet në DST, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të njoftimit të fituesit.
KVO ka mbyllur procesin e vlerësimit dhe ka dërguar "Formularit të Njoftimit të Fituesit" dt. 23.10.2024 sipas Shtojcës 11 të DST, publikuar në SPE, duke kërkuar dorëzimin e sigurimit të kontratës, brenda 5-ditëve nga dita e marrjes/publikimit. Raporti përmbledhës është miratuar nga Titullari,
OE ka paraqitur Sigurimin e Kontratës me dok "Police Sigurimi Kontrate" në protokollin e AMK me nr. 11887, datë 11.11.2024, për procedurën e prokurimit me Ref-22960-07-2024, datë 11.11.2024, në shumën 255.680 lekë e vlefshme nga 11.11.2024 deri 31.12.2024 nga shoqëria "A".

Nga auditimi rezultoi se:
KVO, në vlerësimin e ofertave te paraqitura nga OE dhe **proces verbalin përfundimtar nr. 10832/2 prot., datë 30.10.2024**, nuk ka vlerësuar nëse certifikatat e lëshuara nga "L" **përbëjnë certifikata të lëshuara nga** organ i pavarur i njohur nga sistemet e standardizimit ndërkombëtar**, ose nga** Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA)**, apo nga** organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë**,** në kundërshtim me DST dhe nenin 79 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar**, si dhe me** nenin 44 të VKM-së nr. 285, datë, 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Lidhja e kontratës
AK ka lidhur Kontratë Furnizimi nr. 10022/2 prot., datë 19.11.2024 me K. shpk, për furnizim me mallra për blerje reagentësh dhe materiale laboratori, në përputhje me specifikimet teknike, afatin e lëvrimit të mallit dhe DST të miratuar.
Grafiku i ekzekutimit të Kontratës do te realizohet për lëvrimin e mallit do të realizohet brenda 40 (dyzet) ditëve, nga data e lidhjes së kontratës.
Vlera totale e kontratës është 2,130,660 lekë (pa tvsh) ose 2,556,792 lekë (me tvsh).
Sigurimin kontratës do të jetë 255,679 lekë.
Me shkrese nr. 12402 prot., datë 25.11.2024 është miratuar "Plani zbatimit të Kontratës". nënshkruar sipas të cilës: në pikën B.1.3. "Kushtet e lëvrimit/ dorëzimit të mallrave", përcaktohen kushtet e dorëzimit, datat dhe vendet e dorëzimit në përputhje me Grafikun e Dorëzimeve të parashikuar në kontratë; në pikën B.2 përcaktohet dokumentacioni që do të administrohet nga palët gjatë zbatimit të kontratës janë aktet e kontrollit periodike që kryhen gjatë zbatimit të kontratës, kopje të raporteve të monitorimit, listë e problemeve të hasura, fature tatimore, urdhër shpenzime, kopje komunikimit shkresor, sasia dhe grafiku i lëvrimit, dokumenti për marrjen në dorëzim.
Zbatimi i kontratës
-Me Urdhër i Brendshëm Nr. 10024 Prot datë 26.09.2024, Titullari ka urdhëruar ngritjen e Grupit të Punës për Zbatimin e Kontratës, sipas VKM Nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, dhe Udhëzimit të APP nr. 2, datë 18.03.2022 "Mbi Raportimin e zbatimit të Kontratës"

Grupi i punës për zbatimin e kontratës nr. 12402 prot., datë 25.11.2024 për marrjen në dorëzim të mallit ka mbajtur proces verbal sipas tabelës bashkëlidhur.

Dokumentacionin marrjes në dorëzim të mallit .

PV marrje ne dorëzim	Dokumentacion shoqërues	Fature Tatimore	Flete Hyrje Magazine	Totali
PV marrje ne dorëzim malli nr. 10024/1 Prot., datë 05.12.2024	Akt Dorëzimi nga OE me date 05.12.2024	FT nr. 1833, date 05.12.2024	F-H nr. 11, datë 05.12.2024	1,038,312
PV marrje ne dorëzim malli nr. 10024/2 Prot., datë 24.12.2024	Akt Dorëzimi nga OE me date 24.12.2024	FT nr. 1953, date 24.12.2024	F-H nr. 13, datë 24.12.2024	1,518,480
Totali				**2,556,792**
Urdhër –Blerje nr. 320, date 30.12.2024				**2,556,792**
Pa paguar				**0**

Grupi i punës për zbatimin e kontratës për kontratën e furnizimit nr. 10022/2 prot., datë 19.11.2024 ka hartuar dhe nënshkruar Raport Përmbledhës për Zbatimin e Kontratës nr.10024/3 prot., dt. 30.12.2024 për blerjen dhe marrjen në dorëzim të reagentëve për materiale laboratorike.

Ne këtë raport grupi i marrjes në dorëzim sqaron se me proces verbalet nr. 10024/1 Prot., datë 05.12.2024 dhe nr. 10024/2 Prot., datë 24.12.2024 është verifikuar dhe është marrë në dorëzim malli sipas kërkesës së AK. Grupi shprehet se AK ka zbatuar kontratën përpara afatit kontraktual dhe gjatë zbatimit të kontratës grupi shprehet se nuk ka pasur asnjë problematikë. Sipas urdhrit të shpenzimit nr. 320 datë 30.12.2024 praktika është dërguar dhe konfirmuar në degën e thesarit për likuidim fature.

Raporti Përmbledhës për Zbatimin e Kontratës është miratuar dhe nënshkruar nga Titullari i institucionit.

Me shkresë nr. 12402/2 Prot., datë 14.01.2025 AKM ka raportuar në APP mbi zbatimin e kontratës për prokurimin publik me REF-22960-10-07-2024, me objekt *"Blerje reagent dhe materiale laboratori*" , shoqëruar me "*Formularin e Raportimit për Zbatimin e Kontratës".*

Nga auditimi rezulton se:

Proces verbali-et nr. 10024/1 Prot., datë 05.02.2024 dhe nr. 10024/2 Prot., datë 24.12.2024 të marrjes në dorëzim të mallit, **nuk janë firmosur nga dorëzuesi i mallit**, **nuk përmbajnë të dhëna mbi datën e skadencës jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës, ose jo më pak se 1 vit nga data e lëvrimit të mallit**, kritere të pa përcaktuara në DST, veprim në kundërshtim me **DST, dhe** nenit 36.3.b te Ligjit 162/2020, i ndryshuar dhe nenit 2 të VKM 285/2021, i ndryshuar sipas të cilit specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike, ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit.

Akt Dorëzimi nga OE me date 05.12.2024 dhe Akt Dorëzimi nga OE me date 24.12.2024, të pranuara dhe të nënshkruara nga grupi i zbatimit të kontratës, nuk janë firmosur nga përfaqësuesi i OE, nuk kanë numër të protokollit hyrës në institucion, veprim në kundërshtim, në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit në fuqi për dokumentimin e veprimeve administrative dhe financiare, si dhe me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

4- **Tenderi me objekt me objekt "Shërbimi i riparimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve të instaluara në stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit urban**", **nr. REF-50227-06-04-2025, për subjektin "A. S", me NIPT L.....N .**

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Shërbimi i riparimit dhe mirëmbajtjes së stacioneve të monitorimit të cilësisë së ajrit urban"		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 7, Datë 30.05.2025		
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: *"Procedurë e hapur e **mbi kufirin** e lartë monetar "*	3. **Njësia e Prokurimit** Urdhër Nr. 7, dt.30.05.2025 A. Z (Kryetar) A. K (Anëtar); B. S (Anëtar);	4. **Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhër Nr. 8, datë 30.05.2025 E. O (Kryetar); A. A (Anëtar) D. Sh (Anëtar)
5. Fondi Limit (pa TVSH) **29,874,560** lekë	6.Oferta fituese "**A. S.**" shpk **29,627,900**lekë (pa TVSH)	7.Diferenca me fondin limit 246,600 lekë (pa TVSH).
8. Data e hapjes së tenderit: Dt. 04.06.2025 ora 11:00	9. Burimi Financimit Buxheti I shtetit	10. Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër 1 (një) OE b)Shkualifikuar 0 (zero) OE
11. Ankimime (jo)	12. Përgjigje Ankesës: (jo)	13. Përgjigje Ankesës (jo)
b. Zbatimi i Kontratës Riparim Shërbim		
14. Lidhja e kontratës: **nr. 7680 Prot., datë 18.07.2025**	15. Vlera e kontratës **35,553,480 lekë (me tvsh).**	16. Likuiduar deri dt. 31.12.2025, në shumën **29,609,880** lekë (me tvsh) Pa likuiduar **6,239,592** lekë (me tvsh)
17- Situacioni Përfundimtar (proces verbal pjesor)	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar =1 vit /365 ditë; **Statusi Në proces**	19. Zgjatja e kontratës (jo)

Planifikimi i nevojave për prokurim: AKM me shkresë nr. 8658 prot., datë 16.08.2024 ka dërguar në MTM projekt buxhetin afat mesëm PBA 2025-2027 faza teknike së bashku me relacion shoqërues bashkëlidhur tij.

Në relacion konstatohet se stacionet e monitorimit të ajrit janë në degradim, procedurat e prokurimit zgjasin në kohë për rrjedhojë mirëmbajtja e tyre kryhet në muajin maj-qershor, duke mos patur të dhëna të vazhdueshme të cilësisë së ajrit urban. Pajisjet janë të tilla që nëse nuk mirëmbahen në frekuencën dhe kohën e duhur nuk funksionojnë,

Mirëmbajtja pajisjeve të instaluara për vitin 2024 llogaritur për 10 stacioneve të monitorimit të ajrit është rreth 8,583,333 lekë (pa tvsh) dhe 10,300,000 lekë (me tvsh). Ndërkohë që pas testimit të tregut vlera është 25,000,000 lekë. Në relacion kërkohet që mirëmbajtja të realizohet për një periudhë 2 ose më shumë vjeçare duke siguruar mirëmbajtje të vazhdueshme për një eficencë të plotë të tyre

Në regjistrin e parashikimeve për vitin 2025 fondi limit për shpenzimet e prokurimit u parashikuan shpenzime për riparimin dhe mirëmbajtjen e aparateve te pajisjeve teknike (stacionet e monitorimit te ajrit) u parashikuan fonde në vlerën 30,000,000 lekë pa tvsh. Regjistri i parashikimit nuk ka pësuar ndryshime të mëvonshme nga ato të publikuara në regjistrin e parashikimeve dërguar në MFE me shkresë Nr. 690/1 23.01.2025 Prot., datë 24.01.2023, konform nenit 3, pika 4, e VKM nr. 285, datë 19.5.2021 me ndryshime. (për Degën e Thesarit Tiranë nuk u paraqit shkresë)

Nga auditimi rezulton se

AKM shkresë nr. 8658 Prot., datë 16.08.2024 ka dërguar në MTM projekt buxhetin afat mesëm PBA 2025-2027 **faza teknike** së bashku me relacion shoqërues bashkëlidhur tij. Në këto shkresa është cilësuar se mirëmbajtja pajisjeve të instaluara për vitin 2024 është rreth **8,583,333 lekë** (pa tvsh) dhe 10,300,000 lekë (me tvsh). Ndërkohë që **pas testimit të tregut vlera rezulton 25,000,000 lekë**. Në relacion kërkohet që mirëmbajtja të realizohet për një periudhë 2 ose më shumë vjeçare duke siguruar mirëmbajtje të vazhdueshme për një eficencë të plotë të tyre.

Ndërkohë në regjistrin e parashikimeve për vitin 2025 dërguar në MFE me shkresë nr. 690/1 23.01.2025 Prot., datë 24.01.2023, konform nenit 3, pika 4, e VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 me ndryshime. (për Degën e Thesarit Tiranë nuk u paraqit shkresë) fondi limit për shpenzimet për riparimin dhe mirëmbajtjen e aparateve te pajisjeve teknike në stacionet e monitorimit të ajrit, u parashikuan fonde në vlerën 30,000,000 lekë pa tvsh

Parashikimi i shpenzimeve me shtesë fondi **5,000,000 lekë** për riparim dhe mirëmbajtje, i regjistruar në planin e parashikimeve të fondit limit për riparimin dhe mirëmbajtjen e aparateve teknike (stacionet e monitorimit të ajrit), është llogaritur pa argumentim financiar. Ky veprim përbën **shkelje të nenit 35 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik"**, i cili kërkon që vlera e kontratës të përcaktohet mbi bazën e analizës së tregut dhe të mbështetet me argumentim të plotë dokumentar.

Ngritja e Komisioneve.

Grupi i verifikimit në terren për gjendjen e stacioneve të monitorimi të cilës së ajrit urban, ngritur me Program Pune nr. 13548 Prot., datë 23.12.2024.

I. H;

I. K;

B. P.

Komisioni të Testimit të Tregut dhe llogaritjes së fondit limit, i ngritur me Urdhër nr. 3, datë 08.01.2025 (vjetor), i përbërë nga:

M.P;

O. T;

K. M;

Grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe termat e referencës i ngritur me Urdhër nr. 05, datë 08.01.2025, Prot 124, data 08.01.2025 , i përbërë nga:

I. H, specialist, Sektori i Laboratorëve dhe Infrastrukturës Mjedisore, Drejtoria e kërkimit dhe Dijes Mjedisore në AKM;

K. T, specialist, Sektori i Informacionit, GIS dhe Regjistrave Mjedisorë,, Drejtoria e kërkimit dhe Dijes Mjedisore në AKM;

B. P, specialist, Sektori i Laboratorëve dhe Infrastrukturës Mjedisore, Drejtoria e kërkimit dhe Dijes Mjedisore në AKM;

Njësia e Prokurimit e ngritur me Urdhër Prokurimi Nr. 07/2025, Prot. 6149, datë 30.05.2025, të përbërë nga:

- A.Z (Kryetar), me detyrë përgjegjëse, Sektori Juridik dhe i Çështjeve Gjyqësore.
- A. K (Anëtar) me detyre përgjegjëse në Sektorin e Vlerësimit të Gjendjes në Mjedis,
- B. S (Anëtar), me detyre specialiste në Sektorin e Mostrimit dhe Shkarkimeve në Mjedis

Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO) ngritur ne Urdhër i Brendshëm Nr. 8/2025, me 6159 Prot., datë 30.05.2025, i ndryshuar me Urdhër nr. 12, datë 15.07.2025, i përbërë nga:

E. O (Kryetar) me detyrë specialiste laboratori, DMIA Laborator.

D. H (Anëtar) zëvendësohet me znj. A. A, me detyrë inspektore, Sektori Juridik dhe çështjeve ligjore

D. Sh (Anëtar), me detyrë specialist, Sektori i Analizave Laboratorike dhe Monitorimit të Kontratave.

Grupit të Punës për Zbatimin e Kontratës ngritur me Urdhër Nr. 09/2025, Prot. 6151, datë 30.05.2025, përbërë nga:

I. H (Kryetar); specialist, Sektori i Laboratorëve dhe Infrastrukturës Mjedisore, Drejtoria e kërkimit dhe Dijes Mjedisore në AKM;

S. P (Anëtar), specialist, Sektori i Laboratorëve dhe Infrastrukturës Mjedisore, Drejtoria e kërkimit dhe Dijes Mjedisore në AKM;

I. K (Anëtar) me detyre specialiste në Sektorin e Mostrimit dhe Analizave.

Vlerësimi gjendjes funksionale të pajisjeve sipas stacioneve te monitorimit të cilësisë së ajrit.

Grupi i verifikimit në terren për gjendjen e stacioneve të monitorimit të cilësisë së ajrit urban, ngritur me Urdhër nr. 13548 Prot., datë 23.12.2024, vlerësoi në terren statusin e funksionimit të

stacioneve të monitorimit, dhe pas ndezi të gjithë stacionet për të bërë vlerësimin e gjendjes aktuale të secilit stacion, konstatoi se një pjesë e madhe e moduleve që përbëjnë stacionet janë jashtë funksioni. Për këtë konstatim grupi i verifikimit ka mbajtur në terren 28 proces verbale konstatimi, shoqëruar me foto nga terreni, si më poshtë vijon:

PV datë 26.12.2024, me vendndodhje "Stacion Mobile", moduli SO2, me konstatimin pajisja nuk shfaq Error, pajisja është me Sampling, nuk funksionon kondicioni në tavanin e stacionit mobile dhe GC 955 tregon Error/ Ëarning.

PV datë (N/A), me vendndodhje "Stacion Mobile", moduli NO2, me konstatimin pajisja shfaq Error, pajisja nuk është me Sampling, Ozone Gen Off dhe pajisja tregon vetëm vlera negative;

PV datë (N/A), me vendndodhje "Stacion Mobile", moduli O3, me konstatimin se pajisja nuk shfaq Error, pajisja është me Sampling (pa problematik).

PV datë (N/A), me vendndodhje "Stacion Mobile", moduli CO , me konstatimin pajisja nuk shfaq Error, pajisja është me Sampling, pajisja tregon vetëm vlera negative;

PV datë 26.12.2024, me vendndodhje "Stacioni Higjiena", moduli SO2, me konstatimin pajisja nuk shfaq Error, pajisja është me Sampling, GC955 paraqet "System Alarm" dhe Pressure Too Loë;

PV datë 26.12.2024, me vendndodhje "Stacioni Higjiena", moduli O3, me konstatimin pajisja nuk shfaq Error, pajisja është me Sampling, (pa konstatim)

PV datë 26.12.2024, me vendndodhje "Stacion Higjena", moduli NOx, me konstatimin pajisja shfaq Error, pajisja është me Sampling , Ozone Gen Off, Sample FLoë Ëarning, Rcell pres Ëarning, Ozone Floë Ëarning.

PV datë 26.12.2024, me vendndodhje "Stacion Higjiena", moduli CO, me konstatimin pajisja nuk shfaq Error, pajisja është me Sampling, (pa konstatim)

PV datë 26.12.2024, me vendndodhje "Elbasan", moduli SO2, me konstatimin pajisja nuk shfaq Error, pajisja është me Sampling, çatia/ tavani e stacionit ka probleme, duket sikur ka pikuar brenda në stacion. GC 955 me problem.

PV datë 26.12.2024, me vendndodhje "Elbasan", moduli O3, me konstatimin pajisja nuk shfaq Error, pajisja është me Sampling, pajisja lexon vlera negative (-9 ; -30 PPB)

PV datë 26.12.2024, me vendndodhje "Elbasan", moduli NOx, me konstatimin pajisja nuk shfaq Error, pajisja është me Sampling, pajisja lexon vlera negative.

PV datë 26.12.2024, me vendndodhje "Elbasan", moduli CO, me konstatimin pajisja shfaq Error, pajisja është me Sampling, pajisja shfaq Source Ëarning!

PV datë 27.12.2024, me vendndodhje "Korçë", moduli SO2, me konstatimin pajisja nuk shfaq Error, pajisja është me Sampling, kompresori nuk funksionon, vlerat që shfaqen janë negative, Grim nuk ndizet, GC 955 nuk duket "Ok" nga cikli që tregon (nuk ka spiks).

PV datë 27.12.2024, me vendndodhje "Korçë", moduli O3, me konstatimin se pajisja nuk shfaq Error, pajisja është me Sampling, Photot Ref Ëarning, tregon që është në Sampling/ Mostrim por nuk jep vlera të matura .

PV datë 27.12.2024, me vendndodhje "Korçë", moduli NOx, me konstatimin pajisja shfaq Error, pajisja nuk është me Sampling, pajisja shfaq Error të vazhdueshëm, pajisja nuk është me Sampling, Ozone Gen Off.

PV datë 27.12.2024, me vendndodhje "Korçë", moduli CO, me konstatimin se pajisja nuk shfaq Error të vazhdueshëm, pajisja është me Sampling, Ozone Gen Off.

PV datë 30.12.2024, me vendndodhje "Stacioni Shkodër", moduli SO2, me konstatimin se pajisja shfaq Error të vazhdueshëm, pajisja është me Sampling, kondicioneri dhe pajisja janë "Ok", UPS e djegur, ekrani i GC i djegur dhe pajisja tregon Error. Moduli SO2 tregon Fault/Error, tregon Dark Cal Ëarning, Sample Flaë Ëarning, tregon vlera negative.

PV datë 30.12.2024, me vendndodhje “Stacioni Shkodër”, moduli O3, me konstatimin se pajisja shfaq Error, pajisja është me Sampling, Sample Flaë Ëarning, tregon Error/Fault.
PV datë 30.12.2024, me vendndodhje “Stacioni Shkodër”, moduli NOx, me konstatimin se pajisja shfaq Error, nuk është e pajisur me SAMPLING, tregon Error/Fault, Ozone Gen Off, tregon vlera negative, pajisja/ moduli nuk bën Sampling.
PV datë 30.12.2024, me vendndodhje “Stacioni Shkodër”, moduli CO, me konstatimin se pajisja shfaq Error, është e pajisur me SAMPLING, tregon Error/Fault.
PV datë 30.12.2024, me vendndodhje “Durrës”, moduli SO2, me konstatimin se pajisja shfaq Error, pajisja është me Sampling, bazamenti ku qëndron kompresori është mbushur me ujë dhe kompresori/ struktura kanë filluar të ndryshken. Nëse niveli i ujit do të rritet do të dëmtohet shumë kompresori. GC 955 tregon Error!, ekranin e ka të djegur.
PV datë 30.12.2024, me vendndodhje “Durrës”, moduli O3, me konstatimin se pajisja nuk shfaq Error, pajisja është me Sampling, Grimm Aerosol Teknik tregon Error!, kur u ndez tregon “Lift not ok”, kur bën self test, tregon “Air Pump Problem”, etj
PV datë 30.12.2024, me vendndodhje “Durrës”, moduli NO2, me konstatimin se pajisja shfaq Error, pajisja është me Sampling, Ozone Gen Off!, shfaq vlera negative
PV datë 30.12.2024, me vendndodhje “Durrës”, moduli CO, me konstatimin se pajisja nuk shfaq Error, pajisja është me Sampling, (pa problematik).
PV datë 31.12.2024, me vendndodhje “Fier”, moduli SO2, me konstatimin se pajisja nuk shfaq Error, pajisja është me Sampling, GC 955 tregon Error!, tubi i mostrimit është prishur (shkëputur), UPS me Fault.
PV datë 31.12.2024, me vendndodhje “Fier”, moduli O3, me konstatimin se pajisja shfaq Error, pajisja është pajisur me Sampling, modulit nuk i punon ekrani, nuk bëjnë ekstraktim të të dhënave duke qenë se moduli është me “touch”
PV datë 31.12.2024, me vendndodhje “Fier”, moduli NO, me konstatimin se pajisja nuk shfaq Error, pajisja është pajisur me Sampling, tregon Ozone Gen Off!.
PV datë 31.12.2024, me vendndodhje “Fier”, moduli CO, me konstatimin se pajisja nuk shfaq Error, pajisja është pajisur me Sampling, tregon Ozone Gen Off! (pa problematik).
Grupi i punës për vlerësimin në terren të gjendjes funksionale të pajisjeve të monitorimit të cilësisë së ajrit., me shkresë nr. 83, datë 07.01.2025 ka informuar Titullarin se nga verifikimi në terren prej tyre u konstatua së një pjesë e madhe e moduleve që përbëjnë stacionet e monitorimit janë jashtë funksioni.
Për të siguruar funksionim normal të pajisjeve të ajrit është e nevojshme mirëmbajtja dhe kalibrimi për të siguruar funksionalitet të plotë të tyre.
Me shkresë nr. 83/1 prot., datë 08.01.2025 znj. A. Z, përgjegjëse e Sektorit Juridik kërkon ngritjen e grupit te punës për hartimin e specifikimeve teknike, më specialistë të fushës, ku të përcaktohen qartë karakteristikat emalit dhe/ose shërbimit që do të prokurohet. Testimi i tregut dhe përllogaritja e fondit limit do të realizohet nga Komisioni përkatës, i ngritur për testimin e tregut.
Llogaritja e Fondit Limit:
Titullari me Urdhër nr. 3, datë 08.01.2025 ka urdhëruar ngritjen e Komisioni të Testimit të Tregut dhe llogaritjes së fondit limit.
Komisioni të Testimit të Tregut dhe llogaritjes së fondit limit ka mbajtur PV nr. 82/3 prot., datë 29.05.2025 për testimin e tregut dhe llogaritjen e fondit limit.
Komisioni të Testimit të Tregut dhe llogaritjes së fondit limit ka nënshkruar “*Deklaratën e Konfliktit të Interesit*”, në datë 29.05.2025.

Komisioni për studimin e tregut dhe llogaritjen e fondit limit ka kryer analizën e tregut duke iu drejtuar tre operatorëve ekonomikë të përzgjedhur në treg, përmes kërkesave të dërguara me email dhe përgjigjeve të marra po nëpërmjet email-it.
Komisioni të Testimit të Tregut në llogaritjen e fondit limit, u bazua në çmimet e blerjes (pa tvsh) sipas ofertave te paraqitura me çmim blerje për njësi (pa tvsh) nga subjekti "K" ne vlerë 15,631,900 lekë; "A" në vlerë 15,853,400 lekë dhe "G. G" në vlerë 15,960,300 lekë.
Komisioni, bazuar në çmimin mesatar për njësi të ofertave të paraqitura dhe në sasinë për t'u prokuruar, llogariti fondin limit 29,874,560 lekë (pa tvsh), më të dhënat si më poshtë vijon:
Të dhënat për studimin e tregut dhe llogaritja e fondit limit:

Nr.	Emërtimi	Sasia	Çmimi i blerjes pa tvsh[3]			**Vlera totale (pa tvsh) bazuar ne çmimin mestar**
			A.S	G. G	K.	
1	Shërbimi i mirëmbajtjes së pajisjeve të instaluara në stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit urban .	1	15,853,400	15,960,300	15,631,900	**29,874,560**

Nga auditimi rezulton se

Komisioni të Testimit të Tregut dhe llogaritjes së fondit limit ka mbajtur **PV nr. 83/2 prot., datë 29.05.2025** për testimin e tregut dhe llogaritjen e fondit limit.ka përllogaritur fondin limit mbi bazën e çmimit mesatar për artikull të tre (3) ofertave të paraqitura nga tre (3) operatorë ekonomikë. **Studimi i tregut** është bazuar në ofertat e paraqitura nga shoqëria "A. S" në vlerë 15,853,400 lekë, "G. G" në vlerë 15,960,300 lekë dhe "K" në vlerë 15,631,900 lekë**. Fondi limit** u llogarit në vlerën **29,874,560 lekë** (pa TVSH). Nga auditimi rezulton se përllogaritja e vlerës së fondit limit **nuk përputhet** me rezultatet e testimit të tregut sipas ofertave të paraqitura, si dhe **nuk është dokumentuar dhe argumentuar në mënyrë të plotë, pasi numri i moduleve dhe shërbimet e përcaktuara për to nuk janë në përputhje me studimin e tregut**. Ky veprim është në kundërshtim me përcaktimet e nenit 76 të VKM nr. 285/2021 "*Për rregullat e prokurimit publik*", i ndryshuar.
Komisioni i Testimit të Tregut dhe i llogaritjes së fondit limit, në përcaktimin e vlerës së kontratës, **ka detyrimin të marrë në analizë alternativat** e parashikuara në nenin 34, pika 11 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si: çmimet e publikuara nga INSTAT, çmimet referencë të Doganës, çmimet e evidentuara në sistemin e fiskalizimit, në përputhje me natyrën e kontratës dhe të dhënat e 6 muajve të fundit. Në rast se këto burime nuk ekzistojnë, autoriteti kontraktor duhet të mbështetet në **studimin e tregut përmes sistemeve elektronike**, ku operatorët ekonomikë i përgjigjen kërkesës së tij në sistem. Gjithashtu, autoriteti kontraktor mund të përdorë **çmimet e kontratave të mëparshme** të realizuara nga vetë institucioni ose nga ente të tjera kontraktore, duke u bazuar në të dhënat e sistemit të menaxhimit të kontratave të administruar nga **SPE**.

Titullari me Urdhër nr. 05, datë 08.01.2025, protokolluar me nr. 124, datë 08.01.2025 ka urdhëruar ngritjen e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe termat e referencës.
Grupi punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe termat e referencës ka nënshkruar "*Deklaratën e Konfliktit të Interesit*", në datë 22.01.2025 në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
Grupi punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe termat e referencës ka mbajtur Proces Verbal nr. 124/1 prot., datë 22.01.2025, me objekt "*Specifikimet teknike dhe termave të referencës në procedurën e prokurimit shërbimi i riparimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve te instaluara ...*" . (DST, shtojca 5)

[33] Çmimi i blerjes (pa tvsh) është llogaritur për 1(një artikull)

Në PV përcakton se për hartimi e specifikimeve teknike është bazuar në manualet e përdorimit të pajisjeve të cilësisë së ajrit urban. Mirëmbajtja e tyre do të kryhet sipas grafikut të shërbimit, me përjashtim të pajisjeve që kërkojnë dërgimin e modulit jashtë vendit.
Shërbimet që do të kryhen janë listuar sipas Moduleve që do të riparohen, duke përcaktuar Modulin (me të dhëna teknike), llojin e shërbimit të mirëmbajtës (pastrim, ndërrim., riparim dhe frekuencën vjetore të shërbimit (raste).
Proces verbali është nënshkruar nga anëtarët e komisionit.
Nga auditimi u konstatua se:

1. Në Procesverbalin nr. 124/1 prot., datë 22.01.2025, si dhe në DST, shtojca 5, në kuadër të hartimit të specifikimeve teknike, Komisioni për Hartimin e Specifikimeve Teknike nuk ka përcaktuar numrin e moduleve për të cilat do të ofrohet shërbimi, si dhe argumentimi i specifikimeve teknike për secilin prej tyre, në kundërshtim me kërkesat e nenit 78, pika 1 dhe 2, të VKM nr. 285/2021 sipas të cilave në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre
2. Komisioni për Hartimin e Specifikimeve Teknike në hartimin e specifikimeve teknike referon se është bazuar në manualet e përdorimit të pajisjeve të cilësisë së ajrit urban. Grupi i auditimit konstaton se në PV nr.124/1 prot., datë 22.01.2024 hartuar nga Komisioni Hartimit të Specifikimeve Teknike mungon referenca e Manualit mbi të cilin vlerësohet frekuenca e shërbimit dhe riparimit të pajisjes, veprim në kundërshtim me nenin 36, pika b) dhe/ose c) të Ligjit nr. 162/2020 'Për Prokurimin Publik', i ndryshuar, b) sipas të cilit specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve; dhe /ose c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale

Titullari me Urdhër Prokurimi nr. 7 datë 30.05.2025 ka urdhëruar të prokurohet fondi prej 29,874,560 lekë (pa tvsh), të përdoret procedura e prokurimit elektronik "Procedurë e hapur - shërbime" për shërbimin për prokurimin publik me objekt "*Shërbimi i riparimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve të instaluara në stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit urban*.", ngritjen e Njësisë së Prokurimit për zbatimin e këtij urdhri dhe caktimin znj. A. Z, personit përgjegjës për procedurën e prokurimit. Njësia e prokurimit, ka nënshkruar deklaratën e konfliktit të interesit datë 04.06.2024.
Njësia e Prokurimit ka mbajtur proces verbalin nr. 6149/1 prot., datë 04.06.2025, ku ka përcaktuar kriteret për kualifikim, në procedurën e prokurimit me fond limit 29,874,560 lekë (pa tvsh) ose 304.252 euro (pa tvsh), llojin e procedurës, kriteret për kualifikim. Proces verbali nr. 6149/1 prot., datë 04.06.2025 është firmosur nga gjithë anëtarët e Njësisë Prokurimit.
Në PV nr. 6149/1 prot., datë 04.06.2025, Njësia e Prokurimit ka argumentuar se procedura e prokurimit "E hapur mbi kufirin e lartë monetar", për shërbimin e riparim –shërbimit të pajisjeve të monitorimit të cilësisë së ajrit, të mos kryhet e ndarë në lote, nisur nga natyra e shërbimit që do të kryhet, si dhe n duke vlerësuar që proceset, pjesët e shërbimit objekt prokurimi, janë të ndërlidhura dhe ndërvarura me njëra tjetrën, Ndarja në lote rrit fragmentim e përgjegjësive dhe rreziqet për mosfunksionim të pajisjeve.

AK ka plotësuar njoftimin e shkurtuar të kontratës, i cili është publikuar Buletinin e APP nr.29, date 9 Qershor 2025, ku është publikuar fondi limit 29,874,560 lekë pa tvsh ose 304,252 euro (PA TVSH). Kohëzgjatja 1(një vit) kalendarik nga nënshkrimi i kontratës. Afati i fundit për hapjen e ofertave datë 07.07.2025, ora 11:00,

Personi përgjegjës znj. A. Z, me shkrese nr. 83/4 prot., datë 18.06.2025, me lëndë "*Mbi pezullimin e procedurës së prokurimit -shërbimi i riparimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve të instaluara në stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit urban*" ka njoftuar Titullarin, për pezullimin e procedurës së prokurimit, me qëllim kryerjen e veprimeve përkatëse në SPE, duke u mbështetur në rekomandimet e APP (Koordinimi) sipas email datë 16.06.2025, i cili ka sugjeruar saktësime dhe sqarime në lidhje me kriteret e veçanta të kualifikimit. Për kryerjen e procesit është i nevojshëm pezullimi i procedurës në SPE për të ngarkuar dokumentin e ri, duke propozuar njëkohësisht edhe shtyrje të afatit për paraqitjen e ofertave.

Në vijim të informacionit, Titullari me Urdhër Pezullimi nr. 116 prot., datë 18.06.2025, protokolluar me nr. 6651 prot., datë 18.06.2025 ka urdhëruar:

Pezullimin e procedurës së prokurimit me objekt "*Shërbimi i riparimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve të instaluara në stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit urban*";

Të përgatiten aktet me argumentimin përkatës për saktësimet dhe ndryshimet e nevojshme në lidhje me kriteret e veçanta të kualifikimit të vendosura në DST dhe të publikohen sipas rregullave të prokurimit publik.

Të bëhet shtyrja e afatit për paraqitjen e ofertave dhe zhvillimin e procedurës në zbatim të parimeve të prokurimit publik për trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE, si dhe transparencë.

Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Nj.P

Pasi të jenë kryer veprimet në SPE për ngarkimin e akteve dhe shtyrjen e datës për paraqitjen e ofertave dhe zhvillimin e procedurës, procedura do të ndiqet nga personi përgjegjës për procedurën e prokurimit znj. A. Z.

Njësia e Prokurimit në zbatim të Urdhrit të Pezullimit, ka mbajtur PV nr. 6651/1 prot., datë 19.05.2025 "*Për saktësime dhe sqarime në lidhje me kriteret e veçanta të kualifikimit të vendosura në DST për procedurën e prokurimit me objekt "Shërbimi i riparimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve të instaluara në stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit urban*", bazuar dhe ne rekomandimin e APP dërguar me email date 16.6.2025. APP sugjeron se në hartimin e DST të procedurës ë prokurimit të shpallur, AK duhet t'i referohet dokumenteve të reja standarde të miratuara me ndryshimet e fundit në datë 23.09.2024 (të publikuara në faqen zyrtare të

AK ka plotësuar dokumentin standard "Njoftimin e ndryshimin e dokumenteve te tenderit", me argumente dhe referencë ligjore për nevojën e ndryshimeve, duke saktësuar/ riformuluar kriteret, me qellim shmangien e problematikave që mund të krijohen në plotësimin e kriterit nga OE ofertues që mbarten edhe ne procesin e vlerësimit nga KVO, të cilat ju vihen në dispozicion OE në DST të publikuara në SPE, bashkëlidhur njoftimi.

Afati i ri për paraqitjen e ofertave do të jetë data 10.07.2025 ora 12:00, publikuar në SPE (bashkëlidhur Shtojca për ndryshimin e DST "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit").

AK në këtë shtojce paraqet me shkrim si ishin dhe si bëhen kriteret e ndryshuara, duke argumentuar dhe referuar në dispozita ligjore, mbështetur në përcaktimet e nenit 75 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe me asistencën e APP dërguar me email datë 16.06.2025, AK ka bërë saktësim/ riformulim përmes hartimit të "*Shtojca për ndryshimin e dokumenteve të tenderit "Kriteret e veçanta të kualifikimit*", si më poshtë vijon:

Kriteri 1: AK ka kërkuar Ofertuesi të paraqesë:

1. Sigurimi i ofertës sipas shtojcës 3.
2. Formularin përmbledhës të vete deklarimit, sipas shtojcës 10

APP arsyeton: Në hartimin e DST të procedurës të prokurimit të shpallur, AK duhet t'i referohet dokumenteve të reja standarde të miratuara me ndryshimet e fundit në datë 23.09.2024 (të publikuara në faqen zyrtare të APP).
APP sugjeron të shmanget kërkesa për paraqitjen e deklaratave të mësipërme, duke përcaktuar në këtë kërkesë vetëm paraqitjen e Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, dhe Sigurimin e Ofertës, sipas shtojcave përkatëse.
NjP: Pranon rekomandimin e APP-së dhe ndryshon kriterin.
Kriteri 2.2
Ishte:
"Vërtetim, lëshuar nga administratat tatimore, për xhiron vjetore minimale të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022, 2023,2024), të aktivitetit të operatorit, në një vlerë të paktën sa 20% e vlerës së fondit limit. Kushti konsiderohet i përmbushur nëse OE arrin vlerën e xhiros minimale, edhe në të paktën një vit të periudhës së kërkuar në të paktën 20% e vlerës së fondit limit.
Kërkesat duhet te përmbushen nga gjithë bashkimi, në përputhje përqindjen dhe /ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje".
Kopje të vërtetuara të bilanceve të viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse. Në rast se OE është ne kushtet e përcaktimeve te nenit 41, të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga audites ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit. Kërkesat duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe /ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim.
Bëhet:
"Vërtetim, lëshuar nga administratat tatimore, për xhiron vjetore minimale të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022, 2023,2024, të aktivitetit të operatorit, në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit. Operatorët ekonomik mund të paraqesin vlera edhe më të mëdha se vlera minimale kufi. Kushti konsiderohet i përmbushur nëse OE arrin vlerën e xhiros minimale, edhe në të paktën një vit të periudhës së kërkuar në të paktën 20% e vlerës së fondit limit. Kërkesat duhet te përmbushen nga gjithë bashkimi, në përputhje përqindjen dhe /ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje".
Argumentimi nga NJP: Në hartimin kriterit për xhiron vjetore AK i përmbahet kuptimit të përcaktimeve të pikës 2/a, të nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar. Në kuptimin e dispozitës së mësipërme, ku përcaktohen vlerat kufi që AK mund të përcaktojë në kriter, OE mund të paraqesin vlera edhe më të mëdha se vlera kufi minimal.
APP arsyeton:
Në hartimin e kriterit për xhiron vjetore, AK duhet t'í përmbahet kuptimit të përcaktimeve të pikës 2/b të nenit 43 të VKM nr. 285/2021, i ndryshuar, ku përcaktohet se vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar. Në kuptim të dispozitës së sipërcituar, ku përcaktohen vlerat kufi që AK mund të përcaktojë në kriter, OE mund të paraqesin vlera edhe më të mëdha se vlera kufi minimale.
APP sugjeron:
- AK të përcaktojë që ofertuesit duhet të kenë realizuar xhiro vjetore në një vlerë jo më të vogël se ...., por pa tejkaluar vlerën maksimale të përcaktuar në dispozitën e sipërcituar.

- Kërkesat për kualifikim ekonomik, financiar, profesional dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi i OE, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrës së pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në Aktmarrëveshje

NjP: Pranon pjesërisht rekomandimin e APP-së dhe ndryshon kriterin.

Grupi i auditimit arsyeton se:

Njësia e Prokurimit argumenton se në hartimin e kriterit për përvojën e ngjashme, i përmbahet kuptimit të përcaktimeve pikës **2/b të nenit 43** të VKM nr. 285/2021, sipas të cilit "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë **nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit**, në procedurat e prokurimit **mbi kufirin e lartë monetar".** *Në kuptim të dispozitës së sipërcituar, ofertuesi/it* ***gëzojnë të drejtën*** **të paraqesin vlera edhe më të mëdha se vlera kufi minimale, por pa tejkaluar vlerën maksimale** të përcaktuar në dispozitën e sipërcituar. Për sa më sipër përcaktimi i kriterit specifik për xhiron minimale vjetore është në mospërputhje me pikën 2.b të nenit 43 të VKM nr. 285/2021, i ndryshuar**.**

Kriteri 2.3

Ishte:

Operatori ekonomik duhet të disponojë numrin e nevojshëm të punonjësve për ekzekutimin e kontratës dhe për të provuar këtë kusht duhet të ketë një punësim mesatar për periudhën prill 2024-prill 2025, me të paktën 5 (pesë) punonjës, duke përfshirë stafin kryesor, të provuar me:

Vërtetim të lëshuar nga Dega e Tatimeve të Qarkut ose Drejtoria rajonale e Sigurimeve Shoqërore të qarkut përkatës, ose

Listëpagesat për periudhën e mësipërme (E-Sig 025), sipas formatit elektronik në përputhje me "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera, vetëm nëpërmjet formës elektronike", i ndryshuar.

Bëhet:

Operatori ekonomik duhet të disponojë numrin e nevojshëm të punonjësve për ekzekutimin e kontratës dhe për të provuar këtë kusht duhet të ketë një punësim mesatar për periudhën Maj 2024-Maj 2025, me të paktën 5 (pesë) punonjës, duke përfshirë stafin kryesor, të provuar me:

Vërtetim të lëshuar nga Dega e Tatimeve të Qarkut ose Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore të qarkut përkatës, ose

Listëpagesat për periudhën e mësipërme (E-Sig 025), sipas formatit elektronik në përputhje me "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera, vetëm nëpërmjet formës elektronike", i ndryshuar.

Argumentimi AK: Në lidhje me periudhën e kërkuar Maj 2024-Maj 2025, me qëllim që periudha e nevojshme, e përcaktuar për listëpagesë, të jetë sa më koherente me datën e zhvillimit të tenderit, do të përfshihet në listëpagesën e muajit të fundit, të cilat OE mund t'i disponojë, duke patur parasysh edhe përcaktimet e nenit 11, germa a) të ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH", ku parashikohet se pagesat e kontributeve bëhen: "Nga personat juridikë, përjashtuar personat juridikë të regjistruar si tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, brenda datës 20 të muajit pasardhës. Kur pronarët e personave juridikë ushtrojnë funksione drejtuese në shoqëri si administratorë ose çdo funksion tjetër trajtohen si çdo punëmarrës tjetër".

APP sqaron se: në lidhje me periudhën e kërkuar të listë pagesave Prill 2024-Prill 2025, sugjerojmë që përudha e nevojshme e përcaktuar në listëpagesa, të jetë sa më koherente me datën e zhvillimit të tenderit, duke përfshirë listëpagesën e muajit të fundit, të cilat OE mund t' i disponojë, duka patur parasysh edhe përcaktimet e nenit 11, germa a) të ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH", ku parashikohet se pagesat e kontributeve bëhen: "Nga personat juridikë,

përjashtuar personat juridikë të regjistruar si tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, brenda datës 20 të muajit pasardhës. Kur pronarët e personave juridikë ushtrojnë funksione drejtuese në shoqëri si administratorë ose çdo funksion tjetër trajtohen si çdo punëmarrës tjetër".

NjP: Pranon pjesërisht rekomandimin e APP-së dhe ndryshon kriterin.

Grupi i auditimit arsyeton se:

Nga analiza e afatit ligjor për deklarimin e listëpagesave të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, rezulton se kontributet **për <u>muajin prill 2024</u>** duhen deklaruar dhe paguar brenda datës 20 të muajit pasardhës, pra deri më 20 maj 2024, ose para datës së hapjes se procedurës së prokurimit në SPE. Në këtë mënyrë, ligjërisht Operatorët Ekonomikë duhet të kenë kryer deklarimin dhe pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me nenin 11, germa a), të ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë". Në këtë kontekst, **mos përfshirja e listëpagesave** të sigurimeve shoqërore të muajit prill 2024 **përbën veprim të pajustifikuar dhe në kundërshtim me pika 2 neni 41 të VKM** nr. 285/2021, i ndryshuar, sipas të cilës kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor duhet të jenë të **argumentuara dhe të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës**

Përveç ndryshimeve sipas rekomandimeve të APP-së, grupi i punës për argumentimin e kritereve për kualifikim, në kriterin 7.2 të PV nr. 6149/1 prot., datë 04.06.2025 dhe DST ka përcaktuar se për të garantuar se zotëron burimet e nevojshme njerëzore dhe teknike për realizimin e kontratës OE duhet të këtë në stafin e tij:1(një) inxhinier elektronik/informatikë/telekomunikacion; 1 (një) kimist ose inxhinier mjedisi. Preferohen që 2(dy) inxhinierë të jenë të certifikuar/ trajnuar për shërbimin e pajisjeve objekt prokurimi ose të ngjashme, të vërtetuar nëpërmjet certifikatës së trajnimit të lëshuara nga kompani prodhuese të stacioneve të monitorimit apo moduleve përbërës të tyre ose organizatave apo institucioneve të akredituara për trajnime për shërbimet e pajisjeve të ngjashme; Kërkesat për personelin duhet të vërtetohen me paraqitjen e dokumenteve përkatës si: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së realizmit të kontratës; Diploma përkatëse për specialistët ose diplomë e huaj e njësuar nga ministria përgjegjëse për arsimimin; Certifikatë/ ta trajnimi për shërbimin e pajisjeve objekt prokurimi, të lëshuara nga kompani prodhuese të stacioneve të monitorimit apo moduleve përbërës të tyre, sipas rastit.

Nga auditimi rezultoi se:

Në Procesverbalin **nr. 6149/1 Prot., datë 04.06.2025**, "Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta për kualifikim", si dhe në Dokumentet Standarde të Tenderit (DST), lidhur me kriteret e veçanta për provimin e deponimit të burimeve të nevojshme njerëzore dhe teknike për realizimin e procedurës së prokurimit, **Njësia e Prokurimit ka përcaktua**r se operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) inxhinier elektronik dhe/ose informatikë dhe/ose telekomunikacioni, si dhe 1 (një) kimist ose inxhinier mjedisi, duke kërkuar paraqitjen e kontratave të punës, diplomave përkatëse, si dhe certifikatave apo trajnimeve të lëshuara nga prodhuesit e pajisjeve objekt prokurimi.

Grupi i auditimit vlerëson se kërkesa për disponimin e burimeve njerëzore, duke e cilësuar si të detyrueshme zotërimin nga operatori ekonomik të profileve profesionale të sipërcituara, nuk është në përputhje **me pikën 4 të nenit 41 të VKM nr. 285/2021**, të ndryshuar. Sipas këtij përcaktimi, për kontratat e shërbimeve, autoriteti/enti kontraktor, në kuadër të vlerësimit të kapaciteteve teknike dhe profesionale për ushtrimin e veprimtarisë, **duhet të referohet në kriteret e licencimit profesional të nevojshme për realizimin e shërbimeve** objekt kontrate, të lëshuara nga autoritetet shtetërore kompetente, dhe/ose në paraqitjen e një liste të personelit kryesor të domosdoshëm për zbatimin e objektit të prokurimit, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore

në fuqi. Më tej mbetet në përgjegjësinë e tij për të vlerësuar nëse profili profesional i deklaruar nga OE përputhet plotësisht me natyrën e **shërbimit** objekt kontrate

Gjatë procedurës së prokurimit, para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave, nëpërmjet SPE, në datën 02.07.2025, subjekti "A. S", me NIPT L.....N ka kërkuar sqarime lidhur me DST të publikuara nga AK , bazuar në pikën 1 të nenit 75 të ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik", protokolluar në AKM me nr. 7105 prot., datë 02.07.2025. Kërkesa është dorëzuar jo më vonë se 6 ditë para afatit ligjor përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Subjekti kërkon: 1- Sa është numri i moduleve /sistemeve të transmetimit të të dhënave, kabinave, pajisjeve të monitorimit, sensorëve meteorologjikë tek operatori ekonomik i interesuare. 2- Sa shpesh dhe për cilat module aplikohet shërbimi i cituar në DST. Kërkesa është brenda afati ligjor "jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave" përkatësisht datës 10.07.20025.

Personi përgjegjës për prokurimin, nëpërmjet shkresës nr. 7105/1 prot., datë 02.07.2025 ka njoftuar Titullarin për kërkesën e subjektit, ka kërkuar dërgimin e saj tek grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike, për saktësimet dhe ndryshimet e nevojshme lidhur me specifikimet teknike të vendosura në DST, dhe publikimin sipas rregullave të PP. Lidhur me kërkesën kërkohet miratimi i Urdhrit të Pezullimit me qëllim kryerjen e veprimeve në SPE.
Titullari, me Urdhër 126, datë 03.07.2025, protokolluar me nr. 7134 prot., datë 03.07.2025, ka urdhëruar të Pezullohet në sistem elektronik procedura e prokurimit, të dërgohet për trajtim të grupi i punës, për hartimin e specifikimeve teknike dhe të përgatiten aktet me argumentim përkatës për saktësimet dhe ndryshimet e nevojshme në lidhje me "Specifikimet teknike" të vendosura në DST dhe të publikohen sipas rregullave të prokurimit publik.
Ne vijim, me shkresë nr. 7134/1 prot., datë 03.07.2025 nga grupi i specifikimeve teknike i ngritur me Urdhër nr. 05, datë 08.01.2025, Prot 124, data 08.01.2025, ka hartuar tabelën me të dhëna specifike, për modulin, përshkrimin e shërbimit; numrin e moduleve për të cilat duhet shërbimi, dhe frekuencën e shërbimeve.
Nga auditimi u konstatua se

1. Shkresa me nr. 7134/1 prot., datë 03.07.2025, me objekt sqarime mbi procedurën e prokurimit për shërbimin e riparimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve të instaluara në stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit, nuk është firmosur nga grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike, i ngritur me Urdhrin e Titullarit nr. 05, datë 08.01.2025, i përbërë nga I. H, K. T dhe B. P. Konceptimi dhe nënshkrimi i kësaj shkrese vetëm nga një anëtare e grupit, konkretisht znj. I. H, është në kundërshtim me Urdhrin e Titullarit nr. 05, datë 08.01.2025, me të cilin është përcaktuar përbërja e Grupit të Punës me përbërje I. H, K. T dhe B. P.
2. Në shkresën nr. 7134/1 prot., datë 03.07.2025, si pasojë e kërkesës për sqarim të paraqitur nga OE "A. S", regjistruar në AKM me nr. 7105 prot., datë 02.07.2025, është shtuar numri i moduleve për të cilat duhet shërbimi, element i papërcaktuar në specifikimet teknike për të cilat është mbajtur Procesverbali nr. 6149/1 prot., datë 04.06.2025. Në këtë akt mungon argumentimi përkatës për saktësimet dhe ndryshimet e bëra në lidhje me "Specifikimet teknike" të vendosura në DST, në kundërshtim me Urdhrin nr. 126, datë 03.07.2025, protokolluar me nr. 7134 prot., datë 03.07.2025, si dhe me dokumentacionin e procedurave të prokurimit, sipas kërkesave të nenit 36 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.
3. Shkresa nuk përmban subjektin të cilit i drejtohet, veprim në kundërshtim me kërkesat për formën dhe përmbajtjen e akteve administrative, sipas ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", i cili parashikon se akti administrativ duhet të përcaktojë qartë palës që i drejtohet.

Vlerësimi i Ofertave:
Titullari më Urdhër i Brendshëm Nr. 8/2025, me 6150 prot., datë 30.05.2025 ka urdhëruar krijimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO) referuar nenit 75, VKM Nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, i ndryshuar me Urdhër nr. 12, datë 15.07.2025 duke zëvendësuar anëtarit të KVO z. D. H, me znj. A. A, kërkuar me email datë 14.07.2025 nga kryetarja e KVO-së e cila ka konstatuar anëtari i komisionit z. D. H, nuk ka realizuar hapjen e procedurës së prokurimit në SPE. Për shkak të mos prezencës së anëtarit të KVO z. D. H, titullari me Urdhër nr. 12, datë 15.07.2025 zëvendëson z. D. H me znj. A. A.
Në datën 15.07.2025 anëtarët e KVO kanë nënshkruar deklaratën e konfliktit të interesit.
KVO ka konstatuar në SPE është paraqitur vetëm një ofertë nga OE "A. S".
Nga shqyrtimi i dokumentacionin tekniko-ligjor-financiar KVO ka vlerësuar se kandidati ofertues, plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në DST-it dhe oferta kualifikohet e vlefshme. KVO bazuar në pikën 2 të nenit 96 të ligjit nr. 162/2020 "për prokurimin publik", i ndryshuar, argumenton se periudha e pritjes nuk zbatohet, pasi në sistem rezultoi vetëm një ofertë e paraqitur, e cila konsiderohet e vlefshme. Në përfundim të procesit të vlerësimit të dokumentacionit, KVO konstatoi se oferta ekonomike që plotëson të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe DST, dokumentacionin e kërkuar në kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të DST, është oferta e vetme e operatorit "A. S", e kualifikuar si fitues me vlerë 29,627,900 lekë (pa tvsh) ose 35,553,480 lekë (me tvsh). Oferta nuk rezulton anomalisht e ulët dhe dorëzuar sipas kërkesave dhe specifikimeve të përcaktuara në DST.
KVO ka mbyllur procesin paraprak të vlerësimit dhe i propozon titullarit miratimin e "Formularit të Njoftimit të Fituesit (paraprak)"sipas Shtojcës 13 të DST, publikuar në SPE. Në këtë fazë ofertuesi nëpërmjet SPE duhet të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 10. Në përfundim KVO konfirmon se është dakord me zhvillimin e procedurës. Të gjithë anëtarët e KVO kanë nënshkruar proces verbalin nr. 7400/1 prot., datë 17.07.2025. KVO mbyll vlerësimin në SPE dhe shpall fitues OE "A. S". i kualifikuar si fitues, i cili me shkresë nr. 15, datë 17.07.2025 dorëzoi dokumentacionin ligjor dhe teknik, ne protokoll arkivin e AKM-së, protokolluar me shkresën me nr. 7590 Prot., datë 17.07.2023.
KVO ka mbajtur Proces verbalin e vlerësimit të ofertave" nr. 7460/1 prot., datë 17.07.2025., për dokumentacionin e dorëzuar në zyrën e protokoll arkivës së AKM-së, duke vlerësuar përputhshmërinë me dokumentacionin e dorëzuar në SPE, dhe vlerësuar përfundimisht se OE plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe te veçanta në DST, dhe oferta kualifikohet e vlefshme.
Në datën 18.07.2025 KVO ka hartuar Raportin Përmbledhës nr. 7460/2 Prot., datë 18.07.2025, miratuar nga Titullari. Gjate procesit të vlerësimit të përputhshmërisë së dokumentacionit të dorëzuar në SPE dhe dokumentacionit fizik, KVO nuk u konstatuan mospërputhje. Për këto arsye KVO, mbyll procesin e vlerësimit dhe propozon t'i dërgohet OE fitues njoftimin për lidhjen e Kontratës, referuar Udhëzimit nr. 1, datë 03.06.2025 "Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike"
AK nëpërmjet SPE ka dërguar në datën 17.07.2025 Shtojën 13 "Formulari i njoftimit të fituesit, në përfundim te afateve te ankimit", Botuar në Buletin nr.37, datë 21.07.2025, me anë të këtij formulari OE njoftohet se oferta e paraqitur nga "A. S". me vlerë të përgjithshme 29,627,900 lekë pa tvsh, është kualifikuar si oferta e fituese., për të cilën OE njoftohet nëpërmjet SPE të paraqesë sigurimin e kontratës, si parashikohet në DST, brenda 2 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të njoftimit të fituesit.

OE ka paraqitur Sigurimin e Kontratës “Formular Sigurimi Kontrate” ne protokollin e AMK me nr. 3172/1, date 27.04.2023, për procedurën e prokurimit me Ref-50227-06-04-2025, date 18.07.2025, në shumën 3,555,348 lekë nga shoqëria “A” e cila merr përsipër të transferojë në llogarinë e AKM vlerën e siguruar brenda 15 ditës nga kërkesa me shkrim.
Nga auditimi rezulton se:
KVO ka mbajtur Proces verbalin e vlerësimit të ofertave” nr. 7460/1 prot., datë 17.07.2025 për dokumentacionin e dorëzuar në zyrën e protokoll arkivës së AKM-së, duke vlerësuar përputhshmërinë me dokumentacionin e dorëzuar në SPE, dhe vlerësuar përfundimisht se OE plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta në DST, dhe oferta kualifikohet e vlefshme.
Grupi i auditimit arsyeton se:
1. Në DST është përcaktuar se OE duhet të paraqesë kopje të vërtetuara të bilanceve të viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse.

Nga verifikimi dokumentacionit të paraqitur rezulton se OE ka paraqitur vërtetim nga DRTT, nr. T13616762, datë 04.07.2025, në te cilin, në bazë të të dhënave të situatës financiare ka paraqitur të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve për vitet 2022 në vlerën 6,808,196 lekë, për vitin 2023 në vlerë 7,962,732 lekë dhe për vitin 2023 në vlerë 9,888,757 lekë.
Me shkresën nr. 13360 prot., datë 01.07.2025 Dr. Rajonale Tatimore Tirane, në përgjigje të shkresës së OE “A.S” me nr. E0001442833, datë 27.06.2025 ka vënë në dispozicion të OE kopje të pasqyrave financiare të depozituara në sistemim tatimor si më poshtë:
PF të vitit 2022 dorëzuar elektronikisht pranë DRTT datë 27.06.2025;
PF të vitit 2023 dorëzuar elektronikisht pranë DRTT datë 27.06.2025;
PF të vitit 2024 dorëzuar elektronikisht pranë DRTT datë 27.06.2025;
Gjithashtu, OE ka paraqitur “Ekstraktin Historik të Regjistrit Tregtar” për të dhënat e subjektit “A.S”, të printuar nga sistemi më datë 04.07.2025. Në këtë dokument konstatohet mungesa e depozitimit të Pasqyrave të Pozicionit Financiar për vitet 2022, 2023 dhe 2024, në kundërshtim me kërkesat e DST-së, sipas të cilave OE duhet të paraqesë kopje të vërtetuara të bilanceve të viteve të fundit (2022, 2023, 2024), të depozituara pranë autoriteteve përkatëse, ku përveç DRT Tiranë përfshihet edhe QKB, veprim në kundërshtim me nenin 43, pika 3, shkronja “a” të Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”, sipas të cilit subjekti ka detyrimin të regjistrojë dhe të depozitojë në regjistrin e biznesit pasqyrat financiare vjetore, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe raportin e auditimit, të përgatitura sipas kërkesave ligjore, në rastet kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme.

1. Operatori ekonomik ka depozituar listë pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore për periudhat Maj 2024-Maj 2025, ku nga KVO vlerësohet se OE plotëson kriterin ekonomik për me të paktën 5 (pesë) punonjës, duke përfshirë stafin kryesor. Nga auditimi rezulton se në listë pagesën e muajit maj 2024, rezultojnë 4 punonjës, përfshirë edhe stafin kryesor, veprim në kundërshtim me DST, kriteri 7.
2. Për te kryer shërbimin e mirëmbajtjes, në DST është përcaktuar se OE duhet të disponojë të paktën 1(një automjet në pronësi, me qira, të pajisur me dokumentacion ligjor dhe të mbulojë gjithë periudhën e zbatimit të kontratës. Gjatë procesit të verifikimit të dokumentacionit të paraqitur, grupi i auditimit konstaton mospërputhje të pronësisë së mjetit që do të mbulojë transportin për kryerjen e shërbimit. Referuar Pasqyrave Financiare të vitit 2024, në listën e inventarit të automjeteve subjektit nuk ka në pronësi të shoqërisë automjetin Mercedes Benz me targe AA***TI i paraqitur me dokumentacion si mjet për kryerjen e transportit, por automjetin

Veturë Golf , me kapacitet 1.6, me targë AA***ZY. Pra KVO nuk ka konstatuar mospërputhjen e mjetit të transportit sipas DST, veprim në kundërshtim me kërkesat për kualifikim dhe DST.

ZBATIMI I KONTRATËS

Titullari me Urdhër Nr. 09/2025, Prot. 6151, datë 30.05.2025, ka urdhëruar ngritjen e grupit të punës për zbatimin e kontratës së shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes të pajisjeve të instaluara në stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit urban.

AK dhe OE kanë lidhur Kontratë Riparimi dhe Mirëmbajtje nr. 7680 Prot., datë 18.07.2025, në vlerë totale 35,553,480 lekë (me tvsh) si dhe Planin e Zbatimit të Kontratës me akt nr. 7680/1 Prot., datë 21.07.2025.

AK me shkresë nr. 7680/1 prot., datë 21.07.2025 AK ka miratuar "Planin e zbatimit të kontratës."

Në seksionin II përcaktohet së grafiku i zbatimit të punëve / lëvrimit te mallrave / të realizmit të shërbimeve bëhet sipas specifikimeve teknike bashkëlidhur.

Në pikën B.13 Kushtet e lëvrimit/ dorëzimit të mallrave përcaktohet se: Dokumentet e tjera që duhet të sigurohen nga Furnizuesi janë:

Kushtet e dorëzimit , datat dhe vendet e dorëzimit të mallrave dhe pjesëve të këmbimit do të përmbushen në përputhje me Grafikun e Dorëzimeve të parashikuar në këtë Kontratë.

Kontraktori do të njoftojë më shkrim, me faks, me postë elektronike (N/A) ditë para çdo dorëzimi të mallrave.

Njoftimi i dorëzimit do të bëhet me shkrim , me faks, me postë elektronike tek __(N/A).

Grupit të Punës për Zbatimin e Kontratës ka mbajtur PV nr. 7680/2 prot., datë 28.07.2025, nëpërmjet të cilit ka dorëzuar/ kaluar stacionet e cilësisë së ajrit urban nga AKM te "A. S", në zbatim të kontratës nr. 7680 prot., datë 18.07.2025 dhe urdhër pune nr. 7856 prot., datë 22.07.2025. Proces verbali është nënshkruar nga grupi i zbatimit të kontratës dhe përfaqësuesi i OE z. J. Sh.

Titullari, me Urdhër Shpenzim nr. 219, datë 17.09.2025 ka kryerjen e pagesës për në shumën total 18,858,960 lekë (me tvsh), ndërmjet bazuar në dokumentacion vërtetues: Urdhër prokurimi nr. 7 datë 30.05.2025; Fature tatimore nr. 123/2025, datë 21.08.2025; Kontratë Riparim – shërbim nr. 7680 prot., datë 18.07.2025; Urdhër blerje nr. 2, datë 11.08.2025; Urdhërim për pagesë nr. 203, datë 17.09.2025, Informacion për Titullarin nr. 7680/3, datë 01.09.2025 bashkëlidhur me listën e shërbimeve të OE për periudhën nga nënshkrimi i kontratës deri 21.08.2025. PV marrje në dorëzim nr. 7680/4 prot., datë 01.09.2025, nënshkruar nga grupi i zbatimit të kontratës.

Titullari, me Urdhër Shpenzim nr. 246, datë 23.10.2025 ka kryerjen e pagesës për në shumën total 775,680 lekë (me tvsh) bazuar në: Urdhër prokurimi nr. 7 datë 30.05.2025; Fature tatimore nr. 143/2025, datë 30.09.2025; Kontratë Riparim – shërbimi nr. 7680 prot., date 18.07.2025; Urdhër blerje nr. 2, datë 11.08.2025; Urdhër për pagesë nr. 223, datë 23.10.2025; Informacion për Titullarin nr. 7680/5, dt. 30.09.2025 nga grupi i zbatimit të kontratës (bashkëlidhur lista e shërbimeve për periudhën shtator 2025.

Titullari, me Urdhër Shpenzim nr. 268, datë 17.11.2025 ka kryerjen e pagesës për në shumën total 2,503,080 lekë (me tvsh) bazuar në: Urdhër prokurimi nr. 7 datë 30.05.2025; Fature tatimore nr. 160/2025, datë 25.10.2025; Kontratë Riparim – shërbimi nr. 7680 prot., datë 18.07.2025; Urdhër blerje nr. 2, datë 11.08.2025; Urdhër për pagesë nr. 237, datë 17.11.2025; Informacion për Titullarin nr. 7680/7, datë 10.11.2025 nga grupi i zbatimit të kontratës (bashkëlidhur lista e shërbimeve për periudhën tetor 2025..

Titullari, me Urdhër Shpenzim nr. 297, datë 17.12.2025 ka kryerjen e pagesës për në shumën total 1,121,280 lekë (me tvsh) bazuar në: Urdhër prokurimi nr. 7 datë 30.05.2025; Fature tatimore Nr.174/2025, datë 20.11.2025; Kontratë Riparim – shërbimi nr. 7680 prot., datë 18.07.2025; Urdhër blerje nr. 2, datë 11.08.2025; Urdhër për pagesë nr. 256, datë 16,12,2025; Informacion për

Titullarin nr. 7680/9, datë 10.11.2025 nga grupi i zbatimit të kontratës (bashkëlidhur lista e shërbimeve për periudhën nëntor 2025.
Titullari, me Urdhër Shpenzim nr. 322, datë 31.12.2025 ka kryerjen e pagesës për në shumën total 6,350,880 lekë (me tvsh) bazuar në: Urdhër prokurimi nr. 7 datë 30.05.2025; Fature tatimore Nr.191/2025, datë 19.12.2025; Kontratë Riparim – shërbimi nr. 7680 prot., datë 18.07.2025; Urdhër blerje nr. 2, datë 11.08.2025; Urdhër për pagesë nr. 09, datë 16.01.2025; Informacion për Titullarin nr. 1071/1, datë 15.01.2026 nga grupi i zbatimit tëe kontratës (bashkëlidhur lista e shërbimeve për periudhën dhjetor 2025.
Për periudhën objekt auditimi, AK ka likuiduar faturat tatimore si më poshtë vijon:
Zbatimi Kontratë Riparim Shërbim nr. 7680 Prot., datë 18.07.2028

PV marrje ne dorëzim	Periudha	F-H	Dokumentacion Shoqërues	U_SH	Fature Tatimore	Totali
Nr.4133 Prot., dt 02.06.2023	deri 21.08.2028	N/A	Leter Tip	nr. 219, dt 17.09.2025	FT. Nr.123/2025 dt 21.08.2025	18,858,960
N/A	deri 30.09.2025	N/A	Leter Tip	nr. 246, dt 23.10.2025	FT. Nr.143/2025 dt 30.09.2025	775,680
N/A	deri 27.10.2025	N/A	Leter Tip	nr. 268, dt 17.11.2025	FT. Nr.160/2025, dt 25.10.2025	2,503,080
N/A	deri 21.11.2025	N/A	Leter Tip	nr. 297, dt 17.12.2025	FT. Nr.174/2025, dt 20.11.2025	1,121,280
N/A	deri 22.12.2026	N/A	Leter Tip	nr. 322, dt 31.12.2025	FT. Nr.191/2025, dt 19.12.2025	6,350,880
				Paguar		**29,609,880**
				Kontrata 18.07.2025		35,849,472
				Pa Paguar		(6,239,592)

Nga auditimi rezulton se:
AK me shkresë **nr. 7680/1 prot.,** datë 21.07.2025 AK ka miratuar "Planin e zbatimit të kontratës." **Plani i punës nuk përmban sasia dhe grafiku i lëvrimit** të mallrave (riparim shërbim), në kundërshtim me seksionin II përcaktohet së grafiku i zbatimit të punëve/ lëvrimit te mallrave/ të realizmit të shërbimeve bëhet sipas specifikimeve teknike bashkëlidhur. Mos përcaktimi i grafikut të shërbimit është në kundërshtim me DST si dhe nenin 3 pika 5 të Kontratës së Shërbimit **nr. 7680/1 prot., datë 21.07.2025, sipas të cilës pagesa do të behët me faturë tatimore , në varësi të shërbimit të kryer sipas grafikut të ekzekutimit dhe të miratuar nga grupi i punës për zbatimin e kontratës.**
Grupi i Punës për zbatimin e Kontratës nuk mban procesverbalet e marrjes në dorëzim ku të konfirmohet kryerja e shërbimit, si dhe dorëzimi i të gjitha pjesëve të përdorura. Referuar urdhër-shpenzimit për pagesën e shërbimit të mirëmbajtjes dhe dokumentacionit vërtetues bashkëlidhur tij, nuk rezulton asnjë Fletë-Hyrje në magazinë për pjesët e këmbimit të hequra dhe të zëvendësuara me pjesë të reja, për të vijuar më pas me procedurat e inventarizimit dhe/ose asgjësimit të tyre. Për Titullarin hartohet informacion, ku konfirmohet pranimin e shërbimit të kryer pa përcaktuar modulin ku është kryer shërbimi .Nuk mbahet procesverbale i nënshkruar ndërmjet grupit të punës për zbatimin e kontratës dhe përfaqësuesi i Operatorit Ekonomik, duke cenuar vlefshmërinë e aktit si dokument dypalësh pranimi. Dorëzimi i shërbimit nga OE kryhet me dokument "Letër Tip" të cilat nuk mbajnë numër protokolli hyrës në institucionin e AKM-së, Mungesa e këtyre elementeve përbën mosrespektim të elementeve formale të mbajtjes së aktit administrativ, duke kufizuar gjurmueshmërinë, transparencën dhe kontrollueshmërinë e dokumentacionit, në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit në fuqi për dokumentimin e veprimeve administrative dhe financiare, si dhe me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

Për për gjitë procedurat e prokurimit trajtuar sa më sipër ngarkohen me përgjegjëësi sipas komisioneve përkatëse personat përegjegjes si më poshtë:
znj. A. Z; znj. A. K; znj. I. K; znj. I. H; z. K. T; z. B. P.; znj. A. A; z. B. S; znj. D. B,; znj. S. S; znj.V. Gj; znj. S. P; z. Sh. B; z. S. H; z. D. H; znj. O. T; z. A. B; znj. Xh. G; znj. E. F; znj. M. S;

znj. M. P; znj. K.M.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është paraqitur observacion *me shkresën dt. 23.04.2026 protokolluar në KLSH me nr. 769/90 date 27.04.2026 lidhur nga* ***: A. Z, A. K, I. K, I. H, K. T, B. P, A. A, S. S, V. Gj, S. P, D. H, O. T, (Pa Nënshkruar) A. B, E. F, M. S, K. M, (pa nënshkruar), D. Sh, E. O, B. S.***

*Në lidhje me procedurën "****Blerje reagentësh dhe materiale laboratori****" për vitin 2023 sqarojmë se :*

Në lidhje me verifikimin e mallit në ditën e marrjes në dorëzim (fq 26 e PRA) sqarojmë se çdo artikull është i ambalazhuar, kusht i cili është i domosdoshëm për qëllime të sigurisë së ruajtjes së mallit por edhe punonjësve. Në momentin e marrjes në dorëzim verifikohet nëse produkti është i ambalazhuar, sipas kushteve teknike për produkte kimike.

Data e skadencës është verifikuar në kohën e marrjes në dorëzim dhe përputhet me kushtet /kriteret e pranimit të mallit.

Për OE është vendosur kriter për dorëzimin e tabelës së produkteve me të dhëna për prodhuesit, vendi origjinës dhe vendi i ushtrimit të aktivitetit.

Gjithashtu OE ka paraqitur katalogët origjinale/ skedat teknike , autorizim nga prodhuesi , si dhe deklaratë mbi datën e skadencës së produkteve të do të furnizohen.

Në specifikimet teknike (PV nr., 1327/1, dt. 23.02.2026\ për dokumentimin e kritereve për kualifikim dhe DST sqarojmë së kriteri f) tek kriteret e veçanta (shtojca 7) janë përcaktuar kërkesat e AK për datën e skadencës.

Ne lidhje me specifikimet teknike, dokumentuar në proces verbalin tone nr. 1326/1 prot, datë 23.02.2023, edhe pse e justifikon objekti I kontratës, nuk përmendet asnjë marke prodhimi, burim specifik apo proces i veçantë.

Emri " ose Ekuivalent" është përdorur në rastin e "Membrabe RO", ELGA LabWater 1(një) copë; Katrixhe jon shkëmbimi ELGA LabWater 1(një) copë për sistem purifikimi dhe filtër i përbërë ventilimi ELGA LabWater 1(një) copë

Ne lidhje Raportin Përmbledhës mbi zbatimin e kontratës nr. 1329/3 prot, Datë 21.07.2023 dhe Formularin e zbatimit të Kontratës, AK ka shprehur se në proces verbalin marrje në dorëzim nr. 1329/1 prot, datë 19.06.20223 dhe nr. 1329/2 prot, datë 29.06.2023 është verifikuar sasia e mallit dhe është marrë në dorëzim në mënyrë të rregullt sipas kërkesës së AK, ndërkohë që Komisioni i Marrjes në dorëzim në proces verbalet e marrjes në dorëzim në përmbajtjen e tyre nuk shprehen për kriteret specifike te marrjes ne dorëzim sipas kritereve specifike të përcaktuara ne DST,

*Në lidhje me procedurën "****Shërbimi i mirëmbajtjes së pajisjeve të instaluara në stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit urban në qytet : Durrës, Shkodër, Korçë, Elbasan, Fier, stacioni i lëvizshëm në Tiranë dhe stacioni i DSHP në Tiranë****" për vitin 2023 sqarojmë se :*

Në proces verbalin e specifikimeve teknike dhe proces verbalin për argumentimin e kritereve për kualifikim, është përcaktuar se shërbimi kërkohet vetëm për mirëmbajte. Në rast se nga subjekti dhe grupi i punës do të konstatohet se për këto module ka nevojë për shërbime riparimi, nuk specifikohet për zbatim në kontratë, pasi nuk është parashikuar fond shtesë për riparimin e tyre.

Grupi i Punës së testimit të tregut mbështet në manualet e pajisjeve për të përcaktuar frekuencat e shërbimeve dhe riparimet e pajisjeve , të cilat janë :

1. *Operation manual Model T100UV Fluorescence SO2 Analyzer,*
2. *Operation manual Model T200 NO/NO2?NOX Analyzer,*
3. *Operation manual Model T300/T300M Carbon Monoxide Analyzer,*
4. *Operation manual Model T300/T300M Carbon Monoxide Analyzer,*
5. *Operation manual Model T400 Photometric Ozone Analyzer,*

Manuali i prodhimit për modulet janë të dhëna nga prodhuesi i pajisjes dhe në to janë të përcaktuara edhe kushtet e mirëmbajtjes.

Në lidhje me kriterin për stafin dhe profilin sqarojmë se referuar nenit 41 të VKM nr. 285/2021 i jepet e drejta AK që ti kërkojë OE për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale.

Neni 77.4 në ligjin nr. 162/2020 është përdorur si referencë ligjore dhe kriterin në lidhje me kriterin se OE duhet të ketë në stafin e tij 1 inxhinier elektronik; informatike, telekomunikacion dhe 1 kimist ose inxhinier mjedisi. Preferohet që 2 (dy) inxhinieret të jenë certifikuar / trajnuar për shërbimin e pajisjeve objekt prokurimi, të vërtetuar nëpërmjet certifikatës/ certifikatës së trajnimit të lëshuara nga kompani prodhuese të stacioneve të monitorimit apo moduleve përbërës të tyre.

Argumentimi për kriterin 3 dhe 4 me të cilin kërkohet që OE të dëshmojnë që në stafin e tyre kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Numri i përcaktuar i punonjësve është llogaritur duke marrë në konsideratë objektin e kontratës me shtrirje të gjerë gjeografike të vëndodhjes së stacioneve , natyrën dhe volumin e saj. Në këtë kontekst nga AK referuar nenit 77.4 të ligjit nr. 162/2020 dhe nenit 41.4.b të VKM nr.

285/2021është vendosur në përputhje me specifikimet teknike për këtë procedurë. Kërkesa e AK për inxhinier të certifikuar ose trajnuar lidhet me prezencën në stafin e OE të profesionistëve që janë përgjegjës për ndjekjen e të gjithë ciklit të procesit , duke marrë parasysh kompleksitetin e kontratës, afatet kohore, shumëllojshmërinë e shërbimit të kërkuar, që do të siguronte që çdo pikë e kërkesave të AK të kryhet me sukses , cilësi dhe në afat sipas DST. Sjelli në vëmendje se nga përvoja e mëparshme AK ka dështuar procedura e prokurimit pasi OE nuk kanë staf të certifikuar dhe trajnuar nga kompanitë prodhuese.

Në lidhje më certifikatë ISO dhe vlerësimin e tyre nga KVO sqarojmë se certifikata ISO dhe vlerësimin e tyre nga KVO sqarojmë se kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" dhe në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që OE pjesëmarrjes të dëshmojnë se i plotësojnë kërkesat e cilësisë , ë rrjedhimisht AK tu kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar dhe Ndërkombëtar. Certifikatë ISO 9001 dëshmon së mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Në lidhje me grafikun e zbatimit të kontratës sqarojmë se në planin e zbatimit, të miratuar, grafiku zbatimit të kontratës do të jetë sipas specifikimeve teknike, ku janë dhënë të detajuara zërat e shërbimit, periodiciteti i realizimit të tyre dokumentuar me proces verbalin nr. 1763/1 Prot, datë 30.03.3023 dhe Plani i Zbatimit nr. 2713/4 Prot , dt. 08.05.2023, te cilat ju janë vendosur në dispozicion në kohë e auditimit.

Raporti përmbledhës për zbatimin e kontratës nr. 5745prot, dt. 27.05.2024 dhe raporti përfundimtar për realizimin e kontratës me nr. 5744 Prot, dt. 27.05.2024 është hartuar nga grupi i punës në mbarim të afatit të kontratës. Në datën 29.05.2024 është hartuar Formulari i Raportimit të zbatimit të kontratës dhe dërguar në APP me shkresën n. 5745/1 Prot, dt. 29.05.2024.

Në lidhje me konstatimet për procedurën e prokurimit "Blerje reagentësh dhe materiale laboratori" për vitin 2024 sqarojmë se është argumentuar në mënyrë të detajuar në pikën 1 të këtij observacioni, pasi bëhet fjalë për produkt e njëjta sa i përket termit "ekuivalent" dhe aty ka qene e vlerësuar e nevojshme është përmendur emri "Ekuivalent" (dokumentuar ne PV për hartimin e specifikimeve teknike)

Në lidhje me kriterin e stafit të OE sqarojmë se është argumentuar ne pikën 2

Në lidhje me certifikatat ISO sqarojmë së është trajtuar në pikën 2 të këtij observacioni

Në lidhje me marrjen në dorëzim të produkteve dhe verifikimit sqarojmë se është argumentuar në mënyrë te detajuar në pikën 1 të këtij observacioni

Qëndrimi i grupit të auditimit

*Në lidhje me procedurën "**Blerje reagentësh dhe materiale laboratori**" për vitin 2023 dhe për procedurën e prokurimit "Blerje reagentësh dhe materiale laboratori" për vitin 2024 meqenëse procedurat e prokurimit përmbajnë të njëjtin objekt prokurimi, grupi i auditimit arsyeton si më poshtë vijon:*

Në DST në shtojcën nr. 6 "Formulari i specifikimeve teknike" janë përcaktuar specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi për secilin mall (gjithsej 52 artikuj), duke cilësuar se kërkesën për pranimin e furnizimit lidhet me datën e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit e cila duhet të jetë jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës, ose jo më pak se 1 vit nga data e lëvrimit të mallit.

Grupi i punës për zbatimin e kontratës për marrjen në dorëzim të mallit në proces verbal për marrjen në dorëzim të mallit me nr. 1329/1 Prot, datë 19.06.2023, dhe 1329/2 Prot, datë 29.06.2023, nuk është shprehur në këto akte mbi datën e skadencës së mallit të pranuar, as *nëse produkti është i ambalazhuar, sipas kushteve teknike për produkte kimike, as të dhëna të prodhuesit, as origjina e mallit.* Pra pretendimet tuaja nuk gjejnë mbështetje në Proces verbalet e mbajtura për pranimin e mallit dhe jo në DST pretenduar në këtë observacion.

Ju arsyetoni se termi *"ose ekuivalente" në rastin e kësaj kontrate nuk bëhet për sa kohë produkti, me përshkrimin e dhënë, gjendet gjerësisht në treg me ato specifika., duke veçuar vetëm 3 raste (nr. 26; nr.27 dhe nr.28) termi "ekuivalent" është shënuar tek specifikimet teknike. Grupi i auditimit arsyeton se* sipas nenit 36 pika 3 (**Specifikimet teknike) të** ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", përcaktohet se citojmë: "*... Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj*". Pra termi **"ekuivalent"** në këndvështrim të këtij neni duhet të përdoret kur autoriteti kontraktor përshkruan një produkt, shërbim ose material duke iu referuar një **standardi, modeli ose origjine specifike**, por **lejon edhe produkte të tjera që kanë karakteristika të barasvlershme**. Pra pretendimet tuaja nuk gjejnë mbështetje në ligj.

Ne lidhje me specifikimet teknike, dokumentuar në proces verbalin tone nr. 1326/1 prot, datë 23.02.2023, grupi i auditimi nuk ka konstatuar së kemi referencë në markë të specifikuar, dhe në rast se do te ishte kështu përsëri nuk do të ishte e ligjshme, për shkak të llojit te procedurës sipas ligjit të PP.

Lidhur me referimin e Manuali i prodhimit për modulet janë të dhëna nga prodhuesi i pajisjes dhe në to janë të përcaktuara edhe kushtet e mirëmbajtje evidentuar në këtë observacion, sqarojmë se ato duhet të jenë pjesë e referencës së procedurave të auditimit

➢ ***Në lidhje me procedurën e prokurimit "Shërbimi i riparimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve të instaluara në stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit urban" në vitin 2025 sqarojmë se****:*

Me Memo nr. 83/1 prot, datë 08.01.2025 me lëndë "Mbi shërbimin e riparimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve të instaluara në stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit urban", znj. A. Z nuk ka qenë person përgjegjës për prokurimin, por përgjegjës i sektorit juridik..

Me Urdhrin nr. 3, datë 08.01.2025 është ngritur grupi/ komisioni për testimin e tregut për procedurat e prokurimit për vitin 2025 dhe nuk është përcaktuar vetëm për blerjen e vogla.

Ne lidhje me testimin e tregut, AKM ka kërkuar konsulencë / asistencë nga APP dhe nga institucionet publike (email bashkëlidhur dhe shkresa bashkëlidhur). Lidhur me konsulencë/ asistencë sipas email bashkëlidhur dt. 18 shkurt 2025, në përgjigjen e APP referuar nenit 71.1 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" parashikohet se në llogaritjen e fondit limit AK duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë vijon (çmimet e botuara , studimi tregut, çmimet e kontratave te mëparshme, çmimet ndërkombëtare te shpallura publikisht) një ose me shumë alternativave, duke sjellë në vëmendje se vlera e llogaritur e fondit limit të jetë sa më reale me çmimet e tregut.

Përsa i përket testimit të tregut (PV nr. 83/2 Prot, dt. 29.05.2025 sqarojmë së në tabelën e përllogaritjes janë renditur secili modul, në kolonën "Moduli për të cilat duhet shërbimi" për sa shërbime riparimi i nevojitet dhe kolona "Frekuenca Vjetore" për mirëmbajtje, e cila në fund ka një sasi totale dhe bazuar në çmimet e marra nga OE ka rezultuar vlera përkatëse.

Grupi i Punës së testimit të tregut mbështet në manualet e pajisjeve për të përcaktuar frekuencat e shërbimeve dhe riparimet e pajisjeve , të cilat janë :

1. *Operation manual Model T100UV Fluorescence SO2 Analyzer,*
2. *Operation manual Model T200 NO/NO2?NOX Analyzer,*
3. *Operation manual Model T300/T300M Carbon Monoxide Analyzer,*
4. *Operation manual Model T300/T300M Carbon Monoxide Analyzer,*
5. *Operation manual Model T400 Photometric Ozone Analyzer,*

PV nr. 124/1 Prot, dt. 22.01.2025 "Për hartimin e specifikimeve teknike" e kanë hartuar sipas çdo moduli të vendosur në stacion (modulet janë të njëjta në çdo stacion monitorimi), sipas manualit të përdorimit të pajisjeve.

Më poshtë bashkëlidhur grafikë dhe modulet, ku duhet theksuar që këto shërbime janë për pajisje në gjendje operacionale optimale, ndryshe nga pajisjet në stacionet tona për të cilat jemi njoftuar nga kompania prodhuese që kanë arritur fundin e ciklit të tyre operacione, "End of life" e quajtur në komunikim nga kompania (bashkëlidhur shkresat).

Por kjo tabelë është saktësuar në tabelën e llogaritjes së fondit limit*.*

Lidhur me kriterin 2.2 "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" për xhiro vjetore minimale të realizuar gjatë 3 viteve të fundit financiare (2022, 2023,2024) AK i përmbahet kuptimit të përcaktimeve të pikës 2/a të nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku përcaktohet se vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet OE nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit në procedurën e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar. Në kuptim të dispozitës së sipërcituar, ku përcaktohen vlerat kufi që AK mund të përcaktojë në kriter, OE mund të paraqesin vlera edhe më të mëdha se vlerat kufi minimale (dokumentuar ne PV nr. 6651/1, dt. 19.06.2025) dhe Njoftimi i Modifikimeve të Kritereve.

Lidhur me listë pagesat për Maj 2024 deri Maj 2025, AKM i është referuar legjislacionit dhe rekomandimit të APP-se (dokumentuar në Memo nr. 83/4, dt. 18.06.2025. Argumentimi i AKM në lidhje me listëpagesat për periudhën Maj 2024-Maj 2025, me qëllimin që periudha e përcaktuar në listëpagesë të jetë sa më koherente me datën e zhvillimit të tenderit, do të përfshihet në listëpagesën e muajit të fundit, të cilat OE mund t'i disponojë, duke patur parasysh përcaktimet e nenit 11, germa a) të ligjit nr. 9136/2003 "Për mbledhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore" në RSH" ku përcaktohet së tatimpaguesit persona juridike të regjistruar si tatimpagues së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, bëhen brenda datës 20 të muajit pasardhës. Pra KVO e ka vlerësuar dokumentacionin provues të paraqitur si të <u>saktë duke llogaritur një punësim mesatar</u>.

Përsa i përket kriterit të vendosur në lidhje me stafin e kualifikuar të nevojshëm, i qëndrojmë sqarimit dhe argumenteve të dhëna më lart, që OE të dëshmojnë që janë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Numri i përcaktuar i punonjësve është llogaritur dukë marrë në konsideratë objektin e kontratës më shtrirje të gjerë gjeografike të vendodhje së stacioneve, natyrën dhe volumin e saj.

Kërkesa e AK për inxhinierë të certifikuar/trajnuar, lidhet me domosdoshmërinë për prezencën në stafin e OE të profesionistëve që janë përgjegjës për ndjekjen e të gjithë ciklit të procesit duke siguruar që çdo pikë e përcaktimeve sipas kërkesave të AK të kryhet me sukses dhe cilësi si në kohë e afat sipas DST. Sjellim në vëmendje se përvoja e mëparshme e procedurave të prokurimit të iniciuara nga AKM ka rezultuar se OE nuk kanë staf të certifikuar dhe të trajnuar nga kompanitë prodhuese, kanë dështuar në realizimin me sukses apo 100% të kontratës.

Në lidhje me konstatimin përsa i përket bilanceve , sqarojmë se AKM mjaftohet me faktin që këto balance janë të pranuara nga DRT organ kompetent për pranimin e tyre sipas procedurave tatimor dhe procedurat e QKB-së nuk janë kompetencë e AKM-së. Kriteri konsiderohet i përmbushur pasi në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Grafiku i realizimit është përcaktuar në specifikimet teknike në planin e zbatimit të kontratës, ashtu siç kemi argumentuar edhe me lart për kontratën e vitit 2023.

Qëndrimi i grupit të auditimit.

Grupi i auditimit ne procedurën e prokurimit me objekt me objekt "Shërbimi i riparimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve të instaluara në stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit urban", për vitin 2025 ka evidentuat Urdhërata e Titullarit për ketë procedurë prokurimi, ndërmjet të cilëve është edhe *Urdhri nr. 3, datë 08.01.2025 për testimin e tregut për këtë procedure prokurimi.*

Referuar nenin 34, pika 11 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, **AK mund të përdorë edhe më shumë se një alternativë**, si çmimet e publikuara nga INSTAT, çmimet referencë të Doganës, kontrata të ngjashme, etj. pasi këto të dhëna do të vlerësonin vlerën e fondit limit të përllogaritur sa më afër vlerës së tregut.

Në **Procesverbalin nr. 124/1 prot., datë 22.01.2025**, si dhe në DST, shtojca 5, në kuadër të hartimit të specifikimeve teknike, Komisioni për Hartimin e Specifikimeve Teknike **nuk ka përcaktuar numrin e moduleve** për të cilat do të ofrohet shërbimi, si dhe argumentimi i specifikimeve teknike për secilin prej tyre, në kundërshtim me kërkesat e **nenit 78, pika 1 dhe 2**, të VKM nr. 285/2021 sipas të cilave në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre

Komisioni të Testimit të Tregut dhe llogaritjes së fondit limit ka mbajtur **PV nr. 83/2 prot, datë 29.05.2025** për testimin e tregut dhe llogaritjen e fondit limit ka përllogaritur fondin limit mbi bazën e çmimit mesatar për artikull të tre (3) ofertave të paraqitura nga tre (3) operatorë ekonomikë. **Studimi i tregut** është bazuar në ofertat e paraqitura nga shoqëria A. S në vlerë 15,853,400 lekë, G. G. në vlerë 15,960,300 lekë dhe K. në vlerë 15,631,900 lekë**. Fondi limit** u llogarit në vlerën **29,874,560 lekë** (pa TVSH).Specifikimet teknike dhe termat e referencës të përcaktuara ne shkresën nr. 124/1 dt. 22.01.2025 dhe **PV nr. 83/2 prot, datë 29.05.2025** *"Moduli për të cilat duhet shërbimi" për sa shërbime riparimi i nevojitet dhe kolona "Frekuenca Vjetore" dhe tabela e llogaritjes se fondit limit në mirëmbajtje kanë mospërputhje në të dhënat e përshkruara. Grupi i auditimit konstatoi se* përllogaritja e vlerës së fondit limit **nuk përputhet** me rezultatet e testimit të tregut sipas ofertave të paraqitura, **pasi numri i moduleve dhe shërbimet e përcaktuara për to nuk është dokumentuar dhe argumentuar në mënyrë të plotë sipas studimit të tregut. Përcaktimi i moduleve dhe referenca për mirëmbajtje duhet te referojnë ne kritere teknike sipas Manualit të pajisjes për të cilin do të kryhet shërbimi teknik .**

Njësia e Prokurimit argumenton se në hartimin e kriterit për përvojën e ngjashme, i përmbahet kuptimit të përcaktimeve pikës **2/b të nenit 43** të VKM nr. 285/2021, sipas të cilit " Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit **mbi kufirin e lartë monetar".** *Në kuptim të dispozitës së sipërcituar, ofertuesi/it* ***gëzojnë të drejtën*** **të paraqesin vlera edhe më të mëdha se vlera kufi minimale, por pa tejkaluar vlerën maksimale** të përcaktuar në dispozitën e sipërcituar. Për sa më sipër përcaktimi i kriterit specifik për xhiron minimale vjetore është në mospërputhje me pikën 2.b të nenit 43 të VKM nr. 285/2021, i ndryshuar**. NJP ka argumentuar se** OE mund të paraqesin vlera **edhe më të mëdha se vlera kufi minimale, e cila nuk duhet të** tejkalojë vlerën maksimale të përcaktuar në dispozitën e sipërcituar. Ky përbën një kufizim ligjor, të rekomanduar për tu zbatuar edhe nga APP.

Grupi i auditimit arsyeton se afati ligjor për deklarimin e listëpagesave të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, rezulton se kontributet **për muajin prill 2024** duhen deklaruar dhe paguar brenda datës 20 të muajit pasardhës, pra deri më 20 maj 2024, ose para datës së hapjes se procedurës së prokurimit në SPE përkatësisht 19.05.2025. Në këtë kontekst, **mos përfshirja e listëpagesave** të sigurimeve shoqërore të muajit prill 2024 **përbën veprim të pajustifikuar dhe në kundërshtim me pika 2 neni 41 të VKM** nr. 285/2021, i ndryshuar, sipas të cilës kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor duhet të jenë të **argumentuara dhe të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës.**

Njësia e Prokurimit ka përcaktuar se operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) inxhinier elektronik dhe/ose informatikë dhe/ose telekomunikacioni, si dhe 1 (një) kimist ose inxhinier mjedisi, duke kërkuar paraqitjen e kontratave të punës, diplomave përkatëse, si dhe certifikatave apo trajnimeve të lëshuara nga prodhuesit e pajisjeve objekt prokurimi. NjP **duhet të referohet në kriteret e licencimit profesional të nevojshme për realizimin e shërbimeve** objekt kontrate, të lëshuara nga autoritetet shtetërore kompetente, dhe/ose në paraqitjen e një liste të personelit kryesor të domosdoshëm për zbatimin e objektit të prokurimit, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Më tej mbetet në përgjegjësinë e tij për të vlerësuar nëse profili profesional i deklaruar nga OE përputhet plotësisht me natyrën e **shërbimit** objekt Anulimi *me herët i procedurave të prokurimit për shkakun se OE nuk dispononin staf të certifikuar dhe trajnuar nga kompanitë prodhuese nuk përbën argument për të mbështetur kriteret e përcaktuara lidhur me profesionet e përcaktuara në DST.*

➢ ***Në lidhje me procedurën "Shërbimi i mirëmbajtjes së pajisjeve të instaluara në stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit urban në qytet : Durrës, Shkodër, Korçë, Elbasan, Fier, stacioni i lëvizshëm në Tiranë dhe stacioni i DSHP në Tiranë" për vitin 2023 sqarojmë se :***

Grupi i Punës për Hartimin e Specifikimeve Teknike, i ngritur me Urdhër nr. 08, datë 10.03.2023, **në shkresën nr. 2713/1 Prot, datë 06.04.2023 "***Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta për kualifikim*", ka kërkuar se shërbimi i mirëmbajtës **do të kontraktohet vetëm për pajisjet që janë në gjendje pune,** të cilat nuk kërkojnë dërgimin e modulit jashtë vendit dhe arrijnë të japin të dhënat e domosdoshme për raportim , të përcaktuara nga grupi I ekspertëve të AKM-së. Kjo evidenton faktin se për pajisjet e instaluara në stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit, për të cilat parashikohet ofrimi i shërbimit të mirëmbajtjes, nuk disponohet informacion i saktë mbi gjendjen e tyre funksionale, pasi AK nuk ka kryer më parë vlerësimin e gjendjes së aktiveve, veprim ky në kundërshtim me paragrafin 102 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Grupi i auditimit konstaton se, në vlerësimin e ofertave të paraqitura, sipas PV nr. 2714/1, datë 20.04.2023 dhe PV përfundimtar nr. 2714/2 Prot., datë 25.04.2023, subjekti K. shpk ka paraqitur certifikatat ISO 9001:2015, të vlefshme deri më 29.01.2025, dhe ISO 14001:2015, të vlefshme deri më 30.03.2025, të lëshuara nga L .Në përmbajtjen e këtyre dokumenteve përcaktohet se: "Kjo certifikatë është lëshuar elektronikisht dhe mbetet pronë e C.W B. Ltd dhe lidhet me kushtet e kontratës. Kopjet e printuara mund të bëhen të vlefshme me kërkesë. Për të verifikuar autenticitetin dërgoni email në info@certiw.com ose skanoni QR Code SIA 'C. W. B".

KVO nuk është shprehur mbi verifikimin e autenticitetit të certifikatave të paraqitura nga OE, sipas përcaktimeve në vetë përmbajtjen e certifikatave. Pra, KVO nuk ka vlerësuar nëse certifikatat e lëshuara nga C.W B.L përbëjnë certifikata të lëshuara nga një organ i pavarur i njohur nga sistemet ndërkombëtare të standardizimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), apo nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, veprime në kundërshtim me nenin 79 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe me nenin 44 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Në lidhje me grafikun e zbatimit të kontratës sqarojmë se Plani i Zbatimit nr. 2713/4 Prot, dt. 08.05.2023, është miratuar si dokument standard dhe por grupi auditimit ka konstatuar së në të mungon grafiku zbatimit të kontratës për shërbimet që dom të kryhen sipas specifikimeve teknike, ku zërat e shërbimit, periodiciteti i realizimit të tyre janë të përcaktuara.

Nga auditimi u konstatua se AK me shkresë nr. 5745/1, datë 29.05.2024 ka njoftuar APP mbi zbatimin e kontratës nëpërmjet "**Formularit të raportimit për Zbatimin e Kontratës**" firmosur nga Titullari. Grupi i punës konstatoi se Komisioni për zbatimin e Kontratës së Shërbimit nr. 2713/3 Prot, datë 02.05.2023 **nuk ka hartuar Raport Përmbledhës për Zbatimin e Kontratës**, në kundërshtim me kreun II, neni 2 germa "ll", VKM 285/2011 sipas të cilit për çdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë Raportin për zbatimin e kontratës, sipas parashikimeve në LPP, i cili nuk gjendet as në këtë observacion si dokument shkresor që mbështet pretendimin tuaj

Për sa më sipër arsyetuar observacioni juaj nuk merret parasysh dhe trajtohet në raportin përfundimtar të auditimit.

2.3 Mbi auditimin e procedurave për dhënie mendimi për lejet Mjedisore dhe Licencave

Fusha e veprimtarisë së Sektorit të Lejeve Mjedisore

Sektori i Lejeve Mjedisore administron procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve mjedisore, duke kryer verifikimin e aplikimeve, dokumentacionit shoqërues dhe përmbushjes së kushteve teknike përkatëse, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. Në ushtrimin e funksioneve të tij, sektori realizon koordinimin ndërinstitucional me Agjencitë Rajonale të Mjedisit (ARM) dhe institucione të tjera përgjegjëse, harton opinionet teknike, përgatit projekt-vendimet përkatëse dhe formalizon aktet administrative të miratimit ose refuzimit.

Përgjegjësi i sektorit siguron organizimin dhe shpërndarjen efektive të ngarkesës së punës, respektimin e parimit të shmangies së konfliktit të interesit, si dhe garanton transparencën përmes publikimit të informacionit mbi lejet mjedisore në faqen zyrtare dhe në databazat përkatëse. Specialistët e sektorit kryejnë shqyrtimin teknik të aplikimeve, përcaktojnë kategorinë dhe llojin e lejes mjedisore, vendosin kushtet specifike mjedisore sipas natyrës së aktivitetit dhe industrisë, si

dhe sigurojnë regjistrimin dhe ngarkimin e akteve përfundimtare në sistemin elektronik të Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB).
Bazuar në rregulloren nr. 120, datë 12.01.2021 *"Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit",* Drejtoria e Vlerësimit të Impaktit dhe Licencimit mbulon procesin e shqyrtimit të dokumenteve të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe administrimin e lejeve mjedisore, duke garantuar respektimin e kuadrit ligjor dhe parimit "*Ndotësi paguan".* Në ushtrimin e funksioneve të saj, drejtoria organizon dhe menaxhon veprimtarinë e brendshme, koordinon qëndrimet teknike dhe juridike ndërmjet sektorëve përbërës, shqyrton dhe miraton dokumentacionin përfundimtar të oponencës teknike, si dhe siguron mbikëqyrjen e plotë të procedurave administrative për dhënien e lejeve mjedisore. Gjithashtu, ajo evidenton dhe sinjalizon rastet e përgjegjësive mjedisore të subjekteve, siguron përdorimin efikas të burimeve institucionale, kontribuon në procesin e planifikimit dhe buxhetimit të nevojave të institucionit, si dhe harton dhe paraqet raporte periodike në përputhje me kërkesat e Drejtorit të Përgjithshëm.
Ajo organizon dhe menaxhon punën e brendshme, koordinon qëndrimet teknike dhe juridike të sektorëve, miraton dokumentet përfundimtare të oponencës teknike dhe siguron mbikëqyrjen e procedurave të dhënies së lejeve. Drejtoria sinjalizon në rastet e përgjegjësive mjedisore të subjekteve, siguron përdorimin efikas të burimeve, kontribuon në buxhetimin e nevojave të institucionit dhe dorëzon raporte periodike sipas kërkesave të Drejtorit të Përgjithshëm.
Gjatë auditimit, nga grupi i auditimit u kërkua baza e të dhënave në lidhje me lejet mjedisore aktive, nga ku konstatohet se, për periudhën objekt auditimi, drejtori të ndryshme pranë AKM-së disponojnë baza të ndryshme të dhënash mbi lejet mjedisore aktive, të cilat nuk janë të harmonizuara mes tyre. Kjo situatë paraqet mungesë konsistence dhe unifikimi në administrimin dhe përditësimin e informacionit, duke ndikuar në besueshmërinë dhe saktësinë e të dhënave të raportuara.
Për këtë arsye, grupi i auditimit ka kërkuar që të dhënat lidhur me operatorët e pajisur me Leje Mjedisore të Tipit A dhe B, me status aktiv, si dhe operatorët e pajisur me Licencë të nënkategorisë III.2.B, të sigurohen edhe nga QKB me qëllim kryqëzimin dhe verifikimin e tyre. Në këtë kuadër, në funksion të bashkëpunimit ndërinstitucional, AKM i është drejtuar QKB-së me shkresën nr. 11929 prot., datë 13.11.2025, për vënien në dispozicion të informacionit përkatës.
Në përgjigje të kësaj kërkese, më datë 17.11.2025, QKB ka përcjellë informacionin mbi lejet mjedisore aktive të lëshuara që nga viti 2009. Nga analiza e të dhënave të vëna në dispozicion nga ky institucion, rezulton si më poshtë:

Përshkrimi	**Numri**
Leje Mjedisi e tipit A	173
Leje Mjedisi e tipit B	2,988
Veprimtaritë e tjera profesionale lidhur me ndikimin në mjedis	584
Totali	**3,745**

Burimi: QKB, përpunuar nga grupi i auditimit.
Nga të dhënat e administruara nga grupi i auditimit, të përmbledhura në tabelën e mësipërme dhe të vëna në dispozicion nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), rezulton se numri total i lejeve dhe licencave aktive të lidhura me ndikimin në mjedis arrin në 3,745 subjekte, nga të cilat 173 i përkasin lejeve mjedisore të tipit A, 2,988 lejeve të tipit B dhe 584 subjekteve të pajisura me licenca për veprimtari profesionale në fushën e mjedisit. Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga AKM, konstatohet se në regjistrin e lejeve ekzistojnë 778 leje me format të vjetër, me status aktiv, por të paformatizuara. Mos azhornimi dhe përditësimi i të dhënave të subjekteve të pajisura me leje mjedisore përbën mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011, *"Për mbrojtjen e mjedisit"*, si dhe të Ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011, *"Për lejet e mjedisit"*, i ndryshuar, konkretisht me pikën 1 dhe 2 të nenit 30, ku përcaktohet:
1. "Të gjitha instalimet ekzistuese të tipit A dhe të tipit B do të zbatojnë të gjitha dispozitat e këtij

ligji jo më vonë se tetë vjet nga hyrja në fuqi e tij."
2. "Operatori i një instalimi ekzistues të tipit A ose të tipit B, brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, i dërgon Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, përmes QKB-së, kërkesën për rishikimin e kushteve të lejes ekzistuese të mjedisit të tipit A ose të tipit B, sipas rastit, në përputhje me kërkesat e reja të këtij ligji dhe planin e përputhshmërisë, së bashku me afatet përkatëse."
Gjithashtu, nga auditimi i praktikave të lejeve mjedisore konstatohet se për disa subjekte, për të njëjtin instalim dhe nga i njëjti subjekt, ekzistojnë dy ose më shumë leje mjedisore (PN) të lëshuara në vite të ndryshme. Megjithëse është miratuar leja mjedisore e re, në asnjë rast nuk rezulton të jetë kryer revokimi i lejes mjedisore të mëparshme për një periudhë të konsiderueshme kohore, çka krijon mbivendosje të akteve administrative dhe pasiguri në përcaktimin e statusit aktual të lejes në fuqi, rastet e evidentuara paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. x: *"Listë e subjekteve me leje të mbivendosura në të njëjtin instalim"*

NIPTI	Urdhër shfuqizimi	Tipi	Arsyeja	PN e shfuqizuar	Komente	PN e mbivendosur	Pas sa vitesh
J.....M	Urdhër 75 datë 07.02.2025	B	Me kërkesë të subjektit	PN-2869-01-2012	Mbivendosje të lejeve	PN-7007-03-2014	11
K.....R	Urdhër 311 datë 22.08.2025	B	Me kërkesë të subjektit	PN-4688-12-2012	Mbivendosje të lejeve	PN-1763-01-2016	9
K.....Q	Urdhër 93 datë 27.02.2025	B	Me kërkesë të subjektit	PN-4846-02-2013	Mbivendosje të lejeve	PN-3825-09-2016	9
K.....K	Urdhër 67 datë 07.02.2024	B	Me kërkesë të subjektit	PN-1341-01-2011	Mbivendosje të lejeve	PN-0974-10-2015	9
K.....Ë	Urdhër 38 datë 22.01.2024	B	Me kërkesë të subjektit	PN-9104-01-2015	Mbivendosje të lejeve	PN-9104-01-2015	9
K.....B	Urdhër 283 datë 23.07.2025	B	Me kërkesë të subjektit	PN-4352-11-2012	Mbivendosje të lejeve	PN-4938-04-2017	8
J.....E	Urdhër 253 datë 03.07.2025	B	Me kërkesë të subjektit	PN-4445-11-2012	Mbivendosje të lejeve	PN-7240-09-2018	7
K.....E	Urdhër 218 datë 17.06.2025	B	Me kërkesë të subjektit	PN-3755-07-2012	Mbivendosje të lejeve	PN-6342-03-2018	7
K.....O	Urdhër 95 datë 27.02.2025	B	Me kërkesë të subjektit	PN-8583-11-2014	Mbivendosje të lejeve	PN-7525-11-2018	7
K.....O	Urdhër 94 datë 27.02.2025	B	Me kërkesë të subjektit	PN-4602-02-2017	Mbivendosje të lejeve	PN-7525-11-2018	7
L.....B	Urdhër 77 datë 07.02.2024	B	Me kërkesë të subjektit	PN-0433-05-2010	Mbivendosje të lejeve	PN-6710-07-2018	6
J.....D	Urdhër 395 datë 24.10.2024	B	Me kërkesë të subjektit	PN-0220-03-2010	Mbivendosje të lejeve	PN-0348-04-2021	3
K.....F	Urdhër 407 datë 31.10.2024	A	Me kërkesë të subjektit	PN-7396-06-2014	Mbivendosje të lejeve	PN-0356-04-2021	3
L.....D	Urdhër 401 date 28.10.2024	B	Me kërkesë të subjektit	PN-2611-12-2011	Mbivendosje të lejeve	PN-0309-03-2021	3
L.....G	Urdhër 121 datë 26.03.2025	A	Me kërkesë të subjektit	PN-3747-09-2016	Mbivendosje të lejeve	PN-2068-04-2024	1
L.....G	Urdhër 281 datë 23.07.2025	B	Me kërkesë të subjektit	PN-1993-07-2011	Mbivendosje të lejeve	PN-2068-04-2024	1
L.....G	Urdhër 122 datë 26.03.2025	A	Me kërkesë të subjektit	PN-3764-09-2016	Mbivendosje të lejeve	PN-2068-04-2024	1

Burimi: AKM, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga analiza e të dhënave të paraqitura, në tabelën më sipër, duke marrë si referencë datën e urdhrit (si moment i shfuqizimit të lejes së vjetër) dhe datën e lejes së mbivendosur (PN), rezulton se subjektet kanë operuar për me dy leje mjedisore të mbivendosura, për periudhat kohore të paraqitura si më poshtë:
- 9 raste me mbivendosje të lejeve për një periudhë 7–11 vite;
- 2 raste me mbivendosje të lejeve për një periudhë 5–6 vite;
- 3 raste me mbivendosje të lejeve për një periudhë 3–4 vite;
- 3 raste me mbivendosje të lejeve për një periudhë 1 vjeccare.

Për sa më sipër, konstatohet se praktika e evidentuar**, është në kundërshtim** me pikat 1 dhe 2, te nenit 8, të Ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 *"Për lejet mjedisit"* i ndryshuar ku përcaktohet:
1. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, instalimet e kategorisë A pajisen me leje mjedisi të tipit A, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.
2. E njëjta leje mjedisi e tipit A mund të lejojë funksionimin e më shumë se një instalimi të të njëjtit operator në të njëjtën vendndodhje. Instalimet e operatorëve të ndryshëm, që ndodhen në të njëjtën vendndodhje dhe instalimet e të njëjtit operator, që ndodhen në vendndodhje të ndryshme kërkojnë leje të veçanta të tipit A, B apo C, sipas rastit.
Në nenin 20 *"Kërkesat e përgjithshme për funksionimin e lejes së mjedisit të tipit B"* pika 1 dhe 2 ku përcaktohet:
1. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, instalimet e kategorisë B pajisen me leje mjedisi të tipit B, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji. 2. E njëjta leje mjedisi e tipit B mund të lejojë funksionimin e më shumë se një instalimi të të njëjtit operator, në të njëjtën vendndodhje. Instalimet e

operatorëve të ndryshëm, që ndodhen në të njëjtën vendndodhje dhe instalimet e të njëjtit operator, që ndodhen në vendndodhje të ndryshme kërkojnë leje të veçanta të tipave A, B apo C, sipas rastit.
Si dhe neni 30 pika 1 dhe 2 ku përcaktohet:
1. Të gjitha instalimet ekzistuese të tipit A dhe të tipit B do të zbatojnë të gjitha dispozitat e këtij ligji jo më vonë se tetë vjet nga hyrja në fuqi e tij.
2. Operatori i një instalimi ekzistues të tipit A ose të tipit B, brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, i dërgon Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, përmes QKB-së, kërkesën për rishikimin e kushteve të lejes ekzistuese të mjedisit të tipit A ose të tipit B, sipas rastit, në përputhje me kërkesat e reja të këtij ligji dhe planin e përputhshmërisë, së bashku me afatet përkatëse.

Test mbi saktësinë e databazës së lejeve

Në kuadër të verifikimit të saktësisë dhe besueshmërisë së të dhënave, grupi i auditimit, bazuar në informacionin e vënë në dispozicion si dhe në të dhënat e publikuara edhe në faqen zyrtare të AKM-së [4], kreu analizën e strukturës së numrit të lejeve mjedisore (PN), duke identifikuar dhe klasifikuar rastet sipas vitit të koduar në fund të PN-s ë, nga ku situara paraqitet si më poshtë:

Kodi në fund të PN-së	Numri i subjekteve
2010	3
2011	5
2012	10
2013	8
2014	7
2015	8
2016	7
2017	9
2018	3
2019	7
2020	2
2021	8
2022	6
2023	**278**
Totali	**361**

Burimi: AKM, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga përpunimi i të dhënave rezulton se 278 raste përfundojnë me kodin *"2023*", duke treguar se këto i përkasin lejeve të aprovuara gjatë vitit 2023. Ndërkohë, nga tabela e plotësuar rezulton se numri total i lejeve të raportuara si të aprovuara (përfshirë lejet e tipit A dhe B) është 282, duke evidentuar një mospërputhje ndërmjet numrit të lejeve të raportuara dhe atyre të identifikuara sipas kodit të PN-së. Diferenca prej 4 rastesh nuk përfaqëson miratime të reja lejesh mjedisore, por lidhet me shqyrtime administrative dhe ndryshime në regjistrim (si përditësime, rishikime apo korrigjime të të dhënave ekzistuese), të cilat janë klasifikuar gabimisht si *"miratim*". Kjo praktikë ndikon në shtrembërimin e treguesve të performancës lidhur me numrin e lejeve të dhëna, si dhe krijon pasaktësi në raportimin dhe analizën statistikore të veprimtarisë së AKM-së.
Nga verifikimi i mëtejshëm i bazës së të dhënave rezultoi se 5 leje të tipit B, megjithëse në kolonën e vendimmarrjes janë shënuar si "*Miratim*", nuk përfundojnë me kodin "2023", çka tregon se nuk përbëjnë miratime të reja të këtij viti, por janë regjistruar gabimisht si të tilla.
Gjithashtu, u evidentuan raste të përsëritjes së të njëjtit numër PN, konkretisht PN-1857-07-2023 dhe PN-1808-06-2023, të cilat paraqiten më shumë se një herë në databazë me status "*Miratuar*". Duke qenë se numri PN është unik për çdo leje mjedisore, regjistrimi i dyfishtë i të njëjtit PN si miratim i ri përbën pasaktësi në evidencë dhe krijon risk për shtrembërim të raportimit të të dhënave.

[4] Baza e të dhënave për Lejet e Mjedisit Tipi A/B për periudhën Janar 2014- Shtator 2025 - Agjencia Kombëtare e Mjedisit

Në këto kushte, rezulton se PN-1857-07-2023 nuk duhet të konsiderohet si miratim i ri në numërimin total të lejeve të aprovuara.
Gjithashtu, nga analiza e numrit unik të PN-ve rezulton se 171 leje përfundojnë me kodin *"2024*", duke evidentuar nevojën për një rishikim dhe pastrim të databazës, me qëllim sigurimin e saktësisë, unifikimit dhe besueshmërisë së informacionit të administruar.

Kodi i fundit 4 shifror I PN-së	Numri i subjekteve
2010	1
2011	1
2012	5
2013	3
2014	3
2015	5
2016	6
2017	1
2018	6
2019	3
2020	3
2021	11
2022	2
2023	9
2024	171
Total	**230**

Burimi: AKM, përpunuar nga grupi i auditimit

Te databaza e lejeve 2024 ka 40 kode PN të cilat përsëriten më shumë se njëherë dhe nuk paraqesin të dhëna për tipin e shqyrtimit, por kanë të plotësuar shënimin "*Tipi A*" apo "*Tipi B*" ç'ka nuk paraqet të dhënat të plota e të sakta më tipin e miratimit të bërë për secilën çështje të shqyrtuar.

PN	Numri i përsëritjes
PN-2238-12-2024	2
PN-0874-12-2021	2
PN-2042-03-2024	3
PN-2062-03-2024	2
PN-2068-04-2024	2
PN-2115-05-2024	2
PN-2120-05-2024	2
PN-2133-06-2024	2
PN-2134-06-2024	3
PN-2139-07-2024	2
PN-2145-07-2024	2
PN-2204-10-2024	2
PN-2213-10-2024	2
PN-2217-11-2024	2
PN-2219-11-2024	2
PN-3518-05-2012	2
PN-3599-08-2016	2
PN-6592-06-2018	2
PN-7241-09-2018	2
Grand Total	**40**

Burimi: AKM, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga verifikimi i mëtejshëm i të dhënave për vitin 2025, rezultojnë 5 shqyrtime të cilat nuk kanë të plotësuar PN-në, duke mos ofruar informacion të plotë mbi lejen e dhënë apo ndryshuar.

Subjekt	PN-ja	LC	NUIS
A. A		(LC –5817)	M.....E
LL. O-D		(LC –7594)	L.....P
LL. O-D		(LC –7598)	L.....P
V. P		(LC – 8266)	K.....K
RecycAl		(LC – 4932)	K.....A

Burimi: AKM, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga verifikimi i kodit 4 shifror, për lejet e vitit 2025 PN-të paraqiten si në vijim:

Kodi 4 shifror në fund të PV-së	Numri I PN-ve
2010	2
2011	6
2012	1
2013	5
2014	6
2015	2
2016	2
2017	3
2018	2
2019	2
2020	8
2021	7
2022	4
2023	4
2024	4
2025	**105**
Total	**163**

Burimi: AKM, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga sa më sipër konstatohet se të dhënat e publikuara në faqen zyrtare të AKM-së nuk ofrojnë një klasifikim të qartë mbi llojin e shqyrtimit të kryer, si dhe paraqiten të paplota, pasi në 5 raste që i përkasin vitit 2025 nuk evidentohet numri përkatës i PN-së. Gjithashtu, rezulton se në raportim janë përfshirë të gjitha shqyrtimet e aprovuara, pa bërë dallimin ndërmjet miratimeve të reja, transferimeve apo ndryshimeve të lejeve ekzistuese, çka ndikon në mungesën e qartësisë dhe saktësisë së informacionit të raportuar.

Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga AKM, lejet sipas viteve për periudhën objekt auditimi, paraqiten si në vijim:

Lejet e vitit 2023

Në të dhënat e vitit 2023 rezultojnë gjithsej 16 praktika të shqyrtimit të lejeve të Tipit A dhe 345 praktika për lejet e Tipit B. Përpunimi i mëtejshëm i kësaj baze të dhënash paraqet në mënyrë të detajuar shpërndarjen e shqyrtimeve sipas tipit të lejes, siç pasqyrohet në tabelën më poshtë:

Vendimmarrja	TIPI A	TIPI B
Miratim	9	273
Miratim Ndryshim	6	57
Miratim Transferim	1	15
Total	**16**	**345**

Burimi: AKM, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga të dhënat e detajuara në këtë bazë rezulton se janë miratuar 9 leje "*tipi A*" dhe 273 leje "tipi B".

Lejet e vitit 2024

Nga baza e të dhënave të vëna në dispozicion për vitin 2024 evidentohet si në vijim:

Tipi I aplikimit për leje	Numri i subjekteve
Ndryshim Tipi B	4
Tipi A	8
Tipi A-ndryshim	1
Tipi B	213
Tipi B Korrigjim	3
Transferim Tipi B	1
Total	**230**

Burimi: AKM, përpunuar nga grupi i auditimit

Ka pasur 230 shqyrtime të lejeve A dhe B. Leje "*Tipi A"* dhe "*Tipi B",* pra të miratuara janë 221 leje.

Viti 2025

Tek sheet i të dhënave për vitin 2025, rezultojnë [5]të plotësuara *"tipi A*" dhe "*tipi B*" në kolonën koordinatat. Nga të dhënat e vendosura në dispozicion rezulton se janë shqyrtuar 293 kërkesa ku specifikohet vetëm Tipi A/Tipi B, dhe kërkesat për ndryshime. Nga përpunimi i databazës rezultojnë të ndara sipas tipit A/B një numër subjektesh si më poshtë:

Tipi I aplikimit për leje	Numri i subjekteve
Leje tipi A	0
Ndryshim tipi A	12
Leje tipi B	191
Ndryshim tipi B	90
Total	**293**

Burimi: AKM, përpunuar nga grupi i auditimit

Pra të miratuara rezultojnë 191 leje tipi B.

Praktika e shqyrtimit të dosjeve të aplikimi për Leje Mjedisi Tipi A ose Tipi B

Procedura e aplikimit për paisje me leje mjedisi Tipi A dhe B është e parashikuar në Shtojcën 1 të Ligjit nr. 10448 datë 14.07.2011 *"Për Lejet e Mjedisit"* i ndryshuar, ligji nr. 52/2020 dhe në përputhje me përcaktimet e kreut II "*Leje Tipi A*" ose kreut III "*Leje Tipi B*" të VKM-së nr. 419, datë 25.06.2014 *"Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A dhe B, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja",* i ndryshuar. Aplikimi për VNM kryhet në zbatim të Ligjit nr. 10440 datë 07.07.2011 *"Për vlerësimin e Ndikimit në Mjedis"* i ndryshuar. Procedura e aplikimi kryhet në sistemin e-leje, në portalin e-albania në mbështetje të VKM nr. 686, datë 29.07.2015 *"Për miratimin e rregullave, përgjegjësive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore"* i ndryshuar. Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 153 prot., datë 25.11.2019 *"Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm online nga data 01.01.2020".* Operatori i dërgon Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, kërkesën, nëpërmjet platformës qeveritare "*e-Albania",* nëpërmjet QKB-së, referuar Ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009, *"Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, VKM nr. 538 datë 26.05.2009 *"Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore përbashkëta",* i ndryshuar. Përditësimi i listës së subjekteve të pajisura me dokumentacion mjedisor realizohet dhe rifreskohet nëpërmjet shkëmbimit të informacioneve ndërmjet sektorëve të Lejeve dhe VNM të cilët menaxhojnë listat përkatëse të rifreskuara për lejet A dhe B, VNM Paraprake dhe Deklarata Mjedisore që miratohen nga ministri.

Konkretisht përzgjedhur praktikat si në vijim:

1. Subjekti "F. P" sh.p.k me Nipt L.....O

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikës së lejes mjedisore konstatohet se:

- Kontrata e qerasë nr. 887 rep dhe nr. 665/3 kol, datë 19.07.2017, me afat vlefshmërie nga 01.11.2017 deri më 01.11.2022, parashikon mundësinë e rinovimit me pëlqimin e palëve për një periudhë shtesë. Megjithatë, nga auditimi rezulton se në momentin e vendimmarrjes nga Komisioni, subjekti rezulton me kontratë qeraje të përfunduar, pa evidencë dokumentare për rinovimin e saj.
- Tek pika 12 *"Rehabilitimi, ndërprerja e veprimtarisë, rifillimi dhe kontrolli pas nxjerrjes nga përdorimi"* – nga ana e subjektit nuk është bashkëlidhur asnjë masë ekzistuese apo e propozuar që

[5] Të dhënat në lidhje me lejet, për vite tëndryshme kanë forma të ndryshme të raportimit, më të detajuara për vitin 2025.

synon reduktimin e ndikimit në mjedis pas ndërprerjes së aktivitetit në të gjithë instalimin apo në pjesë të ndryshme të tij, duke përfshirë masat për menaxhimin e mbetjeve të mundshme ndotëse pas mbylljes së instalimit.
Nga verifikimi i respektimit të afateve në kryerjen e procedurës nga AKM janë zbatuar afatet e përcaktuara në pikën 2–10, kreu III, të VKM-së nr. 419, datë 25.06.2014, *"Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja"*.
Komisioni i shqyrtimit të kërkesës: znj. A. D, znj. M. P, z. N. P, znj. A. P, znj. J. M, z. O. Dh, znj. K. S, z. A. D, znj. E. Sh.

2. Subjekti "T. O. S" me Nipt L.....I
Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikës së lejes mjedisore konstatohet se
- në kërkesën për leje mjedisi tipi A sipas shtojcës 1, pika 5.2 *"Menaxhimi i mbetjeve të ngurta"*, nuk është plotësuar tabela 5.2.1 *"Mbi rikuperimin/asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme*" por është bërë shënimi: *"Nga zhvillimi i këtij aktiviteti nuk kemi gjenerim mbetjesh, pas rafinimit nafta ndahet nga uji, pa krijuar mbetje llumrash, ujë pasi është ndarë nafta ripërdoret përsëri si ujë teknologjik duke u injektuar në puse".*
*Grupi i auditimit verifikoi n*ë sistemin e-inspektime një nga çështjet e inspektimit të këtij, subjekti mbi ketë leje mjedisore, konkretisht çështjen me nr. AKM-FR-2024-000261, nga ku rezultoi se në menunë "*Dokumente*" rezulton dokumenti *"Zbatim i kushteve 3-mujore qershor 2024-shtator 2024*", në të cilën raportohet mbi zbatimin e kushteve 3-mujore të lejes mjedisore me PN-1718-03-2023, numër identifikimi të lejes 4431. Në pikën 7 të këtij dokumenti, faqe 29 citohet se: "…subjekti gjeneron mbetje të rrezikshme me kod nr. 01 05 05*[6], nr. *01 05 06, nr. 13 05 02* , nr. 13 05 07*, nr. 16 03 03*, nr. 16 03 05*, nr. 16 07 08*, nr. 16 07 09*, nr. 17 01 06*, nr. 19 13 01* etj.*
Në lidhje me këto mbetje në metodën e asgjësimit, trajtimit në vendndodhje subjekti citon se*: "Grumbullim, transportim dhe asgjësim përfundimtar nga subjekte të licensuara".*
Por nga auditimi konstatohet se në faqen 29 të raportit të vetë monitorimit të subjektit, citohet gjithashtu se: "*Për këtë periudhë mbetjet e gjeneruara janë në sasi të pakët dhe janë grumbulluar në një vend të posaçëm sipas llojit, pasi subjekti T. S. është në proces diskutimesh për të finalizuar kontratat për menaxhimin e mbetjeve që gjeneron*". Pra subjekti nuk ka disponuar kontratë për menaxhimin e mbetjeve edhe pas pajisjes me leje mjedisore në kushtet e zhvillimit të aktivitetit në kundërshtim me pikën 9/e, kreu II, të VKM-së nr. 419, datë 25.06.2014 "*Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja*".
Në Shtojcën 1, të VKM së sipërcituar për plotësimin e tabelës 5.2.1, e cila në aplikim nuk rezulton të jetë plotësuar, citohet se: "...të sigurojë menaxhimin e duhur të mbetjeve të gjeneruara nga 1instalimi" dhe shtojcën 1 pika 5.2 ku citohet: *"Për secilën tipologji mbetjesh, përkatësisht për mbetjet e rrezikshme dhe mbetjet jo të rrezikshme, duhet të jepet si informacion plotësues, detaje mbi nr. e regjistrimit të licensës /lejes së grumbullimit të mbetjeve të operatorit si dhe detaje të*

[6] **01 05 05 ***- Baltë dhe mbetje të tjera nga shpimet për naftë hidrokarbure, sipas Vendimit nr. 402, datë 30.6.2021 *"Për miratimin e katalogut të mbetjeve"*

operatorit me të cilin është nënshkruar kontrata për rikuperimin /asgjësimin e mbetjeve ose datën e përfundimit të afatit të lejeve. Nga ana tjetër nga ana e subjektit deklarohet se nga kjo veprimtari nuk gjenerohen mbetje të rrezikshme. Për sa kohë në raportin e vetë monitorimit janë evidentuar mbetje të rrezikshme, konstatohet se aplikimi i subjektit për aplikimin për leje tipi A, nuk është plotë dhe duhet të ishte refuzuar".

Për shkak të mosdeklarimit të saktë të gjenerimit të mbetjeve të rrezikshme dhe mungesës së informacionit mbi menaxhimin e tyre (licenca dhe kontrata me operatorë të autorizuar), aplikimi për leje mjedisi tipi A rezulton i paplotë. Konstatohet se nga ana e ana e autoritetit kompetent nuk është kryer refuzimi.

- Në pikën 6 "*Shkarkimi në ajër*", tabela nr. 6.1.3 "*Shkarkimet kryesore në ajër"* nuk është plotësuar plotësisht, pasi mungojnë të dhëna mbi numrat referues të pikave të shkarkimit, duke kufizuar identifikimin dhe gjurmueshmërinë e burimeve të emetimeve.
- Nuk rezulton e plotësuar tabela nr. 6.1.4 "*Shkarkimet kryesore në ajër*", e cila duhet të përmbajë informacion mbi burimet e vogla dhe të mundshme të shkarkimeve, si dhe të dhëna teknike mbi lartësinë e pikave të shkarkimit, rrjedhjet dhe presionin, në kundërshtim me kërkesat e Shtojcës 1 të VKM nr. 419, datë 25.06.2014.
- Nga verifikimi i respektimit të afateve procedurale nga AKM rezulton se këto afate janë zbatuar në përputhje me pikat 2–10, Kreu III, të VKM nr. 419, datë 25.06.2014.
- Sipas procesverbalit nr. 2847/1, datë 12.04.2023, në lidhje me vendimmarrjen e Komisionit nr. 37, evidentohet se në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti nuk janë konstatuar mangësi dhe si rrjedhojë është miratuar kërkesa për leje mjedisi tipi A. Megjithatë, nga verifikimi në databazën zyrtare të AKM [7]rezulton se aktmiratimi i lejes mjedisore mban datën 27.03.2023 dhe i përket Komisionit nr. 33, duke evidentuar mospërputhje ndërmjet procesverbalit dhe të dhënave zyrtare të publikuara. Kjo mospërputhje në të dhënat e vendimmarrjes cenon saktësinë dhe besueshmërinë e dokumentacionit administrativ, si dhe krijon pasiguri mbi gjurmueshmërinë e procesit vendimmarrës.

Subjekti	NUIS	Data Lejes	Nr. Prot	Rajoni	Tipi Lejes	Koordinatat	Komisioni
T. S. SH.A (LC – 9618)	L.....I	27.03.2023	2081	Fier	Tipi A	1 4391500 4500000 2 4386000 4500000 3 4386000 4508500 4 4391500 4508500	33

Burimi: AKM

Pra akti i miratimit është bërë përpara shqyrtimit të aplikimit për leje mjedisi tipi A nga ana e Komisionit.

Komisioni i shqyrtimit të kërkesës: znj. A. D, znj. M. P, z. N. P, znj. A. P, znj. J. M, z. O. Dh, znj. K. S.

3. Subjekti: "B. P. LTD" me Nipt: K.....L

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikës së lejes mjedisore konstatohet se:

- Në formularin e kërkesës për leje mjedisi tipi A, pika *"lëndët e para dhe materialet ndihmëse, materiale të tjera dhe energjia e përdorur ose e gjeneruar në impiant/instalim"*, tabela 4.1.1 nuk përmban kodet e riskut për secilën substancë të rrezikshme, në mospërputhje me Shtojcën 1, pika 4 të VKM nr. 419, datë 25.06.2014, ku citohet konkretisht: *"Vëmendje e veçantë duhet t'i*

[7] https://akm.gov.al/ova_doc/baza-e-te-dhenave-per-lejet-e-mjedisit-tipi-a-b-per-periudhen-janar-2014-korrik-2024/

kushtohet materialeve dhe produkteve që përbëhen nga/ose përmbajnë substanca të rrezikshme. Lista e mësipërme duhet të specifikojë Kodin e Riskut për secilën substancë sipas Skedës së të Dhënave të Sigurisë së Materialit (SDSM) të prodhuesit".
- Në *"Aneksin nr. 5"* nuk jepet informacion sipas përcaktimeve në Shtojcën 1 të VKM nr. 419, datë 25.06.2014, ku përcaktohet se: *"Të gjitha informacionet shtesë duhet t'i bashkëngjiten këtij formulari me emërtimin Aneksi 5. Në rast asgjësimi të mbetjeve, brenda instalimit/impiantit, duhet të jepet informacion i detajuar mbi vendin e asgjësimit duke përfshirë ndërmjet të tjerave procedurat në lidhje me zgjedhjen e vendit, hartat e vendit ku tregohen qartësisht zonat e mbrojtura ujore, kushtet gjeologjike dhe hidrologjike, planin e aktiviteteve, përbërjen e mbetjeve, menaxhimin e gazit dhe ujit të filtruar, së bashku me planin e menaxhimit të mbetjeve pas ndërprerjes së operacioneve në këtë vend"*.
- Në pikën *"Programi i përmirësimit"* konstatohet se mungojnë vlerësimet financiare përkatëse dhe tabela përkatëse, në kundërshtim me kërkesat e Shtojcës 1 të VKM nr. 419, datë 25.06.2014, e cila kërkon që programi të jetë i shoqëruar me elementë të plotë teknikë dhe financiarë për zbatimin e tij, si dhe të përfshijë informacionet e detajuara sipas kërkesave të sipërcituara për Aneksin 5.
Sa më sipër konstatohet se dokumentacioni i aplikimit rezulton i paplotë në elementë thelbësorë teknikë dhe informativë të kërkuar nga VKM nr. 419, datë 25.06.2014.
Nga verifikimi i respektimit të afateve në kryerjen e procedurës nga AKM janë zbatuar afatet e përcaktuara në pikën 2-10, kreu III, të VKM-së nr. 419, datë 25.06.2014 *"Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja.*
Komisioni i shqyrtimit të kërkesës: znj. A. D, znj. M. P, z. N. P, z. O. Dh, znj. E. M..

4. Subjekti "N dhe M" me Nipt K.....V
Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikës së lejes mjedisore konstatohet se:
- Në pikën 2 të aneksit të formularit *"Përshkrimi i instalimit, njësitë e tij teknike dhe aktivitetet/veprimtaritë e lidhura drejtpërdrejtë me të"*, kërkohet që të sigurohen kopje të planeve, skicave ose hartave (planet e terrenit dhe hartat e vendndodhjes, si dhe rrjedhat e procesit teknologjik në lidhje me operacionet e instalimit), ndërkohë konstatohet se këto skica nuk janë bashkëlidhur në Aneksin nr. 2, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 419, datë 25.06.2014.
- Në formularin e dorëzuar nga aplikuesi, në pikën *"Pronësia e impiantit"* kjo çështje është trajtuar në pikën 1.5, ndërkohë që sipas formatit tip të përcaktuar në VKM nr. 419, datë 25.06.2014, kjo duhet të paraqitet në pikën 1.4, duke evidencuar mosrespektim të strukturës standarde të formularit të aplikimit.
- Në pikën *"Programi i përmirësimit"* konstatohet se programi i paraqitur nuk është në përputhje me kërkesat e VKM nr. 419, datë 25.06.2014, pasi aktivitetet e përfshira (blerja e uniformave për punonjësit dhe blerja e makinerive) nuk lidhen drejtpërdrejt me përmirësimin e performancës mjedisore të instalimit, si dhe mungojnë elementë thelbësorë si: masat konkrete për reduktimin e shkarkimeve, rritjen e eficencës së energjisë dhe përdorimit të burimeve, afatet e zbatimit dhe vlerësimet financiare përkatëse për secilën masë.
Sa më sipër konstatohet se dokumentacioni i aplikimit rezulton i paplotë dhe jo plotësisht në përputhje me kërkesat formale dhe përmbajtësore të përcaktuara në VKM nr. 419, datë 25.06.2014.
Nga verifikimi i respektimit të afateve në kryerjen e procedurës nga AKM janë zbatuar afatet e përcaktuara në pikën 2-10, kreu III, të VKM-së nr. 419, datë 25.06.2014.

Komisioni i shqyrtimit të kërkesës: znj. A. D, znj. M. P, z. N. P, z. O. Dhima, znj. E. M.

5. Subjekti "G" me Nipt L.....B

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikës së lejes mjedisore konstatohet se:

- Në pikën 2 të Aneksit 2 *"Përshkrimi i instalimit, njësitë e tij teknike dhe aktivitetet/veprimtaritë e lidhura drejtpërdrejtë me të"*, ku përcaktohet se: *"Siguroni kopje të planeve, skicave ose hartave (planet e terrenit dhe hartat e vendndodhjes, rrjedhat e procesit teknologjik në lidhje me operacionet e instalimit) dhe detaje të tjera të nevojshme për të përshkruar të gjitha aspektet e aktiviteteve të instalimit"*, konstatohet se subjekti nuk ka paraqitur hartat e vendndodhjes dhe rrjedhat e procesit teknologjik, por vetëm fotografi të vendit dhe të pajisjeve si dhe skica të pjesshme, duke mos përmbushur kërkesat për dokumentacionin teknik të instalimit, në kundërshtim me VKM nr. 419, datë 25.06.2014.
- Nga verifikimi i plan projektit *"Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin"* rezulton se dokumenti mban datën 08.06.2018 sipas nënshkrimit elektronik, pra rreth 5 vite para paraqitjes së kërkesës për pajisje me leje mjedisore të tipit B, çka tregon përdorimin e një dokumentacioni të papërditësuar dhe jo në përputhje me gjendjen aktuale të instalimit në momentin e aplikimit.
- Pavarësisht mangësive të mësipërme në dokumentacionin teknik dhe përditësimin e tij, sipas procesverbalit nr. 10472/1, prot., datë 09.10.2024, në lidhje me vendimmarrjen e Komisionit nr. 72, evidentohet se në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti nuk janë konstatuar mangësi dhe është miratuar kërkesa për pajisje me leje mjedisore të tipit B, duke reflektuar një vlerësim jo të plotë të dokumentacionit nga autoriteti kompetent.
-Dokumentacioni i aplikimit rezulton i paplotë dhe jo në përputhje me kërkesat përmbajtësore dhe teknike të përcaktuara në VKM nr. 419, datë 25.06.2014.

Komisioni i shqyrtimit të kërkesës: znj. A. D, znj. M. P, z. N. P, znj. A. Z, z. O. Dh, z. P. M,, znj. E. M, z. E. B.

6. Subjekti "V. C" shpk me Nipt L.....U

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikës së lejes mjedisore konstatohet se:

- Në pikën 2 të Aneksit 2 *"Përshkrimi i instalimit, njësitë e tij teknike dhe aktivitetet/veprimtaritë e lidhura drejtpërdrejtë me të"*, ku përcaktohet se: *"Siguroni kopje të planeve, skicave ose hartave (planet e terrenit dhe hartat e vendndodhjes, rrjedhat e procesit teknologjik në lidhje me operacionet e instalimit) dhe detaje të tjera të nevojshme për të përshkruar të gjitha aspektet e aktiviteteve të instalimit"*, rezulton se subjekti nuk ka paraqitur hartat e vendndodhjes dhe rrjedhat e procesit teknologjik, por vetëm fotografi të vendit dhe të pajisjeve si dhe skica të pjesshme, duke mos përmbushur kërkesat për dokumentacionin teknik të instalimit, në kundërshtim me VKM nr. 419, datë 25.06.2014.
- Nga verifikimi i plan projektit *"Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin"* rezulton se dokumenti mban datën 08.06.2018 sipas nënshkrimit elektronik, pra rreth 5 vite para paraqitjes së kërkesës për pajisje me leje mjedisore të tipit B, çka nuk siguron përditësimin e dokumentacionit teknik në raport me kohën e aplikimit dhe gjendjen aktuale të instalimit.
- Pavarësisht mangësive të konstatuara në dokumentacionin teknik, sipas procesverbalit nr. 10472/1, prot., datë 09.10.2024, në lidhje me vendimmarrjen e Komisionit nr. 72, evidentohet se në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti nuk janë konstatuar mangësi dhe, për rrjedhojë, është miratuar kërkesa për pajisje me leje mjedisore të tipit B, duke reflektuar një vlerësim jo të plotë të dokumentacionit nga autoriteti kompetent.

Sa më sipër kosntatohet se dokumentacioni i aplikimit rezulton i paplotë dhe jo në përputhje me kërkesat përmbajtësore dhe teknike të përcaktuara në VKM nr. 419, datë 25.06.2014.

Nga verifikimi i respektimit të afateve procedurale nga AKM rezultoi se procedura e shqyrtimit të aplikimit është kryer në përputhje me afatet e përcaktuara në pikat 2–10, Kreu III, të VKM nr. 419, datë 25.06.2014.
Komisioni i shqyrtimit të kërkesës: znj. A. D, znj. M. P, z. N. P, znj. A. Z. Z. O. Dh, znj. E. Sh, z. G. H, z. A. D.

7. Subjekti "B. A" shpk me Nipt L.....G
Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikës së lejes mjedisore konstatohet se:
- Në tabelën 4.1.1 *"Detaje mbi lëndët e para, materialet e ndërmjetme, produktet etj., që lidhen me proceset dhe përdoren apo gjenerohen në impiant/instalim"* nuk janë të plotësuara kodet përkatëse për lëndët e para, konkretisht Kodi i riskut R dhe Kodi i sigurisë S, në kundërshtim me kërkesat e Shtojcës 1 të VKM nr. 419, datë 25.06.2014.
- Në tabelën 5.2.1 *"Mbetjet-Rikuperimi/Asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme (që janë aktualisht në leje)"* nuk janë të përcaktuara sasitë përkatëse të mbetjeve, volumi në ton dhe në metra kub, në mospërputhje me pikën 5.2 të Shtojcës 1 të VKM nr. 419, datë 25.06.2014.
- Në tabelën 5.2.2 *"Rikuperimi/Asgjësimi i mbetjeve jo të rrezikshme (që janë aktualisht në leje)"* nuk janë të përcaktuara sasitë përkatëse të mbetjeve, volumi në ton dhe në metra kub, në mospërputhje me pikën 5.2 të Shtojcës 1 të VKM nr. 419, datë 25.06.2014.
- Nga auditimi konstatohet se mungon origjinali ose fotokopje e noteruar e aktit të regjistrimit të subjektit në regjistrin tregtar, në kundërshtim me pikën 1.1 të Udhëzimit nr. 3, datë 02.12.2013, ku citohet: *"Për t'u pajisur me leje mjedisore të tipit A dhe B për aktivitete të reja… dokumentacioni ligjor që përbëhet nga: origjinali ose fotokopje e noteruar e aktit të regjistrimit të subjektit në regjistrin tregtar"*.
- Në dokumentacionin e aplikuesit mungon *"Plani i propozuar për mbylljen e impiantit dhe procedurat e kujdesit pas mbylljes"*, si dhe *"Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis"*, në mospërputhje me Kreun V, pika *"e, ë"* të VKM nr. 452, datë 11.07.2012 *"Për landfillet e mbetjeve"*, i ndryshuar.
Nga verifikimi i respektimit të afateve në kryerjen e procedurës nga AKM rezulton se janë zbatuar afatet e përcaktuara në pikat 2–10, Kreu III, të VKM-së nr. 419, datë 25.06.2014.
Komisioni i shqyrtimit të kërkesës: znj. A. D, znj. M. P, z. N. P, znj. A. P, znj. A.Z, z. O. Dh, znj. E. Z, znj. E. M, z. G. H, z. A. D.

8. "B. D" sh.p.k me Nipt K.....O
Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikës së lejes mjedisore konstatohet se:
- Në pikën *"Menaxhimi i materialeve"*, në aneksin përkatës, subjekti ka deklaruar se ka nënshkruar kontratë për evadimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore me subjektin "*V. R*" SHPK, por dokumentacioni bashkëlidhur nuk përmban afatin e përfundimit të kësaj kontrate, duke mos siguruar informacion të plotë mbi vlefshmërinë dhe vazhdimësinë e marrëdhënies kontraktore për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme, në kundërshtim me kërkesat për dokumentim të plotë sipas Shtojcës 1 të VKM nr. 419, datë 25.06.2014. Mungesa e përcaktimit të afatit të kontratës cenon mundësinë për të verifikuar nëse subjekti ka garantuar në mënyrë të vazhdueshme menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme për periudhën e ushtrimit të aktivitetit, duke krijuar pasiguri mbi përputhshmërinë me kërkesat ligjore për trajtimin e këtyre mbetjeve. Pavarësisht mangësisë së konstatuar në dokumentacionin e aplikimit, nga verifikimi rezulton se janë respektuar afatet procedurale të përcaktuara në pikat 2–10, Kreu III, të VKM nr. 419, datë 25.06.2014.
Komisioni i shqyrtimit të kërkesës: znj. A. D, znj. M. P, z. N.P, znj. A. K, z. O. Dh, znj. A. F,, znj. E. M, z. M. Gj.

9. “I. C” sh.p.k me Nipt K.....W

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikës së lejes mjedisore konstatohet se:

- Në dokumentacionin e aplikimit mungon ekstrakti i regjistrimit të subjektit në regjistrin tregtar, në kundërshtim me kërkesat për dokumentacion ligjor të plotë sipas VKM nr. 419, datë 25.06.2014;
- Mungon *“procesverbali i komisionit”* dhe *“akti i miratimit”*, në kundërshtim me pikën 1, të Kreut III, të VKM nr. 419, datë 25.06.2014;

Komisioni i shqyrtimit të kërkesës: znj. A. D, znj. M. P, z. N.P, z. O. Dh, z. D. Sh, znj. E. M,, z. E. B.

10. “Ŵ” sh.p.k me Nipt M.....N

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikës së lejes mjedisore konstatohet se:

- Mungon kontrata e huapërdorimit, sipas neneve 901 e vijim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, ndërmjet pronarit të pasurisë me nr. 111/2026 në zonën kadastrale 2625 Tiranë Mazrek dhe subjektit, ndërkohë që certifikata e pronësisë rezulton në emër të ortakut z. E. K, duke mos provuar të drejtën e përdorimit të pasurisë nga subjekti për ushtrimin e aktivitetit.
- Në tabelën 6.1.3 *“Shkarkimet kryesore në ajër-karakteristikat e shkarkimeve”* mungojnë detaje në lidhje me shkarkimet, konkretisht nuk janë përcaktuar vlerat maksimale të shkarkimeve për çdo substancë, në kundërshtim me kërkesat e Shtojcës 1 të VKM nr. 419, datë 25.06.2014.
- Dokumentacioni i aplikimit rezulton i paplotë në elementë thelbësorë teknikë dhe ligjorë, duke mos përmbushur kërkesat për një vlerësim të plotë dhe të saktë të ndikimit mjedisor dhe kushteve të ushtrimit të aktivitetit.

Komisioni i shqyrtimit të kërkesës: znj. A. D, znj. M. P, z. N. P, znj. A. P, znj, J. M, z. O. Dh, znj. E. Sh, znj. K. S, z. A. D.

Për problematikat e trajtuara më sipër, ngarkohen me përgjegjësi Titullari i AKM në cilësinë e Kryetarit të komisionit dhe anëtarë e komisioneve përkatëse.

Auditimi mbi tarifën vjetore të lejeve mjedisore

Tarifa e lejeve mjedisore përbën një detyrim financiar që lidhet me procesin e pajisjes dhe ushtrimit të aktivitetit nga subjektet që operojnë me ndikim në mjedis, dhe rregullohet nga kuadri ligjor dhe nënligjor në fuqi. Konkretisht, VKM nr. 417, datë 25.06.2014, *“Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit”*, përcakton tarifat që paguhen nga subjektet si në momentin e aplikimit për leje mjedisore, ashtu edhe detyrimin për pagesën e tarifës vjetore për instalimet që ushtrojnë veprimtari me ndikim në mjedis. Në zbatim të këtij vendimi, përveç tarifës fillestare për shqyrtimin e kërkesave për leje të tipit A, B dhe C apo për ndryshimin e kushteve të tyre, subjektet e pajisura me leje mjedisore kanë detyrimin të paguajnë një tarifë vjetore, e cila varion sipas kategorisë së instalimit, konkretisht: për tipin A në vlerën 10,000 lekë, për tipin B në vlerën 5,000 lekë dhe për tipin C në vlerën 2,000 lekë.

Gjatë periudhës objekt auditimi, konstatohet se kjo VKM ka pësuar ndryshime, konkretisht:

- në vitin 2023, me VKM nr. 462, datë 26.07.2023, ku në pikën 7 emërtimi *“Ministrisë së Mjedisit”* zëvendësohet me shprehjen *“... ministrisë përgjegjëse për mjedisin ...”*, duke përcaktuar se këto të ardhura administrohen në llogaritë e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.
- më tej, me ndryshimet ligjore të miratuara me Ligji nr. 108/2024, datë 07.10.2024, për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011, *“Për lejet e mjedisit”*, i ndryshuar, në nenin 25 përcaktohet se tarifat për lejet e mjedisit të tipave A dhe B paguhen në llogarinë AKM-së.

Gjithashtu, operatorët e këtyre instalimeve kanë detyrimin të paguajnë çdo vit tarifën përkatëse në llogarinë e AKM-së, duke identifikuar numrin e lejes (PN-së) dhe duke depozituar një kopje të mandatit të pagesës pranë AKM-së dhe ARM- ve përkatëse.
Nga auditimi u konstatua se**,** AKM nuk disponon një databazë të plotë, të saktë dhe të unifikuar për pagesat e tarifave vjetore të lejeve mjedisore të tipit A dhe B, në të cilën të evidentohet lista e plotë e subjekteve debitorë dhe lista e plotë e subjekteve që kanë paguar tarifë, për PN-të përkatëse. Kjo databazë është kërkuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë fazës së auditimit në terren, por në dispozicion janë vënë versione të ndryshme, të pakonsoliduara ndërmjet tyre, të cilat, nga testimet e kryera nga grupi i auditimit, kanë rezultuar pasaktësi dhe mangësi në të dhëna, përfshirë:
- të dhëna të paplota;
- regjistrime të dubluara;
- mospërputhje me të dhënat e marra nga sektorë të tjerë;
- si dhe raste të identifikuara nga testimet në sistem, ku pagesa të kryera nuk rezultonin pjesë e listës së debitorëve, duke mos u përllogaritur në vlerën totale të pagesave të pakryera nga subjektet për llogari të AKM.

Grupi i auditimit, me qëllim identifikimin e listës së subjekteve debitorë dhe shumave përkatëse për mospagimin e tarifës vjetore, në kushtet e mungesës së një databaze të plotë dhe të unifikuar nga AKM, u mbështet në shqyrtimin e një dokumentacioni, alternativ të disponueshëm.
Konkretisht, nisur nga mungesa e këtyre të dhënave, u shyqrtuan shkresat e dërguara subjekteve debitore nga Drejtori i Përgjithshëm i AKM-së, me datë 21.01.2026, në lidhje me detyrimet për pagesën e tarifave vjetore që i përkasin periudhës deri më 31.12.2025. Nga përpunimi i databazës së këtyre shkresave u identifikuan subjektet ndaj të cilave janë adresuar kërkesa për shlyerjen e detyrimeve, si dhe u evidentua numri dhe data e shkresës përkatëse, së bashku me shumën e detyrimit, nga ku rezultoi si më poshtë:
- 748 shkresa të drejtuara në lidhje me pagesën e detyrimeve;
- Shuma totale e detyrimit, sipas shkresave të dërguara është 12,640,000 lekë;
- Pas dërgimit të shkresave është likuiduar shuma 1,235,000 lekë.

Grupi i auditimit pas shqyrtimit të databazës, për këto shkresa evidentoi se:

- Nga lista totale me 748 nipte, 666 raste janë unike, pra 82 raste janë subjekte të cilat janë paraqitur në tabelë më shumë se një herë, ç'ka tregon mungesë kontrolli mbi cilësinë e të dhënave dhe rrezik për raportim jo të saktë dhe databaza nuk përfaqëson gjendjen reale të debitorëve, ka regjistrim të dyfishtë të detyrimeve dhe raportim të pasaktë të shumës totale.

Nr.	Nipti	Numri i herëve që shfaqet
1	J********H	3
2	J********H	2
3	J********U	2
4	J********M	2
5	J********A	2
6	J********D	2
7	J********R	2
8	K********J	2
9	K********C	2
10	K********B	2
11	K********D	2
12	K********U	2
13	K********G	2
14	K********Q	2
15	K********U	3
16	K********U	2
17	K********S	2
18	K********T	2
19	K********L	2
20	K********O	2
21	K********S	2

22	K********J	2
23	K********U	2
24	K********A	2
25	K********V	2
26	L********V	2
27	L********A	2
28	L********I	2
29	L********J	2
30	L********U	2
31	L********H	2
32	L********F	2
33	L********B	2
34	L********A	2
35	L********N	2
36	L********R	2
37	L********I	2
38	L********N	2
39	M********P	2
40	M********R	2
41	M********D	2
42	M********U	2
43	M********M	2
44	M********U	2
45	M********R	2
Totali		**92**

Burimi: *AKM, përpunuar nga grupi i auditimit*

Në përputhje me pikën 3 të nenit 25, të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 *"Për lejet e mjedisit*", i ndryshuar, përcakton se: "*Operatorët e instalimeve të tipave A dhe B paguajnë çdo vit një tarifë vjetore në llogarinë e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit[8], duke u identifikuar nëpërmjet numrit të lejes (PN-së) përkatëse, duke përcjellë gjithmonë një kopje të mandatit të pagesës pranë AKM-së dhe ARM-së ku ndodhet instalimi*". Po ashtu, gërmës "c" të pikës 1/1 të nenit 27 përcaktohet se; "*1. Ministri, me propozim të AKM-së, për lejet e mjedisit të tipave A dhe B, pezullon ose shfuqizon lejen e mjedisit kur: 1/1. Në rast pezullimi: c) mbajtësi i lejes nuk ka paguar tarifën e lejes së mjedisit dhe/apo gjobat administrative të vëna në bazë të këtij ligji apo të çdo akti tjetër normativ mjedisor",* ndërsa sipas gërmës "d", të pikës ½, të nenit 27 leja mund të shfuqizohet në rast se këto detyrime nuk paguhen brenda afatit të pezullimit. Në këto kushte, administrimi i saktë dhe i plotë i të dhënave mbi pagesën e tarifës vjetore të lejes mjedisore paraqet rëndësi thelbësore për identifikimin e subjekteve debitorë, ndjekjen e detyrimeve ligjore dhe marrjen në kohë të masave administrative nga institucioni përgjegjës. Mungesa e një databaze të plotë dhe të besueshme mbi lejet aktive dhe mbi detyrimet e tyre financiare nga ana e AKM-së krijon risk për mosidentifikimin e saktë të debitorëve, nënvlerësimin e vlerës reale të detyrimeve dhe dobësimin e mekanizmave të kontrollit për zbatimin e kushteve të lejes mjedisore

Për sa më sipër, grupi i auditimit shprehet me rezerva në lidhje me numrin total të subjekteve dhe vlerën totale të detyrimit, për pagesën e tarifës vjetore të lejes vjetore, duke marrë në konsideratë dhe faktin që këta rezultojnë debitorë të identifikuar vetëm nëpërmjet shkresave komunikuese (të njëanshme, pra të dërguara nga AKM) me subjektet. Duke qenë se AKM nuk disponon një databazë të konsoliduar dhe të përditësuar për secilën leje aktive, ekziston risku që ky numër dhe kjo vlerë të jetë e nënvlerësuar.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: Titullari i AKM: znj. A. D*; Drejtor Finance dhe Shërbimeve Mbështetëse:* znj. N. N dhe znj. E. O*; Përgjegjës Finance:* N. N, znj. F. M, Përgjegjës Finance; *sipas periudhave që kanë mbuluar në pozicionet përkatëse.*

[8] Sipas ndryshimit më të fundit të ligjit nr. 10448/2011 (datë 19.11.2024), pranë llogarisë së AKM, më parë në llogari të Ministrisë përgjegjesë, trajtuar dhe më sipër në material.

Mbi auditimin e raporteve të vetë monitorimit, Sektori i Monitorimit të Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve.

Sektori i Monitorimit të Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve, pranë AKM-së, ushtron funksionin e shqyrtimit të raporteve mjedisore të vetëmonitorimit, në funksion të verifikimit të zbatimit të kushteve të lejeve mjedisore dhe akteve përkatëse të VNM-së, mbi të cilat subjektet e pajisura kanë detyrimin për raportim periodik. Dorëzimi dhe shqyrtimi i këtyre raporteve kryhet në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentacionin mjedisor, si dhe në zbatim të Urdhrit nr. 92, datë 02.05.2024, *"Për procedurën e dorëzimit/pranimit të dokumenteve dhe raporteve të vetëmonitorimit, për subjektet e pajisura me vendim për VNM Paraprake / Deklaratë Mjedisore / Leje Mjedisi të tipit A ose B"*. Sipas këtij urdhri, operatorët kanë detyrimin të dorëzojnë dokumentacionin dhe raportet përkatëse brenda 15 ditëve nga data e miratuar e lejes, në varësi të tipit (A ose B). Në rastet kur raportet nuk janë në përputhje me kërkesat ose kur konstatohet mosraportim, subjektet duhet të njoftohen për mangësitë e evidentuara dhe detyrimin për plotësimin e tyre.

Në zbatim të Rregullores së Brendshme, fusha e veprimtarisë së sektorit përfshin:

- administrimin dhe grumbullimin e të dhënave të dorëzuara nga personat fizikë dhe juridikë, subjekt i lejeve mjedisore;
- ndjekjen e përditësimit të të dhënave në databazën përkatëse mbi dokumentacionin e dorëzuar;
- bashkëpunimin me sektorët e tjerë të drejtorisë në funksion të hartimit të planeve të inspektimit.

Sektori analizon raportet e vetëmonitorimit mbi bazën e kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi, përfshirë Ligji nr. 9024, datë 06.03.2003, *"Për akreditimin e laboratorëve testues kalibrues, organizmave certifikues dhe inspektues në Republikën e Shqipërisë"*, VKM nr. 435, datë 12.09.2002, *"Për normat e shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë"*, VKM nr. 1189, datë 18.11.2009, *"Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit"*, VKM nr. 177, datë 31.03.2005, *"Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse"*, si dhe Udhëzimit nr. 8, datë 27.11.2007, *"Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara"*.

Nga të dhënat e dërguara me email-in e datës 12.02.2026 nga Sektori i Monitorimit, në lidhje me subjektet që kanë dorëzuar ose jo raportet e vetëmonitorimit, rezulton si më poshtë:

Viti	Leje A	Subjektet që kanë dorëzuar	Subjektet që nuk kanë dorëzuar
2023	104	95	9
2024	106	84	22
2025	106	91	15

Viti	Leje B	Subjektet që kanë dorëzuar	Subjektet që nuk kanë dorëzuar
2023	3202	3026	176
2024	3219	3014	205
2025	3396	2783	613

Burimi: AKM

Nga auditimi u konstatua se, për periudhën objekt auditimi, të dhënat janë administruar dhe hedhur manualisht në format Excel të paunifikuara ndërmjet sektorëve të AKM-së duke reflektuar informacion që nuk përmbush kriteret minimale për një sistem monitorimi të gjurmueshëm, të plotë dhe të besueshëm.

Gjithashtu, databazat e administruara nuk përmbajnë një sërë fushash bazë të domosdoshme për ndjekjen efektive të detyrimeve ligjore nga subjektet. Në veçanti, konstatohet mungesa e të dhënave mbi afatin e raportimit për secilin subjekt, çka e bën të pamundur verifikimin nga grupi i auditimit nëse raportimet janë kryer brenda afatit, me vonesë apo nuk janë kryer fare.Kjo mangësi krijon një boshllëk të konsiderueshëm në evidentimin e nivelit të përputhshmërisë së subjekteve me detyrimet ligjore të monitorimit dhe cënon aftësinë e institucionit për të kryer një analizë të saktë të riskut. Si pasojë, ekziston rreziku që të mos planifikohen në mënyrë të duhur inspektime

ndaj subjekteve që nuk kanë paraqitur raportet përkatëse të vetë monitorimit dhe që potencialisht përfaqësojnë një nivel të lartë risku.
Mungesa e këtyre elementeve penalizon drejtpërdrejtë procesin e monitorimit, dobëson mekanizmat e kontrollit dhe riskon integritetin e procesit të vendimmarrjes, i cili mbështetet në plotësinë, saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave të regjistruara. Diferenca në evidentimin e lejeve mjedisore aktive ndërmjet dy sektorëve, atë të lejeve mjedisore dhe monitorimeve, ka sjellë si pasojë mos evidentimin e saktë të detyrimeve të lindura, por edhe risk të lartë në planifikimin e inspektimeve nga Drejtoria e Inspektimit e Kontrollit. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar, në nenin 23 "Menaxhimi i informacionit" dhe neni 29 "Kundërvajtjet" pika 2, ku përcaktohet: "*Informacioni që i jepet Agjencisë Kombëtare të Mjedisit nga operatori i një veprimtarie, subjekt i këtij ligji, nëpërmjet procesit të vetë monitorimit, mund të përdoret për të vërtetuar përgjegjësinë penale apo administrative të atij operatori apo çdo personi tjetër në një çështje gjyqësore*".
Sa më sipër, mungon informacioni mbi masat administrative të marra në rast vonese ose mos raportimi, siç parashikohet nga kuadri ligjor dhe nënligjor. Kjo mungesë ngre dyshime të arsyeshme mbi funksionimin e mekanizmit të ndjekjes së rasteve të shkeljes dhe krijon pamundësi për të verifikuar nëse institucioni ka ndërhyrë në mënyrë të njëtrajtshme, të drejtë dhe në kohë në rastet problematike.
Informacioni është i pakoordinuar, i pa strukturuar dhe pa standardizim mes tipeve të lejeve. Kjo e bën të vështirë, dhe në disa raste të pamundur, krahasimin e të dhënave mes subjekteve apo brenda sektorëve të njëjtë. Formati aktual i mbajtjes së të dhënave nuk përfshin asnjë mekanizëm sinjalizimi për afatet e raportimit, nuk mundëson ndjekjen e statusit të raporteve dhe nuk gjeneron tregues analitikë që të ndihmojnë vendimmarrjen.
Nga një analizë më e thelluar rezultoi se mungesat e evidentuara nuk përbëjnë vetëm problematika teknike, por paraqesin risqe të konsiderueshme për institucionin**,** të cilat mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e politikave mjedisore dhe në performancën e detyrave ligjore.
Konkretisht, mungesa e dokumentimit të plotë krijon risk për:
- identifikimin e subjekteve të pajisur rishtazi me leje mjedisore (operatorët duhet të dorëzojnë dokumentacionin dhe raportet brenda 15 ditëve nga data e miratuar e lejes).
- mosrespektimin e afateve ligjore nga subjektet, për shkak se institucionet nuk disponojnë informacion të saktë mbi momentin kur duhet të ndërhyjnë;
- moszbatimin e masave administrative, pasi nuk dokumentohet nëse ato janë marrë apo jo;
- trajtim të pabarabartë të subjekteve**,** për shkak të mungesës së gjurmueshmërisë së vendimmarrjes ose të praktikave të ndjekjes;
- gabime në raportimin e të dhënave;
- risk të shtuar në procesin e planifikimit të inspektimeve;
- deformim të vlerësimeve të riskut mjedisor, duke qenë se informacioni i përdorur për analizë është i fragmentuar dhe jo i verifikueshëm;
- risk të drejtpërdrejtë për mjedisin, nëse subjekte me ngarkesë të lartë ndotëse nuk monitorohen në kohë si pasojë e mungesës së të dhënave kritike.
Për më tepër, auditimi evidentoi se mungesa e këtyre fushave thelbësore në databaza kufizon ndjeshëm aftësinë e institucionit për të hartuar raporte periodike të plota dhe të besueshme, të cilat janë të domosdoshme për një proces efektiv monitorimi, për kryerjen e analizave sektoriale dhe për mbështetjen e planifikimit strategjik. Në kushtet kur të dhënat nuk janë të strukturuara dhe nuk përfshijnë elementë kyç, si afatet e raportimit dhe statusin e përmbushjes së detyrimeve, raportet e përgatitura nuk pasqyrojnë në mënyrë të saktë situatën reale të subjekteve të monitoruara. Kjo situatë përbën një dobësi thelbësore institucionale, pasi procesi i vendimmarrjes zhvillohet mbi

baza të pjesshme, të pa standardizuara dhe të pamjaftueshme, duke mos u mbështetur në evidenca të plota, të sakta dhe të krahasueshme në kohë.
Si përfundim, databazat e dorëzuara nuk sigurojnë një pasqyrë të plotë, të integruar dhe të besueshme të procesit të monitorimit dhe, për rrjedhojë, nuk përmbushin funksionin e tyre si instrument bazë për ndjekjen e detyrimeve ligjore, vlerësimin e riskut dhe mbështetjen e vendimmarrjes institucionale. Mungesat e evidentuara në strukturën dhe përmbajtjen e të dhënave kompromet ojnë efektivitetin e procesit të monitorimit dhe kufizojnë ndjeshëm aftësinë e institucionit për të ushtruar në mënyrë të plotë dhe të qëndrueshme funksionet e tij mbikëqyrëse dhe kontrolluese.
Për periudhën objekt auditimi konstatohet se ekzistojnë raste kur në AKM janë depozituar raporte vetëmonitorimi të paplota. Në këto raste, AKM, në zbatim të Urdhrit nr. 126, datë 10.06.2022, *"Për procedurën e dorëzimit/pranimit të dokumenteve dhe raporteve të vetëmonitorimit për subjektet e pajisura me Leje Mjedisi të tipit A dhe B"*, ka njoftuar operatorët e veprimtarive, në rrugë shkresore, lidhur me mangësitë e konstatuara në raportet e vetëmonitorimit.
Nga auditimi i komunikimeve shkresore të vendosura në dispozicion konstatohet se nuk disponohet një evidencë e strukturuar dhe e unifikuar e problematikave të konstatuara sipas periudhës objekt auditimi dhe për çdo subjekt më vete, e cila të pasqyrojë në mënyrë të plotë mangësitë dhe ndjekjen e tyre. Për këtë arsye, grupi i auditimit kërkoi nga sektori përkatës evidentimin e problematikave të identifikuara në raportet e vetëmonitorimit, si dhe masat e marra në lidhje me to. Nga informacioni i vënë në dispozicion rezulton se problematikat e konstatuara dhe masat e ndërmarra nga sektori (kryesisht përmes dërgimit të shkresave njoftuese) paraqiten si më poshtë:

1. **Mosdorëzim i dokumentacionit të kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të Lejes Mjedisore (56 raste):**

- Subjekti "*P-O*", me PN-0927-02-2022, njoftuar me shkresën nr. 6384, prot., datë 16.08.2023 për mos dorëzim dokumentacioni të kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti "*K- A*", me PN-1570-12-2022, njoftuar me shkresën nr. 6383, prot., datë 16.08.2023 për mos dorëzim dokumentacioni të kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti "*S*", me PN-1166-04-2022, njoftuar me shkresën nr. 6382, prot., datë 16.08.2023 për mos dorëzim dokumentacioni të kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti "*S*", me PN-1048-03-2022, njoftuar me shkresën nr. 6381, prot., datë 16.08.2023 për mos dorëzim dokumentacioni të kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti "*S*", me PN-1049-03-2022, njoftuar me shkresën nr. 6380, prot., datë 16.08.2023 për mos dorëzim dokumentacioni të kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti "*SH-G*", me PN-1048-03-2022, njoftuar me shkresën nr. 6379, prot., datë 16.08.2023 për mos dorëzim dokumentacioni të kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti "*XH. M. A*", me PN-1163-04-2022, njoftuar me shkresën nr. 6378, prot., datë 16.08.2023 për mos dorëzim dokumentacioni të kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti "*O. O*", me PN-1489-11-2022, njoftuar me shkresën nr. 6377, prot., datë 16.08.2023 për mos dorëzim dokumentacioni të kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti "*B.P.P*", me PN-1313-07-2022, njoftuar me shkresën nr. 6376, prot., datë 16.08.2023 për mos dorëzim dokumentacioni të kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti "*A*", me PN-1308-07-2022, njoftuar me shkresën nr. 6374, prot., datë 16.08.2023 për mos dorëzim dokumentacioni të kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti "*B. P. P*", me PN-1311-07-2022, njoftuar me shkresën nr. 6373, prot., datë 16.08.2023 për mos dorëzim dokumentacioni të kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.

- Subjekti “*D*”, me PN-0915-01-2022, njoftuar me shkresën nr. 6372, prot., datë 16.08.2023 për mos dorëzim dokumentacioni të kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti “*E-S*”, me PN-1162-04-2022, njoftuar me shkresën nr. 6371, prot., datë 16.08.2023 për mos dorëzim dokumentacioni të kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti “*D*”, me PN-1340-08-2022, njoftuar me shkresën nr. 6370, prot., datë 16.08.2023 për mos dorëzim dokumentacioni të kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti “*E*”, me PN-1532-11-2022, njoftuar me shkresën nr. 6368, prot., datë 16.08.2023 për mos dorëzim dokumentacioni të kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti “*L. C*”, me PN-1528-11-2022, njoftuar me shkresën nr. 6367, prot., datë 16.08.2023 për mos dorëzim dokumentacioni të kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti “*T. A. G*”, me PN-1211-05-2022, njoftuar me shkresën nr. 6366, prot., datë 16.08.2023 për mos dorëzim dokumentacioni e kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti “*G. GJ*”, me PN-1468-10-2022, njoftuar me shkresën nr. 6365, prot., datë 16.08.2023 për mos dorëzim dokumentacioni e kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti “*U. C*”, me PN-1544-12-2022, njoftuar me shkresën nr. 6364, prot., datë 16.08.2023 për mos dorëzim dokumentacioni e kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti “*M-O*”, me PN-1127-04-2022, njoftuar me shkresën nr. 6363, prot., datë 16.08.2023 për mos dorëzim dokumentacioni e kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti “*O*”, me PN-5658-08-2017, njoftuar me shkresën nr. 2684, prot., datë 05.03.2024 për mos dorëzim dokumentacioni e kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti “*SH. I. P. L*”, me PN-1993-07-2011, njoftuar me shkresën nr. 2683, prot., datë 05.03.2024 për mos dorëzim dokumentacioni e kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti “*A. O*”, me PN-7396-06-2014, njoftuar me shkresën nr. 2682, prot., datë 05.03.2024 për mos dorëzim dokumentacioni e kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti “*E.A*”, me PN-9081-01-2015, njoftuar me shkresën nr. 2680, prot., datë 05.03.2024 për mos dorëzim dokumentacioni e kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti “*E 3*”, me PN-6003-08-2013, njoftuar me shkresën nr. 2678, prot., datë 05.03.2024 për mos dorëzim dokumentacioni e kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti “*U. M. C*”, me PN-5422-07-2017, njoftuar me shkresën nr. 7623, prot., datë 18.07.2025 për mos dorëzim dokumentacioni e kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti “*U. L. P*”, me PN-4417-12-2016, njoftuar me shkresën nr. 7623, prot., datë 18.07.2025 për mos dorëzim dokumentacioni e kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti “*O*”, me PN-5658-08-2017, njoftuar me shkresën nr. 7610, prot., datë 18.07.2025 për mos dorëzim dokumentacioni e kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti “*N*”, me PN-0318-03-2021, njoftuar me shkresën nr. 7611, prot., datë 18.07.2025 për mos dorëzim dokumentacioni e kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti “*M P*”, me PN-0120-10-2020, njoftuar me shkresën nr. 7779, prot., datë 21.07.2025 për mos dorëzim dokumentacioni e kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti “*D. E. SH. S. G*”, me PN-2982-06-2016, njoftuar me shkresën nr. 7757, prot., datë 21.07.2025 për mos dorëzim dokumentacioni e kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti “*D. E. SH. S. D*”, me PN-5336-06-2017, njoftuar me shkresën nr. 7758, prot., datë 21.07.2025 për mos dorëzim dokumentacioni e kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.

- Subjekti “*D. E. SH. S. S*”, me PN-8389-04-2019, njoftuar me shkresën nr. 7760, prot., datë 21.07.2025 për mos dorëzim dokumentacioni e kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti “*D. E. SH. S. P*”, me PN-4122-11-2016, njoftuar me shkresën nr. 7759, prot., datë 21.07.2025 për mos dorëzim dokumentacioni e kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti “*D. E. SH. S. K*”, me PN-1762-01-2016, njoftuar me shkresën nr. 7758, prot., datë 21.07.2025 për mos dorëzim dokumentacioni e kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti “*D. E. SH. S. D*”, me PN-5915-10-2017, njoftuar me shkresën nr. 7755, prot., datë 21.07.2025 për mos dorëzim dokumentacioni e kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti “*A. S*”, me PN-5257-06-2017, njoftuar me shkresën nr. 13658, prot., datë 24.12.2024 për mos dorëzimin e raporteve të monitorimit për vitin 2024.
- Subjekti “*A-F*”, me PN-1191-05-2022, njoftuar me shkresën nr. 13659, prot., datë 24.12.2024 për mos dorëzimin e raporteve të monitorimit për vitin 2024.
- Subjekti “*A-R*”, me PN-2687-12-2011, njoftuar me shkresën nr. 13656, prot., datë 24.12.2024 për mos dorëzimin e raporteve të monitorimit për vitin 2024.
- Subjekti “*A*”, me PN-1810-06-2023, njoftuar me shkresën nr. 13657, prot., datë 24.12.2024 për mos dorëzimin e raporteve të monitorimit për vitin 2024.
- Subjekti “*A-S*”, me PN-0603-07-2015, njoftuar me shkresën nr. 13655, prot., datë 24.12.2024 për mos dorëzimin e raporteve të monitorimit për vitin 2024.
- Subjekti “*A-B*”, me PN-2760-05-2016, njoftuar me shkresën nr. 13654, prot., datë 24.12.2024 për mos dorëzimin e raporteve të monitorimit për vitin 2024.
- Subjekti “*P. A*”, me PN-1393-09-2022, njoftuar me shkresën nr. 13811, prot., datë 26.12.2024 për mos dorëzimin e raporteve të monitorimit për vitin 2024.
- Subjekti “*D. E. SH. S. D*”, me PN-5915-10-2017, njoftuar me shkresën nr. 13741, prot., datë 26.12.2024 për mos dorëzimin e raporteve të monitorimit për vitin 2024.
- Subjekti “*G. C. G*”, me PN-0748-08-2021, njoftuar me shkresën nr. 13739, prot., datë 26.12.2024 për mos dorëzimin e raporteve të monitorimit për vitin 2024.
- Subjekti “*G-07*”, me PN-0851-09-2015, njoftuar me shkresën nr. 13740, prot., datë 26.12.2024 për mos dorëzimin e raporteve të monitorimit për vitin 2024.
- Subjekti “*G. B*”, me PN-9215-02-2015, njoftuar me shkresën nr. 13738, prot., datë 24.12.2024 për mos dorëzimin e raporteve të monitorimit për vitin 2024.
- Subjekti “*H4 CH*”, me PN-1083-03-2022, njoftuar me shkresën nr. 13737, prot., datë 26.12.2024 për mos dorëzimin e raporteve të monitorimit për vitin 2024.
- Subjekti “*C & E*”, me PN-3589-08-2016, njoftuar me shkresën nr. 13752, prot., datë 26.12.2024 për mos dorëzimin e raporteve të monitorimit për vitin 2024.
- Subjekti “*C. G. C. C. K.”,* me PN-8293-03-2019, njoftuar me shkresën nr. 13751, prot., datë 26.12.2024 për mos dorëzimin e raporteve të monitorimit për vitin 2024.
- Subjekti “*Ç*”, me PN-1182-05-2022, njoftuar me shkresën nr. 13750, prot., datë 26.12.2024 për mos dorëzimin e raporteve të monitorimit për vitin 2024.
- Subjekti “*C*”, me PN-8755-12-2014, njoftuar me shkresën nr. 13750, prot., datë 26.12.2024 për mos dorëzimin e raporteve të monitorimit për vitin 2024.
- Subjekti “*C*”, me PN-0170-06-2015, njoftuar me shkresën nr. 13748, prot., datë 26.12.2024 për mos dorëzimin e raporteve të monitorimit për vitin 2024.

- Subjekti "*D*", me PN-3102-06-2016, njoftuar me shkresën nr. 13747, prot., datë 26.12.2024 për mos dorëzimin e raporteve të monitorimit për vitin 2024.
- Subjekti "*E-S*", me PN-1162-04-2022, njoftuar me shkresën nr. 13637, prot., datë 24.12.2024 për mos dorëzimin e raporteve të monitorimit për vitin 2024.
- Subjekti "*GJ K*", me PN-0469-06-2021, njoftuar me shkresën nr. 13746, prot., datë 26.12.2024 për mos dorëzimin e raporteve të monitorimit për vitin 2024.

2. Raporti vjetor i mjedisit nuk është sipas përmbajtjes së përcaktuar në tabelën 8.1, Shtojca 8.1.2 të aktit të miratimit të lejes dhe Aneksit I të urdhrit, si dhe mungesë informacioni mbi sasitë për çdo kod mbetje në të dhënat e regjistruara për menaxhimin e mbetjeve (4 raste):

- Për arsyet e sipërcituara, subjekti "*D. G*" është njoftuar me shkresën nr. 9420/1, prot., datë 25.09.2024 që raporti vjetor gusht 2023-gusht 2024 nuk do t'i merret në shqyrtim.
- Për arsyet e sipërcituara, subjekti "*Rr. U. A. nr.2*" është njoftuar me shkresën nr. 9416/1, prot., datë 25.09.2024 që raporti vjetor gusht 2023-gusht 2024 nuk do ti merret në shqyrtim.
- Për arsyet e sipërcituara, subjekti "*E*" është njoftuar me shkresën nr. 9171/1, prot., datë 25.09.2024 që raporti vjetor gusht 2023-gusht 2024 nuk do t'i merret në shqyrtim.
- Për arsyet e sipërcituara, subjekti "*2 E. G*" është njoftuar me shkresën nr. 9026/1, prot., datë 25.09.2024 që raporti vjetor gusht 2023-gusht 2024 nuk do t'i merret në shqyrtim.

3. CD e dërguar në AKM nuk përmban dokumentacionin mbi raportet (2 raste):

- Subjekti "*A*", njoftuar me shkresën nr. 4015/1, prot., datë 15.05.2024 për ridërgimin e dokumenteve në format CD.
- Subjekti "*I. I. S. T. A*" dhe subjekti "*L*" sh.p.k, njoftuar me shkresën nr. 7805/1, prot., datë 23.07.2025 për ridërgimin e dokumenteve në format CD.

4. Pasaktësi në përcaktimin e PN përkatëse të lejes mjedisore të subjektit raportues (3 raste):

- Për arsyet e sipërcituara, subjekti "*A*" është njoftuar me shkresën nr. 9227/1, prot., datë 26.08.2025 që raporti 6 mujor i vetë monitorimit nuk do ti merret në shqyrtim pa bërë saktësimin e PN dhe të dhënave të tjera të lejes mjedisore.
- Për arsyet e sipërcituara, subjekti "*T. G. A. C*" është njoftuar me shkresën nr. 9226/1, prot., datë 26.08.2025 që raporti 6 mujor i vetë monitorimit nuk do t'i merret në shqyrtim pa bërë saktësimin e PN dhe të dhënave të tjera të lejes mjedisore.
- Për arsyet e sipërcituara, subjekti "*I. I. S. T. A.*" është njoftuar me shkresën nr. 9226/1, prot., datë 26.08.2025 që raporti 6 mujor i vetë monitorimit nuk do t'i merret në shqyrtim pa bërë saktësimin e PN dhe të dhënave të tjera të lejes mjedisore.

Nga verifikimet në sistemin e-inspektimi, grupi i auditimit konstaton se, për subjektet e mëposhtëm nuk është bërë asnjë parashikim për inspektim brenda vitit nga momenti i konstatimit të problematikave me raportet e vetë monitorimit, apo dhe vitit pasardhës me qëllim verifikimin në terren të situatës dhe zbatimit të kushteve të lejes:

- Subjekti "*A*", me PN-5257-06-2017, njoftuar me shkresën nr. 13658, prot., datë 24.12.2024 për mos dorëzimin e raporteve të monitorimit për vitin 2024.
- Subjekti "*A-F*", me PN-1191-05-2022, njoftuar me shkresën nr. 13659, prot., datë 24.12.2024 për mos dorëzimin e raporteve të monitorimit për vitin 2024.
- Subjekti "*A-S*", me PN-0603-07-2015, njoftuar me shkresën nr. 13655, prot., datë 24.12.2024 për mos dorëzimin e raporteve të monitorimit për vitin 2024.
- Subjekti "*GJ. K.*", me PN-0469-06-2021, njoftuar me shkresën nr. 13746, prot., datë 26.12.2024 për mos dorëzimin e raporteve të monitorimit për vitin 2024. Për këtë subjekt është bërë një inspektim nisur në 29.07.2024, dhe në vijim të njoftimin për mungesat e raporteve vjetore nuk ka pasur ri inspektime të realizuara.

- Subjekti "*U. C*", me PN-1544-12-2022, njoftuar me shkresën nr. 6364, prot., datë 16.08.2023 për mos dorëzim dokumentacioni e kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti "*O*", me PN-5658-08-2017, njoftuar me shkresën nr. 2684, prot., datë 05.03.2024 për mos dorëzim dokumentacioni e kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore. (Rast i përsëritur pasi është njoftuar dhe me shkresën nr. 7610 prot., datë 18.07.2025 nga AKM për të njëjtin problem).
- Subjekti "*SH. I. P. L*", me PN-1993-07-2011, njoftuar me shkresën nr. 2683, prot., datë 05.03.2024 për mos dorëzim dokumentacioni e kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore. *(rast i përsëritur pasi është njoftuar dhe me shkresën nr. 7620 prot., datë 18.07.2025 nga AKM për të njëjtin problem).*
- Subjekti "*A. O*", me PN-7396-06-2014, njoftuar me shkresën nr. 2682, prot., datë 05.03.2024 për mos dorëzim dokumentacioni e kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti "*E. A*", me PN-9081-01-2015, njoftuar me shkresën nr. 2680, prot., datë 05.03.2024 për mos dorëzim dokumentacioni e kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti "*E. 3*", me PN-6003-08-2013, njoftuar me shkresën nr. 2678, prot., datë 05.03.2024 për mos dorëzim dokumentacioni e kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti "*U. M. C*", me PN-5422-07-2017, njoftuar me shkresën nr. 7623, prot., datë 18.07.2025 për mos dorëzim dokumentacioni e kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti "*U. L. P*", me PN-4417-12-2016, njoftuar me shkresën nr. 7623, prot., datë 18.07.2025 për mos dorëzim dokumentacioni e kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti "*M. P*", me PN-0120-10-2020, njoftuar me shkresën nr. 7779, prot., datë 21.07.2025 për mos dorëzim dokumentacioni e kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti "*D. E. SH. S. G*", me PN-2982-06-2016, njoftuar me shkresën nr. 7757, prot., datë 21.07.2025 për mos dorëzim dokumentacioni e kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti "*D. E. SH. S. D*", me PN-5336-06-2017, njoftuar me shkresën nr. 7758, prot., datë 21.07.2025 për mos dorëzim dokumentacioni e kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti "*D. E. SH. S. S*", me PN-8389-04-2019, njoftuar me shkresën nr. 7760, prot., datë 21.07.2025 për mos dorëzim dokumentacioni e kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti "*D. E. SH. S.P*", me PN-4122-11-2016, njoftuar me shkresën nr. 7759, prot., datë 21.07.2025 për mos dorëzim dokumentacioni e kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti "*D. E. SH. S. K*", me PN-1762-01-2016, njoftuar me shkresën nr. 7758, prot., datë 21.07.2025 për mos dorëzim dokumentacioni e kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.
- Subjekti "*D. E. SH. S. D*", me PN-5915-10-2017, njoftuar me shkresën nr. 7755, prot., datë 21.07.2025 për mos dorëzim dokumentacioni e kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të lejes mjedisore.

Në vijim të këtyre problematikave, grupi i auditimit ka kërkuar vënien në dispozicion të informacionit mbi zbatimin e kushtit nr. 8 *"Menaxhimi i mbetjeve"* nga subjektet e pajisura me leje mjedisore të tipit A dhe B, informacion i cili duhet të pasqyrohet në raportet vjetore që subjektet dorëzojnë çdo vit pranë sektorit të monitorimit në AKM.
Nga auditimi u konstatua se ky sektor nuk dispononte dokumentacionin e kërkuar, duke argumentuar se raportimi mbi këtë kusht nuk përfshihet në detyrat e tij funksionale.

Megjithatë nga auditimi rezulton se nga ky sektor në drejtim të menaxhimit të mbetjeve janë përcjellë shkresa si në vijim:

Lista e shkresave per menaxhimin e mbetjeve				
Nr	**Subjekti**	**Leje B me PN**	**Raportimi vjetor me shkrese**	**Data e daljes se shkreses**
Shtator, 2024				
1	S. P.	PN-1004-02-2022	9212, dt 03.09.2024	9212/1, dt 20.09.2024
2	E.	PN-7060-08-2018	9171, dt 02.09.2024	9171/1, dt 25.09.2024
3	2 E-G	PN-5644-08-2017	9026, dt 28.08.2024	9026/1, dt 25.09.2024
4	La.P. I-A	PN-09-2016	9357, dt 09.09.2024	9357/1, dt 25.09.2024
5	Rr. U. A.	PN-0789-09-2015	9416, dt 10.09.2024	9416/1, dt 25.09.2024
6	D. G.	PN-4167-10-2012	9420, dt 10.09.2024	9420/1, dt 25.09.2024
7	I. I	PN-3744-06-2012	9505, dt 12.09.2024	9505/1, dt 26.09.2024
8	G. W	PN-1918-08-2023	9508, dt 12.09.2024	9508/1, dt 27.09.2024
9	V	PN-1368-08-2022	9488, dt 11.09.2024	9488/1, dt 27.09.2024
10	A	PN-0786-09-2021	9413, dt 10.09.2024	9413/1, dt 27.09.2024
11	T. M. A	PN-3430-07-2016	8167, dt 01.08.2024	8167/1, date 25.09.2024
12	G-G. T. Sh	PN-5508-07-2017	8163, dt 01.08.2024	8163/1, date 25.09.2024
13	K	PN-0819-09-2021	9767, dt 20.09.2024	9767/1, date 25.09.2024
Tetor, 2024				
14	A	PN-1392-09-2022	9484, dt 11.09.2024	9484/1, dt 01.10.2024
15	T	PN-1383-09-2022	9490, dt 11.09.2024	9490/1, dt 01.10.2024
16	4 A. M	PN-0094-09-2020	9477, dt 11.09.2024	9477/1, dt 01.10.2024
17	A	PN-5745-09-2017	9485/1, dt 02.10.2024	9485/1, dt 04.10.2024
18	A	PN-1390-09-2022	9489/1, dt 02.10.2024	9489/1, dt 04.10.2024
19	T. C	PN-1928-09-2023	9491/1, dt 02.10.2024	9194/1, dt 04.10.2024
20	N. K	PN-5748-09-2017	9412/1, dt 03.10.2024	9412/1, dt 04.10.2024
21	E. P	PN-0083-08-2020	9394/1, dt 03.10.2024	9394/1, dt 04.10.2024
22	A	PN-0794-09-2021	9519/1, dt 03.10.2024	9519/1, dt 04.10.2024
23	V. M	PN-0035-07-2020	6217/1, dt 07.10.2024	6217/1, dt 08.10.2024
24	A. K	PN-1927-09-2023	9607, dt 16.09.2024	9607/1, dt 08.10.2024
25	C	PN-0809-09-2021	9599, dt 16.09.202	9599/1, dt 08.10.2024
26	K. I	PN-0788-09-2021	9608, dt 16.09.204	9608/1, dt 08.10.2024
27	C. R	PN-9342-09-2019	9974, dt 25.09.2024	9974/1, dt 09.10.2024
28	A. S. A	PN-3677-08-2016	9264, dt 04.09.2024	9264/1, dt 03.10.2024
29	A.B	PN-0785-09-2021	9225, dt 03.09.2024	9225/1, dt 03.10.2024
30	M. Y	PN-1389-09-2022	9246, dt 04.09.2024	9246/1, dt 03.10.2024
31	M. A	PN-0774-08-2021	9336, dt 06.09.2024	9336/1, dt 03.10.2024
32	N. C	PN-0786-09-2015	9782, dt 20.09.2024	9782/1, dt 08.10.2024
33	Q. S- Sh	PN-1063-03-2022	9850, dt 23.09.2024	9850/1, dt 00.10.2024
34	Sh. I. P. L (Leje A)	PN-3747-09-2016	10144, dt 01.10.2024	10144/1, dt 03.10.2024
35	P. M.G	PN-3849-09-2016	10071, dt 30.09.2024	10071/1, dt 15.10.2024
36	A	PN-0745-08-2010	10446, dt 09.10.2024	10446/1, dt 16.10.2024
37	P. G	PN-9476-10-2019	10591, dt 11.10.2024	10591/1, dt 18.10.2024
38	S.RR	PN-0853-09-2015	10328, dt 04.10.24	10328/1, dt 21.10.2024
39	A.D	PN-7238-09-2018	10316, dt 04.10.2024	10316/1, dt 22.10.2024
40	M – T	PN-9903-03-2020	3537/1, dt 08.10.2024	3537/2, dt 18.10.2024
41	Sh. U.A.B.V	PN-3838-09-2016 PN-3842-09-2016 PN-3927-10-2016	10580, dt 11.10.2024	10580/1, dt 18.10.2024
42	Sh. I. P. L	PN-3764-09-2016	10146, dt 01.10.2024	10146/1, dt 04.10.2024
43	Sh. I.P. L	PN-3747-09-2016	10144, dt 01.10.2024	10144/1, dt 04.10.2024
44	Sh. I.P.L	PN-2068-06-2024	10482, dt 10.10.2024	10482/1, dt 18.10.2024
Nentor, 2024				
45	A. S	PN-47434-10-2018	11819, dt 08.11.2024	11819/1, dt 14.11.2024
46	Ç. M	PN-1954-10-2023	11939, dt 12.11.2024	11939/1, dt 18.11.2024
Dhjetor, 2024				
47	P. V	PN-1974-12-2023	12821, dt 06.12.2024	12821/1, dt 23.12.2024
48	G	PN-9611-11-2019	12846, dt 10.12.2024	12846/1, dt 23.12.2025
49	B. G	PN-7632-11-2018	12908, dt 10.12.2024	
Janar 2025				
1	V. K	PN-9698-12-2019	13480, dt 20.12.2024	
2	B. T	PN-6095-12-2017	13841. dt 27.12.2024	13841/1, dt 27.12.2024
3	K. K	PN-0213-12-2020	13948, dt 31.12.2024	13948/1, dt 31.12.2024
4	T. T	PN-1594-01-2020	105, dt 08.01.2025	105/1, dt 16.01.2025
5	M	PN-4486-01-2017	57, dt 07.01.2025	57/1, dt 16.01.2025
6	O. N	PN-1174-05-2022	13890, dt 30.12.2024	13890/1, dt 16.01.2025
7	F	PN-1063-03-2022	188, dt 10.01.2025	188/1, dt 20.01.2025
8	I. M	PN-1603-01-2023	236, dt 13.01.2025	236/1, dt 22.01.2025
9	D. E SH. S. L	PN-2776-05-2016	390, dt 16.01.2025	390/1, dt 22.01.2026
10	R.B.H B	PN-8584-11-2014	12411/2, dt 15.01.2025	12411/3, dt 16.01.2025
11	B. P L	PN-2000-01-2024, PN-2002-01-2024	752, 800, dt 27.01.225	
12	D	PN-9810-01-2020	909, dt 29.01.2025	909/1, dt 03.02.2025
13	A.C. SH.A	PN-1764-01-2016	911, dt 29.01.2025	911/1, 30.01.2025
14	D. E SH. S. D	PN-5915-10-2017	1025, dt 31.01.2025	1025/1, dt 05.02.2025
15	B. P. L	PN-2000-01-2021 PN-2002-01-2024	752, dt 27.01.2025 800, dt 27.01.2025	752/1, dt 03.02.2025
16	B. P. L	PN-2005-01-2024	1075,dt.31.01.2025	1075/1, dt 04.02.2025
17	T. T	PN-1594-01-2023	105, dt 23.01.2025	105/3, dt 31.01.2025
SHKURT 2025				
18	D	PN-9810-01-2020	909, dt 29.01.2025	909/1, dt 04.02.2025
19	S. P. G	PN-0106-09-2020	1150, dt 04.02.2025	1150/1, dt 06.02.2025
20	B. P. L	PN-2012-01-2024	1279, dt 06.02.2025	1279/1. dt 21.02.2025
21	B. P. L	PN-2013-01-2024 PN-2013-01-2024	1172/1173, dt 27.01.2025	1172/1, dt 06.02.2025
MARS 2025				

22	V. R	PN-8024-01-2019	2189, dt 26.02.2025	2189/1, dt 04.03.2025
23	G. F	PN-5272-06-2017	2398, dt 04.03.2025	2398/1, dt 06.03.2025
24	SH. S. P	PN-8034-02-2019	2501, dt 05.03.2025	2501/1, dt 07.03.2025
25	Q. SH. V. I D	PN-0904-01-2022	2589, dt 06.03.2025	2589/1, dt 11.03.2025
26	G	PN-1703-03-2023	3830, dt 28.03.2025	3830/1, dt 03.04.2025
	PRILL 2025			
27	K	PN-0264-02-2021	3860, dt 01.04.2025	3860/1, dt 03.04.2025
28	S. A	PN-4614-02-2017	4577,dt 15.04.2025	4577/1, dt 17.04.2025
29	G. A	PN-0357-04-2021	4582, dt 15.04.2025	4582/1, dt 18.04.2025
30	C	PN-2547-04-2016	5028, dt 24.04.2025	5028/1, dt 28.04.2025
31	V. R	PN-9488-03-2015	5093, dt 25.04.2025	5093/1, dt 29.04.2025
32	V.R	PN-4736-01-2013	5094, dt 25.04.2025	5094/1, dt 29.04.2025
	MAJ 2025			
33	3P L. L	PN-9966-05-2015	5462, dt 09.05.2025	5462/1, dt 13.05.2025
34	M. I	PN-1781-05-2023	5527, dt 14.05.2025	5527/1, dt 14.05.2025
35	K sh.a.	PN-6509-05-2018	5818, dt 21.05.2025	5818/1, dt 23.05.2025
	QERSHOR 2025			
36	M. P	PN-8899-06-2019	6782,dt 24.06.2025	6782/1 dt 25.06.2025
37	A. D	PN-1848-06-2023	6833, dt 25.06.2025	6833/1, dt 30.06.2025
	KORRIK 2025			
38	G-G	PN-3034-06-2016	6918, dt 27.06.2025	6918/1 dt 01.07.02025
39	V. H	PN-0390-07-2015	7229, dt 07.07.2025	7229/1, dt 10.07.2025
	SHTATOR 2025			
40	G. 2	PN-0772-08-2021	9605, dt 04.09.2025	9605/1, dt 15.09.2025
41	E. A. P.O	PN-1346-08-2022	10019, dt 17.09.2025	10019/1, dt 23.09.2025
	Tetor, 2025			
42	B	PN-3879-09-2016	10520, dt 30.09.2025	10520/1, dt 02.10.2025
43	A.P	PN-9442-10-2019	10714, dt 06.10.2025	10714/1, dt 10.10.2025
	Dhjetor 2025			
44	G	PN-9611-11-2019	12722, dt 27.11.2025	12722/1, dt 03.12.2025
45	F	PN-8579-11-2014	12743, dt 27.11.2025	12743/1, dt 03.12.2025

Burimi: AKM

Nga shqyrtimi i kuadrit rregullator konstatohet se ky qëndrim nuk është i bazuar, pasi rregullorja nr. 120 *"Rregullore e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit",* parashikon se sektori *"Ndjek mirëmbajtjen dhe përditësimin e databazëa së të dhënave (dokumentacionit) që dorëzojnë personat fizikë dhe juridikë, subjekt të lejes mjedisore", "Menaxhon dokumentacionin e dërguar nga personat fizikë dhe juridikë… subjekte të lejes"* dhe *"Harton informacione në lidhje me subjektet e licensuara, të cilët nuk kanë raportuar, sipas kushteve dhe parimeve të lejes mjedisore"*.

Po ashtu, për inspektorin e sektorit përcaktohet se ai *"Harton dhe koncepton kthimin e përgjigjes… për subjektet që dorëzojnë dokumentacion mbi zbatimin e kritereve dhe kushteve të lejes"* dhe *"Harton informacione… për subjektet që nuk kanë raportuar sipas kushteve të lejes mjedisore".*

Njëkohësisht, Urdhri nr. 92, datë 02.05.2024 i Drejtorit të Përgjithshëm të AKM-së "*Për procedurën e dorëzimit/pranimit të dokumenteve dhe raporteve të vetë monitorimit, për subjektet e pajisur me vendim për VNM paraprake, Deklaratë Mjedisore, Leje Mjedisi të Tipit A ose B" i cili në pikat 2, 5 dhe 10* përcakton qartë se:

2. Sektori i Monitorimeve të Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve pranë Drejtorisë së Shqyrtimit dhe Monitorimit të Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve, kontrollon dhe verifikon dokumentacionin dhe raportet e vetë monitorimit në përputhje me kushtet e aktit të miratuar që disponon subjekti, si dhe përditëson regjistrin e dokumentacionit dhe raporteve të vetë monitorimit sipas formatit të miratuar.

5. Sektori i Monitorimeve të Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve pranë Drejtorisë së Shqyrtimit dhe Monitorimit të Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve, kërkon plotësim të dokumentacionit apo informacion shtesë në rastet kur operatorët e pajisur me vendim për VNM paraprake, Deklaratë Mjedisore, Leje Mjedisi të Tipit A ose B, nuk kanë zbatuar kushtet e aktit të miratimit dhe nuk kanë dorëzuar dokumentacionin sipas Aneksit I dhe II të këtij urdhri.

10. Sektori i Monitorimeve të Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve pranë Drejtorisë së Shqyrtimit dhe Monitorimit të Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve, në rastet kur dokumentacioni i kërkuar nuk është sipas kërkesave të këtij urdhri, nuk pranon shqyrtimit e tyre dhe njofton menjëherë operatorin e lejes mjedisore si dhe laboratorin e autorizuar ose personin e autorizuar.

Për rrjedhojë, mos vendosja në dispozicion e dokumentacionit mbi zbatimin e kushtit 8 dhe pretendimi se ndjekja e tij nuk është detyrë e sektorit përbën mos përmbushje të funksioneve të tij

dhe veprime në mospërputhje me rregulloren nr. 120, datë 12.01.2021*"Rregullore e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit",* dhe Urdhrin nr. 92, datë 02.05.2024 "*Për procedurën e dorëzimit/pranimit të dokumenteve dhe raporteve të vetë monitorimit, për subjektet e pajisur me vendim për VNM paraprake, Deklaratë Mjedisore, Leje Mjedisi të Tipit A ose B"* duke dobësuar kontrollin institucional mbi zbatimin e kushteve të lejeve mjedisore.
Nga komunikimi me përgjegjësen e Sektorit të Monitorimit, grupi i auditimit u informua se, pas daljes së Urdhrit nr. 92, datë 02.05.2024 *"Për procedurën e dorëzimit/pranimit të dokumenteve dhe raporteve të vetë monitorimit për subjektet e pajisura me vendim për VNM paraprake, Deklaratë Mjedisore, si dhe Leje Mjedisi të Tipit A ose B"*, ky sektor pjesën e raportit vjetor të subjekteve që përfshin informacion mbi kushtin nr. 8 *"Menaxhimi i mbetjeve"* e përcjell çdo muaj pranë Sektorit të Informacionit, GIS dhe Regjistrave Mjedisorë, në varësi të Drejtorisë së Kërkimit dhe Dijes Mjedisore, i cili ka ndër detyrat funksionale edhe administrimin e data bazës së mbetjeve, trajtuar si në vijim.

Për sa trajtuar me sipër ngarkohen me përgjegjësi: Përgjegjësi i Sektorit të Monitorimeve K. S nga data 01.04. 2023 deri më 30.10.2023, përgjegjësi i sektorit të Monitorimeve znj. E. M nga data 02.05.2024-31.12.2025 dhe Titullari i AKM 01.01.2023-23.10.2025 znj. A. D.

Mbi auditimin e menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme, Drejtoria e Kërkimit dhe Dijes Mjedisore
Bazuar në rregulloren nr. 120, datë 12.01.2021 *"Rregullore e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit",* fusha e veprimtarisë së Drejtorisë së Kërkimit dhe Njohurive Mjedisore përfshin funksionimin dhe administrimin e laboratorit, zhvillimin e kërkimit shkencor mbi metodat bashkëkohore për verifikimin e gjendjes dhe cilësisë së mjedisit, si dhe analizimin dhe shpjegimin e rasteve specifike mjedisore. Gjithashtu, kjo drejtori është përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin dhe regjistrimin e informacionit që lidhet me vlerësimin dhe analizimin e kimikateve dhe trajtimin e tyre, si dhe për veprimtari të tjera të ndërlidhura me këtë funksion. Në kuadër të përgjegjësive të saj, përfshihet edhe projektimi, ndërtimi, mirëmbajtja dhe përditësimi i sistemeve të integruara të informacionit mjedisor, përfshirë SIM, GIS dhe PRTR.
Sektori i Informacionit, Gis dhe Regjistrave Mjedisor është përgjegjës për instalimin, zhvillimin, administrimin dhe përditësimin e databazave dhe sistemeve elektronike mjedisore, përfshirë EIMS, EIS, PBQ, ALFIS, PRTR, CLRTAP dhe *databazat e menaxhimit të mbetjeve.*
Sipas rregullores nr. 120, datë 12.01.2021, *në fushën e menaxhimit të mbetjeve, sektori është përgjegjës për grumbullimin, përpunimin, regjistrimin, administrimin dhe përditësimin e të dhënave që lidhen me mbetjet në kuadër të sistemeve të informacionit mjedisor dhe databazave përkatëse. Gjithashtu, siguron integrimin, ruajtjen dhe menaxhimin efektiv të informacionit mbi mbetjet, përgatit dhe përpunon të dhëna për qëllime raportimi dhe monitorimi, si dhe mbështet procesin e shpërndarjes së informacionit në përputhje me kërkesat institucionale dhe ligjore për administrimin e të dhënave mjedisore.*
Në zbatim të Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2012 *"Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve",* janë miratuar VKM nr. 229, datë 23.04.*2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit",* i

ndryshuar, si dhe VKM nr. 371, datë 11.06.2014 *"Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të tyre".*

Në zbatim të VKM nr. 229, me Urdhrin e Ministrit të Mjedisit nr. 123, datë 25.04.2017 *"Për miratimin e formatit të regjistrit të transfertave individuale dhe të regjistrit kombëtar të transfertave si dhe mënyrën e administrimit të tyre",* është përcaktuar se regjistri i transfertave individuale të mbetjeve jo të rrezikshme mbahet nga dorëzuesi dhe marrësi i mbetjeve në mënyrë të pavarur, sipas formatit përkatës, plotësohet për çdo dokument dorëzimi dhe ruhet për një afat 2-vjeçar, ndërsa kopje e tij dërgohet pranë AKM-së një herë në vit, në periudhën 1-15 nëntor.

Gjithashtu, AKM mban Regjistrin Kombëtar të Transfertave të mbetjeve jo të rrezikshme, i cili përditësohet një herë në vit brenda datës 15 dhjetor, dhe dërgon kopje pranë ministrisë përkatëse brenda 10 ditëve pune nga përditësimi. Personi përgjegjës për mbajtjen dhe përditësimin e këtij regjistri caktohet me urdhër të titullarit të AKM-së.

Në zbatim të VKM nr. 371, datë 11.06.2014, me Urdhrin e Ministrit të Mjedisit nr. 135, datë 16.04.2015 *"Për miratimin e mënyrës së administrimit të formatit të Regjistrit të Transfertave Individuale dhe të Regjistrit Kombëtar të Transfertave, si dhe mënyrën e administrimit të tyre",* është përcaktuar se regjistri i transfertave individuale të mbetjeve të rrezikshme mbahet nga dorëzuesi dhe marrësi i mbetjeve në mënyrë të pavarur, plotësohet për çdo dokument dorëzimi dhe ruhet për një afat 3-vjeçar. Kopje e regjistrit dërgohet pranë AKM-së dy herë në vit, në periudhat 1-15 maj dhe 1-15 nëntor. AKM krijon dhe administron Regjistrin Kombëtar të Transfertave të mbetjeve të rrezikshme, i cili përditësohet dy herë në vit, brenda datave 15 qershor dhe 15 dhjetor, dhe kopje e tij i dërgohet ministrisë përkatëse brenda 10 ditëve pune nga përditësimi. Personat përgjegjës për mbajtjen dhe përditësimin e regjistrit caktohen me urdhër të titullarit të AKM-së, ndërsa përgjegjësia për zbatimin e urdhrit i ngarkohet AKM-së.

Në zbatim të këtyre dispozitave, AKM, me Urdhrin nr. 62, datë 08.05.2015, ka caktuar personat përgjegjës për mbajtjen dhe përditësimin e Regjistrit Kombëtar të Transfertave të mbetjeve të rrezikshme, konkretisht znj. E. Sh, përgjegjëse e sektorit të regjistrit të shkarkimeve dhe transferimit të ndotësve në Drejtorinë e Informacionit dhe Statistikave, si dhe znj. A. K, specialiste në Sektorin e Regjistrit të Shkarkimeve dhe të Transferimit të Ndotësve në të njëjtën drejtori. Nga auditimi konstatohet se nuk ka dal urdhër tjetër, pavarësisht se specialistja znj. A. K është larguar nga detyra prej më shumë se 8 vitesh.

Urdhri i Ministrit të Mjedisit nr. 135, datë 16.04.2015 dhe Urdhri i Ministrit të Mjedisit nr. 123, datë 25.04.2017, në pikën 5 citon se: *"Personi përgjegjës për mbajtjen dhe përditësimin e Regjistrit Kombëtar të Transfertave të mbetjeve jo të rrezikshme caktohen me Urdhër të Titullarit të AKM".*

Nga komunikimi me sektorin janë përcjellë këto problematika:

- Për shkak të mungesës së infrastrukturës regjistri i transfertave të mbetjeve nuk ka përfunduar brenda afateve ligjore.
- Duke qenë se i njëjti subjekt mund të këtë më shumë se një licencë aktive në të njëjtën vendndodhje është shumë e vështirë të bëhet një analizë krahasimore se sa subjekte nuk janë të pajisura me kod unik.
- Informacioni i munguar mbi të dhënat nga sektorët e tjerë ka sjellë problematikë në përmirësimin e panoramës së plotë të mbetjeve të gjeneruara, transferuara për riciklim, trajtim apo për vend depozitim përfundimtar në landfill gjatë një viti të plotë.
- Gjithashtu problematikë krijon edhe shtimi i një licence të re kur i njëjti subjekt me të njëjtën vendndodhje kërkon shtim kodesh dhe i rritet numri i licencave në vend që ti përditësohet licenca aktuale edhe të shtohen kodet e rinj.

Në vijim, grupi i auditimit testoi drejtimet si më poshtë:

Licenca III.2.B. sipas bazës së të dhënave administruar në AKM

Bazuar në ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, *"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve",* të ndryshuar, ligjin nr. 10081, datë 23.02.2009 *"Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë"* të ndryshuar, ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 *"Për Mbrojtjen e Mjedisit"* të ndryshuar, ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 *"Për Lejet e Mjedisit"* të ndryshuar, Vendimit nr. 229, datë 23.04.2014 *"Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme", (ndryshuar me VKM nr. 1031, datë 16.12.2020),* Vendimit nr. 371, datë 11.06.2014, *"Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre", (ndryshuar me VKM nr. 1032, datë 16.12.2020),* Urdhrit të Ministrit të Mjedisit nr. 135 datë 16.04.2015 *"Për Miratimin e Mënyrës së Administrimit të Formatit të Regjistrit të Transfertave Individuale dhe të Regjistrit Kombëtar të Transfertave si dhe Mënyrën e Administrimit të tyre",* u konstatua se:

Nga kontrolli i Regjistrit të Licencave III.2.B nga viti 2012 deri në dhjetor të vitit 2025 rezultojnë **743 Licenca III.2.B** ku 39 prej tyre e kanë statusin "Jo aktiv", "Pezulluar" apo "Revokuar" në QKB, pra në total janë 704 Licenca III.2.B. Nga këto 704 licenca, 80 prej tyre janë përsëritje për subjekte të cilat janë pajisur njëherë me licence III.2.B por që kanë kërkuar shtim kodesh ose ndryshim vendndodhje, pra gjithsej janë 616 subjekte aktive me licenca III.2.B, nga të cilat vetëm 285 subjekte kanë Kod Unik dhe 239 subjekte janë pa Kod Unik, të cilat janë njoftuar me shkrese zyrtare në nëntor- dhjetor 2025 që të pajisen me kod Unik.

Për sa më sipër konstatohet se Regjistri i licencave nuk është i organizuar dhe i ndarë në refuzime/miratime/revokime.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka miratuar kode unike deri në 31 dhjetor të vitit 2019 ku ka arritur në numrin 171 subjekte ndërsa nga 1 Janari vitit 2020 e në vazhdim Kodi Unik miratohet nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, nëpërmjet sistemit e-Albania dhe deri në fund të dhjetorit të vitit 2025 ka arritur në numrin 346 të kodeve unike ndërkohë që subjekte janë vetëm 285.

Nga ky verifikim është vëne re se ministria ka miratuar më shumë se një kod për të njëjtin subjekt (38 subjekte**)**, në kundërshtim me VKM nr. 229, datë 23.4.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit" (ndryshuar me VKM nr. 1031, datë 16.12.2020) pika 16 ku përcaktohet: *"Pjesa e parë e kodit unik është individuale dhe e papërsëritshme për çdo subjekt që transferon mbetje jo të rrezikshme, ndërsa pjesa e dytë e këtij kodi vendoset nga vetë personi që transferon mbetjet te pritësi dhe ndryshon për çdo transfertë" dhe* VKM nr. 371, datë 11.6.2014, "Për Miratimin e Rregullave për Dorëzimin e Mbetjeve të Rrezikshme dhe të Dokumentit të Dorëzimit të tyre" (ndryshuar me VKM nr. 1032, datë 16.12.2020), pika 25 ku citohet se: *"Mos përmbushja e detyrimeve të përcaktuara në këtë vendim përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet sipas përcaktimeve të nenit 62 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar".*

Lista e subjekteve aktual të cilët kanë marrë më shumë se dy kode unike.

Nr.	Subjekti	Kodi Unik		
1	4A (a. m)	AML0093	KAM0193	AML0093
2	E. R. SHPK 2	EOR0140	ECR0044	
3	E. P	EPK0175	EGP0143	
4	L-E	LEM0180	LMM0171	
5	Ç.	ÇA0182	ÇA0183	
6	V. R	VER0190	VLR0064	
7	B. A	BAE0203	BRI0202	
8	A.A	AIA0215	AIA0216	

9	G. C	GTC0226	GTC0225	
10	R. O. I	ROI0229	ROI0041	
11	A.A Sh.p.k.	ASA0251	AGA0100	
12	A	ASL0252	ASL0235	
13	A.P Sh.p.k.	APO0253	APO0051	
14	E	EMR0258	EMR0255	
15	K. Sh.p.k.	KNT0266	KNT0142	
16	GJ.	GJK0267	GÇ0113	
17	M. M	MHM0270	MRH0272	MRS0139
18	O. O	OXO0271	ONX0238	
19	E-P A" SH.P.K	EPA0279	EPA0280	
20	B sh.p.k	BRI0282	JBI0103	
21	I. I	ISI0291	ISI0160	
22	N.2000 sh.p.k	NTI0292	NDI0218	
23	S-F sh.p.k	STC-0293	SPF0189	
24	M. P sh.p.k	MYK-0294	MYR0150	
25	SH. sh.p.k	SAU-0295	SAU-0296	SHS0034
26	E sh.p.k	EOR-0299	EOR-0300	
27	P-G SH.P.K	PAP-0306	PAP-0307	
28	M sh.p.k	MTO-0311	MTO0129	
29	"A.G R" sh.p.k	ACG-0313	ACG-0314	
30	H. M-p.f	HIJ-0317	HNM0131	
31	G. sh.p.k	GER-0318	GEA0177	
32	R. 2002-sh.p.k	RAO-0319	RFO0124	
33	B. P. P.F	BRA-0329	BPA0256	
34	L. M sh.p.k	LML-0332	LML-0333	
35	A. M. P.F	AMJ-0335	AMJ-0336	
36	K. B P.F	KIA-0339	KOA0328	
37	P. S. sh.p.k	PEO-0345	PSO0106	
38	M. V.	MVR0223	MVR0123	

Burimi: AKM-përpunuar nga grupi i auditimit.

Për sa më sipër konstatohen 38 subjekte të cilët nuk janë të pajisur me një kod të vetëm unik. Mungesa e kodit unuk cënon saktësinë dhe integritetin e regjistrit, vështirëson gjurmueshmërinë e mbetjeve dhe dobëson kontrollin institucional, duke krijuar mundësi për shmangie të detyrimeve ligjore dhe pasqyrim jo real të të dhënave.

Mbi auditimin e raportimeve të regjistrit të transfertave nga subjektet e pajisur me kod unik

Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, konstatohet se përgjatë vitit 2023 nga 272 subjekte të pajisura me kod unik kanë raportuar vetëm 41 subjekte mbi Regjistrat e Transfertave, pra nuk kanë raportuar 231 subjekte.

Gjatë vitit 2024 nga 297 kode unike të miratuara gjithsej kanë raportuar në total 152 duke marr në konsideratë edhe rastet kur ka përsëritje kodi ose raportim që nuk kanë kryer transferime dhe nuk kanë raportuar 145 subjekte.

Gjatë vitit 2025, nga 346 kode unike të miratuara gjithsej, kanë deklaruar 265 operatorë duke marr në konsideratë edhe rastet kur ka përsëritje kodi ose raportim që nuk kanë kryer transferime ndërsa 81 operatorë kanë deklaruar se nuk kanë kryer transferta.

Mos raportimi i informacionit për transfertat përbën mungesë transparence mbi veprimtarinë e subjekteve dhe pamundëson gjurmueshmërinë e lëvizjes së mbetjeve, duke rritur rrezikun e menaxhimit të pakontrolluar të tyre dhe potencialisht ndikimin negativ në mjedis dhe në shëndetin publik.

Për sa më sipër, krijuesit ose zotëruesit fillestar të mbetjeve dhe personat fizikë apo juridikë të licencuar që grumbullojnë ose transportojnë mbetje të rrezikshme apo jo të rrezikshme, sipas ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 *"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar,* kanë detyrime të qarta ligjore për dokumentimin dhe raportimin e transfertave të mbetjeve. Sipas nenit 20, pika 6, përcaktohet se: *Të gjitha llojet e mbetjeve jo të rrezikshme, që transferohen në baza profesionale nga një person te një tjetër, shoqërohen me një dokument transferimi. Dokumenti i transferimit*

është i vlefshëm edhe në formë elektronike. Po sipas këtij neni, pika 10 përcakton se: *Si transferuesi edhe pritësi i mbetjeve i dërgojnë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, një herë në vit, informacion për mbetjet jo të rrezikshme.*
Në lidhje me mbetjet e rrezikshme, neni 26, pika 1 përcakton se: *Mbetjet e rrezikshme, që dorëzohen nga një person fizik a juridik te një tjetër, shoqërohen me dokument dorëzimi, i cili është i vlefshëm edhe në formë elektronike.* Po sipas këtij neni, pika 6 përcaktohet se: *Çdo dorëzues, transportues dhe marrës në dorëzim i dërgon çdo 3 muaj Agjencisë Kombëtare të Mjedisit informacion për dorëzimin e mbetjeve*.
Pika 1 dhe 2 e nenit 56 të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, i ndryshuar parashikon se:
1. Inspektorati për Mjedisin inspekton instalimet, mbi të cilat zbatohet ky ligj, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit".
2. Inspektimet për çdo operacion grumbullimi dhe transporti duhet të përfshijnë origjinën, natyrën dhe sasinë e mbetjeve të grumbulluara dhe të transportuara deri në destinacionin përfundimtar.
Në rast të moszbatimit të këtyre detyrimeve, neni 62, në pikat 10 dhe 20 të tij parashikon këto masa ndëshkuese:
10. Çdo person, që angazhohet në transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe që nuk dërgon informacion në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, në përputhje me nenin 21 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 300,000 (treqind mijë) deri në 500,000 (pesëqind mijë) lekë.
20. Çdo person, që angazhohet në transferimin e mbetjeve të rrezikshme dhe që nuk dërgon informacion në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, në përputhje me nenin 26 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 500,000 (pesëqind mijë) deri në 1,000,000 (një milion) lekë;
Konkluzion: Mos raportimi i informacionit për transfertat e mbetjeve cenon funksionimin e sistemit kombëtar të gjurmueshmërisë së mbetjeve, rrit rrezikun e transferimeve të pakontrolluara ose informale, pengon monitorimin institucional të flukseve të mbetjeve dhe rrit rrezikun për ndotje mjedisore dhe ndikim negativ në shëndetin publik. Gjithashtu, krijon risk për mos aplikim të sanksioneve administrative të parashikuara në ligj dhe cenon integritetin e bazave kombëtare të të dhënave për menaxhimin e mbetjeve. Për sa më sipër, grupi i auditimit nuk është në gjendje të vlerësojë efektin që do të kishte rezultuar nga aplikimi i penaliteteve, për shkak të mungesës së inspektimeve që do të vlerësonte situatën e subjekteve në raport me mbetjet.
Po kështu, u konstatua se për periudhën objekt auditimi nuk ka patur asnjë inspektim për licencat III.2.B. Gjithashtu nga auditimi konstatohet se raporti vjetor nuk është dërguar në MTM me shkresë zyrtare jo në përputhje me Urdhrin nr. 123, datë 25.04.2017 "Për miratimin e formatit të regjistrit të transfertave individuale dhe të regjistrit kombëtar të transfertave si dhe mënyrën e administrimit të tyre", pika 6 ku citohet se: *"AKM dërgon pranë Ministrisë një kopje të Regjistrit Kombëtar të transfertave të mbetjeve jo të rrezikshme brenda 10 ditëve pune nga përditësimi i tij"* dhe Urdhrin nr. 135 datë 16.04.2015 "Për miratimin e formatit të regjistrit të transfertave individuale dhe të regjistrit kombëtar të transfertave, si dhe mënyrën e administrimit të tyre", pika 6 ku citohet se: *"AKM dërgon pranë Ministrisë një kopje të Regjistrit Kombëtar të transfertave të mbetjeve jo të rrezikshme brenda 10 ditëve pune nga përditësimi i tij.*

Nga auditimi konstatohet se Sektori i Informacionit, GIS dhe Regjistrave Mjedisorë, ka hartuar memo me nr. 6369 prot., datë 16.08.2023 me lëndë *"Mbi problematikat e hasura në raportimet e transfertave të mbetjeve të rrezikshme dhe të parrezikshme për subjektet e pajisura me licencë III.2.B"* drejtuar titullarit të Agjencisë.
Bazuar në memon e sipërcituar titullari i agjencisë ngriti grupin e punës për kontrollin dhe verifikimin në terren të subjekteve të pajisura me licencë III.2.B me anë të urdhrit nr. 193, datë 16.08.2023, të protokolluar me nr. 6375 prot., datë 16.08.2023. Nga auditimi u konstatua se ky

grup pune nuk ka kryer verifikime në terren por analizimi është realizuar nga zyra. Gjetjet e grupit të punës janë paraqitur te titullari nëpërmjet memos nr. 6375/1 prot., datë 21.08.2023 me lënde *"Informacion mbi zbatimin e urdhrit nr. 193 datë 16.08.2023 për ngritjen e grupit të punës së kontrollit dhe verifikimit në teren të subjekteve të pajisura me licencë III.2.B".* Sipas kësaj memo problematikat kryesore konsistojnë në:

- Mospërputhje mes licencave dhe kodeve unike: nga 401 subjekte aktive me licencë III.2.B, vetëm 259 janë të pajisura me Kod Unik; 142 subjekte rezultojnë pa Kod Unik, ndonëse e kanë detyrim ligjor.
- Dublikime të kodeve unike: janë konstatuar kode të përsëritura për të njëjtin subjekt (13 kode për 6 subjekte), në kundërshtim me VKM-të përkatëse që parashikojnë një kod unik, të papërsëritshëm për çdo subjekt.
- Mangësi në raportim: numër i ulët subjektesh që raportojnë transfertat e mbetjeve (mesatarisht rreth 50 subjekte në vit për 2021–2022), krahasuar me numrin total të subjekteve të licencuara. Subjektet që pajisen me Kod Unik gjatë vitit raportojnë vetëm në vitin pasardhës, duke krijuar vonesë njëvjeçare në raportim dhe vështirësi në monitorim.
- Mos koordinim institucional dhe vonesa në njoftim: Ministria nuk i njofton në kohë reale AKM-në për kodet e miratuara (njoftimi bëhet brenda 10 ditëve të para të vitit pasardhës), çka pamundëson verifikimin në kohë të subjekteve të reja.
- Probleme me mënyrën e raportimit elektronik: Megjithëse VKM-të parashikojnë raportim elektronik përmes e-Albania, në praktikë raportimi është bërë në formë shkresore dhe me CD. Ndalimi i përdorimit të CD/USB-ve në rrjetin qeveritar ka bërë që AKM të mos përditësojë në kohë reale regjistrin e transfertave.

Në vijim të kësaj memo nga ana e Titullarit të AKM nuk janë iniciuar inspektime në drejtim të këtyre problematikave.

Kjo memo ka shërbyer edhe si pikënisje e fillimit të ndërtimit të sistemit të integruar mjedisor por edhe e ndryshimeve ligjore të VKM-së 1031/2020 dhe VKM-së 1032/2020 me VKM nr. 526, Datë 1.8.2024 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 229, datë 23.04.2014, të këshillit të ministrave, "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit", të ndryshuar dhe Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 522, datë 10.08.2024 Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 371, datë 11.06.2014, të Këshillit të Ministrave, *"Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre",* të ndryshuar.

Mbi raportimin e kodeve të mbetjeve dhera

Nga auditimi konstatohet se në regjistrat e deklaruar nga vet subjektet u vunë re shumë parregullsi në raportimin e kodeve të mbetjeve dhera. Kjo Drejtori i ka përcjellë këto problematika nëpërmjet memos-s nr. 1274 prot., datë 05.02.2025 me lëndë *"Mbi problematikat e hasura në raportimet e transfertave të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme për vitin 2024, nga subjektet e pajisura me Licencë III.2.B".*

Nr	Dorëzuesi	Transportuesi	Kodi Unik i transportuesit
1	2 K. 2014	N-B SH.P.K	NOB0101
2	2. C. G. SHPK	2 U. SH.P.K	2EU0179
3	5 K.SHPK & B.SHPK	A.C. SHPK	
4	2 SHPK	2 SHPK	NMS0214/NDS0172
5	A	A	AKS0099
6	A SHPK & B-I SHPK	A.SHPK & B-I SHPK	AKS0099/BIS0075
7	A. V. SHPK	B. 04 SHPK	BAI0284
8	A. S. SHPK	A. S. SHPK	AST0013
9	A. K SHPK	A. K SHPK	
10	A. C SHPK	A. C SHPK	ACN0287
11	A. K SHPK	V SHPK	VGA0286

12	A. SHPK	A SHPK	ABR0268
13	A SHPK	A. SHPK	
14	A-S SH.P.K	A.-S SH.P.K	AST0013
15	A	N-B SH.P.K	NOB0101
16	A. I. C	N-B SH.P.K	NOB0101
17	B.T	P. G. SHPK	PGP0115
		P-V-K SHPK	
		A SHPK	AKS0099
		A. K SHPK	ACN0287
		BOE "A. K" SHPK & "B" SHPK	
18	B-I SHPK	B-I SHPK	BIS0075
19	A.SHPK	A-2014 SH.P.K	AEO0082
20	D	N-B SH.P.K	NOB0101
21	BOE "A. K" SHPK & "B" SHPK	BOE "A. K" SHPK & "B" SHPK	
22	D SHPK	N-B SH.P.K	NOB0101
23	D. C SHPK	D. C SHPK	
24	E. C	R-A P SHPK	RAL0237/RIA0086
25	GBK SHPK	B.SHPK	BAI0284
26	F C.SHPK, D.C SHPK	M. A. SHPK	MEA0281
27	E / SH SHPK	A. C SHPK	
28	G – P. C SHPK	G. C. SHPK	
29	D	D	
30	E. T. SHPK	E. T SHPK	ETS0244
31	K SHPK	KSHPK	KNT0142/KNT0266
32	G	A P	APO0051/APO0253
33	K. SHPK	F. GJ	
34	K. K SHPK	B.SHPK	BAI0284
35	I. C SHPK	T.TH SHPK	TTL0154
36	G.N. P. SHPK	N-B SHPK	NOB0101
37	G. 2 SHPK	G. 2 SHPK	GNR0109
38	P. SHPK	P. SHPK	
39	N-B SH.P.K	N-B SH.P.K	NOB0101
40	N. C.2012 SHPK, L. CO SHPK	N. C. 2012 SHPK, L. CO SHPK	NCN0200
41	P. G SHPK	P. GSHPK	PGP0115
42	O.C	N-B SH.P.K	NOB0101
43	O. T. C. A. C. S. SHPK	S SHPK	SMR0083
44	M. D SHPK	E. T. SHPK	ETS0244
45	P. SHPK	P.SHPK	
46	S.SHPK	S.SHPK	
47	P-V-K SHPK	P-V-K SHPK	
48	P-V-K SHPK	P-V-K SHPK	
49	U. SHA	O SHPK	ONX0238/OXO0271
50	S. SHPK	S. SHPK	SAU0167
51	U. C. SHPK	V. C SHPK	
52	S. K. SHPK	N-B SHPK	NOB0101
53	U. C SHPK	V. C SHPK	VCN0233
54	U.C.G SHPK	U.C. G SHPK	

Burimi: AKM-përpunuar nga grupi i auditimit.

Ngjyrat në tabelën më sipër paraqiten si më poshtë:

Legjenda	***Situata***
	Kodi Unik miratuar në 2024/nuk ka raportuar në AKM
	Ka raportuar në AKM /IBVS[9]
	Nuk është i qartë destinacioni përfundimtar
	Nuk ka raportuar në AKM
	Në AKM ka deklaruar se nuk ka kryer transferta por tek IBVS rezulton që ka dërguar mbetje
	Deklaron se i kryen me të tretë por nuk e specifikon kush është destinacioni përfundimtar
	Në AKM ka deklaruar se nuk ka kryer transferta në IBVS por tek IBVS rezulton që ka dërguar mbetje

Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Sektori i Informacionit, GIS dhe Regjistrave Mjedisorë rezulton se për periudhën 10.10.2024 - 31.12.2025 janë përcjellë në total **592 shkresa** mbi verifikimin e zbatimit të kushtit nr. 8 "Menaxhimi i mbetjeve" për subjektet e pajisura me leje mjedisore të tipit A dhe B, si në vijim:

Përshkrimi	**Numri i subjekteve**
Subjektet kanë përmbushur detyrimet në lidhje me kushtin 8 të LM	90
Mospërmbushje e kushtit 8, mos raportim i sasisë së mbetjeve, nuk bashkëngjitet kontrata me operatorët transferues	211
Nuk është bashkëngjitur kontrata	283
Të tjera[10]	8
Totali	**592**

[9] Shoqëria koncesionare I.E. B. S sh.p.k

[10] Raste në të cilat është kërkuar revokim, janë nën mbikëqyrjen e doganës, etj., pra nuk përbëjnë problematika.

Burimi: AKM-përpunuar nga grupi i auditimit.

Nga verifikimi i tyre rezultoi se:

-Në **211 raste** raportimet janë të paplota, pasi subjektet nuk kanë paraqitur sasinë e mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme të gjeneruara gjatë vitit, si dhe nuk kanë bashkëlidhur kontratat me operatorë të licencuar për trajtimin e mbetjeve, element ky thelbësor në aktet e miratimit të lejeve mjedisore.

-Në **283 raste** të tjera subjektet nuk kanë bashkëlidhur kontratat përkatëse me transportuesit e mbetjeve.

-Vetëm në **90 raste** subjektet kanë paraqitur informacion të plotë dhe të saktë në përmbushje të kushtit nr. 8 të lejes mjedisore.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" , neni 20, për mbetjet jo të rrezikshme, në pikat 6 dhe 10 përcakton se:

6. "Të gjitha llojet e mbetjeve jo të rrezikshme, që transferohen në baza profesionale nga një person te një tjetër, shoqërohen me një dokument transferimi. Dokumenti i transferimit është i vlefshëm edhe në formë elektronike."

10."Si transferuesi edhe pritësi i mbetjeve i dërgojnë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, një herë në vit, informacion për mbetjet jo të rrezikshme."

Në lidhje me mbetjet e rrezikshme, neni 26, në pikat 1dhe 6 përcakton se:*"Mbetjet e rrezikshme, që dorëzohen nga një person fizik a juridik te një tjetër, shoqërohen me dokument dorëzimi, i cili është i vlefshëm edhe në formë elektronike."*

"Çdo dorëzues, transportues dhe marrës në dorëzim i dërgon çdo 3 muaj Agjencisë Kombëtare të Mjedisit informacion për dorëzimin e mbetjeve."

Mosplotësimi i detyrimeve ligjore për dokumentimin dhe raportimin e transfertave të mbetjeve cenon gjurmueshmërinë e mbetjeve, krijon risk për menaxhim të pakontrolluar të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme, si dhe kufizon aftësinë e AKM për të ushtruar kontroll efektiv mbi zinxhirin e menaxhimit të tyre. Kjo situatë rrit rrezikun për ndotje mjedisore, për transferim informal të mbetjeve dhe për shmangie nga detyrimet ligjore të subjekteve.

Nga sa më sipër konstatohet se një pjesë e konsiderueshme e subjekteve të pajisura me leje mjedisore të tipit A dhe B nuk kanë përmbushur detyrimet ligjore për dokumentimin dhe raportimin e menaxhimit të mbetjeve, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr. 10463, datë 22.09.*2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".*

Kjo situatë tregon mangësi në zbatimin e kuadrit ligjor dhe në mekanizmat e kontrollit institucional mbi përmbushjen e kushteve të lejeve mjedisore.

Për sa më sipër, ky sektor ka informuar me email sektorin e monitorimit mbi problematikat e konstatuara.

-Nga auditimi konstatohet se Sektori i Monitorimit nuk ka ushtruar në mënyrë efektive funksionin e tij monitorues mbi raportimet e subjekteve lidhur me kushtin nr. 8 të lejeve mjedisore, duke mos verifikuar plotësinë e informacionit dhe duke mos kërkuar dokumentacionin mungues. Kjo tregon mangësi në përmbushjen e detyrave funksionale dhe në funksionimin e zinxhirit institucional të monitorimit dhe kontrollit të menaxhimit të mbetjeve.

-Nga auditimi konstatohet se, megjithëse ligji nr. 10463, datë 22.09.2011 *"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"* përcakton detyrime të qarta për kontrollin dhe ndëshkimin e mos raportimit të mbetjeve, këto dispozita nuk janë zbatuar në praktikë, konfirmuar edhe me email-in e datës 13.02.2025 të Sektorit të Informacionit, Statistikave Mjedisore dhe GIS ku citohet se: *"...Në asnjë rast nuk është kërkuar informacion nga Drejtoria e Inspektim Kontrollit mbi raportimin e transfertave të mbetjeve për subjektet që kanë qenë subjekt inspektimi".* Po sipas këtij ligji, neni 56 parashikon se Inspektorati për Mjedisin inspekton instalimet mbi të cilat zbatohet ky ligj, në

përputhje me dispozitat e ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 "*Për mbrojtjen e mjedisit",* duke përcaktuar se inspektimet për çdo operacion grumbullimi dhe transporti duhet të përfshijnë origjinën, natyrën dhe sasinë e mbetjeve të grumbulluara dhe të transportuara deri në destinacionin përfundimtar.
Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet strukturave të AKM-se dhe mungesa e marrjes së masave nga ana e Titullarit të AKM-së ka cënuar mangësi në ushtrimin e funksionit inspektues dhe në zbatimin e kuadrit ligjor për kontrollin e menaxhimit të mbetjeve, duke cenuar efektivitetin e mekanizmave të monitorimit dhe ndëshkimit, si dhe duke rritur rrezikun për menaxhim të pakontrolluar të mbetjeve në kundërshtim me kushtet e lejeve mjedisore.

Nga 211 raste në të cilat raportimet janë të paplota, pasi subjektet nuk kanë paraqitur sasinë e mbetjeve të rrezikshme të gjeneruara gjatë vitit, si dhe nuk kanë bashkëlidhur kontratat me operatorë të licencuar për trajtimin e mbetjeve, të cilat janë potencial ndotës në mjedis, janë pasqyruar rastet në vijim, të vlerësuara me më tepër problematika:

Subjekti	Lenda	Informacioni
Shoqeria "V"SHpk	PN-3459-05-2012 Aktiviteti: Rregjia e lëkurave te paperpunuara dhe shollave.	Ka te dhena sasi mbetje Tabela qe ka pasqyruar nuk eshte sipas formatit te kushteve te lejes dhe nuk ka dhe kodin e mbetjes. Rregjistri i mbetjeve Nentor 2023 - Tetor 2024.Mungon kontrata me subjektet" B. A" Shpk dhe" G. R" Shpk
A. Shpk Elbasan	PN-1531-12-2015.Aktiviteti: "Shkrirja e substancave minerare"	Ka te dhena sasi mbetje Kodi 01 04 99,20 03 01,16 01 03, por formati nuk eshte sipas kushteve te lejes. Periudha Shtator 2023 - Shtator 2024.Nuk eshte bashkangjitur kontrata me subjektin G.R.Eshte ne proces tenderimi per te lidhur kontrate sepse me subjektin G. R ka mbaruar kontrata.
"G. H"	PN-6432-04-2018 Aktiviteti: Magazinim, rikuperim I hekurishteve/ skrapeve te metalit. Grumbullim dhe transportin e mbetjeve te skrapeve/ hekurishteve te metalit	Ka sasi te dhena mbetjesh Kodi 20 01 04 Periudha Janar 2024- Tetor 2024.Tabela nuk eshte sipas kushtit 8 te lejes.
A. P	PN-1577-12-2022 Aktiviteti: Magazinim, rikuperim I hekurishteve/ skrapeve te metalit, ose cmontim I mbetjeve nga motoret e makinave.	Ka sasi te dhena mbetjesh Kodi 20 03 01, 13 03 08* Periudha Janar 2024- Tetor 2024.Tabela nuk eshte sipas kushtit 8 te lejes.
Subjekti M-T Shpk	PN-9903-10-2016 Aktiviteti: Incenerimi I mbetje te rrezikshme ne nje instalim incenerimi.Stacion transferimi per mbetjet e rrezikshme dhe te pa rrezikshme.	Ka te dhena sasi mbetje. Kodi 19 01 13*, 18 01 02*.Periudha Shkurt 2023- Shkurt 2024 Formati nuk eshte sipas kushtit te lejes.Nuk jane bashkangjitur kontrata e sherbimit me operatore te licensuar.
" P. A" Shpk	PN-3426-04-2011 Aktiviteti: Linje per prodhim duralumini.	Ka te dhena sasi mbetje. Kodi 12 01 03. 17 04 02 Mbetjet me kodin 13 02 06* qe gjeneron jane ne sasi te vogla.Kontrata e sherbimit me kontraktoret nuk eshte bashkangjitur.Nuk eshte percaktuar periudha e gjenerimit te mbetjeve.
"A-F"	PN-0403-04-2021 Aktiviteti: Magazinimi i hekurishteve/skrapeve te metalit,ose cmontimi I mbetjeve nga motoret e makinave.	Ka te dhena sasi mbetje. Kodi 13 02 06*, 16 01 17, 16 01 19.Periudha Janar- Tetor 2024.Kontrata e sherbimit me kontraktoret nuk eshte bashkangjitur.Nuk eshte plotesuar kushti 8 lejes.
"M. I"	PN-1781-05-2023 Aktiviteti:Magazinimi I hekurishteve/skrapeve te metalit,ose cmontimi I mbetjeve nga motoret e makinave.	Ka te dhena sasi mbetje. Kodi 13 02 06*, 13 02 07*, 13 02 08*. Periudha Maj- Nentor 2024.Kontrata e sherbimit me kontraktoret nuk eshte bashkangjitur.Kushti 8 i lejes nuk eshte I plote.
" A. D"	PN-4898-04-2017 Aktiviteti:Thertore. Rregjia e lekurave te papunuara dhe shollave.Trajtimi i ujrave te ndotura industriale ne vendin ku krijohen.	Ka te dhena sasi mbetje. Kodi 02 02 01, 02 02 02, 02 02 03,04 01 01,20 03 01. Periudha Nentor 2023- Nentor 2024.RSHTN jashte afatit.Ka kontrata sherbimi me operatore te licensuar, por nuk I ka te bashkangjitur.Nuk eshte plotesuar formulari i kushtit 8 te lejes.
"L. A"	PN-1271-06-2022 Aktiviteti: Magazinim, rikuperim I hekurishteve/ skrapeve te metalit, ose cmontim I mbetjeve nga motoret e makinave.	Ka te dhena sasi mbetje. Kodi 13 02 08*,20 01 33*, 20 01 39.Periudha Janar- Nentor 2024.Nuk ka kontrate sherbimi te bashkangjitur.Nuk eshte plotesuar formulari i kushtit 8 te lejes.
H. S	PN-0793-09-2021 Aktiviteti: Magazinim i hekurishteve/ skrapeve te metalit qe nuk permbajne materiale te rrezikshme.	Ka te dhena sasi mbetje Kodi 20 01 40.Periudha Janar- Nentor 2024. Nuk ka te bashkangjitur kontrate sherbimi me operatore te licensuar.Nuk eshte plotesuar formulari i kushtit 8 te lejes.
R. P	PN-7705-07-2014 Aktiviteti: Industria minerare	Ka te dhena sasi mbetje te gjeneruara per periudhen Janar- Dhjetor 2024. Kodet 20 01 01, 20 03 01.Ka kontrate me subjektin A. L, por nuk e ka te bashkangjitur. Nuk ka plotesuar formatin sipas kushtit 8 te lejes.
"C.M"Shpk	PN-0211-12-2020 Aktiviteti :	Ka te dhena sasi mbetje te duke i ndare ne 2 periudha.Periudha Nentor 2023- Dhjetor 2024. Ne tabelat e formatit te kushtit 8 te lejes nuk jane vendosur sasite e mbetjeve sipas kodeve te mbetjeve. Subjekti grumbullon mbetjet e skrapeve qe i merr nga subjekte te tjera qe i gjenerojne dhe i magazinon tek stacionet e grumbullimit dhe pastaj i tregton. Subjekti "C" ka lidhur kontrate sherbimi.Nuk i ka te bashkangjitur kontratat e sherbimit.
"K. A"Shpk	PN-8960-01-2015 Aktiviteti:Trajtim ose magazinim I peshqve te ngordhur ose mbetjeve te peshqve	Subjekti gjeneron mbetje te ngurta organike nga perpunumi I aguceve te freskta dhe mbetje kripe ne trajte precipitati. Ka te dhena sasi mbetje qe dalin nga procesi teknologjik dhe i ka gjendje ne magazine rreth 49.178.12 kg.kurse mbetjet me kodet 20 01 01, 20 01 11, 20 01 02, 20 01 39, 20 01 40 hidhen ne venddepozitimet e Nj.V. Periudha 26 Dhjetor 2023- 26 Dhjetor 2024.Ka kontrate bashkepunimi me kompanine "S. S. A. R. R" Shpk. Kontrata nuk jane bashkangjitur.Nuk eshte plotesuar formati I kushtit 8 te lejes.
P. V	PN-1974-12-2023 Aktiviteti: Magazinim , rikuperim I hekurishteve / skrapeve te metalit ose cmontimi I mbetjeve nga motoret e makinave. Grumbullim I mbetjeve te gomuara.	Subjekti ka paraqitur Formatin e rregjistrit te transfertave individuale te mbetjeve ku ka dhena sasi me kodet 13 02 06*, 16 01 03, 20 01 01, 20 03 01 por nuk eshte plotesuar ne rregull.Periudha Dhjetor 2023- Nentor 2024.Ka kontrate me subjektet I.I dhe me G. W dhe i ka te bashkangjitur. Nuk eshte plotesuar formati I kushtit 8 te lejes.
"A.R"	PN-2001-01-2024 Aktiviteti: Magazinim , rikuperim I hekurishteve / skrapeve te metalit ose cmontimi I mbetjeve nga motoret e makinave. Grumbullim I mbetjeve te gomuara.	Ka te dhena sasi mbetje Kodi 16 01 03.Periudha Janar -Dhjetor 2024. Nuk eshte plotesuar formati I kushtit 8 te lejes.Nuk ka kontrata te bashkangjitur me subjekte te licensuar.
A Sh.a	PN-6161-09-2013 Aktiviteti: Zhvillimi dhe prodhimi I hidrokarbureve.	Ka te dhena sasi mbetje (m3). Subjekti deklaron se mbetjet me kodet 13 05 07*(kane uje dhe nafte dhe asgjesohen nepermjet grumbullimit ne separator) , 16 07 08*(kane nafte dhe asgjesohen ne gropa dhe sheshe pusesh),16 07 09*(jane te lengshme dhe asgjesohen ne kanalizime).Periudha Shkurt- Dhjetor 2024. Subjekti gjeneron mbetje urbane(meren nga bashkia) dhe mbetje teknologjike qe terhiqen nga subjekte te licensuara. Subjekti eshte ne proces me disa subjekte te licensuar per te lidhur kontrata persa i perket mbetjeve sabione historike dhe atyre aktuale. Ujerat teknologjike qe dalin nga procesi i nxjerjes se naftes injektohen perseri ne puset e injektimit Ca-17, dhe Ca-21.Subjekti deklaron se nuk eshte objekt i RSHTN. Nuk qartesohet se mbetjet qe pasqyrohen ne tabele me sasi mbahen ne subjekt apo terhiqen nga subjekte te licensuar.
A –A	PN-1876-01-2016. Aktiviteti: Trajtime siperfaqesore te metaleve dhe plastikave duke perdorur procese elektrolitike ose kimike. Trajtimi I ujrave dhe ujrave te zeza. Veprimtari te tjera te lyerjes.	Ka te dhena sasi mbetje urbane dhe metalike te Al sipas muajve me kodet perkatese.Periudha Janar - Dhjetor 2024. Nuk eshte plotesuar formati i kushtit 8 te lejes. Mbetjet urbana dergohen ne venddepozitimet e Njesise te qeverisjes vendore, kurse mbetjet metalike riperdoren nga vete aktiviteti duke u ricikluar dhe rifutur ne proces.Subjekti deklaron se nuk eshte objekt i RSHTN.
B	PN-2019-01-2024. Aktiviteti: Stacion transferimi mbetje jo te rrezikshme qe nuk permenden me lart.	Ka te dhena sasi mbetje Kodi 20 03 01. Periudha Janar - Dhjetor 2024. Formati i kushtit 8 te lejes nuk eshte plotesuar.Subjekti deklaron se nuk eshte objekt i RSHTN.Nuk jane bashkangjitur kontratat me subjekte te licensuar.

"B. P." PF	PN-1618-01-2023. Aktiviteti:Menaxhimi i mbetjeve. Prodhimi i produkteve plastike. Rikuperimi i mbetjeve jo te rrezikshme.	Mbetjet urbane qe gjenerohen nga vete subjekti dergohen ne venddepozitimet e Njesise se Qeverise Vendore. Mbetje plastike perdoren si lende e pare ne impiantin e rikuperimit te mbetjeve.Ka te dhena sasi. Subjekti deklaron se nuk eshte objekt i RSHTN. Formati i kushtit 8 te lejes nuk eshte plotesuar.
A. Shpk	PN-6254-02-2018. Aktiviteti: Trajtim dhe perpunim I qumeshtit	Ka te dhena sasi mbetje te ndare sipas muajve me kodet perkatese.Periudha Janar 2024- Janar 2025. Nuk jane plotesuar tabelat e kushtit 8 te lejes.Nuk ka informacion per subjekte qe terheqin mbetjet dhe kontrata e tyre.
G. R Shpk	PN-0923-02-2022. Aktiviteti: Rikuperim I mbetjeve jo te rrezikshme. Magazinim, trajtim, riparim ose rinovim I mbetjeve te pajisjeve elektrike dhe elektronike.Stacion transferimi per mbetje jo te rrezikshme qe nuk permendet me lart.	Ka te dhena sasi mbetje.Periudha Korrik- Nentor 2024. Rregjistri i mbetjeve jo i plote.Tabelat sipas kushtit 8 te lejes nuk jane plotesuar.Kontratat e sherbimit nuk jane bashkangjitur.
B.Z. F Shpk	PN-9071-07-2019. Aktiviteti:Thertore.Asgjesim ose riciklim I karkasave te kafsheve ose mbetjeve te kafsheve me menyra te tjera pervec shnderimit ose incinerimit te permendura ne ndonje veprimtari tjeter te kesaj shtojce. Trajtimi ose perpunimi i materialeve te nevojshme per prodhimin e ushqimeve nga lendet e para nga kafshet(pervec qumeshtit).Magazinimi frigoriferik i produkteve ushqimore te ambalazhuara.Rritje intesive e derrave ne instalim.	Nuk ka te dhena sasi mbetje .Periudha 22 Korrik 2024- 22 Janar 2025. Subjekti deklaron se ka nje impiant renderimi dhe nje impiant te trajtimit te ujrave si dhe eshte duke ngritur nje impiant kompostimi.Subjekti ka lidhur nje kontrate sherbimi me nje subjekt G. M. B. I dhe e ka te bashkangjitur.Kjo kontrate eshte lidhur per rastet e jashtezakonshme kur per arsye te ndryshme(avari makinerie) keto mbetje nuk mund te trajtohen ne impiantin e subjektit. Nuk jane plotesuar tabelat e kushtit 8 te lejes.
"T.T"	PN-1594-01-2023 .Aktiviteti: Magazinim, rikuperim I hekurishteve/ skrapeve te metalit ose cmontim I mbetjeve nga motoret e makinave.	Informacioni i derguar eshte per periudhen Janar 2023- Janar 2024. Per periudhen Janar - Dhjetor 2024 nuk ka informacion.
P Sh.a	PN-0251-01-2021 .Aktiviteti:Prodhimi dhe perpunimi i metaleve. Perpunumi i metaleve ferrore me mullinj me rrula ne te nxehte.Trajtimi siperfaqsor i metaleve dhe plastikave.	Subjekti eksporton mbetje si Zink i Rende dhe Hi Zinku. Importuesi eshte subjekti P.M. S.A. Subjekti ka raportuar sipas Formatit te transfertave te mbetjeve dhe jo sipas kushtit 8 te lejes.Periudha 30 Janar 2024 - 10 Dhjetor 2024.Kodi unik jo i plote. Subjekti ka kontrate me subjektin G. C Shpk si transportues dhe stacioni perfundimtar i mbetjeve eshte subjekti B. A.Kontrata e sherbimi nuk eshte bashkangjitur.
"K" Shpk	PN-1922-09-2023 .Aktiviteti: Magazinimi I hekurishteve/ skrapeve te metalit qe nuk permbajne materiale te rrezikshme.	Ka plotesuar vetem tabelen 8.3.1 te kushtit 8 te lejes ku ka te dhena sasi mbetje per periudhen 19.11.2024-21.02.2025.Informacioni eshte jo I plote.
"N E.A" Shpk	PN-1000-02-2022 .Aktiviteti:Veprimtari te tjera te lyerjes/ veshjes perfshire ato te metalit, plastikes, tekstileve(me perjashtim te stampimit/printimit me makine shtypi rotative te teksileve) pelhurave, filmit, letres.Veprimtari e lyerjes/ veshjes aplikuar ne materiale lekure.	Ka te dhena sasi per mbetjet Firo dhe Skarco per periudhen Gusht 2024- Shkurt 2025. Nuk eshte plotesuar kushti 8 i lejes.
H. T	PN-0789-09-2021 .Aktiviteti: "Thertore"	Subjekti ka paraqitur Rregjistrin e transferimit te mbetjeve ku ka te dhena sasi per periudhen Shtator 2024 - Mars 2025.Ska informacion se nga kush subjekt terhiqen mbetjet qe gjeneron nga aktiviteti.Nuk eshte plotesuar kushti 8 i lejes.
B.P.A L	PN-1682 -03-2023 .Aktiviteti: Asgjesimi I mbetjeve te rrezikshme pervec incinerimit ose lendfillet.	Ka paraqitur vetem Dokumentin e menaxhimit te mbetjeve. Periudha Mars 2024- Mars 2025.
A	PN-0745 -08-2010 .Aktiviteti: Thertore	Ka paraqitur Dokumentin e traansferimit te mbetjeve midis subjektit A(krijuesi i mbetjeve) , subjektit A R (grumbulluesi) , I. (pritesi). Ka mbetje sasi te dhena. Periudha Tetor 2024 - Mars 2025. Nuk eshte plotesuar kushti 8 I lejes.
"S. S"Shpk	PN-3833 -09-2016 .Aktiviteti: Asgjesimi I mbetjeve te rrezikshme, pervec incinerimit ose landfillit.	Ka paraqitur Rregjistrin e mbetjeve te rrezikshme.Kodi nuk eshte i plote. Ka sasi te dhena . Periudha Tetor 2024- Mars 2025.Nuk eshte plotesuar kushti 8 i lejes.
P. M.-G Shpk	PN-3849 -09-2016 .Aktiviteti:Veprimtari te tjera te lyerjes/ veshjes perfshire ato te metalit, plastikes, tekstileve(me perjashtim te stampimit/printimit me makine shtypi rotative te teksileve) pelhurave, filmit, letres.	Nuk ka te dhena sasi mbetje.Periudha Shtator 2024- Mars 2025.
P.Z	PN-0363 -04-2021 .Aktiviteti: Thertore.	Ka te dhena sasi mbetje te ndare sipas muajve. Periudha 08 Prill 2024-08 Prill 2025. Nuk ka plotesuar kushtin 8 te lejes. Nuk ka informacion se kush subjekt terheq mbetjet qe gjeneron subjekti. Subjekti deklaron se nuk eshte objekt i deklarimit te RSHTN.
V	PN-9689 -04-2015 .Aktiviteti:Veprimtari qe nuk perfshihen ne pikat 7.3A dhe 7.3 ose ne pika te tjera te kesaj shtojce qe perfshijne ngrohjen, por jo distilimin e katranit ose bitumit ne lidhje me ndonje veprimtari prodhimi.	Nuk ka te dhena sasi mbetje. Periudha tetor 2024- Mars 2025.
K Sh.a	PN-0380 -04-2021 .Aktiviteti:RingjyrosjeI ose risprucimiiI mjeteve te transportit rrogor ose pjeseve te tyre.riparim dhe mirembajtje e makinerive dhe paisjeve motorike dhe motocikletave.	Subjekti deklaron se nuk eshte objkekt i deklarimit te RSHTN. Ka te dhena sasi mbetje . Periudha Prill 2024-Prill 2025.mbetjet terhiqen nga subjektet A.O dhe Ç, por nuk i kane te bashkangjitur kontratat. Disa mbetje ruhen ne magazine dhe kur krijohet nje sasi e konsiderueshme, subjekti lidh kontrate me subjekte per ti terhequr ato.
Shoqeria B. Shpk	PN-0425 -05-2021 .Aktiviteti: Prodhimi i produkteve plastike.	Nuk ka te dhena sasi mbetje. Periudha 19 Tetor 2024- 19 Prill 2025. Subjekti nga aktiviteti nuk gjeneron mbetje sepse mbetjet futen ne granulatorin dhe pastaj e rifut ne procesin pasues te prodhimit.
E. K.Shpk	PN-9979 -05-2020 .Aktiviteti:Veprimtari te tjera te lyerjes/ veshjes perfshire ato te metalit, plastikes, tekstileve(me perjashtim te stampimit/printimit me makine shtypi rotative te teksileve) pelhurave, filmit, letres.	Ka te dhena sasi mbetje. Periudha 7 Maj 2024- 7 Maj 2025.Rregjistri i mbetjeve eshte paraqitur sipas 3-mujoreve.Subjekti deklaron se nuk ka detyrim te deklaroje RSHTN.Mbetjet qe gjeneron terhiqen nga subjekti C.ML shpk. Nuk eshte plotesuar kushti 8 i lejes.
A Shpk	PN-1777 -05-2023 .Aktiviteti : Perpunimi dhe saldimi i metaleve.	Ka te dhena sasi mbetje te ndare sipas 3- mujoreve. Periudha Janar 2024- Maj 2025. Nuk eshte plotesuar kushti 8 i lejes.Nuk ka informacion se kush i terheq mbetjet qe gjeneron subjekti.
T -A	PN-1227 -05-2022 .Aktiviteti : Thertore	Subjekti deklaron se nuk eshte objekt i RSHTN. Ka te dhena sasi mbetje . Periudha Maj 2024- Maj 2025.Mbetjet teknologjike pasi trajtohen ne impiantin e pastrimit te ujrave te subjektit , kalojne ne kolektorin kryesor te zones dhe pastaj ne impiantin e UK Korce.Mbetjet si plastika , qelqi dergohen ne vendepozitimet e Nj. Q. vendore.
K – F Shpk	PN-1225 -05-2022 .Aktiviteti :Trajtimi dhe magazinimi i peshqeve te ngordhur ose mbetjeve te peshqeve.	Subjekti deklaron se nuk eshte objekt i deklarimit te RSHTN.Ujrat teknologjike qe dalin nga aktiviteti dergohen ne impiantin e trajtimit te ujrave teknologjike e me pas shkarkohen ne kolektorin kryesor per ne gropat e trajtimit te ujrave 2 km larg aktivitetit.
G.B.	PN-1803-06-2023.Aktiviteti: Magazinim, rikuperim i hekurishteve , skrapeve te metalit ose cmontimi i mbetjeve nga motoret e makinave.	Ka te dhena sasi mbetje te ndare sipas 3- mujoreve. Periudha Qershor 2024 - Qershor 2025.Mbetjet qe gjenerohen terhiqen nga subjekti G.W, por nuk eshte bashkangjitur kontrata..Nuk eshte plotesuar kushti 8 i lejes.Subjekti deklaron se nuk eshte objekt i RSHTN.
S Shpk	PN-0479-06-2021.Aktiviteti: Magazinimi I hekurishteve/ skrapeve qe nuk permbajne material te rrezikshem.Riparim dhe mirembajtja e makinerive dhe pajisjeve motorike dhe motocikletave ne qofte se nuk jane permendur diku tjeter ne kete shtojce.	Ka te dhena sasi mbetje te ndare sipas 3- mujoreve. Periudha Qershor 2024 - Qershor 2025.Nuk eshte plotesuar kushti 8 i lejes.Nuk ka informacion se kush i terheq mbetjet qe gjeneron subjekti.Subjekti deklaron se nuk eshte objekt i RSHTN.
A Shpk	PN-2233-12-2024.Aktiviteti: Perpunimi dhe saldimi I metaleve.Veprimtari te tjera te lyerjes/ veshjes perfshire ato te metalit, plastikes, tekstileve(me perjashtim te stampimit/printimit me makine shtypi rotative te teksileve) pelhurave, filmit, letres.	Subjekti deklaron se Raporti i vetmonitorimit eshte paraqitur me CD per periudhen Dhjetor 2024- Qershor 2025. . Te na vihet ne dispozicion per te marre informacion.
B. M. RShpk	PN-0490-06-2021.Aktiviteti:Magazinim, rikuperim i hekurishteve / skrapeve te metalit qe nuk permbajne mbetje te rrezikshme.	Ka te dhena sasi mbetje. Periudha Prill 2024 - Prill 2025.Ka kontrate me subjektin K. I.Subjekti deklaron se nuk gjeneron mbetje , por ai grumbullon serape te ndryshme nga subjekte fizike(mungon informacioni se kush jane) dhe i tregton ato ne subjekte te licensuar(K. I).
A. A Shpk	PN-0085-05-2015.Aktiviteti: Stacion transferimi te mbetjejeve jo te rrezikshme.	Ka te dhena sasi mbetje.Ka paraqitur Rregjistrin e mbetjeve ku krijuesi dhe transportuesi i mbetjeve eshte A. A dhe marresi eshte N. B.Shkoder. . Kodi unik jo i sakte. Periudha 20 Dhjetor 2024 - 22 Prill 2025.Ka paraqitur Rregjistrin e mbetjeve marresi dhe transportuesi i mbetjeve eshte A. A .Ka pasaktesi tek ky rregjister sepse nuk perkon kodi unuk me daten e kryerjes se transfertave.
A Shpk	PN-0085-05-2015.Aktiviteti:Trajtimi siperfaqsor te metaleve dhe plastikave duke perdorur proceset elektrolite ose kimike.Veprimtari te tjera te lyerjes/ veshjes perfshire ato te metalit, plastikes, tekstileve(me perjashtim te stampimit/printimit me makine shtypi rotative te teksileve) pelhurave, filmit, letres.	Ka te dhena sasi mbetje te ndare sipas 3- mujoreve. Periudha Janar 2025 - Maj 2025.Nuk ka informacion se kush i terheq mbetjet qe gjeneron subjekti.Nuk eshte plotesuar kushti 8 i lejes.

M Shpk	PN-1282-06-2022.Aktiviteti:Veprimtari te tjera te lyerjes/ veshjes perfshire ato te metalit, plastikes, tekstileve(me perjashtim te stampimit/printimit me makine shtypi rotative te teksileve) pelhurave, filmit, letres.Perpunimi dhe saldimi i metaleve.	Ka te dhena sasi mbetje te ndare sipas 3- mujoreve. Periudha Qershor 2024 - Qershor 2025. Ka kontrate me R. 2002 dhe e ka te bashkangjitur.Subjekti deklaron se nuk eshte objekt i RSHTN.Nuk eshte plotesuar kushti 8 i lejes.
G. G. G&G	PN-1275-06-2022.Aktiviteti: Linje per prodhimin e produkteve prej gome dhe prodhimi i produkteve mjeksore prej gome.	Ka te dhena sasi mbetje te ndare sipas 3- mujoreve. Periudha Qershor 2024 - Qershor 2025. Ka kontrate me E. E dhe e ka te bashkangjitur.Subjekti deklaron se nuk eshte objekt i RSHTN.Nuk eshte plotesuar kushti 8 i lejes.
I Shpk	PN-2139-07-2024.Aktiviteti:Veprimtari te tjera te lyerjes/ veshjes perfshire ato te metalit, plastikes, tekstileve(me perjashtim te stampimit/printimit me makine shtypi rotative te teksileve) pelhurave, filmit, letres.	Ka te dhena sasi mbetje (metalike skrapi qe gjenerohen nga veprimtaria e lyerjes se metaleve)te ndare sipas 3-mujoreve. Periudha Qershor 2024 - Qershor 2025. Ka kontrate me L.M dhe e ka te bashkangjitur.Subjekti deklaron se nuk eshte objekt i RSHTN.Nuk eshte plotesuar kushti 8 i lejes.
N. I.G Shpk	PN-0212 -12 -2020 .Aktiviteti :Pervec rasteve te permendura ne ndonje nga veprimtarite e tipit A, ne kete shtojce trazimi,bluarja apo perzjerja : Gomez natyrale, ose Elastmereve me perbrje sintetike organike, nqse nuk eshte perdorur karboni I zi.	Ka te dhena sasi mbetje te ndare sipas 3- mujoreve. Periudha Janar 2024 - Dhjetor 2024. Subjekti prodhon guarnicione (gomina) industriale te formave te ndryshme qe i eksporton ne shtetin italian.Nuk eshte plotesuar kushti 8 i lejes.Kerkojme informacion me te detajuar se nga kush subjekt tehiqen mbetjet qe gjenerohen nga aktiviteti dhe kontratat e sherbimit. Per 6- mujorin e vitit 2025 nuk kemi asnje te dhene.
A	PN-3527-08 -2016 .Aktiviteti : Rritje intensive e derrave ne nje instalim.Thertore.Prodhimi I ushqimeveper kafshe.Trajtim dhe perpunim i materialeve te nevojshme per prodhimin e ushqimeve nga lendet e para nga kafshet pervec qumeshtit.	Nuk ka te dhena sasi mbetje . Periudha Korrik 2024 - Korrik 2025. Subjekti deklaron se mbetje urbane largohen cdo dite pasi behet ndarja e tyre per riciklim.Plehu i nxjere nga aktiviteti u shitet operatoreve te licensuar qe e perdorin si pleh organik nga fermeret. Nuk ka informacion se kush jane keto operatore te licensuar.Subjekti deklaron se nuk eshte objekt i RSHTN.
A. O & G Sh.a	PN-6741-07 -2018 .Aktiviteti : Nxjerja e naftes dhe e gazit natyror.	Ka te dhena sasi mbetje sipas kodeve te mbetjes. Periudha Korrik 2024 - Korrik 2025. Ka lidhur kontrate me shoqerine A Sh.a . Ne rast se gjeneron mbetje hidrokarbure i depoziton ne gropen ekologjike ne Zharres kundrejt pageses me A.Uji i perzier me nafte qe grumbullohet ne separator rikthehet serish ne procesin e trajtimit, me qellim qe te ndahet uji nga nafta.ungon kontrata.
A - F Shpk	PN-0636-07 -2021 .Aktiviteti : Rritja intensive e shpendeve ne nje instalim.	Ka te dhena sasi mbetje . Periudha Korrik 2024 - Korrik 2025. Subjekti deklaron se gjate aktivitetit nuk gjeneron mbetjet e deklaruara ne kushtin 8 te lejes mjedisore , por gjeneron mbetjet 02 02 01, 02 02 02, 02 02 03 qe i terheq subjekti B.Z. F qe ka lidhur dhe kontrate sherbimi.Subjekti ka kontrate dhe me subjektin A. R ,por nuk i ka te bashkangjitur.Ka paraqitur RSHTN me CD. Mbetjet me kodin 02 01 06 perdoren si pleh kimik
A. H.PF	PN-5662 -08-2017 .Aktiviteti:Magazinimi, rikuperimi i hekurishteve/ skrapeve te metalit ose cmontimi i mbetjeve nga motoret e makinave.	Ka te dhena sasi mbetje te ndare sipas 3- mujoreve. Periudha 14 Gusht 2024 - 14 Gusht 2025.Ka kontrate me subjektin F. L< A. O, Sh Shpk. Subjekti deklaron se nuk eshte objekt i RSHTN
V shpk	PN-1368 -08-2024.Aktiviteti : Trajtimet me rregjie dhe prodhim i lekures. Veprimtari te tjera qe perfshijne perdorimin e solventeve.	Ka te dhena sasi mbetje te ndare sipas 3- mujoreve. Periudha Janar - Korrik 2025.Informacioni i derguar nga subjekti nuk eshte i plote.
J-11 Shpk	PN-0771 -08-2021.Aktiviteti : Magazinim i hekurishteve ose skrapeve te metalit qe nuk permbajne materiale te rrezikshme.	Ka te dhena sasi mbetje te ndare sipas 3- mujoreve. Periudha 26 Gusht 2024 - 26 Gusht 2025.Ka kontrate me subjektin F. L dhe D-2005, por nuk i ka te bashkangjitur.. Subjekti deklaron se nuk eshte objekt i RSHTN. Nuk eshte plotesuar kushti 8 i lejes.
T. L Shpk	PN-1383-09-2022. Aktiviteti : Prodhim kepucesh.	Ka paraqitur Akt- Marveshjen per asgjesim mbetjesh midis subjektit G. C Shpksi pranues dhe transportues i mbetjeve dhe T. L (depozituesi i mbetjeve)dhe B. A Park & L. I (pritesi i mbetjeve). Ka te dhena sasi mbetje te ndare sipas 3- mujoreve. Periudha Janar 2024 - Dhjetor 2024 , Janar 2025-Shtator 2025.Nuk eshte plotesuar kushti i 8 i lejes.
A.Shpk	PN-1390 -09-2022. Aktiviteti : Prodhimi dhe perpunimi I metaleve dhe plastikave duke perdorur procese elektrolitike dhe kimike.	Ka te dhena sasi mbetje te ndare sipas 3- mujoreve. Periudha Janar 2024 - Dhjetor 2024 , Janar 2025-Gusht 2025.Nuk ka informacion se kush subjekt i terheq mbetjet qe gjeneron subjekti. Nuk ka plotesuar kushtin 8 te lejes.
G. W Shpk	PN-1918 -08-2023. Aktiviteti : Asgjesimi i vajrave te perdorur pervev incinerimit (5.1.a) ose lendfillit (5.2.a). Stacion transferimi per mbetje te rrezikshme dhe jo te rrezikshme qe nuk permenden me lart.	Subjekti nuk gjeneron vete mbetje, por i terheq nga subjekte qe i gjenerojne dhe i magazinon ne Stacionin e transferimit te mbetjeve te ndara (te rrezikshme dhe jo te rrezikshme). Periudha Gusht 2024 - Gusht 2025.Nuk ka informacion se subjekti G. W nga kush subjekt terheq mbetjet qe magazinon dhe kush jane subjektet qe i terheqin mbetjet nga G. W.Subjekti deklaron se nuk eshte objekt i RSHTN.
M. Z	PN-0791-09-2021. Aktiviteti : perpunimi dhe saldimi I metaleve	Ka te dhena sasi mbetje .Periudha Mars- Shtator 2025. Nuk ka plotesuar kushtin 8 te lejes.
H. T PF	PN-0789-09-2021. Aktiviteti : Thertore.	Ka te dhena sasi mbetje .Periudha Mars- Shtator 2025. Ka plotesuar vetem tabelen 8.3.1 te kushtit 8 te lejes. Ka lidhur kontrate me subjektet BZM0330 (kodi unuk jo I plote) dhe me A.Z.R , por nuk I ka te bashkangjitur.
E. L	PN-1068-03-2022. Aktiviteti : Veprimtarite e prodhimit te letres , pulpes, derrases.	Nuk hapet Derguar nga E
M.V.A C.A Shpk	PN-1421-09-2022. Aktiviteti : Veprimtarite e mbulimit te siperfaqes dhe te stampimit. Prodhimi I produkteve plastike.	Ka te dhena sasi mbetje .Periudha Mars- Shtator 2025. Ka plotesuar vetem tabelen 8.3.1 te kushtit 8 te lejes.Nuk ka informacion se kush i terheq mbetjet qe gjeneron subjekti.
M. V.Shpk	PN-. Aktiviteti : Prodhim i produkteve abrazive dhe produkteve te tjera minerale.	Ka te dhena sasi mbetje te ndare sipas 3- mujoreve Periudha Mars - Shtator 2025. Nuk eshte plotesuar kushti i 8 i lejes ..Nuk ka informacion se kush i terheq mbetjet qe gjeneron subjekti.
A. Shpk	PN-9300-09-2019. Aktiviteti :Ringjyrosja ose risprucimi i mjeteve te transportit rrugor ose pjeseve te tyre. Lyerja dhe lustrimi i makinave . Riparimi dhe mirembejtja e pajisjeve motorike dhe motocikletave	Ka te dhena sasi mbetje te ndare sipas 3- mujoreve Periudha Janar - Shtator 2025. Nuk eshte plotesuar kushti i 8 i lejes .Subjekti deklaron se nuk eshte objekt i RSHTN.Ka lidhur kontrate me subjektin G. W (vajrat) dhe A. C. C (skrap, plastike) ,por nuk i ka te bashkangjitur.A ka kontrate me B. A (pritesi i mbetjeve) dhe G.C (transportuesi i mbetjeve).
S Shpk	PN-3833-09-2016 Aktiviteti: Azgjesimi I mbetjeve te rrezikshme , pervec incinerimit ose landfillit.	Ka sasi te dhena . Periudha 1 Shtator - 19 Shtator 2025. Ka paraqitur Rregjistrin e mbetjeve.Nuk eshte plotesuar kushti 8 i lejes. Tek rregjistri qe ka paraqitur kodi unik i SMR(S Shpk) nuk eshte I sakte.
H.T PF	PN-0789-09-2021. Aktiviteti : Thertore.	Ka sasi te dhena . Periudha Shtator 2024 - Shtator 2025.Nuk eshte plotesuar kushti 8 i lejes. Nuk ka informacion se kush subjekt i terheq mbetjet qe gjeneron subjekti.
M - B M.B	PN-1131-04-2022. Aktiviteti: Perzjerja e cimentos ose perdorimi i saj ne mase te madhe ,por jo ne sheshin e ndertimit , perfshire ambalazhimin dhe perzjerjen e cimentos ,grumbullim i betonit dhe prodhimi I blloqeve te betonit dhe produkteve te tjera te cimentos	Nuk ka te dhena sasi mbetje . Periudha 4 Prill - Tetor 2025.
M. L	PN-1117-04-2022. Aktiviteti:Magazinimi, rikuperimi i hekurishteve/ skrapeve te metalit ose cmontimi i mbetjeve nga motoret e makinave.	Nuk hapet
A. P	PN-9442-10-2019. Aktiviteti:Prodhim i alkolit dhe pijeve alkolike duke perfshire fabrikat e birrave.Trajtim dhe perpunim i materialeve te nevojshme per prodhimin e ushqimevenga lendet e para nga kafshet pervec (pervec qumeshtit) Trajtim dhe perpunim i qumeshtit	Ka te dhena sasi mbetje . Periudha Janar- Dhjetor 2024. Janar -Shtator 2025.Nuk eshte plotesuar kushti 8 I lejes. Nuk ka informacion se kush subjekt i terheq mbetjet qe gjeneron subjekti.
Q.S	PN-6425-11-2013. Aktiviteti: Stacion transferimi per mbetje te rrezikshme.Riparim dhe mirembajtje e makinerive e pajisjeve.	Ka te dhena sasi mbetje . Periudha Tetor 2024 -Tetor 2025.Ka kontrate me subjektin I. I Sh.a dhe e ka te bashkangjitur. Nuk eshte plotesuar kushti 8 I lejes.
A. Shpk	PN-2345-05-2025. Aktiviteti: Prodhim dhe ambalazhim i pijeve joalkolike.	Ka te dhena sasi mbetje te ndare sipas 3- mujoreve. Periudha Prill 2025 - Tetor 2025. Nuk ka plotesuar kushtin 8 te lejes. Nuk ka informacion se kush subjekt i terheq mbetjet qe gjeneron subjekti.
A. M. SShpk	PN-0863-11-2021.Aktiviteti : Lyerje dhe lustrim i makinave. Riparim I makinerive dhe pajisjeve motorike dhe motocikletave,nqse nuk jane permendur diku tjeter ne kete shtojce.	Ka te dhena sasi mbetje te ndare sipas 3- mujoreve. Periudha Tetor 2024 - Tetor 2025. Nuk ka plotesuar kushtin 8 te lejes.Subjekti deklaron se nuk eshte objekt i RSHTN.Ka kontrate me subjektin A. O, dhe e ka te bashkangjitur.
M. Shpk	PN-0418-04-2021. Aktiviteti: Magazinim , trajtim, riparim ose rinovim i pajisjeve elektrike dhe elektronike.Magazinimi, rikuperimi i hekurishteve/ skrapeve te metalit ose cmontimi i mbetjeve nga motoret e makinave. Stacion transferimi i mbetjeve te rrezikshme dhe jo te rrezikshme qe nuk permenden me lart.	Ka te dhena sasi mbetje . Periudha Korrik 2025 - Tetor 2025. Ka plotesuar vetem tabelen 8.3.1 te kushtit 8 te lejes.Nuk ka informacion se kush subjekt i terheq mbetjet qe gjeneron gjate aktivitetit.
K. I Shpk	PN-9585-11-2019. Aktiviteti: Nxjerja e mineraleve te reres,dhe argjiles nga minierat me shfrytezim ne qiell te hapur dhe nga gurroret.	Ka te dhena sasi mbetje te ndare sipas 3- mujoreve. Periudha Nentor 2024 - Tetor 2025. Nuk ka plotesuar kushtin 8 te lejes.
G Shpk	PN-4186-11-2016. Aktiviteti :Perzjerja e cimentos ose perdorimi i saj ne mase te madhe ,por jo ne sheshin e ndertimit , perfshire ambalazhimin dhe perzjerjen e cimentos ,grumbullim i betonit dhe prodhimi i blloqeve te betonit dhe produkteve te tjera te cimentos.	Ka te dhena sasi mbetje te ndare sipas 3-mujoreve. Periudha Dhjetor 2024 - Nentor 2025. Nuk ka informacion se kush subjekt i terheq mbetjet qe gjenerohen nga aktiviteti.

Sh.-A	PN-7354-10-2018. Aktiviteti:	
Ch. L	PN-5084-05-2017. Aktiviteti: Rritje intensive e shpendeve ne nje instalim.	Ka te dhena sasi mbetje. Periudha Maj - Nentor 2025. Ka plotesuar vetem tabelen 8.1.2 te kushtit 8 te lejes. Nuk ka informacion se kush subjekt i terheq mbetjet qe gjenerohen nga aktiviteti.
T.10 Shpk	PN-7533-11-2018. Aktiviteti: Prodhimi i këpucëve. Riparim dhe mirëmbajtje e makinerive dhe pajisjeve.	Ka te dhena sasi mbetje te ndare sipas 3-mujoreve. Periudha Janar - Nentor 2025. Nuk ka plotesuar kushtin 8 te lejes. Nuk ka informacion se kush subjekt i terheq mbetjet qe gjenerohen nga aktiviteti.
L. R	PN-2212-10-2024. Aktiviteti: Lyerja dhe lustrimi i makinave.	Ka te dhena sasi mbetje te ndare sipas 3-mujoreve. Periudha Janar - Nentor 2025. Nuk ka plotesuar kushtin 8 te lejes.Ka lidhur kontrate me subjektet A. P (mbetje urbane) dhe N. C PF (mbetje Skrap) dhe i ka te bashkangjitur.
E Shpk	PN-0159-11-2020. Aktiviteti : Magazinimi i hekurishteve/skrapeve te metalit qe nuk permbajne materiale te rrezikshme.	Ka te dhena sasi mbetje. Periudha Nentor 2024 - Nentor 2025. Subjekti deklaron se magazinon hekurishte /skrap dhe ua shet kompanive te riciklimit dhe nuk eshte objekt i RSHTN.
ND P. B. P M. E M	PN-0862-11-2021. Aktiviteti :Lendfilli i mbetjeve (D1) duke perjashtuar lendfillin e mbetjeve inerte.	Subjekti deklaron se gjate aktivitetit gjeneron mbetje me kod 19 06 03, 19 06 04, 19 07 03 te cilat terhiqen nga subjekte te licensuar. Nuk ka informacion se kush jane keto subjekte.Ka paraqitur RSHTN per vitin 2025. Periudha Nentor 2024 - Nentor 2025.
B. A	PN-0874-11-2021. Aktiviteti :Lendfill i mbetjeve (D1) duke perjashtuar lendfillin e mbetjeve inerte.ID 5.2 b. Lendfill i mbetjeve inerte.ID 5.3 e.Asgjesimi i mbetjeve jo te rrezikshme me metoda te tjera perve (D1), (D8) ose (D9).ID 5.4 b. Rikuperimi i mbetjeve te rrezikshme me ane te operacioneve R2, R3, R4, R7 ose R10. ID 5.4 c. Rikuperimi i mbetjeve jo te rrezikshme. ID 5.5 Magazinimi i hekurishteve/skrapeve te metalit qe nuk permbajne materiale te rrezikshme.ID 5.8 Magazinim, rikuperim i hekurishteve/skrapeve te metalit ose cmontim i mbetjeve nga motorret e makinave.ID 5.10 a. Stacion transferimi per mbetje te rrezikshme qe nuk permendet me lart.ID 5.10 b. Stacion transferimi per mbetje jo te rrezikshme qe nuk permendet me lart.ID 6.2 Trajtim ujërave të ndotura industriale ne vendin ku krijohen.	Ka te dhena sasi mbetje te rrezikshme dhe jo te rrezikshme per periudhen Nentor 2024- Nentor 2025. Ka paraqitur Rregjistrin e mbetjeve qe jane pranuar ne landfill me sasite perkatese te tyre.Nuk ka informacion se kush subjekte i ka sjelle mbetjet.
C. C Shpk	PN-9450-10-2019. Aktiviteti : Magazinim i përkohshëm i mbetjeve duke përfshirë tepricat e produkteve nga kontenierët ose nga larjet e kontenierëve, dhe çdo mbetje të rrezikshme në mjediset pritëse të një zone portuale dhe ku mbetjet janë magazinuar për jo më shumë se 7 ditë.	Ka te dhena sasi mbetje te ndare sipas 3-mujoreve. Periudha Qershor - Nentor 2025.Nuk eshte plotesuar kushti 8 i lejes. Nuk ka informacion se kush subjekt i terheq mbetjet qe gjenerohen nga aktiviteti.
A-K-B A	PN-1540-12-2022. Aktiviteti : Perzierja e cimentos oseperdorimi i cimentos ne mase te madhe,por jo ne sheshin e ndertimit, perfshire ambalazhimin dhe perzierjen e cimentos, grumbullim i betonit dhe prodhimi ibllоqeve te betonit dhe produkteve te tjera te cimentos, si dhe prodhimi i i llacit, kolles,gelqeres (parafabrikateve, paletave, etj). Veprimtarite e katranit dhe te bitumit, -ID 7.3.c Veprimtarite qe nuk perfshihen ne pikat 7.3.a ose 7.3.b ose ne pika te tjera te kesaj Shtojce, qe perfshijne ngrohjen, por jo distilimin e katranit ose bitumit ne lidhje me ndonje veprimtari prodhimi.	Ka te dhena sasi mbetje te ndare sipas 3-mujoreve. Periudha Maj - Nentor 2025.Nuk ka informacion se kush subjekt i terheq mbetjet qe gjenerohen nga aktiviteti.Nuk eshte plotesuar kushti 8 i lejes.
A. Y PF	PN-1239-06-2022. Aktiviteti : Qender Shendetësore	Ka te dhena sasi mbetje te ndare sipas 3-mujoreve. Periudha Janar- Dhjetor 2025. Nuk ka informacion se kush subjekt i terheq mbetjet qe gjenerohen nga aktiviteti. Nuk eshte plotesuar kushti 8 i lejes.
M SHPK	PN-7228-05-2014. Aktiviteti : "Kantina e verës Miqësia".	Ka te dhena sasi mbetje te ndare sipas 3-mujoreve. Periudha Korrik- Dhjetor 2025.Nuk ka informacion se kush subjekt i terheq mbetjet qe gjenerohen nga aktiviteti. Nuk eshte plotesuar kushti 8 i lejes.
A. A Shpk	PN-0085-05-2015.Aktiviteti: Stacion transferimi te mbetjejeve jo te rrezikshme.	Ka te dhena sasi mbetje.Ka paraqitur Rregjistrin e mbetjeve ku krijues i tyre jane 14 subjekte dhe marresi dhe transportuesi i mbetjeve eshte A. A .Nuk ka te bashkangjitur kontrata sherbimi.Periudha 22 Maj 2023 -02 Dhjetor 2025.
A Shpk	PN-2233-12-2024. Aktiviteti : Veprimtari të tjera të lyerjes/veshjes përfshirë ato të metalit,plastikes, tekstileve (me përjashtim të stampimit/printimit me makinë shtypi rotativë të tekstileve),pelhurave filmit dhe letrës. Perpunimi dhe saldimi i metaleve.	Nuk ka sasi te dhena sasi mbetje. Periudha 3 Qershor- 3 Dhjetor 2025. Ka plotesuar vetem tabelen 8.1.2 te kushtit 8 te lejes. Ka kontrate sherbimi me subjektin F. 2006 (mbetje urbane, mbetje teknologjike, terheqjen e ujrave te zeza) dhe R. G. (mbetje metali), dhe i ka te bashkangjitur.Tek Shkresa percjellse derguar nga subjekti Leja mjedisore me PN-8019-01-2019 i takon subjektit J&F.
A. G Shpk	PN-8825-06-2019. Aktiviteti: Trajtim ose magazimin i peshqve të ngordhur ose mbetjeve të peshqve.	Ka te dhena sasi mbetje. Periudha Qershor - Dhjetor 2025. Nuk ka plotesuar kushtin 8 te lejes. Nuk ka informacion se kush subjekt i terheq mbetjet qe gjenerohen nga aktiviteti.
N. I. G Shpk	PN-8825-06-2019. Aktiviteti: Përveç rasteve të përmendura në ndonje nga veprimtarite e tipit A, ne kete shtojce, trazimi, bluarja ose perzierja e gomes natyrale; ose elastomereve me perberje sintetike organike, n.q.s. eshte perdorur karboni i zi.	Ka te dhena sasi mbetje. Periudha Janar - Nentor 2025. Nuk ka plotesuar kushtin 8 te lejes. Nuk ka informacion se kush subjekt i terheq mbetjet qe gjenerohen nga aktiviteti.
A. HPF	PN-0065-07-2020. Aktiviteti: Lyerja dhe lustrimi i makinave. Riparim dhe mirembajtje e makinerive dhe pajisjeve motorike dhe motocikletave n.q.se nuk jane permendur diku tjeter ne kete shtojce.	Ka te dhena sasi mbetje te ndare sipas 3- mujoreve. Periudha Korrik 2025- Janar 2026. Nuk eshte plotesuar kushti 8 i lejes.Nuk ka informacion se kush subjekt i terheq mbetjet qe gjenerohen nga aktiviteti.
D. Shpk	PN-6208-09-2013. Aktiviteti: Rritje intensive e shpendëve në një instalim.	Nuk ka te dhena sasi mbetje,sepse mbetjet qe gjenerohen perdoren per pleherimin e tokave. Periudha Janar 2025- Janar 2026. Subjekti deklaron se nuk eshte objekt i RSHTN.

Burimi: AKM-përpunuar nga grupi i auditimit.

Grupi i auditimit, mori me përzgjedhje 5 raste të vlerësuara me risk, në drejtim të krijuesit dhe transportuesit të mbetjeve të rrezikshme me qëllim evidentimin e destinacionit përfundimtar të mbetjeve, ku rezultoi si në vijim:

1. Subjekti E

Kodi i mbetjes	Përshkrimi i Mbetjes	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
18 02 02*	Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave u nënshtrohen kërkesave të veçanta për të parandaluar infeksionet		1424	1974

18 01 01/18 01 03*	Bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 01 03)/Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave u nënshtrohen kërkesave të veçanta për të parandaluar infeksionet	603978.7	614023.1	60306.5
18 01 08*	Medikamente citostatike dhe citotoksike	1095.3	6120.62	6431.87
18 01 03*	Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave u nënshtrohen kërkesave të veçanta për të parandaluar infeksionet	29746.86	128489.91	744037.64

Nga auditimi konstatohet se: Subjekti E, gjatë tre viteve të raportimit, ka marrë mbetje nga klinika dhe spitale private të ndryshme, si 3 L.L dhe S. A (njësitë I, II dhe III), si edhe nga laboratorë të ndryshëm, Njësi Vendore të Kujdesit Shëndetësor, Qendra Shëndetësore dhe spitale të tjera. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga sektori i vetëmonitorimeve rezulton se është përcjellë vetëm raporti për periudhën Maj 2024 – Maj 2025. Në kuadër të këtij raporti vjetor janë dërguar vetëm tabelat në format Excel, të cilat subjekti i ka deklaruar edhe në fazat e raportimit të regjistrave të transfertave individuale për periudhat 1–15 Maj dhe 1–15 Nëntor. Ndërkohë, informacioni në zbatim të kushtit nr. 8, "Menaxhimi i mbetjeve", ku duhet të deklarohet edhe sasia e mbetjeve të gjeneruara, nuk është përcjellë.

2. Subjekti P

Kodi i mbetjes	Përshkrimi i Mbetjes	Viti 2024	Viti 2025
13 02 08*	Vaj sintetik motori, ingranazhi dhe lubrifikues	10,000	
13 02 06*	Vaj sintetik motori, ingranazhi dhe lubrifikues		1790

Nga auditimi konstatohet se: Subjekti PGroup është pajisur me licencë të kategorisë III.2.B, me datë 15.10.2024, me nr. protokolli 6478, Nr. Identifikimi të Lejes 545 dhe K.Nr. 73.

Për periudhën Tetor 2024 – Dhjetor 2024, subjekti ka vepruar në cilësinë e marrësit të mbetjeve, ndërsa dorëzuesit kanë qenë persona fizikë (kryesisht servise). Për vitin 2025, subjekti ka raportuar se ka marrë një sasi totale prej 1,790 kg mbetje, të gjeneruara nga persona fizikë si dhe nga A. Ky subjekt është pajisur me leje mjedisore në korrik 2023, me nr. PN-1872-07-2023. Në zbatim të kushtit nr. 12 të kësaj lejeje, raportet vjetore duhet të dorëzohen brenda datës 17 korrik 2024 dhe 17 korrik 2025. Megjithatë, të dy këto raporte, nga të cilat mund të verifikohet sasia e mbetjeve të gjeneruara, nuk janë përcjellë nga ky subjekt.

3. Subjekti B

Kodi I mbetjes	Përshkrimi i Mbetjes	Viti 2024	Viti 2025
17 02 04*	Dru, qelq dhe plastika që përmbajnë substancë të rrezikshme	139320	
05 01 03*	Llumra të fundit të depozitave	9516723	3311200
13 02 06*	Vaj sintetik motori, ingranazhi dhe lubrifikues		13560

Në raportin vjetor për periudhën Gusht 2024 – Gusht 2025, të përcjellë nga sektori i vetëmonitorimeve, deklarohet se sasia prej 35.5 ton mbetje me kod 17 02 04* është transferuar tek subjekti G. Ndërsa sasia prej 5.86 ton me kod 05 01 03* rezulton të jetë transferuar brenda vetë subjektit B. P, konkretisht nga një gropë ekologjike në një tjetër.

4. Subjekti V. R

Kodi i mbetjes	Përshkrimi i Mbetjes	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
19 01 11*	Hira fundore dhe numra që përmbajnë substanca të rrezikshme	27.85	100	
18 01 08*	Medikamente citostatike dhe citotoksike	793.1	51.8	
18 01 03*	Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave u nënshtrohen kërkesave të veçanta për të parandaluar infeksionet			
18 01 02/18 01 08*	Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset e gjakut dhe rezervat e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03)/ Medikamente citostatike dhe citotoksike		14821.73	
18 01 01/18 01 03*/ 18 02 01/18 02 02*	Bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 01 03)/ Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave u nënshtrohen kërkesave të veçanta për të parandaluar infeksionet/Bisturi, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 02 02)/ Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave u nënshtrohen kërkesave të veçanta për të parandaluar infeksionet	119039.55	37792.38	198408.2

Subjekti V. R, bazuar në lejen mjedisore me nr. PN-9488-03-2015, ka detyrimin të dorëzojë raportin vjetor çdo datë 20 qershor. Nga sektori i vetëmonitorimit është përcjellë raporti për periudhën Mars – Shtator 2025, sipas të cilit sasia totale e mbetjeve spitalore të rrezikshme të trajtuara arrin në 115,194.84 kg. Këto mbetje janë trajtuar përmes procesit autokllavë.

Për sa më sipër, grupi i auditimit nuk është në gjendje të vlerësojë efektin që do të kishte rezultuar nga aplikimi i penaliteteve, për shkak të mungesës së inspektimeve që do të vlerësonte situatën e subjekteve në raport me mbetjet.
Për sa trajtuar më sipër ngarkohen me përgjegjësi Titullari i AKM për periudhën 01.01.2023-23.10.2025 znj. A. D dhe përgjegjësi Sektori i Informacionit GIS dhe Regjistrave Mjedisor znj. E. Sh.

Fusha e veprimtarisë së Sektorit të Laboratorit, Teknologjisë dhe Infrastrukturës Mjedisore
Bazuar në rregulloren nr. 120, datë 12.01.2021 *"Rregullore e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit",* Sektori i Laboratorit, Teknologjisë dhe Infrastrukturës Mjedisore ka për përgjegjësi kryesore organizimin dhe realizimin e analizave laboratorike, menaxhimin e procesit të mostrimit dhe sigurimin e funksionimit të laboratorit në përputhje me standardet e cilësisë dhe kërkesat ligjore. Përgjegjësi i sektorit koordinon punën e stafit sipas planeve të monitorimit, siguron pajisjen e laboratorit me mjete dhe teknologji të nevojshme, administron burimet financiare dhe garanton zbatimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë. Gjithashtu, ai siguron që analizat dhe mostrimet të kryhen sipas metodave të certifikuara ose të validuara, ruajtjen dhe integritetin e të dhënave laboratorike, përgatitjen dhe raportimin e rezultateve, si dhe menaxhimin e kontratave me ofrues të jashtëm të shërbimeve, duke garantuar cilësinë dhe eficiencën e kostos. Në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm, mbështet zhvillimin profesional të stafit, zbatimin e praktikave të sigurta në punë dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës laboratorike dhe teknologjike.
Në nivel operativ, përgjegjësi i laboratorit dhe specialistët realizojnë analizat sipas profileve përkatëse (komponentë organikë, metale të rënda, ndotës në ajër, zhurma, si dhe procesin e mostrimit), duke zbatuar sistemin e cilësisë, programet e monitorimit dhe procedurat e certifikuara të analizës dhe mostrimit. Specialistët janë përgjegjës për përpunimin dhe raportimin e të dhënave, ruajtjen e tyre në formë elektronike, bashkëpunimin brenda ekipit dhe me strukturat e tjera teknike, si dhe për zhvillimin e programeve të analizave sipas kërkesave të laboratorit. Gjithashtu, ata kontribuojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së analizave, në rritjen profesionale të stafit dhe në sigurimin e zbatimit të standardeve të sigurisë dhe cilësisë në të gjitha proceset laboratorike dhe të mostrimit.
Lidhur me monitorimet që Laboratori ka kryer jashtë PKMM për vitin 2023 janë realizuar 13 inspektime ku janë marrë në total 23 mostra, nga të cilat 16 janë mbi normë.
Për vitin 2024, në periudhën Janar-Maj janë realizuar 8 inspektime ku janë marre 8 mostra në total, nga të cilat 3 janë mbi normë.
Në datën 02.05.2024 në Drejtorinë e Menaxhimit të të Dhënave Mjedisore, Kimikateve, Analizave Laboratorike dhe Inovacionit, u krijua Sektori i Mostrimit dhe i Shkarkimeve në Mjedis, aktiviteti i të cilit paraqitet si në vijim:
Për periudhën Maj-Dhjetor 2024 janë kryer 21 mostrime, të cilat janë dërguar në Laboratorin e AKM. Në këtë numër analizash të kryera në vitin 2024, 33 mostra kanë dalë me ndotje dhe 14 pa ndotje. Për periudhën Janar-Dhjetor 2025 janë kryer 18 mostrime, nga të cilat 27 mostra kanë dalë të ndotura dhe 16 pa ndotje.
Nga auditimi u evidentua se, nga gjithsej 51 raste në të cilat janë kryer analiza laboratorike për mostrat e marra në instalimet e subjekteve me ndikim në mjedis, në 40 raste rezultatet kanë evidentuar ndotje/tejkalim të normave të lejuara mjedisore. Megjithatë, për këto 40 raste nuk rezulton që titullari i institucionit pasi ka marrë dijeni për rezultate, të ketë iniciuar inspektime mbi bazë indiciesh të dala nga rezultatet negative laboratorike. Ndërkohë, në 11 raste kërkesat për analiza dhe ndjekje të mëtejshme kanë ardhur nga vetë ARM-të, në bashkëpunim me institucione

të tjera. Po ashtu, nuk evidentohet informim sistematik i Drejtorisë së Inspektimit dhe Kontrollit mbi rezultatet e analizave, si për rastet me tejkalim normash, ashtu edhe për ato brenda normave të lejuara, duke krijuar mangësi në ndjekjen dhe monitorimin institucional të subjekteve ndotëse. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011, "Për Lejet e Mjedisit", i ndryshuar; ligjit nr. 111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", i ndryshuar; ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar; si dhe ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë". *Për sa trajtuar më sipër ngarkohen me përgjegjësi: Titullari i AKM për periudhën 01.01.2023-23.10.2025 znj. A. D, mbi mungesën e mbarëvajtjes dhe koordinimit të strukturave të AKM-së për problematikat e konstatuara.*

Mbi praktikat e ndjekura për marrjen e mostrave dhe rezultatet laboratorike

Nga rastet e evidentuara me rezultate analizash mbi normë, grupi i auditimit kryqëzoi këto raste analizash me databzën e inspektimeve të kryera nga AKM/ARM-të nga ku rezultoi se për 1 rast, konkretisht për subjektin "N" nga inspektimi është vendosur masa "Paralajmërim" edhe pse analizat kanë rezultuar me vlera mbi normë, trajtuar si në vijim:

Me shkresën nr. 3385 prot., datë 08.07.2025, të Komisariatit të Policisë Lushnje, e protokolluar në AKM me nr. 7378 prot., datë 11.07.2025, si dhe me e-mailin e datës 03.07.2025, të ardhur nga ARM Fier, janë kërkuar rezultatet e analizave të mostrave të ujit të marra për nevoja të hetimit të një procedimi penal, i cili lidhet me shkarkimin e ujërave teknologjikë në një kanal kullues në adresën: fshati Allprenaj, Lushnje, pranë fabrikës së peshkut me emër tregtar "N".

Në vijim, me shkresën nr. 7140 prot., datë 03.07.2025, AKM ka ngritur një grup pune të përbërë nga Specialistët e Mostrimit në Drejtorinë e Menaxhimit të të Dhënave Mjedisore, Kimikateve dhe Analizave Laboratorike, në Sektorin e Mostrimit dhe Shkarkimeve në Mjedis, për marrjen e mostrave të ujit dhe kryerjen e analizave në Laboratorin e AKM-së. Ky veprim është ndërmarrë bazuar në e-mailin e ardhur nga z. E. H, N/Komisar, Shef i Policisë për Hetimin e Krimeve, Lushnje, ku kërkohej bashkëpunim për evidentimin e situatës dhe për marrjen e mostrave në fshatin Allprenaj, Lushnje, në subjektin "N".

Grupi i mostrimit përbëhej nga:

-B. S, Specialist në Sektorin e Mostrimit dhe Shkarkimeve në Mjedis;

-B. P, Specialist në Sektorin e Mostrimit dhe Shkarkimeve në Mjedis.

Nëpërmjet MEMO nr. 7454 prot., datë 14.07.2025, Sektori i Analizave Laboratorike ka përcjellë informacion për titullarin mbi rezultatet e analizave për mostrat e marra me Nr. Serial 36, 37 dhe 38. Vlerësimi i rezultateve për parametrat e analizuar sipas Raport-Analizave me Nr. Serial 36, 37 dhe 38 është realizuar mbi bazën e parametrave fiziko-kimikë, duke i krahasuar me normat e lejuara të përcaktuara në VKM nr. 177, datë 31.03.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse", Shtojca nr. 3.

Nga auditimi konstatohet se në Raport-Analizën me Nr. Serial 36, kampioni i koduar MMA070725 është kampionuar në vaskën dekantuese pranë subjektit "N", Allprenaj, Lushnje, dhe vlerësimi është kryer për parametrat sipas VKM nr. 177, datë 31.03.2005, Shtojca 3, pika 11. Nga rezultatet rezulton se të gjithë parametrat e monitoruar, konkretisht: pH, Nevoja Biokimike për Oksigjen (BOD), Nevoja Kimike për Oksigjen (COD), lëndët pezull, fosfori total dhe yndyrnat, kanë tejkalim të normës disa herë më të lartë.

Si konkluzion, *në analizën e kryer për kampionin MM1070725 vlerësohet se ka ndotje mbi normat e lejuara, në lëndë organike dhe yndyrna.*

Gjithashtu konstatohet se në Raport-Analizën me Nr. Serial 37, kampioni i koduar MM2070725 është kampionuar në pikën e shkarkimit të subjektit, në kanalin që kalon aty pranë, dhe vlerësimi

është kryer sipas VKM nr. 177, datë 31.03.2005, Shtojca 3, pika 11. Nga rezultatet rezulton se parametrat e monitoruar: Nevoja Biokimike për Oksigjen, Nevoja Kimike për Oksigjen, lëndët pezull, fosfori total dhe yndyrnat, kanë tejkalim të normës së lejuar. Si konkluzion, në analizën e kryer për kampionin MM2070725 vlerësohet se ka përmbajtje organike që tejkalon normat e lejuara, duke shkaktuar ndotje në mjedisin pritës.
Nga auditimi konstatohet se në Raport-Analizën me Nr. Serial 38, kampioni i koduar MM3070725 është kampionuar në pusin brenda subjektit dhe vlerësimi është kryer sipas VKM nr. 177, datë 31.03.2005, Shtojca 3, pika 11. Nga rezultatet rezulton se parametrat e monitoruar: Nevoja Biokimike për Oksigjen, Nevoja Kimike për Oksigjen, lëndët pezull, fosfori total dhe yndyrnat, kanë tejkalim të normës së lejuar.
Si konkluzion, *në analizën e kryer për kampionin MM3070725 vlerësohet se ka përmbajtje organike që tejkalon normat e lejuara.*
Me shkresën nr. 7378/1 prot., datë 15.07.2025, AKM i ka përcjellë ARM Fier dhe Komisariatit të Policisë Lushnje rezultatet e analizave për problematikën e mësipërme.
Në lidhje me praktikën e ndjekur dhe inspektimin e ushtruar nga ARM Fier, konstatohet si më poshtë:
- Subjekti: N sh.p.k., me NIPT: L.....J, *në inspektimin: nr. 1987*, me *Objekt inspektimi:*
*"*Kontrolli i zbatimit të legjislacionit dhe evidentimi i problematikave të mundshme".
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në portalin e inspektimeve rezulton se, gjatë inspektimit të kryer, pavarësisht rezultateve të analizave laboratorike, të cilat kanë evidentuar tejkalim të normave të lejuara sipas VKM nr. 177, datë 31.03.2005, për parametrat fiziko-kimikë të ujërave të shkarkuara, trupa inspektuese nuk ka reflektuar në mënyrë të plotë këto rezultate në vendimmarrjen administrative përfundimtare.
Konkretisht, megjithëse Raport-Analizat me Nr. Serial 36, 37 dhe 38 janë evidentuar tejkalime të konsiderueshme të parametrave si Nevoja Biokimike për Oksigjen (BOD), Nevoja Kimike për Oksigjen (COD), lëndët pezull, fosfori total dhe yndyrnat, të cilat përbëjnë tregues të ndotjes së mjedisit ujore pritës, në vendimin përfundimtar të inspektimit është aplikuar masa administrative "*Paralajmërim*".
Në vlerësimin e grupit të auditimit, duke marrë në konsideratë faktin që shkeljet e konstatuara klasifikohen si kundërvajtje administrative sipas nenit 23, pika 2, germa "ç", të ligjit nr. 9115, datë 24.07.2003 "*Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura",* i ndryshuar, dhe duke qenë se neni 24 i këtij ligji parashikon shprehimisht aplikimin e masës administrative gjobë, vendosja e masës *"Paralajmërim*" nuk garanton një reagim proporcional dhe në përputhje me kuadrin ligjor material që rregullon këtë fushë.
Për rrjedhojë, konstatohet se trupa inspektuese nuk ka ndjekur në mënyrë të plotë dhe të harmonizuar evidencat teknike laboratorike me kuadrin ligjor material në fuqi, duke sjellë si pasojë aplikimin e një mase administrative që nuk reflekton në mënyrë proporcionale nivelin e shkeljes së konstatuar.
Për sa trajtuar më sipër ngarkohen me përgjgjësi Inspektorët: A. B, M. H, E. H.

Nga AKM, konkretisht firmosur nga znj. A.Z dhe z. N. P, është dërguar observacion pa nr prot., dhe pa datë, protokolluar në KLSH me nr. 769/90 prot., datë 27.04.2026, dhe gjithashtu observacioni me nr. prot., 3983/4 datë 27.04.2026 protokolluar në KLSH me nr. 769/91 prot., datë 08.05.2026, firmosur nga znj. A. Z, z. N. P dhe znj. N. N, me të njëjtën përmbajtje, si në vijim:
Pretendimi i subjektit: Sqarojmë se: Drejtoria e Shqyrtimit dhe Monitorimit të Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve, kryen procesin e shqyrtimit paraprak të aplikimit dhe të dokumentacionit shoqërues. Përkatësisht: Sipas VKM nr. 568/2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit" e ndryshuar, AKM kryen:

a) vlerësimin e ndikimit në mjedis të shkaktuar nga projekte, aktivitete të subjekteve të ndryshme dhe fenomene natyrore/klimaterikë etj., duke mundësuar një mjedis brenda standardeve dhe parametrave të kërkuar dhe në përputhje me kërkesat ligjore, për jetë cilësore dhe të shëndetshme të qytetarëve;
b) përgatitjen e projektdeklaratave mjedisore për programe, plane, strategji, projekte;
c) hartimin e databazës së lejeve mjedisore ku të reflektohen të gjitha aplikimet për leje të bëra nga subjekte të ndryshme;
ç) përgatitjen e formatit standard të kërkesës për leje mjedisi;
d) pranimin e aplikimeve për leje mjedisore dhe realizimin e procedurës së vlerësimit të dokumentacionit ligjor dhe teknik për pajisjen me leje (A, B, C);
dh) verifikimin e saktësisë së informacionit të dhënë nga operatori në kërkesën e tij për leje mjedisi (të tipit A, B) dhe përgatitjen e mendimit të argumentuar për ministrin në lidhje me miratimin ose jo të kësaj lejeje, me kushte të detajuara;
e) kryerjen e oponencës teknike për lejet mjedisore dhe hartimin e opinioneve profesionale;
ë) përcaktimin e përgjegjësive mjedisore dhe vlerësimin e riskut, që ka si objektiv parandalimin e rikuperimin e dëmeve që i shkaktohen mjedisit, organizimin e sektorit për marrjen e masave, rehabilitimin e mjedisit etj.
Sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 194, datë 04.10.2024 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit” dhe përshkrimeve të punës për çdo drejtori përcaktohet se: Fusha e Veprimtarisë së Drejtorisë së Shqyrtimit dhe Monitorimit Lejeve Mjedisore dhe VNM:
a. Kryen vlerësimin e dokumenteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis. Kryen përpunimin e lejeve mjedisore dhe Përgatit Lejet Mjedisore (kategoria A dhe B);
b. Vë ne zbatim parimin e përgjegjësisë mjedisore bazuar në parimin “Ndotësi paguan”.
Fusha e Veprimtarisë së Sektorit të Shqyrtimit Teknik për veprimtaritë në mjedis:
a. Ndjek procedurat e parashikuara teknike për dhënien e lejeve mjedisore. Shqyrtimi i aplikimeve për pajisje me leje mjedisore të Tipit A dhe B.
b. Koordinon qëndrimet e sektorëve të Drejtorisë së Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve në lidhje me dokumentin përfundimtar që i sugjerohet Drejtorit të Përgjithshëm të AKM dhe atij që i dorëzohet Ministrisë në lidhje me aplikimin për leje mjedisore.
Në Rregulloret përkatëse mbi bazën e të cilave mblidhet "Komisioni për Vlerësimin e aplikimeve dhe kërkesave për Leje Mjedisi të Tipit A, B dhe Licencave të Nënkategorisë III.2.B" është e përcaktuar se: Drejtoria e Shqyrtimit dhe Monitorimit të Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve, nëpërmjet Sektorit të Shqyrtimit Teknik për Veprimtaritë në Mjedis, bazuar në legjislacionin në fuqi për lejet e mjedisit, shqyrton paraprakisht aplikimin dhe dokumentacionit shoqërues të paraqitur në lidhje me:
a) aplikimet për t'u pajisur me leje mjedisi të tipit A ose B;
b) aplikimeve për t'u pajisur me licencë të nënkategorisë III.2.B.
c) kërkesave për ndryshime apo shtesa për lejet e mjedisit të tipit A ose B dhe licensave të nënkategorisë III.2.B.
- Drejtoria e Shqyrtimit dhe Monitorimit të Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve nëpërmjet Sektorit të Shqyrtimit Teknik për Veprimtaritë në Mjedis, kryen shqyrtimin paraprak të aplikimit dhe të dokumentacionit shoqërues dhe i paraqet Komisionit në mbledhje propozimet për miratim apo refuzim të aplikimit.
- Komisioni vlerëson mbi propozimet e paraqitura nga Drejtoria e Shqyrtimit dhe Monitorimit të Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve, nëpërmjet Sektorit të Shqyrtimit Teknik për Veprimtaritë 2 Nënkategorisë në Mjedis, për aplikimet dhe kërkesat për Leje Mjedisi të Tipit A, B dhe Licencave të III.2.B.
- Në përfundim të mbledhjes së Komisionit, Drejtoria e Shqyrtimit dhe Monitorimit të Lejeve Mjedisore përgatit dhe VNM-ve, nëpërmjet Sektorit të Shqyrtimit Teknik për Veprimtaritë në Mjedis, aktet e zbardhura (aktet e miratimit/refuzimit) dhe i parashtron me memo/shkresë përcjellëse Ministrit përgjegjës për mjedisin.
Për sa më lart, anëtarët e Komisionit, që nuk janë nëpunës / përfaqësues të Sektorit të Shqyrtimit Teknik për Veprimtaritë në Mjedis në Drejtorinë e Shqyrtimit dhe Monitorimit të Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve, bazohen vetëm në prezantimin e realizuar në mbledhje. Shqyrtimi i aplikimit apo edhe i dokumentacionit që shoqëron aplikimin nuk është detyrë e këtyre anëtarëve të komisionit. Sipas Rregullores, Sektori i Shqyrtimit Teknik për Veprimtaritë në Mjedis mban përgjegjësi në prezantimin e dosjeve të aplikimit të shqyrtuara paraprakisht si dhe mbi vërtetësinë e informacionit të paraqitur para Komisionit. Aktet e zbardhura (procesverbal, vendim, aktet e miratimit/refuzimit, shkresa përcjellëse, etj) hartohen nga Sektori.
Nëpërmjet Memo nr. 13236 prot., datë 17.12.2024 (vënë në dispozicionin tuaj me observacionin nr. 3366/3 prot., datë 24.02.2026), duke qenë se Drejtoria e Shqyrtimit dhe Monitorimit të Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve (sektorët përkatës) ka kryer dhe kryen si detyrë funksionale shqyrtimin e aplikimeve (leje mjedisore, licenca, VNM) dhe të dokumentacionit të dorëzuar nga aplikuesi.
3 anëtarët A. Z, N. P, K. A i kanë kërkuar Drejtorit të Përgjithshëm, saktësimin dhe përcaktimin e qartë të veprimtarisë së komisioneve si dhe qartësimin e funksioneve të anëtarëve edhe në vijim. Në rregulloret nr. 4933/1 prot., datë

02.05.2024 dhe nr. 2836/1 prot., datë 11.04.2023 në Kreun X është e përcaktuar qartë mbi detyrën dhe përgjegjësinë e sektorit që prezanton aplikimet në mbledhje para komisionit. Në rregulloren nr. 13237/1 prot., datë 17.12.2024 detyrat janë të ndara dhe më të sakta, reflektuar sipas kërkesës nga Memo nr. 13236 prot. Sipas kuadrit ligjor me të cilin AKM ushtron funksionet dhe veprimtarinë e saj, nuk është e përcaktuar apo e shprehur në mënyrë cilësuese se procedura administrative për shqyrtimin e këtyre aplikimeve realizohet me ngritjen e një komisioni i cili merr tagrat ligjorë të një njësie organizative kolegjiale brenda strukturës organike të AKM-së. Ngritja e këtij komisioni është kërkuar me urdhrin e titullarit të institucionit, por ky komision nuk shqyrton asnjë aplikim. Komisioni dëgjon (në formë verbale) vetëm prezantimin e aplikimit të përgatitur nga Sektori/Drejtoria. Bashkëngjitur do të gjeni:
- Memo nr. 13236 prot., datë 17.12.2024,
- Urdhrat e komisioneve dhe Rregulloret
- Komunikimet me email nga disa anëtarë.

Në lidhje me konstatimin së dokumentet shoqëruese të aplikimit duhet-Ekstrakt i QKB (origjinal apo kopje e noterizuar) sqarojmë se: Referuar VKM NR. 419, datë 25.6.2014 e ndryshuar, në Kreun II dhe III ka të përcaktuar qartë dokumentacionin që duhet të paraqesë subjekti në aplikim. EKSTRAKT i QKB (origjinal apo kopje e noterizuar) si dokument nuk kërkohet. Kërkuesi aplikon në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) nëpërmjet Portalit "E-ALBANIA" dhe ky verifikim është i kryer për sa kohë aplikimi përcillet për shqyrtim nga QKB në sistem elektronik. Ekstrakti i Regjistrit Tregtar është një dokument që gjenerohet nga Regjistri Publik administruar nga QKB, dhe mund të verifikohet nga vetë autoriteti publik në cdo kohë. Kjo referuar edhe VKM nr. 391, datë 3.5.2017 *"Për përcaktimin e procedurave të regjistrimit dhe të publikimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit"* i ndryshuar.

Në lidhje me : V. Auditim mbi tarifën vjetore të lejeve mjedisore, sqarojmë se: Bazuar në Vendimin Nr. 417, datë 25.6.2014 "Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit", pagesa e tarifave për lejet e mjedisit kalonte në llogarinë e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Për këtë arsye në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) nuk është mbajtur ndonjë evidence për shlyerjen e detyrimeve financiare ndër vite. Nisur nga ky fakt, që të ardhurat nga tarifat e lejeve mjedisore arkëtoheshin në llogarinë e MTM, atëherë këto të ardhura (sëbashku më çdo të ardhur që arkëtohej për MTM) i dërgoheshin nëpërmjet postës elektronike (e-mail) Sektorit të Financës së AKM (formati Excel siç ishte dërguar nga Dega e Thesarit) nga ana e sektorit të financës së MTM, çdo muaj që nga viti 2015-2024.

Referuar informacionit të dërguar nga Sektori i Financës së MTM-Dega e Thesarit, si dhe mandat pagesave të dorëzuara nga subjektet (në rastet kur i kanë dorëzuar në AKM), Sektori i kishte Financës në AKM ka verifikuar pagesat që janë kryer nga subjektet, ka përllogaritur sa duhet të paguar për të gjitha lejet (PN) që disponon dhe verifikuar nëse rezulton debitor apo jo.

Nga ana e Sektorit të Financës në AKM është bërë prezentë kjo problematikë lidhur me kryerjen e pagesës së tarifave për lejet e mjedisit në llogarinë e MTM dhe që verifikimi i kryerjes së pagesës kërkohej nga financa e AKM-së. Shqetësim i cili është përcjellë edhe nga titullari i AKM-së dhe mori zgjidhje me ndryshimet ligjore, ku u miratua që pagesa e tarifave për lejet e mjedisin të kalonte në llogarinë e AKM-së dhe verifikimi mund të kryhej më shpejt si dhe mund të komunikohej drejtpërdrejtë me Degën e Thesarit Tiranë për të ardhurat që ishin arkëtuar në llogarinë e AKM-së.

Gjatë ushtrimit të detyrës si Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe më pas si Drejtore e Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, kam nisur punën për evidentim e pagesave të kryera nga viti 2014 e deri në vitin 2024 dhe përllogaritjen e vlerës së detyrimit që duhet të paguante secili subjekt i identifikuar me NIPT. Dhe me tej është punuar në mënyrë sistematike për plotësimin, përditësimin dhe njoftimin e subjekteve të identifikuara me detyrime.

Listat e subjekteve që disponojnë leje, dërgohej nga Sektori i Lejeve (të identifikuar me PN), mirëpo në momentin e përllogaritjes së shumës totale për tarifat, Sektori i Financës së AKM i verifikonte Subjektet (NIPT) në çdo rast në Regjistrin Kombëtar të lejeve dhe licencave, në QKB se sa leje kanë në total, tipin e lejes (A, B), vitin e miratimit të aktit, statusin e tyre (revokuar /aktive) etj.. Gjate periudhës 20 Janar 2023 – 24 Shtator 2024, për çdo subjekt që ishte në procedurë me AKM-në është kërkuar informacion nga Sektori i Lejeve nëse subjekti ka detyrime për tarifat vjetore apo jo dhe nga Sektori i Financës pasi evidentoheshin tarifat për të gjitha lejet mjedisore aktive të subjektit, i kthehej përgjigje me e-mail zyrtar Sektorit të Lejeve. Llogaritja e detyrimit total bëhej për subjekt (identifikuar me NIPT), pra për të gjitha lejet mjedisore që rezultojnë në Regjistrin Kombëtar të lejeve dhe licensave, në QKB.

Në bashkëpunim me Drejtorinë e Inspektim-Kontrollit dhe ARM-të, në momentin e miratimit të Planit mujor të Inspektimit, kërkohej informacion paraprakisht nëse subjektet që do inspektoheshin rezultonin debitor ose jo dhe këto të fundit njoftoheshin për detyrimet që kishin për tarifat e lejeve mjedisore. Gjatë periudhës Janar 2023-Shtator 2024 nga Financa janë kryer rakordime dhe njoftime me shkresa zyrtare të subjekteve të evidentuara debitore. Kjo databazë përditësohej rast pas rasti nga Sektori i Financës, referuar të dhënave që dërgoheshin nga Dega e Thesarit Tiranë dhe mandat-pagesave të dorëzuara nga subjektet për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Nisur nga numri i lartë i lejeve mjedisore të identifikuara me PN, sqarojmë se procesi i punës për identifikimin në mënyre manuale dhe paraqitjen e tyre në databaze Excel, është mjaft kompleks. Prandaj të ndodhur në këto kushte është kërkuar vazhdimisht ngritja e një "sistemi të integruar" me anë të secilit të bëhej identifikimi në kohë reale i detyrime për

secilin subjekt. Nga ana e titullarit të AKM janë marrë masa për përmirësimin e situatës dhe arkëtimin e ardhurave në Buxhetin e Shtetit dhe ka kërkuar në rrugë shkresore marrjen e masave për ngritjen e një "sistemi të integruar". Konkretisht, me shkresën nr. 5493 prot., datë21.07.2023 "Kërkesë për marrjen e masave për ngritjen e një baze të dhënash të integruar për indikatorët mjedisorë", drejtuar Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit është sqaruar se ngritja e një sistemi të integruar do të evidentonte në kohë reale subjektet debitore.
Gjithashtu me shkresën nr. 7213 prot., dt. 07.09.2023 "Kërkesë për ngritjen e një sistemi të integruar të dhënash për indikatorët e mjedisit", drejtuar Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe për dijeni MTM është kërkuar ngritja e një sistemi të integruar. Pra, e ndodhur në këto kushte, që unë (N. N) jam larguar nga puna në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit me datë 24 shtator 2024, nuk kam dijeni mbi databazën që i është dorëzuar KLSH dhe mbi saktësinë e saj. Për sa më sipër, duke qenë se Agjencia Kombëtare e Mjedisit është në proces implementimi të sistemit të integruar me anë të secilit mund te kryhet në kohë reale edhe identifikimi i debitorëve, kërkojmë nga ana Juaj vlerësimin me objektivitet të situatës.
Qëndrimi i grupit të auditimit: Observacioni i paraqitur është i njëjti i dërguar mbi akt konstatimin, për të cilin grupi i auditimit e ka sqaruar qëndrimin me detaje dhe e ka trajtuar në Projekt Raport. Për sa më sipër duke qenë se nuk ka ndryshime apo evidenca të reja, trajtimi i materialit mbetet i njëjtë në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.

Nga AKM është dërguar observacioni me nr. prot., 3983/4 datë 27.04.2026 protokolluar në KLSH me nr. 769/91 prot., datë 08.05.2026, nga znj. F. M, znj. E. O, z. G. H, z. A. D, z. K. A, z. O. Dh, z. P. M, znj. E. M, z. E. B, znj. A. P, znj. M. P.
Qëndrimi i grupit të auditimit: Observacioni i paraqitur është i njëjti i dërguar mbi akt konstatimin, për të cilin grupi i auditimit e ka sqaruar qëndrimin me detaje dhe e ka trajtuar në Projekt Raport. Për sa më sipër duke qenë se nuk ka ndryshime apo evidenca të reja, trajtimi i materialit mbetet i njëjtë në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.

2.4 Mbi auditimin e procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) paraprake dhe të thelluara.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) shqyrton kërkesat për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe, në fund të secilës procedurë, paraprake apo të thelluar, të VNM-së, merr vendimin për VNM-në paraprake, ndërsa për VNM-në e thelluar përgatit deklaratën mjedisore, me rekomandimet përkatëse, dhe ia dërgon ministrisë.
Në përfundim, vendimmarrja konsiston në:
Vendim - lëshuar nga AKM-ja në përfundim të procedurës paraprake të VNM-së;
Deklaratë mjedisore - lëshuar nga ministri, në përfundim të procedurës së thelluar të VNM-së.
Struktura qe merret me vlerësimin e ndikimit në mjedis në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, është Drejtoria e Shqyrtimit dhe Monitorimit të Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve, sipas strukturës dhe organigramës së miratuar me Urdhër të KM nr. 194, datë 4.10.2024 "*Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit*"
Për periudhën objekt auditimi marrja e Vendimeve të Ndikimit në Mjedis aplikimi, shqyrtimi dhe dhënia e vendimit përkatës nga:
Urdhër nr. 75, datë 07.04.2023 për "Krijimin e Komisionit Teknik për shqyrtimin e kërkesave që i nënshtrohen procedurës paraprake dhe të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis" dhe Rregullorja nr. 2773/1, datë 07.04.2023 "Mbi mënyrën e organizimit, funksionimit dhe vendimmarrjes së Komisionit Teknik për Shqyrtimin e Kërkesave që i nënshtrohen procedurës parapake dhe të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis".
Urdhër nr. 82, datë 02.05.2024 për "Krijimin e Komisionit Teknik për shqyrtimin e kërkesave që i nënshtrohen procedurës paraprake dhe të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis" dhe Rregullorja nr. 4934/1, datë 02.05.2024 "Mbi mënyrën e organizimit, funksionimit dhe vendimmarrjes së Komisionit Teknik për Shqyrtimin e Kërkesave që i nënshtrohen procedurës parapake dhe të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis".
Urdhër nr. 613, datë 17.12.2024 për "Krijimin e Komisionit për vlerësimin e aplikimeve dhe kërkesave që i nënshtrohen procedurës paraprake dhe të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis" dhe Rregullorja nr. 1328/1, datë 17.12.2024 "Mbi mënyrën e organizimit dhe funksionimit

të Komisionit për Vlerësimin e aplikimeve dhe kërkesave që i nënshtrohen procedurës parapake dhe të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.
Zhvilluesi që synon të zbatojë një projekt, i cili është subjekt i kërkesave të nenit 8, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar, që në fazat fillestare të planifikimit të projektit (projekt idesë), paraqet kërkesën nëpërmjet sistemit elektronik e-leje pranë Ministrisë së Mjedisit
Në zbatim të kërkesave të VKM nr. 686, datë 29.07.2015, "*Për përcaktimin e rregullave, kërkesave dhe procedurave për zhvillimin e veprimtarive ndërtimore*", subjekti zhvillues paraqet kërkesën nëpërmjet në Ministrisë së Mjedisit përmes sistemit elektronik e-Leje aplikimin për marrjen e miratimit përkatës.
Ky aplikim depozitohet së bashku me dokumentacionin teknik dhe ligjor të kërkuar, në përputhje me fazën e procedurës dhe natyrën e veprimtarisë ndërtimore që propozohet, me qëllim shqyrtimin, verifikimin dhe vijimin e procedurave nga autoritetet kompetente.
Dokumenti bazë ku mbështetet procesi i VNM-së është raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili, në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit, mund të jetë:
a) raporti paraprak i VNM-së për projektet e shtojcës II;
b) raporti i thelluar i VNM-së për projektet e shtojcës I.
Sipas data bazës së vënë ne dispozicion nga AKM rezultoi se
Gjatë vitit 2023, për vlerësimin e ndikimit në mjedis u paraqitën gjithsej 1,114 aplikime të reja. AKM-ja, në përfundim të procedurës të VNM-së paraprake dhe asaj të thelluar, trajtoi me vendimmarrje 1,536 raste. Nga këto, 28 raste përfunduan me refuzimin e pranimit të aplikimit, 806 raste u konkluduan me vendim për VNM Paraprake, që përbën edhe formën kryesore të vendimmarrjes, ndërsa 6 raste përfunduan me vendimmarrje për VNM të Thelluar.
Gjatë vitit 2024, fluksi i aplikimeve shënoi rritje të lehtë, me gjithsej 1,161 aplikime të reja të paraqitura. Gjatë këtij viti, AKM-ja trajtoi dhe mbylli me vendimmarrje 2,059 raste, ku 23 raste përfunduan me refuzim të aplikimit, 909 raste me vendim për VNM Paraprake, ndërsa 4 raste u trajtuan me vendim për VNM të Thelluar. Ky vit karakterizohet nga një rritje e ndjeshme e volumit të shqyrtimit krahasuar me vitin paraardhës.
Për periudhën 1 janar-30 shtator 2025, janë paraqitur gjithsej 1,094 aplikime të reja për vlerësimin e ndikimit në mjedis. Në këtë periudhë, AKM-ja ka trajtuar dhe mbyllur me vendimmarrje 2,404 raste, çka përfaqëson një rritje të dukshme të ritmit të shqyrtimit. Nga këto vendimmarrje, 53 raste përfunduan me refuzim të aplikimit, 396 raste me vendim për VNM Paraprake, ndërsa vetëm 1 rast u trajtua me vendim për VNM të Thelluar. Gjatë kësaj periudhe 9-mujore ka një tendencë drejt rritjes së refuzimeve prej 53 raste, krahasuar refuzimet 2023 prej 35 raste ose 2024 prej 23 raste.
Aktiviteti i këtij vlerësimi për periudhën e auditimit paraqitet ne Aneksin nr. 4.1 si më poshtë vijon:
Aneksin nr. 4.1: Shqyrtuar nga AKM për procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Emërtimi	**Viti 2023**	**Viti 2024**	**Periudha 01.01.2025 -30.09.2025**
Aplikime te reja	**1,114**	**1,161**	**1,094**
Aplikime të shqyrtuara total	**1,536**	**2,059**	**2,404**
-VNM Paraprake	806	909	396
-Vendim për VNM të Thelluar	6	4	1
-Refuzim Vendimi	28	23	53
-Miratime Deklarata Mjedisore	35	23	3

Burimi: AKM, përpunoi KLSH
Drejtoria e Shqyrtimit dhe Monitorimit të Leje Mjedisore dhe VNM-ve, nëpërmjet Sektorit të Shqyrtimit Teknik të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor, kryen vlerësimin paraprak të aplikimit dhe dokumentacionit shoqërues dhe i paraqet për shqyrtim Komisionit në mbledhje propozimet për miratim apo refuzim, lidhur me:

Aplikimet për t'u pajisur me VNM paraprake;
Aplikimet për fillim procedure për VNM të Thelluar për tu pajisur me Deklaratë Mjedisore
Me Urdhrin e Kryeministrit nr. 194, datë 04.10.2024, është miratuar struktura e rishikuar e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, sipas skemës 1 (struktura) dhe skemës 2 (organigrama) të këtij urdhri. Në këtë kuadër, Drejtoria e Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve, e cila më parë kishte 15 pozicione pune brenda shërbimit civil, me strukturën e re është zgjeruar në 23 pozicione. Drejtoria vjen me emërtim të ri dhe me një riorganizim të brendshëm, ku i është shtuar një njësi e re Sektori i Monitorimit Mjedisor dhe VNM, me strukturë 1 + 5,. Kjo ndryshon nga organizimi i mëparshëm i përcaktuar në Rregulloren e Brendshme nr. 120, datë 12.01.2021, ku kjo njësi njihte strukturën "Drejtoria e Vlerësimit të Impaktit dhe Licencimit" me 1 + 14 pozicione.
Nga auditimi u konstatua se:
Riorganizimi i miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr.194/2024 ka sjellë një zgjerim dhe ndryshim strukturor-funksional në Drejtorinë e Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve, duke rritur numrin e pozicioneve dhe duke krijuar një sektor të ri të specializuar për monitorim mjedisor, çka tregon një orientim drejt forcimit të kapaciteteve institucionale, por njëkohësisht evidenton mospërputhje me Rregullore e Brendshme nr. 120, datë 12.01.2021 "Për Organizimin dhe Funksionimin e AKM-it dhe ARM-ve", që kërkon përditësim të menjëhershëm të saj.
Trajtimi i VNM-ve realizohet drejtpërdrejtë nga AKM në bashkëpunim me Agjencitë Rajonale të Mjedisit (ARM), ku AKM ka rolin drejtues, koordinues dhe miratues, ndërsa ARM-të kryejnë vlerësimin paraprak, verifikimin terreni dhe përgatitjen e materiale teknike mbështetëse. Kjo marrëdhënie funksionale synon që procesi i VNM-së të jetë i unifikuar në nivel kombëtar, por njëkohësisht i bazuar në realitetet mjedisore lokale, duke garantuar një vlerësim më të plotë dhe më të saktë të ndikimeve.
Grupi i auditimit përzgjodhi për auditim vendimmarrjen e komisioneve të ndara sipas agjencive rajonale, të cilat përshkruhen në mënyrë të përmbledhur sipas dokumentacionit dhe arsyetimit ku është mbështetur marrja e vendimit.
Vlerësimi paraprak i aplikimeve dhe shqyrtimi në Komision i propozimeve për miratim ose refuzim, si për kërkesat për VNM paraprake ashtu edhe për ato për fillim procedure të VNM-së së thelluar, do të paraqiten të grupuara sipas Agjencive Rajonale të Mjedisit si më poshtë vijon:
I. Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër.
"XH. M. A." shpk. - Deklaratë Mjedisore
Personi Juridik XH. M. A shpk me NIPT M.....T, ka aplikuar ne sistemin e-leje për të zhvilluar projektin "Shfrytëzim i Mineralit të Kromit" objekti "Lindja e Shtrungës", "Leja Minerare Kërkim Zbulimi, nr. 1907, datë. 21.01.2021, Objekti "Zhulat - Picar".me vendndodhje Objekti "Lindja e Shtrungës", Bulqizë, qarku Dibër. Mbështetur në deklarimet e AKBN-së me të dhëna teknike: Sipërfaqe për t'u shfrytëzuar: 4.0377 km2, për llojin e mineralit Krom.
Aplikimi nr. AN071120250023 është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, datë: 7.7.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", Shtojca I, "Projektet që i nënshtrohen Procedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis", Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.
Nga auditimi rezulton se
Në procedurën e lëshimit të Deklaratës Mjedisore për zhvilluesin "XH. M. A" Shpk me aplikim nr. AN071120250023 konstatohet mungesa e marrjes së mendimit nga njësitë e qeverisjes vendore, konkretisht Bashkia Dibër. Ky veprim është në kundërshtim me Kreun II, pika 4.2, germa c) të VKM nr. 686, datë 29.7.2015, "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit

të vendimit e deklaratës mjedisore", i ndryshuar. Sipas kësaj dispozite, kur Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) vlerëson se dokumentacioni i aplikimit apo dokumentacioni i plotësuar është i plotë, ajo, në varësi të llojit të projektit, është e detyruar t'ia përcjellë dokumentacionin institucioneve të tjera përgjegjëse për lejimin, autorizimin apo licencimin e tij, si dhe institucioneve përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin, shëndetin publik dhe emergjencat natyrore e civile
Nga auditimi u konstatua se gjatë konsultimit publik të zhvilluar më datë 15.11.2025, pjesëmarrja ka qenë e ulët.
"S. S" Shpk. - Deklaratë Mjedisore
Personi Juridik S. S shpk me NIPT M.....K, ka aplikuar ne sistemin e-leje për të zhvilluar projektin "Projekti i Ndërtimit të Parkut Fotovoltaik 100 MW "S. S", me vendndodhje Spitallë, Bashkia Durrës, me të dhëna teknike: Fuqia: 100 MË
Aplikimi nr. AN091020250064 është bërë referuar ligjit nr. 10 440, date:07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", Shtojca I, "Projektet që i nënshtrohen Procedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis", Industria e energjisë, Instalime industriale për mbajtjen e gazit, avullit ose ujit të ngrohtë; transmetimin e energjisë elektrike me kabëll në lartësi.
Nga auditimi rezulton se
Në procedurën e lëshimit të Deklaratës Mjedisore për zhvilluesin "S. S" Shpk me aplikim nr. AN091020250064 konstatohet mungesa e marrjes së mendimit nga njësitë e qeverisjes vendore, konkretisht Bashkia Durrës. Ky veprim është në kundërshtim me Kreun II, pika 4.2, germa c) të VKM nr. 686, datë 29.7.2015, "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore", i ndryshuar. Sipas kësaj dispozite, kur Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) vlerëson se dokumentacioni i aplikimit apo dokumentacioni i plotësuar është i plotë, ajo, në varësi të llojit të projektit, është e detyruar t'ia përcjellë dokumentacionin institucioneve të tjera përgjegjëse për lejimin, autorizimin apo licencimin e tij, si dhe institucioneve përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin, shëndetin publik dhe emergjencat natyrore e civile
"SH" Shpk. - Deklaratë Mjedisore
Personi Juridik "SH" shpk me NIPT J.....V, ka aplikuar ne sistemin e-leje për të zhvilluar projektin "Shfrytëzimi i gurit gëlqerore dhe përpunimi i gurit në impiantin e fraksionimit, zona minerare Nr. 253/6, objekti i gurit gëlqeror "Kodra e Kojlikës", Qarku Durrës", me vendndodhje zonë minerare 253/6, objekti i gurit gëlqeror "Kodra e Kojlikës", Qarku Durrës, me të dhëna teknike: Sipërfaqe sipas MIE: 0.346 km2, Lloji i mineralit: gur gëlqeror
Aplikimi nr. AN270620230002 është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, date: 7.7.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", Shtojca I, "Projektet që i nënshtrohen Procedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis", Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.
Nga auditimi rezulton se
Nga shqyrtimi i dokumentacionit në shqyrtimin e kërkesës së subjektit "SH" Shpk. me aplikim nr. AN270620230002 rezulton se në Deklaratën Mjedisore mungon mendimi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë lidhur me aplikimin për shfrytëzimin e gurit gëlqeror. Kjo përbën mangësi në dokumentacion dhe është në kundërshtim me Ligjin nr. 10 304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, sipas të cilit shfrytëzimi i pasurive minerare lejohet vetëm pas marrjes së miratimeve përkatëse nga autoriteti kompetent.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se në Deklaratën Mjedisore mungon mendimi i *Agjencisë Kombëtare e Burimeve Natyrore* lidhur me aplikimin për shfrytëzimin e gurit gëlqeror. Kjo përbën mangësi në dokumentacion dhe është në kundërshtim me Ligjin nr. 10 304, datë

15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, sipas të cilit shfrytëzimi i pasurive minerare lejohet vetëm pas marrjes së miratimeve përkatëse nga autoriteti kompetent.
Në procedurën e lëshimit të Deklaratës Mjedisore në shqyrtimin e kërkesës së subjektit “SH” Shpk. me aplikim nr. AN270620230002 konstatohet mungesa e dhënies së mendimit nga njësitë e qeverisjes vendore, konkretisht Bashkia Durrës, duke u konsideruar si “Miratim në heshtje”. Kjo situatë nuk është në përputhje me Kreun II, pika 4.2, shkronja “c” të VKM nr. 686, datë 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive dhe të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore”, të ndryshuar, sipas së cilës Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), kur vlerëson se dokumentacioni i aplikimit apo dokumentacioni i plotësuar është i plotë, brenda 5 (pesë) ditëve pune ia përcjell dokumentacionin njësive të qeverisjes vendore përkatëse, të cilat janë të detyruara të japin mendimin on-line në sistemin e-leje 7 (shtatë) ditëve pune.
“I.C” Shpk. - Deklaratë Mjedisore
Personi Juridik I.C shpk me NIPT J.....G, ka aplikuar ne sistemin e-leje për të zhvilluar projektin “Shfrytëzim i mineralit gurë gëlqeror, në sipërfaqen me koordinata të zgjeruara, me vendndodhje Leja minerare nr. 1641/1, objekti «Zall Herr», Tiranë., me të dhëna teknike: Sipërfaqja totale për shfrytëzim: 0.066 km2. Sipërfaqja totale për heqje nga fondi pyjor: 0.036 km2 Lloji i mineralit: gur gëlqeror.
Aplikimi nr. AN040720240009 është bërë referuar ligjit nr. 10 440, date: 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Proçedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.
Nga auditimi rezulton se
Në procedurën e lëshimit të Deklaratës Mjedisore për zhvilluesin “I.C” shpk., me aplikim nr. AN040720240009, konstatohet mungesa e dhënies së mendimit nga njësitë e qeverisjes vendore, konkretisht Bashkia Tiranë, duke u konsideruar si “Miratim në heshtje”. Kjo situatë nuk është në përputhje me Kreun II, pika 4.2, shkronja “c” të VKM nr. 686, datë 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive dhe të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore”, të ndryshuar, sipas së cilës Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), kur vlerëson se dokumentacioni i aplikimit apo dokumentacioni i plotësuar është i plotë, brenda 5 (pesë) ditëve pune ia përcjell dokumentacionin njësive të qeverisjes vendore përkatëse, të cilat janë të detyruara të japin mendimin on-line në sistemin e-leje 7 (shtatë) ditëve pune.
“G-G. T. Sh” Shpk. - Deklaratë Mjedisore
Personi Juridik “G-G. T. Sh” shpk me NIPT J.....B, ka aplikuar ne sistemin e-leje për të zhvilluar projektin “Prodhimi i produkteve farmaceutike bazë me anë të proceseve kimike ose biologjike”, me vendndodhje ZK 3321, Nr.Pas. 342/14, Nj.A.Vaqarr, Bashkia Tiranë., me të dhëna teknike: Kapaciteti i projektuar për prodhimin e gazrave teknike: Oksigjen (O2) Industrial 160 m3 /orë, Oksigjen (O2) mjekësor 160 m3 /orë, Azot (N2) 160 m3 /ore, Argon (Ar), Helium (He) 160 m3 /orë, Dyoksid Karboni (CO2) 100 kg/ore, Mishel Saldimi (80% Ar dhe 20% CO2) 160 m3 /orë..
Aplikimi nr. AN130620230004 është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, date: 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Procedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, pika 6. d. “Prodhimi i produkteve farmaceutike bazë duke përdorur një proces kimik ose biologjik”.
Nga auditimi rezulton se

Në procedurën e lëshimit të Deklaratës Mjedisore për zhvilluesin "G-G. T. Sh" shpk., me aplikim nr. AN130620230004, konstatohet mungesa e dhënies së mendimit nga njësitë e qeverisjes vendore, konkretisht *Bashkia Tiranë, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Ministria e Shëndetësi*së, duke u konsideruar si "Miratim në heshtje". Kjo situatë nuk është në përputhje me Kreun II, pika 4.2, shkronja "c" të VKM nr. 686, datë 29.07.2015, "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive dhe të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore", të ndryshuar, sipas së cilës Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), kur vlerëson se dokumentacioni i aplikimit apo dokumentacioni i plotësuar është i plotë, brenda 5 (pesë) ditëve pune ia përcjell dokumentacionin njësive të qeverisjes vendore përkatëse, të cilat janë të detyruara të japin mendimin on-line në sistemin e-leje 7 (shtatë) ditëve pune.

"GJ. R" Shpk. - Deklaratë Mjedisore

Personi Juridik GJ. R shpk me NIPT L.....J, ka aplikuar ne sistemin e-leje për të zhvilluar projektin "Hidrocentral Malla (Shtesë).", me vendndodhje Bashkia Kukës, me të dhëna teknike: 6251 kË.

Aplikimi nr. AN210820230003 është bërë referuar ligjit nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 9, "Projektet që i nënshtrohen procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis'', Pika 1. Procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis i nënshtrohen: b) projektet, për të cilat vendimi i AKM-së parashikon nevojën e zbatimit të kësaj proçedure. Shtojca II: Pika 3. Industria e energjisë ë) Instalime për prodhimin e energjisë hidroelektrike;

Nga auditimi rezulton se

Aplikimi nr. AN210820230003, nga subjekti "GJ. R" shpk, me vendodhje Bashkia Kukës nuk duhej trajtuar nga Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër por Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhe, Shkodër, Kukës, ne kundërshtim Kreu VI pika 1 "Organika dhe Detyrat Funksionale të Drejtorive Rajonale të Mjedisit" sipas Rregulloren e Brendshme nr. 120, datë 12.01.2021, sipas të cilës fusha e veprimtarisë së të cilës është mbikëqyrja dhe mbrojtja e mjedisit, respektimi I kërkesave ligjore në nivel rajonal, në përputhje me legjislacionin ,mjedisor në fuqi.

Në procedurën e lëshimit të Deklaratës Mjedisore për zhvilluesin "G-G. T.Sh" shpk., me aplikim nr. AN130620230004, konstatohet mungesa e dhënies së mendimit nga institucioneve të konsultuara, konkretisht Bashkia Tiranë/ Kukës, *Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore* , MIE, duke u konsideruar si "Miratim në heshtje". Kjo situatë nuk është në përputhje me Kreun II, pika 4.2, shkronja "c" të VKM nr. 686, datë 29.07.2015, "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive dhe të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore", të ndryshuar, sipas së cilës Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), kur vlerëson se dokumentacioni i aplikimit apo dokumentacioni i plotësuar është i plotë, brenda 5 (pesë) ditëve pune ia përcjell dokumentacionin njësive të qeverisjes vendore përkatëse, të cilat janë të detyruara të japin mendimin on-line në sistemin e-leje 7 (shtatë) ditëve pune.

"G" Shpk. - Deklarate Mjedisore

Personi Juridik Gshpk me NIPT J.....K, ka aplikuar ne sistemin e-leje për të zhvilluar projektin "Nxjerrja e mineralit të kromit me minierë sipërfaqësore dhe nëntokësore Zona Minerare Nr. 233, për objektin Mulliri i Kaconit, Qarku Dibër", me vendndodhje Objekti "Blaç-Stepel-Kumbull", Zona Minerare nr. 233, vendburimi "Mulliri i Kaconit", Njësia Administrative Lurë, Dibër., me të dhëna teknike: Sipërfaqe 0.650 km 2

Aplikimi nr. AN281220220006 është bërë referuar ligjit Nr.10 440, datë: 7.7.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", Shtojca I, "Projektet që i nënshtrohen Procedurës së Thelluar të Vlerësimit

të Ndikimit në Mjedis", Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.
Nga auditimi rezulton se
Në procedurën e lëshimit të Deklaratës Mjedisore në shqyrtimin e kërkesës së subjektit "G" shpk, me aplikim nr. AN281220220006 me vendodhje Dibër, konstatohet mungesa e dhënies së mendimit nga institucioneve të konsultuara, konkretisht *Bashkia Dibër, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, MIE*, duke u konsideruar si "Miratim në heshtje". Kjo situatë nuk është në përputhje me Kreun II, pika 4.2, shkronja "c" të VKM nr. 686, datë 29.07.2015, "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive dhe të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore", të ndryshuar, sipas së cilës Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), kur vlerëson se dokumentacioni i aplikimit apo dokumentacioni i plotësuar është i plotë, brenda 5 (pesë) ditëve pune ia përcjell dokumentacionin njësive të qeverisjes vendore përkatëse, të cilat janë të detyruara të japin mendimin on-line në sistemin e-leje 7 (shtatë) ditëve pune.
"C. T - U" Shpk. - Deklarate Mjedisore
Personi Juridik "C. T – U" shpk me NIPT K.....L, ka aplikuar ne sistemin e-leje për të zhvilluar projektin "Shfrytëzimi i mineralit Argjilë, zona minerare Nr.22/16 Objekti Argjilë "M", me vendndodhje zona minerare nr. 22/16 (Objekti M), Qarku Durrës. me të dhëna teknike: Sipërfaqe: 0.061 km2 Lloji i mineralit: Argjilë
Aplikimi nr. AN281220220006 është bërë referuar ligjit Nr.10 440, datë: 7.7.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", Shtojca I, "Projektet që i nënshtrohen Procedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis", Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.
Nga auditimi rezulton se
Në procedurën e lëshimit të Deklaratës Mjedisore për zhvilluesin "C. T - U" shpk, me aplikim nr. AN070720230005, konstatohet mungesa e dhënies së mendimit nga institucioneve të konsultuara, konkretisht *Bashkia Durrës, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, MIE,* duke u konsideruar si "Miratim në heshtje". Kjo situatë nuk është në përputhje me Kreun II, pika 4.2, shkronja "c" të VKM nr. 686, datë 29.07.2015, "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive dhe të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore", të ndryshuar, sipas së cilës Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), kur vlerëson se dokumentacioni i aplikimit apo dokumentacioni i plotësuar është i plotë, brenda 5 (pesë) ditëve pune ia përcjell dokumentacionin njësive të qeverisjes vendore përkatëse, të cilat janë të detyruara të japin mendimin on-line në sistemin e-leje 7 (shtatë) ditëve pune.
"B. A" Shpk. - Deklaratë Mjedisore (Negative)
Personi Juridik "B. A" shpk me NIPT L.....G, ka aplikuar ne sistemin e-leje për të zhvilluar projektin "Furrë djegieje për asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme, mbetjeve mjekësore e medikamenteve", me vendndodhje Parku Industrial i shtrirë në Zonën Kadastrale 2591, nr. Pasurie nr.1 dhe nr.2, Manskuri, Rrashbull, Bashkia Durrës. me të dhëna teknike: Numri i aplikueshëm i shtretërve 300 – 500; Kapaciteti i djegies 200 – 300 kg/herë (kapaciteti ditor 3-6 herë); Madhësia e furrës 2.25 m x 1.6 m x 3.8 m ;Volumi i furrës: Dhoma e gazifikimit 2.4 m3: Dhoma e djegies dytësore 1.2 m3: Dhoma e djegies finale 0.16 m3 ; Madhësia e mbushjes 900 mm x 1100 mm : Oxhaku Lartësia 13 m; Rrezja e jashtme Ø 400 mm; Fryrësi Fuqi 1.1 KË; Makineri djegëse mbështetëse Fuqi 0.22 KË; Konsumi i karburantit 7-14 kg/h ; Makineri ri-djegëse; Fuqi 0.37 KË; Konsumi i karburantit 10-20 kg/h; Tensioni i punës 220V; Pesha Afërsisht 9 600 kg
Aplikimi nr. AN281220220006 është bërë referuar ligjit Nr.10 440, datë: 7.7.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", Shtojca I, "Projektet që i nënshtrohen Procedurës së Thelluar të Vlerësimit

të Ndikimit në Mjedis", Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.
Nga auditimi rezulton se
Në procedurën e lëshimit vlerësimit të ndikimit në mjedis, për zhvilluesin "C.T- U" shpk., me aplikim nr. AN070720230005, pavarësisht se vendimmarrja është Deklaratë Mjedisore (Negative), me institucioneve e konsultuara konstatohet mungesa e dhënies së mendimit konkretisht nga Bashkia Durrës i cili nuk është shterues, *Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore*, MIE, duke u konsideruar si "Miratim në heshtje". Kjo situatë nuk është në përputhje me Kreun II, pika 4.2, shkronja "c" të institucioneve të konsultuara VKM nr. 686, datë 29.07.2015, "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive dhe të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore", të ndryshuar, sipas së cilës Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), kur vlerëson se dokumentacioni i aplikimit apo dokumentacioni i plotësuar është i plotë, brenda 5 (pesë) ditëve pune ia përcjell dokumentacionin njësive të qeverisjes vendore përkatëse, të cilat janë të detyruara të japin mendimin on-line në sistemin e-leje 7 (shtatë) ditëve pune.
"Ch. F.A" Shpk- Vendim për VNM Paraprake
Person Juridik "Ch. F. A" Shpk me NIPT L.....N, ka aplikuar ne sistemin e-leje për të zhvilluar projektin: " Instalime për therjen e kafshëve".
Vendndodhja: 1 km larg rruges nacionale dhe 2-3 km, larg qytetit te Kavajes, Agonas, Golem, Kavaje, Tirane, me të dhëna teknike: Kapaciteti total është 1700-1800 ton/ vit.
Aplikimi nr. AN310120250005 është bërë referuar Ligjit Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Shtojca II: Pika 7. Industria ushqimore. dh) Instalime për therjen e kafshëve.
Nga auditimi rezulton se në VNM Paraprake me AN310120250005 mbështetur në mendimin e institucioneve të konsultuara dhe mendimin e anëtarëve të Komisionit 43 datë 25.04.2025, mungon marrja e mendimit nga njësitë e qeverisjes vendore Bashkia Tiranë, në kundërshtim Kreun II, pika 4.2 germa c) VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për Miratimin e Rregullave, të Përgjegjësive e të Afateve për Zhvillimin e Procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe Procedurës së Transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore", i ndryshuar, sipas të cilës kur AKM-ja vlerëson se dokumentacioni i aplikimit apo dokumentacioni i plotësuar është i plotë, në varësi të projektit ia përcjell atë *institucioneve të tjera që, në varësi të llojit të projektit, janë përgjegjëse për lejimin/autorizimin/licencimin e tij apo përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin, shëndetin publik dhe emergjencat natyrore dhe civile;*
"Ç. M SHPK"- Vendim për VNM Paraprake
Person Juridik Ç. M "SHPK" me NIPT K.....E, ka aplikuar ne sistemin e-leje për të zhvilluar projektin: "Magazinim, grumbullim i hekurishteve/skrapeve te metalit" Vendndodhja: Xhafzotaj, Shijak, Durrës., me të dhëna teknike: Sipërfaqja totale e pasurisë: 36936 m2 ; Sipërfaqja e truallit e zënë nga sheshi I depozitimit te skrapeve: 7723 m2; Koeficienti i shfrytëzimit të territorit: 20.9%.
Aplikimi nr. AN190720230001 është bërë referuar Ligjit Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr.10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Shtojca II Projektet që i nënshtrohen procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis, d) Depot e skrapit të hekurit, përfshirë ato nga automjetet.
Nga auditimi rezulton se në VNM Paraprake
Në VNM Paraprake me AN310120250005 mbështetur në mendimin e institucioneve të konsultuara dhe mendimin e anëtarëve të Komisionit 43 datë 25.04.2025, mungon marrja e mendimit nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore ; Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura; Bashkia Durrës ; Agjencia Rajonale e Mjedisit Tirane, Durrës, Dibër, në kundërshtim

Kreun II, pika 4.2 germa c) VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për Miratimin e Rregullave, të Përgjegjësive e të Afateve për Zhvillimin e Procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe Procedurës së Transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore", i ndryshuar, sipas të cilës kur AKM-ja vlerëson se dokumentacioni i aplikimit apo dokumentacioni i plotësuar është i plotë, në varësi të projektit ia përcjell atë *institucioneve të tjera që, në varësi të llojit të projektit, janë përgjegjëse për lejimin/autorizimin/licencimin e tij apo përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin, shëndetin publik dhe emergjencat natyrore dhe civile;*

"D-P" shpk - Vendim për VNM Paraprake

Person Juridik "D-P" shpk me NIPT K.....A, ka aplikuar ne sistemin e-leje për të zhvilluar projektin: "Minierë Nëntokësore" me Vendndodhja: Objekti i kromit "Shkallë, Micek", rrethi Mat, qarku Dibër, me të dhëna teknike: Sipërfaqja e zonës minerare: 0.2928 km2, Lloji Mineralit: Krom. Aplikimi nr. AN040620240009 është bërë referuar Ligjit Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Shtojca II: "Projektet që i nënshtrohen procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis", Pika 2. Industri nxjerrëse/ 2.2 Minierat nëntokësore.

Nga auditimi rezulton se në VNM Paraprake

Në VNM Paraprake për Aplikimin AN010820250266 mungon mendimi nga njësitë e qeverisjes vendore Bashkia Fier, në kundërshtim Kreun II, pika 4.2 germa c) VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për Miratimin e Rregullave, të Përgjegjësive e të Afateve për Zhvillimin e Procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe Procedurës së Transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore", i ndryshuar, sipas të cilës kur AKM-ja vlerëson se dokumentacioni i aplikimit apo dokumentacioni i plotësuar është i plotë, në varësi të projektit ia përcjell atë *institucioneve të tjera që, në varësi të llojit të projektit, janë përgjegjëse për lejimin/autorizimin/licencimin e tij apo përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin, shëndetin publik dhe emergjencat natyrore dhe civile;*

P. E – VNM Paraprake

Person Juridik "P. E" Sh.p.k, me NIPT M.....D, ka aplikuar ne sistemin e-leje për të zhvilluar projektin: "Centrali Fotovoltaik Centrali Elektrik Fotovoltaik "Poëer Energy Solar Park" 25 MW".

Vendndodhja: Zona Kadastrale Nr. 3038, Fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier, me të dhëna teknike: Fuqia e instaluar: 25 MË.

Aplikimi është bërë referuar Ligjit nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Shtojca II: Pika 3.Industria e energjisë. a) Instalimet industriale për prodhimin e energjisë elektrike, avullit ose ujit të ngrohtë (projekte që nuk përfshihen në shtojcën I);

Nga auditimi rezulton:

Në VNM Paraprake për Aplikimin AN290120250029 mungon marrja e mendimit nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për të dhënë mendim nëse zhvillimi/ndërtimi, konsiderohet që nuk bie ndesh me përcaktimet e legjislacionit për burimet ujore, nëse projekti ndodhet pranë Zonës me Rrezik nga Përmbytjet apo që ka gjasa të ndodhin përmbytje (ZRrPP) Vjosa 3, e shpallur si e tillë me vendimin nr.1, datë 15.6.2021 të Këshillin Kombëtar të Ujit (KKU) dhe të rikonfirmuar me vendimin nr.1, datë 15.7.2024 të KKU-së, sipas përcaktimeve të pikës 7, të Kreut III, të Vendimit nr.748 datë 1.12.2022 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e zonës, distancës dhe gjerësisë së brigjeve të burimeve ujore".

Në VNM Paraprake për Aplikimin AN290120250029 mungon mendimi nga njësitë e qeverisjes vendore Bashkia Fier, në kundërshtim Kreun II, pika 4.2 germa c) VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për Miratimin e Rregullave, të Përgjegjësive e të Afateve për Zhvillimin e Procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe Procedurës së Transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore", i ndryshuar, sipas të cilës kur AKM-ja vlerëson se dokumentacioni i aplikimit apo dokumentacioni i plotësuar është i plotë, në varësi të projektit ia përcjell atë *institucioneve të tjera që, në varësi të llojit të projektit, janë përgjegjëse për lejimin/autorizimin/licencimin e tij apo përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin, shëndetin publik dhe emergjencat natyrore dhe civile;*

F. S shpk- VNM Paraprake

Person Juridik "F. S" Sh.p.k, me NIPT M.....G, ka aplikuar ne sistemin e-leje për të zhvilluar projektin: "Ndërtimi i Parkut Fotovoltaik Fos Solar 40MW DC (36 MW AC)"

Vendndodhja: Bashkia Fier, Qarku Fier, me të dhëna teknike: Fuqia e instaluar: 40 MW DC (36 MW AC).

Aplikimi AN030420250005 është bërë referuar Ligjit nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Shtojca II: Pika 3.Industria e

energjisë. a) Instalimet industriale për prodhimin e energjisë elektrike, avullit ose ujit të ngrohtë (projekte që nuk përfshihen në shtojcën I);
Nga auditimi rezulton:
Në VNM Paraprake të Agjencisë Kombëtare e Mjedisit për Aplikimin AN030420250005 mungon marrja e vendimit nga njësitë e qeverisjes vendore, në kundërshtim Kreun I, pika 4.2 germa ç) VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për Miratimin e Rregullave, të Përgjegjësive e të Afateve për Zhvillimin e Procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe Procedurës së Transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore", i ndryshuar, sipas të cilës kur AKM-ja vlerëson se dokumentacioni i aplikimit apo dokumentacioni i plotësuar është i plotë, në varësi të projektit ia përcjell atë *Agjencisë Rajonale të Mjedisit (ARM), në qarkun ku propozohet të zbatohet projekti, së cilës i jepen edhe udhëzimet përkatëse për marrjen e mendimit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.*
Në VNM Paraprake për Aplikimin AN030420250005 mungon marrja e mendimit nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (konsideruar miratim në heshtje) për të dhënë mendim nëse zhvillimi/ndërtimi, konsiderohet që nuk bie ndesh me përcaktimet e legjislacionit për burimet ujore, nëse projekti ndodhet pranë Zonës me Rrezik nga Përmbytjet apo që ka gjasa të ndodhin përmbytje (ZRrPP) Vjosa 3, e shpallur si e tillë me vendimin nr.1, datë 15.6.2021 të Këshillin Kombëtar të Ujit (KKU) dhe të rikonfirmuar me vendimin nr.1, datë 15.7.2024 të KKU-së, sipas përcaktimeve të pikës 7, të Kreut III, të Vendimit nr.748 datë 1.12.2022 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e zonës, distancës dhe gjerësisë së brigjeve të burimeve ujore".
"V.S" shpk- VNM Paraprake
Person Juridik "V. S" shpk, me NIPT M.....F, ka aplikuar me AN200520250037 ne sistemin e-leje për të zhvilluar projektin: "Projekti Fotovoltaik Voltz 15.2 MW" Vendndodhja: Bashkia Fier, me të dhëna teknike: Fuqia e instaluar: 15.2 MW.
Aplikimi është bërë referuar Ligjit nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Shtojca II: Pika 3.Industria e energjisë. a) Instalimet industriale për prodhimin e energjisë elektrike, avullit ose ujit të ngrohtë (projekte që nuk përfshihen në shtojcën I);
Nga auditimi rezulton:
Në VNM Paraprake për Aplikimin AN200520250037 mungon mendimi nga njësitë e qeverisjes vendore Bashkia Fier, në kundërshtim Kreun II, pika 4.2 germa c) VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për Miratimin e Rregullave, të Përgjegjësive e të Afateve për Zhvillimin e Procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe Procedurës së Transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore", i ndryshuar, sipas të cilës kur AKM-ja vlerëson se dokumentacioni i aplikimit apo dokumentacioni i plotësuar është i plotë, në varësi të projektit ia përcjell atë *institucioneve të tjera që, në varësi të llojit të projektit, janë përgjegjëse për lejimin/autorizimin/licencimin e tij apo përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin, shëndetin publik dhe emergjencat natyrore dhe civile;*
"Z shpk"- VNM Paraprake
Person Juridik "F. S" Sh.p.k, me NIPT M.....O, ka aplikuar me AN061120240005 ne sistemin e-leje për të zhvilluar projektin: "Ndërtimi i Impiantit Fotovoltaik 2 MW"
Vendndodhja: Njësia Administrative Topoje, FIER, me të dhëna teknike: Fuqia e instaluar: 2 MË.
Aplikimi është bërë referuar Ligjit nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Shtojca II: Pika 3.Industria e energjisë. a) Instalimet industriale për prodhimin e energjisë elektrike, avullit ose ujit të ngrohtë (projekte që nuk përfshihen në shtojcën I);
Nga auditimi rezulton:

Në VNM Paraprake për Aplikimin AN061120240005 mungon mendimi nga njësitë e qeverisjes vendore, në kundërshtim Kreun II, pika 4.2 germa c) VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për Miratimin e Rregullave, të Përgjegjësive e të Afateve për Zhvillimin e Procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe Procedurës së Transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore", i ndryshuar, sipas të cilës kur AKM-ja vlerëson se dokumentacioni i aplikimit apo dokumentacioni i plotësuar është i plotë, në varësi të projektit ia përcjell atë *institucioneve të tjera që, në varësi të llojit të projektit, janë përgjegjëse për lejimin/autorizimin/licencimin e tij apo përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin, shëndetin publik dhe emergjencat natyrore dhe civile;*
Në VNM Paraprake për Aplikimin AN061120240005 mungon marrja e mendimit nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për të dhëna mendim e saj nëse zhvillimi/ndërtimi, konsiderohet që nuk bie ndesh me përcaktimet e legjislacionit për burimet ujore, ose nëse projekti ndodhet pranë Zonës me Rrezik nga Përmbytjet apo që ka gjasa të ndodhin përmbytje (ZRrPP) Vjosa 3, e shpallur si e tillë me vendimin nr.1, datë 15.6.2021 të Këshillin Kombëtar të Ujit (KKU) dhe të rikonfirmuar me vendimin nr.1, datë 15.7.2024 të KKU-së, sipas përcaktimeve të pikës 7, të Kreut III, të Vendimit nr.748 datë 1.12.2022 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e zonës, distancës dhe gjerësisë së brigjeve të burimeve ujore", në kundërshtim Kreun I, pika 4.2 germa c) VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për Miratimin e Rregullave, të Përgjegjësive e të Afateve për Zhvillimin e Procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe Procedurës së Transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore", i ndryshuar.
S- VNM Paraprake
Person Juridik "S" Sh.p.k, me NIPT L.....I, ka aplikuar ne sistemin e-leje për të zhvilluar projektin: "Sun Tech Power - Projekti i Energjisë së Erës, Maja e Shtogut 3 MW)".
Vendndodhja: Tragjas, Njësia administrative Orikum, Bashkia Vlorë, me të dhëna teknike: Fuqia e instaluar: 3 MW
Aplikimi është bërë referuar ligjit nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Shtojca II: Pika 3.Industria e energjisë. a) Instalimet industriale për prodhimin e energjisë elektrike, avullit ose ujit të ngrohtë (projekte që nuk përfshihen në shtojcën I);
Nga auditimi rezulton:
Në VNM Paraprake të Agjencisë Kombëtare e Mjedisit për Aplikimin AN140120250004 mungon marrja e vendimit nga njësitë e qeverisjes vendore edhe pse zhvilluesi ka paraqitur Kontratë Qiraje me Bashkinë Vlorë (Sektori i Pyjeve dhe Kullotave) me nr. 6636 prot., datë 09.06.2022, për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullosor publik, në kundërshtim Kreun I, pika 4.2 germa ç) VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për Miratimin e Rregullave, të Përgjegjësive e të Afateve për Zhvillimin e Procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe Procedurës së Transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore", i ndryshuar, sipas të cilës kur AKM-ja vlerëson se dokumentacioni i aplikimit apo dokumentacioni i plotësuar është i plotë, në varësi të projektit ia përcjell atë *Agjencisë Rajonale të Mjedisit (ARM), në qarkun ku propozohet të zbatohet projekti, së cilës i jepen edhe udhëzimet përkatëse për marrjen e mendimit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.*
A. G- Deklarate Mjedisore
Personi Juridik A. G shpk me NIPT L.....U, ka aplikuar ne sistemin e-leje për të zhvilluar projektin "Shfrytëzim dhe Përpunim i Mineralit Litiumit", "Leja Minerare Kërkim Zbulimi, Nr. 1907, Dt. 21.01.2021, Objekti "Zhulat - Picar".me vendndodhje Bashkia Gjirokastër, Qarku Gjirokastër. Mbështetur në deklarimet e AKBN-së me të dhëna teknike: Sipërfaqja e lejes minerare: 0.9 km^2; Sipërfaqja e karrierës: 39680.126 m^2; Prodhimi vjetor i mineralit: 20 000 m^3 /vit.

Aplikimi nr. AN300620250004 është bërë referuar ligjit nr. 10440, date: 7.7.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", Shtojca I, "Projektet që i nënshtrohen Procedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis", Pika 19, gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.
Nga auditimi rezulton se
Në procesin e lëshimit të Deklaratës Mjedisore për zhvilluesin "A. G" shpk., lidhur me aplikimin nr. AN240320250001, nga grupi i auditimit u konstatua se mendimi i AKBN-së rezulton i paplotë. Konkretisht, ai nuk përmban informacion mbi sipërfaqen që do të hiqet nga fondi pyjor dhe nuk është shprehur nëse zona e shpallur ka qenë objekt i një lejeje kërkim-zbulimi, pavarësisht se kjo është konfirmuar nga MIE.
Në procedurën e lëshimit të Deklaratës Mjedisore për zhvilluesin "A.G" shpk. konstatohet mungesa e marrjes së mendimit nga *Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore,* njësitë e qeverisjes vendore Bashkia Gjirokastër. Ky veprim është në kundërshtim me Kreun II, pika 4.2, germa c) të VKM nr. 686, datë 29.7.2015, "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore", i ndryshuar. Sipas kësaj dispozite, kur Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) vlerëson se dokumentacioni i aplikimit apo dokumentacioni i plotësuar është i plotë, ajo, në varësi të llojit të projektit, është e detyruar t'ia përcjellë dokumentacionin institucioneve të tjera përgjegjëse për lejimin, autorizimin apo licencimin e tij, si dhe institucioneve përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin, shëndetin publik dhe emergjencat natyrore e civile
Nga auditimi u konstatua se gjatë konsultimit publik të zhvilluar më datë 23.06.2025, pjesëmarrja ka qenë e ulët. Në këtë proces kanë munguar përfaqësuesit e strukturave përgjegjëse për pyjet, si dhe përfaqësuesit e njësive të vetëqeverisjes vendore. Ky fakt përbën shkelje të Kreut II, pika 4.2, germa ç) të VKM nr. 686, datë 29.7.2015, "*Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore*", i ndryshuar. Sipas kësaj dispozite, kur Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) vlerëson se dokumentacioni i aplikimit apo dokumentacioni i plotësuar është i plotë, ajo, në varësi të projektit, ia përcjell atë Agjencisë Rajonale të Mjedisit në qarkun ku propozohet të zbatohet projekti, duke i dhënë udhëzimet përkatëse për marrjen e mendimit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

S.V- Deklaratë Mjedisore
Personi Juridik "S. V" shpk. me NIPT L.....R, ka aplikuar ne sistemin e-leje për të zhvilluar projektin "Shfrytëzim i gurit gëlqeror të mermerizuar, Zona Minerare Nr.70/12",.me vendndodhje Zona Minerare nr.70/12, Objekti "Lepenice", Qarku Vlorë. Mbështetur në deklarimet e AKBN-së me të dhëna teknike: Sipërfaqe për t'u shfrytëzuar: 12.03 ha, lloji i mineralit: Gur gëlqeror i mermerizuar.
Aplikimi nr. AN040920250016 është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, datë: 7.7.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", Shtojca I, "Projektet që i nënshtrohen Procedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis", Pika 19., gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.
Ky subjekt është pajisur me Njoftim për fillim procedure në komisionin Nr.105, datë 26.08.2025 bazuar në mendimin e institucioneve të mëposhtme:
Drejtoritë teknike të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit parimisht *shprehen* dakord dhe pa vërejtje duke mbajtur parasysh legjislacionin në fuqi.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet se sipërfaqja ku do të zhvillohet aktiviteti nuk ndodhet brenda rrjetit të zonave të mbrojtura.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore shprehet: Në vijim të shkresës me nr. 2283. Prot, datë 28.05.2025, ju informojmë se Zona Minerare 70/12, Objekti "Selenicë", Bashkia Vlorë, është Miratuar Zonë Konkuruese me VKM, NR.664, date 10.10.2019 "Per miratimin e programit te veprimit 3- vjeçar, ne zbatim te Strategjisë Minerare"

Agjencia e Menaxhimit te Burimeve Ujore shprehet: se sipërfaqja ku kërkohet shfrytëzimi i Gurit Gëlqeror nuk bie ndesh me dispozitat e legjislacionit për burimet ujore. Sugjerojmë, që të zbatohen masat e propozuara në Raportin Teknik, si dhe në Njoftimin për VNM të Thelluar, për mbrojtjen e mjedisit të cilat ruajnë moscënimin e burimeve ujore. Gjithashtu, nëse subjekti "SPA V" sh.p.k nuk ka një kontratë për furnizimin me ujë të aktivitetit dhe do të përdorë burimet ujore për qëllime të tjera (teknologjike), duhet të aplikojë për leje për furnizim me ujë nëpërmjet portalit e-Albania, "Aplikim për përdorim burimi ujor".

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Shoqërisë SPA V. sh.p.k i është dhënë e drejta nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Nr.2592/1 prot. MIE, datë 27.03.2025), për të aplikuar në QKB për pajisje me leje minerare shfrytëzimi, për mineralin gëlqeror i mermerizuar, zona nr.70/12, objekti "Lepenicë", Qarku Vlorë. Për sa më sipër, në zbatim te Ligjit Nr. 10 304, datë 15.7.2010"Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, shprehemi dakord për vazhdimin e procedurave për pajisjen e shoqërisë së mësipërme me lejen përkatëse në funksion të veprimtarisë minerare në zonën e licencuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në rast të plotësimit të dokumentacionit të kërkuar.

Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastër, jep mendimin se subjekti duhet të vazhdojë procedurat përkatëse për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Të Thelluar).

Bashkia Selenicë: Në përgjigje të kërkesës suaj regjistruar ne sistemin e-leje me AN200520250021, për shprehje mendim në lidhje me PPV dhe fondin pyjor/kullosor për zhvillimin e projektit 'Shfrytëzim i gurit gëlqeror' ju bëjmë me dije sa vijon: 1. Sipas Planit të përgjithshëm vendor sipërfaqja e propozuar ndodhet në Kategorinë 1 – Tokë natyrore dhe Nënkategoria N1 – Kullotë. Në këtë kategori përdorimi bazë është për funksione bujqësore – blegtorale dhe mjedisore. 2. Zona është pjesë në fondin pyjor/kullosor të Bashkisë Selenicë, sipas regjistrave të pasurive pyjore e kullosore. Konkretisht Nr. Pasurie 13 bene pjese ne ekonominë kullosore Gjorm – Vranisht, kurse pasuritë nr. 25, 24,26b dhe 26°, bëjnë pjesë në ekonomin pyjore Mali Bratit-Gumenice.

Ministri me propozim të Agjencisë Kombëtare e Mjedisit, në shqyrtimin e kërkesës së subjektit "A. G" shpk. me aplikim nr. AN240320250001, në lidhje zhvillimin e procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis, mbështetur në mendimin e institucioneve të konsultuara dhe mendimin e anëtarëve të Komisionit 168 datë 23.12.2025 vendosi Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për Zhvilluesin duke i sugjeruar autoritetit planifikues Miratimin e lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me sugjerimin e plotësimit të 33 kushte kryesore që duhen marri zhvilluesi për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme.

Në bazë të Ligjit Nr. 10440, datë: 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", të ndryshuar, Neni 25/1 "Monitorimi dhe vlefshmëria", zhvilluesi ka detyrime të bëjë Monitorimin dhe Raportim sipas kritereve të përcaktuara në VNM Paraprake, duke filluar në datën 18.01.2026 lidhur me informacion në momentin e fillimit të punimeve; Raportimin periodik për parametrat që do të monitorohen sipas datës së raportimit/ çdo 6 muaj; informacion në përfundim të punimeve, lidhur me punimet rehabilituese të territorit përreth, shoqëruar edhe me foto.

"T. F" shpk- Deklarate Mjedisore

Personi Juridik “T. F” shpk me NIPT L.....S, ka aplikuar ne sistemin e-leje për të zhvilluar projektin “Ndërtimi i parkut fotovoltaik tekno fire solar – 102 MW, dhe veprave ndihmëse (linje elektrike 110 Kv, dhe nënstacion 110 Kv)”,.me vendndodhje Bashkia Kolonjë dhe Bashkia Përmet me të dhëna teknike: Fuqia e instaluar: 102 MË Sipërfaqja totale: 147.8 ha, Nënstacioni elektrik dhe linja 110 Kv: 42 km.
Aplikimi nr. AN120620250039 është bërë referuar ligjit nr. 10 440, date: 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Procedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, Industria e energjisë, Instalime industriale për mbajtjen e gazit, avullit ose ujit të ngrohtë; transmetimin e energjisë elektrike me kabëll në lartësi.
Nga auditimi u konstatua se:
Impianti fotovoltaik se bashku me nënstacionin është i pozicionuar ne Bashkinë Kolonje ndërsa linja elektrike do te shtrihet përgjatë Bashkisë Përmet, etj. Në lëshimin e Deklaratës Mjedisore për zhvilluesin “T. F” shpk me aplikim nr. AN120620250039 mungon marrja e mendimit nga njësitë e qeverisjes vendore Bashkia Kolonjë, në kundërshtim Kreun II, pika 4.2 germa c) VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për Miratimin e Rregullave, të Përgjegjësive e të Afateve për Zhvillimin e Procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe Procedurës së Transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, i ndryshuar.
Në konsultimin publik të zhvilluar më datë 26.06.2025, pjesëmarrja ka qenë e ulët. Në këtë proces kanë munguar përfaqësuesit e strukturave përgjegjëse për pyjet, si dhe përfaqësuesit e njësive të vetëqeverisjes vendore të Bashkia Përmet, në kundërshtim me Kreu II, pika 4.2, germa ç) të VKM nr. 686, datë 29.7.2015, “*Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore*”, i ndryshuar.
“D-P” shpk VNM Paraprake
Person Juridik “D-P” Sh.p.k, me NIPT K.....A, ka aplikuar ne sistemin e-leje për të zhvilluar projektin: “Magazinë për Paketim Peshku”
Vendndodhja: Cepo, Kardhiq, Zona Kadastrale 3058, Gjirokastër, me të dhëna teknike: Sipërfaqja sheshit të ndërtimit: 4 400 m2, Sipërfaqja e gjurmës së ndërtimit: 435 m^2, Koeficienti i shfrytëzimit te truallit: 10 % , Intensiteti i ndërtimit: 0.15, Numri i kateve, objekti i ri: 2 kat.
Aplikimi është bërë referuar Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Shtojca II: Pika 10. Prodhime infrastrukturore, a) Projekte për zhvillimin e pasurive të patundshme industriale;
Nga auditimi rezulton:
AKM-ja pas përfundimit të procedurës paraprake të VNM-së, për Aplikimin AN090720250040 për të zhvilluar projektin: “Magazinë për Paketim Peshku vendosi që ky projekt nuk duhet t’i nënshtrohet procedurës së VNM-së thelluar për zhvilluesin mbështetur ne mendimin e institucioneve të konsultuara dhe mendimin e anëtarëve të Komisioni 95 datë 11.08.2025 ka përcaktuar marrjen e 22 masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme. Në mendimin e institucioneve të konsultuara, rezulton se Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastër ka ngritur grupin e punës më datë 24.07.2025 i cili ka konstatuar se burimi ujor më i afërt me sipërfaqen e projektit gjendet lumi i Kardhiqit me një distancë rreth 100 m në vijë ajrore nga sipërfaqja ku do të ndërtohet objekti. etj.
Ky subjekt ka aplikuar në sistemin e leje edhe në vitin 2020 me AN07052020004 për të cilin AKM-ja pas përfundimit të procedurës paraprake të VNM-së, mbështetur ne mendimin e institucioneve të konsultuara dhe mendimin e anëtarëve të Komisioni 56 datë 27.05.2024 vendosi nuk mund të dalë me VNM Paraprake për subjektin “D-P” SHPK me projekt “Magazinë për

paketim peshku" me arsyetimin: se Raporti Teknik nuk është në përputhje me përcaktimet e pikës 1.1 të Kreut I të VKM nr.686/2015; Projekti për zhvillimin e aktivitetit të propozuar është në distancë 100 m nga lumi Kardhiq, për rrjedhojë ka shkarkim të ujërave të ndotur me aroma të pakëndshme (aromat e produktit erë peshku); Pastrimi dhe paketimi i peshkut do të shkaktojë ndotje të linjës së pastrimit; Theksojmë se aktivitete të tilla kanë sjellë shqetësime në komunitet.
Grupi i auditimit arsyeton se aplikimi AN090720250040 projekti u pranua me kusht që të zbatohen 22 masa të detyrueshme. Ky Vendim është i vlefshëm vetëm për ndërtimin e objektit. Ndërkohë në aplikimin paradhës AN07052020004 AKM-ja nuk ka miratuar aplikimin, pasi nuk kishte bazë ligjore dhe teknike për të garantuar mbrojtjen e mjedisit.
Grupi i auditimit konstaton se AKM-ja nuk ka vepruar me kritere të unifikuara për të dy aplikimet, duke marrë parasysh faktin që ndotja është e pranishme në të dyja rastet dhe afërsia me lumin Kardhiq e bën zonën shumë të ndjeshme. Kjo do të thotë AKM mund të kërkonte VNM të thelluar për të dy aplikimet, dhe kushte të barabarta për monitorim dhe masa korrigjuese duke përfshirë komunitetin në konsultim, për të adresuar marrjen e masave duke garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe komunitetit. Vendimi i AKM–së bie në kundërshtim me nenin 1 germa a) të ligjit 10440/2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar, sipas të cilit ky ligj ka për qëllim të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim. Vendimi i AKM–së bie në kundërshtim me kriteret ndihmëse për marrjen e vendimit gjatë procedurës paraprake të VNM-së, përcaktuar në Shtojcën 1, pika 1 "Karakteristikat e projektit" paragrafi "prodhimi i mbetjeve" VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për Miratimin e Rregullave, të Përgjegjësive e të Afateve për Zhvillimin e Procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Procedurës së Transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore".
E. D VNM Paraprake
Person Fizik "E. D" me NIPT M.....N, ka aplikuar ne sistemin e-leje për të zhvilluar projektin: "Dy objekte bujqësore 1 kat"
Vendndodhja: Në fshatin Mbrostar Ura, Njësia administrative Mbrostar, Bashkia Fier, me të dhëna teknike: Sipërfaqja e tokës ku do te zhvillohet: 7972 m2 Sipërfaqja e tokës e zënë nga struktura (Gjurma): 895.8m2 Numri i kateve mbi toke 1 Numri i kateve nen toke 0 Lartësia maksimale e strukturës nga niveli i tokës 4.50 m,
Aplikimi është bërë referuar Ligjit Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Shtojca II: Pika 10. Prodhime infrastrukturore, a) Projekte për zhvillimin e pasurive të patundshme industriale;
Nga auditimi rezulton:
Zhvilluesi ka aplikuar në sistemin e lejeve me nr. AN150120250002, për të zhvilluar projektin: "Dy objekte bujqësore 1 kat" duke u mbështetur në Ligjin Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë 07.07.2011, 'Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis'", Shtojca II, pika 10, që lidhet me projektet për zhvillimin e pasurive të patundshme industriale.
Grupi i auditimit konstaton se baza ligjore e përdorur nuk është e saktë, pasi projekti nuk ka të bëjë me një objekt industrial apo bujqësor, por me një objekt me funksion blegtoral. Nga verifikimi në terren, grupi i punës i ARM-së sqaron se subjekti propozon ndërtimin e tre objekteve blegtorale me një kat (pulari, etj.), ndërkohë që në aplikim janë deklaruar si dy objekte bujqësore me një kat. Ky dallim është i rëndësishëm, sepse objektet bujqësore (sera, magazina prodhimi) kanë një regjim më të lehtë të VNM-së, ndërsa objektet blegtorale (stallë, pulari, ferma kafshësh) futen shpesh në listën e aktiviteteve me ndikim më të madh mjedisor, për shkak të mbetjeve organike, erës, ujërave të ndotura dhe menaxhimit të plehut.

Për rrjedhojë, aplikimi i zhvilluesit me AN150120250002 nuk është deklaruar si bujqësor dhe vendimi i AKM-së bie në kundërshtim me kriteret ndihmëse të procedurës të VNM-së paraprake, të përcaktuara në Shtojcën 1, pika 1 "Karakteristikat e projektit", paragrafi "prodhimi i mbetjeve", sipas VKM Nr. 686, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive dhe të afateve për zhvillimin e procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore".

"M. C. S" shpk VNM Paraprake

Person Fizik "M. C. S" shpk me NIPT M.....R, ka aplikuar ne sistemin e-leje për të zhvilluar projektin: "Ndërtim stalle, mbarështimi lopëve për qumësht" .

Vendndodhja: VLORE Bunavi, Kompleks për mbarështim, Zona kadastrale 1316, nr. pasurie 81/21/22, me të dhëna teknike:

Objekti 1: Stalla ekzistuese e lopëve - përmasat e objektit 18.1 m x 68 m - sipërfaqja totale = 1230.8 m2 - lartësia maksimale= 5.24 m - lartësia mesatare = 4.25 m - volumi i objektit = 5231 m3 Struktura e parashikuar për mbarështimin e 50 krerëve lope

Objekti 2: Objekt i ri ne funksion te rritjes se aktivitetit te mbarështimit të lopëve - përmasat e objektit 14 m x 80 m; - sipërfaqja totale = 1120 m2 - lartësia maksimale= 9.0 m; - lartësia mesatare = 7.2 m; - volumi i objektit = 8064 m3.

Objekti 3: Ambienti i veterinerit; - përmasat e objektit 15.6 m x 5.8 m; - sipërfaqja totale = 90.5 m2 - lartësia maksimale= 3.0 m; - lartësia mesatare = 3.0 m; - volumi i objektit = 271 m3 Aplikimi është bërë referuar Ligjit Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Shtojca II: Pika 10. Prodhime infrastrukturore, a) Projekte për zhvillimin e pasurive të patundshme industriale;

Nga auditimi u konstatua:

Në VNM Paraprake me AN010220250001 për të zhvilluar projektin: "Ndërtim stalle, mbarështimi lopëve për qumësht" mbështetur në mendimin e institucioneve të konsultuara dhe mendimin e anëtarëve të Komisionit 25 datë 07.03.2025, mungon marrja e mendimit nga njësitë e qeverisjes vendore Bashkia Vlorë, në kundërshtim Kreun II, pika 4.2 germa c) VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për Miratimin e Rregullave, të Përgjegjësive e të Afateve për Zhvillimin e Procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe Procedurës së Transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore", i ndryshuar, sipas të cilës kur AKM-ja vlerëson se dokumentacioni i aplikimit apo dokumentacioni i plotësuar është i plotë, në varësi të projektit ia përcjell atë *institucioneve të tjera që, në varësi të llojit të projektit, janë përgjegjëse për lejimin/autorizimin/licencimin e tij apo përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin, shëndetin publik dhe emergjencat natyrore dhe civile;*

"V 2002" shpk VNM -Paraprake

Person Fizik "V 2002" shpk me NIPT K.....Q, ka aplikuar ne sistemin e-leje për të zhvilluar projektin: "Rritje Intensive e Peshkut".

Vendndodhja: Vlorë Orikum Rruga e Pashait, Lagjja Pashaliman, Objekt detar (sipërfaqe ujore), vaska për rritjen e peshkut në Gjirin e Raguzës Karaburun, Vlorë, Orikum me të dhëna teknike: Sipërfaqja: 49.5 Ha Kapaciteti Total i kultivimit për 46 kosha: 2.000 ton/vit peshk, Distanca nga Bregu: 500 m.

Aplikimi Nr. AN230520250016 është bërë referuar ligjit nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Shtojca II: 1. Bujqësia, silvikultura dhe akuakultura. dh) Rritje intensive e peshkut;

Nga auditimi u konstatua:

Në VNM Paraprake me Nr. AN230520250016 të zhvilluar projektin: "Rritje Intensive e Peshkut". mbështetur në mendimin e institucioneve të konsultuara dhe mendimin e anëtarëve të Komisionit 25 datë 07.03.2025, mungon marrja e mendimit nga njësitë e qeverisjes vendore Bashkia Orikum,

në kundërshtim Kreun II, pika 4.2 germa c) VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për Miratimin e Rregullave, të Përgjegjësive e të Afateve për Zhvillimin e Procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe Procedurës së Transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore", i ndryshuar, sipas të cilës kur AKM-ja vlerëson se dokumentacioni i aplikimit apo dokumentacioni i plotësuar është i plotë, në varësi të projektit ia përcjell atë *institucioneve të tjera që, në varësi të llojit të projektit, janë përgjegjëse për lejimin/autorizimin/licencimin e tij apo përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin, shëndetin publik dhe emergjencat natyrore dhe civile;*

Konkluzion Përgjithshëm:

Nga auditimi u konstatua se në vendimmarrjen e Komisionit 90, datë 30.07.2025 për AN240720250044, mungon pjesa arsyetuese e shkakut të ndryshimit të koordinatave të projektit dhe përputhshmëria e tyre me vendimmarrjen nga MIE në Miratim Paraprak nr. 2514/1 prot., datë 26.03.2025, veprim në kundërshtim me nenin 99, pika 2, germa b) të Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës Së Shqipërisë",

Në VNM Paraprake mungon mendimi nga njësitë e qeverisjes vendore, në kundërshtim Kreun II, pika 4.2 germa c) VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për Miratimin e Rregullave, të Përgjegjësive e të Afateve për Zhvillimin e Procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe Procedurës së Transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore", i ndryshuar.

Në VNM Paraprake mungon mendimi nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për të dhënë mendimin nëse zhvillimi/ndërtimi, konsiderohet që nuk bie ndesh me përcaktimet e legjislacionit për burimet ujore, nëse projekti ndodhet pranë Zonës me Rrezik nga Përmbytjet apo që ka gjasa të ndodhin përmbytje.

Në VNM Paraprake për Aplikimin AN080120250002 mungon mendimi nga njësitë e qeverisjes vendore, në kundërshtim Kreun II, pika 4.2 germa c) VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për Miratimin e Rregullave, të Përgjegjësive e të Afateve për Zhvillimin e Procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe Procedurës së Transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore", i ndryshuar.

Në VNM Paraprake për Aplikimin AN020420250008 mungon marrja e mendimit nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për të dhënë mendim nëse zhvillimi/ndërtimi, konsiderohet që nuk bie ndesh me përcaktimet e legjislacionit për burimet ujore, nëse projekti ndodhet pranë Zonës me Rrezik nga Përmbytjet apo që ka gjasa të ndodhin përmbytje (ZRrPP) Vjosa 3, e shpallur si e tillë me vendimin nr.1, datë 15.6.2021 të Këshillin Kombëtar të Ujit (KKU) dhe të rikonfirmuar me vendimin nr.1, datë 15.7.2024 të KKU-së, sipas përcaktimeve të pikës 7, të Kreut III, të Vendimit nr.748 datë 1.12.2022 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e zonës, distancës dhe gjerësisë së brigjeve të burimeve ujore".

Në VNM Paraprake për Aplikimin AN010820250266 mungon mendimi nga njësitë e qeverisjes vendore Bashkia Fier, në kundërshtim Kreun II, pika 4.2 germa c) VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për Miratimin e Rregullave, të Përgjegjësive e të Afateve për Zhvillimin e Procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe Procedurës së Transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore", i ndryshuar.

Në VNM Paraprake për Aplikimin AN290120250029 mungon marrja e mendimit nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për të dhënë mendim nëse zhvillimi/ndërtimi, konsiderohet që nuk bie ndesh me përcaktimet e legjislacionit për burimet ujore, nëse projekti ndodhet pranë Zonës me Rrezik nga Përmbytjet apo që ka gjasa të ndodhin përmbytje (ZRrPP) Vjosa 3, e shpallur si e tillë me vendimin nr.1, datë 15.6.2021 të Këshillin Kombëtar të Ujit (KKU) dhe të rikonfirmuar me vendimin nr.1, datë 15.7.2024 të KKU-së, sipas përcaktimeve të pikës 7, të Kreut III, të Vendimit nr.748 datë 1.12.2022 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e zonës, distancës dhe gjerësisë së brigjeve të burimeve ujore".

Në VNM Paraprake për Aplikimin AN290120250029 mungon mendimi nga njësitë e qeverisjes vendore Bashkia Fier, në kundërshtim Kreun II, pika 4.2 germa c) VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për Miratimin e Rregullave, të Përgjegjësive e të Afateve për Zhvillimin e Procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe Procedurës së Transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore", i ndryshuar.
Në VNM Paraprake të Agjencisë Kombëtare e Mjedisit për Aplikimin AN030420250005 mungon marrja e vendimit nga njësitë e qeverisjes vendore, në kundërshtim Kreun I, pika 4.2 germa ç) VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për Miratimin e Rregullave, të Përgjegjësive e të Afateve për Zhvillimin e Procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe Procedurës së Transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore", i ndryshuar.
Në VNM Paraprake për Aplikimin AN030420250005 mungon marrja e mendimit nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (konsideruar miratim në heshtje) për të dhënë mendim nëse zhvillimi/ndërtimi, konsiderohet që nuk bie ndesh me përcaktimet e legjislacionit për burimet ujore, nëse projekti ndodhet pranë Zonës me Rrezik nga Përmbytjet apo që ka gjasa të ndodhin përmbytje.
Në VNM Paraprake për Aplikimin AN200520250037 mungon mendimi nga njësitë e qeverisjes vendore Bashkia Fier, në kundërshtim Kreun II, pika 4.2 germa c) VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për Miratimin e Rregullave, të Përgjegjësive e të Afateve për Zhvillimin e Procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe Procedurës së Transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore", i ndryshuar, sipas të cilës kur AKM-ja vlerëson se dokumentacioni i aplikimit apo dokumentacioni i plotësuar është i plotë, në varësi të projektit ia përcjell atë *institucioneve të tjera që, në varësi të llojit të projektit, janë përgjegjëse për lejimin/autorizimin/licencimin e tij apo përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin, shëndetin publik dhe emergjencat natyrore dhe civile;*

Agjencia Rajonale e Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan.

"B" shpk Vendim për VNM Paraprake
AKM, me vendimin e Komisionit nr. 64, datë 04.08.2023, pasi përfundoi procedurën paraprake të VNM-së, vendosi se projekti i subjektit "B" shpk për ndërtimin e HEC "Mazreka", me fuqi të instaluar 2000 kË dhe të vendosur në pellgun ujëmbledhës të lumit të Becit në Lekas, Bashkia Korçë, nuk duhet t'i nënshtrohet procedurës së VNM-së së thelluar.
Aplikimi AN110720230007 është bërë referuar Ligjit Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", Shtojca II: Pika 3. Industria e energjisë/ ë) Instalime për prodhimin e energjisë hidroelektrike.
Nga auditimi u konstatua:
Për aplikimin me Nr. AN110720230007, për të zhvilluar projektin: "Ndërtim HEC Mazreka", Agjencia Rajonale e Mjedisit Berat–Elbasan–Korçë, e mbështetur në VKM nr. 686/2015, nuk e kundërshton drejtpërdrejt zhvillimin e aktivitetit, por parashtron një sërë kushtesh teknike dhe mjedisore për zbatimin e tij, duke e konsideruar projektin të realizueshëm përmes masave zbutëse, ndërkohë që nuk shpreh një qëndrim të qartë lidhur me ndërtimin në një zonë me status "konservim natyror", sipas informacionit të përcjellë nga Bashkia Korçë.
Bashkia Korçë thekson se zona ku parashikohet zhvillimi i aktivitetit ka status "konservim natyror" sipas Planit të Përgjithshëm Vendor, çka nënkupton ruajtjen dhe mbrojtjen e territorit në gjendjen e tij ekzistuese origjinale dhe, në parim, kufizimin e ndërhyrjeve zhvillimore, ndërkohë që AKM, duke u mbështetur në VKM nr. 686, datë 29.07.2015, nuk e kundërshton drejtpërdrejt aktivitetin, por propozon një sërë kushtesh teknike dhe mjedisore për zbatimin e tij, duke e trajtuar projektin si të realizueshëm me masa zbutëse.

Në Aplikimin me nr. AN170220230004 datë 17..02.2023, AKM-ja ka refuzuar vlersimin mjedisor me arsyetimin se zona ka status konservim natyror, ku ndërhyrjet lejohen vetëm sipas legjislacionit të posaçëm, duke u mbështetur te informacioni i Bashkisë. Ndërsa, në aplikimin Nr. AN110720230007 me datë 11.07.2023, AKM-ja, pas përfundimit të procedures paraprake të VNM-së, vendosi që ky projekt nuk duhet t'i nënshtrohet procedurës së VNM-së së thelluar dhe del me vendim për VNM Paraprake, mbeshetur në mendimin e institucioneve të konsultuarar dhe menidmin e Komisioni 64, më: 04.08.2023.
Sa më sipër, në këto dy vendimmarje të AKM, evidentohet një mospërputhje midis qëndrimit të Bashkisë Korçë dhe qasjes së Agjencisë Kombetare të Mjedisit.
Në konsultimin me publikun të datës 20.04.2023 u konstatua mungesa e përfaqësuesit të Bashkisë Korçë, si edhe një pjesëmarrje shumë e ulët e publikut lidhur me zhvillimin e këtij projekti, pavarësisht se ai parashikohet të realizohet në ose pranë një zone të mbrojtur, ndikon në prurjen ekologjike, prek komunitetin vendas (siç dëshmohet nga një ankesë qytetare) dhe cenon resurse mjedisore të ndjeshme në këtë zonë.
"V. H" shpk Vendim për VNM Paraprake
AKM-ja pas përfundimit të procedurës paraprake të VNM-së, mbështetur në mendimin e anëtarëve të Komisionit 01, datë 07.06.2025, vendosi që ky projekt nuk duhet t'i nënshtrohet procedurës së VNM-së thelluar për "V. H" shpk. me NIPT-i: L.....M, për të zhvilluar projektin: "Ndërtim i hidrocentraleve "Lunik 1" dhe "Lunik 2" , me vendndodhje: Në pellgun ujëmbledhës të Zallit të Lunikut, Librazhd, me të dhëna teknike të projektit: Fuqia e instaluar Lunik 1: 2830 kË Fuqia e instaluar Lunik 2: 4600 kW.
Aplikimi AN031220240014 është bërë referuar Ligjit Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 9, "Projektet që i nënshtrohen procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis'', Pika 1. Procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis i nënshtrohen: b) projektet, për të cilat vendimi i AKM-së parashikon nevojën e zbatimit të kësaj procedure. Shtojca II: Pika 3. Industria e energjisë ë) Instalime për prodhimin e energjisë hidroelektrike.
Nga auditimi u konstatua:
Në VNM Paraprake për aplikim AN031220240014 Për të zhvilluar projektin: "Ndërtim i hidrocentraleve "Lunik 1" dhe "Lunik 2" , mbështetur në mendimin e institucioneve të konsultuara dhe mendimin e anëtarëve të Komisionit 1 datë 07.01.2025, mungon marrja e mendimit nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe *Bashkia Librazhd*, në kundërshtim Kreun II, pika 4.2 germa c) VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për Miratimin e Rregullave, të Përgjegjësive e të Afateve për Zhvillimin e Procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe Procedurës së Transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore", i ndryshuar, sipas të cilës kur AKM-ja vlerëson se dokumentacioni i aplikimit apo dokumentacioni i plotësuar është i plotë, në varësi të projektit ia përcjell atë *institucioneve të tjera që, në varësi të llojit të projektit, janë përgjegjëse për lejimin/autorizimin/licencimin e tij apo përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin, shëndetin publik dhe emergjencat natyrore dhe civile;*
A. R Vendim për VNM Paraprake
AKM-ja pas përfundimit të procedurës paraprake të VNM-së, mbështetur në mendimin e anëtarëve të Komisionit 84, datë 08.07.2024 vendosi që ky projekt nuk duhet t'i nënshtrohet procedurës së VNM-së thelluar për zhvilluesin "A.R" Shpk me NIPT-i: L.....L, për të zhvilluar projektin: "Sistemim i pasurisë shtetërore, depo e koncentratit të hekurit dhe vaskat e betonit", me vendndodhje Kombinati Metalurgjik, Ish Uzina 12, Depo e Koncentratit, Z.K 3965, Bashkia Elbasan, me të dhëna teknike: *Sipërfaqja e përgjithshme= 57,390 m²; Sipërfaqja totale objektit*

Nr.226= 2,655 m²; Sipërfaqja totale e objektit Nr.1-3G=400 m²; Sipërfaqja e truallit të lirë=54 335 m² .

Aplikimi është bërë referuar Ligjit nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", i ndryshuar, Shtojca II: Pika 10. Prodhime infrastrukturore, a) Projekte për zhvillimin e pasurive të patundshme industriale;

Nga auditimi u konstatua:

Në VNM Paraprake për aplikim AN031220240014 Për të zhvilluar projektin: "Ndërtim i hidrocentraleve "Lunik 1" dhe "Lunik 2" , mbështetur në mendimin e institucioneve të konsultuara dhe mendimin e anëtarëve të Komisionit 1 datë 07.01.2025, mungon marrja e mendimit nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si autoriteti që miraton kontratat koncesionare dhe licencat për shfrytëzim, nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore si autoritet që mbikëqyr aktivitetet minerare dhe *Bashkia Elbasan si autoritet që* miraton për përdorimin e tokës dhe koordinon me komunitetin lokal, veprime në kundërshtim Kreun II, pika 4.2 germa c) VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për Miratimin e Rregullave, të Përgjegjësive e të Afateve për Zhvillimin e Procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe Procedurës së Transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore", i ndryshuar, sipas të cilës kur AKM-ja vlerëson se dokumentacioni i aplikimit apo dokumentacioni i plotësuar është i plotë, në varësi të projektit ia përcjell atë *institucioneve të tjera që, në varësi të llojit të projektit, janë përgjegjëse për lejimin/autorizimin/licencimin e tij apo përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin, shëndetin publik dhe emergjencat natyrore dhe civile;*

A SH.P.K Vendim për VNM Paraprake

AKM pas përfundimit të procedurës paraprake të VNM-së, mbështetur në mendimin e anëtarëve të Komisionit 163, datë 10.12.2024, vendosi që projekti nuk duhet t'i nënshtrohet procedurës së VNM-së thelluar për zhvilluesin personi juridik: "A SH.P.K" me NIPT-i: K.....J , për të zhvilluar projektin "Ndërtim kompleks rritje shpendësh – faza III", me Vendndodhje: Fshati Boboshticë, Njësia administrative Drenovë, Korçë me të dhëna teknike: Sipërfaqja e tokës 17389m2; Sipërfaqja e tokës së zënë nga struktura 4261.4 m2; Sipërfaqja totale e ndërtimit mbi tokë 4261.4 m2; Koeficienti i shfrytëzimit të truallit 24.51%; Intensiteti i ndërtimit 0.94 m3/m2; lartësia maximale 4.7 m; lartësia në kate 1 kat; sipërfaqja e gjelbër 13,127.6 m2.

Aplikimi është bërë referuar Ligjit Nr. 10 440, datë 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", Shtojca II: Pika 10. Prodhime infrastrukturore, a) Projekte për zhvillimin e pasurive të patundshme industriale.

Nga auditimi rezultoi se:

AKM për aplikim me numër AN190720230002 nga të dhënat në databazën e AKM-së për "Monitorimin e VNM Paraprake 2023-2024-2025", nuk rezultoi asnjë raportim i këtij subjekti, veprim në kundërshtim me Ligjin Nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", të ndryshuar, Neni 25/1 "Monitorimi dhe vlefshmëria".

GJ. G" SH.P.K Vendim për VNM Paraprake

AKM-ja pas përfundimit të procedurës paraprake të VNM-së, mbështetur në mendimin e anëtarëve të Komisionit 163, datë 10.12.2024, vendosi që ky projekt nuk duhet t'i nënshtrohet procedurës së VNM-së thelluar për zhvilluesin Person Juridik: "GJ. G" SH.P.K me NIPT-i: M.....J, për të zhvilluar projektin: "Instalim për rritje shpendësh", me Vendndodhje: Elbasan Belsh Merhoj, Fshati Merhoj, Pasuria Me Nr.284/5, Me Zone Kadastrale Nr.2658. Njësia Administrative Kajan, Belsh, Elbasan. Të dhënat teknike: Kapaciteti: nën 1 000 krerë për pulat për mish, nën 20 000 vende për pulat për vezë. Sipërfaqe totale= 12996 m2, Lartësia: 3.6 m ,Numër katesh: 1 kat mbi toke.

Aplikimi AN311020240020 është bërë referuar ligjit nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Shtojca II: Pika 1. Bujqësia dhe silvikultura. d) Instalime për rritjen intensive të kafshëve (projekte që nuk përfshihen në shtojcën I).
Nga auditimi rezultoi se:
Në VNM Paraprake për Aplikimi AN311020240020 për të zhvilluar projektin: "Instalim për rritje shpendësh", mbështetur në mendimin e institucioneve të konsultuara dhe mendimin e anëtarëve të Komisionit 1 datë 07.01.2025, mungon marrja e mendimit nga *Bashkia Elbasan si autoritet që* miraton për përdorimin e tokës dhe koordinon me komunitetin lokal, veprime në kundërshtim Kreun II, pika 4.2 germa c) VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për Miratimin e Rregullave, të Përgjegjësive e të Afateve për Zhvillimin e Procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe Procedurës së Transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore", i ndryshuar, sipas të cilës kur AKM-ja vlerëson se dokumentacioni i aplikimit apo dokumentacioni i plotësuar është i plotë, në varësi të projektit ia përcjell atë *institucioneve të tjera që, në varësi të llojit të projektit, janë përgjegjëse për lejimin/autorizimin/licencimin e tij apo përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin, shëndetin publik dhe emergjencat natyrore dhe civile;*
"G. F" Vendim për VNM Paraprake
AKM-ja pas përfundimit të procedurës paraprake të VNM-së, mbështetur në mendimin e anëtarëve të Komisionit 29, datë 19.03.2025, vendosi që ky projekt nuk duhet t'i nënshtrohet procedurës së VNM-së thelluar për zhvilluesin me të dhënat: Person Fizik: "G. F" me NIPT-i: L.....L; për të zhvilluar projektin: "Magazinimi i Hekurishteve/Skrapeve të Metalit që nuk Përmbajnë Materiale të Rrezikshme", me Vendndodhje: Berat, Otllak, fshati Lapardha, Zona Kadastrale 2381. Të dhëna teknike: Sipërfaqe e përgjithshme e parcelës= 1844 m2 (Bashkangjitur Aneksi I, me plan vendosjen e objektit si dhe koordinatat.)
Aplikimi AN100220250002 është bërë referuar Ligjit Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Shtojca II: Projekte të tjera, pika 11. d) Depot e skrapit të hekurit, përfshirë ato nga automjetet
Nga auditimi rezultoi se:
Në VNM Paraprake për Aplikimi AN100220250002 për të zhvilluar projektin: "Magazinimi i Hekurishteve/Skrapeve të Metalit që nuk Përmbajnë Materiale të Rrezikshme", Vendimi për VNM-në paraprake për projektin e propozuar është e vlefshme për aq kohë sa është i vlefshëm edhe dokumenti i miratimit të zhvillimit për projektin.
Sa më sipër Vendimi për VNM Paraprake, bazuar në mendimin e Komisionit 29, datë 19.03.2025, juridikisht ka humbur afatin e vlefshmërisë, bazuar në verifikimin në terren bërë në datë 17.02.2025 në vendndodhjen ku zhvillohet aktiviteti, nga grupi i punës së Agjencisë Rajonale e Mjedisit Berat-Elbasan-Korçë, i cili ka konstatuar se godina është e ndërtuar, subjekti ka te instaluar gjithë bazën infrastrukturore material dhe është në funksion te aktivitetit.
Në VNM Paraprake për Aplikimi AN100220250002 për të zhvilluar projektin: "Magazinimi i Hekurishteve/Skrapeve të Metalit që nuk Përmbajnë Materiale të Rrezikshme", mbështetur në mendimin e institucioneve të konsultuara dhe mendimin e anëtarëve të Komisionit 29 datë 19.03.2025, mungon marrja e mendimit nga *Bashkia Berat si autoritet që* miraton për përdorimin e tokës dhe koordinon me komunitetin lokal, veprime në kundërshtim Kreun II, pika 4.2 germa c) VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për Miratimin e Rregullave, të Përgjegjësive e të Afateve për Zhvillimin e Procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe Procedurës së Transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore", i ndryshuar, sipas të cilës kur AKM-ja vlerëson se dokumentacioni i aplikimit apo dokumentacioni i plotësuar është i plotë, në varësi të projektit ia përcjell atë *institucioneve të tjera që, në varësi të llojit të projektit, janë përgjegjëse për*

lejimin/autorizimin/licencimin e tij apo përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin, shëndetin publik dhe emergjencat natyrore dhe civile;

"G" Vendim për VNM Paraprake

AKM-ja pas përfundimit të procedurës paraprake të VNM-së, mbështetur në mendimin e anëtarëve të Komisionit 29, datë 19.03.2025, vendosi që ky projekt nuk duhet t'i nënshtrohet procedurës së VNM-së thelluar për zhvilluesin me të dhënat: Person Juridik: "G" SH.P.K me NIPT L.....N; Për të zhvilluar projektin: "Ndërtimi i parkut fotovoltaik "Grand Solar" ; Vendndodhja: Fshati Fushe Buall, ne zonën Polis-Vasjan te Bashkisë Elbasan ; Të dhëna teknike: Fuqia instaluar: 40MË; Sipërfaqe totale:24.3Ha

Nga auditimi konstatohet se në listëverifikim nuk është plotësuar asnjë nga rubrikat, pavarësisht se mund t'i ishte referuar kushtit nr. 8, i cili përmban pyetjet përkatëse. Mosplotësimi i listës së verifikimit është në kundërshtim me pikën 26, Kreu V *"Lista e Verifikimit",* të Urdhrit nr. 25, datë 10.08.2018, "Për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ", ku përcaktohet se: *Lista e verifikimit plotësohet nga trupa inspektuese gjatë ushtrimit të veprimtarisë inspektuese, pranë subjektit të inspektimit dhe nënshkruhet nga trupa inspektuese dhe subjekti*, gjithashtu procesverbali i inspektimit rezulton i paplotë, kundërshtim me pikën 3 të nenit 45 të ligjit nr. 10433/2011, *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*", i cili përcakton se procesverbali duhet të përmbajë informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit.
Sipas trupës inspektuese, referuar raportimit të BPAL të depozituar pranë AKM me nr. 10299, datë 16.10.2024, subjekti kryen transferim të mbetjeve brenda kantierit me një licencë, e cila nuk i ka të përcaktuara qartë kodet e mbetjeve që transporton, për shkak të formatit të licencës që disponon, dhe kjo është klasifikuar si shkelje me rëndësi të vogël, për ketë në seksionin e kundërvajtjeve administrative, është dhënë masë administrative *"Paralajmërim"*, dhe për korrigjimin e shkeljeve është lënë detyrë që subjekti të aplikojë për ndryshimin e licencës III.2.B, duke përcaktuar kodet përkatëse të mbetjeve që transporton.
Nga auditimi konstatohet se trupa inspektuese nuk ka përcaktuar asnjë afat për përmirësimin dhe korrigjimin e shkeljeve të konstatuara, duke pamundësuar verifikimin në mënyrë objektive të zbatimit të masës së vendosur. Gjithashtu, nga verifikimi në sistem[11] rezulton se Leja Mjedisore është azhornuar më datë 26.05.2025, pa u dokumentuar më parë përmbushja e detyrimeve dhe korrigjimi i shkeljeve të konstatuara.
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi inspektorët D. S, G. H.

7. Subjekti M C. AL me NIPT L.....J, Inspektimi nr. AKM-DQ-2023-000365 me objekt inspektimi: "*Zbatimi i kushteve të lejes mjedisore"*, Inspektorët: A. L, J. T.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit rezulton se nga trupa inspektuese janë evidentuar mangësi në mosrespektimin e kushteve të lejes mjedisore, konkretisht në mosparaqitjen e planit të rehabilitimit dhe raportimit mbi ecurinë e punimeve rehabilituese, mungesën e regjistrit të mbetjeve dhe dokumentacionit përkatës, si dhe mosmbajtjen e dokumentacionit mjedisor në vendndodhjen e ushtrimit të aktivitetit, në kundërshtim me Ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 dhe Ligjinn nr. 10433, datë 16.06.2011. Për këto shkelje, në procesverbal është vendosur masa administrative *"gjobë"* në vlerën 300,000 lekë dhe *"paralajmërim"*. Ndërsa në vendimin përfundimtar të inspektimit është hequr masa *"gjobë"* dhe është lënë vetëm dënimi administrativ *"paralajmërim"*, duke i vendosur subjektit detyrimin për përmirësimin e përmbushjes së kushteve të lejes, përfshirë raportimin periodik, mbajtjen e dokumentacionit dhe respektimin e afateve të përcaktuara.
Nga verifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikës së inspektimit rezulton se pagesa e tarifës vjetore është kryer më datë 06.10.2023, në tejkalim të afatit të përcaktuar në Lejen Mjedisore të tipit B nr. PN-1637-01-2016, në referim të VKM nr. 417, datë 25.06.2014, *"Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit"*, sipas së cilës tarifa duhet të paguhet brenda tremujorit të parë të vitit; gjithashtu, data e pagesës përkon me datën e procesverbalit dhe listës së verifikimit, duke treguar se detyrimi është përmbushur vetëm pas inspektimit.

[11] Licencat/lejet e lëshuara nga QKB – QKB

Nga aktet e administruara konstatohet se nuk është përcaktuar në mënyrë të qartë në asnjë nga dokumentet e trupës inspektuese se për cilën leje mjedisore të subjektit është kryer inspektimi, ndërkohë që nga verifikimi në Regjistrin e Lejeve Mjedisore rezulton se subjekti disponon tre (3) leje mjedisore, si më poshtë:



Nga verifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur rezulton se Plani i Menaxhimit të Mbetjeve i referohet Lejes Mjedisore nr. PN-1637-01-2016, datë 22.01.2016 (Tipi B), por nga listëverifikimi evidentohet se ky plan nuk është paraqitur gjatë inspektimit; gjithashtu, dokumenti i depozituar nuk mban datë dhe as shkresë përcjellëse pranë AKM-së, duke mos përbërë provë për përmbushjen e kushtit nr. 8 dhe për rrjedhojë përbën moszbatim të kushteve të lejes. Subjekti ka plotësuar dokumentacionin dhe e ka dërguar në AKM me shkresën nr. 5056, datë 15.10.2023, pra pas hartimit të procesverbalit të inspektimit (06.10.2023), duke paraqitur:
- Regjistrin e shkarkimit dhe transferimit të ndotësve,
- Planin e rehabilitimit të objektit minerar,
- Regjistrin e mbetjeve, të dorëzuara pranë AKM-së.

Me shkresën nr. 5056, datë 15.10.2023, subjekti ka paraqitur kontestime dhe dokumentacion shtesë lidhur me inspektimin e kryer nga trupa inspektuese. Nga auditimi i praktikës së administruar rezulton se dokumentacioni i depozituar nga subjekti është përgatitur dhe paraqitur pas konstatimit të shkeljeve, dhe për rrjedhojë nuk mund të konsiderohet si element që përjashton apo zbut përgjegjësinë administrative për shkeljet e konstatuara gjatë inspektimit. Pika pika 1/b (ii), e nenit 29 e ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011, të ndryshuar, parashikon shprehimisht se mos përmbushja dhe mosrespektimi i kushteve të lejes mjedisore të tipit A, B apo C përbën kundërvajtje administrative. Për lejet mjedisore të Tipit B, kjo shkelje ndëshkohet me gjobë në masën nga 300,000 (treqind mijë) deri në 500,000 (pesëqind mijë) lekë.

Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi inspektorët: A. L, J. T.

8. Subjekti B me NIPT K.....F**,** Inspektimi nr. AKM-DQ-2024-000529,
me objekt inspektimi*: "Zbatim i kushteve të lejes mjedisore*", Inspektorët: Xh. H, E. H.

Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit rezulton se nga trupa inspektuese janë evidentuar mangësi në mosvënien në dispozicion të dokumentacionit mjedisor, mosrespektimin e kushteve të lejes dhe depozitimin e mbetjeve jashtë zonës së lejuar, në kundërshtim me Ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011, Ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 dhe Ligji nnr. 10463, datë 22.09.2011. Për këto shkelje, në procesverbal janë vendosur masa administrative *"gjobë*" në vlerat 390,000 lekë dhe 650,000 lekë, si dhe "*paralajmërim*", ndërsa në vendimin përfundimtar janë hequr gjobat dhe është lënë vetëm masa administrative "*paralajmërim".*

Nga verifikimi i dokumentacionit, bashkëlidhur praktikës së isnpektimit kostatohet se me shkresën nr. 12497 prot., datë 27.11.2024, subjekti ka paraqitur kontestime lidhur me inspektimin e kryer nga trupa inspektuese, duke pretenduar se nuk ka marrë njoftim paraprak për zhvillimin e inspektimit. Nga auditimi i praktikës së administruar rezulton se ky pretendim nuk qëndron, pasi Autorizimi i Inspektimit nr. AKM-DQ-2024-000529-1, datë 05.11.2024, vërteton datën e njoftimit të subjektit për inspektimin. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se i është nënshtruar së fundmi një inspektimi nga IKT, Dega Rajonale Burrel, duke kërkuar që trupa inspektuese të jetë racionale në

vendimmarrje. Grupi i auditimit vlerëson se dokumentacioni i depozituar nga subjekti pas konstatimit të shkeljeve nga ana e trupës inspektuese nuk mund të konsiderohet si element që përjashton apo zbut përgjegjësinë administrative për shkeljet e konstatuara gjatë inspektimit. Detyrimet për paraqitjen e dokumentacionit mjedisor dhe për zbatimin e kërkesave ligjore janë detyrime të vazhdueshme dhe duhet të përmbushen në momentin e ushtrimit të kontrollit administrativ. Në këtë kuadër, dispozitat e nenit 29 të Ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011, *"Për Lejet e Mjedisit",* i ndryshuar, nenit 48 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, *"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* si dhe nenit 61 të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, *"Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve",* i ndryshuar, janë të qarta, të drejtpërdrejta dhe nuk parashikojnë hapësirë diskrecioni për organin inspektues në lidhje me zëvendësimin e masës administrative të gjobës me një masë tjetër. Për rrjedhojë, vendosja e masës administrative *"paralajmërim"* nga trupa inspektuese nuk është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, pasi shkeljet e konstatuara janë të parashikuara shprehimisht nga ligji si kundërvajtje administrative dhe duhet të ndëshkohen me masën administrative të gjobës, në intervalin 500,000-1,000,000 lekë sipas pikës 60 dhe 61 të nenit 62 të ligjit nr. 10463 datë 22.09.2011, *"Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve", i ndryshuar.*
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: Xh. H, E. H.

9. Subjekti V. R. me NIPT L.....Q, Inspektimi nr. AKM-DQ-2023-000521, me objekt inspektimi: "*Menaxhimi i mbetjeve të rrezikshme*", Inspektorët: I.B dhe K. A.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit rezulton se nga trupa inspektuese është evidentuar mospërputhje ndërmjet kushteve të lejes mjedisore dhe gjendjes faktike në terren, pasi subjekti disponon leje për dy inceneratorë, ndërsa në vendndodhje rezulton i instaluar vetëm një, në kundërshtim me Ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 dhe Ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011.
Për këtë mangësi është vendosur masa administrative *"paralajmërim*", duke i lënë subjektit detyrë marrjen e masave për përshtatjen e lejes mjedisore me instalimet reale në vendndodhjen e ushtrimit të aktivitetit, masë e cila është reflektuar njësoj edhe në vendimin përfundimtar të inspektimit
Grupi i auditimit, pas verifikimit në Regjistrin e Lejeve Mjedisore, konstatoi se subjekti disponon Leje Mjedisore të tipit A me nr. PN-8024-01-2019, datë 31.01.2019. Në kushtin 1 "*Objekti*", në tabelën nr. 1.1.2 *"Lista e veprimtarive të lidhura me to",* në përshkrimin e procesit teknologjik, përcaktohet se: "*Impiantet janë të tipit ŴFS-50 dhe janë të instaluara 2 (dy) të tilla brenda objektit (kapanon). Instalimi i tipit ŴFS-50 ka sipërfaqe 2.7 m² (1.8 m x 1.5 m) …".* Pra, sipas kushteve të lejes mjedisore, objekti i aktivitetit përfshin dy (2) impiante dhe jo një (1) impiant.
Nga verifikimi i kontestimeve të subjektit, të protokolluara në AKM me nr. 102/2, datë 07.12.2023, janë paraqitur kontestimet si më poshtë:
- Subjekti deklaron se disponon të gjitha pajisjet dhe makineritë e deklaruara në lejen mjedisore të tipit A me nr. PN-8024-01-2019, duke respektuar kushtet e lejes mjedisore.
- Në momentin e inspektimit, të kryer më datë 24.11.2023, në ambientet e ushtrimit të aktivitetit të kompanisë, është konstatuar e instaluar dhe në gjendje pune vetëm një (1) pajisje incinerimi, për shkak se njëra prej pajisjeve të incinerimit, si rezultat i defekteve mekanike, ka qenë e <u>ç'instaluar dhe e dërguar për riparim.</u>
4. Si rezultat i dëmtimeve të parikuperueshme të pajisjes së incinerimit, kjo e fundit është nxjerrë jashtë funksionit.
Nga sa më sipër, rezulton se subjekti, në kontestimet e tij, ka pranuar se në momentin e inspektimit kishte të instaluar vetëm një (1) pajisje incinerimi dhe se pajisja tjetër ka qenë jashtë funksionit për shkak defekti. Ky veprim është në kundërshtim me pikat 2 dhe 3 të nenit 16 të ligjit nr. 10448/2011 "*Për lejet e mjedisit*", i ndryshuar, ku përcaktohet se: *"Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në rast avarie, kur kthimi në funksionimin normal të impiantit nuk është i mundur brenda 24 orëve,*

i kërkon operatorit pakësimin ose ndalimin e operacioneve… Në asnjë rast, koha e përgjithshme e funksionimit në kushte avarie nuk mund të jetë më shumë se 120 orë në 12 muaj. Operatori njofton Agjencinë Kombëtare të Mjedisit brenda 48 orëve nga ndodhja e avarisë."
Në këtë rast, subjekti nuk ka njoftuar AKM-në për avarinë, duke shkelur detyrimin ligjor për informim brenda afatit të përcaktuar.
Për këtë veprim, referuar nenit 29, pika "c", të ligjit nr. 10448/2011, i ndryshuar, përcaktohet se:
"*Mos informimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit nga operatori, në përputhje me përcaktimin e pikës 3 të nenit 16 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1,000,000 deri në 2,000,000 lekë, duke u shtuar me vlerën 10 për qind të masës së gjobës çdo ditë, deri në korrigjimin e mospërputhjes*." Për rrjedhojë, ndaj subjektit duhej të ishte aplikuar masë administrative "*Gjobë*" dhe jo masa administrative "*Paralajmërim",* pasi shkelja e konstatuar përmbush kriteret ligjore për ndëshkim financiar, sipas legjislacionit në fuqi.
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi inspektorët: I.B dhe K.A.

10. Subjekti K, me NIPT L.....I, Inspektimi nr. AKM-DQ-2024-000526, me objekt inspektimi: "*Kushtet e lejes mjedisore*", Inspektorët: Xh. H, E. H.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit rezulton se nga trupa inspektuese janë evidentuar mangësi në depozitimin e materialeve jashtë koordinatave të lejes mjedisore, mungesën e masave mbrojtëse në depozitën e lëndës djegëse dhe mosmbajtjen e regjistrit të mbetjeve, në kundërshtim me Ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 dhe Ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011, i ndryshuar. Për këto shkelje, në procesverbal janë parashikuar masat administrative "*paralajmërim*" dhe "*gjobë*" në vlerën 300,000 lekë, ndërsa në vendimin përfundimtar është hequr masa "*gjobë"* dhe është vendosur vetëm masa administrative "*paralajmërim*".
Nga auditimi konstatohet se me shkresën nr. 12418 prot., datë 26.11.2024, subjekti ka paraqitur kontestime dhe dokumentacion shtesë lidhur me inspektimin e kryer nga trupa inspektuese, ku paraqiten si më poshtë:
- Në lidhje me argjinaturën e depozitës, subjekti deklaron se depozita nuk ka sasi të lëndës djegëse, por pasi janë bërë të ditura kërkesat për argjinaturë, po vendos në dispozicion një projekt për ndërtimin e saj.
- Në lidhje me mineralin që është jashtë koordinatave të lejes mjedisore, subjekti bën të ditur se ka spostuar mineralin brenda koordinatave të lejes mjedisore. Ai thekson se nuk ishte i dijshëm që minerali kishte dalë jashtë koordinatave dhe duke pasur një sipërfaqe relativisht të madhe, ka hapësirë të mjaftueshme për ta mbajtur brenda saj.
- Në lidhje me regjistrin e mbetjeve, subjekti shprehet se në momentin e inspektimit nuk e kishte të pranishëm, pasi e kishte përgatitur zyra e mjedisit. Pas marrjes nga studio, subjekti ka bashkangjitur një kopje të tij në shkresën e kontestimit.
Nga analiza e situatës rezulton se argjinatura nuk ishte e ndërtuar në momentin e inspektimit, dhe subjekti synon ta realizojë atë vetëm përmes projektit të dorëzuar pas inspektimit. Ky veprim është në kundërshtim me kushtin 3.4.1 të lejes mjedisore nr. PN-8689-05-2019, datë 28.05.2019, ku përcaktohet se: *"Sipërfaqet ku janë të vendosur depozitat dhe/ose fuçitë duhet të jenë të papërshkueshme dhe rezistente ndaj materialit të ruajtur brenda tyre"*, pra është shkelur një nga kushtet e lejes mjedisore të tipit B.
Në lidhje me sasinë e materialit dhe mjeteve të punës në një sipërfaqe që nuk përfshihet në koordinatat e lejes mjedisore, subjekti nuk ka mohuar këtë fakt, por ka pretenduar se nuk ishte i dijshëm për këtë. Kjo nuk e përjashton shkeljen e një prej kushteve të lejes mjedisore, konkretisht kushtit 1.6 të lejes, ku përcaktohen koordinatat e vendndodhjes dhe ku sipas këtij kushti dhe kushtit

1.1, aktiviteti nuk duhet të dalë jashtë koordinatave të përcaktuara në lejen mjedisore. Pra, edhe në këtë rast, subjekti është në shkelje të një kushti të lejes mjedisore.
Në lidhje me mosdisponimin e regjistrit të mbetjeve, grupi i auditimit verifikoi regjistrin e ngarkuar në sistemin e-inspektime, ku rezulton se ai nuk ka bashkëngjitur asnjë shkresë që të vërtetojë depozitimin e mbetjeve pranë AKM-së, siç përcaktohet dhe në lejen mjedisore.
Sipas kushtit 12.2 të lejes mjedisore: *"Subjekti duhet të mbajë regjistrin për sasinë e mbetjeve të gjeneruara, rikuperuara dhe magazinuara, si dhe të raportojë të dhënat çdo 6 muaj pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit"*, duke u renditur kështu në shkelje të kushteve të lejes.
Grupi i auditimit vlerëson se dokumentacioni i dorëzuar pas inspektimit nuk përjashton përgjegjësinë administrative për shkeljet e konstatuara gjatë kontrollit. Detyrimet për paraqitjen e dokumentacionit mjedisor dhe për zbatimin e kërkesave ligjore janë detyrime të vazhdueshme dhe duhet të përmbushen në momentin e ushtrimit të kontrollit administrativ.
Në këtë kuadër, dispozitat e nenit 29, pika 1, shkronja "b"/ "ii", të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011, "*Për Lejet e Mjedisit*", i ndryshuar, të nenit 48 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, "*Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, janë të qarta dhe të drejtpërdrejta, duke përcaktuar se: *"Subjekti është i detyruar të respektojë kushtet e lejes mjedisore, të disponojë dokumentacionin përkatës dhe ta vendosë në dispozicion të organit inspektues në momentin e kontrollit. Mosrespektimi i tyre përbën kundërvajtje administrative dhe ndëshkohet sipas ligjit."*
Këto dispozita nuk parashikojnë hapësirë diskrecioni për organin inspektues në lidhje me zëvendësimin e masës administrative të gjobës me një masë tjetër. Për rrjedhojë, vendosja e masës administrative *"paralajmërim"* nga trupa inspektuese nuk është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, pasi shkeljet e konstatuara janë të parashikuara shprehimisht nga ligji si kundërvajtje administrative dhe duhet të ndëshkohen me masën administrative të gjobës, sipas intervalit të përcaktuar nga legjislacioni përkatës.
Gjithashtu, nga verifikimi i të dhënave në sistem rezulton se tarifa e lejes mjedisore është paguar më datë 02.11.2023, dhe nuk verifikon pagesën për vitin 2024, e cila sipas lejes mjedisore duhet të paguhet brenda tremujorit të parë të vitit.
Në këto kushte, janë konstatuar shkelje të qarta të kushteve të lejes mjedisore dhe të detyrimeve ligjore nga subjekti, konkretisht:
Mos ndërtimi i argjinaturës së depozitës në momentin e inspektimit (shkelje e kushtit 3.4.1 të lejes mjedisore). Depozitimi i materialit jashtë koordinatave të lejes mjedisore (shkelje e kushtit 1.6 dhe 1.1 të lejes mjedisore). Mosdisponimi dhe mos dokumentimi i regjistrit të mbetjeve sipas kushteve të kushtit 12.2 të lejes mjedisore.
Mos pagesa e tarifës për vitin 2024 brenda afatit të përcaktuar në lejen mjedisore.
Në këtë kuadër, në zbatim të shkronjës "b/ii", pika 1, nenit 29, të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes mjedisore nga operatori i një instalimi përbën kundërvajtje administrative, dhe për lejet e tipit B ndëshkohet me gjobë në vlerën nga 300,000 deri në 500,000 lekë.
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: Xh. H; E. H.

11. Subjekti H me NIPT K.....B, Inspektimi nr. AKM-DQ-2023-000364, me objekt inspektimi: "*Zbatim i kushteve te lejes mjedisore*", inspektorët: A. L, J. T.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit rezulton se nga trupa inspektuese janë evidentuar mangësi në mosdorëzimin e dokumentacionit mjedisor (raport vjetor, raport vetëmonitorimi, plan përputhshmërie, plan menaxhimi mbetjesh dhe regjistra përkatës), moskryerjen e pagesës së tarifës vjetore, si dhe mospërditësim i koordinatave të lejes mjedisore,

në kundërshtim me ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011, *"Për lejet e mjedisit"*, i ndryshuar, dhe ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011, *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*.
Për këto shkelje, në procesverbal janë parashikuar masat administrative *"gjobë"* në vlerën 300,000 lekë dhe *"paralajmërim"*, ndërsa në vendimin përfundimtar është hequr masa *"gjobë"* dhe është vendosur vetëm masa administrative *"paralajmërim"*, duke i lënë subjektit detyrë përmirësimin e përmbushjes së kushteve të lejes, përfshirë raportimin periodik, mbajtjen e dokumentacionit në vendndodhje dhe përshtatjen e koordinatave të lejes mjedisore me ato të lejes miner
Nga auditimi konstatohet se me shkresën nr. 8465 prot., datë 26.10.2023, subjekti ka paraqitur kontestime dhe dokumentacion shtesë lidhur me inspektimin e kryer nga trupa inspektuese, të cilat janë paraqitur në AKM me shkresën nr. 8847, datë 24.10.2023. Dokumentacioni i dorëzuar përfshin:
- raportin vjetor të mjedisit për periudhën tetor 2022-tetor 2023;
- raportet e vetmonitorimit për periudhën prill 2023-tetor 2023;
- pagesën e tarifës vjetore të datës 24.10.2023;
- planin e përputhshmërisë;
- planin e menaxhimit të mbetjeve;
- planin e rehabilitimit dhe çmontimit;
- shkresën informuese mbi rregjistrin si dhe
- kërkesën për ndryshimin e aktit të miratimit.

Nga auditimi i praktikës së administruar rezulton se dokumentacioni i depozituar nga subjekti është përgatitur dhe dorëzuar pas konstatimit të shkeljeve nga ana e trupës inspektuese dhe për rrjedhojë nuk mund të konsiderohet si element që përjashton apo zbut përgjegjësinë administrative për shkeljet e konstatuara gjatë inspektimit.
Referuar nenit 29, pika 1, shkronja "b/ii", të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011, i ndryshuar, mospërmbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipit A, B apo C nga operatori i një instalimi përbën kundërvajtje administrative. Konkretisht, për lejet e mjedisit të tipit B, kjo kundërvajtje ndëshkohet me gjobë në vlerën nga 300,000 deri në 500,000 lekë. Kjo dispozitë ligjore është e qartë, e drejtpërdrejtë dhe nuk parashikon asnjë hapësirë diskrecioni për organin inspektues në lidhje me zëvendësimin e gjobës me një masë tjetër administrative. Për rrjedhojë, vendosja e masës administrative "paralajmërim" nga trupa inspektuese nuk është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, pasi shkeljet e konstatuara janë të parashikuara shprehimisht nga ligji si kundërvajtje administrative dhe duhet të ndëshkohen me masën administrative të gjobës, sipas intervalit të përcaktuar në ligj.
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: A. L, J. T.

12. Subjekti C. C, me NIPT L.....D, Inspektimi nr. AKM-DQ-2024-000519-1, me objekt inspektimi: "Kushtet e lejes mjedisore", inspektorët Xh. H; E. H.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit rezulton se nga trupa inspektuese janë evidentuar mangësi në operimin e instalimit dhe menaxhimin e mbetjeve, konkretisht përdorimi i pajisjeve mekanike pa reflektim në kushtet e lejes dhe depozitimi i mbetjeve sterile në mënyrë të papërshtatshme, duke shkaktuar ndikim në burimet ujore, në kundërshtim me ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011, *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"* dhe ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, *"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"*, i ndryshuar. Për këto shkelje, në procesverbal janë parashikuar masat administrative *"paralajmërim"* dhe *"gjobë"* në vlerën 650,000 lekë, ndërsa në vendimin përfundimtar është hequr masa *"gjobë"* dhe është vendosur vetëm masa administrative *"paralajmërim"*.

Nga auditimi kosntatohet se me shkresën nr. 71 prot., datë 22.11.2024, subjekti i inspektuar ka paraqitur kontestime dhe dokumentacion shtesë lidhur me inspektimin e kryer nga trupa inspektuese. Në përmbajtje të tyre, subjekti ka sqaruar se transportieri shërben vetëm për transportin e mineralit dhe se procesi i seleksionimit kryhet manualisht nga fuqia punëtore, si dhe ka informuar se për mbetjet sterile që kanë precipituar jashtë zonës minerare është hartuar dhe përcjellë një plan rehabilitimi, i cili parashikon depozitimin e sterilit brenda koordinatave të përcaktuara dhe masat për rehabilitimin e dëmit të shkaktuar.
Grupi i auditimit vlerëson se dokumentacioni dhe sqarimet e paraqitura nga subjekti pas kryerjes së inspektimit nuk përjashtojnë dhe as zbehin përgjegjësinë administrative për shkeljet e konstatuara gjatë kontrollit në terren. Faktet e konstatuara gjatë inspektimit provojnë se mbetjet sterile kanë precipituar jashtë zonës së lejuar minerare, duke përbërë një situatë të ndaluar shprehimisht nga legjislacioni në fuqi për menaxhimin e mbetjeve.
Në ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 "*Për menaxhimin e integruar të mbetjeve",* Kreu XIV "*Ndalimet, sanksionet dhe ndëshkimet*", neni 61 parashikon se: "*Ndalohen: a) hedhja apo groposja e të gjitha llojeve të mbetjeve në vende publike; b) hedhja apo groposja e të gjitha llojeve të mbetjeve në parcelat bujqësore të mbjella ose jo, në anë të kanaleve kulluese e ujitëse, si dhe në çdo vend tjetër ku dëmtohen toka, bima dhe kafsha; c) hedhja apo groposja e të gjitha llojeve të mbetjeve në toka bujqësore";*
Po ashtu, neni 62 i këtij ligji në pikën 61 përcakton se: *Çdo person, që braktis, shkarkon apo asgjëson mbetje në mënyrë të pakontrolluar në kundërshtim me nenin 61 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 500,000 (pesëqind mijë) deri në 1,000,000 (një milionë) lekë.*
Grupi i auditimit vlerëson se këto dispozita ligjore janë të qarta, të drejtpërdrejta dhe detyruese, duke mos parashikuar hapësirë diskrecioni për organin inspektues në lidhje me zëvendësimin e masës administrative të gjobës me një masë tjetër më të lehtë. Për rrjedhojë, vendosja e masës administrative *"paralajmërim"* nga trupa inspektuese nuk është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, pasi shkeljet e konstatuara janë të tipizuara shprehimisht nga ligji si kundërvajtje administrative dhe duhet të ndëshkohen me masën administrative të gjobës, brenda intervalit të përcaktuar nga legjislacioni përkatës.
Në përfundim, grupi i auditimit vlerëson se argumentet dhe dokumentacioni i paraqitur nga subjekti pas inspektimit nuk përbëjnë elemente që përjashtojnë apo justifikojnë shmangien nga përgjegjësia administrative, si dhe nuk ndikojnë në ndryshimin e klasifikimit të shkeljes apo të masës administrative që duhet të ishte vendosur në zbatim të ligjit.
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: Xh. H; E.H.

13. Subjekti K me NIPT K.....D, Inspektimi nr. AKM-DQ-2024-000359, me objekt inspektimit: "*Zbatim i kushteve të lejes mjedisore*", Inspektorët: Xh. H, E. H.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit rezulton se nga trupa inspektuese janë evidentuar mangësi në menaxhimin e mbetjeve, konkretisht depozitimi i mbetjeve sterile jashtë zonës së përcaktuar në lejen mjedisore dhe mosmbajtja e regjistrit të sasive të mbetjeve, në kundërshtim me ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011, "*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"* dhe ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, "*Për menaxhimin e integruar të mbetjeve*", i ndryshuar.
Për këto shkelje, në procesverbal janë parashikuar masat administrative "*gjobë"* në vlerën 650,000 lekë dhe "*paralajmërim",* ndërsa në vendimin përfundimtar është hequr masa *"gjobë"* dhe është vendosur vetëm masa administrative "*paralajmërim".*
Nga auditimi konstatohet se me shkresën nr. 9185/1 prot., datë 08.10.2024, subjekti ka paraqitur kontestime dhe dokumentacion shtesë lidhur me inspektimin e kryer nga trupa inspektuese, shkresë

e depozituar pas përfundimit të afateve ligjore dhe pas daljes së Vendimit Përfundimtar të Inspektimit nr. AKM-DQ-2024-000359-5, datë 07.10.2024.
Nga auditimi konstatohet se referenca ligjore e përdorur nga trupa inspektuese nuk përkon me shkeljen ligjore të konstatuar, pasi mungesa e regjistrit të sasive të mbetjeve të gjeneruara dhe mosdorëzimi i tij pranë institucioneve përkatëse rregullohet nga dispozitat e ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, *"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".*
Në Kreun IV "Menaxhimi i integruar i mbetjeve", neni 21 "Përgjegjësia për menaxhimin e integruar të mbetjeve" përcakton shprehimisht se:
"1. Krijuesi ose zotëruesi fillestar i mbetjeve e kryen trajtimin e tyre vetë ose përmes një tregtari apo personi tjetër që kryen operacione trajtimi të mbetjeve, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, 'Për lejet e mjedisit'."
10. Si transferuesi edhe pritësi i mbetjeve i dërgojnë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, një herë në vit, informacion për mbetjet jo të rrezikshme.
Në zbatim të këtyre dispozitave, neni 62 i ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011, parashikon:
"10. Çdo person që nuk dërgon informacion pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në përputhje me nenin 21 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 300,000 deri në 500,000 lekë."
Për sa më sipër, trupa inspektuese ka konstatuar se regjistri i sasive të mbetjeve nuk është plotësuar periodikisht çdo 6 muaj dhe nuk është dorëzuar pranë institucioneve përkatëse, në kundërshtim me detyrimet e parashikuara nga kushtet e lejes mjedisore. Megjithatë, kjo shkelje, ndonëse përbën shkelje të kushteve të lejes dhe të legjislacionit për menaxhimin e mbetjeve, është klasifikuar nga trupa inspektuese si shkelje e lehtë.
Po ashtu, Kreu XIV "Ndalimet, sanksionet dhe ndëshkimet", neni 61 i ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, përcakton se: *"Ndalohen: a) hedhja apo groposja e të gjitha llojeve të mbetjeve në vende publike; b) hedhja apo groposja e mbetjeve në parcelat bujqësore, në anë të kanaleve kulluese dhe ujitëse, si dhe në çdo vend tjetër ku dëmtohen toka, bimët dhe kafshët; c) hedhja apo groposja e të gjitha llojeve të mbetjeve në toka bujqësore."*
Në vijim, neni 62 i këtij ligji parashikon shprehimisht se: *"Çdo person që braktis, shkarkon apo asgjëson mbetje në mënyrë të pakontrolluar, në kundërshtim me nenin 61 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 500,000 deri në 1,000,000 lekë."*
Për rrjedhojë, vendosja e masës administrative "*paralajmërim*", si dhe heqja e masës së gjobës nga vendimi përfundimtar i inspektimit, nuk janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe bien ndesh me parimin e ligjshmërisë në veprimtarinë administrative. Në këto kushte, rezulton se vendimmarrja administrative e marrë nga trupa inspektuese nuk është e mbështetur në dispozitat përkatëse të ligjit material dhe nuk garanton zbatimin e njëjtë dhe të barabartë të ligjit.
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: Xh. H; E. H.

14. Subjekti B me NIPT J.....S**,** Inspektimi me nr. AKM-DQ-2024-000514, me objekt inspektimi: "*Zbatim i kushteve të lejes mjedisore*", Inspektorët: Xh. H, E. H.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit rezulton se nga trupa inspektuese janë evidentuar mangësi në menaxhimin e mbetjeve, konkretisht depozitimi i mbetjeve sterile jashtë zonës së përcaktuar në lejen mjedisore dhe mosmbajtja/dorëzimi i regjistrit të sasive të mbetjeve, si dhe mospërputhje në përgjegjësin e lejes mjedisore, në kundërshtim me ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011, *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"* dhe ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, *"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"*, i ndryshuar. Për këto shkelje, në procesverbal janë parashikuar masat administrative *"gjobë"* në vlerën 650,000 lekë dhe *"paralajmërim"*, ndërsa në vendimin përfundimtar është hequr masa *"gjobë"* dhe është vendosur vetëm masa administrative *"paralajmërim"*.

Nga auditimi konstatohet se me shkresën nr. 11443 prot., datë 11.11.2024, subjekti ka paraqitur kontestime dhe dokumentacion shtesë lidhur me inspektimin e kryer nga trupa inspektuese. Grupi i auditimit vlerëson se dokumentacioni dhe sqarimet e paraqitura nga subjekti **pas kryerjes së inspektimit** nuk përjashtojnë dhe as zbehin përgjegjësinë administrative për shkeljet e konstatuara gjatë kontrollit në terren. Faktet e konstatuara gjatë inspektimit provojnë se mbetjet sterile kanë precipituar jashtë zonës së lejuar minerare, duke përbërë një situatë të ndaluar shprehimisht nga legjislacioni në fuqi për menaxhimin e mbetjeve.
Nga auditimi konstatohet se referenca ligjore e përdorur nga trupa inspektuese nuk përkon me shkeljen ligjore të konstatuar, pasi mungesa e regjistrit të sasive të mbetjeve të gjeneruara dhe mosdorëzimi i tij pranë institucioneve përkatëse rregullohet nga dispozitat e ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, *"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".*
Në Kreun IV "Menaxhimi i integruar i mbetjeve", neni 21 "Përgjegjësia për menaxhimin e integruar të mbetjeve" përcakton shprehimisht se:
"1. Krijuesi ose zotëruesi fillestar i mbetjeve e kryen trajtimin e tyre vetë ose përmes një tregtari apo personi tjetër që kryen operacione trajtimi të mbetjeve, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, 'Për lejet e mjedisit'."
10. Si transferuesi edhe pritësi i mbetjeve i dërgojnë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, një herë në vit, informacion për mbetjet jo të rrezikshme.
Në zbatim të këtyre dispozitave, neni 62 i ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011, parashikon:
"10. Çdo person që nuk dërgon informacion pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në përputhje me nenin 21 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 300 000 deri në 500 000 lekë."
Për sa më sipër, trupa inspektuese ka konstatuar se regjistri i sasive të mbetjeve nuk është plotësuar periodikisht çdo 6 muaj dhe nuk është dorëzuar pranë institucioneve përkatëse, në kundërshtim me detyrimet e parashikuara nga kushtet e lejes mjedisore. Megjithatë, kjo shkelje, ndonëse përbën shkelje të kushteve të lejes dhe të legjislacionit për menaxhimin e mbetjeve, është klasifikuar nga trupa inspektuese si shkelje e lehtë.
Po ashtu, Kreu XIV "Ndalimet, sanksionet dhe ndëshkimet", neni 61 i ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, përcakton se: *"Ndalohen: a) hedhja apo groposja e të gjitha llojeve të mbetjeve në vende publike; b) hedhja apo groposja e mbetjeve në parcelat bujqësore, në anë të kanaleve kulluese dhe ujitëse, si dhe në çdo vend tjetër ku dëmtohen toka, bimët dhe kafshët; c) hedhja apo groposja e të gjitha llojeve të mbetjeve në toka bujqësore."*
Në vijim, neni 62 i këtij ligji parashikon shprehimisht se: *"Çdo person që braktis, shkarkon apo asgjëson mbetje në mënyrë të pakontrolluar, në kundërshtim me nenin 61 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 500 000 deri në 1 000 000 lekë."*
Për rrjedhojë, vendosja e masës administrative "*paralajmërim",* si dhe heqja e masës së gjobës nga vendimi përfundimtar i inspektimit, nuk janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe bien ndesh me parimin e ligjshmërisë në veprimtarinë administrative. Në këto kushte, rezulton se vendimmarrja administrative e marrë nga trupa inspektuese nuk është e mbështetur në dispozitat përkatëse të ligjit material dhe nuk garanton zbatimin e njëjtë dhe të barabartë të ligjit.
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: Xh. H.; E. H.

15. Subjekti Z me NIPT K.....M**,** Inspektimi nr. AKM-DQ-2024-000316, me objekt inspektimi: *"Zbatim i kushteve të lejes mjedisore*", Inspektorët: Xh. H, E. H.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit rezulton se nga trupa inspektuese janë evidentuar mangësi në mospagimin e tarifës së lejes mjedisore, mungesën e planit të menaxhimit të mbetjeve, depozitimin e mbetjeve sterile jashtë zonës së lejuar dhe në afërsi të burimeve ujore, si dhe mosmbajtjen e regjistrit të mbetjeve, në kundërshtim me ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011,

"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, *"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"*, i ndryshuar. Për këto shkelje, në procesverbal janë parashikuar masat administrative *"gjobë"* në vlerën 500,000 lekë dhe *"paralajmërim"*, ndërsa në vendimin përfundimtar është hequr masa *"gjobë"* dhe është vendosur vetëm masa administrative *"paralajmërim"*.

Nga dokumentacioni në sistemin e inspektimit rezulton se tarifa përkatëse është paguar në datën 19.08.2024, pra pas kryerjes së konstatimeve nga trupa inspektuese.

-Nga auditimi konstatohet se referenca ligjore e përdorur nga trupa inspektuese nuk përkon me shkeljen ligjore të konstatuar, pasi mungesa e planit dhe regjistrit të sasive të mbetjeve të gjeneruara dhe mosdorëzimi i tij pranë institucioneve përkatëse rregullohet nga dispozitat e ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, *"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".*

Në Kreun IV "Menaxhimi i integruar i mbetjeve", neni 21 "Përgjegjësia për menaxhimin e integruar të mbetjeve" përcakton shprehimisht se:

"1. Krijuesi ose zotëruesi fillestar i mbetjeve e kryen trajtimin e tyre vetë ose përmes një tregtari apo personi tjetër që kryen operacione trajtimi të mbetjeve, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, 'Për lejet e mjedisit'."

10. Si transferuesi edhe pritësi i mbetjeve i dërgojnë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, një herë në vit, informacion për mbetjet jo të rrezikshme.

Në zbatim të këtyre dispozitave, neni 62 i ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011, parashikon:

"10. Çdo person që nuk dërgon informacion pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në përputhje me nenin 21 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 300 000 deri në 500 000 lekë."

Për sa më sipër, trupa inspektuese ka konstatuar se plani dhe regjistri i sasive të mbetjeve është plotësuar dhe nuk është dorëzuar pranë institucioneve përkatëse, në kundërshtim me detyrimet e parashikuara nga kushtet e lejes mjedisore. Megjithatë, kjo shkelje, ndonëse përbën shkelje të kushteve të lejes dhe të legjislacionit për menaxhimin e mbetjeve, është klasifikuar nga trupa inspektuese si shkelje e lehtë.

Po ashtu, Kreu XIV "Ndalimet, sanksionet dhe ndëshkimet", neni 61 i ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, përcakton se: *"Ndalohen: a) hedhja apo groposja e të gjitha llojeve të mbetjeve në vende publike; b) hedhja apo groposja e mbetjeve në parcelat bujqësore, në anë të kanaleve kulluese dhe ujitëse, si dhe në çdo vend tjetër ku dëmtohen toka, bimët dhe kafshët; c) hedhja apo groposja e të gjitha llojeve të mbetjeve në toka bujqësore."*

Në vijim, neni 62 i këtij ligji parashikon shprehimisht se: *"Çdo person që braktis, shkarkon apo asgjëson mbetje në mënyrë të pakontrolluar, në kundërshtim me nenin 61 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 500,000 deri në 1,000,000 lekë."*

Për rrjedhojë, vendosja e masës administrative "*paralajmërim*", si dhe heqja e masës së gjobës nga vendimi përfundimtar i inspektimit, nuk janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe bien ndesh me parimin e ligjshmërisë në veprimtarinë administrative. Në këto kushte, rezulton se vendimmarrja administrative e marrë nga trupa inspektuese nuk është e mbështetur në dispozitat përkatëse të ligjit material dhe nuk garanton zbatimin e njëjtë dhe të barabartë të ligjit.

Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: Xh. H; E. H.

16. Subjekti P-X me NIPT K.....O, Inspektimi nr. AKM-DQ-2024-000133, me objekt inspektimi: "*Verifikimi i kushteve të Lejes Mjedisore PN-6053-08-2013*", Inspektorët: P. M, E. H.

Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit rezulton se nga trupa inspektuese janë evidentuar mangësi në ushtrimin e aktivitetit jashtë kushteve të lejes mjedisore (instalimi i dy linjave për fraksionim pa miratim), si dhe në mosparaqitjen e planit të rehabilitimit dhe planit të

përputhshmërisë, në kundërshtim me ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011, *"Për lejet e mjedisit*", i ndryshuar, dhe ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011, *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".*
Për këto shkelje, në procesverbal janë parashikuar masat administrative "*gjobë"* në vlerën 300,000 lekë dhe *"paralajmërim*", ndërsa në vendimin përfundimtar është hequr masa "*gjobë*" dhe është vendosur vetëm masa administrative "*paralajmërim",* duke i lënë subjektit detyrë ndërprerjen e aktivitetit të paautorizuar dhe përmbushjen e kushteve të lejes mjedisore.
Nga auditimi konstatohet se me shkresën me nr. 4587/1 prot., datë 15.05.2024, subjekti ka paraqitur kontestime dhe dokumentacion shtesë lidhur me inspektimin e kryer nga trupa inspektuese. Nga auditimi i praktikës së administruar rezulton se dokumentacioni i depozituar nga subjekti është përgatitur dhe paraqitur **pas konstatimit të shkeljeve** nga ana e trupës inspektuese dhe, për rrjedhojë, nuk mund të konsiderohet si element që përjashton apo zbut përgjegjësinë administrative për shkeljet e konstatuara gjatë inspektimit.
Vendosja nga trupa inspektuese e masës "paralajmërim", në referencë te pikës 1/b (ii), të ligjit 10448/2011, të ndryshua nuk është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, pasi shkeljet e konstatuara janë të parashikuara shprehimisht nga ligji si kundërvajtje administrative dhe duhet i ndryshuar, parashikon shprehimisht se mospërmbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipit A, B apo C nga operatori i një instalimi përbën kundërvajtje administrative dhe, konkretisht, për lejet e mjedisit të tipit B, ndëshkohet me gjobë në vlerën nga 300,000 deri në 500,000 (treqind mijë deri në pesëqind mijë) lekë.
Kjo dispozitë ligjore është e qartë, e drejtpërdrejtë dhe nuk parashikon asnjë hapësirë diskrecioni për organin inspektues në lidhje me zëvendësimin e gjobës me një masë tjetër administrative. Për rrjedhojë, vendosja e masës administrative të ndëshkohen me masën administrative të gjobës, sipas intervalit të përcaktuar në ligj.
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: P. M, E. H.

17. Subjekti E me NIPT J.....S, Inspektimi nr. AKM-DQ-2025-000021 me objekt inspektimi: "*Inspektim mbi zbatimin e kërkesave ligjore",* Inspektorët: D. S dhe G. H.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit rezulton se nga trupa inspektuese janë evidentuar mangësi në moskryerjen e raportimeve dhe monitorimeve të kërkuara sipas kushteve të lejes mjedisore (mungesa e raportit vjetor, planit të përputhshmërisë dhe informacionit për një sërë kushtesh teknike dhe mjedisore), në kundërshtim me ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011, "*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*" dhe ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011*, "Për lejet e mjedisit"*, i ndryshuar.
Për këto shkelje është vendosur masa administrative "*paralajmërim",* si në procesverbal ashtu edhe në vendimin përfundimtar, duke i lënë subjektit detyrë dorëzimin e raporteve periodike dhe përmbushjen e detyrimeve të monitorimit në përputhje me kushtet e lejes mjedisore brenda afateve të përcaktuara.
Nga auditimi i dokumentacionit të inspektimit konstatohet se ndaj subjektit është vendosur masa administrative kryesore *"Paralajmërim"*, pa u argumentuar në mënyrë të arsyetuar pse shkeljet e konstatuara janë konsideruar si shkelje me rëndësi të vogël, sipas parashikimeve të nenit 48 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, i ndryshuar.
Nga verifikimi i dokumentacionit të pagesës së tarifës vjetore rezulton se data e pagesës është 22.01.2025, e cila përkon me datën e inspektimit fizik (sipas autorizimit të inspektimit: 22.01.2025, ora 09:28). Në dokumentacion nuk specifikohet nëse pagesa është kryer për vitin 2024, çka do të përbënte tejkalim të afatit të përcaktuar në lejen mjedisore, apo nëse i përket vitit 2025.
Gjithashtu, lidhur me dokumentacionin e evidentuar sipas listëverifikimit si i paparaqitur në sistem, konstatohet se janë ngarkuar dokumentacione në lidhje me Raportin Vjetor dhe

vetëmonitorimin e subjektit, të protokolluara në AKM me nr. 623, datë 24.01.2025, pra pas datës së procesverbalit të inspektimit.
Grupi i auditimit vlerëson se dokumentacioni i dorëzuar pas inspektimit nuk përjashton përgjegjësinë administrative për shkeljet e konstatuara gjatë kontrollit. Detyrimet për paraqitjen e dokumentacionit mjedisor dhe për zbatimin e kërkesave ligjore janë detyrime të vazhdueshme dhe duhet të përmbushen në momentin e ushtrimit të kontrollit administrativ.
Në këtë kuadër, dispozitat e nenit 29, pika 1, shkronja b/ii, të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011, *"Për Lejet e Mjedisit"*, i ndryshuar, si dhe të nenit 48 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, *"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, janë të qarta dhe të drejtpërdrejta, duke përcaktuar se: *"Subjekti është i detyruar të respektojë kushtet e lejes mjedisore, të disponojë dokumentacionin përkatës dhe ta vendosë në dispozicion të organit inspektues në momentin e kontrollit. Mosrespektimi i tyre përbën kundërvajtje administrative dhe ndëshkohet sipas ligjit."*
Këto dispozita nuk parashikojnë hapësirë diskrecioni për organin inspektues në lidhje me zëvendësimin e masës administrative të gjobës me një masë tjetër. Për rrjedhojë, vendosja e masës administrative *"Paralajmërim"* nga trupa inspektuese nuk është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, pasi shkeljet e konstatuara janë të parashikuara shprehimisht nga ligji si kundërvajtje administrative dhe duhet të ndëshkohen me masën administrative të gjobës, sipas intervalit të përcaktuar nga legjislacioni përkatës.
Ndaj subjektit duhej të ishte aplikuar masa administrative gjobë, sipas pikës 1, shkronja b/ii, të nenit 29 të ligjit nr. 10448/2011, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *"Mospërmbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipave A, B apo C nga operatori i një instalimi: ii) për lejet e mjedisit të tipit B, dënohet me gjobë në vlerën nga 300,000 deri në 500,000 lekë."*
Në lidhje me komentin në listëverifikim mbi vendosjen e masës së sekuestros, kjo nuk e përjashton subjektin nga detyrimet për raportim, pasi nga ekstrakti historik i ngarkuar në sistem rezulton se subjekti ka pasur 26 urdhra sekuestro nga data 06.09.2012 deri në fund të vitit 2024. Në vitin 2022 këta urdhra janë hequr, ndërsa për vitin 2024 ka pasur një urdhër sekuestro të vendosur më 27.12.2024 dhe të hequr më 30.12.2024, çka nuk përbën element përjashtues për moszbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga leja mjedisore.
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: D. S dhe G.H.

18. Subjekti E. A me NIPT K.....F, Inspektimi nr. AKM-DQ-2025-000082, me objekt inspektimi: "*Inspektim mbi zbatimin e kërkesave ligjore, informacion periodik*", Inspektorët: D. S, G. H.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit rezulton se nga trupa inspektuese janë evidentuar mangësi në mosparaqitjen e dokumentacionit mjedisor dhe moskryerjen e raportimeve periodike, mospagimin e tarifës së lejes mjedisore, si dhe në menaxhimin e papërshtatshëm të mbetjeve dhe lëndëve të rrezikshme, në kundërshtim me ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011, "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar, ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", si dhe VKM nr. 419, datë 25.06.2014, "*Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B*", i ndryshuar. Për këto shkelje, në procesverbal janë parashikuar masat administrative "*gjobë"* në vlerën 1,300,000 lekë, "*gjobë*" në vlerën 2,600,000 lekë dhe "*paralajmërim",* si dhe masa plotësuese pezullim aktiviteti deri në marrjen e masave korrigjuese, ndërsa në vendimin përfundimtar janë hequr masat *"gjobë*" dhe është vendosur vetëm masa administrative "*paralajmërim*".
Nga auditimi i ushtruar konstatohet se ndryshimi i masës administrative të vendosur nga trupa inspektuese është i paargumentuar dhe në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi. Analiza e

dispozitave përkatëse ligjore dhe e fakteve të konstatuara gjatë inspektimit tregon se shkeljet e evidentuara përbëjnë kundërvajtje administrative të parashikuara shprehimisht nga legjislacioni mjedisor, për të cilat ligjvënësi ka përcaktuar masa konkrete ndëshkuese. Në këtë kontekst, pika 1/b (ii) e ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se mospërmbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipit A, B apo C nga operatori i një instalimi përbën kundërvajtje administrative dhe, konkretisht, për lejet e mjedisit të tipit B, ndëshkohet me gjobë në vlerën nga 300,000 deri në 500,000 (treqind mijë deri në pesëqind mijë) lekë.
Kjo dispozitë ligjore është e qartë, e drejtpërdrejtë dhe nuk parashikon asnjë hapësirë diskrecioni për organin inspektues në lidhje me zëvendësimin e gjobës me një masë tjetër administrative. Për rrjedhojë, vendosja e masës administrative "*paralajmërim*" nga trupa inspektuese nuk është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, pasi shkeljet e konstatuara janë të parashikuara shprehimisht nga ligji si kundërvajtje administrative dhe duhet të ndëshkohen me masën administrative të gjobës, sipas intervalit të përcaktuar në ligj.
Në lidhje me shkeljet e konstatuara dhe masat për përmirësimin e tyre, nga auditimi konstatohet se nuk është përcaktuar një afat konkret për korrigjimin e shkeljeve të evidentuara. Gjithashtu, nuk rezulton të jetë kryer ri-inspektim në terren për të verifikuar zbatimin e detyrave të lëna dhe përmirësimin e shkeljeve të konstatuara gjatë inspektimit, në kundërshtim me pikën 14, të Kreut IV *"Korrigjimi dhe ndjekja e shkeljeve të lëna nga inspektimi"*, të Urdhrit nr. 25, datë 10.08.2018 *"Për miratimin e rregullores 'Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ'"*, sipas të cilit: *"Në rastet e inspektimeve të programuara, subjekti, objekt inspektimi urdhërohet të korrigjojë shkeljet e konstatuara, duke përcaktuar dhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim. Procesverbali i inspektimit dhe vendimi përfundimtar përfshin këshillimin (rekomandimet) me shkrim të subjektit për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve dhe afatet kohore."*
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: D. S, G. H.

19. Subjekti C-A me NIPT L.....H, Inspektimi me nr. AKM-DQ-2025-000072, me objekt inspektimi*: "Kushtet e lejes mjedisore*", Inspektorët: Xh. H, E. H.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit rezulton se nga trupa inspektuese janë evidentuar mangësi në menaxhimin e mbetjeve dhe substancave të rrezikshme (depozitim jashtë koordinatave dhe pa masa mbrojtëse), në funksionimin e impiantit të trajtimit të ujërave dhe mosrespektimin e detyrimit për njoftim, si dhe në mospërputhjen e sipërfaqes së aktivitetit me lejen mjedisore dhe kushtet teknike të operimit, në kundërshtim me ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011, *"Për lejet e mjedisit"*, i ndryshuar, ligjin nr. 9115, datë 24.07.2003, *"Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura"*, si dhe ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011, *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*.
Për këto shkelje, në procesverbal janë parashikuar masat administrative *"gjobë"* në vlerën 1,300,000 lekë, *"gjobë"* në vlerën 500,000 lekë dhe *"paralajmërim"*, ndërsa në vendimin përfundimtar janë hequr masat *"gjobë"* dhe është vendosur vetëm masa administrative *"paralajmërim"*.
Nga auditimi konstatohet se me shkresën nr. 1827 prot., datë 20.02.2025, subjekti ka paraqitur kontestime dhe dokumentacion shtesë lidhur me inspektimin e kryer nga trupa inspektuese. Nga auditimi i praktikës së administruar rezulton se dokumentacioni i depozituar nga subjekti nuk justifikon shkeljet e konstatuara nga ana e trupës inspektuese dhe, për rrjedhojë, nuk mund të konsiderohet si element që përjashton apo zbut përgjegjësinë administrative për shkeljet e konstatuara gjatë inspektimit.

Ligjvënësi, në nenin 29, pika 1, shkronja "b", nënndarja "ii", të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se mospërmbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipit A, B apo C nga operatori i një instalimi përbën kundërvajtje administrative dhe, konkretisht, për lejet e mjedisit të tipit B, ndëshkohet me gjobë në vlerën nga 300,000 deri në 500,000 (treqind mijë deri në pesëqind mijë) lekë.
Kjo dispozitë ligjore është e qartë, e drejtpërdrejtë dhe nuk parashikon asnjë hapësirë diskrecioni për organin inspektues në lidhje me zëvendësimin e gjobës me një masë tjetër administrative. Për rrjedhojë, vendosja e masës administrative *"paralajmërim"* nga trupa inspektuese nuk është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, pasi shkeljet e konstatuara janë të parashikuara shprehimisht nga ligji si kundërvajtje administrative dhe duhet të ndëshkohen me masën administrative të gjobës, sipas intervalit të përcaktuar në ligj.
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: Xh. H, E. H.

Nga auditimi e të dhënave të paraqitura në tabelë konstatohet se, për 12 inspektime të kryera gjatë vitit 2025, masa administrative e vendosur ndaj subjekteve të inspektuara ka qenë në të gjitha rastet *"paralajmërim",* pavarësisht llojit të veprimtarisë së subjekteve, natyrës së shkeljeve të konstatuara dhe sanksioneve të parashikuara në ligjet e posaçme mjedisore. Kjo praktikë tregon se trupat inspektuese kanë zbatuar në mënyrë uniforme dhe automatike masën e paralajmërimit, duke u mbështetur kryesisht në interpretimin e pikës 1 të nenit 44 të ligjit nr. 99/2024 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* pa kryer një vlerësim të individualizuar të shkeljeve dhe pa aplikuar masat administrative të përcaktuara shprehimisht në legjislacionin e posaçëm për mjedisin, çka e bën këtë praktikë të papërputhshme me parimin e ligjshmërisë dhe me hierarkinë e normave juridike.
Nga auditimi konstatohet se, gjatë periudhës objekt auditimi, ligji nr. 10433, datë 16.06.2011, *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* ka pësuar ndryshime që lidhen me mënyrën e vendosjes së masave administrative ndaj subjekteve të inspektimit.
Në formën e tij para ndryshimeve, ligji nr. 10433/2011, në nenin 48 "*Shkelja e kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit"*, parashikonte shprehimisht se:
1. Kur konstatohet shkelje e kërkesave ligjore, që përbën kundërvajtje administrative, por që është e një rëndësie të vogël, apo për të cilën ligji i posaçëm nuk parashikon dënimin përkatës administrativ, subjekti i inspektimit dënohet me "paralajmërim". Paralajmërimi është dënim administrativ kryesor.
2. Subjekti i inspektimit mund të dënohet drejtpërdrejt me një dënim tjetër kryesor administrativ, më të rëndë, të parashikuar në ligjin e posaçëm, kur:
a) nuk zbaton plotësisht dhe brenda afatit të përcaktuar urdhërimin e parashikuar në pikën 4 të këtij neni;
b) përsërit shkeljen e kërkesave ligjore;
c) shkelja e konstatuar apo pasojat e saj janë të rënda.
Ky formulim ligjor e lidhte drejtpërdrejtë zbatimin e masës administrative me përcaktimet e ligjit të posaçëm dhe nuk lejonte përdorimin e masës *"paralajmërim"* në rastet kur shkelja ishte e parashikuar shprehimisht si kundërvajtje administrative me sanksion konkret.
Me miratimin e ligjit nr. 99/2024 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* kjo dispozitë është riformuluar dhe aktualisht përfshihet në nenin 44 "*Dënimi administrativ kryesor",* i cili parashikon se:
Paralajmërimi është dënimi administrativ kryesor në inspektimin e parë të trupës së inspektimit.
Në të gjitha rastet kur konstatohen shkelje të kërkesave ligjore, që përbëjnë kundërvajtje administrative, subjekti i inspektimit dënohet me paralajmërim.

Paralajmërimi, si masë administrative kryesore, vendoset edhe për rastet kur për shkelje të lehta ligji i posaçëm nuk parashikon dënimin përkatës administrativ.
Dënimi administrativ kryesor me paralajmërim nuk zbatohet në rastet e shkeljeve të rënda për të cilat parashikohet masa e pezullimit të aktivitetit, sipas ligjit të posaçëm.
Dënimi administrativ kryesor me paralajmërim shoqërohet me urdhërimin e subjektit për të korrigjuar shkeljet e konstatuara dhe për të eliminuar pasojat e tyre, duke përcaktuar edhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim.
Nga auditimi konstatohet se kjo dispozitë është interpretuar nga AKM-ja dhe strukturat e saj rajonale në kuptimin se, për çdo subjekt të inspektuar për herë të parë pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 99/2024, masa administrative që duhet të vendoset është vetëm "paralajmërim", pavarësisht llojit të shkeljes dhe pavarësisht sanksioneve të parashikuara në ligjet e posaçme. Gjithashtu nga Inspektori i Përgjithshëm i është përcjellë AKM-së dhe ARM-ve përkatëse shkresa nr. 291 prot., datë 12.05.2025 ku theksohet ndër të tjera se: "...Në inspektoriatin e Përgjithshëm janë depozituar nga subjektet e inspektimit ankimet ndaj masave administrative të vendosura nga disa prej trupave të inspektimit, duke vendosur masë administrative dhe paralajmërimet...nisur nga kjo ju rikujtojmë detyrimin për zbatimin e përcaktimeve ligjore mbi vendosjen e dënimit administrative kryesor "*paralajmërim".*
Grupi i auditimit, nga lista totale e kundërvajtjeve administrative "*Paralajmërim*", të dhëna nga trupat inspektuese përzgjodhi inspektimet me datë vendimi pas datës 13.05.2025. Për këto raste u krye verifikimi i shkeljeve të evidentuara nga trupa inspektuese në listëverifikim dhe në procesverbalet përkatëse të inspektimit, si dhe u vlerësuan gjetjet e konstatuara nga trupa inspektuese me referencat ligjore përkatëse dhe në ligjet e posaçme në fuqi. Situata e konstatuar paraqitet në tabelën "Paralajmërime me datë vendimi pas 13.05.2025", ankesin nr. 1.

Sa më sipër konstatohet se, si rezultat i aplikimit të nenit 44 të Ligji nr. 99/2024 "*Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* të ndryshuar, subjektet e evidentuara janë sanksionuar me dënimin administrativ kryesor "*Paralajmërim*", pavarësisht se kanë qenë në shkelje të legjislacionit të posaçëm mjedisor në fuqi. Në total, për 15 rastet e evidentuara, **dënimi administrativ kryesor sipas legjislacionit mjedisor varion nga 4,210,000 lekë deri në 7,100,000 lekë**, masë kjo e cila nuk është aplikuar nga trupat inspektuese
Sipas vlerësimit të grupit të auditimit, ky interpretim nuk është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, pasi ligji i inspektimit ka karakter të përgjithshëm dhe procedural, ndërsa ligjet e posaçme mjedisore përcaktojnë shprehimisht shkeljet dhe masat administrative përkatëse.
Në këtë kuadër, aplikimi i masës administrative "paralajmërim", pa marrë në konsideratë llojin dhe rëndësinë e shkeljes dhe pa zbatuar sanksionet e përcaktuara në ligjet e posaçme, bie në mospërputhje me:
- Ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011, *"Për lejet e mjedisit",* neni 29;
- Ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011, *"Për mbrojtjen e mjedisit",* neni 69;
- Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011*, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve",* neni 62;
- Ligjin nr. 29/2024 "Për burimet ujore", neni 169.

Për rrjedhojë, nga auditimi konstatohet se vendosja e masës administrative *"paralajmërim"* nga trupat inspektuese gjatë vitit 2025, në rastet kur ligjet e posaçme parashikojnë sanksione konkrete administrative, nuk është në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi dhe nuk garanton zbatimin e plotë dhe efektiv të legjislacionit mjedisor.
Në lidhje me dënimet administrative kryesore "*Paralajmërim"* të vendosura nga trupat inspektuese gjatë inspektimeve, me shtyrjen e periudhës objekt auditimi deri në dhjetor 2025, grupi i auditimit i kërkoi AKM-së të dhëna për periudhën tetor–dhjetor 2025, me qëllim evidentimin e numrit të

inspektimeve dhe llojit të shkeljeve të konstatuara pas datës 13.05.2025, në zbatim të urdhrit të Inspektoriati Qendror. Në përgjigje të kërkesës për plotësimin e informacionit për periudhën 01.10.2025–31.12.2025 lidhur me masën "*Paralajmërim",* u vunë në dispozicion vetëm të dhëna në nivel total për paralajmërimet sipas ARM-ve, pa specifikuar çështjet apo shkeljet e konstatuara. Përjashtim përbën ARM Berat, e cila paraqiti një tabelë me të dhëna mbi numrin e çështjeve dhe shkeljet e evidentuara; sipas kësaj tabele rezultojnë 8 inspektime, por në sistemin e-inspektimeve dosjet paraqiten të paplota, pasi përmbajnë vetëm autorizimet ose procesverbalet, duke e bërë të pamundur vlerësimin e plotë të rasteve, në të njëjtën mënyrë si në rastet e trajtuara më sipër. Në nivel total, sipas të dhënave të raportuara nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për tremujorin e katërt të vitit 2025, dënimet administrative *"Paralajmërim"* janë dhënë si në tabelën më poshtë:

Tabela "Numri i masave "*Paralajmërim*" të dhëna për periudhën tetor-dhjetor 2025"

Inspektorati Shtetëror	Masa administrative "*Paralajmërim*"			Totali 3-mujor I 4-ët 2025
	Tetor 25	Nëntor 25	Dhjetor 25	
AKM	0	3	2	5
ARM Tiranë/ Durrës/Dibër	3	0	3	6
ARM Berat/Elbasan/Korçë	2	5	1	8
ARM Fier/ Vlore/ Gjirokastër	2	3	6	11
ARM Shkodër/ Lezhe/ Kukës	0	0	0	0
TOTALI	**7**	**11**	**12**	**30**

Burimi: AKM, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Në lidhje me problematikat e konstatuara në subjektin K.I SHA

Nga auditimi janë konstatuar se për këtë subjekt në mënyrë të përsëritur janë evidentuar shkelje për të cilat nuk janë ezauruar masa të plota nga AKM në lidhje me këto problematika, konkretisht nisur edhe nga auditimet e kryera në ARM është konstatuar se për periudhën 2021-2025 ka rezultuar si më poshtë:

Subjekti K. I SH.A me NIPT K.....T

1. Inspektimi nr. AKM-BR-2021-000228

Nga verifikimi i dokumntacionit bashkëlidhur praktikës së isnpektimit konstatohet se:

Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit nuk janë evidentuar shkelje dhe, në seksionin e kundërvajtjeve administrative, nuk rezulton të jetë vendosur asnjë dënim administrativ, si në procesverbal ashtu edhe në Vendimin Përfundimtar nr. AKM-BR-2021-000228-5, datë 07.12.2021.

Megjithatë, nga auditimi konstatohet se dokumentacioni i inspektimit paraqet mangësi në aspektin formal dhe përmbajtësor, pasi listëverifikimi dhe procesverbali nuk janë plotësuar dhe argumentuar në mënyrë të plotë, mungon dokumentacioni mbështetës (përfshirë Raportin e vetëmonitorimit) dhe procesverbali nuk është hartuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, "*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*", konkretisht me pikën 3 të nenit 45, që kërkon pasqyrim të detajuar të veprimeve të inspektimit, gjetjeve dhe vendimeve procedurale, si dhe shoqërimin e tij me listëverifikimin e plotësuar

2. Inspektimi nr. AKM-BR-2022-000073

Objekti i inspektimit: Trajtimi i shkresës me nr. 3584 Prot., datë 09.05.2022, lidhur me shkarkimet në ajër nga operatori industrial pranë Ish-Metalurgjikut, Elbasan, për lejen mjedisore me nr. PN-3843-09-2016, duke u bazuar edhe në informacionet/indiciot nga palët e treta.

Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit rezulton se subjekti, në përgjithësi, operon në përputhje me kushtet e lejes mjedisore dhe ka përmbushur detyrimet për raportim dhe pagesë të tarifës vjetore, si dhe operon brenda normave të lejuara për shkarkimet në ajër. Megjithatë, është konstatuar mangësi në mosparaqitjen e dokumentacionit që provon mirëmbajtjen e sistemit të pluhur-kapjes, për të cilën në procesverbal është parashikuar masa administrative "*gjobë*" në

vlerën 2,000,000 lekë, në zbatim të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011, *"Për lejet e mjedisit*", i ndryshuar. Në vendimin përfundimtar të inspektimit, nuk janë pasqyruar gjetjet dhe nuk është vendosur asnjë masë administrative, duke krijuar mospërputhje me procesverbalin.
Nga auditimi konstatohet se dokumentacioni bashkëlidhur praktikës së inspektimit është i paplotë dhe jo i besueshëm, pasi mungon evidenca e depozitimit të raportit të vetëmonitorimit, mungon ankesa që ka iniciuar inspektimin, si dhe janë bashkëlidhur dokumente që nuk i përkasin subjektit të inspektuar (dokumentacion i një subjekti tjetër dhe regjistra me të dhëna jo korresponduese me lejen objekt kontrolli). Në këto kushte, vendimi përfundimtar që ka hequr masën administrative "*gjobë"* nuk rezulton i mbështetur në dokumentacion provues.

3. Inspektimi nr. AKM-BR-2022-000079

Objekti i inspektimit: Hapje e një çështje të re për shkak të Mbylljes se Vendimit Përfundimtar për procesverbalin e mbajtur për K. I sh.a, çështja nr. AKM-BR-2022-000073 pasi është mbyllur gabimisht me dokumentacion të një subjekti tjetër. Informacion nga palët e treta.
Nga auditimi konstatohet se Procesverbalit dhe listëverifikimit, subjekti ka përmbushur detyrën e lënë në procesverbalin nr. AKM-BR-2022-000073 për dorëzimin e grafikut të mirëmbajtjes së sistemit të pluhur-kapjes dhe dokumentacionit shoqërues, dhe për rrjedhojë nuk janë evidentuar shkelje apo vendosur masa administrative.
Nga auditimi konstatohet se procesverbali i inspektimit nr. AKM-BR-2022-000079-2, datë 14.06.2022, nuk është hartuar në përputhje me pikën 3 të nenit 45 të ligjit nr. 10433/2011, *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, pasi nuk përmban informacion të plotë dhe të argumentuar mbi veprimet e inspektimit dhe nuk shoqërohet me dokumentacion mbështetës të mjaftueshëm. Gjithashtu, nga verifikimi i vijueshmërisë së procesit rezulton se në procesverbalin nr. AKM-BR-2022-000073 është vendosur edhe masa administrative *"gjobë"* në vlerën 2,000,000 lekë për shkeljet e konstatuara në momentin e inspektimit, e cila nuk është reflektuar në inspektimin pasardhës nr. AKM-BR-2022-000079. Në këto kushte, mosvijimi i kësaj mase administrative nuk rezulton i justifikuar, pasi ekzistenca e shkeljes në momentin e konstatimit përbën bazë për aplikimin e sanksionit, pavarësisht përmbushjes së mëvonshme të detyrimeve nga subjekti.

4. **Inspektimi nr. AKM-BR-2023-000187**

Objekti i inspektimit: Inspektim mbi incidentin e ndodhur pranë subjektit K. I sha, dhe mbi zbatueshmërinë e ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 *"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"* i përditësuar
Inspektorët: F. Sh, Sh. A, S. R.
Nga inspketimi është evidentuar se nga ana e subjektit në vend-depozitimin e skrapit janë depozituar/grumbulluar skrap të cilat janë të pa diferencuara. Më konkretisht përveç mbetjeve hekurishteve të ndryshme gjendeshin dhe:
1. Goma të ndryshme;
2. Automjete në fund të jetës dhe të pa demoluara (ku mjetet kanë patur gomat, sedilje, stopa, parakolp dhe prapakolp, dhe të tjera pjesë që kompletojnë një automjet);
3. Frigorifer dhe Boliera të pa demoluara nga shtresa termoizoluese (shkumë/polisterol apo lloje të tjera termoizolimi);
4. Bomula.
Për këto shkelje, në procesverbal është vendosur masa administrative *"gjobë"* në vlerën 1,500,000 lekë, si dhe masa për korrigjimin e shkeljeve, e cila është reflektuar në mënyrë të njëjtë edhe në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit nr. AKM-BR-2023-000187-5, datë 21.11.2023. Afati për përmbushjen e këtij detyrimi është përcaktuar me të njëjtën datë si në procesverbal ashtu edhe në vendimin përfundimtar (21.11.2023), duke e bërë atë formal dhe jo efektiv për zbatim.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistem rezulton se procesverbali i inspektimit nr. AKM-BR-2023-000187-2, datë 09.11.2023, nuk është hartuar në përputhje me pikën 3 të nenit 45 të ligjit nr. 10433/2011, *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, pasi nuk përmban informacion të plotë dhe të detajuar mbi veprimet e inspektimit, gjetjet dhe vendimet procedurale, si dhe nuk shoqërohet me dokumentacion mbështetës të mjaftueshëm.
Gjithashtu, në vendimin përfundimtar përsëritet detyrimi për dorëzimin e kontestimeve brenda datës 21.11.2023, datë që përkon me vetë datën e nxjerrjes së vendimit, çka e bën këtë përcaktim të ezauruar në momentin e miratimit dhe, për rrjedhojë, pa efekt praktik.

5. Inspektimi nr. AKM-LE-2023-000183

Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit rezulton se nuk janë evidentuar mangësi. Sipas tyre subjekti zbaton kërkesat e lejes, përfshirë garantimin e rrjedhjes minimale ekologjike dhe kryerjen periodike të pagesave për shfrytëzimin e burimit ujor, në përputhje me ligjin nr. 111/2012, "*Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore*", i ndryshuar. Në seksionet përkatëse të procesverbalit nuk janë përcaktuar shkelje, si dhe nuk janë vendosur dënime administrative kryesore apo plotësuese. E njëjta situatë paraqitet edhe në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit nr. AKM-LE-2023-000183-5, datë 27.12.2023, ku nuk janë evidentuar gjetje apo masa administrative.

6. Inspektimi nr. AKM-DQ-2024-000044

Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit rezulton se subjekti është i pajisur me Leje për Përdorimin e Burimit Ujor, të lëshuara nga Këshilli i Basenit Ujor Vjosë, me nr. serie 15 dhe 16, datë 22.04.2020, të vlefshme për 5 vjet, dhe ka përmbushur detyrimet përkatëse financiare. Nga verifikimi në terren është konstatuar se subjekti respekton kushtet e lejes, përfshirë garantimin e rrjedhjes ekologjike dhe mungesën e shkarkimeve të pakontrolluara.
Në procesverbal nuk janë evidentuar gjetje apo shkelje dhe nuk janë vendosur masa administrative, ndërsa subjektit i është lënë detyrë vetëm respektimi i vazhdueshëm i kushteve të lejes. E njëjta situatë paraqitet edhe në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit nr. AKM-DQ-2024-000044–5, datë 15.02.2024, ku nuk janë evidentuar gjetje apo masa administrative.

7. Inspektimi nr. AKM-DQ-2024-000055

Objekti i inspektimit: Zbatimin e kërkesave ligjore dhe përputhshmërinë e kushteve të Lejes së përdorimit të burimeve ujor.
Nga listëverifikimi, procesverbali dhe Vendimi Përfundimtar i Inspektimit rezulton se nuk janë evidentuar mangësi gjatë inspektimit dhe subjekti paraqitet në përputhje me kushtet e lejes për përdorimin e burimit ujor, duke realizuar edhe raportimin e vetëmonitorimit dhe pagesat përkatëse.
Nga auditimi konstatohet se konstatimet e trupës inspektuese, si në listëverifikim ashtu edhe në procesverbal dhe në vendimin përfundimtar, nuk janë të mbështetura me dokumentacion justifikues. Konkretisht, mungojnë prova mbështetëse si raportet e vetëmonitorimit të depozituara, evidenca fotografike apo dokumente të tjera që të vërtetojnë në mënyrë të plotë përputhshmërinë e subjektit me kushtet e lejes. Dokumentacioni i administruar në sistem për këtë rast përbëhet vetëm nga: autorizimi i inspektimit, listëverifikimi, procesverbali i inspektimit dhe vendimi përfundimtar, pa dokumentacion shtesë mbështetës.

8. Inspektimi nr. AKM-BR-2024-000155

Objekti i inspektimit: Kontroll mbi zbatimin e kushteve të lejes mjedisore me numër PN-7107-04-2014.
Nga verifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur konstatohet se ekzistojnë dy autorizime inspektimi me të njëjtin numër dokumenti, por me data të ndryshme (25.07.2024 dhe 26.08.2024) dhe me përbërje të ndryshme të trupës inspektuese, pa u evidentuar arsyeja e këtij ndryshimi, ndërkohë që data dhe ora e realizimit të inspektimit kanë mbetur të pandryshuara. Nga listëverifikimi dhe

procesverbali rezulton se subjekti ka ndjekur procedurat për transferimin dhe revokimin e lejes mjedisore nr. PN-7107-04-2014, e cila është përfshirë në lejen mjedisore Tip A nr. PN-3843-09-2016, si dhe ka vijuar komunikimi institucional për shfuqizimin e saj. Nga inspektimi nuk janë evidentuar gjetje apo masa administrative, dhe e njëjta pasqyrohet edhe në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit nr. AKM-BR-2024-000155-5, datë 27.08.2024.

Grupi i auditimit gjykon se ndryshimi i autorizimit të inspektimit nuk rezulton i arsyetuar dhe nuk është i dokumentuar me akt justifikues për ndryshimin e përbërjes së trupës inspektuese. Gjithashtu, pavarësisht se procedura për revokimin e lejes mjedisore nr. PN-7107-04-2014 ka qenë në proces që prej datës 13.05.2024, kjo leje ka vijuar të përfshihet në objektin e inspektimit, pa u evidentuar fakte apo rrethana të reja përtej dokumentacionit administrativ të shkëmbyer.

Dokumentacioni i administruar në sistem për këtë rast përfshin autorizimet e inspektimit (përfshirë versionin e përditësuar), listëverifikimin, procesverbalin, vendimin përfundimtar dhe korrespondencën ndërmjet subjektit "*K*" SHA AKM-së dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

9. Inspektimi nr. BR-2024-000157

Subjekti K.I SH.A me NIPT K.....T, Inspektorët: F. Sh, Sh. A, S. R.

Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit rezulton se janë evidentuar mangësi në lidhje me mosparaqitjen e dokumentacionit për shkarkimin dhe transferimin e ndotësve, si dhe në zbatimin e kushtit 8 të lejes mjedisore *"Menaxhimi i mbetjeve"*, përfshirë mungesën e kontratave me subjekte të licencuara për trajtimin/asgjësimin e mbetjeve. Gjithashtu, konstatohet paplotësim i plotë i listëverifikimit (pyetja 22), duke reflektuar mangësi në dokumentimin e gjetjeve. Në procesverbal, këto shkelje janë klasifikuar në kundërshtim me ligjin nr. 10431/2011 *"Për mbrojtjen e mjedisit"* dhe ligjin nr. 10448/2011 *"Për lejet e mjedisit"*, duke u shoqëruar me masa administrative *"gjobë"* në vlerën 500,000 lekë dhe 1,500,000 lekë, si dhe detyrim për dorëzimin e regjistrave përkatës brenda datës 09.09.2024.

Në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit nr. AKM-BR-2024-000157-5, datë 10.09.2024, është vendosur vetëm *"gjobë"* në vlerën 1,500,000 lekë, si dhe masë plotësuese *pezullimi i aktivitetit të transferimit të mbetjeve të rrezikshme* deri në lidhjen e kontratave përkatëse, ndërkohë që afati për korrigjimin e shkeljeve është shtyrë.

Nga auditimi rezulton se afati i përcaktuar në procesverbal nuk është respektuar dhe në vendimin përfundimtar është vendosur një afat i ri, pa u shoqëruar me masa për moszbatimin e detyrimit fillestar, në kundërshtim me nenin 48 të ligjit nr. 10433/2011. Gjithashtu, masa e pezullimit nuk rezulton e shoqëruar me njoftim zyrtar dhe të arsyetuar ndaj subjektit dhe autoritetit përkatës, në kundërshtim me nenin 66 të ligjit nr. 10431/2011. Këto elemente tregojnë mangësi proceduriale si në vendimmarrje ashtu edhe në ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të masave të lëna

10. Inspektimi AKM-DQ-2025-000043

Nga listëverifikimi, procesverbali dhe Vendimi Përfundimtar i Inspektimit rezulton se subjekti është i pajisur me Leje për Përdorimin e Burimit Ujor dhe ka përmbushur detyrimet përkatëse financiare, si dhe nuk janë evidentuar gjetje apo masa administrative. Nga inspektimi në terren është konstatuar respektimi i kushteve të lejes, përfshirë garantimin e rrjedhjes ekologjike.

Nga auditimi rezulton se konstatimet e trupës inspektuese, si në listëverifikim, procesverbal dhe vendimin përfundimtar, nuk janë të mbështetura plotësisht me dokumentacion justifikues. Konkretisht, mungojnë evidenca mbështetëse që provojnë në mënyrë të verifikueshme përmbushjen e kushteve konkrete të lejes për përdorimin e burimit ujor, duke krijuar mangësi në argumentimin dhe gjurmueshmërinë e konkluzioneve të inspektimit.

Konkluzion: Nga auditimi i dokumentacionit të inspektimeve të kryera ndaj subjektit K. I SH.A, me nipt: K.....T për periudhën 2021–2025, rezulton se subjekti ka shfaqur mangësi dhe shkelje

të përsëritura në zbatimin e kërkesave të legjislacionit mjedisor dhe kushteve të lejeve mjedisore, ndërkohë që nga strukturat inspektuese nuk janë ndërmarrë masa të plota administrative për pezullimin e aktivitetit apo për ndjekjen e moszbatimit të detyrimeve të vendosura. Në mënyrë më konkrete:
-Në vitin 2023 janë konstatuar shkelje në menaxhimin e mbetjeve, përfshirë depozitimin e mbetjeve të padiferencuara dhe prezencën e mbetjeve potencialisht të rrezikshme (automjete të pa demoluara, frigoriferë me materiale termoizoluese, bombula, goma etj.), në kundërshtim me ligjin për menaxhimin e integruar të mbetjeve;
-Në vitin 2024 janë konstatuar mangësi në dokumentimin e menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme dhe mungesë kontratash me subjekte të licencuara për trajtimin/asgjësimin e tyre.
-Subjekti nuk ka përmbushur detyrimet brenda afateve të përcaktuara në procesverbal dhe vendimin përfundimtar;
-Nuk rezulton në sistem ndonjë njoftim formal për pezullim aktiviteti apo ndjekje të masave për moszbatimin e detyrimeve;
-Janë konstatuar gjithashtu mangësi proceduriale në dokumentimin e procesverbaleve dhe listë-verifikimeve gjatë viteve të auditimit;
- Në inspektimet e kryera mungojnë dokumentacionet në lidhje me raportet vjetore dhe raportet e vetëmonitorimit, çka përbën mangësi proceduriale të trupave inspektuese në argumentimin e përgjigjeve të tyre. Gjithashtu, nuk verifikohet paraqitja e këtyre raporteve si detyrë e subjektit për respektimin e kushteve të lejeve mjedisore.
Nga grupi i auditimit konstatohet se, për shkak të mangësive në mbajtjen e evidencave lidhur me raportimet pranë AKM-së, nuk është provuar respektimi i këtij kushti nga subjekti.
Në databazën e vënë në dispozicion, përmenden kryesisht shkresa lidhur me njoftimet për ndërprerje aktiviteti dhe, në pak raste, shkresat për depozitimin e raporteve të vetëmonitorimit, pa treguar nëse ato janë depozituar në datë, në mënyrë të plotë dhe përkatëse. Veprime këto në kundërshtim me: nenin 66 të ligjit nr. 10431/2011 "*Për mbrojtjen e mjedisit*", lidhur me pezullimin e aktivitetit dhe detyrimin për njoftim me shkrim të arsyetuar; nenin 48 të ligjit nr. 10433/2011 "*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*", lidhur me masat administrative në rast moszbatimi të detyrimeve të lëna; nenin 45 të ligjit nr. 10433/2011, lidhur me elementët e detyrueshëm të procesverbalit të inspektimit; ligjin nr. 10448/2011 "Për lejet e mjedisit"; ligjin nr. 10463/2011 "*Për menaxhimin e integruar të mbetjeve*".
Situata e mësipërme ka ardhur si shkak i mosndjekjes sistematike e masave administrative nga strukturat inspektuese; mangësive në monitorimin e zbatimit të detyrimeve pas vendimit përfundimtar të inspektimit; dobësive në dokumentimin procedural të inspektimeve; mungesës së koordinimit midis strukturave inspektuese dhe autoriteteve licencuese.
Edhe pse nga inspektimet e kryera janë evidentuar shkelje të përsëritura, trupat inspektuese nuk kanë urdhëruar korrigjimin e tyre duke përcaktuar një afat të arsyeshëm për këtë qëllim, siç parashikohet në Kreun IV "Korrigjimi dhe ndjekja e shkeljeve të lëna nga inspektimi" të Rregullores nr. 25 *"Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ"*, ku citohet se: *"Në rastet e inspektimeve të programuara, subjekti, objekt inspektimi urdhërohet të korrigjojë shkeljet e konstatuara, duke përcaktuar dhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim. Procesverbali i inspektimit dhe vendimi përfundimtar përfshin këshillimin (rekomandimet) me shkrim të subjektit për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve dhe afatet kohore. Subjekti është i detyruar të njoftojë për korrigjimin e shkeljeve brenda afatit të përcaktuar dhe, nëse është e nevojshme, të paraqesë provat përkatëse. Për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve kryhet një inspektim i ri dhe, në rast moszbatimi të detyrave të lëna, procedohet me masë*

administrative." Në asnjë nga inspektimet e mëpasshme nuk rezulton të jetë verifikuar nëse subjektet kanë marrë masa për korrigjimin e shkeljeve të konstatuara.
Mosmarrja e masave për pezullim të aktivitetit apo përshkallëzim të masave administrative ndaj një subjekti që paraqet shkelje të përsëritura dobëson efektivitetin e sistemit të kontrollit mjedisor, krijon precedent negativ për subjektet e tjera të licencuara, rrit rrezikun e ndotjes së mjedisit dhe cenimit të shëndetit publik, si dhe cënon parimin e barazisë para ligjit dhe zbatimit proporcional të masave administrative. Si pasojë, ekziston rreziku që subjektet me histori shkeljesh të vazhdojnë aktivitetin pa respektuar kërkesat mjedisore, të krijohet një praktikë tolerimi ndaj moszbatimit të kushteve të lejeve mjedisore dhe institucionet publike të ekspozohen ndaj përgjegjësive administrative dhe ligjore për mosveprim. Në këto kushte, mosndërmarrja e masave për pezullim aktiviteti dhe për ndjekjen e moszbatimit të detyrimeve administrative ndaj një subjekti me shkelje të përsëritura përgjatë disa viteve përbën mangësi serioze në ushtrimin e funksionit mbikëqyrës dhe në zbatimin e legjislacionit mjedisor, duke dobësuar rolin parandalues dhe ndëshkues të inspektimit shtetëror.

Për problematikat e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi inspektorët sipas rasteve të trajtuara në këtë material, përgjegjësat e sektorëve, Drejtori i Drejtorisë së Inspektimeve dhe Titullari i AKM-së, sipas periudhave që kanë mbuluar në pozicionet përkatëse, konkretisht:
Drejtor i Përgjithshëm: A. D; *Drejtor i Drejtorisë së Inspektim Kontrollit:* D. S;
Përgjegjës i Sektorit të Inspektimeve Mjedisore: K.A*; Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Natyrore dhe Ujrave:* Sh. B, S. H, D. Z, J.C; *Inspektorët e përmendur në këtë material sipas rasteve të lartëpërmendur.*

Nga AKM është dërguar observacioni me nr. prot., 3983/4 datë 27.04.2026 protokolluar në KLSH me nr. 769/91 prot., datë 08.05.2026, nga z. G. H dhe z. D. S, si në vijim:
Pretendimi i subjektit: Dënimi me paralajmërim është i mbështetur në pikën 1 të nenit 48 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në RSH", ku përcaktohet se: "Kur konstatohet shkelje e kërkesave ligjore, që përbën kundërvajtje administrative, por që është e një rëndësie të vogël, apo për të cilën ligji i posaçëm nuk parashikon dënimin përkatës administrativ, subjekti i inspektimit dënohet me "paralajmërim". Paralajmërimi është dënimi administrativ kryesor. Gjetja e grupit të auditimit që ka ndryshim të masës administrative është e pasaktë sepse "paralajmërimi" ka qenë i parashikuar në PV inspektimi, ashtu si dhe masa tjetër dhe që është masa më e lehtë që është aplikuar duke parë që subjekti i inspektimit ka reaguar menjëherë, duke paraqitur dokumentacion për eliminimin e pasojave që mund të sillte shkelja e konstatuar, për këtë arsye grupi i inspektimit ka vendosur masën më të lehtë administrative duke ju referuar edhe pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr. 10433 datë 16.06.2011 ku përcaktohet se: "Në përcaktimin e dënimit apo të masës që duhet marrë, inspektori, në përputhje me rëndësinë e shkeljeve të konstatuara apo pasojave të tyre, vendos atë sanksion apo merr atë masë që është e domosdoshme dhe e përshtatshme për arritjen e qëllimit të dënimit apo masës dhe që cënon me pak të drejtat apo interesat e ligjshëm të subjektit të inspektimit" dhe jo zëvendësimin e saj. Pretendimi se "Në këto kushte ndryshimi i masës nga gjobë në paralajmërim nuk mund të mbështetet në parimin e proporcionalitetit apo në mungesën e një metodologjie të miratuar me VKM", nuk qëndron dhe ju sqaroj se:
Pika 2 e nenit 6 të ligjit nr. 10433 datë 16.06.2011 përcakton qartë se si merret vendimi pas shkeljeve të konstatuara dhe nuk ka nevojë për interpretim, ashtu si dhe mungesa e një VKM- në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 10433 datë 16.06.2011.
Në pikën 7 të nenit 7 të nenit 48 të ligjit nr. 10433 datë 16.06.2011 përcaktohet se: Këshilli i Ministrave miraton rregulloren e përgjithshme të metodologjisë së përcaktimit të dënimeve administrative, në përputhje me parimin e proporcionalitetit, i cili është akti nënligjor që rregullon boshllëkun ligjor dhe jo interpretimet se "parimi i proporcionalitetit dhe diskrecioni i inspektorit zbatohet brenda kufijve të ligjit", që janë të pa mbështetura në dispozita ligjore. Në mungesë të një akti nënligjor të tillë, grupi i auditimit nuk mund të interpretojë ligjin dhe të dal në arsyetime që nuk qëndrojnë, të cilat orientoj në vendimmarrje jo të drejtë dhe të paanshme.
Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit sqaron se, lidhur me observacionet e dërguara, nuk janë paraqitur argumente apo evidenca shtesë që të rrëzojnë konstatimet e evidentuara gjatë procesit të auditimit. Së pari, në pjesën

e parë të observacionit nuk është argumentuar pse shkeljet përkatëse janë konsideruar të një rëndësie të vogël nga ana juaj gjatë inspektimit.
Së dyti, në rastet e trajtuara nga grupi i auditimit është evidentuar vendosja e masës administrative *"paralajmërim",* ndërkohë që nga ana juaj nuk është paraqitur një argumentim i plotë dhe i mbështetur lidhur me arsyetimin e aplikimit të kësaj mase. Së treti, rastet e trajtuara përbëjnë shkelje që rregullohen nga ligje të posaçme dhe janë analizuar në mënyrë të detajuar, rast pas rasti, në këtë material. Për sa më sipër duke qenë se nuk ka ndryshime apo evidenca të reja, trajtimi i materialit mbetet i njëjtë në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.

2.5.2 AGJENCIA RAJONALE MJEDISORE TIRANË, DURRËS DIBËR

Nga verifikimi i plotësimit të strukturës së miratuar për Agjencitë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës dhe Dibër, për periudhën objekt auditimi rezultoi se:
- Për vitin 2021 dhe 2022 nuk është plotësuar struktura për 2 specialistë për SIBN dhe për 4 specialistë në SIM;
- Për vitin 2023 nuk është plotësuar për 1 përgjegjës dhe 1 specialist në SIM[12] në Tiranë, më pas është ristrukturuar dhe janë ndarë rrethet duke rezultuar:
* Nuk është plotësuar struktura për 1 përgjegjës në SIM në Durrës, dhe
* Nuk është plotësuar struktura për SIM për Dibrën dhe rezulton vakant për 1 përgjegjës dhe 2 specialistë;
-Për vitin 2024 struktura është e plotësuar për të dy sektorët në Tiranë;
* Për periudhën Janar-Nëntor në Sektorin e Inspektimit të të Mjedisit në Dibër rezulton se nuk është plotësuar struktura për 1 përgjegjës dhe 1 specialist;
* Struktura në Sektorin e Inspektimit të Mjedisit në Durrës deri në Nëntor 2024 është e plotësuar, më pas është ristrukturuar dhe është bashkuar me rrethin Dibër duke rezultuar për muajin Dhjetor 2024 me vakancë për 1 specialist.
-Për vitin 2025 struktura në SIM në Dibër rezulton se nuk është plotësuar me 1 specialist.
Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me: Urdhërin nr. 23, datë 03.02.2020 të Kryeministrit "*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së AKM-së*"; Urdhërin nr.187, datë 15.11.2022, të Kryeministrit për "Miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit"; Urdhërin nr. 29, datë 13.02.2024 të Kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së AKM-së" dhe Urdhërin nr. 194, datë 04.10.2024 të Kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së AKM-së", skemat 1/2 dhe 2/2, duke rezultuar për periudhën objekt auditimi me vende të lira, krahasuar me numrin e miratuar në organikë, duke sjellë për pasojë ulje të efektivitetit dhe eficiencës në punë. të këtyre sektorëve.

Mbi planifikimin dhe realizim vjetor të inspektimeve:
Programi vjetor hartohet nga drejtori i DIK dhe përcillet te titullari i AKM-së. Përveç inspektimeve të planifikuara janë kryer dhe inspektime të paplanifikuara, kur ka qenë e nevojshme, si në rastet 2e ankesave, denoncimeve apo informacioni nga të tretët, në raste rishikimesh, etj. Dokumentacionet e inspektimeve janë hedhur në sistemin e *E–Inspektim*. Bazuar në Ligjin nr. 10433, datë 16.06.20011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, realizimi i programit inspektues nga të dy sektorët është si në vijim:
- Për vitin 2021 programi vjetor është realizuar me 52%;
- Për vitin 2022 programi vjetor është realizuar me 19%;
- Për vitin 2023 programi vjetor është realizuar me 57%;
- Për vitin 2024 programi vjetor është realizuar me 70%;

[12] Sektori i Inspektimit të Mjedisit.

- Për vitin 2025 programi vjetor është realizuar me 32%;

Për periudhën objekt auditimi, *grupi i auditimit konstatoi* mosrealizimin e plotë të programeve vjetore të inspektimit nga të dy sektorët inspektues. Mosrealizimi i plotë i programeve vjetore të inspektimit ndikon në uljen e efektivitetit të funksionit mbikëqyrës dhe kontrollues të strukturave inspektuese, duke krijuar risk për mungesë kontrolli të plotë mbi subjektet që duhet të inspektohen.

Nga auditimi i procesit të planifikimit dhe përgatitjes së programeve vjetore të auditimit për periudhën objekt auditimi, u konstatua se ARM Tiranë nuk rezulton të kenë përgatitur Program Vjetor të Inspektimeve. Programi Vjetor i inspektimeve është përgatitur nga AKM pa marrë mendim nga Agjencitë Rajonale. E gjithë kjo situatë është në kundërshtim me Rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit nr.120 prot., datë 12.01.2021, e miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i AKM-së, Kreu VII, nënkapitulli III.I pika 11, nënkapitulli III.II germa "d", nënkapitulli III.III germa "b" dhe pika 11.

Nga auditimi me zgjedhje i inspektimeve në ARM Tiranë, të regjistruara në sistemin e-inspektim u konstatua se nuk është evidentuar informacioni mbi statusin e pagesës së tarifave vjetore të lejeve mjedisore nga subjektet. Mospasja e këtij informacioni pengon identifikimin e subjekteve që nuk kanë kryer pagesat përkatëse dhe kufizon mundësinë e përfshirjes së tyre në planet e inspektimit.

Për sa i përket masave administrative të vendosura, konstatohet se mungon një metodologji e përcaktimeve të dënimeve administrative, në kundërshtim me pikën 7 dhe 8, të nenit 48 të ligjit nr. Nr.10 433, datë 16.6.2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"* ku citohet se:

7. Këshilli i Ministrave miraton rregulloren e përgjithshme të metodologjisë së përcaktimit të dënimeve administrative, në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

8. Çdo inspektoriat shtetëror apo vendor harton rregulloren e metodologjisë së përcaktimit të dënimeve, në fushën e tij të inspektimit. Rregullorja miratohet nga ministri përgjegjës për inspektoratet shtetërore dhe organi ekzekutiv i njësisë vendore për inspektoratet vendore.

Mungesa e një metodologjie të miratuar, sjell riskun që inspektorët të vendosin masa administrative bazuar në interpretimin e tyre personal. Kjo krijon hapsirë që masat të jenë të pa unifikuara dhe jo në përpjesëtim me shkeljen e kryer, duke sjellë në këtë mënyrë dënime tepër të ashpra ose tepër të lehta, të cilat cënojnë standardet ligjore dhe krijojnë precedentë të gabuar në praktikë.

Për periudhën Janar – Shtator 2025 nga evidencat e vëna në dispozicion grupit të auditimit, ARM Tiranë, Durrës, Dibër ka hartuar dhe dërguar në AKM për miratim planet mujore të inspektimeve për Sektorin e Inspektimit në Mjedis për muajt, Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj Qershor, Korrik, Gusht, Shtator. Ndërsa sa i përket Sektorit të Inspektimit të Burimeve Natyrore (Ujërave) për muajit janar dhe qershor nuk ka pasur plane inspektimesh të miratuara nga AKM.

Krahas masave administrative, nga ARM Tiranë janë vendosur edhe masa "paralajmërime", të cilat për periudhën objekt auditimi paraqiten si në vijim:

Viti	Numri i subjekteve
2021	39
2022	23
2023	63
2024	24
2025	12
Totali	**161**

Burimi: *AKM regjistri i paralajmerimeve, përpunuar nga grupi i auditimit*

Nga auditimi me zgjedhje i Inspektimeve të regjistruar në sistemin e-inspektimi u konstatua si më poshtë:

1. Subjekti K me NIPT K.....F, Inspektimi nr. AKM-TR-2024-000286, me objekti inspketimi: "*Zbatimi i kushteve te lejes mjedisore*", Inspektorët: M. K, S. K, A. Xh.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit rezulton se gjatë kontrollit janë evidentuar mangësi në lidhje me mosparaqitjen e pagesës vjetore të lejes mjedisore, mungesën e kontratave për evadimin e mbetjeve dhe regjistrit të mbetjeve, si dhe nevojën për përmirësimin e kushteve teknike për kontrollin e emetimeve në ajër, në kundërshtim me nenin 29 të ligjit nr. 10448/2011, nenin 62 të ligjit nr. 10463/2011 dhe nenin 48 të ligjit nr. 10433/2011. Megjithëse në procesverbal nuk janë parashikuar masa administrative, në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit nr. AKM-TR-2024-000286-5, datë 19.12.2024, shkeljet janë klasifikuar si kundërvajtje administrative dhe është vendosur dënim administrativ kryesor "*Gjobë*" në vlerën 390,000 lekë, si dhe masë plotësuese për korrigjimin e shkeljeve dhe eliminimin e pasojave të tyre brenda një afati kohor të arsyeshëm.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistem rezultoi se procesverbali i inspektimit AKM-TR-2024-000286-2 datë, 20.11.2024 nuk është hartuar në përputhje me pikën 3 të nenit 45 të ligjit nr. 10433/2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* i cili përcakton se procesverbali duhet të përmbajë informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit. Bazuar në shkeljet e konstatuara në listë verifikim dhe procesverbalin e inspektimit, konstatohet se subjekti nuk ka përmbushur kushtin 8 të lejes mjedisore, veprim i cili sanksionohet me ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i cili në nenin 62, pika 6, përcakton se: *Çdo person, që transferon mbetje jo të rrezikshme apo që merr mbetje jo të rrezikshme pa një dokument transferimi mbetjesh, në kundërshtim me nenin 21 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1,000,000 (një milion) deri në 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.*
Gjithashtu, rezulton se subjekti ne momentin e kontrollit nuk ka paraqitur pagesën vjetore të lejes së mjedisit, në kundërshtim me nenin 25 të ligjit për "Lejet e Mjedisit" që përcakton se:
1. *Subjekti kërkues i lejes së mjedisit paguan tarifën përkatëse për:*
a) kërkesë për leje mjedisi të tipave A, B ose C;
b) kërkesë për një ndryshim të kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipit A ose të tipit B;
2. Tarifat për lejen e tipave A dhe B paguhen në ministri.
3. Operatori i instalimit i paguan çdo vit një tarifë vjetore ministrisë për instalimet e tipave A dhe B, përkatësisht.
dhe VKM nr. 417 datë 25. 06.2014 *"Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit",* pika 6.
Për sa më sipër nga grupi i Inspektimit nuk janë analizuar shkeljet, për të nxjerrë përgjegjësitë dhe saktësuar Dënimin Administrativ. Nga ana e trupës inspektuese në listë verifikim është evidentuar: Subjektit i lihet detyrë të marrë masa për instalimin e sistemit të ventilimit dhe aspirimit për kapjen dhe trajtimin e pluhurave dhe gazrave, me anë të filtrave, të cilat emetohen gjatë procesit të punës, dhe të realizojë mbylljen hermetike të mjedisit ku ushtron aktivitetin. Në këto kushte duhet të ishin dhënë detyra plotësuese me afate të përcaktuara kohe me qëllim evidentimin e plotësimit të tyre.
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: M. K, S. K, A. Xh.

2. Subjekti F 2020 me NIPT M.....U, Inspektimi nr. AKM-TR-2023-000309, me objekt inspektimi: *"Kontroll i zbatimit të kushteve të Vendimit për VNM Paraprake për projektin "Strukturë turistike 5 kat me 1 kat bodrum"*, Inspektorët: K. K, F. K.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit rezulton se subjekti "F 2020" SHPK, ndonëse është i pajisur me Vendim për VNM Paraprake nr. AN050520210002, datë 09.06.2021, nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të vërtetojë zbatimin e kushteve të këtij vendimi, si dhe nuk ka bashkëpunuar plotësisht gjatë procesit të inspektimit, në kundërshtim me nenin 26 të ligjit nr.

10440/2011 dhe nenin 48 të ligjit nr. 10433/2011. Në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit është vendosur dënim administrativ kryesor "Gjobë" në shumën 200,000 lekë, duke u hequr masa "*Paralajmërim"*, si dhe është përcaktuar detyrimi për raportimin mbi zbatimin e kushteve të Vendimit për VNM Paraprake dhe ruajtjen e dokumentacionit mjedisor në vendndodhje. Megjithatë, mungesa e një afati konkret për përmbushjen e kësaj detyre nuk mundëson verifikimin efektiv të zbatimit të saj.
Nga auditimi konstatohet se në listëverifikimi rubrikat me përgjigje *"Po/Jo"* nuk janë të plotësuara, në kundërshtim me pikën 26, Kreu V *"Lista e Verifikimit"*, të Urdhrit nr. 25, datë 10.08.2018 *"Për miratimin e rregullores 'Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ'"*, që përcakton se: *"Lista e verifikimit plotësohet nga trupa inspektuese gjatë ushtrimit të veprimtarisë inspektuese, pranë subjektit të inspektimit dhe nënshkruhet nga trupa inspektuese dhe subjekti."* Në lidhje me zhvillimin e projektit të pajisur me *"VNM paraprake"* ose *"Deklaratë Mjedisore"* është evidentuar se gjatë inspektimit në terren subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion lidhur me zbatimin e kushteve të përcaktuara.
Në procesverbalin e datës 12.01.2024 është evidentuar shkelja se subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion lidhur me kushtet e *"VNM-së paraprake"*. Në seksionin e kundërvajtjeve administrative është vendosur dënimi administrativ kryesor *"gjobë"* në shumën 200,000 lekë si dhe masa *"Paralajmërim"*.
Për përmirësimin e shkeljeve të konstatuara është lënë detyra: *"Subjekti 'F. 2020' sh.p.k të dorëzojë pranë Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër të gjithë dokumentacionin lidhur me Vendimin për VNM Paraprake për projektin 'Strukturë turistike 5 kat me 1 kat bodrum'."* Gjithastu procesverbali nuk është plotësuar në të gjitha rubrikat përkatëse, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 45 të ligjit nr. 10433/2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, i cili përcakton se procesverbali duhet të përmbajë informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit.
Në vendimin përfundimtar të inspektimit, për shkeljet e konstatuara në procesverbal është vendosur dënimi administrativ kryesor *"gjobë"* në shumën 200,000 lekë, ndërsa masa *"Paralajmërim"* është hequr. Për përmirësimin e shkeljeve është përcaktuar se: *"Subjektit i lihet detyrë që të raportojë mbi zbatimin e kushteve të shkruara e të miratuara në Vendimin për VNM Paraprake si dhe dokumentacionin mjedisor ta ruajë në vendndodhje për t'u vendosur në dispozicion të autoritetit kompetent në momentin e inspektimit"*, **pa u përcaktuar një afat konkret për realizimin e kësaj detyre, çka nuk mundëson verifikimin në kohë të përmbushjes së saj.** Nga ana e ARM Tiranë nuk rezulton te jetë kryer riinspektim në terren për të verifikuar dhe kontrolluar zbatimin e masave lidhur me shkeljet e konstatuara gjatë inspektimit.
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: K. K, F. K.

3. Subjekti P me NIPT K.....A, Inspektimi nr. AKM-TR-2022-000007, me objekt inspektimi: "*Urdhër nga Drejtori i Përgjithshëm nr. 25 date 07.02.2022 "Për ngritjen e grupeve të punës për evidentimin e problematikave mjedisore të veprimtarive minerare me karrierë (guroret) në territor"*, Inspektorët: G. T, E. D.
Sipas listë verifikimit evidentohet se rezulton se, subjekti është në gjendje pune dhe disponon leje mjedisore me legjislacion të shfuqizuar (PN-4330-11-2012), subjekti ka kryer pagesën e garancisë financiare për rehabilitimin e mjedisit, ndërkohë që, në zbatim të VKM nr. 419, datë 25.06.2014, duhet të fillojë procedurat për pajisjen me leje mjedisore sipas legjislacionit në fuqi. Në vijim, në përputhje me urdhrin e sipërcituar, subjektit i është lënë detyrë që brenda 20 ditëve nga data e njoftimit të procesverbalit të inspektimit të hartojë dhe dorëzojë pranë AKM planin e rehabilitimit, si dhe të kryejë rehabilitimin e sipërfaqes së shfrytëzuar brenda një afati 6-mujor.

Nga auditimi konstatohet se rubrikat listëverifikimit janë të paplotësuara në kundërshtim me pikën 26, Kreu V "*Lista e Verifikimit*", të Urdhrit nr. 25, datë 10.08.2018 "*Për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ*". Në procesverbal nuk specifikohet shkelja konkrete por referenca ligjore e saj dhe gjithashtu evidentohet se procesverbali është i paplotësuar në të gjitha rubrikat përkatëse në kundërshtim me me pikën 3 të nenit 45 të ligjit nr. 10433/2011*"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* i cili përcakton se procesverbali duhet të përmbajë informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit. Në seksionin e kundërvajtjeve administrative është vendosur *"Gjobë"* në shumën 500,000 lekë dhe *"paralajmërim".* Në referencë për këto dënime janë marrë pika 1/b (ii) e nenit 29, të ligjit nr. 10448 *"Për lejet e mjedisit"* dhe pika 1 e nenit 48 të ligjit nr. 10433 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".* Pavarësisht nga dënimi i parashikuar në shkronjat "b" dhe "c" të pikës 1 të këtij neni, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, me propozimin e Inspektoratit Shtetëror Kompetent, mund t'i propozojë ministrit pezullimin apo revokimin e lejes përkatëse të mjedisit për të gjithë veprimtarinë apo pjesë të saj. Për përmirësimin e shkeljeve të konstatuara është lënë masa: *"Brenda 20 ditëve nga data e njoftimit të procesverbalit të inspektimit subjekti duhet të marrë masa për hartimin e planit të rehabilitimit dhe dorëzimin e tij pranë AKM, si dhe kryerjen e rehabilitimit të sipërfaqes së shfrytëzuar brenda afatit 6 mujor".*

Në lidhje më këtë masë, për përmirësimin e shkeljeve, konstatohet se nga ARM Tiranë nuk është kryer riinspektim në lidhje me korrigjimin dhe ndjekjen e shkeljeve të lëna nga inspektimi, në kundërshtim me pikat 15-17, kreu IV të Urdhrit e Inspektoratit Qendror nr. 25, datë 10.08.2018, për miratimin e rregullores *"Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve si një proces i rregullt administrativ".*

Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: G.T, E. D.

Në vijim të procedurës së mësipërme grupi i auditimit verifikoi inspektimin e radhës për këtë subjekt, si në vijim:

4. Subjekti P me NIPT K.....A, Inspektimi me nr. AKM-TR-2022-000075, objekti i inspektimit***:*** *"Në zbatim të urdhrit nr. 210, datë 22.09.2022, "Për ngritjen e grupit të punës mbi shqyrtimin e ankesës për ndotjen e shkaktuar nga aktivitetet ekonomike që zhvillohen pranë fshatit Pëllumbas", mbi bazën e "informacionit/indicieve të paraqitura nga palë të treta"*, Inspektorët: A. K, I. A.

Nga listëverifikimi rezulton se gjatë verifikimit në terren subjekti nuk ka vënë në dispozicion lejen mjedisore të tipit B, në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Në procesverbalin e datës 17.10.2022 nuk është formuluar qartë dhe në mënyrë koncize gjetja, pasi është përdorur një formulim i përgjithshëm pa specifikuar shkeljen konkrete, si dhe nuk është parashikuar asnjë dënim administrativ kryesor apo plotësues. Në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit, gjetja nuk paraqitet në mënyrë eksplicite, ndërkohë që është vendosur dënim administrativ kryesor "Gjobë" në shumën 500,000 lekë, në mbështetje të nenit 29 të ligjit nr. 10448/2011, si dhe është përcaktuar dënim administrativ plotësues i njëjtë me atë të procesverbalit, duke evidentuar mospërputhje midis akteve të inspektimit dhe mungesë qartësie në arsyetimin e vendimmarrjes.

Nga verifikimi në QKB, në regjistrin e lejeve të subjektit, [13]rezulton se nga kërkimi me NIPT të subjektit paraqiten tri leje:

- *PN-4330-11-2012, datë lëshimi 06.11.2012, gjendja: Revokuar;*
- *PN-4322-11-2012, datë lëshimi 02.11.2012, gjendja: Revokuar;*
- *PN-3023-02-2012, datë lëshimi 27.02.2012, gjendja: Aktive.*

[13] Licencat/lejet e lëshuara nga QKB – QKB

Për sa më sipër, subjekti nuk ka azhornuar asnjë prej lejeve në kundërshtim me detyrat e lëna për korrigjimin e shkeljeve të konstatuara në Vendimin përfundimtar të Inspektimit nr. AKM TR-2022-000007-5, datë 01.04.2022. Në inspektimin në vijim (nr. çështjeje AKM-TR-2022-000075), subjekti rezulton në përsëritje të shkeljes së konstatuar, ndaj të cilit duhet të ishte aplikuar gjoba maksimale sipas pikës 1/a (ii), ku përcaktohet: *"Zhvillimi i veprimtarisë që është subjekt i një lejeje mjedisi të tipave A, B ose C, sipas përcaktimeve të këtij ligji: pa lejen përkatëse të mjedisit të tipit B, dënohet me gjobë në vlerën nga 500,000 deri në 1,000,000 lekë."*
Nga auditimi konstatohet se nuk është përcaktuar një afat konkret për përmirësimin e shkeljeve të konstatuara dhe gjithashtu nuk rezulton të jetë kryer ri-inspektim në terren për të verifikuar zbatimin e detyrave të lëna dhe përmirësimin e shkeljeve të evidentuara gjatë inspektimit, në kundërshtim me pikën 14, Kreu IV *"Korrigjimi dhe ndjekja e shkeljeve të lëna nga inspektimi"*, të Urdhrit nr. 25, datë 10.08.2018 *"Për miratimin e rregullores 'Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ'"*.
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: A.K, I.A.

5. Subjekti R SH.P.K me NIPT J.....E, Inspektimi me nr. AKM-TR-2021-000082, Objekti i inspektimit: "*Kontrolli e kushteve të lejes mjedisore në përputhje me dispozitat e legjislacioni mjedisor. Kontrollin e të gjitha llojeve të mbetjeve të gjeneruara në këtë instalim dhe mënyrën e trajtimit të tyre. Kontrollin dhe vlerësimin e masave për menaxhimin e mjedisit nga ana e veprimtarisë. Kontrollin e përmbushjes të standardeve të cilësisë së mjedisit, verifikimin dhe vlerësimin e çdo raporti të paraqitur nga operatori i veprimtarisë*.", Inspektorët: B. C, I. A.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit rezulton se subjekti nuk ka plotësuar RrShTN, nuk ka paraqitur kontrata dhe dokumentacion për transferimin e mbetjeve, si dhe nuk ka siguruar sistem për menaxhimin e ujërave të bardha, në kundërshtim me ligjin nr. 10448/2011, nr. 10463/2011 dhe nr. 10433/2011. Në procesverbal janë vendosur disa gjoba dhe masa "*Paralajmërim",* ndërsa në Vendimin Përfundimtar masa është reduktuar në një gjobë prej 1,500,000 lekë, duke u lënë detyra për korrigjimin e shkeljeve.
Nga verifikimi i procesverbalit me nr. AKM-TR-2021-000082-2, datë 22.07.2021, konstatohet se paraqiten mangësi në plotësimin e rubrikave përkatëse, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 45 të ligjit nr. 10433/2011 "*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*", i cili përcakton se: *"procesverbali duhet të përmbajë informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit."*
- Nga auditimi i Listës së Verifikimit nr. AKM-TR-2021-000082-2/2, datë 22.07.2021, konstatohet se subjekti ka deklaruar se ka aplikuar për t'u pajisur me leje përkatëse për përdorimin e ujit dhe për shkarkimet e lëngshme, duke paraqitur kërkesë pranë organeve të menaxhimit të burimeve ujore, konkretisht pranë ish-ABU Erzen. Megjithatë, nga verifikimi në sistemin e inspektimit nuk evidentohet kërkesa përkatëse e subjektit.
Në këto kushte rezulton se subjekti ka ushtruar aktivitetin duke realizuar shkarkime në tokë apo në gropa septike pa qenë i pajisur me lejen ose autorizimin përkatës, në kundërshtim me ligjin nr. 111/2012 "*Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore",* i cili në nenin 73, pika 1 përcakton se: *"Shkarkimet në ujë, tokë, nëntokë bëhen me leje ose autorizim, të lëshuar nga organet e menaxhimit dhe administrimit të burimeve ujore, në përputhje me legjislacionin në fuqi."*
Për rrjedhojë, subjekti ndodhet në kushtet e kundërvajtjes administrative të parashikuar në nenin 97, pika 16 të ligjit nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", sipas së cilës: *"Shkarkimet në ujë, tokë, nëntokë apo në gropa, pa miratimin e lëshuar nga organi i menaxhimit të burimit ujor, parashikuar në pikën 1 të nenit 73 të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 500,000 lekë deri në 1,000,000 lekë.*". Në këtë kontekst, nga ana e

strukturave përgjegjëse të inspektimit duhej të ishte vendosur sanksioni administrativ përkatës, pasi aplikimi i pretenduar nga subjekti, i paevidentuar në sistem dhe i pambështetur me dokumentacion zyrtar, nuk përbën rrethanë përjashtuese nga përgjegjësia administrative.
Nga auditimi konstatohet gjithashtu se nuk është përcaktuar një afat konkret për përmirësimin e shkeljeve të konstatuara dhe nuk rezulton të jetë kryer ri-inspektim në terren për të verifikuar zbatimin e detyrave të lëna dhe përmirësimin e shkeljeve të evidentuara gjatë inspektimit, në kundërshtim me pikën 14, Kreu IV *"Korrigjimi dhe ndjekja e shkeljeve të lëna nga inspektimi"*, të Urdhrit nr. 25, datë 10.08.2018 *"Për miratimin e rregullores 'Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ'"*, e cila përcakton se: *"Në rastet e inspektimeve të programuara, subjekti, objekt inspektimi urdhërohet të korrigjojë shkeljet e konstatuara, duke përcaktuar dhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim. Procesverbali i inspektimit dhe vendimi përfundimtar përfshin këshillimin (rekomandimet) me shkrim të subjektit për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve dhe afatet kohore."*
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: B. C, I. A.

6. Subjekti B me NIPT J.....C, Inspektimi me nr. AKM-TR-2021-000006, me objekt inspketimi: *"Dyshimi i arsyeshëm për shkeljen e kërkesave ligjore nga monitorimi periodik"*, Inspektorët: J. Zh, A. K.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit rezulton se subjekti nuk ka paraqitur informacion mbi mbetjet e gjeneruara dhe regjistrin e mbetjeve, si dhe nuk ka dokumentacion për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme, në kundërshtim me ligjin nr. 10463/2011, ligjin nr. 10448/2011 dhe ligjin nr. 10433/2011. Në procesverbal janë vendosur dënime administrative *"Gjobë"* në vlerat 1,000,000 lekë dhe 300,000 lekë, si dhe *"Paralajmërim",* ndërsa në Vendimin Përfundimtar është mbajtur vetëm dënimi administrativ kryesor "*Gjobë*" në shumën 1,000,000 lekë.
Nga auditimi, konstatohet se në procesverbal nuk specifikohet shkelja konkrete, por vetëm referenca ligjore përkatëse, si dhe evidentohet se procesverbali është i paplotësuar në rubrikat përkatëse, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 45 të ligjit nr. 10433/2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", i cili përcakton se: *"procesverbali duhet të përmbajë informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit."* Gjithashtu, në vendimin përfundimtar të inspektimit nuk është arsyetuar lënia në fuqi vetëm e një prej dënimeve administrative të evidentuara në procesverbal. Konkretisht, nga tre masa administrative të evidentuara në procesverbal, është mbajtur vetëm gjoba në vlerën 1,500,000 lekë, ndërsa është hequr masa *"paralajmërim*" dhe masa administrative në vlerën 300,000 lekë, pa u dhënë argumentim apo arsyetim mbi ndryshimin e vendimmarrjes administrative
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: J.Zh, A.K.

7. Subjekti P. D me NIPT J.....H, Inspektimi me nr. AKM-TR-2023-000104, me objekt inspektimi: *"Kontrollin e kushteve të lejes mjedisore në përputhje me dispozitat e legjislacionit mjedisor; kontrollin e mjediseve dhe të pajisjeve përkatëse; kontrollin e të gjitha mbetjeve të gjeneruara në këtë instalim dhe mënyrën e trajtimit të tyre; kontrollin dhe vlerësimin e masave për menaxhimin e mjedisit nga ana e veprimtarisë; si dhe kontrollin, verifikimin dhe vlerësimin e çdo raporti të paraqitur nga operatori i veprimtarisë."*, Inspektorët: M. K, G. T.
Nga inspektimi sipas listëverifikimit janë evidentuar mangësitë si në vijim:

- Referuar kushtit 2 të lejes mjedisore *"Menaxhimi i instalimit",* subjekti nuk ka vënë në dispozicion Regjistrin për RrShTN[14].
- Referuar kushtit 7.2, subjekti nuk ka kryer matje për elementët e përcaktuar në lejen mjedisore, mungojnë matjet për produktet e naftës, kromin gjashtëvalent, kromin total, plumbin, benzapirenin dhe sulfidet.
- Referuar kushtit 7.2, subjekti nuk trajton paraprakisht ujërat teknologjike të gjeneruara nga proceset e asgjësimit të vajrave të përdorur dhe mbetjeve me përmbajtje hidrokarbure, përpara shkarkimit të tyre në rrjetin e kanalizimeve.
- Referuar kushtit 8, dokumentet e transferimit për mbetjet urbane janë të pavlefshme; nuk janë vënë në dispozicion dokumentet e plota për transferimin e mbetjeve të rrezikshme, si dhe kontratat për grumbullimin e mbetjeve dhe për trajtimin e hidrokarbureve me subjekt të licencuar.
- Referuar kushtit 12 *"Dokumentimi dhe raportimi",* subjekti, megjithëse ka të dokumentuar mënyrën dhe shpeshtësinë e raportimit, nuk ka vënë në dispozicion Regjistrin për RrShTN.

Sipas procesverbalit të inspektimit, dokumentohet se janë marrë 3 mostra, secila me vëllim 1.5 litra, nga shkarkimet e ujërave të ndotura, si më poshtë:

1 Mostra e parë është marrë në pikën e shkarkimit të përcaktuar në kushtet e lejes mjedisore, sipas koordinatave të dhëna në lejen e mjedisit.

2. Mostra e dytë është marrë në pusetën e daljes së ujërave të shkarkimit në rrjetin e kanalizimeve, jashtë rrethimit të veprimtarisë.

3. Mostra e tretë është marrë në mjedisin ujor pritës, konkretisht në kanalin kryesor të zonës.

Në seksionin e gjetjeve të konstatuara janë evidentuar gjetjet sipas listë verifikimit. Në seksionin e kundërvajtjeve administrative është vendosur dënim administrativ kryesor:

- gjobë 300,000 lekë;
- gjobë 500,000 lekë.

Ndërkohë, në Vendimin përfundimtar të inspektimit nuk është përcaktuar qartë gjetja e konstatuar, por është shënuar se: "*Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore: Ligji nr. 10448, datë 14.07.2011, "Për Lejet e Mjedisit", i ndryshuar, neni 29, pika 1/b/i"*, pa u konkretizuar shkelja specifike dhe pa u dhënë argumentimi i nevojshëm si vendim administrative se si nga dy masat e propozuara, në përfundim është lënë në fuqi vetëm një dënim administrativ kryesor, konkretisht gjobë në shumën 300,000 lekë. Grupi i auditimit verifikoi shkeljet sipas listëverifikimit dhe bëri lidhjen me bazën ligjore nga ku situata paraqitet si në vijim:

Referuar kushtit 2 "*Menaxhimi i instalimit*", mbi rregjistrin për RrShTN, sipas përcaktimeve të nenit 32 i ligjit nr. 10431, kundërvajtja administrative e parashikuan në nenin 69, pika 1/a është; *"mosdhënia e informacionit për shkarkimin dhe transferimin e ndotësve nga operatori, sipas përcaktimit të nenit 32 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 300,000 lekë deri në 500,000 lekë, duke u shtuar me vlerën 10 për qind të gjobës për çdo ditë vonesë, deri në plotësimin e detyrimit";*

- Referuar kushtit 7.2, subjekti nuk ka kryer matje për elementët e përcaktuar në lejen mjedisore; mungojnë matjet për produktet e naftës, kromin gjashtëvalent, kromin total, plumbin, benzapirenin dhe sulfidet është shkelje e një prej kushteve të lejes në kundërshtim me nenin 29 pika 1/b (ii) ku parashikohet: *"Mos përmbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipave A, B apo C nga operatori i një instalimi" ii) "për lejet e mjedisit të tipit B, dënohet me gjobë në vlerën nga 300,000 deri në 500,000 lekë".*

[14] **RrShTN** – *Regjistri për Raportimin e Shkarkimeve dhe Transferimeve të Ndotësve*, sipas përkufizimit të nenit 32 të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011, *"Për mbrojtjen e mjedisit*".

Referuar kushtit 8 sipas listë verifikimit subjekti disponon kontratë për mbetjet urbane me Landfillin Tiranë *"I. E. BV SPV"* shpk. Dokumentet e transferimit për mbetjet urbane janë të pavlefshme pasi nuk janë të plotësuara sipas formatit të miratuar. Ky veprim është në kundërshtim, me pikën 7 të nenit 21 të ligjit 10463, ku për këtë shkelje në pikë 6 të nenit 62 të ligjit parashikohet se: *"Çdo person, që transferon mbetje jo të rrezikshme apo që merr mbetje jo të rrezikshme pa një dokument transferimi mbetjesh, në kundërshtim me nenin 21 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1,000,000 (një milion) deri në 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë".*
Gjithashtu në Vendimin përfundimtar të inspektimit është vendosur Dënim Administrativ plotësues "*Pezullim i shkarkimeve të ujërave të ndotura që dalin nga procesi teknologjik i aktivitetit, deri në trajtimin e tyre dhe shkarkimin në mjedisin ujor pritës vetëm pasi të jenë brenda normave të lejuara, sipas legjislacionit në fuqi. Subjekti të marrë masa organizative dhe teknike për vendin e stacionimit të autoboteve që kryejnë shkarkimin e ujërave të ndotura të grumbulluara drejt tankerëve të depozitimit brenda subjektit, në mënyrë që të shmangen ndotjet e pakontrolluara".* Në lidhje me dënimin plotësues nuk evidentohet të jetë kryer ri inspektim, në kundërshtim me pikat 15-17, kreu IV të Urdhrit e Inspektoratit Qendror nr. 25, datë 10.08.20218, për miratimin e rregullores *"Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve si një proces i rregullt administrativ"*, ku përcaktohet:
15. Subjekti, objekt inspektimi, është i detyruar të njoftojë për korrigjimin e shkeljeve, brenda afatit të përcaktuar nga trupa inspektuese në vendimin përfundimtar të inspektimit, të mëparshëm dhe nëse është e nevojshme të paraqesë edhe provat që vërtetojnë këtë fakt.
16. Për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve të konstatuara nga trupa inspektuese, kryhet një inspektim i ri. Në rastet kur nga ri inspektimi rezulton se subjekti nuk ka zbatuar detyrat e lëna nga inspektimi i mëparshëm, procedohet me masë administrative.
17. Procedura e inspektimit dhe ri inspektimit kryhen online në portalin e-Inspektimi.
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: M. K, G. T.

8. Subjekti B SH.P.K me NIPT L.....F, Inspektimi me nr. AKM-TR-2021-000005, me objekt inspektimi: "*Dyshimi i arsyeshëm për shkeljen e kërkesave ligjore nga monitorimi periodik."*, Inspektorët: J. Zh, A. K.
Nga inspektimi, sipas listëverifikimit dhe procesverbalit, janë evidentuar mangësi në lidhje me mosparaqitjen e raporteve të vetëmonitorimit 6-mujor dhe vjetor, mungesën e pagesës së tarifës vjetore, mungesën e regjistrit të shkarkimeve të ndotësve, si dhe mungesën e informacionit mbi shkarkimet në ajër, ujë, zhurmat dhe menaxhimin e mbetjeve, në kundërshtim me kërkesat e lejes mjedisore dhe legjislacionit në fuqi. Në lidhje me këto shkelje, në procesverbalin e inspektimit janë parashikuar masa administrative me "*Gjobë*" në vlerën 500,000 lekë dhe "*Paralajmërim"*, ndërsa në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit është hequr gjoba dhe është vendosur vetëm masa administrative "*Paralajmërim",* duke evidentuar mospërputhje midis procesverbalit dhe vendimit përfundimtar dhe pa e argumentuar ndryshimin e masës administrative.
Nga verifikimi i procesverbalit me nr. AKM-TR-2021-000005-2, datë 24.05.2021, konstatohet se paraqiten mangësi në plotësimin e rubrikave përkatëse, në kundërshtim me pikën 3, nenin 45 të ligjit nr. 10433/2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", i cili përcakton se *"procesverbali duhet të përmbajë informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit."* Me shkresën pa numër protokolli, datë 31.05.2021, subjekti "B." sh.p.k. ka paraqitur kontestime dhe dokumentacion shtesë lidhur me inspektimin e kryer nga trupa inspektuese. Nga auditimi i praktikës së administruar rezulton se dokumentacioni i depozituar nga subjekti është përgatitur dhe paraqitur pas konstatimit të

shkeljeve nga ana e trupës inspektuese dhe, për rrjedhojë, nuk mund të konsiderohet si element që përjashton apo zbut përgjegjësinë administrative për shkeljet e konstatuara gjatë inspektimit.
Gërma "b (ii)", pika 1, neni 29 i ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se *"mos përmbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipit A, B apo C nga operatori i një instalimi"* përbën kundërvajtje administrative dhe, konkretisht, për lejet e mjedisit të tipit B, ndëshkohet me gjobë në vlerën nga 300,000 deri në 500,000 (treqind mijë deri në pesëqind mijë) lekë.
Në këto kushte, vendosja e masës administrative *"paralajmërim"* nga trupa inspektuese nuk është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, pasi shkeljet e konstatuara janë të parashikuara shprehimisht nga ligji si kundërvajtje administrative dhe duhet të ndëshkohen me masën administrative të gjobës, sipas intervalit të përcaktuar në gërmën "b (ii)", pikën 1, nenin 29 të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011, i ndryshuar.
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: J. Zh, A.K.

9. Subjekti XH me NIPT J.....O, Inspektimi me nr. AKM-TR-2021-000055, me objekt inspektimi:"*Kontrolli i kushteve të lejes mjedisore në përputhje me dispozitat e legjislacionit mjedisor. Kontrolli i të gjitha llojeve të mbetjeve të gjeneruara në këtë instalim dhe mënyrën e trajtimit të tyre. Kontrolli dhe vlerësimi i masave për menaxhimin e mjedisit nga ana e veprimtarisë. Kontrolli i përmbushjes së standardeve të cilësisë së mjedisit, verifikimin dhe vlerësimin e çdo raporti të paraqitur nga operatori i veprimtarisë",* Inspektorët: F. M, M. K.
Nga inspektimi, sipas listëverifikimit dhe procesverbalit, janë evidentuar mangësi në lidhje me mosparaqitjen e dokumentacionit për Regjistrin e Shkarkimeve dhe Transferimit të Ndotësve (RrShTN), mungesën e sistemeve për kontrollin e shkarkimeve në ajër (spërkatje/rrjeta uji për kapjen e pluhurave), mungesën e sistemit të kanalizimeve për ujërat e ndotura dhe sipërfaqësore, si dhe mungesën e një vendi të përcaktuar për depozitimin dhe menaxhimin e mbetjeve brenda territorit të aktivitetit, në kundërshtim me kushtet e lejes mjedisore dhe legjislacionin përkatës në fuqi. Në lidhje me këto shkelje, në procesverbalin e inspektimit janë parashikuar masa administrative me disa gjoba (tre në vlerën 500,000 lekë dhe një në vlerën 1,000,000 lekë), si dhe masa "*Paralajmërim".* Ndërkohë, në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit këto masa nuk janë reflektuar në të njëjtën mënyrë, pasi të gjitha gjobat janë hequr dhe ndaj subjektit është vendosur vetëm masa administrative *"Paralajmërim*", duke evidentuar mospërputhje midis procesverbalit dhe vendimit përfundimtar.
Nga auditimi i dokumentacionit të inspektimit konstatohet se, ndonëse në procesverbalin e inspektimit, në seksionin e kundërvajtjeve administrative, janë evidentuar shkelje konkrete dhe të përsëritura të kushteve të lejes mjedisore, të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative të parashikuara shprehimisht nga legjislacioni mjedisor në fuqi, në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit është ndryshuar në mënyrë thelbësore trajtimi administrativ i këtyre shkeljeve.
Konkretisht, katër dënime administrative kryesore me masën "*Gjobë*", përkatësisht në vlerat 500,000 lekë, 500,000 lekë, 500,000 lekë dhe 1,000,000 lekë, të vendosura në procesverbalin e inspektimit në përputhje me shkeljet e konstatuara dhe me dispozitat përkatëse të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 "*Për lejet e mjedisit*", ligjit nr. 162/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis", ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 "*Për mbrojtjen e mjedisit*" dhe ligjit nr. 9115, datë 24.07.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura", janë hequr pa u shoqëruar me arsyetim ligjor, analizë të fakteve apo vlerësim të proporcionalitetit të masës administrative.
Nga shqyrtimi i vendimit përfundimtar konstatohet se ndaj subjektit është vendosur vetëm masa administrative kryesore "*Paralajmërim",* pa u argumentuar pse shkeljet e konstatuara konsiderohen si shkelje të një rëndësie të vogël, siç parashikohet në nenin 48 të ligjit nr. 10433,

datë 16.06.2011 "*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* dhe pa u justifikuar juridikisht zëvendësimi i gjobave me këtë masë më të lehtë.
Ky veprim nuk është në përputhje me natyrën dhe rëndësinë e shkeljeve të konstatuara, të cilat lidhen drejtpërdrejt me mosrespektimin e kushteve të lejes mjedisore, mungesën e sistemeve të kontrollit të ndotjes dhe mangësitë në menaxhimin e mbetjeve. Në këto kushte, konstatohet se heqja e masave administrative me gjobë dhe vendosja vetëm e masës *"Paralajmërim"* është e paargumentuar dhe formale, në mospërputhje me shkeljet konkrete të evidentuara gjatë inspektimit, duke cenuar zbatimin e drejtë dhe të njëtrajtshëm të legjislacionit mjedisor dhe parimin e ligjshmërisë në veprimtarinë inspektuese
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: F. M, M. K.

10. Subjekti XH me NIPT J.....O, Inspektimi me nr. AKM-TR-2021-000105, me objekt inspektimi: "*Informacion/Indicio nga palët e treta",* Inspektorët: F. M, M. K.
Nga inspektimi, sipas listëverifikimit dhe procesverbalit, janë evidentuar mangësi në lidhje me menaxhimin e mbetjeve, konkretisht për gjenerimin e llumrave nga proceset teknologjike pa sigurimin e grumbullimit dhe trajtimit nga subjekte të licencuara, si dhe për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme (vajra të përdorura) të krijuara nga shërbimet e mirëmbajtjes së mjeteve, pa kontrata me operatorë të licencuar, në kundërshtim me legjislacionin për ujërat e ndotura dhe menaxhimin e mbetjeve. Në lidhje me këto shkelje, në procesverbalin e inspektimit janë parashikuar masa administrative me gjobë në vlerën 500,000 lekë dhe gjobë në vlerën 1,000,000 lekë, si dhe janë lënë detyra konkrete për lidhjen e kontratave me subjekte të licencuara për trajtimin e llumrave dhe mbetjeve të rrezikshme. Ndërkohë, në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit këto masa nuk janë reflektuar, pasi gjobat janë hequr dhe nuk është vendosur asnjë dënim administrativ, duke krijuar mospërputhje ndërmjet procesverbalit dhe vendimit përfundimtar.
Nga verifikimi i dokumentacionit të inspektimit, gjetjeve të konstatuara në procesverbal dhe vendimit përfundimtar të inspektimit, konstatohet se heqja e masave administrative gjobë ndaj subjektit XH është kryer pa argumentim ligjor dhe në kundërshtim me dispozitat përkatëse të legjislacionit mjedisor në fuqi.
Referuar pikës 13, nenit 62 të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 *"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"* përcaktohet se: *"Çdo person, që prodhon, grumbullon, transporton, magazinon apo trajton mbetje të rrezikshme jo në përputhje me nenin 23 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1,000,000 (një milion) deri në 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë."*
Gjithashtu, pika 1, neni 23 i ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 *"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"* përcakton se: *"Krijimi, grumbullimi, transporti, magazinimi dhe trajtimi i mbetjeve të rrezikshme kryhen vetëm në kushte që sigurojnë mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut, në përputhje me këtë ligj."*
Në lidhje me administrimin mjedisor të ujërave të ndotura, gërma "b", pika 2, neni 23 i ligjit nr. 9115, datë 24.07.2003 *"Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura"* përcakton se: *"Mosrespektimi i kushteve dhe kërkesave të vendosura në lejet mjedisore për administrimin mjedisor të ujërave të ndotura e të përdorura"* përbën kundërvajtje administrative.
Ndërsa gërma "a", pika 1, neni 24 i ligjit nr. 9115, datë 24.07.2003 *"Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura"* parashikon se: *"Për kundërvajtjet administrative, të parashikuara në nenin 23 të këtij ligji, inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit jep dënim kryesor me gjobë nga 300,000 deri në 500,000 lekë."*
Në këto kushte, shkeljet e konstatuara gjatë inspektimit, që lidhen me gjenerimin dhe menaxhimin e llumrave si dhe me mbetjet e rrezikshme *(vajra të përdorura)*, janë shkelje të parashikuara

shprehimisht nga ligji si kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen me masë administrative gjobë, sipas intervaleve të përcaktuara në dispozitat përkatëse. Heqja e dënimeve administrative *"Gjobë"* në vlerën 500,000 lekë dhe *"Gjobë"* në vlerën 1,000,000 lekë në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit, pa arsyetim ligjor dhe pa analizë të fakteve, përbën veprim në kundërshtim me dispozitat e sipërcituara ligjore dhe cenon parimin e ligjshmërisë në veprimtarinë inspektuese.
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: F. M, M. K.

11. Subjekti P me NIPT K.....D, Inspektimi nr. AKM-TR-2023-000167, me objekt isnpektimi: "*Kontrollin e kushteve të lejes mjedisore në përputhje me dispozitat e legjislacioni mjedisor. Kontrollin e mjediseve dhe të pajisjeve përkatëse, kontrollin e të gjitha llojeve të mbetjeve të gjeneruara në këtë instalim dhe mënyrën e trajtimit të tyre. Kontrollin dhe vlerësimin e masave për menaxhimin e mjedisit nga ana e veprimtarisë. Kontrollin, verifikimin dhe vlerësimin e çdo raporti të paraqitur nga operatori i veprimtarisë*", Inspektorët: F. M, R. Xh, M. S.
Nga inspektimi, sipas listëverifikimit dhe procesverbalit, janë evidentuar mangësi të në lidhje me mosrespektimin e kushteve të lejes mjedisore dhe detyrimeve të raportimit, konkretisht për mosparaqitjen e pagesës së tarifës vjetore, raportit vjetor, planit të përputhshmërisë, raporteve periodike të monitorimit për disa kushte të lejes, mungesën e regjistrit të mbetjeve, si dhe mosdorëzimin e planit të çmontimit dhe rehabilitimit, në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Në lidhje me këto shkelje, në procesverbalin e inspektimit janë parashikuar masa administrative me dy gjoba në vlerën 500,000 lekë secila dhe masa "*Paralajmërim".* Ndërkohë, në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit këto masa nuk janë reflektuar në të njëjtën mënyrë, pasi është hequr një nga gjobat dhe është vendosur vetëm masa administrative "*Paralajmërim*", pa u shoqëruar me arsyetim ligjor apo analizë të fakteve, duke krijuar mospërputhje ndërmjet procesverbalit dhe vendimit përfundimtar. Për korrigjimin e shkeljeve, subjektit i janë lënë detyra për plotësimin e dokumentacionit të transferimit të mbetjeve sipas VKM-ve në fuqi, si dhe për realizimin në vijimësi të raporteve të vetëmonitorimit dhe raportit vjetor, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në lejen mjedisore.
Nga auditimi i dokumentacionit të mësipërm konstatohet se, ndonëse në procesverbalin e inspektimit dhe në seksionin e kundërvajtjeve administrative janë konstatuar shkelje konkrete dhe të përsëritura të kushteve të lejes mjedisore nga subjekti P, të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative të parashikuara shprehimisht nga legjislacioni mjedisor në fuqi, në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit është ndryshuar në mënyrë të pajustifikuar trajtimi administrativ i këtyre shkeljeve.
Konkretisht, gërma "b (ii)", pika 1, neni 29 i ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar, përcakton se: *"Mos përmbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipave A, B apo C nga operatori i një instalimi; për lejet e mjedisit të tipit B, dënohet me gjobë në vlerën nga 300,000 deri në 500,000 lekë."*
Nga gjetjet e konstatuara gjatë inspektimit rezulton se subjekti nuk ka paraqitur në momentin e inspektimit raportet periodike të monitorimit, raportin vjetor të mjedisit, pagesën e tarifës vjetore, si dhe planin e përputhshmërisë, duke mos përmbushur në mënyrë të vazhdueshme dhe të përsëritur kushtet e lejes mjedisore, çka e vendos subjektin në kushtet e kundërvajtjes administrative të parashikuar nga dispozita e sipërcituar.
Gjithashtu, pika 1 dhe pika 3, neni 23 i ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" përcakton se: "*Krijimi, grumbullimi, transporti, magazinimi dhe trajtimi i mbetjeve të rrezikshme kryhen vetëm në kushte që sigurojnë mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut, në përputhje me këtë ligj."*

Dhe "Leja e mjedisit për personat fizikë a juridikë, që krijojnë, grumbullojnë, transportojnë, magazinojnë apo trajtojnë mbetje të rrezikshme, përcakton kushtet që duhen përmbushur për të siguruar zbatimin e pikës 1 të këtij neni dhe përfshihet në kategorinë III.1 të shtojcës bashkëlidhur ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë"."

Mosrespektimi i këtyre kërkesave sanksionohet shprehimisht në pika 13, neni 62 i ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 "*Për menaxhimin e integruar të mbetjeve*", ku përcaktohet se:

"Çdo person, që prodhon, grumbullon, transporton, magazinon apo trajton mbetje të rrezikshme jo në përputhje me nenin 23 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1,000,000 (një milion) deri në 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë."

Nga shqyrtimi i Vendimit Përfundimtar të Inspektimit konstatohet se, pavarësisht ekzistencës së këtyre shkeljeve të parashikuara shprehimisht nga ligji si kundërvajtje administrative dhe të ndëshkueshme me gjobë, ndaj subjektit është vendosur vetëm masa administrative kryesore "*Paralajmërim",* pa u argumentuar në asnjë moment pse shkeljet e konstatuara konsiderohen si shkelje të një rëndësie të vogël, sipas pika 1, neni 48 i ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, dhe pa u justifikuar juridikisht zëvendësimi i masave administrative me gjobë me një masë më të lehtë.

Në këtë kontekst, grupi i auditimit vlerëson se heqja e dënimit administrativ kryesor "*Gjobë*" në vlerën 500,000 lekë dhe vendosja e vetëm një mase administrative "*Paralajmërim*" është e paargumentuar, formale dhe në mospërputhje me natyrën, shtrirjen dhe rëndësinë e shkeljeve të konstatuara, të cilat lidhen drejtpërdrejt me mosrespektimin e kushteve të lejes mjedisore, mangësitë në dokumentimin dhe raportimin mjedisor, si dhe në menaxhimin e mbetjeve.

Për rrjedhojë, konstatohet se veprimet e trupës inspektuese kanë cenuar zbatimin e drejtë dhe të njëtrajtshëm të legjislacionit mjedisor dhe parimin e ligjshmërisë në veprimtarinë inspektuese.

Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: F. M, R. Xh, M. S.

12. Subjekti L-E me NIPT K.....O, Inspektimi me nr. AKM-TR-2022-000011, me objekt inspektimi: "*Urdhër nga Drejtori i Përgjithshëm nr. 25 datë 07.02.2022 "Për ngritjen e grupeve të punës për evidentimin e problematikave mjedisore të veprimtarive minerare me karrierë (guroret) në territor*", Inspektorët: G. T dhe E. D.

Nga inspektimi, sipas listëverifikimit dhe procesverbalit, konstatohet se subjekti ka përmbushur detyrimin për pagesën e tarifës vjetore, ndërkohë që i është lënë detyrë hartimi dhe dorëzimi i planit të rehabilitimit pranë AKM-së brenda 20 ditëve nga njoftimi i procesverbalit, si dhe kryerja e rehabilitimit të sipërfaqes së shfrytëzuar brenda një afati 6-mujor.

Në procesverbalin inspektimit konstatohet se gjetja nuk është formuluar në mënyrë të qartë dhe eksplicite, por janë cituar vetëm referencat ligjore përkatëse, konkretisht ligji nr. 10448/2011 dhe ligji nr. 10433/2011, pa u bërë një përshkrim i drejtpërdrejtë i shkeljes së konstatuar.

Në lidhje me këtë situatë, në procesverbal janë parashikuar masa administrative me "*Gjobë"* në vlerën 500,000 lekë dhe "*Paralajmërim",* si dhe është përcaktuar detyrimi për marrjen e masave konkrete për rehabilitim, në përputhje me afatet e përcaktuara.

Gjithashtu nga auditimi konstatohet se, procesverbali nuk është plotësuar në të gjitha rubrikat përkatëse, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 45 të ligjit nr. 10433/2011*"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* i cili përcakton se procesverbali duhet të përmbajë informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit dhe nulk është nënshkruar nga trupa inspektuese dhe as nga personi i autorizuar i subjektit.

Sipas Vendimit Përfundimtar të inspektimit, shkeljet e konstatuara sipas listë verifikimit dhe procesverbalit janë trajtuar në kundërshtim me pikën 1 të nenit 48 të ligjit nr. 10433/2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*"(pa trajtuar shkeljen ne mënyrë konkrete, por thjesht është trajtuar si shkelje e një prej kushteve të lejes mjedisore), ndryshe nga procesverbali, ku shkelja ishte trajtuar dhe në kundërshtim me ligjin nr. 10448/2011 "*Për lejet e mjedisit*", si shkelje e një prej kushteve të lejes mjedisore. Në këto kushte, grupi i auditimit gjykon se, për shkelje të cilat rregullohen me ligj të posaçëm, duhet të aplikohej ligji specifik dhe jo ligji që rregullon procedurën e inspektimit. Gjithashtu, në Vendimin Përfundimtar mungon arsyetimi për heqjen e masës së gjobës në shumën 500,000 lekë, e cila është parashikuar në procesverbal.
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: G. T dhe E. D.

13. Subjekti L-E me NIPT K.....O, Inspektimi nr. AKM-TR-2023-000037, me objekt inspektimi: "*Zbatimi i kushteve të lejes mjedisore*", Inspektorët: M. K dhe I. A.
Nga inspektimi, sipas listëverifikimit, procesverbalit të inspektimit dhe vendimit përfundimtar, janë evidentuar mangësi në lidhje me mosrespektimin e kushteve të lejes mjedisore dhe detyrimeve të raportimit. Konkretisht, subjekti nuk ka paraqitur dokumentacionin mbi pagesën e tarifës vjetore të lejes mjedisore; nuk ka siguruar sinjalistikën siguruese dhe informuese në objektin minerar dhe operon me leje në format të vjetër të papërshtatur sipas kërkesave aktuale; nuk ka paraqitur Regjistrin e Shkarkimeve dhe Transferimit të Ndotësve (RrShTN); nuk ka paraqitur raportin vjetor të mjedisit dhe raportet e vetëmonitorimit; nuk ka paraqitur planin e përputhshmërisë dhe planin e menaxhimit të mbetjeve. Për më tepër, për një sërë kushtesh të tjera të lejes mjedisore nuk është dhënë përgjigje në listëverifikim për shkak të mungesës së raporteve të monitorimit, duke bërë të pamundur verifikimin e zbatimit të tyre në praktikë. Në procesverbalin e inspektimit, për këto mangësi janë cituar si baza ligjore pika 1/b (ii) e nenit 29 të ligjit nr. 10448/2011 dhe pika 1 e nenit 48 të ligjit nr. 10433/2011, ndërsa në seksionin e kundërvajtjeve administrative është parashikuar dënim administrativ me gjobë në vlerën 300,000 lekë dhe masa *"Paralajmërim*". Gjithashtu, janë përcaktuar detyra konkrete për subjektin, që lidhen me paraqitjen e të gjithë dokumentacionit të munguar pranë ARM-së, përfshirë raportet e vetëmonitorimit, raportin vjetor, pagesën e tarifës, planin e menaxhimit të mbetjeve, planin e përputhshmërisë dhe RrShTN, si dhe marrjen e masave për rishikimin e kushteve të lejes mjedisore për shkak të formatit të vjetruar të saj.
Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar rezulton se një pjesë e këtyre dokumenteve është paraqitur nga subjekti pas kryerjes së inspektimit, konkretisht raporti vjetor, raporti 6-mujor i vetëmonitorimit, dokumenti i pagesës së tarifës vjetore (si pagesë e prapambetur) dhe plani i rehabilitimit, çka konfirmon se në momentin e inspektimit subjekti nuk i përmbushte këto detyrime dhe ka reaguar vetëm pas konstatimit të shkeljeve.
Në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit, në kundërshtim me procesverbalin, është vendosur vetëm masa administrative "*Paralajmërim",* duke u hequr gjoba prej 300,000 lekë pa u dhënë arsyetim ligjor apo analizë e fakteve dhe provave të administruara. Kjo mospërputhje ndërmjet procesverbalit dhe vendimit përfundimtar evidenton mangësi në arsyetimin dhe qëndrueshmërinë e vendimmarrjes administrative, si dhe dobëson efektin ndëshkues dhe parandalues të masave të marra.
Gjithashtu, procesverbali nuk është plotësuar në të gjitha rubrikat përkatëse, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 45 të ligjit nr. 10433/2011*"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* i cili përcakton se procesverbali duhet të përmbajë informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit;
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar konstatohet se:

- Në lidhje me mangësitë në sinjalistikë dhe azhornimin e lejes mjedisore, siç përcaktohet në listë verifikim, subjekti nuk ka dërguar asnjë informacion.
- Në lidhje me pagesën e tarifës vjetore, dokumentacioni bashkëlidhur i referohet tarifës së vitit 2022. Për vitin 2023 nuk ka dokumentacion që të vërtetojë respektimin e afatit të pagesës, të përcaktuar në Lejen Mjedisore të tipit B nr. PN-8908-12-2014, datë 26.12.2014, ku, në zbatim të Vendimit nr. 417, datë 25.06.2014 "*Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit",* tarifa duhet të paguhet brenda tremujorit të parë të vitit.

Në zbatim të pikës 1, nenit 48 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"* është vendosur masa administrative *"paralajmërim"*. Megjithatë, në përmbajtje të procesverbalit nuk është dhënë argumentimi përkatës ligjor dhe faktik mbi arsyet pse shkelja e konstatuar është konsideruar si shkelje e një rëndësie të vogël, siç parashikohet shprehimisht nga dispozita në fjalë.

Në mungesë të një arsyetimi të qartë dhe të dokumentuar mbi karakterin e shkeljes si *"e një rëndësie të vogël"*, vendosja e masës administrative *"paralajmërim"* rezulton e paargumentuar dhe jo plotësisht në përputhje me kërkesat e pikës 1, nenit 48 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*.

Në lidhje me masat për përmirësimin e kërkesave ligjore, nga auditimi konstatohet se nuk është përcaktuar një afat konkret për përmirësimin e shkeljeve të konstatuara dhe gjithashtu nuk rezulton të jetë kryer ri-inspektim në terren për të verifikuar zbatimin e detyrave të lëna dhe përmirësimin e shkeljeve të evidentuara gjatë inspektimit, në kundërshtim me pikën 14, Kreu IV *"Korrigjimi dhe ndjekja e shkeljeve të lëna nga inspektimi"*, të Urdhrit nr. 25, datë 10.08.2018 *"Për miratimin e rregullores 'Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ"*, e cila përcakton se: *"Në rastet e inspektimeve të programuara, subjekti, objekt inspektimi urdhërohet të korrigjojë shkeljet e konstatuara, duke përcaktuar dhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim. Procesverbali i inspektimit dhe vendimi përfundimtar përfshin këshillimin (rekomandimet) me shkrim të subjektit për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve dhe afatet kohore."*

14. Subjekti: P. Q me NIPT L.....R, Inspektimi me nr. AKM-TR-2022-000020, me objekt inpektimi: "*Urdhër nga Drejtori i Përgjithshëm nr. 25 datë 07.02.2022 "Për ngritjen e grupeve të punës për evidentimin e problematikave mjedisore të veprimtarive minerare me karrierë (guroret) në territor"*, Inspektorët: J. Zh, A.B.

Nga inspektimi, sipas listëverifikimit dhe procesverbalit të inspektimit, janë evidentuar mangësitë si në vijim: subjekti nuk ka vënë në dispozicion Programin për Menaxhimin e Riskut dhe Planin e Përputhshmërisë; nuk ka paraqitur raportin 6-mujor të vetëmonitorimit për një sërë kushtesh të lejes mjedisore (kushtet 5, 6, 7.1, 7.2, 7.3, 7.4, 9, 11 dhe 12); nuk ka paraqitur planin e rehabilitimit të miratuar, si dhe nuk ka vënë në dispozicion planin vjetor. Këto mangësi tregojnë mosplotësim të detyrimeve për dokumentim, raportim dhe planifikim sipas kushteve të lejes mjedisore.

Në lidhje me këto shkelje, në procesverbalin e inspektimit janë cituar si baza ligjore pika 1/b (ii) e nenit 29 të ligjit nr. 10448/2011 dhe pika 1 e nenit 48 të ligjit nr. 10433/2011, ndërsa në seksionin e kundërvajtjeve administrative janë parashikuar masa me dy gjoba në vlerën 500,000 lekë dhe masa "*Paralajmërim*". Në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit, në kundërshtim me procesverbalin, është hequr gjoba në vlerën 500,000 lekë dhe ndaj subjektit është vendosur vetëm masa administrative "*Paralajmërim*", duke krijuar mospërputhje ndërmjet akteve të inspektimit dhe duke dobësuar qëndrueshmërinë e vendimmarrjes administrative.

Nga verifikimi i procesverbalit me nr. AKM-TR-2022-000020-2, datë 02.03.2022, konstatohet se paraqiten mangësi në plotësimin e rubrikave përkatëse, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 45 të

ligjit nr. 10433/2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, i cili kërkon që procesverbali të përmbajë informacion të plotë dhe të detajuar mbi veprimet e inspektimit, gjetjet dhe vendimet procedurale të marra. Me shkresën me nr. 318/1 prot., datë 24.03.2022, subjekti P. Q ka paraqitur kontestime dhe dokumentacion shtesë lidhur me inspektimin e kryer nga trupa inspektuese. Nga auditimi i praktikës së administruar rezulton se dokumentacioni i depozituar nga subjekti është përgatitur dhe paraqitur pas konstatimit të shkeljeve nga ana e trupës inspektuese dhe, për rrjedhojë, nuk mund të konsiderohet si element që përjashton apo zbut përgjegjësinë administrative për shkeljet e konstatuara gjatë inspektimit. Nga auditimi konstatohet se dokumentacioni është përgatitur nga E. S. P. sh.p.k më datë 07.03.2022.
Ligjvënësi, në shkronjën "b", nënndarjen "ii", pikën 1, të nenit 29 të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 *"Për lejet e mjedisit"*, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se mos përmbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipit A, B apo C nga operatori i një instalimi përbën kundërvajtje administrative dhe, konkretisht, për lejet e mjedisit të tipit B, ndëshkohet me gjobë në vlerën nga 300,000 deri në 500,000 (treqind mijë deri në pesëqind mijë) lekë. Kjo dispozitë ligjore është e qartë, e drejtpërdrejtë dhe nuk parashikon hapësirë diskrecioni për organin inspektues në lidhje me zëvendësimin e gjobës me një masë tjetër administrative. Për rrjedhojë, vendosja e masës administrative *"paralajmërim"* nga trupa inspektuese nuk është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, pasi shkeljet e konstatuara janë të parashikuara shprehimisht nga ligji si kundërvajtje administrative dhe duhet të ndëshkohen me masën administrative të gjobës, sipas intervalit të përcaktuar në ligj.
Nga auditimi konstatohet gjithashtu se, në lidhje me kushtin 8 të lejes mjedisore për menaxhimin e mbetjeve, trupa inspektuese nuk ka ushtruar verifikim mbi regjistrin e mbetjeve të gjeneruara, rikuperuara dhe magazinuara, si dhe nuk ka kërkuar evidencën e raportimeve periodike çdo 6 muaj pranë AKM-së, duke mos përmbushur detyrimin për kontrollin e dokumentimit dhe raportimit të kërkuar nga kuadri ligjor mjedisor.
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: J. Zh, A.B.

15. Subjekti S.U.i T me NIPT L.....E, Inspektimi me nr. AKM-TR-2023-000214, me objekt inspektimi: "*Kontrollin e kushteve të lejes mjedisore në përputhje me dispozitat e legjislacionit mjedisor, kontrollin e të gjitha llojeve të mbetjeve të gjeneruara në këtë instalim dhe mënyrën e trajtimit të tyre. Kontrollin dhe vlerësimin e masave për menaxhimin e mjedisit nga ana e veprimtarisë. Kontrollin e përmbushjes të standardeve të cilësisë së mjedisit, verifikimin dhe vlerësimin e çdo raporti të paraqitur nga operatori i veprimtarisë*", Inspektorët: B. C, E.B.
Nga inspektimi, sipas listëverifikimit dhe procesverbalit të inspektimit, janë evidentuar mangësi në lidhje me mosparaqitjen e dokumentacionit mjedisor, konkretisht për mosparaqitjen e pagesës së tarifës vjetore, raportit vjetor dhe planit të përputhshmërisë, si dhe për mungesën e dokumentacionit lidhur me menaxhimin e mbetjeve. Gjithashtu, për një sërë kushtesh të lejes mjedisore (kushtet 5, 6, 7.1, 7.2, 7.3, 7.4, 9, 11 dhe 12) nuk është bërë i mundur verifikimi i zbatimit të tyre, për shkak të mosparaqitjes së plotë dhe të rregullt të raporteve të vetëmonitorimit.
Në procesverbalin e inspektimit këto mangësi janë referuar si shkelje në kundërshtim me nenin 29 të ligjit nr. 10448/2011 dhe nenin 48 të ligjit nr. 10433/2011, ndërsa në seksionin e kundërvajtjeve administrative janë parashikuar masa me dy gjoba në vlerën 300,000 lekë dhe masa "*Paralajmërim".* Gjithashtu, subjektit i është lënë detyrë të paraqesë dokumentacionin mjedisor të plotë dhe të sigurojë zbatimin e kushteve të lejes mjedisore. Në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit, në kundërshtim me procesverbalin, është hequr gjoba në vlerën 300,000 lekë dhe është vendosur vetëm masa administrative *"Paralajmërim*", pa u dhënë një arsyetim i qartë ligjor, duke krijuar mospërputhje ndërmjet akteve të inspektimit. Për korrigjimin e shkeljeve, subjektit i janë

lënë detyra për plotësimin e dokumentacionit të transferimit të mbetjeve sipas VKM-ve në fuqi, si dhe për realizimin në vijimësi të raporteve të vetëmonitorimit dhe raportit vjetor, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në lejen mjedisore.
Nga auditimi i dokumentacionit të inspektimit konstatohet se, ndonëse në procesverbalin e inspektimit dhe në seksionin e kundërvajtjeve administrative janë konstatuar shkelje konkrete dhe të përsëritura të kushteve të lejes mjedisore nga subjekti S. U. i T., të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative të parashikuara shprehimisht nga legjislacioni mjedisor në fuqi, në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit është ndryshuar në mënyrë të pajustifikuar trajtimi administrativ i këtyre shkeljeve.
Konkretisht, shkronja "b", nënndarja "ii", pika 1, neni 29, ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 "*Për lejet e mjedisit*", i ndryshuar, përcakton se:
b) Mos përmbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipave A, B apo C nga operatori i një instalimi;
ii) për lejet e mjedisit të tipit B, dënohet me gjobë në vlerën nga 300,000 deri në 500,000.
Nga gjetjet e konstatuara gjatë inspektimit rezulton se subjekti nuk ka paraqitur në momentin e inspektimit raportet periodike të monitorimit, raportin vjetor të mjedisit, pagesën e tarifës vjetore, si dhe planin e përputhshmërisë, duke mos përmbushur në mënyrë të vazhdueshme dhe të përsëritur kushtet e lejes mjedisore, çka e vendos subjektin në kushtet e kundërvajtjes administrative të parashikuar nga dispozita e sipërcituar.
Gjithashtu, pika 1 dhe pika 3, neni 23, ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", përcakton se: "*1. Krijimi, grumbullimi, transporti, magazinimi dhe trajtimi i mbetjeve të rrezikshme kryhen vetëm në kushte që sigurojnë mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut, në përputhje me këtë ligj. Këto kushte përfshijnë masat që sigurojnë gjurmueshmërinë e mbetjeve që nga krijimi deri në destinacionin përfundimtar të tyre, si dhe kontrollin e mbetjeve të rrezikshme, me qëllim plotësimin e kërkesave të këtij ligji."*
"3. Leja e mjedisit për personat fizikë a juridikë, që krijojnë, grumbullojnë, transportojnë, magazinojnë apo trajtojnë mbetje të rrezikshme, përcakton kushtet që duhen përmbushur për të siguruar zbatimin e pikës 1 të këtij neni dhe përfshihet në kategorinë III.1 të shtojcës bashkëlidhur ligjit nr. 10 081, datë 23.02.2009 'Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë'."
Mosrespektimi i këtyre kërkesave sanksionohet shprehimisht në pika 13, neni 62, ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i cili përcakton se: "*Çdo person, që prodhon, grumbullon, transporton, magazinon apo trajton mbetje të rrezikshme jo në përputhje me nenin 23 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1,000,000 (një milion) deri në 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë."*
Nga shqyrtimi i Vendimit Përfundimtar të Inspektimit konstatohet se, pavarësisht ekzistencës së këtyre shkeljeve të parashikuara shprehimisht nga ligji si kundërvajtje administrative dhe të ndëshkueshme me gjobë, ndaj subjektit është vendosur vetëm masa administrative kryesore "*Paralajmërim*", pa u argumentuar në asnjë moment pse shkeljet e konstatuara konsiderohen si shkelje të një rëndësie të vogël, sipas pika 1, neni 48, ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe pa u justifikuar juridikisht zëvendësimi i masave administrative me gjobë me një masë më të lehtë.
Në këtë kontekst, grupi i auditimit vlerëson se heqja e dënimit administrativ kryesor "*Gjobë"* në vlerën 300,000 lekë dhe vendosja e vetëm një mase administrative "*Paralajmërim*" është e paargumentuar, formale dhe në mospërputhje me natyrën, shtrirjen dhe rëndësinë e shkeljeve të konstatuara, të cilat lidhen drejtpërdrejt me mosrespektimin e kushteve të lejes mjedisore, mangësitë në dokumentimin dhe raportimin mjedisor, si dhe në menaxhimin e mbetjeve.

Gjithashtu, me shkresën nr. 8903 prot., datë 25.10.2023, subjekti S. U. i T. ka paraqitur dokumentacion shtesë lidhur me inspektimin e kryer nga trupa inspektuese. Nga auditimi i praktikës së administruar rezulton se dokumentacioni i depozituar nga subjekti është përgatitur dhe paraqitur pas konstatimit të shkeljeve nga ana e trupës inspektuese dhe, për rrjedhojë, nuk mund të konsiderohet si element që përjashton apo zbut përgjegjësinë administrative për shkeljet e konstatuara gjatë inspektimit.
Për sa më sipër, konstatohet se veprimet e trupës inspektuese kanë cenuar zbatimin e drejtë dhe të njëtrajtshëm të legjislacionit mjedisor dhe parimin e ligjshmërisë në veprimtarinë inspektuese.
Në lidhje me masat për përmirësimin e kërkesave ligjore, nga auditimi konstatohet se nuk është përcaktuar një afat konkret për përmirësimin e shkeljeve të konstatuara dhe gjithashtu nuk rezulton të jetë kryer ri-inspektim në terren për të verifikuar zbatimin e detyrave të lëna dhe përmirësimin e shkeljeve të evidentuara gjatë inspektimit, në kundërshtim me pikën 14, Kreu *IV "Korrigjimi dhe ndjekja e shkeljeve të lëna nga inspektimi", të Urdhrit nr. 25, datë 10.08.2018 "Për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ"*", e cila përcakton se: *"Në rastet e inspektimeve të programuara, subjekti, objekt inspektimi urdhërohet të korrigjojë shkeljet e konstatuara, duke përcaktuar dhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim. Procesverbali i inspektimit dhe vendimi përfundimtar përfshin këshillimin (rekomandimet) me shkrim të subjektit për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve dhe afatet kohore."*
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: B.C, E. B.

16. Subjekti R. O. I me NIPT L.....A, Inspektimi me nr. AKM-TR-2022-000049, me objekt inspketimi: "*Në zbatim të urdhrit nr.207 datë 12.09.2022 për ngritjen e grupit të punës për shqyrtimin e ankesës së zotit E.T dhe zonjës L.T, mbi ndotjen e shkaktuar nga aktiviteti ekonomik pranë Portit të Durrësit Informacion/Indicio nga palët e treta*", Inspektorët: G.T dhe M. K.
Nga shqyrtimi i listë-verifikimit dhe dokumentacionit të inspektimit konstatohet se subjekti nuk disponon kontratë qiraje me Autoritetin Portual Durrës, duke ushtruar aktivitet në një sipërfaqe pa të drejtë të provuar përdorimi. Gjithashtu, ushtron aktivitet si stacion transferimi të mbetjeve pa qenë i pajisur me leje mjedisore përkatëse, në kundërshtim me nenin 29, pika 1/a/i, në lidhje me nenin 69 të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 "*Për lejet e mjedisit",* i ndryshuar. Në terren janë konstatuar mbetje të kategorive të ndryshme dhe goma të përdorura të shpërndara, si dhe mungesë e kushteve të kontrolluara për menaxhimin e tyre. Evidentohet mungesa e sistemit të kanalizimeve perimetrike dhe prania e ndotjes nga vajrat e derdhura në tokë, duke shkaktuar ndotje të mjedisit. Subjekti nuk ka njoftuar Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe nuk ka marrë masa për parandalimin dhe rehabilitimin e dëmit, në kundërshtim me nenin 50, pika 6, nenin 48 dhe nenin 69, pika 1/e të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar.
Për shkeljet e konstatuara, në procesverbal dhe në vendimin përfundimtar të inspektimit janë vendosur masa administrative, konkretisht gjobë në shumën 500,000 lekë, gjobë në shumën 1,000,000 lekë, si dhe *masë administrative "Paralajmërim". Në vijim, për përmirësimin e situatës është kërkuar që subjekti "Të paraqesë Kontratën e Qerasë për sipërfaqen e përdorur, të fillojë procedurat për t'u pajisur me lejen përkatëse të mjedisit brenda datës 3 Nëntor 2022, si dhe të kryejë rehabilitimin e sipërfaqes që shfrytëzohet për të eleminuar ndotjen që shkaktohet nga aktiviteti dhe të marrë masat për parandalimin dhe monitorimin e tyre pas rehabilitimit të ndotjes ekzistuese*".
Nga auditimi i dokumentacionit të inspektimit konstatohet se, ndonëse në procesverbalin e inspektimit, në seksionin e kundërvajtjeve administrative janë konstatuar shkelje konkrete, të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative të parashikuara shprehimisht nga legjislacioni mjedisor në

fuqi, në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit është ndryshuar në mënyrë thelbësore trajtimi administrativ i këtyre shkeljeve.
Konkretisht, dy dënime administrative kryesore me masë *"Gjobë"*, përkatësisht në vlerat 500,000 lekë dhe 1,000,000 lekë, të vendosura në procesverbalin e inspektimit në përputhje me shkeljet e konstatuara dhe me dispozitat përkatëse të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 *"Për lejet e mjedisit"* dhe ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 *"Për mbrojtjen e mjedisit"*, janë hequr pa u shoqëruar me arsyetim ligjor, analizë të fakteve apo vlerësim të proporcionalitetit të masës administrative.
Nga shqyrtimi i Vendimit Përfundimtar të Inspektimit konstatohet se ndaj subjektit është vendosur vetëm masa administrative kryesore *"Paralajmërim"*, pa u argumentuar pse shkeljet e konstatuara konsiderohen si shkelje të një rëndësie të vogël, siç parashikohet në pika 1, neni 48, ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, dhe pa u justifikuar juridikisht zëvendësimi i gjobave me këtë masë më të lehtë. Ky veprim nuk është në përputhje me natyrën dhe rëndësinë e shkeljeve të konstatuara, të cilat lidhen drejtpërdrejt me mosrespektimin e kushteve të lejes mjedisore, mungesën e sistemeve të kontrollit të ndotjes dhe mangësitë në menaxhimin e mbetjeve.
Me shkresën nr. 8251, datë 20.10.2022, subjekti i është drejtuar Drejtorisë së AKM-së për informacion lidhur me pajisjen me leje mjedisore për aktivitetin që ushtron. AKM, me shkresën nr. 251/1, datë 26.10.2022, i ka kthyer përgjigje se: *"Operatorët duhet të pajisen me leje mjedisi nëse veprimtaria që ushtrojnë përfshihet në kategorinë e aktiviteteve për lejet e mjedisit, të përcaktuara sipas Shtojcës 1, të ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011 'Për lejet e mjedisit', i ndryshuar. Ju duhet të pajiseni me leje mjedisi tipi B, nëse veprimtaria që ushtroni dhe kapaciteti prodhues janë sipas përcaktimeve ligjore të shtojcës së sipërpërmendur."*
Gjithashtu, nga verifikimi i kontestimeve të subjektit, të protokolluara në AKM me nr. 1389, datë 04.11.2022, evidentohet se subjekti nuk ka paraqitur fakte të reja, të cilat të provojnë të kundërtën e konstatimeve të trupës inspektuese, sipas listës së verifikimit.
Në këto kushte, heqja e masave administrative me gjobë dhe vendosja e vetëm një mase *"Paralajmërim"* është e paargumentuar, formale dhe në mospërputhje me shkeljet konkrete të evidentuara gjatë inspektimit, duke cenuar zbatimin e drejtë dhe të njëtrajtshëm të legjislacionit mjedisor dhe parimin e ligjshmërisë në veprimtarinë inspektuese.
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: G.T dhe M. K.

Dhënia e masës "*Paralajmërim*", pas datës 13.05.2025.
Në fund të vitit 2024 është miratuar Ligji nr. 99/2024 "*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, konkretisht në datën 12.09.2024, i cili, sipas nenit 129 "*Hyrja në fuqi*", hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare, duke filluar efektet juridike nga data 13.05.2025. Ky ligj ka sjellë ndryshime thelbësore në mënyrën e ushtrimit të funksionit inspektues dhe në vendosjen e masave administrative.
Në zbatim të këtij ndryshimi ligjor, me shkresën nr. 291, datë 12.05.2025, Inspektorati Qendror ka orientuar strukturat inspektuese për zbatimin e dispozitave të ligjit të ri, duke kërkuar unifikimin e praktikës inspektuese. Në vijim, nga Inspektorati Qendror është dërguar një shkresë tjetër, konkretisht shkresa nr. 549, datë 27.08.2025 drejtuar institucioneve, që janë në fushën e veprimit të ligjit të sipërcituar, ndër të tjera dhe AKM, përmes së cilës është saktësuar më tej mënyra e zbatimit të ligjit nr. 99/2024, duke përcaktuar shprehimisht se: "*Në të gjitha rastet kur konstatohen shkelje të kërkesave ligjore që përbëjnë kundërvajtje administrative, në inspektimin e parë të vendoset si rregull dënimi administrativ kryesor 'paralajmërim*". Gjithashtu, në të njëjtën shkresë theksohet se vendosja e masave të tjera administrative në inspektimin e parë, jashtë rasteve të posaçme të parashikuara nga ligji, konsiderohet e paligjshme dhe mund të sjellë përgjegjësi

disiplinore për inspektorët që e kanë zbatuar, çka detyron trupat inspektuese të zbatojnë në mënyrë të detyrueshme këtë qasje dhe kufizon përdorimin e masave ndëshkuese në fazën fillestare të inspektimit.

Në zbatim të sa më sipër, grupi i auditimit kampionoi inspektimet e kryera në Agjencinë Rajonale të Mjedisit, Tiranë pas datës 13.05.2025, nga ku rezultoi se në një pjesë të konsiderueshme të rasteve është aplikuar masa administrative "*paralajmërim*", konkretisht rastet paraqiten si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. *Të dhëna mbi inspektimet dhe masat administrative të ARM –TR për vitin 2025*

NR.	NR.ÇËSHTJE	SUBJEKTI I INSPEKTUAR	NIPTI	MASA ADMINISTRATIVE
1	AKM-TR-2025-000067	S. C. I	M********M	*"Paralajmërim"*
2	AKM-TR-2025-000051	GJ. H T	K********S	*"Paralajmërim"*
3	AKM-TR-2025-000050	M. LL	L********V	*"Paralajmërim"*
4	AKM-TR-2025-000032	J	L********J	*"Paralajmërim"*
5	AKM-TR-2025-000194	P	J********G	*"Paralajmërim"*
6	AKM-TR-2025-000095	V. P	L********U	*"Paralajmërim"*
7	AKM-TR-2025-000043	XH SHPK	L********I	*"Paralajmërim"*
8	AKM-TR-2025-000039	M. O	L********H	*"Paralajmërim"*
9	AKM-TR-2025-000038	K	K********H	*"Paralajmërim"*
10	AKM-TR-2025-000033	A. B. A	J********L	*"Paralajmërim"*
11	AKM-TR-2025-000031	K	K********H	*"Paralajmërim"*
12	AKM-TR-2025-000015	A. SH. G	L********A	*"Paralajmërim"*

Burimi: *AKM, përpunoi Grupi Auditimit.*

Nga tabela mësipër konstatohet se, për 12 inspektime të kryera gjatë vitit 2025, masa administrative e vendosur ndaj subjekteve të inspektuara ka qenë në të gjitha rastet *"paralajmërim",* pavarësisht llojit të veprimtarisë së subjekteve, natyrës së shkeljeve të konstatuara dhe sanksioneve të parashikuara në ligjet e posaçme mjedisore. Kjo praktikë tregon se trupat inspektuese kanë zbatuar në mënyrë uniforme dhe automatike masën e paralajmërimit, duke u mbështetur kryesisht në interpretimin e pikës 1 të nenit 44 të ligjit nr. 99/2024 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* pa kryer një vlerësim të individualizuar të shkeljeve dhe pa aplikuar masat administrative të përcaktuara shprehimisht në legjislacionin e posaçëm për mjedisin, çka e bën këtë praktikë të papërputhshme me parimin e ligjshmërisë dhe me hierarkinë e normave juridike.

Nga auditimi konstatohet se, gjatë periudhës objekt auditimi, Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011, *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* ka pësuar ndryshime që lidhen me mënyrën e vendosjes së masave administrative ndaj subjekteve të inspektimit.

Në formën e tij para ndryshimeve, Ligji nr. 10433/2011, në nenin 48 "*Shkelja e kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit"*, parashikonte shprehimisht se:

1. Kur konstatohet shkelje e kërkesave ligjore, që përbën kundërvajtje administrative, por që është e një rëndësie të vogël, apo për të cilën ligji i posaçëm nuk parashikon dënimin përkatës administrativ, subjekti i inspektimit dënohet me 'paralajmërim'. Paralajmërimi është dënim administrativ kryesor.

2. Subjekti i inspektimit mund të dënohet drejtpërdrejt me një dënim tjetër kryesor administrativ, më të rëndë, të parashikuar në ligjin e posaçëm, kur:

a) nuk zbaton plotësisht dhe brenda afatit të përcaktuar urdhërimin e parashikuar në pikën 4 të këtij neni;

b) përsërit shkeljen e kërkesave ligjore;

c) shkelja e konstatuar apo pasojat e saj janë të rënda.

Ky formulim ligjor e lidhte drejtpërdrejt zbatimin e masës administrative me përcaktimet e ligjit të posaçëm dhe nuk lejonte përdorimin e masës *"paralajmërim"* në rastet kur shkelja ishte e parashikuar shprehimisht si kundërvajtje administrative me sanksion konkret.

Me miratimin e ligjit nr. 99/2024 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* kjo dispozitë është riformuluar dhe aktualisht përfshihet në nenin 44 "*Dënimi administrativ kryesor",* i cili parashikon se:

1. Paralajmërimi është dënimi administrativ kryesor në inspektimin e parë të trupës së inspektimit.

2. Në të gjitha rastet kur konstatohen shkelje të kërkesave ligjore, që përbëjnë kundërvajtje administrative, subjekti i inspektimit dënohet me paralajmërim.

3. Paralajmërimi, si masë administrative kryesore, vendoset edhe për rastet kur për shkelje të lehta ligji i posaçëm nuk parashikon dënimin përkatës administrativ.

4. Dënimi administrativ kryesor me paralajmërim nuk zbatohet në rastet e shkeljeve të rënda për të cilat parashikohet masa e pezullimit të aktivitetit, sipas ligjit të posaçëm.

5. Dënimi administrativ kryesor me paralajmërim shoqërohet me urdhërimin e subjektit për të korrigjuar shkeljet e konstatuara dhe për të eliminuar pasojat e tyre, duke përcaktuar edhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim.

Nga auditimi konstatohet se kjo dispozitë është interpretuar nga AKM-ja dhe strukturat e saj rajonale në kuptimin se, për çdo subjekt të inspektuar për herë të parë pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 99/2024, masa administrative që duhet të vendoset është vetëm *"paralajmërim*", pavarësisht llojit të shkeljes dhe pavarësisht sanksioneve të parashikuara në ligjet e posaçme.

Sipas vlerësimit të grupit të auditimit, ky interpretim nuk është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, pasi ligji i inspektimit ka karakter të përgjithshëm dhe procedural, ndërsa ligjet e posaçme mjedisore përcaktojnë shprehimisht shkeljet dhe masat administrative përkatëse.

Në këtë kuadër, aplikimi i masës administrative "*paralajmërim*", pa marrë në konsideratë llojin dhe rëndësinë e shkeljes dhe pa zbatuar sanksionet e përcaktuara në ligjet e posaçme, bie në mospërputhje me:

- Ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011, *"Për lejet e mjedisit",* neni 29;
- Ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011, *"Për mbrojtjen e mjedisit",* neni 69;
- Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011*, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve",* neni 62;
- Ligjin nr. 29/2024 "*Për burimet ujore*", neni 169.

Për rrjedhojë, nga auditimi konstatohet se vendosja e masës administrative *"paralajmërim"* nga trupat inspektuese gjatë vitit 2025, në rastet kur ligjet e posaçme parashikojnë sanksione konkrete administrative, nuk është në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi dhe nuk garanton zbatimin e plotë dhe efektiv të legjislacionit mjedisor, problematikë kjo e konstatuar në të gjitha ARM-të.

Për problematikat e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi inspektorët sipas rasteve të trajtuara në këtë material, përgjegjësi i sektorit të Inspektimeve Mjedisore dhe Burimeve Natyrore dhe Drejtori i ARM Tiranë, sipas periudhave që kanë mbuluar në pozicionet përkatëse.

Drejtor i ARM Tiranë: O. Gj, G. H, D. M, P. M, E. A; *Përgjegjës Sektori i Inspektimit Mjedisor:* G. T, S. V, M. K, Xh. N; *Përgjegjës, Sektori i Inspektimit të Burimeve Ujor:* B. D, K. K; *Inspektorët e përmendur në këtë material.*

2.5.3 Agjencia Rajonale Mjedisore Fier Vlorë, Gjirokastër

Nga verifikimi i plotësimit të strukturës së miratuar për Agjencitë Rajonale të Mjedisit Fier Vlorë, Gjirokastër, për periudhën objekt auditimi rezultoi se:

- Për vitin 2021 nuk është plotësuar përkatësisht për 1 përgjegjës në Sektorin e Inspektimit të Mjedisit.
- Për vitin 2022 nuk është plotësuar për 4 specialistë për Sektorin e Inspektimit të Mjedisit.

- Për vitin 2023 dhe 2024 nuk është plotësuar për 1 specialist në Sektorin e Inspektimit të Burimeve Natyrore dhe 4 specialistë për Sektorin e Inspektimit të Mjedisit.
- Për periudhë janar-shator 2025 struktura nuk është plotësuar për 1 specialist në Sektorin e Inspektimit të Burimeve Natyrore dhe për 1 specialist në Sektorin e Inspektimit të Mjedisit.

Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me: Urdhërin nr. 23, datë 03.02.2020 të Kryeministrit "*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së AKM-së*"; Urdhërin nr.187, datë 15.11.2022, të Kryeministrit për "*Miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit"*; Urdhërin nr. 29, datë 13.02.2024 të Kryeministrit "*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së AKM-së*" dhe Urdhërin nr. 194, datë 04.10.2024 të Kryeministrit "*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së AKM-së*", skemat 1/2 dhe 2/2, duke rezultuar për periudhën objekt auditimi me vende të lira, krahasuar me numrin e miratuar në organikë, duke sjellë për pasojë ulje të efektivitetit dhe eficiencës në punë. të këtyre sektorëve.

Mbi planifikimin dhe realizim vjetor të inspektimeve:

Programi vjetor hartohet nga drejtori i DIK dhe përcillet te titullari i AKM-së. Përveç inspektimeve të planifikuara janë kryer dhe inspektime të paplanifikuara, kur ka qenë e nevojshme, si në rastet e ankesave, denoncimeve apo informacioni nga të tretët, në raste rishikimesh, etj. Dokumentacionet e inspektimeve janë hedhur në sistemin e *E–Inspektim*. Bazuar në Ligjin nr. 10433, datë 16.06.20011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, realizimi i programit inspektues nga të dy sektorët është si në vijim:

- Për vitin 2021 programi vjetor është realizuar me 53%;
- Për vitin 2022 programi vjetor është realizuar me 35%;
- Për vitin 2023 programi vjetor është realizuar me 41%;
- Për vitin 2024 programi vjetor është realizuar me 61%;
- Për vitin 2025 programi vjetor është realizuar me 44%;

Për periudhën objekt auditimi, *grupi i auditimit konstatoi* mosrealizimin e plotë të programeve vjetore të inspektimit nga të dy sektorët inspektues. Mosrealizimi i plotë i programeve vjetore të inspektimit ndikon në uljen e efektivitetit të funksionit mbikëqyrës dhe kontrollues të strukturave inspektuese, duke krijuar risk për mungesë kontrolli të plotë mbi subjektet që duhet të inspektohen.

Nga auditimi i procesit të planifikimit dhe përgatitjes së programeve vjetore të auditimit për periudhën objekt auditimi, u konstatua se ARM Fier nuk rezulton të kenë përgatitur Program Vjetor të Inspektimeve. Programi Vjetor i inspektimeve është përgatitur nga AKM pa marrë mendim nga Agjencitë Rajonale. E gjithë kjo situatë është në kundërshtim me Rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit nr.120 prot., datë 12.01.2021, e miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i AKM-së, Kreu VII, nënkapitulli III.I pika 11, nënkapitulli III.II germa "d", nënkapitulli III.III germa "b" dhe pika 11.

Nga auditimi me zgjedhje i inspektimeve në ARM Fier, të regjistruara në sistemin e-*inspektim u konstatua* se nuk është evidentuar informacioni mbi statusin e pagesës së tarifave vjetore të lejeve mjedisore nga subjektet. Mospasja e këtij informacioni pengon identifikimin e subjekteve që nuk kanë kryer pagesat përkatëse dhe kufizon mundësinë e përfshirjes së tyre në planet e inspektimit.

Për sa i përket masave administrative të vendosura, konstatohet se mungon një metodologji e përcaktimeve të dënimeve administrative, në kundërshtim me pikën 7 dhe 8, të nenit 48 të ligjit nr. Nr.10 433, datë 16.6.2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"* ku citohet se:

7. Këshilli i Ministrave miraton rregulloren e përgjithshme të metodologjisë së përcaktimit të dënimeve administrative, në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

8. Çdo inspektoriat shtetëror apo vendor harton rregulloren e metodologjisë së përcaktimit të dënimeve, në fushën e tij të inspektimit. Rregullorja miratohet nga ministri përgjegjës për inspektoratet shtetërore dhe organi ekzekutiv i njësisë vendore për inspektoratet vendore. Mungesa e një metodologjie të miratuar, sjell riskun që inspektorët të vendosin masa administrative bazuar në interpretimin e tyre personal. Kjo krijon hapsirë që masat të jenë të pa unifikuara dhe jo në përpjesëtim me shkeljen e kryer, duke sjellë në këtë mënyrë dënime tepër të ashpra ose tepër të lehta, të cilat cënojnë standardet ligjore dhe krijojnë precedentë të gabuar në praktikë.
Gjithashtu, nga grupi i auditimit u konstatua se nuk është evidentuar informacioni mbi statusin e pagesës së tarifave vjetore të lejeve mjedisore nga subjektet. Mospasja e këtij informacioni pengon identifikimin e subjekteve që nuk kanë kryer pagesat përkatëse dhe kufizon mundësinë e përfshirjes së tyre në planet e inspektimit.

Krahas masave administrative, nga ARM Fier janë vendosur edhe masa "paralajmërime", të cilat për periudhën objekt auditimi paraqiten si në vijim:

Viti	Numri i subjekteve
2021	1
2022	13
2023	6
2024	22
2025	18
Totali	**60**

Burimi: *ARM Fier, përpunuar nga grupi i auditimit*

Nga auditimi me zgjedhje i inspektimeve në ARM Fier, të regjistruar në sistemin e-inspektimi u konstatua si më poshtë:

1. Subjekti T.S me NIPT L.....I, Inspektimi nr. AKM-FR-2021-000083, me objekt inspektimi:*"Kontroll mbi zbatimin e kushteve të Lejes Mjedisore", Inspektorët: D. V, F. B*".
Nga inspektimi, sipas listëverifikimit dhe procesverbalit të inspektimit, janë evidentuar mangësi në lidhje me zbatimin e kushteve të lejes mjedisore dhe detyrimet e raportimit nga ana e subjektit. Konkretisht, subjekti nuk ka paraqitur dokumentin e pagesës së tarifës vjetore për vitin 2021, nuk ka vënë në dispozicion dokumentacion mbi zbatimin e nenit 32 të ligjit nr. 10731/2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", nuk ka paraqitur raportimin periodik 6-mujor dhe raportin vjetor të mjedisit. Po ashtu, nuk janë zbatuar kushtet e lejes mjedisore lidhur me "*Operimin dhe infrastrukturën*", nuk është paraqitur plani i përputhshmërisë dhe afatet kohore, si dhe nuk është dhënë informacion për zbatimin e kushteve të tjera të lejes.
Nga verifikimi në terren janë evidentuar problematika konkrete mjedisore, pasi në lidhje me kushtet 7.2 dhe 7.4 janë konstatuar gjurmë hidrokarburesh në afërsi të kanalizimeve, dekantimit, pompave dhe puseve, ndërsa për kushtin 8 nuk janë zbatuar kërkesat për menaxhimin e mbetjeve, duke u evidentuar gjithashtu prani ndotjeje me hidrokarbure në zonat përreth. Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion për kushtin 12 "*Dokumentimi dhe raportimi",* nuk ka vënë në dispozicion prova për zbatimin e kushteve lidhur me incidentet dhe emergjencat, si dhe nuk ka marrë masa për rehabilitimin e zonës së ndotur, në kundërshtim me kushtin 14 të lejes mjedisore.
Nga procesverbali i inspektimit rezulton se subjekti nuk ka përmbushur detyrimet për dokumentacionin mjedisor, nuk ka marrë masa për rrethimin e puseve me platforma betoni për parandalimin e rrjedhjeve të hidrokarbureve në tokë, si dhe nuk ka ndërmarrë masa për rehabilitimin e zonës së ndotur përreth puseve dhe në afërsi të pompave të injektimit. Gjithashtu, janë evidentuar ujëra sipërfaqësore të përziera me hidrokarbure, të dokumentuara me materiale fotografike, çka konfirmon praninë e ndotjes dhe mungesën e masave parandaluese.

Për këto shkelje, në procesverbal është vendosur dënim administrativ kryesor në shumën 1,000,000 lekë, si dhe dënim administrativ plotësues për korrigjimin e shkeljeve, duke detyruar subjektin të paraqesë dokumentacionin e kërkuar në lejen mjedisore, të marrë masa për rrethimin e puseve aktive me platforma betoni dhe të kryejë rehabilitimin e zonës së ndotur, si dhe të marrë masa për parandalimin e rrjedhjeve aksidentale dhe eliminimin e pasojave të tyre.
Nga verifikimi i procesverbalit me nr. AKM-FR-2021-000083-2, datë 23.07.2021 konstatohet se, paraqiten mangësi në plotësimin e rubrikave përkatëse, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 45 të ligjit nr. 10433/2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, i cili kërkon që procesverbali të përmbajë informacion të plotë dhe të detajuar mbi veprimet e inspektimit, gjetjet dhe vendimet procedurale të marra. Nga krahasimi i listë verifikimit me procesverbalin, të cilat mbajnë të njëjtën datë (02.07.2021) rezulton se, problematikat e konstatuara mbi zbatimin e kushteve të lejes në listë verifikim janë më tepër se ato të paraqitura në procesverbal, konkretisht sipas listë verifikimit nuk janë përmbushur 8 kushte të lejes mjedisore (2; 3; 4; 7.2; 7.4; 8; 12; 13; 14). Pra rezulton se subjekti nuk ka përmbushur 8 nga 14 kushtet e lejes mjedisore.
Në vendimin përfundimtar të inspektimit me nr. AKM-FR-2021-000083-5, datë 12.11.2021 për mos përmbushjen dhe mosrespektimin e kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipave A, është dënuar me Gjobë në shumën 1,000,000 lekë dhe dënim administrativ plotësues: "*Të korrigjohen shkeljet e mësipërme dhe të raportohen pranë ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër.*
1.Të kryej dokumentacionin e kërkuar në Lejen Mjedisore.
2.Të marrë masa për rrethimin e të gjithë puseve aktive me platforma betoni.
3.Të rehabilitojë zonën e ndotur përreth puseve dhe rrjedhjen e ndodhur në afërsi të pompave, dhe të marrë masa për parandalimin e rrjedhjeve aksidentale".
Konstatohet se Vendimi i Përfundimtar i inspektimit është hartuar 82[15] ditë në tejkalim të afatit të përcaktuar në pikën 1, të nenit 46, të ligjit nr. 10433 *"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* ku përcaktohet se: "*Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm, vendimi përfundimtar i inspektimit merret nga inspektori apo inspektorët që kanë kryer inspektimin, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të procesverbalit subjektit të inspektimit".* Gjithashtu duke qenë se subjekti është në shkelje të 8 nga 14 kushteve të lejes, grupi i auditimit gjykon se ndaj tij duhet të ishte aplikuar gjoba maksimale e parashikuar në pikën 1/b (i), të nenit 29, te ligjit nr. 10448 *"Për lejet e mjedisit"* ku përcaktohet se: *"b) Mos përmbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipave A, B apo C nga operatori i një instalimi: i) për lejet e mjedisit të tipit A, dënohet me gjobë në vlerën nga 1,000,000 deri në 2,000,000 lekë, pra masa administrative duhet të ishte lënë 2,000,000 lekë.* Gjithashtu në lidhje me verifikimin e masave plotësuese, konstatohet se nga ARM Fier nuk rezulton të jetë kryer ri inspektim në lidhje me korrigjimin dhe ndjekjen e shkeljeve të lëna nga inspektimi, në kundërshtim me pikat 15-17, kreu IV të Urdhrit e Inspektoratit Qendror nr. 25, datë 10.08.20218, për miratimin e rregullores *"Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve si një proces i rregullt administrativ"*, ku përcaktohet:
15. Subjekti, objekt inspektimi, është i detyruar të njoftojë për korrigjimin e shkeljeve, brenda afatit të përcaktuar nga trupa inspektuese në vendimin përfundimtar të inspektimit, të mëparshëm dhe nëse është e nevojshme të paraqesë edhe provat që vërtetojnë këtë fakt.
16. Për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve të konstatuara nga trupa inspektuese, kryhet një inspektim i ri. Në rastet kur nga ri inspektimi rezulton se subjekti nuk ka zbatuar detyrat e lëna nga inspektimi i mëparshëm, procedohet me masë administrative.
17. Procedura e inspektimit dhe ri inspektimit kryhen online në portalin e-Inspektimi.

[15] Data e Procesverbalit 23.07.2021, data e vendimit 12.11.2021.

Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi inspektorët: D. V, F. B.

2. Subjekti T.S me NIPT: L.....I, Inspektimi nr. AKM-FR-2024-000048, me objekt inspektimi: "*Inspektim mbi problematikën e shfaqur në media dhe referuar informacionit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit Fier. Inspektim mbi zbatimin e kushteve të Lejes Mjedisore"*, Inspektorët: A.C, A.H.

Nga inspektimi, sipas listëverifikimit dhe procesverbalit të inspektimit, janë evidentuar mangësi në lidhje me shkarkimet në ujëra dhe menaxhimin e mbetjeve nga ana e operatorit. Konkretisht, në lidhje me kushtet 7.2 dhe 7.3 të lejes mjedisore janë konstatuar gjurmë të shkarkimeve të ujërave të ndotura me lëndë hidrokarbure në vendin e quajtur Përroi i Margellicit, pranë urës së Ofiçinës së vjetër, ku janë marrë mostra për analiza për shkak të pamundësisë së marrjes së tyre brenda territorit të aktivitetit, pasi kanalizimet janë të mbuluara me tombino të shtrira nëntokë. Në lidhje me kushtin 7.4 "*Ujërat nëntokësorë dhe toka",* nga inspektimi janë konstatuar gjurmë të mbetjeve me lëndë hidrokarbure në sipërfaqen e tokës në disa prej shesheve të puseve, ndërkohë që operatori injekton në nëntokë ujërat e ndotur teknologjik që dalin nga procesi i prodhimit. Po ashtu, në lidhje me kushtin 8 "*Menaxhimi i mbetjeve",* janë evidentuar të njëjtat problematika në sheshet e puseve, si dhe mungesa e dorëzimit pranë AKM Tiranë e regjistrit të mbetjeve, në kundërshtim me kushtet e lejes mjedisore. Nga procesverbali i inspektimit rezulton se gjetjet janë pasqyruar në mënyrë të kufizuar krahasuar me listëverifikimin, duke u referuar kryesisht shkeljes së kushtit 7.4.1 të lejes mjedisore për praninë e gjurmëve të hidrokarbureve dhe mosdorëzimit të regjistrit të mbetjeve sipas kushtit 12.2, pa reflektuar në mënyrë të plotë të gjitha problematikat e evidentuara gjatë inspektimit në terren. Për këto shkelje është vendosur dënim administrativ kryesor gjobë në shumën 1,000,000 lekë, si dhe dënim administrativ plotësues për rehabilitimin e zonave të ndotura dhe raportimin pranë ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër.

Në vijim, më datë 11.03.2024, subjekti ka paraqitur ankesë duke kundërshtuar procesverbalin dhe listëverifikimin, me pretendimin se inspektimi nuk është kryer në praninë e tij dhe se ndotja e konstatuar kufizohet vetëm në disa njolla hidrokarbure brenda territorit të puseve, të cilat sipas tij janë normale dhe pa impakt mjedisor jashtë këtij territori.

Nga auditimi konstatohet se procesverbali i inspektimit nuk është hartuar në përputhje me pikën 3 të nenit 45 të ligjit nr. 10433/2011 "*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*", pasi nuk përmban informacion të plotë dhe të detajuar mbi të gjitha gjetjet e konstatuara gjatë inspektimit. Gjithashtu, ndonëse në procesverbal është parashikuar dënim administrativ plotësues për korrigjimin e shkeljeve, ky nuk është reflektuar në vendimin përfundimtar të inspektimit, duke mos përcaktuar masat konkrete dhe afatet për korrigjimin e tyre, në kundërshtim me kërkesat e pikave 4 dhe 5 të nenit 48 të këtij ligji dhe me rregulloren e miratuar me Urdhrin nr. 25, datë 10.08.2018.

Në të njëjtën kohë, nga verifikimi në sistem rezulton se nuk është kryer ri-inspektimi për të verifikuar zbatimin e detyrimeve të lëna, në kundërshtim me kërkesat proceduriale për ndjekjen e korrigjimit të shkeljeve, duke treguar mangësi në monitorimin e zbatimit të tyre dhe duke dobësuar efektivitetin e procesit inspektues.

Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi inspektorët: A. C, A. H.

3. Subjekti A SHA me NIPT J.....U, Inspektimi nr. AKM-FR-2023-000096, me objekt inspektimi: *"Kontroll mbi zbatimin e kushteve të Lejes Mjedisore*", Inspektorët: L. I, A. H, A. V.

Nga inspektimi, sipas listëverifikimit dhe procesverbalit të inspektimit, janë evidentuar mangësi të shumta në lidhje me zbatimin e kushteve të lejes mjedisore dhe detyrimet e dokumentimit e raportimit nga ana e subjektit. Konkretisht, nga listëverifikimi rezulton se subjekti nuk ka paraqitur dokumentin e pagesës së tarifës vjetore, dokumentacion mbi raportin vjetor dhe raportet e

vetëmonitorimit, planin e përputhshmërisë, si dhe dokumentacionin për menaxhimin e mbetjeve, dokumentimin dhe planin e emergjencave. Gjithashtu, është konstatuar se makineritë dhe pajisjet janë në gjendje të amortizuar, mungojnë argjinaturat e depozitave sipas kushtit 3.4 të lejes mjedisore, nuk është kryer monitorimi i parametrave mjedisorë, si dhe janë evidentuar në terren aroma hidrokarburesh, shkarkime të pakontrolluara dhe prani mbetjesh hidrokarbure në sipërfaqen e tokës. Nga verifikimi i procesverbalit nr. AKM-FR-2023-000096-2, datë 06.09.2023, rezulton se janë pasqyruar vetëm një pjesë e këtyre problematikave, duke u evidentuar kryesisht ndotja me hidrokarbure në tokë dhe moszbatimi i disa kushteve të lejes mjedisore, konkretisht kushtet 1.5.17, 1.5.12, 3.4, 7.4, 8 dhe 12, për të cilat është vendosur dënim administrativ kryesor: *"Gjobë" në shumën 1,000,000 lekë*. Nga krahasimi i listëverifikimit me procesverbalin konstatohet mospërputhje, pasi një pjesë e konsiderueshme e shkeljeve të evidentuara në listëverifikim nuk janë reflektuar në procesverbal, duke mos pasqyruar në mënyrë të plotë nivelin real të mosrespektimit të kushteve të lejes mjedisore. Konkretisht, sipas listëverifikimit subjekti nuk ka përmbushur një numër të konsiderueshëm kushtesh të lejes (përfshirë kushtet 2, 3.4, 4, 5, 7.1, 7.3, 7.4, 8, 11, 12 dhe 13), ndërkohë që në procesverbal janë trajtuar vetëm një pjesë e tyre.
Gjithashtu, nga auditimi konstatohet se nuk rezulton të jetë planifikuar apo kryer ri-inspektim për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve të konstatuara, në kundërshtim me pikën 14 të Kreut IV *"Korrigjimi dhe ndjekja e shkeljeve të lëna nga inspektimi"* të Urdhrit nr. 25, datë 10.08.2018 *"Për miratimin e rregullores 'Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ'"*, e cila parashikon verifikimin e korrigjimit të shkeljeve përmes ri-inspektimit, duke evidentuar mangësi në monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të detyrimeve të lëna ndaj subjektit.
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi inspektorët: L. I, A. H, A. V.

4. Subjekti A. H NIPT: K.....C, Inspektimi me nr. AKM-FR-2024-000216, me objekt isnpektimi: "*Inspektim mjedisor mbi zbatimin e kushteve të lejes mjedisore me PN-0560-07-2021"*, Inspektorët: A. H, A.C, G. Zh.
Nga inspektimi, sipas listëverifikimit dhe procesverbalit të inspektimit, janë evidentuar mangësi në lidhje me zbatimin e kushteve të lejes mjedisore, konkretisht për kushtin 8 *"Menaxhimi i Mbetjeve"* dhe kushtin 12 *"Dokumentimi dhe Raportimi"*. Subjekti nuk ka raportuar pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe nuk ka mbajtur regjistrin e mbetjeve, si dhe nuk ka zbatuar kushtin 12.2, i cili kërkon që *"Subjekti të mbajë regjistër për sasinë e mbetjeve të asgjësuara, të gjeneruara, të rikuperuara dhe të magazinuara, si dhe t'i raportojë këto të dhëna Agjencisë Kombëtare të Mjedisit çdo 3 muaj"*.
Nga verifikimi i procesverbalit nr. AKM-FR-2024-000216-2, datë 22.10.2024, konstatohet se gjetjet janë pasqyruar në të njëjtën formë, ku citohet se *"Operatori Spitali Amerikan Fier nuk ka raportuar në AKM Tiranë për regjistrin e mbetjeve"* dhe se *"Operatori nuk ka zbatuar kushtin 12 'Dokumentimi dhe Raportimi', konkretisht kushtin 12.2"*. Për këto shkelje është vendosur dënim administrativ kryesor *"gjobë" në shumën 300,000 lekë*, si dhe është lënë detyrimi që *"Operatori Spitali Amerikan Fier të zbatojë kushtin 12 'Dokumentimi dhe Raportimi', konkretisht kushtin 12.2…"*. i njëjti dënim dhe detyrim janë reflektuar edhe në Vendimin përfundimtar nr. AKM-FR-2024-000216–5, datë 19.11.2024.
Nga auditimi konstatohet se, përtej moszbatimit të kushtit të lejes mjedisore, subjekti nuk dispononte kontratë të vlefshme për menaxhimin e mbetjeve, pasi nga verifikimi i kontratës së shërbimit ndërmjet A.H. dhe shoqërisë E.R. SHPK rezulton se ajo kishte përfunduar në datë 01.02.2018 dhe nuk evidentohet asnjë dokument shkresor që të vërtetojë zgjatjen e saj, duke e lënë aktivitetin pa bazë kontraktuale për trajtimin e mbetjeve.

Gjithashtu, mosraportimi pranë AKM për regjistrin e mbetjeve përbën shkelje të drejtpërdrejtë të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 10463/2011, e cila përcakton se *"Personat fizikë dhe juridikë… vënë në dispozicion të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit… evidenca të dokumentuara që tregojnë se operacionet e menaxhimit janë kryer"*. Në vijim, pika 33 e nenit 62 të po këtij ligji parashikon se *"Çdo person, që angazhohet me mbetjet spitalore jo në përputhje me nenin 35 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1,000,000 deri në 1,500,000 lekë"*.
Në këto kushte, trajtimi i shkeljes vetëm si moszbatim i një kushti të lejes mjedisore dhe aplikimi i një gjobe në vlerën 300,000 lekë nuk është në përputhje me kuadrin ligjor specifik për menaxhimin e mbetjeve, duke rezultuar në një kualifikim të pasaktë të shkeljes dhe në një masë administrative më të ulët nga sa parashikon legjislacioni përkatës.
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi inspektorët: A. H, A. C, G. Zh.

5. Subjekti: I. T. Ŵ. T. F. me NIPT L.....F, Inspektimi me nr. AKM-FR-2024-000208, me objekt inspektimi: "*Inspektim mbi zbatimin e kushteve te Lejes Mjedisore me Numër Identifikues 3139 date 14.04.2020"*, inspektorët: E. Sh, V. G, E. Z.
Nga inspektimi, sipas listëverifikimit dhe procesverbalit të inspektimit, janë evidentuar mangësi në lidhje me zbatimin e kushteve të lejes mjedisore, ku në kushtin 8 *"Menaxhimi i Mbetjeve"* është konstatuar se subjekti ndodhet nën sekuestro që prej vitit 2022 dhe administrohet nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK), ndërkohë që informacioni është marrë vetëm nga përfaqësues të kësaj agjencie, pa u siguruar dokumentacion mbi zbatimin e kushteve të lejes mjedisore, duke bërë që rubrikat e tjera të listëverifikimit të rezultojnë të paplotësuara.
Nga verifikimi i procesverbalit konstatohet se, pavarësisht kësaj situate, në seksionin e gjetjeve është shënuar *"Nuk ka shkelje"*, ndërsa në arsyetim evidentohet se *"Integrated Technology Ëaste Treatment Fier ndodhet nën sekuestro dhe landfilli administrohet përkohësisht nga bashkitë e Qarkut Fier, pa u evidentuar tejkalime kapaciteti apo parregullsi"*, pa u analizuar zbatimi i kushteve të lejes mjedisore dhe pa u evidentuar përgjegjësitë përkatëse. Në seksionin *"Këshillimet"* është sugjeruar transferimi i Lejes Mjedisore tek administratorët aktualë dhe programimi i inspektimeve në të gjitha bashkitë për zbatimin e ligjit nr. 10463, ndërsa në vendimin përfundimtar, datë 11.10.2024, është pasqyruar vetëm situata e sekuestrimit, pa u vendosur masa ndëshkuese dhe pa u reflektuar seksioni *"Këshillimet"*.
Nga auditimi konstatohet se procesverbali nuk është hartuar në përputhje me pikën 3 të nenit 45 të ligjit nr. 10433/2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", i cili përcakton se: *"procesverbali duhet të përmbajë informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit, si dhe të shoqërohet me listë verifikimin e plotësuar"*, pasi mungon një analizë e plotë dhe e dokumentuar mbi përmbushjen e kushteve të lejes mjedisore dhe nuk janë evidentuar faktet dhe provat që mbështesin përfundimin e arritur nga trupa inspektuese.
Nga auditimi i dokumentacionit të inspektimit, si dhe nga shqyrtimi i Lejes Mjedisore të subjektit, konstatohet se me Vendimin Gjyqësor nr. 134, akti i regjistruar më datë 18.03.2022 *"Për caktimin e masës Sigurim Pasuror"* shoqëria ka kaluar nën administrimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK), ndërsa sipas Kontratës së Qirasë nr. 268, datë 18.01.2024 landfilli është dhënë në përdorim bashkive të Qarkut Fier për menaxhimin e mbetjeve urbane. Sipas pikës 2 të nenit 2 të kontratës, *"qiramarrësit pranojnë marrjen me qira të objektit dhe vazhdimin e ushtrimit të kësaj veprimtarie në funksion të menaxhimit të mbetjeve urbane, duke u kujdesur për administrimin e veprimtarisë ekonomike në përputhje me destinacionin ekonomik të sendit"*, ndërsa sipas nenit 3 të kontratës *"Destinacioni i përdorimit të*

objektit", objekti do të përdoret vetëm për menaxhimin e rrugës hyrëse, peshores dhe vend depozitimit (landfillit) të mbetjeve urbane në Impiantin e Trajtimit të Mbetjeve Urbane të Qarkut Fier".

Bazuar në auditimin e dokumentacionit të inspektimit dhe në analizën e kuadrit ligjor të përcaktuar nga ligji nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", konstatohet se veprimtaria e depozitimit të mbetjeve urbane në landfill është zhvilluar pa u garantuar përmbushja e kërkesave ligjore dhe mjedisore që rregullojnë operimin e landfill-eve. Referuar nenit 3, pika 16 të këtij ligji, përcaktohet se: *"16. 'Lendfill' është fusha e asgjësimit të mbetjeve të ngurta mbi ose nën tokë, përfshirë: a) një vend ku mbetjet asgjësohen brenda territorit të impiantit që i ka krijuar, siç është rasti i lendfillit ku krijuesi i mbetjeve i asgjëson mbetjet e veta në vendin e prodhimit; b) një vend të përhershëm që përdoret për ruajtjen e përkohshme, zakonisht për më shumë se një vit, të mbetjeve me përjashtim të: i) impianteve ku mbetjet shkarkohen për t'u përgatitur për t'u transportuar më pas për rikuperim, trajtim apo asgjësim diku tjetër; ii) vendeve ku mbetjet ruhen për një periudhë kohe jo më të gjatë se tre vjet përpara se të rikuperohen ose të trajtohen; iii) vendet ku mbetjet ruhen për një periudhë kohe jo më të gjatë se një vit përpara asgjësimit të tyre"*.

Në të njëjtën kohë, sipas nenit 5 të ligjit nr. 10463/2011 përcaktohet se: *"Mbetjet menaxhohen duke mos vënë në rrezik shëndetin e njeriut, duke mos përdorur procese ose metoda që mund ta dëmtojnë atë ose mjedisin dhe sidomos: a) duke mos vënë në rrezik ujërat, ajrin, tokën, tokën bujqësore, bimët ose kafshët; b) duke mos ndikuar negativisht mbi fshatin ose vendet me interes të veçantë; c) duke mos shkaktuar shqetësime përmes zhurmave ose erërave, në përputhje me përcaktimet e akteve të tjera ligjore apo nënligjore."*. Mungesa e çdo dokumentacioni mbi monitorimin, raportimin dhe kontrollin e mbetjeve nuk lejon të provohet përmbushja e këtyre kërkesave.

Gjithashtu, në shkelje të pikës 2 të nenit 21 të këtij ligji, ku përcaktohet se: *"Krijuesi ose zotëruesi fillestar i mbetjeve, që transferon mbetjet te një tregtar ose person që kryen operacione trajtimi të mbetjeve, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij neni, nuk çlirohet nga përgjegjësia për operacionet e rikuperimit ose të asgjësimit të tyre"*, bashkitë e Qarkut Fier, në cilësinë e krijuesve dhe zotëruesve të mbetjeve, nuk kanë provuar ekzistencën e dokumenteve të transferimit, monitorimit dhe raportimit pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

Nga procedura e inspektimit nuk verifikohet zbatimi i kërkesave të neneve 43, 44 dhe 45 të ligjit nr. 10463/2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", pasi nuk është dokumentuar zbatimi i procedurave të pranimit të mbetjeve, nuk është provuar se janë respektuar kriteret e ndalimit për mbetjet e përjashtuara nga landfill-et dhe nuk është realizuar monitorimi dhe kontrolli sipas kërkesave të operimit të landfill-it. Në këto kushte, veprimtaria rezulton si operim i landfill-it jo në përputhje me lejen e mjedisit, në kuptim të nenit 62, pika 45 të këtij ligji, i cili përcakton se: *"Shkeljet e mëposhtme, që nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative: 45. Çdo person, që operon një landfill jo në përputhje me lejen e mjedisit apo jo në përputhje me nenin 45 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1,000,000 (një milion) deri në 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë."*.

Për sa më sipër, nga ana e trupës inspektuese nuk janë marrë masa për pezullimin e aktivitetit, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 29 të ligjit nr. 10448/2011 "Për lejet e mjedisit", e cila përcakton se: *"Pavarësisht nga dënimi kryesor me gjobë, të parashikuar në shkronjat 'b' dhe 'c' të pikës 1 të këtij neni, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, vetë ose me propozimin e Inspektoratit Shtetëror përgjegjës, mund t'i propozojë ministrit pezullimin apo shfuqizimin e lejes përkatëse të mjedisit për të gjithë veprimtarinë apo pjesë të saj, masë e cila është dënim plotësues"*, duke evidentuar mungesë të trajtimit të plotë ligjor dhe administrativ të situatës së konstatuar.

Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi inspektorët: E. Sh, V. G, E. Z.

6. I.T. Ŵ.T.F me NIPT: L.....F (inspektimi i kryer në vitin 2025, Inspektimi me nr. 2128, objekti i inspektimit: "*Inspektim mbi zbatimin e kushteve të lejes mjedisore, PN-9944-04-2020*", Inspektorët: A. H, D. V.

Nga inspektimi, sipas listëverifikimit dhe procesverbalit të inspektimit, janë evidentuar mangësi të theksuara në lidhje me zbatimin e kushteve të lejes mjedisore, ku konstatohet se nuk është plotësuar asnjë prej kushteve të saj. Konkretisht, nga procesverbali rezulton se subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion për pagesën e tarifës vjetore, nuk ka paraqitur dokumentacion për raportin vjetor të mjedisit, në kundërshtim me kushtin 2.12.2 të lejes mjedisore, nuk ka zbatuar kushtin 3.4.5 lidhur me testimin e rrethimeve/argjinaturave, nuk ka paraqitur dokumentacion për kryerjen e monitorimeve të shkarkimeve në ajër, ujë dhe tokë sipas kushtit 5, si dhe nuk ka paraqitur dokumentacion për kushtin 7 "*Shkarkimet në kanalizime",* ndërkohë që impianti i trajtimit të ujërave nuk ishte në funksion. Gjithashtu, janë evidentuar gjurmë të mbushjes në nivele të larta të qelizës së lëngjeve kulluese nga mbetjet, nuk janë marrë masa për zbatimin e shtojcës 4.02 të lejes mjedisore për menaxhimin e mbetjeve dhe mungon çdo dokumentacion mbi kushtin 12 "*Dokumentimi dhe raportimi*". Pavarësisht këtyre shkeljeve, në seksionin e kundërvajtjeve administrative është vendosur vetëm dënim administrativ kryesor *"Paralajmërim"* dhe dënim administrativ plotësues *"Të korrigjojë shkeljet dhe t'i raportojë strukturës urdhëruese"*, si dhe janë lënë detyra për marrjen e masave për funksionimin e impiantit, depozitimin e mbetjeve sipas kërkesave ligjore të ligjit nr. 10463/2011, vënien në funksion të impiantit të trajtimit të lëngjeve kulluese dhe paraqitjen e dokumentacionit të kërkuar sipas kushteve të lejes mjedisore. Këto masa janë reflektuar në mënyrë të njëjtë edhe në vendimin përfundimtar të inspektimit.

Nga auditimi konstatohet se procesverbali i datës 21.08.2025 paraqet mangësi në plotësimin e rubrikave përkatëse, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 45 të ligjit nr. 10433/2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", i cili përcakton se *"procesverbali duhet të përmbajë informacion të plotë dhe të detajuar mbi veprimet e inspektimit, gjetjet dhe vendimet procedurale të marra"*. Gjithashtu, në lidhje me vendimmarrjen e trupës inspektuese, konstatohet se nuk është bërë një interpretim i drejtë i dispozitave ligjore, pasi subjekti nuk ndodhet në kushtet e një inspektimi të parë dhe problematikat e evidentuara janë të përsëritura, ndërkohë që edhe në raste të mëparshme nuk janë marrë masa ndëshkuese. Në këto kushte, veprimtaria e zhvilluar në landfill përbën operim jo në përputhje me lejen mjedisore, në kuptim të nenit 62, pika 45 të ligjit nr. 10463/2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i cili përcakton se *"Shkeljet e mëposhtme, që nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative: 45. Çdo person që operon një landfill jo në përputhje me lejen e mjedisit apo jo në përputhje me nenin 45 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1,000,000 (një milion) deri në 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë."*. Gjithashtu, nga auditimi konstatohet se nuk janë marrë masa për pezullimin e aktivitetit, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 29 "Kundërvajtjet" të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar, i cili përcakton se *"Pavarësisht nga dënimi kryesor me gjobë, të parashikuar në shkronjat 'b' dhe 'c' të pikës 1 të këtij neni, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, vetë ose me propozimin e Inspektoratit Shtetëror përgjegjës, mund t'i propozojë ministrit pezullimin apo shfuqizimin e lejes përkatëse të mjedisit për të gjithë veprimtarinë apo pjesë të saj, masë e cila është dënim plotësues"*. Madje, në rastet e mos përmbushjes së detyrimit për pagesën e tarifës vjetore, sipas pikave 5 dhe 6 të nenit 25 të ligjit nr. 10448/2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar, parashikohet revokimi i lejes, konkretisht: *"Ministria i kërkon QKL-së revokimin e lejes përkatëse të mjedisit të tipave A ose B, në rast se operatori i këtij instalimi nuk ka kryer pagimin e tarifës përkatëse në zbatim të këtij ligji."* dhe *"Agjencia përkatëse Rajonale e Mjedisit i kërkon QKL-së*

revokimin e lejes së mjedisit të tipit C, në rast se operatori i këtij instalimi nuk ka kryer pagimin e tarifës përkatëse në zbatim të këtij ligji.”.
Për sa më sipër, trajtimi i kësaj situate vetëm me masën *“Paralajmërim”* nuk është në përputhje me natyrën dhe përsëritjen e shkeljeve të konstatuara, duke reflektuar një aplikim jo proporcional të masave administrative dhe një dobësim të rolit ndëshkues dhe parandalues të inspektimit mjedisor.
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi inspektorët: A. H, D. V.

7. Subjekti N. Shpk I–E C. I, me NIPT L.....J, Inspektimi nr. 1987, datë 21.07.2025, me objekt inspektimi: “*Kontroll i zbatimit të ligjit nr. 9115 dhe problematika të ndryshme që mund të hasen*”, inspektorët: A. B, M. H dhe E. H.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit janë evidentuar mangësi, konkretisht: subjekti ka kryer shkarkime të pakontrolluara të ujërave të ndotura, në kundërshtim me pikën 21/ç të nenit 23, të ligjit nr. 9115/2008 *‘Për trajtimin e ujërave të ndotura”*”; sistemi i brendshëm i kanalizimeve të ujërave teknologjike nuk është funksional dhe kërkon rehabilitim, pasi ujërat përfundojnë në kolektorë në mënyrë të pakontrolluar; nuk janë marrë masa për trajtimin paraprak të ujërave të ndotura, duke rezultuar në nivele të larta të parametrave ndotës, si BOD, yndyrna dhe fosfor. Për këto mangësi, nga trupa inspektuese është vendosur masa administrative *“Paralajmërim*”, si dhe janë lënë masa korrigjuese, konkretisht: “*Ndërprerja e menjëhershme e shkarkimeve të ujërave larës, rehabilitimi i sistemit të brendshëm të kanalizimeve dhe marrja e masave për uljen e parametrave ndotës, me një afat realizimi prej 30 ditësh*”.
Grupi i auditimit konstaton se, në lidhje me gjetjet e trupës inspektuese, nuk bëhet fjalë për një rast inspektimi për herë të parë. Trupa inspektuese, në seksionin e kundërvajtjeve, i është referuar pikës 2, të nenit 44, të ligjit nr. 99/2024 *“Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, e cila përcakton se: *“Në të gjitha rastet kur konstatohen shkelje të kërkesave ligjore, që përbëjnë kundërvajtje administrative, subjekti i inspektimit dënohet me paralajmërim.”*
Nga analiza e kryer nga grupi i auditimit konstatohet se kjo dispozitë është interpretuar në mënyrë të pasaktë nga trupa inspektuese, pasi subjekti i inspektimit nuk ndodhet në kushtet e një inspektimi të parë nga kjo trupë inspektuese, pasi nga verifikimi në sistemin e inspektimeve rezulton se ky subjekt ka të dhëna të mëparshme në lidhje me çështje të ngjashme inspektimi, të cilat paraqiten si në tabelën më poshtë.

Nipt	Numri i çështjes	Data e hapjes së çështjes	Data e mbylljes së çështjes
L********J	AKM-FR-2025-000001- shkresore	21/07/2025	21/08/2025
L********J	AKM-FR-2025-000009	21/01/2025	29/01/2025
L********J	AKM-FR-2023-000033	30/06/2023	11/07/2023
L********J	AKM-FR-2022-000059	20/09/2022	03/10/2022
L********J	AKM-DQ-2021-000195	19/11/2021	15/12/2021
L********J	AKM-FR-2020-000083	26/10/2020	27/10/2020

Burimi: *ARM Fier, përpunuar nga grupi i auditimit*
Për sa më sipër konstatohet se ndaj subjektit nuk janë marrë masa administrative në mos përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara në nenin 23, pika 2/ç, ku përcaktohet se: “*Shkeljet e kërkesave të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative, për rastet si më poshtë: ç) shkarkimet e pakontrolluara të ujërave të ndotura, kur nuk ka sisteme kanalizimesh brenda territorit të veprimtarisë, kur nuk ka sisteme të tilla nga veprimtaria deri në kolektor ose kur këto sisteme nuk funksionojnë;”* dhe nenin 24, pika 1/c të ligjit nr. 9115, datë 24.07.2003 *“Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”,* ku përcaktohet se: *“Për kundërvajtjet administrative, të parashikuara në nenin 23 të këtij ligji, Inspektorati i Mjedisit jep dënime me gjobë: c) për shkronjat "ç" dhe "d" nga 500,000 deri në 1,000,000 lekë”.*
Pra masa e marrë ndaj subjektit duhet të ishte gjobë 500,000-1,000,000 lekë.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi inspektorët: A. B, M. H dhe E. H.

8. Subjekti J sh.p.k, me NIPT K.....V, Inspektimi nr. 2158, Inspektorët: A. H, D. V dhe G.Zh. Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit janë evidentuar mangësi, konkretisht: subjekti nuk ka vënë në dispozicion dokumentacion në lidhje me përmbushjen e kushtit 14.2 të lejes së mjedisit *"Çmontimi, rehabilitimi dhe kontrolli pas ndërprerjes së operacioneve*", si dhe nuk ka dorëzuar pranë AKM planin e rehabilitimit. Për këto mangësi, të cilat paraqiten të njëjta si në listëverifikim ashtu edhe në procesverbal, nga trupa inspektuese është vendosur masa administrative "*Paralajmërim*", bazuar në pikën 2 të nenit 44 të ligjit nr. 99/2024 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*. Gjithashtu, janë lënë masa korrigjuese për përmirësimin e shkeljeve të konstatuara, konkretisht që operatori të marrë masat e nevojshme për përgatitjen e planit për çmontimin dhe rehabilitimin, në përputhje me kushtin nr. 14.2 të lejes mjedisore, dhe ta depozitojë atë pranë AKM brenda datës 30.09.2025. Të njëjtat masa janë reflektuar edhe në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit nr. 2158/5, datë 22.09.2025.
Nga auditimi konstatohet se nga trupa inspektuese, në seksionin e kundërvajtjeve, i është referuar pikës 2, të nenit 44, të ligjit nr. 99/2024 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, e cila përcakton se: *"Në të gjitha rastet kur konstatohen shkelje të kërkesave ligjore, që përbëjnë kundërvajtje administrative, subjekti i inspektimit dënohet me paralajmërim".*
Nga analiza e kryer nga grupi i auditimit konstatohet se kjo dispozitë është interpretuar në mënyrë të pasaktë nga trupa inspektuese, pasi subjekti i inspektimit nuk ndodhet në kushtet e një inspektimi të parë nga kjo trupë inspektuese, pasi nga verifikimi në sistemin e inspektimeve rezulton se ky subjekt ka të dhëna të mëparshme në lidhje me çështje të ngjashme inspektimi, të cilat paraqiten si në tabelën më poshtë.

Nipt	Numri i çështjes	Data e hapjes së çështjes	Data e mbylljes së çështjes
K*********V	AKM-FR-2025-000065-SHKRESORE	8/15/2025 12:00:00 AM	22/09/2025
K*********V	AKM-FR-2022-000024	3/17/2022 9:12:24 AM	05/04/2022
K*********V	AKM-FR-2021-000288	11/25/2021 11:50:48 AM	15/12/2021
K*********V	AKM-FR-2021-000014	5/27/2021 2:08:42 PM	11/06/2021
K*********V	ISHMPUT-GJ-2019-000380	8/26/2019 10:55:06 AM	17/09/2019
K*********V	ISHMPUT-GJ-2018-000089	12/03/2018	18/12/2018

Burimi: *ARM Fier, përpunuar nga grupi i auditimit*

Për sa më sipër konstatohet se mos përmbushja e një prej kushteve të lejes mjedisore, konkretisht kushtit 14.2, është veprim në kundërshtim me ne nenin 29, pika b/ii të ligjit nr. 10448/2011, ku përcaktohet se: *"Mos përmbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipave A, B apo C nga operatori i një instalimi: ii) për lejet e mjedisit të tipit B, dënohet me gjobë në vlerën nga 300 000 deri në 500 000 lekë";*
Grupi i auditimit verifikoi dhe një inspektim, përpara, konkretisht inspektimin me nr. çështjeje AKM-FR-2022-000024, ku konstatohet se shkelja është po e njëjta, konkretisht: subjekti nuk ka ka kryer pagesën financiare për garancinë e rehabilitimit. Subjekti duhet të paraqes planin e rehabilitimit pranë AKM për miratim dhe të fillojë rehabilitimin e objektit. Dhe në vendimin përfundimtar me nr. AKM-FR-2022-000024-5, datë 05.04.2022 është lënë dënim administrativ kryesor *"Paralajmërim"* dhe për përmirësimin e shkeljeve të konstatuara: Subjekti duhet të realizojë detyrat e mëposhtme:
1. Të vazhdojë të ndjek procedurat për rishikimin e kushteve të lejes mjedisore.
2. Subjekti duhet të paraqes pranë AKM planin e rehabilitimit për miratim dhe të fillojë rehabilitimin e objektit minerar për pjesën e shfrytëzuar".
Nga auditimi konstatohet se nuk është përcaktuar një afat konkret për përmirësimin e shkeljeve të konstatuara dhe gjithashtu nuk rezulton të jetë kryer ri-inspektim në terren për të verifikuar

zbatimin e detyrave të lëna dhe përmirësimin e shkeljeve të evidentuara gjatë inspektimit, në kundërshtim me pikën 14, Kreu IV *"Korrigjimi dhe ndjekja e shkeljeve të lëna nga inspektimi"*, të Urdhrit nr. 25, datë 10.08.2018 *"Për miratimin e rregullores 'Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ'"*, e cila përcakton se: *"Në rastet e inspektimeve të programuara, subjekti, objekt inspektimi urdhërohet të korrigjojë shkeljet e konstatuara, duke përcaktuar dhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim. Procesverbali i inspektimit dhe vendimi përfundimtar përfshin këshillimin (rekomandimet) me shkrim të subjektit për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve dhe afatet kohore."*

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi inspektorët: A.H, D. V dhe G. Zh.

9. Subjekti P sh.p.k me NIPT K.....L, Inspektimi me nr. 2270, Inspektorët: A. B, E. H, M.H.

Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit janë evidentuar mangësitë konkretisht: operatori nuk disponon plane të menaxhimit të riskut, në kundërshtim me nenin 125 të ligjit nr. 29/2024 *"Për burimet ujore"*; nuk disponon dokumentacion për verifikimin e prurjeve minimale ekologjike për trupat ujorë natyrorë, në kundërshtim me nenin 133 të ligjit nr. 29/2024 "*Për burimet ujore"*; si dhe nuk disponon leje për përdorimin e burimeve ujore nga organet përkatëse (Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Këshilli i Basenit Lumor), në kundërshtim me nenin 135 të ligjit nr. 29/2024 *"Për burimet ujore"*. Në procesverbalin e inspektimit është konstatuar gjithashtu se operatori nuk disponon leje shfrytëzimi për përdorimin e burimit ujor, në kundërshtim me *"pikën 1, gërma "ç" të ligjit nr. 29/2024 'Për burimet ujore'"*, për të cilën është vendosur dënimi administrativ kryesor *"Gjobë*" në vlerën 1,000,000 lekë, si dhe dënimi administrativ plotësues për pajisjen me leje nga organet përkatëse. Ndërkohë, në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit rezulton mospërputhje me procesverbalin, pasi dënimi administrativ kryesor "*Gjobë"* është zëvendësuar me masën "*Paralajmërim*", ndërsa dënimi administrativ plotësues nuk është pasqyruar. Sipas trupës inspektuese, vendosja e masës "*Paralajmërim"* është mbështetur në *"nenin 44, pika 2 të ligjit nr. 99/2024 'Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë', i ndryshuar"*, i cili përcakton se: *"Në të gjitha rastet kur konstatohen shkelje të kërkesave ligjore, që përbëjnë kundërvajtje administrative, subjekti i inspektimit dënohet me paralajmërim."*

Nga auditimi i listëverifikimit dhe procesverbalit të inspektimit u konstatua se operatori ushtron veprimtari duke përdorur burime ujore pa u pajisur me lejet përkatëse nga organet kompetente të menaxhimit të burimeve ujore, konkretisht nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe nga Këshilli i Basenit Lumor, si dhe pa përmbushur detyrime thelbësore ligjore që lidhen me planifikimin dhe menaxhimin e riskut dhe garantimin e prurjeve minimale ekologjike, sipas kërkesave të ligjit nr. 29/2024 *"Për burimet ujore".*

Këto veprime dhe mosveprime përbëjnë shkelje të drejtpërdrejta pikave 1 dhe 2 të nenit 135 të ligjit nr. 29/2024 *"Për burimet ujore"* i cili përcakton se:

1. Veprimtaritë e mëposhtme që mund të kryhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ushtrohen në bazë të lejes së dhënë nga organet e menaxhimit dhe administrimit të burimeve ujore:
a) përdorimi i burimeve ujore për qëllime të ndryshme kur realizohet përmes instalimeve artificiale;
b) përdorimi i burimeve ujore për ujitje;
c) përdorimi i burimeve ujore për qëllime industriale dhe procese teknologjike;
ç) përdorimi i burimeve ujore për prodhim energjie dhe ftohjeje;
d) përdorimi i burimeve ujore për pishina;
dh) përdorimi i burimeve ujore për ujë të ambalazhuar, tregtim dhe eksport;
e) përdorimi i burimeve ujore kurative, minerale, termo-minerale dhe gjeotermale;
ë) përdorimi i burimeve ujore për hidroenergji;

f) përdorimi i burimeve ujore për zhvillimin e akuakulturës;
g) përdorimi i burimeve ujore për gjënë e gjallë kur shoqërohet me instalime artificiale.
2. Kërkohet leja përkatëse nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për këto raste:
a) përdorimi i burimeve ujore për qëllime familjare kur shoqërohet me instalime artificiale;
b) përdorimi i burimeve ujore për gjënë e gjallë kur shoqërohet me instalime artificiale;
c) përdorimi i burimeve ujore për ujitje për sipërfaqe më të vogël apo të barabartë me 5 hektarë.
Shkronja "dh" e nenit 169, e ligjit nr. 29/2024 *"Për burimet ujore"*, ka parashikuar shprehimisht se veprimtaritë e kryera në kundërshtim me pikat 1 dhe 2 të nenit 135 përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen me gjobë, duke përcaktuar qartë kufijtë minimalë dhe maksimalë të sanksionit administrativ, në varësi të organit që jep lejen. Kjo dispozitë është e qartë, e drejtpërdrejtë dhe nuk i lë hapësirë organit inspektues për zëvendësimin e gjobës me një masë tjetër administrative. Konkretisht kjo dispozitë parashikon:
dh) veprimtaritë e kryera në kundërshtim me pikat 1 dhe 2 të nenit 135 të këtij ligji lidhur me përdorimin me leje të burimeve ujore, përbëjnë kundërvajtje administrative. Kur për veprimtarinë ligji parashikon dhënien e lejes nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, shkelja administrative ndëshkohet me gjobë nga 100 000 lekë deri në 500 000 lekë. Kur për veprimtarinë ligji parashikon dhënien e lejes nga Këshilli i Basenit Lumor, shkelja administrative ndëshkohet me gjobë nga 500,000 lekë deri në 1,000,000 lekë. Kur ligji parashikon dhënien e lejes nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, shkelja administrative ndëshkohet me gjobë nga 1,000,000 lekë deri në 2,000,000 lekë;
Vendosja e masës administrative *"paralajmërim"* në këtë rast është rezultat i një interpretimi të gabuar të dispozitës së ligjit për inspektimin që parashikon paralajmërimin si masë administrative. Dispozita që përcakton se "*në të gjitha rastet kur konstatohen shkelje të kërkesave ligjore, që përbëjnë kundërvajtje administrative, subjekti i inspektimit dënohet me paralajmërim"* ka karakter parimor dhe nuk mund të zbatohet në mënyrë të shkëputur nga pikat e tjera të të njëjtit nen, të cilat e kufizojnë qartë përdorimin e paralajmërimit vetëm në rastet kur ligji material nuk parashikon një sanksion të caktuar ose kur bëhet fjalë për shkelje të lehta.
Në rastin konkret, ligji nr. 29/2024*"Për burimet ujore"* jo vetëm që parashikon sanksion administrativ për shkeljen e konstatuar, por e cilëson atë shprehimisht si kundërvajtje administrative dhe përcakton masën përkatëse të gjobës. Për rrjedhojë, zbatimi i paralajmërimit përbën shmangie nga zbatimi i ligjit material dhe bie ndesh me parimin e ligjshmërisë, sipas të cilit organi administrativ është i detyruar të zbatojë normën ligjore të posaçme dhe të detyrueshme. Për më tepër, mungesa e lejeve për përdorimin e burimeve ujore, mungesa e planeve të menaxhimit të riskut dhe mungesa e dokumentacionit për garantimin e prurjeve minimale ekologjike tregojnë se nuk kemi të bëjmë me një shkelje të izoluar apo të përkohshme, por me një situatë të vazhdueshme paligjshmërie, e cila cenon drejtpërdrejt mbrojtjen e burimeve ujore dhe ekuilibrin mjedisor. Në këto kushte, vendosja e një mase paralajmëruese është jo proporcionale dhe nuk përmbush funksionin parandalues dhe ndëshkues të sanksioneve administrative.
Si konkluzion, trupa inspektuese nuk duhej të kishte vendosur masën administrative *"paralajmërim",* pasi shkeljet e konstatuara janë të parashikuara shprehimisht nga ligji nr. 29/2024 *"Për burimet ujore"* si kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen me gjobë.
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi inspektorët: A. B, E. H, M. H.

10. Subjekti N me NIPT K.....D, Inspektimi me nr. 2073, datë 04.08.2025, Inspektorët: A. B, M. H, E. H.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit është konstatuar se subjekti disponon pus për shfrytëzimin e ujërave tokësore, për të cilin nuk disponon leje nga organet përgjegjëse të

menaxhimit të burimeve ujore, në kundërshtim me nenin 135 të ligjit nr. 29/2024 "*Për burimet ujore"*. Për këtë shkelje, në procesverbalin e inspektimit është vendosur dënimi administrativ kryesor "*Paralajmërim",* si dhe dënimi administrativ plotësues që subjekti të pajiset me leje për shfrytëzimin e burimit ujor nga organet përkatëse. Të njëjtat gjetje dhe masa janë reflektuar edhe në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit. Sipas trupës inspektuese, vendosja e masës "Paralajmërim" është mbështetur në pikën 1 dhe 2 të nenit 44të ligjit nr. 99/2024 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar, ku përcaktohet se paralajmërimi është dënimi administrativ kryesor në inspektimin e parë dhe aplikohet në rastet kur konstatohen shkelje që përbëjnë kundërvajtje administrative.
Nga auditimi i listëverifikimit dhe procesverbalit u konstatua se operatori ushtron veprimtari, përdorim të burimeve ujore, pa u pajisur me leje mjedisore përkatëse nga organet kompetente të menaxhimit të burimeve ujore, konkretisht nga organet e menaxhimit dhe administrimit të burimeve ujore, sipas kërkesave të nenit 35, të ligjit nr. 29/2024 *"Për burimet ujore".* Këto veprime dhe mosveprime përbëjnë shkelje të drejtpërdrejta pikave 1 dhe 2 të nenit 135 të ligjit nr. 29/2024 *"Për burimet ujore"* i cili përcakton se:
1. Veprimtaritë e mëposhtme që mund të kryhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ushtrohen në bazë të lejes së dhënë nga organet e menaxhimit dhe administrimit të burimeve ujore:
a) përdorimi i burimeve ujore për qëllime të ndryshme kur realizohet përmes instalimeve artificiale;
b) përdorimi i burimeve ujore për ujitje;
c) përdorimi i burimeve ujore për qëllime industriale dhe procese teknologjike;
ç) përdorimi i burimeve ujore për prodhim energjie dhe ftohjeje;
d) përdorimi i burimeve ujore për pishina;
dh) përdorimi i burimeve ujore për ujë të ambalazhuar, tregtim dhe eksport;
e) përdorimi i i burimeve ujore kurative, minerale, termo-minerale dhe gjeotermale;
ë) përdorimi i burimeve ujore për hidroenergji;
f) përdorimi i burimeve ujore për zhvillimin e akuakulturës;
g) përdorimi i burimeve ujore për gjënë e gjallë kur shoqërohet me instalime artificiale.
2. Kërkohet leja përkatëse nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për këto raste:
a) përdorimi i burimeve ujore për qëllime familjare kur shoqërohet me instalime artificiale;
b) përdorimi i burimeve ujore për gjënë e gjallë kur shoqërohet me instalime artificiale;
c) përdorimi i burimeve ujore për ujitje për sipërfaqe më të vogël apo të barabartë me 5 hektarë.
Ligjvënësi, në nenin 169, shkronja "dh", të ligjit nr. 29/2024 *"Për burimet ujore"*, ka parashikuar shprehimisht se veprimtaritë e kryera në kundërshtim me pikat 1 dhe 2 të nenit 135 përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen me gjobë, duke përcaktuar qartë dhe pa ekuivok kufijtë minimalë dhe maksimalë të sanksionit administrativ, në varësi të organit që jep lejen. Kjo dispozitë është e qartë, e drejtpërdrejtë dhe nuk i lë hapësirë organit inspektues për zëvendësimin e gjobës me një masë tjetër administrative. Konkretisht kjo dispozitë parashikon:
dh) veprimtaritë e kryera në kundërshtim me pikat 1 dhe 2 të nenit 135 të këtij ligji lidhur me përdorimin me leje të burimeve ujore, përbëjnë kundërvajtje administrative. Kur për veprimtarinë ligji parashikon dhënien e lejes nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, shkelja administrative ndëshkohet me gjobë nga 100,000 lekë deri në 500,000 lekë. Kur për veprimtarinë ligji parashikon dhënien e lejes nga Këshilli i Basenit Lumor, shkelja administrative ndëshkohet me gjobë nga 500,000 lekë deri në 1,000,000 lekë. Kur ligji parashikon dhënien e lejes nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, shkelja administrative ndëshkohet me gjobë nga 1,000,000 lekë deri në 2,000,000 lekë;

Vendosja e masës administrative *"paralajmërim"* në këtë rast është rezultat i një interpretimi të gabuar të dispozitës së ligjit për inspektimin që parashikon paralajmërimin si masë administrative. Dispozita që përcakton se "*në të gjitha rastet kur konstatohen shkelje të kërkesave ligjore, që përbëjnë kundërvajtje administrative, subjekti i inspektimit dënohet me paralajmërim"* ka karakter parimor dhe nuk mund të zbatohet në mënyrë të shkëputur nga pikat e tjera të të njëjtit nen, të cilat e kufizojnë qartë përdorimin e paralajmërimit vetëm në rastet kur ligji material nuk parashikon një sanksion të caktuar ose kur bëhet fjalë për shkelje të lehta.
Në rastin konkret, ligji nr. 29/2024*"Për burimet ujore"* jo vetëm që parashikon sanksion administrativ për shkeljen e konstatuar, por e cilëson atë shprehimisht si kundërvajtje administrative dhe përcakton masën përkatëse të gjobës. Për rrjedhojë, zbatimi i paralajmërimit përbën shmangie nga zbatimi i ligjit material dhe bie ndesh me parimin e ligjshmërisë, sipas të cilit organi administrativ është i detyruar të zbatojë normën ligjore të posaçme dhe të detyrueshme. Për më tepër, mungesa e lejeve për përdorimin e burimeve ujore cenon drejtpërdrejt mbrojtjen e burimeve ujore dhe ekuilibrin mjedisor. Në këto kushte, vendosja e një mase paralajmëruese është jo proporcionale dhe nuk përmbush funksionin parandalues dhe ndëshkues të sanksioneve administrative. Si konkluzion, trupa inspektuese nuk duhej të kishte vendosur masën administrative *"paralajmërim",* pasi shkeljet e konstatuara janë të parashikuara shprehimisht nga ligji nr. 29/2024 *"Për burimet ujore"* si kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen me gjobë.
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: A. B, M. H, E. H.

11. Subjekti B SHPK me NIPT: K.....**M,** Inspektimi me nr. AKM-FR-2023-000128, me objekt inspektimi: "*Inspektim mbi zbatimin mbi kushtet e lejes mjedisore"*, Inspektorët: E. Z dhe E. Sh.
Nga listëverifikimi është eviudentuar se: "*Operatori ka paguar tarifën vjetore për vitin 2023, ndërkohë që subjekti nuk ushtron aktivitet prej dy vitesh në karrierë. Gjithashtu, evidentohet se në datën 16.12.2021 operatori ka njoftuar AKM-në për ndërprerjen e aktivitetit, për shkak se ndodhej në pritje të rinovimit të lejes minerare. Në vijim, të gjitha rubrikat e tjera të listë verifikimit janë plotësuar me shënimin "Nuk kryhet aktivitet prej vitit 2021".*
Sipas procesverbalit të trupës isnpektuese, gjatë inspektimit në subjekt nuk janë konstatuar mjete që kryenin aktivitet për nxjerrjen e gurit gëlqeror, si dhe nuk janë vërejtur problematika mjedisore, si shkarkime në ajër apo zhurma. Operatori ka deklaruar se aktiviteti nuk ushtrohej prej dy vitesh dhe ka vënë në dispozicion njoftimin e dërguar AKM-së në dhjetor të vitit 2021, për ndërprerjen e aktivitetit për shkak të përfundimit të afatit të lejes minerare dhe pritjes për rinovimin e saj. Megjithatë, është konstatuar se ky njoftim nuk shoqërohej me elementë provues të dorëzimit zyrtar, si datë postare, vulë postare apo konfirmim marrjeje nga ana e institucionit AKM. Për këtë arsye, është evidentuar detyrimi i operatorit për të mbajtur korrespondencë të saktë dhe të dokumentuar me AKM-në, si dhe për të zbatuar kushtet e lejes mjedisore, konkretisht kushtin nr. 6, pika 6.2.2 *"Njoftimet".*
Nga auditimi i procesverbalit të inspektimit është konstatuar se për shkeljet e konstatuara, në seksionin e kundërvajtjeve administrative është vendosur masa administrative kryesore *"Paralajmërim",* duke u referuar pikës 1/b (ii) të nenit 29 të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 *"Për lejet e mjedisit",* ku përcaktohet: "*Mos përmbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipave A, B apo C nga operatori i një instalimi: ii) për lejet e mjedisit të tipit B, dënohet me gjobë në vlerën nga 300,000 deri në 500,000 lekë."*
Për sa më sipër, konstatohet se masa e dhënë në procesverbalin e inspektimit me nr. AKM-FR-2023-000128–2, datë 20.10.2023, nuk është e mbështetur në referencën e duhur ligjore, pasi dispozita e cituar nuk parashikon masën administrative "*paralajmërim"*, por masën administrative kryesore "*gjobë*". Gjithashtu, në vendimin përfundimtar të inspektimit, datë 20.10.2023, nuk janë

përcaktuar qartë gjetjet konkrete të konstatuara gjatë inspektimit, por është shënuar në mënyrë të përgjithshme se janë konstatuar shkelje të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 *"Për lejet e mjedisit",* neni 29, pika 1, shkronja b, ii. Nga verifikimi i dokumentacionit administrativ rezulton se subjekti kishte njoftuar AKM-në me shkresën nr. EX, datë 16.12.2023, e protokolluar në AKM me nr. 6443, datë 16.12.2023, për moszhvillimin e aktivitetit. Megjithatë, edhe në këtë vendim, në seksionin e kundërvajtjeve administrative është vendosur sërish masa "*Paralajmërim"*.
Grupi i auditimit vlerëson se masa administrative "*paralajmërim"* është e pambështetur në bazën përkatëse ligjore, pasi shkelja e një prej kushteve të lejes mjedisore dhe mungesa e provimit se njoftimi ndaj AKM-së është bërë në mënyrë të dokumentuar dhe përpara kryerjes së inspektimit, përbën shkelje të kushteve të lejes mjedisore të tipit B.
Në këto kushte, duhet të ishte aplikuar masa administrative "*gjobë",* në përputhje me pikën 1/b (ii) të nenit 29 të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 *"Për lejet e mjedisit*", veçanërisht duke marrë parasysh faktin se subjekti ka pasur shkelje të kushteve të lejes edhe në inspektimet e mëparshme, të cilat trajtohen si më poshtë:
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: E. Z dhe E. Sh.

12. Subjekti B. SHPK me NIPT K.....**M,** Inspektimi me nr. AKM-DQ-2021-000101me objekt inspektimi: "*Zbatim i kushteve te lejes mjedisore"*, Inspektorët: P. M, K. A dhe L. S.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit janë evidentuar mangësi, konkretisht: mosparaqitja e raportit vjetor të mjedisit nga ana e subjektit; mosparaqitja e planit të përputhshmërisë sipas kushtit nr. 4 të lejes mjedisore; mosdisiplinimi i ujërave sipërfaqësorë dhe mungesa e ndërtimit të vaskës së dekantimit, në kundërshtim me kushtin nr. 7.3; mungesa e kontratave me subjekte të licencuara për trajtimin dhe evadimin e mbetjeve, në kundërshtim me kushtin nr. 8; mosparaqitja e dokumentacionit mbi monitorimin dhe rehabilitimin e karrierës, në kundërshtim me kushtin nr. 11; si dhe mosplotësimi i kërkesave për dokumentim dhe raportim sipas kushtit nr. 12 të lejes mjedisore. Për këto shkelje, në procesverbalin e inspektimit janë vendosur masa administrative në formën e gjobave në vlerat 300,000 lekë, 1,000,000 lekë dhe 1,000,000 lekë, të cilat janë reflektuar edhe në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit, së bashku me detyrat për përmirësimin e situatës dhe për përmbushjen e kushteve të lejes mjedisore. Subjekti i inspektuar ka paraqitur kontestimet mbi procesverbal me shkresën e protokolluar në AKM me nr. 44591/1, datë 20.10.2021 si më poshtë: *"Infrastruktura si vaska e dekantimit për menaxhimin e duhur të ujërave sipërfaqësorë të shkallëve të karrierës, është ndërtuar shoqëruar me fotot përkatës. Janë paraqitur raporte dhe planet si dhe kontrata për menaxhimin e integruar të mbetjeve".*
Nga verifikimi, në sistem, tek seksioni *"Dokumente"* mungon kontrata për menaxhimin e integruar të mbetjeve, në kundërshtim me referencën e paraqitur nga subjekti në kontestim. Në vendim, te seksioni *"Kundërvajtje administrative"* nuk figuron asnjë masë, ndryshe nga procesverbali që përmbante tre masa administrative. Gjatë inspektimit në terren, trupa konstatoi mosndërtimin e vaskës dekantuese, por nuk ka paraqitur asnjë argument ose provë mbi shqyrtimin e kontestimit të subjektit dhe ndryshimin e qëndrimit. Kjo ka sjellë përjashtimin e shkeljes së raportuar në procesverbal nga vendimi përfundimtar dhe shmangien e tre masave administrative të parashikuara aty.
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: P. M, K. A dhe L. S.

13. Subjekti B. SHPK me NIPT K.....**M,** Inspektimi me nr. AKM-FR-2022-000004, me objekt inspektimi: "*Urdhër nga Drejtori i Përgjithshëm nr. 25 datë 07.02.2022 "Për ngritjen e grupeve*

të punës për evidentimin e problematikave mjedisore të veprimtarive minerare me karrierë (guroret) në territor", Inspektorët: D. V dhe A. C.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit janë evidentuar mangësi, konkretisht: në lidhje me kushtin nr. 14 "*Çmontimi, rehabilitimi dhe kontrolli pas ndërprerjes së operacioneve*", subjekti nuk ka vënë në dispozicion planet e rehabilitimit vjetor dhe nuk ka paraqitur pranë AKM për miratim planin e rehabilitimit, në kundërshtim me kërkesat e lejes mjedisore. Në procesverbalin e inspektimit kjo gjetje është pasqyruar në të njëjtën formë, ndërsa në seksionin e kundërvajtjeve administrative është vendosur dënimi administrativ kryesor "*Paralajmërim",* në mbështetje të pikës 1 të nenit 48 të ligjit nr. 10433 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, masë e cila është reflektuar edhe në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit, së bashku me detyrimin për paraqitjen e planit të rehabilitimit pranë AKM dhe fillimin e procesit të rehabilitimit të objektit.
Nga auditimi konstatohet se procesverbali i inspektimit nuk është i plotësuar në të gjitha rubrikat përkatëse në kundërshtim me pikën 3 të nenit 45 të ligjit nr. 10433/2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* i cili kërkon që procesverbali të përmbajë informacion të plotë dhe të detajuar mbi veprimet e inspektimit, gjetjet dhe vendimet procedurale të marra.
Gjithashtu grupi i auditimit vlerëson se masa administrative "*Paralajmërim*" e lënë në Vendimin Përfundimtar të inspektimit nuk është e një rëndësie të vogël, por është shkelje e një prej kushteve të lejes e cila parashikohet në ligjin e posaçëm, konkretisht në nenin 29, pika i/b (ii), të ligjit "*Për lejet e mjedisit*", ndërsa referenca e përdorur nga trupa inspektuese nuk konsiderohet e argumentuar, neni 48, pika 1 përcakton: *"Kur konstatohet shkelje e kërkesave ligjore, që përbën kundërvajtje administrative, por që është e një rëndësie të vogël, apo për të cilën ligji i posaçëm nuk parashikon dënimin përkatës administrativ, subjekti i inspektimit dënohet me "paralajmërim".* Paralajmërimi është dënim administrativ kryesor". Kushtet e lejes nuk janë të një rëndësie të vogël.
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: D. V dhe A. C.

14. Subjekti B-X me NIPT K.....N, Inspektimi me nr. AKM-FR-2024-000159, me objekt inspektmi: Kontroll mbi zbatimin e kushteve të Lejes Mjedisore me PN-9001-07-2019, Inspektorët: E. H, L. I dhe S. J.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit janë evidentuar mangësi, konkretisht: gjatë verifikimit në terren është konstatuar se instalimi nuk ishte në punë, ndërkohë që operatori ushtron aktivitet në kuadër të punimeve për by-pass-in Vlorë dhe ka në dispozicion dokumentacion mjedisor përkatës (plan çmontimi dhe rehabilitimi, raport vetmonitorimi, raport vjetor dhe plan përputhshmërie); megjithatë, është evidentuar se sipërfaqja e ushtrimit të veprimtarisë nuk ishte e rrethuar, duke mos garantuar ndalimin e hyrjes së faunës dhe përmirësimin e pamjes vizuale. Gjithashtu, konstatohet se rubrikat e tjera të listëverifikimit rezultojnë të paplotësuara. Në procesverbalin e inspektimit është pasqyruar si gjetje mungesa e rrethimit të sipërfaqes së ushtrimit të aktivitetit, ndërsa në seksionin e kundërvajtjeve administrative është vendosur masa "*Paralajmërim*", në mbështetje të nenit 48 të ligjit nr. 10433 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar"*. E njëjta gjetje dhe masë administrative janë reflektuar edhe në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit nr. AKM-FR-2024-000159-5, datë 10.09.2024.
Nga verifikimi i kryer nga grupi i auditimit mbi Lejen Mjedisore të tipit B të subjektit, me nr. 3026, datë 10.07.2019, u konstatua se gjetja e evidentuar nga trupa inspektuese: "Sipërfaqja e ushtrimit të veprimtarisë nuk ishte e rrethuar në mënyrë që të bënte të mundur ndalimin e hyrjes së faunës së zonës dhe përmirësimin e pamjes vizuale" përbën mosplotësim të një prej kushteve të lejes mjedisore, konkretisht kushtit *"1.5.9: Të jenë marrë të gjitha masat e nevojshme për rrethimin e objektit ku zhvillohet veprimtaria, me qëllim shmangien e hyrjeve të faunës së zonës"*.

Nga verifikimi i mëtejshëm rezultoi se për mosplotësimin e kushteve të lejes mjedisore të tipit B, pika i/b (ii) e nenit 29, të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 *"Për lejet e mjedisit"*, i ndryshuar, parashikon vendosjen e dënimit administrativ me gjobë në vlerën nga 300,000 deri në 500,000 lekë. Gjithashtu, nga verifikimi në sistemin e inspektimeve u konstatua se subjekti ka qenë objekt i inspektimeve të mëparshme, konkretisht në çështjen me nr. AKM-DQ-2022-000625, datë 31.10.2022, ku është konstatuar mosplotësim i kushteve të lejes mjedisore, duke evidentuar përsëritje të shkeljes.
Në këto kushte, grupi i auditimit konstaton se vendosja e dënimit administrativ kryesor "*Paralajmërim*" nga trupa inspektuese nuk është aplikuar në mënyrë të drejtë, pasi në rastin konkret, duke marrë në konsideratë natyrën e shkeljes dhe përsëritjen e saj, duhet të ishte vendosur dënimi "*Gjobë",* në zbatim të pikës 1/b (ii) të nenit 29,të ligjit nr. 10448/2011, në intervalin 300,000–500,000 lekë.
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: E. H, L. I dhe S. J.

15. Subjekti A me NIPT K.....I, Inspektimi me nr. AKM-FR-2023-000208, me objekt inspektimi: "*Inspektim në fushën e shfrytëzimit të burimit ujor si dhe shkarkimet që gjenerohen nga ky aktivitet",*Inspektorët: M. H dhe B. F.
Nga trupia inspektuese sipas listëverifikimit është evidentuar se: *"Subjekti furnizohet me ujë nga rrjeti i ujësjellësit të qytetit të Këlcyrës, vërtetuar nga kontrata si dhe faturat periodike të furnizimit me ujë. Duhet evidentuar që subjekti disponon një leje të shfrytëzimit të burimit ujor me nr. 3, datë 05.04.2018, me afat 5-vjeçar, e cila nuk është rinovuar për arsye objektive",* dhe përpos kësaj evidentohet edhe një rubrikë e plotësuar, mbi trajtimin e shkarkimeve të lëngëta nga veprimtaritë që shkarkojnë ujëra të ndotura, ku është evidentuar se nga subjekti është kryer trajtim parësor i ujërave, nëpërmjet sistemit të dekantimit. Në procesverbalin e inspektimit, në seksionin e gjetjeve, trupa inspektuese nuk ka paraqitur asnjë gjetje, pavarësisht se në listë verifikim ka evidentuar se subjektit i ka përfunduar afati i lejes për shfrytëzimin e burimeve ujore.
Grupi i auditimit vlerëson se lista e verifikimit e inspektimit është e paplotësuar në rubrikat përkatëse (20 nga 22 rubrika të paplotësuara), në shkelje të pikës 26, Kreu V, të Urdhrit nr. 25, datë 10.08.2018, dhe se procesverbali i datës 12.12.2023 nuk përmban informacion mbi përfundimin e vlefshmërisë së lejes për përdorimin e burimeve ujore, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 45 të ligjit nr. 10433/2011. Mungesa e informacionit të detajuar në listëverifikim, procesverbal dhe vendim përfundimtar nuk lejon grupin e auditimit të konkludojë nëse subjekti ka përdorur ujë pa leje, duke sjellë një pasqyrim të cunguar të zbatimit të kërkesave ligjore për përdorimin e ujërave sipas nenit 41 të ligjit nr. 111/2012.
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: M. H dhe B. F.

16. Subjekti A. I. C, me NIPT K.....Q, Inspektimi me nr. AKM-FR-2023-000179-2/1, datë 04.12.2023, me objekt inspektimi: "*Inspektim mbi zbatimin e kushteve të VNM-së"*, Inspektorët: E. Z dhe E. Sh.
Nga verifikimi i listëverifikimit dhe procesverbalit të inspektimit u evidentuan mangësitë si në vijim: në lidhje me zbatimin e nenit 26/a të ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011, *"Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"*, në të gjitha rubrikat e listëverifikimit është dhënë i njëjti koment standard "Subjekti është drejt përfundimit të projektit, nuk ka problematika mjedisore dhe nuk ka raportuar në AKM", pa një vlerësim të diferencuar sipas elementëve të kontrollit. Në procesverbalin e inspektimit është reflektuar e njëjta gjetje, konkretisht mosraportimi pranë AKM-së sipas kushteve të lejes, ndërsa në seksionin e kundërvajtjeve administrative është vendosur dënimi administrativ kryesor "*Paralajmërim*", në mbështetje të nenit 48 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, *"Për*

inspektimin në Republikën e Shqipërisë". Në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit, përveç masës "Paralajmërim", janë lënë edhe masa korrigjuese, konkretisht: kryerja e raportimit periodik në mënyrë të menjëhershme sipas kushteve të VNM-së pranë AKM-së, si dhe përgatitja dhe dorëzimi i raportit përfundimtar në përfundim të projektit. Nga verifikimi i kryer nga grupi i auditimit u konstatua se plotësimi formal dhe i njëjtë i të gjitha rubrikave të listëverifikimit, si dhe pasqyrimi i kufizuar i gjetjeve në procesverbal, nuk siguron një vlerësim të plotë dhe të detajuar të përmbushjes së kushteve të lejes mjedisore, duke cenuar cilësinë dhe besueshmërinë e procesit të inspektimit.

Grupi auditimit konstaton mosplotësim të rubrikave përkatëse, të procesverbalit, veprim në kundërshtim me pikën 3 të nenit 45 të ligjit nr. 10433 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* ku përcaktohet se: *"Procesverbali përmban informacion të hollësishëm për veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit dhe shoqërohet me listë verifikimin e plotësuar gjatë inspektimit".*

Konstatohet gjithashtu se në lidhje detyrat e lëna nga trupa inspektuese nuk konstatohet të jetë kryer ri inspektim; në portalin e-Inspektimi, veprim në kundërshtim me pikat 15–17, kreu IV, të Urdhrit të Inspektoratit Qendror nr. 25, datë 10.08.2018, për miratimin e rregullores *"Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve si një proces i rregullt administrativ",* ku përcaktohet:

15. Subjekti, objekt inspektimi, është i detyruar të njoftojë për korrigjimin e shkeljeve, brenda afatit të përcaktuar nga trupa inspektuese në vendimin përfundimtar të inspektimit të mëparshëm dhe, nëse është e nevojshme, të paraqesë edhe provat që vërtetojnë këtë fakt.

16. Për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve të konstatuara nga trupa inspektuese, kryhet një inspektim i ri. Në rastet kur nga ri inspektimi rezulton se subjekti nuk ka zbatuar detyrat e lëna nga inspektimi i mëparshëm, procedohet me masë administrative.

17. Procedura e inspektimit dhe ri inspektimit kryhen online në portalin e-Inspektimi.

Gjithashtu konstatohet se, për mos raportimin për VNM-të paraprake, bazuar në ligjin nr. 10440, datë 07.07.2011, *"Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"*, i ndryshuar, neni 25/1 *"Monitorimi dhe vlefshmëria*", pikat 1, 2 dhe 3, përcakton se:

1. AKM-ja përcakton llojin e parametrave që monitorohen dhe kohëzgjatjen e monitorimit, në raport me natyrën, vendndodhjen dhe madhësinë e projektit, si dhe me ndikimet e rëndësishme të tij në mjedis, të cilat parashikohen në vendimin për VNM-në paraprake apo në deklaratën mjedisore.

2. Zhvilluesi, gjatë fazës së zbatimit të projektit, kryen vetë monitorimin e ndikimeve të rëndësishme të projektit në mjedis dhe i raporton AKM-së për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit.

3. Struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e mjedisit inspekton ndikimet në mjedis nga zbatimi i projektit, si dhe kushtet e monitorimit të përcaktuara në vendimin për VNM-në paraprake apo në deklaratën mjedisore.

Nga auditimi konstatohet se ndaj subjektit nuk është aplikuar dënimi administrativ me gjobë, në kundërshtim me nenin 26 *"Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet",* pika 1, shkronja b, nën shkronja i, të ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011, *"Për vlerësimin e ndikimit në mjedis*", i cili përcakton se:

1. Shkeljet e këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

b) mos përmbushja dhe mosrespektimi i kushteve nga zhvilluesi i projektit:

i) për vendimin për VNM-në paraprake dënohet me gjobë nga 65,000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë deri në 260,000 (dyqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë.

Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: E. Z dhe E. Sh.

17. Subjekti E. B me NIPT K.....**B,** Inspektimi me nr. AKM-FR-2023-000261, me objekt inspektimi: "*Inspektim VNM Paraprake për projektin Objekt banimi dhe shërbimeve me 11 kate mbi tokë, 2 kate parkim nëntokë. zona kadastrale: 8602, nr. pasurisë: 36/256. rruga Mehmet Agaliu, Bashkia Vlorë"*, Inspektorët: A.H dhe A. C.

Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit u evidentuan mangësitë si në vijim: në lidhje me zbatimin e nenit 26/a të ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011, *"Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"*, zhvilluesi gjatë fazës së zbatimit të projektit nuk ka raportuar në AKM për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit; nuk është zbatuar kushti nr. 4 *"Monitorimi dhe Raportimi*" sipas afateve të përcaktuara në VNM-në paraprake; në lidhje me zbatimin e kushteve të Deklaratës Mjedisore është konstatuar se operatori është pajisur me vendim për VNM paraprake, por nuk ka kryer raportimet përkatëse; si dhe në lidhje me masat parandaluese të dëmit në mjedis, sipas nenit 69, pika "e" të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011, *"Për mbrojtjen e mjedisit"*, zhvilluesi ka deklaruar se nuk ka raportuar në AKM. Nga verifikimi i procesverbalit u konstatua se janë reflektuar të njëjtat gjetje si në listëverifikim, si dhe është evidentuar se operatori nuk ka njoftuar për fillimin e punimeve dhe nuk ka zbatuar kushtin e monitorimit dhe raportimit, ndërsa në seksionin e kundërvajtjeve administrative është vendosur dënimi administrativ kryesor "*Paralajmërim*", në mbështetje të pikës 1 të nenit 48 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, "*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*. Të njëjtat gjetje dhe masa administrative janë reflektuar edhe në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit

Grupi auditimit konstaton mosplotësim të rubrikave përkatëse, të procesverbalit, veprim në kundërshtim me pikën 3 të nenit 45 të ligjit nr. 10433 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* ku përcaktohet se: *"Procesverbali përmban informacion të hollësishëm për veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit dhe shoqërohet me listë verifikimin e plotësuar gjatë inspektimit".* Në lidhje me shkeljet e evidentuara nga trupa inspektuese, grupi i auditimit gjykon se për mos raportimin për VNM-të paraprake, është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 10440, datë 07.07.2011, *"Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"*, i ndryshuar, neni 25/1 *"Monitorimi dhe vlefshmëria"*, pikat 1, 2 dhe 3, përcakton se:

"1. AKM-ja përcakton llojin e parametrave që monitorohen dhe kohëzgjatjen e monitorimit, në raport me natyrën, vendndodhjen dhe madhësinë e projektit, si dhe me ndikimet e rëndësishme të tij në mjedis, të cilat parashikohen në vendimin për VNM-në paraprake apo në deklaratën mjedisore.

2. Zhvilluesi, gjatë fazës së zbatimit të projektit, kryen vetë monitorimin e ndikimeve të rëndësishme të projektit në mjedis dhe i raporton AKM-së për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit.

3. Struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e mjedisit inspekton ndikimet në mjedis nga zbatimi i projektit, si dhe kushtet e monitorimit të përcaktuara në vendimin për VNM-në paraprake apo në deklaratën mjedisore".

Nga auditimi konstatohet se ndaj subjektit nuk është aplikuar dënimi administrativ me gjobë, në kundërshtim me nenin 26 *"Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet"*, pika 1, shkronja b, nën shkronja i, të ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011, *"Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"*, i cili përcakton se:

1 Shkeljet e këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

b) mos përmbushja dhe mosrespektimi i kushteve nga zhvilluesi i projektit:

i) për vendimin për VNM-në paraprake dënohet me gjobë nga 65 000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë deri në 260 000 (dyqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë.

Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: A.H dhe A. C.

Në lidhje me subjektin e mëposhtëm, nga AKM është shfuqizuar masa administrative e vendosur nga ARM Fier, trajtuar si në vijim:

18. Subjekti T.S (ish T. G) me NIPT L.....I, me objekt aktiviteti *"Për shfrytëzim nafte"* me leje Mjedisi Tipi B me PN-4139-09-2012, ka marrë masë administrative gjobë në vlerën 5,000,000 lekë, nëpërmjet vendimit përfundimtar të inspektimit nr. AKM-FR-2023-000156-5 datë 26.10.2023.
Sipas procesverbalit nr. AKM-FR-2023-000156-2, datë 26.10.2023, listës së verifikimit nr. FR-2023-000156-2/1 datë 26.10.2023, dhe Vendimit përfundimtar të Inspektimit AKM-FR-2024-000168-5, datë 03.10.2024, rezultojnë këto gjetje:
- Gjatë inspektimit mbi ndotjen e Lumit Gjanica, u konstatua se në vendin e quajtur Oficinë e Vjetër Visokë shkarkim i lëndëve hidrokarbure së bashku me ujin teknologjik që gjenerohet nga aktiviteti i dekantimit të lëndëve hidrokarbure. E gjithë kjo u evidentua përgjatë përroit e shoqëruar dhe me foto dhe video, lëndë kjo që përfundon nga përroi (kanali) në lumin Gjanica, në kundërshtim me ligjin nr. 111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", neni 30, pika 7.
Subjekti ka ankimuar vendimin me shkresën nr. 9221 prot., datë 06.11.2023, depozituar pranë AKM-së.
Nga ana e subjektit pretendohet se nga ana e përfaqësuesit të inspektimit në terren nuk është verifikuar që nga aktiviteti i T. S të ketë ndodhur shkarkim që mund të ketë rezultuar në ndotjen e mëtejshme të lumit Gjanica dhe se nga ana e inspektorëve të ARM-së nuk është mbajtur asnjë procesverbal inspektimi në vendndodhje dhe nuk është vënë në dijeni për procesverbalin.
Komisioni i shqyrtimit të Ankimimit, i përbërë nga:
- Znj. A. D Kryetar
- z. K. A Anëtar
- znj. N. N Anëtar
- znj. A. Z Anëtar
- znj. J. B.

Ky komision në vlerësim të ankimimit të subjektit, citon se: "...referuar procedurës së inspektimit është në kundërshtim me nenin 43 pika 4 ku citohet: *"Nëse është e mundur, qëllimi për të marrë një masë urgjente i njoftohet, paraprakisht, në mënyrë verbale, përfaqësuesit të subjektit të inspektimit, duke i dhënë mundësinë për të paraqitur pa vonesë komentet dhe shpjegimet përkatëse"* dhe 9 ku citohet: *"Kundër vendimit të masës urgjente, subjekti i interesuar ka të drejtën e ankimit të veçantë, sipas nenit 44 të këtij ligji" duke mos i dhënë mundësinë subjektit për të paraqitur shpjegimet përkatëse për sa i përket masës urgjente, neni 45 pika 4 ku citohet "Procesverbali i inspektimit përmban, gjithashtu, informacion për të drejtën e subjektit të inspektimit që të paraqesë me shkrim apo me gojë shpjegimet apo kontestimet e tij për faktet dhe rrethanat e konstatuara në procesverbal, brenda një afati të përcaktuar nga inspektori, por jo më të shkurtër se 8 ditë nga data e njoftimit të procesverbalit, për paraqitjen e këtyre komenteve, si dhe organin ku paraqiten këto komente. Pas kalimit të këtij afati, vendimi përfundimtar mund të merret pa qenë i nevojshëm dëgjimi i mëtejshëm i subjektit të inspektimit. Shpjegimet apo kontestimet e subjektit të inspektimit janë pjesë e dosjes"*, neni 46 pika 1 ku citohet: *"Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm, vendimi përfundimtar i inspektimit merret nga inspektori apo inspektorët që kanë kryer inspektimin, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të procesverbalit subjektit të inspektimit".*
Ky komision në vlerësim të ankimimit të subjektit, ka vendosur për shfuqizim të masës

administrative duke u bazuar në nenin 43-46 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".
Grupi i auditimit vlerëson se vendimi i Komisionit të Ankimimit për shfuqizimin e masës administrative ndaj subjektit *"T. O. S"* është i pambështetur në prova, i paargumentuar juridikisht dhe në kundërshtim me detyrimet që burojnë nga legjislacioni mjedisor, kushtetues dhe procedural.
Në Ankesën Administrative të depozituar pranë AKM-së me nr. 2921 prot., datë 06.11.2023, subjekti *"T. O. S"* ka pretenduar se nga aktiviteti i tij nuk është shkarkuar ujë i ndotur në përroin që përfundon në lumin Gjanica dhe se sipas tij nuk është mbajtur procesverbal inspektimi në vend.
Në ankimin e paraqitur, subjekti ka kërkuar shfuqizimin e vendimit përfundimtar të inspektimit, pa ngritur asnjë pretendim lidhur me afatin e ankimimit të vendimit të ndërmjetëm, duke mos e konsideruar këtë si cenim të të drejtave procedurale.
Pavarësisht këtij fakti, Komisioni i Ankimimit ka bazuar vendimin e shfuqizimit mbi pretendimin se subjekti nuk është informuar për afatin 5-ditor të ankimimit të vendimit të ndërmjetëm, duke mos shqyrtuar aspak shkeljen thelbësore të konstatuar në terren. Nga inspektimi i datës 26.10.2023 rezulton se është mbajtur procesverbal dhe është dokumentuar me foto dhe video, gjithashtu është konstatuar se është kryer shkarkim i ujërave industriale të përziera me lëndë hidrokarbure në përroin që derdhet në lumin Gjanica. Kjo situatë përbën shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 30, pika 3 dhe 7 të ligjit nr. 111/2012 *"Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore",* i cili detyron subjektet të menaxhojnë dhe trajtojnë ujërat industriale sipas parimit *"Ndotësi paguan"* dhe ndalon çdo shkarkim të pakontrolluar në mjedisin ujor pa trajtim dhe pa monitorim nga organet kompetente. Në asnjë moment Komisioni i Ankimimit nuk është shprehur se gjetjet e inspektimit nuk qëndrojnë, por ka shfuqizuar masën administrative vetëm mbi një mospërputhje procedurale që nuk lidhet me objektin e ankesës së subjektit. *Për më tepër, në referim të neneve 43 dhe 44 të ligjit nr. 10433/2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", ankimi i veçantë ndaj vendimit të ndërmjetëm paraqitet dhe shqyrtohet sipas kompetencës së përcaktuar shprehimisht nga ligji. Në rastin konkret, nëse subjekti do të kishte ushtruar ankim ndaj vendimit të ndërmjetëm, organi kompetent për pranimin dhe shqyrtimin e këtij ankimi do të ishte Drejtoria Rajonale e ARM Fier, si autoriteti territorial përgjegjës për ushtrimin e funksionit inspektues. Për rrjedhojë, çdo trajtim i pretendimeve që lidhen me ligjshmërinë ose afatet e vendimit të ndërmjetëm nga një organ tjetër, jashtë kësaj kompetence ligjore, bie ndesh me parashikimet e ligjit dhe parimin e kompetencës administrative.*
Vlen të theksohet se AKM-ja, si autoritet publik, ka mision kushtetues dhe ligjor mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit, në funksion të interesit publik, shëndetit të njeriut dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Në këtë kuadër, shkelje të tilla si ndotja e ujërave sipërfaqësore përbëjnë rrezik të drejtpërdrejtë ndaj komunitetit dhe kërkojnë masë të menjëhershme ndaluese dhe korrigjuese. Neni 59, pika dh i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon detyrimin e shtetit për të garantuar shfrytëzimin racional të ujërave dhe burimeve natyrore mbi parimin e zhvillimit të qëndrueshëm, çka nënkupton ndërhyrje të menjëhershme për të parandaluar dhe ndaluar ndotjen e mjedisit ujor.
Gjithashtu, grupi i auditimit vlerëson se Komisioni nuk ka interpretuar drejt dispozitat e ligjit nr. 10433/2011*"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*". Ky ligj nuk parashikon se mospërcaktimi i afatit të ankimimit të vendimit të ndërmjetëm sjell automatikisht pavlefshmërinë e masave materiale të vendosura ndaj subjektit, sidomos në rastet kur shkeljet përbëjnë rrezik të rëndë mjedisor. Për më tepër, subjekti ka ushtruar ankimim ndaj vendimit përfundimtar brenda afatit ligjor, çka tregon se e drejta e tij për t'u ankuar nuk është cenuar.
Për të gjitha arsyet e mësipërme, grupi i auditimit vlerëson se vendimi i Komisionit të Ankimimit është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me ligjin nr. 111/2012, madje

dhe me vetë misionin e AKM-së. Shfuqizimi i masës administrative ka sjellë jo vetëm heqjen e gjobës, por edhe *pezullimin e masës urgjente për ndalimin e shkarkimeve të ujërave industriale dhe për pastrimin e zonës së ndotur, duke vënë në rrezik mjedisin, shëndetin publik dhe interesin e komunitetit.* Në këtë kuadër, një mos përmbushje procedurale nuk mund të prevalojë mbi mbrojtjen e mjedisit dhe interesit publik, të cilët janë të mbrojtur me ligj dhe me Kushtetutë.

Referuar edhe ndryshimit të dispozitave ligjore gjatë vitit 2025, janë marrë me përzgjedhje për auditimin inspektimet si në vijim:

Grupi i auditimit, nga lista totale e kundërvajtjeve administrative "*Paralajmërim*", të dhëna nga trupa inspektuese e ARM Fier, përzgjodhi inspektimet me datë vendimi pas datës 13.05.2025. Për këto raste u krye verifikimi i shkeljeve të evidentuara nga trupa inspektuese në listëverifikim dhe në procesverbalet përkatëse të inspektimit, si dhe u vlerësuan gjetjet e konstatuara nga trupa inspektuese me referencat ligjore përkatëse dhe në ligjet e posaçme në fuqi. Situata e konstatuar paraqitet si më poshtë në tabelën e më poshtë:

Tabela nr. x: *"Paralajmërime me datë vendimi pas 13.05.2025"*

Numri i çështjes	Subjekti	NIPT	Shkelja e konstatuar	Gjykim I gr. Të KLSH-së			Nr.i inspektimeve në sistem
				Referenca ligjore	Masa administrative	Shuma (lekë)	
AKM-FR-2025-000022	N.S	L********Q	Shkelje e kushteve nr. :1; 7.2; 7.3; 7.4 të LM.[16]	Pika1/ b"ii" e nenit 24 të ligjit nr. 9115/2003	Gjobë	300,000-500,000	2
AKM-FR-2025-000050	A.R SHA	J********U	Avari, në momoentin e insektimi po behej rehabilitimi, një pjese e e vogël kishte dalë në sipërfaqe.[17]				39

Burimi: *AKM, përpunoi Grupi Auditimit.*

Nga auditimi e të dhënave të paraqitura në tabelë konstatohet se, për 4 inspektime të kryera gjatë vitit 2025, masa administrative e vendosur ndaj subjekteve të inspektuara ka qenë në të gjitha rastet *"paralajmërim",* pavarësisht llojit të veprimtarisë së subjekteve, natyrës së shkeljeve të konstatuara dhe sanksioneve të parashikuara në ligjet e posaçme mjedisore. Kjo praktikë tregon se trupat inspektuese kanë zbatuar në mënyrë uniforme dhe automatike masën e paralajmërimit, duke u mbështetur kryesisht në interpretimin e pikës 1 të nenit 44 të ligjit nr. 99/2024 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* pa kryer një vlerësim të individualizuar të shkeljeve dhe pa aplikuar masat administrative të përcaktuara shprehimisht në legjislacionin e posaçëm për mjedisin, çka e bën këtë praktikë të papërputhshme me parimin e ligjshmërisë dhe me hierarkinë e normave juridike.

Nga auditimi konstatohet se, gjatë periudhës objekt auditimi, Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011, *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* ka pësuar ndryshime që lidhen me mënyrën e vendosjes së masave administrative ndaj subjekteve të inspektimit.

Në formën e tij para ndryshimeve, Ligji nr. 10433/2011, në nenin 48 "*Shkelja e kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit"*, parashikonte shprehimisht se:

1. Kur konstatohet shkelje e kërkesave ligjore, që përbën kundërvajtje administrative, por që është e një rëndësie të vogël, apo për të cilën ligji i posaçëm nuk parashikon dënimin përkatës administrativ, subjekti i inspektimit dënohet me 'paralajmërim'. Paralajmërimi është dënim administrativ kryesor.

2. Subjekti i inspektimit mund të dënohet drejtpërdrejt me një dënim tjetër kryesor administrativ, më të rëndë, të parashikuar në ligjin e posaçëm, kur:

[16] LM- Leje Mjedisore.

[17] Gjithashtu tarifa paguar përtej afatit të përcaktuar në kushtet e LM.

a) nuk zbaton plotësisht dhe brenda afatit të përcaktuar urdhërimin e parashikuar në pikën 4 të këtij neni;
b) përsërit shkeljen e kërkesave ligjore;
c) shkelja e konstatuar apo pasojat e saj janë të rënda.
Ky formulim ligjor e lidhte drejtpërdrejt zbatimin e masës administrative me përcaktimet e ligjit të posaçëm dhe nuk lejonte përdorimin e masës *"paralajmërim"* në rastet kur shkelja ishte e parashikuar shprehimisht si kundërvajtje administrative me sanksion konkret.
Me miratimin e ligjit nr. 99/2024 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* kjo dispozitë është riformuluar dhe aktualisht përfshihet në nenin 44 "*Dënimi administrativ kryesor",* i cili parashikon se:
6. Paralajmërimi është dënimi administrativ kryesor në inspektimin e parë të trupës së inspektimit.
7. Në të gjitha rastet kur konstatohen shkelje të kërkesave ligjore, që përbëjnë kundërvajtje administrative, subjekti i inspektimit dënohet me paralajmërim.
8. Paralajmërimi, si masë administrative kryesore, vendoset edhe për rastet kur për shkelje të lehta ligji i posaçëm nuk parashikon dënimin përkatës administrativ.
9. Dënimi administrativ kryesor me paralajmërim nuk zbatohet në rastet e shkeljeve të rënda për të cilat parashikohet masa e pezullimit të aktivitetit, sipas ligjit të posaçëm.
10. Dënimi administrativ kryesor me paralajmërim shoqërohet me urdhërimin e subjektit për të korrigjuar shkeljet e konstatuara dhe për të eliminuar pasojat e tyre, duke përcaktuar edhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim.
Nga auditimi konstatohet se kjo dispozitë është interpretuar nga AKM-ja dhe strukturat e saj rajonale në kuptimin se, për çdo subjekt të inspektuar për herë të parë pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 99/2024, masa administrative që duhet të vendoset është vetëm "paralajmërim", pavarësisht llojit të shkeljes dhe pavarësisht sanksioneve të parashikuara në ligjet e posaçme.
Sipas vlerësimit të grupit të auditimit, ky interpretim nuk është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, pasi ligji i inspektimit ka karakter të përgjithshëm dhe procedural, ndërsa ligjet e posaçme mjedisore përcaktojnë shprehimisht shkeljet dhe masat administrative përkatëse.
Në këtë kuadër, aplikimi i masës administrative "paralajmërim", pa marrë në konsideratë llojin dhe rëndësinë e shkeljes dhe pa zbatuar sanksionet e përcaktuara në ligjet e posaçme, bie në mospërputhje me:
- Ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011, *"Për lejet e mjedisit",* neni 29;
- Ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011, *"Për mbrojtjen e mjedisit",* neni 69;
- Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011*, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve",* neni 62;
- Ligjin nr. 29/2024 "*Për burimet ujore*", neni 169.

Për rrjedhojë, nga auditimi konstatohet se vendosja e masës administrative *"paralajmërim"* nga trupat inspektuese gjatë vitit 2025, në rastet kur ligjet e posaçme parashikojnë sanksione konkrete administrative, nuk është në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi dhe nuk garanton zbatimin e plotë dhe efektiv të legjislacionit mjedisor.
Për problematikat e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi inspektorët sipas rasteve të trajtuara në këtë material, përgjegjësi i sektorit të Inspektimeve Mjedisore dhe Burimeve Natyrore dhe Drejtori i ARM Fier, sipas periudhave që kanë mbuluar në pozicionet përkatëse.
Drejtor i ARM Fier: A. V, D. V, A. T; *Përgjegjës Sektori i Inspektimeve Mjedisore*: F. B, A. H; *Përgjegjës Sektori i Burimeve Natyrore dhe Ujrave:* I. M, A. B; inspektorët e përmendur në këtë material.

2.5.4 AGJENCIA RAJONALE MJEDISORE Berat, Elbasan, Korçë

Nga auditimi u konstatua se:

- Për vitin 2021 dhe 2022 nuk është plotësuar për 1 përgjegjës dhe 2 specialistë për Sektorin e Inspektimit të Burimeve Natyrore;
- Për vitin 2023 nuk është plotësuar për 1 përgjegjës dhe 2 specialist në Sektorin e Inspektimit të Mjedisit dhe për 1 specialist në Sektorin e Inspektimit të Mjedisit;
- Për vitin 2024:

- Për periudhën Janar-Prill nuk është plotësuar struktura 1 përgjegjës dhe 3 specialistë në Sektorin e Inspektimit të Burimeve Natyrore dhe 1 specialist në Sektorin e Inspektimit Mjedisor;
- Për periudhën Maj-Dhjetor nuk është plotësuar struktura 1 specialist të në Sektorin e Inspektimit Mjedisor.

- Për periudhën janar-shtator 2025 struktura për Sektorin e Inspektimit të Burimeve Natyrore dhe Sektorin e e Inspektimit të Mjedisit është e plotë.

Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me: Urdhërin nr. 23, datë 03.02.2020 të Kryeministrit "*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së AKM-së*"; Urdhërin nr.187, datë 15.11.2022, të Kryeministrit për "*Miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit";* Urdhërin nr. 29, datë 13.02.2024 të Kryeministrit "*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së AKM-së*" dhe Urdhërin nr. 194, datë 04.10.2024 të Kryeministrit "*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së AKM-së*", skemat 1/2 dhe 2/2, duke rezultuar për periudhën objekt auditimi me vende të lira, krahasuar me numrin e miratuar në organikë, duke sjellë për pasojë ulje të efektivitetit dhe eficiencës në punë. të këtyre sektorëve.

Mbi planifikimin dhe realizim vjetor të inspektimeve:

Programi vjetor hartohet nga drejtori i DIK dhe përcillet te titullari i AKM-së. Përveç inspektimeve të planifikuara janë kryer dhe inspektime të paplanifikuara, kur ka qenë e nevojshme, si në rastet e ankesave, denoncimeve apo informacioni nga të tretët, në raste rishikimesh, etj. Dokumentacionet e inspektimeve janë hedhur në sistemin e *E–Inspektim*. Bazuar në Ligjin nr. 10433, datë 16.06.20011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, realizimi i programit inspektues nga të dy sektorët është si në vijim:

- Për vitin 2021 programi vjetor është realizuar me 44%;
- Për vitin 2022 programi vjetor është realizuar me 35%;
- Për vitin 2023 programi vjetor është realizuar me 43%;
- Për vitin 2024 programi vjetor është realizuar me 77%;
- Për vitin 2025 programi vjetor është realizuar me 32%;

Për periudhën objekt auditimi, *grupi i auditimit konstatoi* mosrealizimin e plotë të programeve vjetore të inspektimit nga të dy sektorët inspektues. Mosrealizimi i plotë i programeve vjetore të inspektimit ndikon në uljen e efektivitetit të funksionit mbikëqyrës dhe kontrollues të strukturave inspektuese, duke krijuar risk për mungesë kontrolli të plotë mbi subjektet që duhet të inspektohen.

Nga auditimi i procesit të planifikimit dhe përgatitjes së programeve vjetore të auditimit për periudhën objekt auditimi, *grupi i auditimit konstatoi se* ARM Berat nuk rezulton të kenë përgatitur Program Vjetor të Inspektimeve. Programi Vjetor i inspektimeve është përgatitur nga AKM pa marrë mendim nga Agjencitë Rajonale. E gjithë kjo situatë është në kundërshtim me Rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit nr. 120 prot., datë 12.01.2021, e miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i AKM-së, Kreu VII, nënkapitulli III.I pika 11, nënkapitulli III.II germa "d", nënkapitulli III.III germa "b" dhe pika 11.

Nga auditimi me zgjedhje i inspektimeve në ARM Berat, të regjistruara në sistemin e-inspektim u

konstatua se nuk është evidentuar informacioni mbi statusin e pagesës së tarifave vjetore të lejeve mjedisore nga subjektet. Mospasja e këtij informacioni pengon identifikimin e subjekteve që nuk kanë kryer pagesat përkatëse dhe kufizon mundësinë e përfshirjes së tyre në planet e inspektimit.
Për sa i përket masave administrative të vendosura, konstatohet se mungon një metodologji e përcaktimeve të dënimeve administrative, në kundërshtim me pikën 7 dhe 8, të nenit 48 të ligjit nr. Nr.10 433, datë 16.6.2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"* ku citohet se:
7. Këshilli i Ministrave miraton rregulloren e përgjithshme të metodologjisë së përcaktimit të dënimeve administrative, në përputhje me parimin e proporcionalitetit.
8. Çdo inspektoriat shtetëror apo vendor harton rregulloren e metodologjisë së përcaktimit të dënimeve, në fushën e tij të inspektimit. Rregullorja miratohet nga ministri përgjegjës për inspektoratet shtetërore dhe organi ekzekutiv i njësisë vendore për inspektoratet vendore.
Mungesa e një metodologjie të miratuar, sjell riskun që inspektorët të vendosin masa administrative bazuar në interpretimin e tyre personal. Kjo krijon hapsirë që masat të jenë të pa unifikuara dhe jo në përpjesëtim me shkeljen e kryer, duke sjellë në këtë mënyrë dënime tepër të ashpra ose tepër të lehta, të cilat cënojnë standardet ligjore dhe krijojnë precedentë të gabuar në praktikë.
Gjithashtu, nga grupi i auditimit u konstatua se nuk është evidentuar informacioni mbi statusin e pagesës së tarifave vjetore të lejeve mjedisore nga subjektet. Mospasja e këtij informacioni pengon identifikimin e subjekteve që nuk kanë kryer pagesat përkatëse dhe kufizon mundësinë e përfshirjes së tyre në planet e inspektimit.

Nga auditimi me zgjedhje i inspektimeve në ARM Berat, të regjistruar në sistemin e-inspektimi u konstatua si më poshtë:

1. Subjekti: T – B me NIPT L.....F, Inspektimi nr. AKM-BR-2021-000125, me objekt inspektimi: "*Informacion/Indicio nga palët e treta"*, Inspektorët: Sh. A, E. R, P. K, S. R.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit janë evidentuar mangësitë si në vijim: në lidhje me kushtin nr. 9 të lejes mjedisore, që lidhet me zhurmën dhe vibracionet, është konstatuar moszbatim nga ana e subjektit; gjithashtu, nga verifikimi i listëverifikimit rezulton se nuk janë plotësuar rubrikat e tjera që lidhen me zbatimin e kushteve të lejes mjedisore, duke treguar mungesë dokumentimi dhe vlerësimi të plotë të përputhshmërisë. Në procesverbalin e inspektimit është evidentuar se subjekti nuk ka realizuar detyrat e lëna në inspektimin e mëparshëm (nr. AKM-BR-2021-000123-2, datë 27.07.2021), në kundërshtim me pikën 1 të nenit 66 të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011, *"Për mbrojtjen e mjedisit"*. Për këto shkelje, në seksionin e kundërvajtjeve administrative është vendosur dënimi administrativ kryesor "Paralajmërim", si dhe dënimi administrativ plotësues "*Pezullim i aktivitetit deri në realizimin e detyrave*", ndërsa si masë korrigjuese është lënë detyrimi për kryerjen e monitorimit të zhurmës nga ekspertë të certifikuar dhe të akredituar. Të njëjtat gjetje dhe masa janë reflektuar edhe në Vendimin Përfundimtar të Inspektim
Nga verifikimi i procesverbalit me nr. AKM-BR-2021-000125 - 2, datë 24.08.2021, konstatohet se paraqiten mangësi në plotësimin e rubrikave përkatëse, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 45 të ligjit nr. 10433/2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, i cili kërkon që procesverbali të përmbajë informacion të plotë dhe të detajuar mbi veprimet e inspektimit, gjetjet dhe vendimet procedurale të marra;
-Nga auditimi konstatohet se vendimi përfundimtar i inspektimit është nxjerrë në të njëjtën ditë me procesverbalin e inspektimit, duke mos i lënë subjektit të inspektimit mundësinë për të ushtruar të drejtën e ankimimit. Kjo praktikë është në kundërshtim me ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011,

"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", neni 43 *"Shqyrtimi dhe marrja e vendimit përfundimtar"*, i cili përcakton se: *"Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm, vendimi përfundimtar i inspektimit merret nga inspektori apo inspektorët që kanë kryer inspektimin, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të procesverbalit subjektit të inspektimit".*
Sipas trupës inspektuese subjekti nuk ka realizuar detyrën e lënë nga inspektimi i kryer në datë 27.07.2021, lënë me procesverbalin nr. AKM-BR-2021-000123-2. Në këto kushte duhet të ishte vendosur gjobë nga 10,000-100,000 sipas pikës 6 të nenit 48 të ligjit nr. 10433 datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" ku citohet se: *"Moskorrigjimi i parregullsive brenda afatit të përcaktuar, sipas pikës 4 të këtij neni, përbën, veçmas, kundërvajtje administrative dhe dënimi kryesor mund të shoqërohet me dënimin plotësues, gjobë, në vlerë nga 10,000 deri në 100,000 lekë".* Gjithashtu duhej vendosur gjobe sipas pikës dh, neni 32 i ligjit nr. 97/74 datë 12.07.2007 "*Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis*" ku citohet se: *"Fillimi i punës ose i veprimtarisë, pa zbatuar masat e mbrojtjes nga zhurma, që kërkohen për zhvillimin e veprimtarisë që lëshon zhurmë nga 100,000 lekë deri në 300,000 lekë;*
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: Sh. A, E. R, P. K, S. R.

2. Subjekti: E me NIPT K.....C, Inspektimi nr. AKM-BR-2023-00008, me objekt inspektimi: "*Në trajtim të ankesës së ardhur nga AMBU me Nr. 1, 111 Prot, datë:13.07.2023 " Informacion i përditësuar për HEC-et që prodhojnë energji elektrike duke përdorur në mënyrë të jashtëligjshme burimet ujore" deleguar për trajtim nga AKM , protokolluar pranë ARM Berat Elbasan Korçë me Nr. 746 Prot., datë 31.07.2023*". Inspektorët: M.Sh, A.T.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit janë evidentuar mangësitë si në vijim: subjekti "E" sh.p.k., me aktivitet HEC për prodhimin e energjisë, shfrytëzon burimin ujor pa qenë i pajisur me Leje Përdorimi të Ujit nga organet përkatëse, pasi në momentin e inspektimit nuk ka paraqitur një të tillë. Në procesverbalin e inspektimit kjo situatë është konstatuar si shkelje në kundërshtim me pikën 1 të nenit 41 të ligjit nr. 111/2012, *"Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore"*, dhe për këtë është vendosur dënimi administrativ kryesor "Gjobë" në vlerën 500,000 lekë, si dhe është lënë detyrimi që subjekti të mos shfrytëzojë burimin ujor pa u pajisur paraprakisht me lejen përkatëse. Megjithatë, nga verifikimi i Vendimit Përfundimtar të Inspektimit konstatohet mospërputhje me procesverbalin, pasi masa administrative "*Gjobë*" është hequr dhe është zëvendësuar me masën "*Paralajmërim",* ndërkohë që detyrimi për pajisjen me leje është lënë në fuqi.
Nga verifikimi i procesverbalit me nr. AKM-BR-2021-000125-2, datë 24.08.2021, konstatohet se paraqiten mangësi në plotësimin e rubrikave përkatëse, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 45 të ligjit nr. 10433/2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, i cili kërkon që procesverbali të përmbajë informacion të plotë dhe të detajuar mbi veprimet e inspektimit, gjetjet dhe vendimet procedurale të marra; Gjithashtu konstatohet se shkelja e konstatuar nga trupa inspektuese bie në kundërshtim me parashikimet e nenit 97 *"Sanksionet administrative"* të ligjit nr. 111/2012 *"Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore",* i ndryshuar, i cili në pikën 3 përcakton shprehimisht se *veprimet e kryera në kundërshtim me shkronjat "a", "b", "c", "ç", "d", "dh", "e" dhe "ë" të pikës 1 të nenit 41 të këtij ligji përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen me masën administrative të gjobës, në intervalin nga 500,000 lekë deri në 1,000,000 lekë, kur leja jepet nga Këshilli i Basenit Ujor, ose nga 1,000,000 lekë deri në 2,000,000 lekë, kur leja jepet nga Këshilli Kombëtar i Ujit.* Këto parashikime lidhen drejtpërdrejt me nenin 41 *"Përdorimi me leje i ujit",* i cili përcakton se veprimtari të tilla si përdorimi i ujit me instalime të përhershme, përdorimet industriale të ujit sipërfaqësor, shfrytëzimi i ujërave nëntokësore dhe dhënia në përdorim e burimeve ujore për akuakulturë ushtrohen vetëm mbi bazën e lejes administrative përkatëse.

Në këto kushte, vendosja e dënimit administrativ *"Paralajmërim"* nuk është e justifikuar në raport me shkeljen e konstatuar, pasi dispozita ligjore është e qartë, e drejtpërdrejtë dhe nuk parashikon asnjë hapësirë diskrecioni për organin inspektues për zëvendësimin e gjobës me një masë tjetër administrative. Për rrjedhojë, vendosja e masës administrative *"Paralajmërim"* nuk është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, pasi shkeljet e konstatuara janë të parashikuara shprehimisht nga ligji si kundërvajtje administrative dhe duhet të ndëshkohen me masën administrative të gjobës, sipas intervalit të përcaktuar në ligj.

Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: M.Sh, A. T.

3. Subjekti: I me NIPT M.....C, Inspektimi me nr. AKM-BR-2025-000085, me objekt inspektimi: "*Në trajtim të shkresës me nr. 705/4 prot., datë 15.05.2025"*, Inspektorët: K. K dhe R. V.

Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit janë evidentuar mangësitë si në vijim: në zonën ku subjekti I SHPK ushtron aktivitetin, në shtratin e lumit Shkumbin dhe në brigjet e tij, janë konstatuar dy ekskavatorë të subjektit të pozicionuar pranë lumit, si dhe gropa dhe gjurmë mjetesh që tregojnë kryerjen e veprimeve për marrjen e inerteve lumore, megjithëse në momentin e inspektimit mjetet ishin të fikura. Nga procesverbali i inspektimit kjo situatë është evidentuar si shkelje në kundërshtim me nenin 137, pika 1 të ligjit nr. 29/2024, "*Për burimet ujore*", pasi shfrytëzimi i materialeve inerte nga shtretërit e lumenjve kryhet vetëm me leje nga organet përgjegjëse. Për këto shkelje, në seksionin e kundërvajtjeve administrative është vendosur dënimi administrativ kryesor "*Paralajmërim*", si dhe dënimi administrativ plotësues "*Pezullim i aktivitetit deri në realizimin e detyrave",* ndërsa si masa korrigjuese është lënë detyrimi që subjekti të largojë menjëherë ekskavatorët nga shtrati i lumit dhe të ndalojë çdo veprimtari për marrjen e inerteve pa u pajisur me lejen përkatëse nga organet e menaxhimit të burimeve ujore.

Grupi i auditimit, pasi verifikoi gjetjen e konstatuar nga trupa inspektuese, evidentoi se kjo gjetje është në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1 të nenit 137 të Ligjit nr. 29, datë 04.04.2024, *"Për burimet ujore"* ku parashikohet se: *"Organet e menaxhimit të burimeve ujore lëshojnë leje për shfrytëzimin e materialeve inerte, si: rërë, zhavorr, që nxirren nga shtretërit e lumenjve, përrenjve dhe liqeneve, me ose pa ujë."* Në lidhje me këtë dispozitë, neni 169 "*Sanksionet administrative",* pika 9 përcakton se: *"Veprimtaritë e kryera në kundërshtim me nenin 137 të këtij ligji, lidhur me shfrytëzimin e materialeve inerte që nxirren nga shtretërit e lumenjve, përrenjve dhe liqeneve, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen me gjobë nga 1,000,000 (një milion) lekë deri në 2,000,000 (dy milionë) lekë."* Sa më sipër, grupi i auditimit konstaton se vendosja e dënimit administrativ *"paralajmërim"* nuk është e justifikuar në raport me shkeljen e nenit 137 të Ligjit nr. 29/2024, në të cilin parashikohet shprehimisht se veprimtaritë në kundërshtim me këtë nen ndëshkohen me gjobë nga *1,000,000 (një milion) lekë deri në 2,000,000 (dy milionë) lekë.*

Kjo dispozitë ligjore është e qartë, e drejtpërdrejtë dhe nuk parashikon asnjë hapësirë diskrecioni për organin inspektues në lidhje me zëvendësimin e gjobës me një masë tjetër administrative. Për rrjedhojë, vendosja e masës administrative *"paralajmërim"* nga trupa inspektuese nuk është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, pasi shkeljet e konstatuara janë të parashikuara shprehimisht nga ligji si kundërvajtje administrative dhe duhet të ndëshkohen me masën administrative të gjobës, sipas intervalit të përcaktuar në ligj.

Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: K. K dhe R. V.

4. Subjekti C-E me NIPT K.....T, Inspektimi me nr. AKM-BR-2023-000090, me objekt inspektimi:"*Në trajtim të ankesës së ardhur nga AMBU me Nr. 1111 Prot., datë 13.07.2023 " Informacion i përditësuar për HEC-et që prodhojnë energji elektrike duke përdorur në mënyrë të*

jashtëligjshme burimet ujore" deleguar për trajtim nga AKM, protokolluar pranë ARM Berat Elbasan Korçë me Nr. 746 Prot., datë 31.07.2023" Inspektorët: A. A dhe M.Sh.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit janë evidentuar mangësitë si në vijim: subjekti nuk është i pajisur me Leje për Përdorim të Burimit Ujor të vlefshme, të lëshuar nga organet kompetente të menaxhimit të burimeve ujore. Nga procesverbali i inspektimit kjo situatë është konstatuar si shkelje në kundërshtim me nenin 41, pika 1, shkronjat "a" dhe "c" të ligjit nr. 111/2012, *"Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore",* pasi subjekti ushtron aktivitet duke shfrytëzuar burimin ujor pa u pajisur me lejen përkatëse. Për këto shkelje, në seksionin e kundërvajtjeve administrative është vendosur dënimi administrativ kryesor *"Gjobë*" në vlerën 500,000 lekë, si dhe është lënë detyrimi që subjekti të mos ushtrojë aktivitet pa u pajisur më parë me lejen përkatëse. Megjithatë, nga verifikimi i Vendimit Përfundimtar të Inspektimit konstatohet mospërputhje me procesverbalin, pasi masa administrative "Gjobë" është hequr dhe është zëvendësuar me dënimin kryesor "*Paralajmërim*". Ndërkohë, është lënë detyrë që subjekti, brenda afatit 08.08.2023, të zbatojë kërkesat ligjore dhe të përdorë burimin ujor vetëm pasi të jetë pajisur me lejen përkatëse nga organet kompetente.
Nga auditimi konstatohet se shkelja e konstatuar nga trupa inspektuese bie në kundërshtim me parashikimet e nenit 97 *"Sanksionet administrative"* të ligjit nr. 111/2012 *"Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore",* i ndryshuar, i cili në pikën 3 përcakton shprehimisht se *veprimet e kryera në kundërshtim me shkronjat "a", "b", "c", "ç", "d", "dh", "e" dhe "ë" të pikës 1 të nenit 41 të këtij ligji përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen me masën administrative të gjobës, në intervalin nga 500,000 lekë deri në 1,000,000 lekë, kur leja jepet nga Këshilli i Basenit Ujor, ose nga 1,000,000 lekë deri në 2,000,000 lekë, kur leja jepet nga Këshilli Kombëtar i Ujit.* Këto parashikime lidhen drejtpërdrejt me nenin 41 *"Përdorimi me leje i ujit",* i cili përcakton se veprimtari të tilla si përdorimi i ujit me instalime të përhershme, përdorimet industriale të ujit sipërfaqësor, shfrytëzimi i ujërave nëntokësore dhe dhënia në përdorim e burimeve ujore për akuakulturë ushtrohen vetëm mbi bazën e lejes administrative përkatëse.
Në këto kushte, vendosja e dënimit administrativ *"Paralajmërim"* nuk është e justifikuar në raport me shkeljen e konstatuar, pasi dispozita ligjore është e qartë, e drejtpërdrejtë dhe nuk parashikon asnjë hapësirë diskrecioni për organin inspektues për zëvendësimin e gjobës me një masë tjetër administrative. Për rrjedhojë, vendosja e masës administrative *"Paralajmërim"* nuk është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, pasi shkeljet e konstatuara janë të parashikuara shprehimisht nga ligji si kundërvajtje administrative dhe duhet të ndëshkohen me masën administrative të gjobës, sipas intervalit të përcaktuar në ligj.
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: A. A dhe M.Sh.

5. Subjekti B. K me NIPT K.....G, Inspektimi me nr. AKM-BR-2023-000241 me objekt isnpektimi: "Kontroll mbi zbatimin e kushteve të VNM Paraprake", Inspektorët: M. C, E. R, J. L. Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit janë evidentuar mangësitë si në vijim: zhvilluesi nuk ka paraqitur lejet/licencat përkatëse të lëshuara nga autoriteti përgjegjës për miratimin e zhvillimit, në kundërshtim me kërkesat e nenit 26, pika b, të ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011, *"Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"*. Nga procesverbali i inspektimit është konstatuar se subjekti ka përfunduar zbatimin e projektit, por nuk ka përmbushur detyrimet ligjore për dorëzimin e dokumentacionit përkatës, në kundërshtim me nenin 26, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 128/2020, *"Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"*. Për këto shkelje, në seksionin e kundërvajtjeve administrative është vendosur dënimi administrativ "*Gjobë"* në shumën 50,000 lekë, si dhe është lënë detyrimi që subjekti të dorëzojë brenda datës 29.01.2024 pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit dokumentacionin përkatës, përfshirë

informacionin mbi përfundimin e punimeve, punimet rehabilituese të territorit të shoqëruara me dokumentacion fotografik, si dhe lejet/licencat përkatëse. Të njëjtat masa administrative dhe detyrime janë reflektuar edhe në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit.
Nga auditimi konstatohet në vendimin përfundimtar të inspektimit se data 29.01.2024, e lënë si afat përfundimtar për korrigjimin e problematikave të konstatuara, është e njëjtë më datën e vendimit përfundimtar të inspektimit. Procesverbali i inspektimit nuk është hartuar i plotë, masa administrative e vendosur është nën nivelin minimal, në kundërshtim me pikën 1/b/i, nenin 26 ku përcaktohet se: *"Mos përmbushja dhe mosrespektimi i kushteve nga zhvilluesi i projektit: i) për vendimin për VNM paraprake dënohet me gjobë nga 65,000-260,000 lekë".* Pavarësisht shkeljeve të konstatuara, nga ARM Berat nuk është kryer ri inspektim për verifikimin e detyrave plotësuese si dhe nuk është vendosur masë administrative në lidhje me përfundimin e afatit për korrigjimin e shkeljeve të konstatuara, në kundërshtim me pikën 4, 5 dhe 6, neni 48 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"* ku citohet se:
4. *Kur është e nevojshme, dënimi administrativ shoqërohet me urdhërimin e subjektit të inspektimit për të korrigjuar shkeljet e konstatuara dhe për të eliminuar pasojat e tyre, duke përcaktuar dhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim. Vendimi i dënimit përfshin këshillimin me shkrim të subjektit për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve që pasqyrohet në një fletë shoqëruese.*
5. *Në rastin e parashikuar në pikën 4 të këtij neni, subjekti i inspektimit është i detyruar të njoftojë për korrigjimin e shkeljeve brenda afatit të përcaktuar dhe, nëse është e nevojshme, të paraqesë edhe provat që vërtetojnë këtë fakt. Për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve mund të kryhet një inspektim i ri.*
6. *Mos korrigjimi i parregullsive brenda afatit të përcaktuar, sipas pikës 4 të këtij neni, përbën, veçmas, kundërvajtje administrative dhe dënimi kryesor mund të shoqërohet me dënimin plotësues, gjobë, në vlerë nga 10,000 deri në 100,000 lekë.*
Nga shqyrtimi i inspektimeve mbi këtë subjekt nuk rezulton të jetë kryer ri inspektim në lidhje me korrigjimin dhe ndjekjen e shkeljeve të lëna nga inspektimi, në kundërshtim me pikat 15-17, kreu IV të Urdhrit të Inspektoratit Qendror nr. 25, datë 10.08.20218, për miratimin e Rregullores "*Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve si një proces i rregullt administrativ",* ku përcaktohet:
15. Subjekti, objekt inspektimi, është i detyruar të njoftojë për korrigjimin e shkeljeve, brenda afatit të përcaktuar nga trupa inspektuese në vendimin përfundimtar të inspektimit, të mëparshëm dhe nëse është e nevojshme të paraqesë edhe provat që vërtetojnë këtë fakt.
16. Për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve të konstatuara nga trupa inspektuese, kryhet një inspektim i ri. Në rastet kur nga ri inspektimi rezulton se subjekti nuk ka zbatuar detyrat e lëna nga inspektimi i mëparshëm, procedohet me masë administrative.
17. Procedura e inspektimit dhe ri inspektimit kryhen online në portalin e-Inspektimi.
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi inspektorët: M. C, E. R, J. L.

6. Subjekti E. C. F me NIPT J.....B, Inspektimi nr. AKM-BR-2024-000043, me objekt inspektimit: "*Kontroll mbi zbatimin e kushteve të lejes së mjedisit me numër PN-3906-10-2016",* Inspektorët: F. Sh, P. K, S. R.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit janë evidentuar mangësitë si në vijim: në momentin e inspektimit, subjekti nuk ka paraqitur mandatpagesën e tarifës vjetore për lejen e mjedisit Tip A, si dhe nuk ka paraqitur kontratat e vlefshme me subjekte të licencuara për menaxhimin e mbetjeve, sipas tabelës 4.1.2 të lejes mjedisore, pasi kontratat e dorëzuara kishin kaluar afatin e vlefshmërisë. Nga procesverbali i inspektimit këto shkelje janë konstatuar në kundërshtim me pikën 1/ b(i)të nenit 29 të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011, *"Për lejet e mjedisit",* dhe për to është vendosur dënimi administrativ kryesor "*Gjobë*" në shumën 1,000,000 lekë, si dhe

është lënë detyrimi që subjekti të dorëzojë pranë Agjencisë Rajonale të Mjedisit, brenda datës 20.03.2024, mandatpagesën e tarifës vjetore dhe kontratat e vlefshme për trajtimin e mbetjeve. Nga verifikimi i Vendimit Përfundimtar të Inspektimit, datë 25.03.2024, konstatohet se masa administrative është lënë e njëjtë me atë të përcaktuar në procesverbal, ndërkohë që data e vendimit përfundimtar përkon me datën e përcaktuar për përmbushjen e detyrimeve, duke kufizuar në praktikë mundësinë për verifikimin e zbatimit të tyre.
Nga verifikimi i praktikës së inspektimit në sistemin E-inspektimi, rezulton se janë dhënë konstatime të cilat nuk mbështeten me dokumentacion vërtetues/justifikues të ngarkuar në portalin e-Inspektimi. Mungesa e dokumentacionit plotësues dhe vërtetues në sistem përbën veprim në kundërshtim me nenin 41, pikat a-e të ligjit nr. 10433/2011 "*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*", i cili kërkon që çdo gjetje e inspektimit të mbështetet në prova dhe dokumente të verifikueshme. Procesverbali rezulton i paplotë, pasi mungon argumentimi i gjetjes, veprim në kundërshtim me pikën me pikën 3, neni 45, i ligjit nr. 110433/2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", ku përcaktohet se: "*Procesverbali përmban informacion të hollësishëm për veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit dhe shoqërohet me listë-verifikimin e plotësuar gjatë inspektimit*."
Nga shqyrtimi i inspektimeve mbi këtë subjekt rezulton, se nga ARM Berat nuk kryer ri inspektim në lidhje me korrigjimin dhe ndjekjen e shkeljeve të lëna nga inspektimi, në kundërshtim me pikat 15-17, kreu IV të urdhrit e inspektoratit qendror nr. 25, datë 10.08.2018, për miratimin e rregullores "*Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve si një proces i rregullt administrativ, ku përcaktohet:*
15. Subjekti, objekt inspektimi, është i detyruar të njoftojë për korrigjimin e shkeljeve, brenda afatit të përcaktuar nga trupa inspektuese në vendimin përfundimtar të inspektimit, të mëparshëm dhe nëse është e nevojshme të paraqesë edhe provat që vërtetojnë këtë fakt.
16. Për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve të konstatuara nga trupa inspektuese, kryhet një inspektim i ri. Në rastet kur nga ri inspektimi rezulton se subjekti nuk ka zbatuar detyrat e lëna nga inspektimi i mëparshëm, procedohet me masë administrative.
17. Procedura e inspektimit dhe ri inspektimit kryhen online në portalin e-Inspektimi.
Dënimi administrativ plotësues, për të cilin ishte caktuar si afat zbatimi data 20.03.2024, duhet të ishte konsideruar i parealizuar dhe të ishte vendosur masë administrative. Mos vendosja e masës administrative është në kundërshtim me pikën 4, 5 dhe 6, neni 48 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"* ku citohet se:
4. *Kur është e nevojshme, dënimi administrativ shoqërohet me urdhërimin e subjektit të inspektimit për të korrigjuar shkeljet e konstatuara dhe për të eliminuar pasojat e tyre, duke përcaktuar dhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim. Vendimi i dënimit përfshin këshillimin me shkrim të subjektit për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve që pasqyrohet në një fletë shoqëruese.*
5. *Në rastin e parashikuar në pikën 4 të këtij neni, subjekti i inspektimit është i detyruar të njoftojë për korrigjimin e shkeljeve brenda afatit të përcaktuar dhe, nëse është e nevojshme, të paraqesë edhe provat që vërtetojnë këtë fakt. Për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve mund të kryhet një inspektim i ri.*
6. *Mos korrigjimi i parregullsive brenda afatit të përcaktuar, sipas pikës 4 të këtij neni, përbën, veçmas, kundërvajtje administrative dhe dënimi kryesor mund të shoqërohet me dënimin plotësues, gjobë, në vlerë nga 10,000 deri në 100,000 lekë.*
Nga verifikimi në databazën e debitorëve të vënë në dispozicion nga AKM, ky subjekt nuk gjendet, duke mos e bërë të mundur verifikimin në lidhje me pagesën e tarifës, duke sjell risk të shtuar përsa i përket saktësisë së të dhënave të databazave.
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi inspektorët: F. Sh, P. K, S. R.

7. Subjekti E. C. F me NIPT J.....B, nr. AKM-BR-2021-000114, me objekt inspektimi: *"Kontroll mbi zbatimin e kushteve të lejes së mjedisit*", Inspektorët: F. Sh, I. A, I. C, S. R.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit rezulton se nuk janë evidentuar mangësi apo problematika gjatë kontrollit të ushtruar, pasi në rubrikat përkatëse të listëverifikimit nuk janë pasqyruar gjetje, ndërsa në procesverbal është shënuar se "*nuk ka gjetje*". Në vijim, në seksionin e kundërvajtjeve administrative nuk është vendosur asnjë dënim administrativ, kryesor apo plotësues. E njëjta situatë paraqitet edhe në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit nr. AKM-BR-2021-000114-5, datë 26.08.2021, ku nuk është vendosur asnjë masë administrative dhe nuk janë evidentuar shkelje të kërkesave ligjore për t'u korrigjuar.
Nga shqyrtimi i listë verifikimit dhe procesverbalit të inspektimit konstatohet mungesa e dokumentacionit plotësues dhe vërtetues që duhet të mbështesë gjetjet e inspektorëve në sistemin e inspektimeve, veprim ky në kundërshtim me pikat a–e të nenit 41 të ligjit nr. 10433/2011, "*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*". Në këto kushte, procesi i inspektimit rezulton i paplotë, i shoqëruar me mungesë dokumentacioni mbështetës, paqartësi lidhur me objektin e inspektimit, si dhe të dhëna të pamjaftueshme për marrjen e një vendimi të argumentuar, të ligjshëm dhe të bazuar në prova.
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi inspektorët: F. Sh, I. A, I. C, S. R.

8. Subjekti P-G me NIPT M.....B, Inspektimi nr. AKM-BR-2024-000045, me objekt inspektimi "*Trajtim i ankesës se subjektit A. OIL sha, protokolluar me nr. 564 prot., datë 02.05.2024*", Inspektorët: F. Sh, S. R, E. R.
Nga procesverbali i inspektimit janë evidentuar mangësitë si në vijim: subjekti nuk ka paraqitur Licencë me kod III.2.B, në kundërshtim me nenin 58 të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, *"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"*, për të cilën, sipas pikës 58 të nenit 62, është parashikuar dënimi administrativ kryesor "*Gjobë"* në shumën 1,000,000 lekë. Gjithashtu, është vendosur dënimi administrativ plotësues, në zbatim të nenit 66 të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011, *"Për mbrojtjen e mjedisit"*, që subjekti të pezullojë aktivitetin deri në pajisje me licencën përkatëse, si dhe është lënë detyrimi që subjekti të bëjë riaplikimin për licencën dhe të dorëzojë një kopje të aplikimit pranë Agjencisë Rajonale të Mjedisit brenda datës 07.06.2024. Megjithatë, nga verifikimi i Vendimit Përfundimtar të Inspektimit konstatohet mospërputhje me procesverbalin, pasi dënimi administrativ kryesor "*Gjobë*" është zëvendësuar me *"Paralajmërim",* ndërsa në seksionin e shkeljeve për t'u korrigjuar nuk janë pasqyruar detyrime konkrete, duke u kufizuar vetëm në masën plotësuese për pezullimin e aktivitetit deri në pajisjen me licencën përkatëse.
Nga auditimi konstatohet se procesverbali nuk përmban informacion të mjaftueshëm për shkeljet e identifikuara, veprim në kundërshtim me pikën 3 të nenit 45 të ligjit nr. 10433/2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* i cili përcakton se: "*Procesverbali përmban informacion të hollësishëm për veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit dhe shoqërohet me listë-verifikimin e plotësuar gjatë inspektimit*." Lidhur me zbatimin e kushteve të lejes mjedisore për menaxhimin e mbetjeve, inspektorët kanë shënuar që nuk disponon licencë III.2.B, e aplikuar dhe e refuzuar dhe që ky subjekt nuk ushtron aktivitetin pasi ndodhet në fazën e përgatitjes së dokumentacionit për ri aplikim. Në gjykimin e grupit të auditimit, ky arsyetim nuk konsiderohet evidencë e mjaftueshme në sistemin e-Inspektimi, pasi as nga subjekti nuk disponohet kërkesë për pezullim të aktivitetit dhe as nga inspektorati nuk është lëshuar njoftim pezullimi, në kundërshtim me nenin 66, pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 10431/2011 *"Për mbrojtjen e mjedisit"* i cili përcakton se: "*1. Inspektorati, në rast se është i mendimit që ndërtimi apo kryerja e një veprimtarie ose ndërtimi, apo kryerja e saj në një mënyrë të caktuar përbën*

rrezik të mundshëm për ndotje serioze të mjedisit, ai i dërgon njoftimin për pezullimin e asaj veprimtarie pronarit të sendit apo operatorit të veprimtarisë, sipas rastit. Një kopje e njoftimit për pezullim i dërgohet autoritetit publik, që ka dhënë lejen për ushtrimin e veprimtarisë.
Nga verifikimi i vendimit përfundimtar të datës 07.06.2024, konstatohet se masa është ndryshuar nga gjobë në "paralajmërim", ndërsa masa plotësuese e pezullimit është lënë në fuqi. Ndryshimi i masës në paralajmërim është në kundërshtim me nenin 62, pika 58 të ligjit nr. 10463/2011 *"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve",* i cili sanksionon qartë se: *"Çdo person, që vepron si agjent apo tregtar mbetjesh pa licencë apo jo në përputhje me licencën, në kundërshtim me nenin 58 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1,000,000 (një milion) deri në 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë."* Gjithashtu nga verifikimi i ccështjeve të inspektimit në sistem rezulton se nga ARM Berat nuk është kryer ri inspektim për ndjekjen e shkeljeve, në kundërshtim me pikat 15-17 të Kreut IV të Rregullores së miratuar me Urdhrin nr. 25, datë 10.08.2018 të Inspektoratit Qendror, që detyron subjektin të njoftojë korrigjimin e shkeljeve, kërkon verifikim me inspektim të ri dhe përcakton se i gjithë procesi duhet të kryhet në portalin e-Inspektimi. Mungesa e ri inspektimit dhe e provave për korrigjimin e shkeljeve tregon mangësi në ndjekjen procedurale të masave të vendosura.
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi inspektorët: F. Sh, S. R, E. R.

9. Subjekti K. I SH.A me NIPT K.....T, Inspektimi nr. AKM-BR-2024-000157, me objekt inspektimi: "*Kontroll mbi zbatimin e kushteve të lejes mjedisore me numër PN-3843-09-2016",* Inspektorët: F. Sh, Sh. A, S. R.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit janë evidentuar mangësitë si në vijim: subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion në lidhje me shkarkimin dhe transferimin e ndotësve, si dhe nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë për zbatimin e kushtit 8 të lejes mjedisore "*Menaxhimi i mbetjeve",* konkretisht kontratat me subjekte të licencuara për trajtimin/asgjësimin përfundimtar të mbetjeve sipas Shtojcës 4.1, Tabela 4.1.1 dhe Tabela 4.1.2. Gjithashtu, nga listëverifikimi konstatohet se një pjesë e rubrikave nuk janë plotësuar (pyetja 22), duke treguar mangësi në dokumentimin e plotë të gjetjeve. Nga procesverbali i inspektimit këto shkelje janë konstatuar në kundërshtim me pikën 1/a të nenit 69 të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011, *"Për mbrojtjen e mjedisit"*, si dhe me pikën 1/b i të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011, *"Për lejet e mjedisit"*, dhe për to janë vendosur dënime administrative kryesore në formën e gjobave në shumën 500,000 lekë dhe 1,500,000 lekë, si dhe detyrimi që subjekti të dorëzojë regjistrat e shkarkimeve dhe transferimeve të ndotjeve brenda datës 09.09.2024. Nga verifikimi i Vendimit Përfundimtar të Inspektimit konstatohet se është vendosur dënim administrativ kryesor "*Gjobë*" në shumën 1,500,000 lekë, si dhe dënim administrativ plotësues *"Pezullimi i aktivitetit të transferimit të mbetjeve të rrezikshme"* deri në lidhjen e kontratave përkatëse me subjekte të licencuara, ndërsa afati për korrigjimin e shkeljeve është përcaktuar deri më datë 10.10.2024.
Nga shqyrtimi i të dhënave në sistem rezulton se afati i parashikuar në procesverbal , data 09.09.2024 nuk është respektuar nga subjekti dhe se në vendimin përfundimtar është vendosur një afat i dytë, i cili përkon me datën e vetë vendimit. Duke qenë se detyra plotësuese nuk është përmbushur, grupi inspektues duhej të kishte vendosur masë administrative për moszbatim të masës plotësuese, në zbatim të pikave 4, 5 dhe 6 të nenit 48 të ligjit nr. 10433/2011. Në lidhje me pezullimin, nuk rezulton në sistem asnjë kërkesë për pezullim nga subjekti dhe as ndonjë njoftim zyrtar për pezullim nga inspektorati, në kundërshtim me pikën 1 dhe 2 të nenit 66 të ligjit nr. 10431/2011, i cili përcakton se pezullimi bëhet vetëm me njoftim me shkrim të arsyetuar dhe të komunikuar operatorit dhe autoritetit licencues. Mungesa e njoftimit të pezullimit dhe

mospërputhja e afateve të masave plotësuese tregojnë mangësi proceduriale, si në vendimmarrje ashtu edhe në ndjekjen e detyrave të lëna.
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi inspektorët: Sh. A, S. R.

10. Subjekti K. I SH.A. me NIPT K.....T, Inspektimi me nr. AKM-BR-2023-000187, me objekt inspektimi: "*Inspektim mbi incidentin e ndodhur pranë subjektit Kurum International sha, dhe mbi zbatueshmërinë e ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" i përditësuar",* inspektorët: F. Sh, Sh. A, S. R.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit janë evidentuar mangësitë si në vijim: në vend-depozitimin e skrapit, subjekti ka grumbulluar mbetje të pa diferencuara, ku përveç hekurishteve janë konstatuar goma të ndryshme, automjete në fund të jetës të pa demoluara, frigoriferë dhe bolierë të pa trajtuar nga shtresat termoizoluese, si dhe bombula, duke treguar mungesë të menaxhimit të duhur të mbetjeve. Nga procesverbali i inspektimit këto shkelje janë konstatuar në kundërshtim me pikat 2 dhe 24 të nenit 17, si dhe nenin 62 të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, *"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"*. Për këto shkelje është vendosur dënimi administrativ kryesor "*Gjobë"* në shumën 1,500,000 lekë, pa vendosur dënim administrativ plotësues, si dhe është lënë detyrimi që subjekti të paraqesë kontestimet pranë Agjencisë Rajonale të Mjedisit brenda datës 21.11.2023. Nga verifikimi i Vendimit Përfundimtar të Inspektimit nr. AKM-BR-2023-000187-5, datë 21.11.2023, konstatohet se masa administrative dhe detyrimi i lënë janë të njëjta me ato të përcaktuara në procesverbal. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistem rezultoi se procesverbali i inspektimit nr. AKM-BR-2023-000187-2, datë 09.11.2023, nuk është hartuar në përputhje me pikën 3 të nenit 45 të ligjit nr. 10 433/2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* i cili përcakton se procesverbali duhet të përmbajë informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit, si dhe të shoqërohet me listë verifikimin e plotësuar. Nga verifikimi i vendimit të inspektimit nr. AKM-BR-2023-000187-5, datë 21.11.2023, mbi korrigjimin e shkeljeve, rezulton se përsëritet i njëjti detyrim *"Subjekti të dorëzojë kontestimet pranë Agjencisë Rajonale të Mjedisit Berat/Elbasan/Korçë brenda datës 21.11.2023".* Grupi i auditimit vlerëson se ky paragraf nuk duhet të ishte pjesë e vendimit të inspektimit, pasi data e kërkuar për përmbushjen e detyrimit përkon me datën e vetë vendimit dhe konsiderohet e ezauruar në momentin e nxjerrjes së tij.
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi inspektorët: F. Sh, Sh. A, S. R.

11. Subjekti K. I SH.A me NIPT K.....T, Inspektimi nr. AKM-BR-2021-000228-2, datë 07.12.2021, më objekt inspektimi: "*Kontroll mbi zbatimin e kushteve të lejes mjedisore"*, Inspektorët: F.Sh, I. A, P. K, I. C, S. R.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit nuk janë evidentuar shkelje apo problematika, ndërsa në seksionin e kundërvajtjeve administrative nuk është vendosur asnjë dënim administrativ, kryesor apo plotësues, si dhe nuk janë përcaktuar shkelje të kërkesave ligjore për t'u korrigjuar. E njëjta situatë paraqitet edhe në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit nr. AKM-BR-2021-000228-5, datë 07.12.2021, ku nuk është vendosur asnjë masë administrative dhe nuk janë evidentuar detyrime për korrigjim.
Nga verifikimi i dokumentacionit, pjesë e praktikës së inspekimit rezultoi se listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit nuk janë plotësuar në mënyrë të plotë të plota dhe të argumentuar. Konkretisht, mungon dokumentacioni mbështetës mbi Raportin e vetëmonitorimit, i cili përdoret si referencë për vlerësimin e disa kritereve të listëverifikimit. Gjithashtu, procesverbali nuk është hartuar në përputhje me pikën 3 të nenit 45 të ligjit nr. 10433/2011, *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, sipas të cilit procesverbali duhet të përmbajë informacion të hollësishëm mbi

veprimet e inspektimit, gjetjet dhe vendimet procedurale të marra, si dhe të shoqërohet me listëverifikimin e plotësuar. Si pasojë, konstatohet mungesë në dokumentimin dhe argumentimin e procesit të inspektimit, duke cenuar gjurmueshmërinë dhebesueshmërinë e tij.
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi inspektorët: F. Sh, I.A, P. K, I. C, S. R.

12. Subjekti K. I SH.A me NIPT K.....T, Inspektimi nr KM-BR-2022-000079, me objekt inspektimi: "*Hapje e një çështje të re për shkak të Mbylljes se Vendimit Përfundimtar për procesverbalin e mbajtur për Kurum International sh.a, çështja nr. AKM-BR-2022-000073 pasi është mbyllur gabimisht me dokumentacion të një subjekti tjetër. Informacion nga palët e treta"*, Inspektorët: M. C, Sh. A, E. R, S. R.
Nga Listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit është konstatuar se subjekti ka realizuar detyrën e lënë në procesverbalin nr. AKM-BR-2022-000073, duke dorëzuar pranë ARM Berat/Elbasan/Korçë, brenda datës 14.06.2022, grafikun e mirëmbajtjes (remontit) të sistemit të pluhur-kapjes, si dhe faturën e fundit të furnizimit me pjesë këmbimi (filtra) për këtë sistem. Nga verifikimi nuk janë evidentuar shkelje, si dhe në seksionin e kundërvajtjeve administrative nuk është vendosur asnjë dënim administrativ, kryesor apo plotësues, dhe nuk janë përcaktuar shkelje të kërkesave ligjore për t'u korrigjuar. E njëjta situatë paraqitet edhe në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit nr. AKM-BR-2022-000079-5, datë 14.06.2022, ku nuk është vendosur asnjë masë administrative.
Nga auditimi konstatohet se procesverbali i inspektimit nuk është hartuar në përputhje me pikën 3 të nenit 45 të ligjit nr. 10433/2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* i cili përcakton se procesverbali duhet të përmbajë informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit, si dhe të shoqërohet me listë verifikimin e plotësuar.
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi inspektorët: M. C, Sh. A, E. R, S. R.

13. Subjekti S. R. B me NIPT K.....H, Inspektimi nr. AKM-BR-2022-000118, me objekt inspektimi: *"Kontroll mbi zbatimin e kushteve të Lejes Mjedisore nr. PN-5894-10-2017, sipas Urdhrit nr. 224, datë 26.10.2022, për përcaktimin e rregullave për kryerjen e procedurave të inspektimit gjatë muajit nëntor 2022".* Inspektorët: F. Sh, S. R, E. R.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit janë evidentuar mangësitë si në vijim: megjithëse në pyetjen nr. 1 të listës së verifikimit është shënuar se tarifa vjetore është paguar, në pyetjen nr. 5 evidentohet se subjekti nuk ka dorëzuar raportin vjetor në momentin e inspektimit. Gjithashtu, në pyetjen nr. 11, që lidhet me kushtin nr. 6 "*Njoftimet*", rezulton se nuk është paraqitur raporti vjetor dhe nuk është vërtetuar nëse AKM është njoftuar për vetë-monitorimet, ndërsa pyetjet nr. 12–16 dhe 23–24 nuk janë verifikuar, duke u plotësuar me shënimin për mungesë të raportit të vetëmonitorimit. Nga procesverbali i inspektimit konstatohet se subjekti është ndëshkuar për mosparaqitjen e raportit 6-mujor dhe raportit vjetor me masën administrative *"Paralajmërim",* të cilën procesverbali e klasifikon si dënim administrativ kryesor, si dhe me gjobë në shumën 300,000 lekë, duke krijuar paqartësi në klasifikimin e masave administrative. Për korrigjimin e shkeljeve, subjektit i është lënë detyra që brenda datës 30.11.2022 të dorëzojë raportin vjetor dhe raportin 6-mujor të monitorimit pranë ARM Berat/Elbasan/Korçë. Nga verifikimi i Vendimit Përfundimtar të Inspektimit nr. AKM-BR-2023-000148-5, datë 03.11.2023, konstatohet mospërputhje me procesverbalin, pasi masa administrative "*Gjobë*" në shumën 300,000 lekë është hequr dhe është lënë vetëm masa "*Paralajmërim".*
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e-inspektime rezulton se për pagesën e tarifës vjetore është ngarkuar vetëm Urdhër-shpenzimi nr. 267, datë 10.05.2022, pa

dokumentacion shoqërues që vërteton kryerjen e pagesës në bankën e nivelit të dytë. Gjithashtu, kjo datë tejkalon afatin e përcaktuar në Lejen Mjedisore të tipit B nr. PN-5894-10-2017, datë 06.11.2017, në zbatim të Vendimit nr. 417, datë 25.06.2014, sipas të cilit tarifa duhet të paguhet brenda tremujorit të parë të vitit, duke rezultuar një vonesë prej 40 ditësh.
Gjithashtu, procesverbali nuk është hartuar në përputhje me nenin 45, pika 3, të ligjit nr. 10433/2011, i cili përcakton se *"Procesverbali duhet të përmbajë informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit"*.
Ndryshimi i masës në vendimin përfundimtar është bërë pa argumente ligjore, në kundërshtim me pikën "b/ii" të nenit 29 të ligjit nr. 10448/2011, të ndryshuar. Po ashtu, masa administrative *"Paralajmërim"* nuk është shoqëruar me arsyetim, në kundërshtim me nenin 48, pika 1, të ligjit nr. 10433/2011, i cili parashikon se *"Kur konstatohet shkelje ... subjekti i inspektimit dënohet me 'paralajmërim'"* vetëm në rastet e shkeljeve me rëndësi të vogël.
Në vendim është vendosur edhe masë administrative plotësuese, e formuluar si *"30.11.2022 – kryerja dhe paraqitja e dokumentacionit të monitorimit në momentin e inspektimit"*, datë që përkon me datën e marrjes së vendimit, duke e bërë detyrimin praktikisht të parealizueshëm.
Në përfundim, duke qenë se raporti vjetor dhe raporti 6-mujor i vetë monitorimit nuk ishin dorëzuar deri në momentin e Vendimit Përfundimtar, subjekti rezulton në shkelje të kushteve të lejes mjedisore për monitorimin. Në këtë situatë, nuk duhej të ishte vendosur masa *"Paralajmërim"*, por masa *"Gjobë"*, sipas kushtit 12 "Dokumentimi dhe raportimi" dhe pikës b/ii të nenit 29 të ligjit nr. 10448/2011, në masën 300,000 – 500,000 lekë.
Nga verifikimi në sistem rezulton se, me shkresën nr. 1120, datë 19.12.2022, S. R. B ka dorëzuar vetëm raportin 6-mujor (korrik–dhjetor 2022) dhe jo raportin vjetor, jashtë afateve ligjore dhe përtej afatit të lënë nga inspektorët. Ky veprim është gjithashtu në kundërshtim me kushtin 12.6 të Lejes Mjedisore nr. PN-5894-10-2017, sipas të cilit raporti vjetor i monitorimit duhet të paraqitet çdo vit më datë 26 shtator për vitin pasardhës.
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi inspektorët: F. Sh, S. R, E. R.

14. Subjekti T. E sh.p.k me NIPT J.....G Inspektimi me nr. AKM-BR-2022-000039, me objekt inspektimi: *"Urdhër nga Drejtori i Përgjithshëm nr. 25 datë 07.02.2022 " Për ngritjen e grupeve të punës për evidentimin e problematikave mjedisore të veprimtarive minerare me karrierë (guroret) në territor"*, Inspektorët: M. C dhe G. R.
Nga auditimi konstatohet se në listëverifikim, konkretisht në pyetjen nr. 31, në lidhje me kushtin nr. 14 *"Çmontimi, rehabilitimi dhe kontrolli pas ndërprerjes së operacioneve*", nuk është paraqitur plani i rehabilitimit. Nga verifikimi i procesverbalit nr. AKM-BR-2022-000039-2, datë 08.03.2022, evidentohet se subjekti nuk ka paraqitur planin e rehabilitimit të karrierës, nuk ka raportuar çdo 6 muaj për ecurinë e punimeve rehabilituese dhe nuk ka realizuar rehabilitimin paralelisht me shfrytëzimin. Për këto shkelje, në seksionin e kundërvajtjeve administrative është vendosur dënimi administrativ kryesor *"Paralajmërim",* si dhe është lënë detyrimi që subjekti të dorëzojë planin e rehabilitimit brenda datës 18.03.2022 dhe të realizojë rehabilitimin e sipërfaqeve të shfrytëzuara brenda një afati 6-mujor nga data e inspektimit. Nga verifikimi i Vendimit Përfundimtar të Inspektimit nr. AKM-BR-2022-000039-5, datë 18.03.2022, konstatohet se është vendosur e njëjta masë administrative "*Paralajmërim"* dhe i njëjti afat për korrigjimin e shkeljeve, ku data e përcaktuar për dorëzimin e planit përkon me datën e vendimit, duke kufizuar në praktikë mundësinë për zbatimin dhe verifikimin e këtij detyrimi.
Nga auditimi konstatohet se procesverbali i inspektimit nuk është hartuar në përputhje me pikën 3 të nenit 45 të ligjit nr. 10433/2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* i cili përcakton

se procesverbali duhet të përmbajë informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit;
-afati i lënë për përmirësimin e shkeljeve përkon me datën e vendimit, ç'ka e bën të parealizueshëm si kusht. Grupi i auditimit vlerëson se përfshirja e këtij paragrafi në vendimin e inspektimit nuk është e justifikuar, pasi afati i përcaktuar për përmbushjen e detyrimit përkon me datën e vetë vendimit, duke e bërë objektivisht të pamundur realizimin e tij nga subjekti. Në këto kushte, ndaj subjektit duhet ishte vendosur masë administrative. Mos vendosja e masës administrative është në kundërshtim me pikën 4, 5 dhe 6, neni 48 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"* ku citohet se:
4. *Kur është e nevojshme, dënimi administrativ shoqërohet me urdhërimin e subjektit të inspektimit për të korrigjuar shkeljet e konstatuara dhe për të eliminuar pasojat e tyre, duke përcaktuar dhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim. Vendimi i dënimit përfshin këshillimin me shkrim të subjektit për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve që pasqyrohet në një fletë shoqëruese.*
5. *Në rastin e parashikuar në pikën 4 të këtij neni, subjekti i inspektimit është*
i detyruar të njoftojë për korrigjimin e shkeljeve brenda afatit të përcaktuar dhe, nëse është e nevojshme, të paraqesë edhe provat që vërtetojnë këtë fakt. Për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve mund të kryhet një inspektim i ri.
6. *Mos korrigjimi i parregullsive brenda afatit të përcaktuar, sipas pikës 4 të këtij neni, përbën, veçmas, kundërvajtje administrative dhe dënimi kryesor mund të shoqërohet me dënimin plotësues, gjobë, në vlerë nga 10,000 deri në 100,000 lekë.*
Shkelja e konstatuar nga inspektorët është në mos përmbushje të kushtit 14 të Lejes së mjedisit *"Çmontimi, Rehabilitimi dhe Kontrollo pas Ndërprerjes së Operacioneve",* konkretisht pikat 14.1 dhe 14.2 që përcaktojnë:
14.1*"Brenda 6 muajve nga data e marrjes së lejes, operatori duhet të përgatisë dhe paraqes për miratim tek AKM një plan të detajuar dhe kostot përkatëse për çmontimin ose mbylljen e instalimit"* dhe;
14.2 *"Planet për çmontimin dhe rehabilitimin duhet të rishikohen çdo vit dhe paraqiten për miratim tek AKM",* për rrjedhojë masa administrative e lënë "Paralajmërim" është në kundërshtim me pikën "b/ii" të nenit 29 të ligjit nr. 10448/2011, të ndryshuar, ku përcaktohet se; *"b) Mos përmbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipave A, B apo C nga operatori i një instalimi: ii) për lejet e mjedisit të tipit B, dënohet me gjobë në vlerën nga 300,000 deri në 500,000 lekë."*
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi inspektorët: M.C, G. R.

15. Subjekti T. E sh.p.k me NIPT J.....G, Inspektimi nr. AKM-BR-2022-000053, me objekt inspektimi: *"Kërkesë për informacion për Lejen e Shfrytëzimit 1548" Objekti "Melove" Skrapar, i iniciuar nga shkresa "Delegim për kompetencë" nga AKM, nr. 2042/1, datë 24.03.2022, Informacion/Indicio nga palët e treta"*, Inspektorët: Sh. A dhe I. A.
Nga procesverbali i inspektimit konstatohet se në seksionin e gjetjeve evidentohet kërkesa për dorëzimin e informacionit mbi Lejen Mjedisore që subjekti disponon për Lejen e Shfrytëzimit nr. 1548, në zbatim të nenit 36, pika "d" të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, si dhe referuar shkresës së AKM nr. 2042/1 prot., datë 24.03.2022 *"Delegim për kompetencë*", me afat dorëzimi deri më datë 20.04.2022. Nga verifikimi i Vendimit Përfundimtar të Inspektimit nr. AKM-BR-2022-000053-5, datë 21.04.2022, konstatohet se subjektit i është vendosur dënimi administrativ kryesor "*Gjobë"* në shumën 100,000 lekë, si dhe është lënë detyrimi që të depozitojë pranë ARM Berat/Elbasan/Korçë Lejen e Mjedisit përkatëse për objektin "Melove", Leshnje, Skrapar, brenda datës 20.04.2022, datë e cila përkon me afatin e

përcaktuar për përmbushjen e detyrimit, duke kufizuar në praktikë mundësinë për verifikimin e zbatimit të tij.
Nga auditimi konstatohet se:
- Listëverifikimi është i pa plotësuar në rubrikat përkatëse në kundërshtim me pikën 26, Kreu V "*Lista e Verifikimit*", të Urdhrit nr. 25, datë 10.08.2018 "*Për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ*", që përcakton se: "*Lista e verifikimit plotësohet nga trupa inspektuese gjatë ushtrimit të veprimtarisë inspektuese, pranë subjektit të inspektimit dhe nënshkruhet nga trupa inspektuese dhe subjekti"*;
- Procesverbali nuk është hartuar në përputhje me pikën 3 të nenit 45 të ligjit nr. 10433/2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* i cili përcakton se procesverbali duhet të përmbajë informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit;
- Mungon shkresa/dokumenti i indicios prej palëve të treta. Grupi i auditimit kërkoi informacion dhe nga AKM u vendos në dispozicion shkresa nr. 2041/1 prot., datë 24.03.2022. Sipas kësaj shkrese është deleguar kompetenca për inspektim te Agjencia Rajonale e Mjedisit Berat, Elbasan, Korçë, për të kryer verifikimin ndaj subjektit të lartpërmendur. Nga auditimi konstatohet se gjetja e grupit inspektues është e paargumentuar dhe jo në koherencë me kërkesën për verifikimin në terren të veprimtarisë së këtij subjekti.
Bazuar në shkresën nr. 342/3 prot., datë 04.02.2022 të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, kërkohet verifikim në terren ndaj veprimtarisë së subjektit "*T. E*" SHPK, pasi sipas Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM) leja minerare nr. 1548 ndodhet e gjitha brenda kufirit të monumentit natyror "*Trasgersioni i Paleogjenit dhe Karsti i Qafës së Devries*".
Me shkresën nr. 199/1 prot., datë 22.02.2022, nga AKZM citohet se: "...Referuar ligjit nr. 81/2017 *"Për zonat e mbrojtura",* neni 17, pika 2 dhe 3 citon se: Në një moment natyror zbatohet shkalla e mbrojtjes, e njëjtë me Rezervën Strikte. Zona mbrohet e menaxhohet për ruajtjen e karakteristikave dhe dukurive të veçanta natyrore, kulturore, historike e arkeologjike, për të cilat është shpallur monument. Monumentet natyrore rrethohen nga zona buferike e gjerësi deri në 200 metra nga perimetri i monumentit. Pra ky subjekt nuk përmbush kushtet për të ushtruar zhvillimin e këtij aktiviteti, pasi impakton zonën me aktivitetin e tij dhe duhet të largohet në distancën maksimale nga Monumenti.
Nga ana grupit inspektues nuk është vlerësuar ky konstatim i AKZM dhe nuk janë marrë masa për vendosjen e masës administrative, në kundërshtim me shkronjën c, pika 1 neni 67 i ligjit nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura" ku përcaktohet se: *1. Kur shkeljet nuk përbëjnë vepër penale, por përbëjnë kundërvajtje administrative, të cilat grupohen si më poshtë: c) për mos përmbushje dhe mosrespektim të kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit, sipas parashikimeve të këtij ligji,* ***subjekti dënohet me gjobë nga 500,000 deri në 1,000,000 lekë.***
Nga auditimi gjithashtu konstatohet se:
-afati i lënë për përmirësimin e shkeljeve daton më 20.04.2022 ç'ka e bën të parealizueshëm si kusht. Grupi i auditimit vlerëson se përfshirja e këtij paragrafi në vendimin e inspektimit nuk është e justifikuar, pasi afati i përcaktuar për përmbushjen e detyrimit përkon me datën e vetë vendimit, duke e bërë objektivisht të pamundur realizimin e tij nga subjekti. Në këto kushte, ndaj subjektit duhet ishte vendosur masë administrative. *Mos vendosja e masës administrative është në kundërshtim me pikën 4, 5 dhe 6, neni 48 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"* ku citohet se:
4. *Kur është e nevojshme, dënimi administrativ shoqërohet me urdhërimin e subjektit të inspektimit për të korrigjuar shkeljet e konstatuara dhe për të eliminuar pasojat e tyre, duke përcaktuar dhe*

një afat të arsyeshëm për këtë qëllim. Vendimi i dënimit përfshin këshillimin me shkrim të subjektit për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve që pasqyrohet në një fletë shoqëruese.
5. *Në rastin e parashikuar në pikën 4 të këtij neni, subjekti i inspektimit është i detyruar të njoftojë për korrigjimin e shkeljeve brenda afatit të përcaktuar dhe, nëse është e nevojshme, të paraqesë edhe provat që vërtetojnë këtë fakt. Për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve mund të kryhet një inspektim i ri.*
6. *Mos korrigjimi i parregullsive brenda afatit të përcaktuar, sipas pikës 4 të këtij neni, përbën, veçmas, kundërvajtje administrative dhe dënimi kryesor mund të shoqërohet me dënimin plotësues, gjobë, në vlerë nga* ***10,000 deri në 100,000 lekë.***
Nga shqyrtimi i inspektimeve mbi këtë subjekt rezulton se nga ARM Berat nuk është kryer ri inspektim në lidhje me korrigjimin dhe ndjekjen e shkeljeve të lëna nga inspektimi, në kundërshtim me pikat 15-17, kreu IV të urdhrit e inspektoratit qendror nr. 25, datë 10.08.20218, për miratimin e rregullores "*Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve si një proces i rregullt administrativ*, ku përcaktohet:
"15. Subjekti, objekt inspektimi, është i detyruar të njoftojë për korrigjimin e shkeljeve, brenda afatit të përcaktuar nga trupa inspektuese në vendimin përfundimtar të inspektimit, të mëparshëm dhe nëse është e nevojshme të paraqesë edhe provat që vërtetojnë këtë fakt.
16. Për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve të konstatuara nga trupa inspektuese, kryhet një inspektim i ri. Në rastet kur nga ri inspektimi rezulton se subjekti nuk ka zbatuar detyrat e lëna nga inspektimi i mëparshëm, procedohet me masë administrative.
17. Procedura e inspektimit dhe ri inspektimit kryhen online në portalin e-Inspektimi.
Pra ana e grupit të inspektimit nuk është vijuar me verifikimin mbi distancën e kryerjes së veprimtarisë dhe impaktimin të zonës së mbrojtur nga aktiviteti i vet".
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi inspektorët: Sh. A dhe I. A.

16. Subjekti S me NIPT J.....G, Inspektimi me nr. AKM-BR-2022-000008, me objekt inspektimi:"*Urdhër nga Drejtori i Përgjithshëm nr. 25, datë 07.02.2022 "Për ngritjen e grupeve të punës për evidentimin e problematikave mjedisore të veprimtarive minerare me karrierë (guroret) në territor"*, Inspektorët: M. C, G. R.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit janë evidentuar mangësitë si në vijim: subjekti nuk disponon plan rehabilitimi, referuar kushtit 14 "*Çmontimi, rehabilitimi dhe kontrolli pas ndërprerjes së operacioneve*". Nga procesverbali konstatohet se nuk është realizuar rehabilitimi paralelisht me shfrytëzimin, si dhe është lënë detyrimi që subjekti të dorëzojë raportin 6-mujor të ecurisë së punimeve rehabilituese pranë AKM dhe ARM Berat-Elbasan-Korçë brenda datës 25.02.2022, si dhe të realizojë rehabilitimin për çdo shkallë të shfrytëzuar brenda një afati 6-mujor nga data e inspektimit 15.02.2022. Nga verifikimi i Vendimit Përfundimtar të Inspektimit nr. AKM-BR-2022-000008-5, datë 28.02.2022, konstatohet se subjektit i është vendosur dënimi administrativ kryesor "*Paralajmërim"*
Nga auditimi konstatohet se Procesverbali i inspektimit nr. AKM-BR-2022-000008-2, datë 15.02.2022, nuk është hartuar në përputhje me pikën 3 të nenit 45 të ligjit nr. 10433/2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* i cili përcakton se procesverbali duhet të përmbajë informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit.
Subjekti nuk ka përmbushur detyrën e lënë nga trupa e inspektimit në procesverbalin e datës 15.02.2022, për dorëzimin e raportit 6 mujor të ecurisë së punimeve rehabilituese pranë AKM dhe ARM Berat-Elbasan Korçë. Në këto kushte, ndaj subjektit duhet ishte vendosur masë administrative. Mos vendosja e masës administrative është në kundërshtim me pikën 4, 5 dhe 6,

neni 48 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"* ku citohet se:

4. *Kur është e nevojshme, dënimi administrativ shoqërohet me urdhërimin e subjektit të inspektimit për të korrigjuar shkeljet e konstatuara dhe për të eliminuar pasojat e tyre, duke përcaktuar dhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim. Vendimi i dënimit përfshin këshillimin me shkrim të subjektit për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve që pasqyrohet në një fletë shoqëruese.*

5. *Në rastin e parashikuar në pikën 4 të këtij neni, subjekti i inspektimit është i detyruar të njoftojë për korrigjimin e shkeljeve brenda afatit të përcaktuar dhe, nëse është e nevojshme, të paraqesë edhe provat që vërtetojnë këtë fakt. Për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve mund të kryhet një inspektim i ri.*

6. *Mos korrigjimi i parregullsive brenda afatit të përcaktuar, sipas pikës 4 të këtij neni, përbën, veçmas, kundërvajtje administrative dhe dënimi kryesor mund të shoqërohet me dënimin plotësues, gjobë, në vlerë nga* ***10,000 deri në 100,000 lekë.***

- shkelja e konstatuar nga inspektorët është në mos përmbushje të kushtit 14 të Lejes së mjedisit *"Çmontimi, Rehabilitimi dhe Kontrolli pas Ndërprerjes së Operacioneve",* konkretisht pikat 14.1 dhe 14.2 që përcaktojnë: *"Brenda 6 muajve nga data e marrjes së lejes, operatori duhet të përgatisë dhe paraqes për miratim tek AKM një plan të detajuar dhe kostot përkatëse për çmontimin ose mbylljen e instalimit"* dhe 14.2 *"Planet për çmontimin dhe rehabilitimin duhet të rishikohen çdo vit dhe paraqiten për miratim tek AKM",* për rrjedhojë masa administrative e lënë *"Paralajmërim"* është në kundërshtim me pikën "b/ii" të nenit 29 të ligjit nr. 10448/2011, të ndryshuar, ku përcaktohet se; *"b) Mos përmbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipave A, B apo C nga operatori i një instalimi: ii) për lejet e mjedisit të tipit B, dënohet me gjobë në vlerën nga 300 000 deri në 500 000 lekë;"*

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi inspektorët: M.C, G. R.

17. Subjekti S. P me NIPT K.....U, Inspektimi me nr. AKM-BR-2022-000035, me objekt inspektimi: "*Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm nr. 25, datë 07.02.2022, "Për ngritjen e grupeve të punës për evidentimin e problematikave mjedisore të veprimtarive minerare me karrierë (guroret) në territor"*, Inspektorët: M. C, G. R.

Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit janë evidentuar mangësitë si në vijim: megjithëse në listëverifikim nuk janë shënuar shkelje, nga procesverbali rezulton se subjekti nuk ka paraqitur planin e rehabilitimit të karrierës, nuk ka raportuar çdo 6 muaj për ecurinë e punimeve rehabilituese dhe nuk ka realizuar rehabilitimin paralelisht me shfrytëzimin. Gjithashtu, është evidentuar se subjekti ka dorëzuar pranë AKM raportin vjetor me nr. 5590 prot., datë 10.11.2021, ndërsa është lënë detyrimi që brenda datës 18.03.2022 të paraqesë planin e rehabilitimit pranë ARM Berat, Elbasan, Korçë dhe të realizojë rehabilitimin e sipërfaqeve të shfrytëzuara brenda një afati 6-mujor nga data e inspektimit. Për këto gjetje, trupa e inspektimit ka vendosur dënimin administrativ kryesor "*Paralajmërim*", si dhe ka përcaktuar detyrimet për korrigjimin e shkeljeve.

Nga verifikimi i Vendimit Përfundimtar të Inspektimit nr. AKM-BR-2022-000035-5, datë 18.03.2022, konstatohet se, në bazë të pikës 1 të nenit 48 të ligjit nr. 10433/2011, është vendosur e njëjta masë administrative "*Paralajmërim",* duke u përsëritur të njëjtat detyrime për korrigjimin e shkeljeve, çka evidenton mospërputhje ndërmjet listëverifikimit dhe procesverbalit lidhur me evidentimin e shkeljeve.

Nga auditimi konstatohet se procesverbali i inspektimit nuk është hartuar në përputhje me pikën 3 të nenit 45 të ligjit nr. 10433/2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, i cili kërkon që procesverbali të përmbajë informacion të plotë dhe të detajuar mbi veprimet e inspektimit, gjetjet dhe vendimet procedurale të marra. Subjekti nuk ka përmbushur detyrën e lënë nga trupa e

inspektimit në procesverbalin e datës 03.03.2022, në këto kushte, ndaj subjektit duhej të ishte vendosur masë administrative. Mos vendosja e saj bie ndesh me pikat 4, 5 dhe 6 të nenit 48 të ligjit nr. 10433/2011, ku citohet se:

4. Kur është e nevojshme, dënimi administrativ shoqërohet me urdhërimin e subjektit të inspektimit për të korrigjuar shkeljet e konstatuara dhe për të eliminuar pasojat e tyre, duke përcaktuar dhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim. Vendimi i dënimit përfshin këshillimin me shkrim të subjektit për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve që pasqyrohet në një fletë shoqëruese.

5. Në rastin e parashikuar në pikën 4 të këtij neni, subjekti i inspektimit është i detyruar të njoftojë për korrigjimin e shkeljeve brenda afatit të përcaktuar dhe, nëse është e nevojshme, të paraqesë edhe provat që vërtetojnë këtë fakt. Për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve mund të kryhet një inspektim i ri.

6. Mos korrgjimi i parregullsive brenda afatit të përcaktuar, sipas pikës 4 të këtij neni, përbën, veçmas, kundërvajtje administrative dhe dënimi kryesor mund të shoqërohet me dënimin plotësues, gjobë, në vlerë nga 10,000 deri në 100,000 lekë.

Shkelja e konstatuar lidhet me mosrespektimin e kushtit 14 të Lejes së Mjedisit *"Çmontimi, Rehabilitimi dhe Kontrolli pas Ndërprerjes së Operacioneve"*, konkretisht pikave 14.1 dhe 14.2, të cilat kërkojnë:

- përgatitjen dhe parashtrimin pranë AKM të planit të çmontimit/rehabilitimit brenda 6 muajve nga marrja e lejes;
- rishikimin dhe paraqitjen e planit çdo vit për miratim pranë AKM.

Në këto kushte, vendosja e masës administrative *"paralajmërim"* është në kundërshtim me pikën b/ii të nenit 29 të ligjit nr. 10448/2011, të ndryshuar, ku përcaktohet se mosrespektimi i kushteve të lejes së mjedisit të tipit B dënohet me gjobë nga 300,000 deri në 500,000 lekë.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi inspektorët: M.C dhe G. R.

18. Subjekti D me NIPT L.....U, Inspektimi me nr. AKM-BR-2022-00003, me objekt inspektimi: *"Urdhër nga Drejtori i Përgjithshëm nr. 25, datë 07.02.2022 "Për ngritjen e grupeve të punës për evidentimin e problematikave mjedisore të veprimtarive minerare me karrierë (guroret) në territor"*, Inspektorët: M. C, G. R.

Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit janë evidentuar mangësitë si në vijim: subjekti nuk disponon plan rehabilitimi, referuar kushtit 14 "*Çmontimi, rehabilitimi dhe kontrolli pas ndërprerjes së operacioneve*", ndërsa nga procesverbali rezulton se subjekti ka pasur plan rehabilitimi vetëm për vitin 2014 dhe për periudhën 2015–2022 nuk ka hartuar plan rehabilitimi, nuk ka raportuar çdo 6 muaj për ecurinë e punimeve rehabilituese dhe nuk ka realizuar rehabilitimin paralelisht me shfrytëzimin. Për këto gjetje është lënë detyrimi që subjekti, brenda datës 15.03.2022, të paraqesë pranë ARM Berat, Elbasan, Korçë planin e rehabilitimit për ecurinë e punimeve rehabilituese të objektit minerar, si dhe të realizojë rehabilitimin e sipërfaqeve të shfrytëzuara brenda një afati 6-mujor nga data e inspektimit.

Nga auditimi, konstatohet se nuk ka arsyetim ligjor përse subjektit i është vendosur *"Dënim Administrativ"* kryesor *"Paralajmërim",* pasi shkelja është kundërvajtje sipas pikës 1/b (ii) të nenit 29, të ligjit nr. 10448/2011, të ndryshuar ku përcaktohet se: "b) *Mos përmbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipave A, B apo C nga operatori i një instalimi:*

ii) për lejet e mjedisit të tipit B, dënohet me gjobë në vlerën nga 300,000 deri në 500,000 lekë".

Evidentohet se kjo problematikë nuk ka marrë zgjidhje, pasi nuk ka pasur plan rehabilitimi për periudhën 2015-2022 si dhe nuk ka patur raportim 6-mujor mbi planin e rehabilitimit.

Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistem rezultoi se procesverbali i inspektimit nr. AKM-BR-2022-000031-2, datë 28.02.2022, nuk është hartuar në përputhje me pikën 3 të nenit 45 të ligjit nr. 10433/2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* i cili përcakton se procesverbali duhet të përmbajë informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit.
Përsa i përket masës për korrigjimin e shkeljes nga verifikimi i Vendimit Përfundimtar të inspektimit me nr. AKM-BR-2022-000031-5, datë 15.03.2022, grupi i auditimit vlerëson se përfshirja e këtij paragrafi në vendimin e inspektimit nuk është e justifikuar, pasi afati i përcaktuar për përmbushjen e detyrimit përkon me datën e vetë vendimit, duke e bërë objektivisht të pamundur realizimin e tij nga subjekti. Në këto kushte, ndaj subjektit duhet ishte vendosur masë administrative. Mos vendosja e masës administrative është në kundërshtim me pikën 4, 5 dhe 6, neni 48 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"* ku citohet se:
4. *Kur është e nevojshme, dënimi administrativ shoqërohet me urdhërimin e subjektit të inspektimit për të korrigjuar shkeljet e konstatuara dhe për të eliminuar pasojat e tyre, duke përcaktuar dhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim. Vendimi i dënimit përfshin këshillimin me shkrim të subjektit për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve që pasqyrohet në një fletë shoqëruese.*
5. *Në rastin e parashikuar në pikën 4 të këtij neni, subjekti i inspektimit është i detyruar të njoftojë për korrigjimin e shkeljeve brenda afatit të përcaktuar dhe, nëse është e nevojshme, të paraqesë edhe provat që vërtetojnë këtë fakt. Për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve mund të kryhet një inspektim i ri.*
6. *Mos korrigjimi i parregullsive brenda afatit të përcaktuar, sipas pikës 4 të këtij neni, përbën, veçmas, kundërvajtje administrative dhe dënimi kryesor mund të shoqërohet me dënimin plotësues, gjobë, në vlerë nga* ***10,000 deri në 100,000 lekë.***
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi inspektorët: M. C, G. R.

19. Subjekti E-E me NIPT M.....T, Inspektimi me nr. AKM-BR-2023-000163, me objekt inspektimi "*Referuar email-it të ardhur nga Sektori i Monitorimit pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, mbi dorëzimin e dokumentacionit e kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të Lejes Mjedisore"*, Inspektorët: S. R, G. R.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit janë evidentuar mangësitë si në vijim: listëverifikimi nuk është plotësuar në tërësi, por vetëm në pyetjen nr. 28, lidhur me zbatimin e kushteve të lejes mjedisore për dokumentimin dhe raportimin, ndërkohë që subjekti nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për zbatimin e kushteve periodike të Lejes Mjedisore. Nga procesverbali evidentohet se operatori "*E-E*" SHPK., me PN-5783-09-2017, nuk ka respektuar kërkesat e pikës 12.7 të Lejes së Mjedisit, sipas së cilës raportet me të gjitha të dhënat e regjistruara duhet t'i dorëzohen autoritetit kompetent brenda afateve dhe formatit të përcaktuar. Për këto shkelje është vendosur dënimi administrativ kryesor *"Paralajmërim*", pa argumentim ligjor mbi karakterin e shkeljes si e një rëndësie të vogël dhe pa plotësuar kushtet e pikës 1 të nenit 48 të ligjit nr. 10433, datë 16.04.2011, ku citohet se: "*Kur konstatohet shkelje e kërkesave ligjore, që përbën kundërvajtje administrative, por që është e një rëndësie të vogël, apo për të cilën ligji i posaçëm nuk parashikon dënimin përkatës administrativ, subjekti i inspektimit dënohet me "paralajmërim"*", ndërkohë që në të njëjtin procesverbal është parashikuar edhe "Gjobë" në shumën 1,000,000 lekë, duke krijuar paqartësi në klasifikimin dhe aplikimin e masave administrative. Gjithashtu, për përmirësimin e shkeljeve është lënë detyrimi që subjekti të dorëzojë pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit Berat/Elbasan/Korçë raportin e fundit të vetëmonitorimit brenda datës 31.10.2023.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistem rezultoi se procesverbali i inspektimit nr. AKM-BR-2023-000163-2, datë 13.10.2023, nuk është hartuar në përputhje me pikën 3 të nenit 45 të ligjit nr. 10433/2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* i cili përcakton se procesverbali duhet të përmbajë informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit.
Nga auditimi konstatohet gjithashtu se në vendimin përfundimtar të inspektimit me nr. AKM-BR-2023-000163–5, datë 31.10.2023, dënimi administrativ kryesor *"Gjobë në shumën 1,000,000 lekë"* sipas procesverbalit është hequr pa u argumentuar ligjërisht, në kundërshtim me pikën "1/a (i) të nenit 29 të ligjit nr. 10448/2011, të ndryshuar, ku citohet se:
1.Shkeljet e mëposhtme të këtij ligji, që nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:
a) Zhvillimi i veprimtarisë që është subjekt i një lejeje mjedisi të tipave A, B ose C, sipas përcaktimeve të këtij ligji:
i) pa lejen përkatëse të mjedisit të tipit A, dënohet me gjobë në vlerën nga 1,000,000 deri në 2,000,000 lekë.
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi inspektorët: S. R, G. R.

20. Subjekti K. B me NIPT K.....N, Inspektimi me nr. AKM-BR-2023-000148, me objekt inspektimi"*Kontroll mbi zbatimin e kushteve te L/M me nr. PN-0390-04-2021*", Inspektorët: S. R, F. Sh, Sh. A.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit janë evidentuar mangësitë si në vijim: subjekti nuk ka paraqitur mandatpagesën e tarifës vjetore, ndërsa në vijim të gjitha rubrikat janë plotësuar me shënimin se gjatë inspektimit në vendndodhje subjekti nuk ushtronte aktivitet dhe nuk ka paraqitur dokumentacionin e nevojshëm. Nga procesverbali konstatohet se subjekti nuk ka dorëzuar dokumentacionin për zbatimin e kushteve periodike të Lejes Mjedisore, si dhe nuk ka paraqitur raportin e fundit të vetëmonitorimit dhe mandatpagesën e tarifës vjetore. Për këto shkelje është vendosur dënimi administrativ kryesor *"Paralajmërim*" dhe "*Gjobë"* në shumën 300,000 lekë, si dhe është lënë detyrimi që subjekti të dorëzojë pranë Agjencisë Rajonale të Mjedisit Berat/Elbasan/Korçë raportin e fundit të vetëmonitorimit dhe mandatpagesën e tarifës vjetore brenda datës 08.11.2023. Nga verifikimi i Vendimit Përfundimtar të Inspektimit nr. AKM-BR-2023-000148-5, datë 03.11.2023, konstatohet se dënimi administrativ "*Gjobë"* është hequr dhe është lënë vetëm masa "*Paralajmërim"*.
Nga auditimi konstatohet se Procesverbali i isnpektimit nuk është hartuar në përputhje me pikën 3 të nenit 45 të ligjit nr. 10433/2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, i cili përcakton se procesverbali duhet të përmbajë informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektimit, gjetjet dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit.
Nga evidentimi i dokumentacionit bashkëlidhur konstatohet se tarifa e lejes mjedisore është paguar më datë 30.10.2023, pra pas datës së procesverbalit (25.10.2023), në kundërshtim me afatin e përcaktuar në lejen mjedisore nr. LC5310 dhe në Vendimin nr. 417, datë 25.06.2014 *"Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit"*, sipas të cilit tarifa vjetore paguhet brenda tremujorit të parë të vitit.
Gjithashtu, është depozituar raporti i monitorimit me shkresën përcjellëse datë 01.11.2023, protokolluar në AKM me nr. 9112, datë 01.11.2023, për periudhën Tetor 2022 – Prill 2023, pra për një periudhë para kohës së inspektimit dhe jo raportimi i fundit, siç përcaktohet në procesverbal. Ky raport është dorëzuar gjithashtu në tejkalim të afatit të parashikuar në kushtin 12.6 të lejes mjedisore nr. PN-0390-04-2021, sipas të cilit raporti vjetor i monitorimit duhet të dorëzohet çdo vit më datë 16 prill për vitin pasardhës.

Në dokumentacionin bashkëlidhur gjendet edhe shkresa e datës 29.03.2023, protokolluar në AKM me nr. 2644, datë 03.04.2023 *"Informacion mbi Raportin e Vetëmonitorimit"*, sipas së cilës subjekti ka informuar se nuk kryen aktualisht punime, pasi është në proces të krijimit të infrastrukturës së nevojshme dhe për rrjedhojë nuk mund të kryejë matje të parametrave mjedisore që pasqyrohen në raportin e vetëmonitorimit.
Sa më sipër, konstatohet se subjekti nuk ka ka respektuar e afatin të pagesës së tarifës vjetore dhe mosrespektimin e afatit për dorëzimin e raportit të monitorimit, sipas përcaktimeve në lejen mjedisore.
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi inspektorët: S. R, F. Sh, Sh. A.

Tabela e mëposhtme paraqet inspektimet e kryera nga AKM-BR gjatë vitit 2025, për të cilat trupa inspektuese ka vendosur masën administrative "paralajmërim".

Tabela *Të dhëna mbi inspektimet dhe masat administrative të ARM –BR për vitin 2025*

NR.	NR.ÇËSHTJE	AKM/RAJONI	SUBJEKTI I INSPEKTUAR	NIPTI	MASA ADMINISTRATIVE
1	AKM-BR-2025-000086	ARM/BR	E. K	M********I	Paralajmërim
2	AKM-BR-2025-000085	ARM/BR	I	M********C	Paralajmërim

Burimi: *AKM, përpunoi Grupi Auditimit.*

Nga auditimi e të dhënave të paraqitura në tabelë konstatohet se, për 2 inspektime të kryera gjatë vitit 2025, masa administrative e vendosur ndaj subjekteve të inspektuara ka qenë në të gjitha rastet *"paralajmërim",* pavarësisht llojit të veprimtarisë së subjekteve, natyrës së shkeljeve të konstatuara dhe sanksioneve të parashikuara në ligjet e posaçme mjedisore. Kjo praktikë tregon se trupat inspektuese kanë zbatuar në mënyrë uniforme dhe automatike masën e paralajmërimit, duke u mbështetur kryesisht në interpretimin e pikës 1 të nenit 44 të ligjit nr. 99/2024 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* pa kryer një vlerësim të individualizuar të shkeljeve dhe pa aplikuar masat administrative të përcaktuara shprehimisht në legjislacionin e posaçëm për mjedisin, çka e bën këtë praktikë të papërputhshme me parimin e ligjshmërisë dhe me hierarkinë e normave juridike.
Nga auditimi konstatohet se, gjatë periudhës objekt auditimi, Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011, *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* ka pësuar ndryshime që lidhen me mënyrën e vendosjes së masave administrative ndaj subjekteve të inspektimit.
Në formën e tij para ndryshimeve, Ligji nr. 10433/2011, në nenin 48 "*Shkelja e kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit"*, parashikonte shprehimisht se:
1. Kur konstatohet shkelje e kërkesave ligjore, që përbën kundërvajtje administrative, por që është e një rëndësie të vogël, apo për të cilën ligji i posaçëm nuk parashikon dënimin përkatës administrativ, subjekti i inspektimit dënohet me 'paralajmërim'. Paralajmërimi është dënim administrativ kryesor.
2. Subjekti i inspektimit mund të dënohet drejtpërdrejt me një dënim tjetër kryesor administrativ, më të rëndë, të parashikuar në ligjin e posaçëm, kur:
a) nuk zbaton plotësisht dhe brenda afatit të përcaktuar urdhërimin e parashikuar në pikën 4 të këtij neni;
b) përsërit shkeljen e kërkesave ligjore;
c) shkelja e konstatuar apo pasojat e saj janë të rënda.
Ky formulim ligjor e lidhte drejtpërdrejt zbatimin e masës administrative me përcaktimet e ligjit të posaçëm dhe nuk lejonte përdorimin e masës *"paralajmërim"* në rastet kur shkelja ishte e parashikuar shprehimisht si kundërvajtje administrative me sanksion konkret.

Me miratimin e ligjit nr. 99/2024 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* kjo dispozitë është riformuluar dhe aktualisht përfshihet në nenin 44 "*Dënimi administrativ kryesor",* i cili parashikon se:

11. Paralajmërimi është dënimi administrativ kryesor në inspektimin e parë të trupës së inspektimit.

12. Në të gjitha rastet kur konstatohen shkelje të kërkesave ligjore, që përbëjnë kundërvajtje administrative, subjekti i inspektimit dënohet me paralajmërim.

13. Paralajmërimi, si masë administrative kryesore, vendoset edhe për rastet kur për shkelje të lehta ligji i posaçëm nuk parashikon dënimin përkatës administrativ.

14. Dënimi administrativ kryesor me paralajmërim nuk zbatohet në rastet e shkeljeve të rënda për të cilat parashikohet masa e pezullimit të aktivitetit, sipas ligjit të posaçëm.

15. Dënimi administrativ kryesor me paralajmërim shoqërohet me urdhërimin e subjektit për të korrigjuar shkeljet e konstatuara dhe për të eliminuar pasojat e tyre, duke përcaktuar edhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim.

Nga auditimi konstatohet se kjo dispozitë është interpretuar nga AKM-ja dhe strukturat e saj rajonale në kuptimin se, për çdo subjekt të inspektuar për herë të parë pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 99/2024, masa administrative që duhet të vendoset është vetëm "paralajmërim", pavarësisht llojit të shkeljes dhe pavarësisht sanksioneve të parashikuara në ligjet e posaçme.

Sipas vlerësimit të grupit të auditimit, ky interpretim nuk është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, pasi ligji i inspektimit ka karakter të përgjithshëm dhe procedural, ndërsa ligjet e posaçme mjedisore përcaktojnë shprehimisht shkeljet dhe masat administrative përkatëse.

Në këtë kuadër, aplikimi i masës administrative "paralajmërim", pa marrë në konsideratë llojin dhe rëndësinë e shkeljes dhe pa zbatuar sanksionet e përcaktuara në ligjet e posaçme, bie në mospërputhje me:

Ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011, *"Për lejet e mjedisit",* neni 29;

Ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011, *"Për mbrojtjen e mjedisit",* neni 69;

Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011*, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve",* neni 62;

Ligjin nr. 29/2024 "Për burimet ujore", neni 169.

Për rrjedhojë, nga auditimi konstatohet se vendosja e masës administrative *"paralajmërim"* nga trupat inspektuese gjatë vitit 2025, në rastet kur ligjet e posaçme parashikojnë sanksione konkrete administrative, nuk është në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi dhe nuk garanton zbatimin e plotë dhe efektiv të legjislacionit mjedisor.

Për problematikat e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi inspektorët sipas rasteve të trajtuara në këtë material, përgjegjësi i sektorit të Inspektimeve Mjedisore dhe Burimeve Natyrore dhe Drejtori i ARM Berat, sipas periudhave që kanë mbuluar në pozicionet përkatëse.

Drejtori i ARM Berat: Xh. L, D. M; *Përgjegjësi i sektorit të Inspektimeve Mjedisore F. Sh, Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Ujore:* A. A; Inspektorët e përmendur në këtë material.

2.5.5 AGJENCIA RAJONALE MJEDISORE Lezhë, Shkodër, Kukës

Nga verifikimi i plotësimit të strukturës së miratuar për Agjencitë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës, për periudhën objekt auditimi rezultoi se:

- Për vitin 2021 nuk është plotësuar për 1 përgjegjës për SIBN dhe për 1 përgjegjës dhe 3 specialistë në SIM;
- Për vitin 2022 nuk është plotësuar për 1 përgjegjës për SIBN dhe për 1 përgjegjës dhe 3 specialistë nga periudha Janar-Korrik dhe 2 specialistë nga periudha Gusht-Dhjetor në SIM;

-Për vitin 2023 nuk është plotësuar për 1 përgjegjës dhe 1 specialist për SIBN dhe për 1 përgjegjës dhe 2 specialistë në SIM;
-Për vitin 2024 nuk është plotësuar për 1 përgjegjës dhe 1 specialist për SIBN dhe 2 specialistë nga periudha Janar-Prill dhe më pas struktura është plotësuar në SIM;
-Për vitin 2025 nuk është plotësuar për 1 përgjegjës dhe 1 specialist për SIBN dhe 1 specialist në SIM.
Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me: Urdhërin nr. 23, datë 03.02.2020 të Kryeministrit "*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së AKM-së*"; Urdhërin nr.187, datë 15.11.2022, të Kryeministrit për "Miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit"; Urdhërin nr. 29, datë 13.02.2024 të Kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së AKM-së" dhe Urdhërin nr. 194, datë 04.10.2024 të Kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së AKM-së", skemat 1/2 dhe 2/2, duke rezultuar për periudhën objekt auditimi me vende të lira, krahasuar me numrin e miratuar në organikë, duke sjellë për pasojë ulje të efektivitetit dhe eficiencës në punë. të këtyre sektorëve.

Mbi planifikimin dhe realizim vjetor të inspektimeve:
Programi vjetor hartohet nga drejtori i DIK dhe përcillet te titullari i AKM-së. Përveç inspektimeve të planifikuara janë kryer dhe inspektime të paplanifikuara, kur ka qenë e nevojshme, si në rastet e ankesave, denoncimeve apo informacioni nga të tretët, në raste rishikimesh, etj. Dokumentacionet e inspektimeve janë hedhur në sistemin e *E–Inspektim*. Bazuar në Ligjin nr. 10433, datë 16.06.20011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, realizimi i programit inspektues nga të dy sektorët është si në vijim:
- Për vitin 2021 programi vjetor është realizuar me 59%;
- Për vitin 2022 programi vjetor është realizuar me 30%;
- Për vitin 2023 programi vjetor është realizuar me 39%;
- Për vitin 2024 programi vjetor është realizuar me 41%;
- Për vitin 2025 programi vjetor është realizuar me 47%;

Për periudhën objekt auditimi, *grupi i auditimit konstatoi* mosrealizimin e plotë të programeve vjetore të inspektimit nga të dy sektorët inspektues. Mosrealizimi i plotë i programeve vjetore të inspektimit ndikon në uljen e efektivitetit të funksionit mbikëqyrës dhe kontrollues të strukturave inspektuese, duke krijuar risk për mungesë kontrolli të plotë mbi subjektet që duhet të inspektohen. Nga auditimi i procesit të planifikimit dhe përgatitjes së programeve vjetore të auditimit për periudhën objekt auditimi, *grupi i auditimit konstatoi se* ARM Lezhë nuk rezulton të kenë përgatitur Program Vjetor të Inspektimeve. Programi Vjetor i inspektimeve është përgatitur nga AKM pa marrë mendim nga Agjencitë Rajonale. E gjithë kjo situatë është në kundërshtim me Rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit nr.120 prot., datë 12.01.2021, e miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i AKM-së, Kreu VII, nënkapitulli III.I pika 11, nënkapitulli III.II germa "d", nënkapitulli III.III germa "b" dhe pika 11.

Nga auditimi me zgjedhje i inspektimeve në ARM Lezhë, të regjistruara në sistemin e-inspektim u konstatua se nuk është evidentuar informacioni mbi statusin e pagesës së tarifave vjetore të lejeve mjedisore nga subjektet. Mospasja e këtij informacioni pengon identifikimin e subjekteve që nuk kanë kryer pagesat përkatëse dhe kufizon mundësinë e përfshirjes së tyre në planet e inspektimit.

Inspektimet e përzgjedhura për auditim:

1. Subjekti S. U. me NIPT J.....Q, Inspektimi nr. AKM-LE-2021-000224, me objket nspketimi: "*Inspektim mbi zbatueshmërinë e kushteve të licencës me LN-7408-05-2019",*
Inspektorët: J. Sh, B. L.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit janë evidentuar mangësitë si në vijim: nga inspektimi i kryer në subjektin S. U, për licencën III.2B me LN-7408-05-2019, rezulton se subjekti, sipas deklarimeve, nuk ka ushtruar aktivitet në mënyrë të qëndrueshme, duke disponuar vetëm një kontratë me Landfillin e Bushatit për transferimin e mbetjeve në rast nevoje, si dhe një kontratë me Fondin Shqiptar të Zhvillimit për zhvendosjen e inerteve brenda të njëjtit territor. Nga procesverbali konstatohet se gjetjet bien në kundërshtim me kërkesat e nenit 21, pika 6 të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, "*Për menaxhimin e integruar të mbetjeve*", sipas të cilit transferimi i mbetjeve duhet të shoqërohet me dokumentacion përkatës dhe të ruhet për një periudhë të caktuar. Për këto shkelje, në seksionin e kundërvajtjeve administrative është vendosur dënimi administrativ kryesor "*Paralajmërim*", me argumentimin se subjekti kontrollohet për herë të parë. Nga verifikimi i Vendimit Përfundimtar të Inspektimit konstatohet se gjetjet dhe masa administrative janë të njëjta me ato të procesverbalit, duke u vendosur ndaj subjektit dënimi kryesor *"Paralajmërim*".
Nga verifikimi i vendimit përfundimtar të inspektimit me nr. AKM-LE-2021-000224-5, datë 10.11.2021, rezulton se data e marrjes së këtij vendimi përkon me datën e mbajtjes së procesverbalit të inspektimit. ligji nr. 10433, datë 16.06.2011, *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*", në nenin 45, pika 4, përcakton se: "*Procesverbali i inspektimit përmban, gjithashtu, informacion për të drejtën e subjektit të inspektimit që të paraqesë me shkrim apo me gojë shpjegimet apo kontestimet e tij për faktet dhe rrethanat e konstatuara në procesverbal, brenda një afati të përcaktuar nga inspektori, por jo më të shkurtër se 8 ditë nga data e njoftimit të procesverbalit, për paraqitjen e këtyre komenteve, si dhe organin ku paraqiten këto komente. Pas kalimit të këtij afati, vendimi përfundimtar mund të merret pa qenë i nevojshëm dëgjimi i mëtejshëm i subjektit të inspektimit. Shpjegimet apo kontestimet e subjektit të inspektimit janë pjesë e dosjes".* Në këto kushte, rezulton se subjektit të inspektimit nuk i është lënë hapësira ligjore për të paraqitur shpjegime apo kontestime ndaj procesverbalit të inspektimit, siç parashikohet shprehimisht nga dispozitat ligjore të sipërcituara, duke cenuar të drejtën e tij për t'u dëgjuar dhe për të ushtruar të drejtën e ankimit në fazën procedurale përkatëse.
Gjithashtu nga verifikimi i dokumentacionit të inspektimit dhe i fakteve të konstatuara në terren, grupi i auditimit vlerëson se shkelja e kryer nga subjekti i inspektimit përbën kundërvajtje administrative të parashikuar shprehimisht në nenin 62, pikat 8, 9 dhe 10 të ligjit "*Për menaxhimin e integruar të mbetjeve",* ku përcaktohet se:
8. Çdo person, që angazhohet në transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe që nuk ruan dokumentet, në përputhje me nenin 21 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 300 000 (treqind mijë) deri në 500,000 (pesëqind mijë) lekë.
9. Çdo person, që angazhohet në transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe që nuk ua vë dokumentet në dispozicion autoriteteve përkatëse, në përputhje me nenin 21 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 300,000 (treqind mijë) deri në 500,000 (pesëqind mijë) lekë. 10. Çdo person, që angazhohet në transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe që nuk dërgon informacion në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, në përputhje me nenin 21 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 300,000 (treqind mijë) deri në 500,000 (pesëqind mijë) lekë.
Sa më sipër, grupi i auditimit vlerëson se legjislacioni i posaçëm për menaxhimin e integruar të mbetjeve parashikon në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të detyrueshme masën administrative të gjobës për shkeljet e mësipërme, pa lënë hapësirë për zëvendësimin e saj me masën *"paralajmërim*". Për rrjedhojë, vendosja e masës administrative *"paralajmërim"* ndaj subjektit të

inspektimit, në kushtet kur shkelja është e përcaktuar qartë si kundërvajtje administrative e sanksionuar me gjobë nga ligji i posaçëm, është e paargumentuar dhe e pajustifikuar nga pikëpamja ligjore.

Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: J. Sh, B. L.

2. Subjekti L. I me NIPT J.....P, Inspektimi me nr. AKM-LE-2023-000164, me objekt inspektimi: "*Inspektim mbi zbatueshmërinë e kushteve të "Vendim për VNM Paraprake" me nr. AN28012010028*", inspektorët: N. D, K. U.

Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit janë evidentuar mangësitë si në vijim: nuk është plotësuar rubrika që lidhet me verifikimin e kryerjes së vetëmonitorimit dhe raportimit të tij pranë AKM-së gjatë fazës së zbatimit të projektit. Nga procesverbali konstatohet se subjekti nuk i ka vënë në dispozicion trupës inspektuese raportet e vetëmonitorimit të dorëzuara në AKM, duke u konsideruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 26 të ligjit nr. 128/2020 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10440, datë 07.07.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis*", të ndryshuar, lidhur me mos përmbushjen e kushteve të vendimit për VNM paraprake ose deklaratës mjedisore nga zhvilluesi i projektit. Për këto shkelje, në seksionin e kundërvajtjeve administrative është vendosur dënimi administrativ kryesor "*Paralajmërim".* Nga verifikimi i Vendimit Përfundimtar të Inspektimit konstatohet se gjetjet dhe masa administrative janë të njëjta me ato të procesverbalit, duke u vendosur ndaj subjektit dënimi kryesor "Paralajmërim".

Nga auditimi konstatohet se në VNM me nr. AN280120210028, datë 03.03.2021**,** pika 3.23 citon se: "*Subjekti duhet të paraqesë pranë AKM-së si më poshtë:*

- informacion në momentin e fillimit të punimeve;

- raportimin periodik për parametrat që do të monitorohen, sipas datës së raportimit / çdo 6 muaj".

Për sa më sipër, bazuar në pikat 1, 2 dhe 3, neni 25/1, ligjit nr. 10440/2011 *"Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"***,** i ndryshuar**,** përcaktohet se:

"1. AKM-ja përcakton llojin e parametrave që monitorohen dhe kohëzgjatjen e monitorimit, në raport me natyrën, vendndodhjen dhe madhësinë e projektit, si dhe me ndikimet e rëndësishme të tij në mjedis, të cilat parashikohen në vendimin për VNM-në paraprake apo në deklaratën mjedisore."

"2. Zhvilluesi, gjatë fazës së zbatimit të projektit, kryen vetë monitorimin e ndikimeve të rëndësishme të projektit në mjedis dhe i raporton AKM-së për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit."

"3. Struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e mjedisit inspekton ndikimet në mjedis nga zbatimi i projektit, si dhe kushtet e monitorimit të përcaktuara në vendimin për VNM-në paraprake apo në deklaratën mjedisore."

Nga auditimi konstatohet se, pavarësisht mos përmbushjes së detyrimeve për informim dhe raportim periodik pranë AKM-së, ndaj subjektit nuk është aplikuar dënimi administrativ me gjobë, në kundërshtim me gërmën "b (i)", pika 1, neni 26, ligjit nr. 10440/2011 *"Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"*, i cili përcakton se:*"Shkeljet e këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:*

b) mos përmbushja dhe mosrespektimi i kushteve nga zhvilluesi i projektit:

i) për vendimin për VNM-në paraprake dënohet me gjobë nga 65,000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë deri në 260,000 (dyqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë."

Në këto kushte, shkelja e konstatuar përbën kundërvajtje administrative të përcaktuar shprehimisht në legjislacionin e sipërcituar. Për rrjedhojë, vendosja e masës administrative *"paralajmërim"* ndaj subjektit rezulton e pajustifikuar dhe e paargumentuar nga pikëpamja ligjore, pasi bie ndesh me dispozitat e ligjit të posaçëm që parashikon detyrimisht sanksionin me gjobë për këtë lloj shkeljeje

Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: N. D, K. U.

3. Subjekti: 4 A. me NIPT K.....L, Inspektimi me nr. AKM-LE-2023-000167, me objekt inspektimi: "*Inspektim mbi zbatueshmërinë e kushteve të VNM-se paraprake me nr. AN150620210003, datë 19.08.2021 për projektin "Ndërtimi i lidhjes së rrugës së Oroshit me rrugën e Kombit"* , Inspektorët: J. Sh, A. M.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit janë evidentuar mangësitë si në vijim: në lidhje me detyrimin për kryerjen e vetëmonitorimit të ndikimeve në mjedis gjatë fazës së zbatimit të projektit dhe raportimin e tyre pranë AKM-së, rezulton se subjekti ka realizuar raportet e vetëmonitorimit, por nuk ka përmbushur detyrimin për raportimin e tyre në kohë, në kundërshtim me kërkesat ligjore dhe kushtet e përcaktuara në vendimin për VNM. Nga procesverbali konstatohet se këto shkelje bien në kundërshtim me shkronjën "b", pika 1, neni 26 të ligjit nr. 128/2020 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10440, datë 07.07.2011 'Për vlerësimin e ndikimit në mjedis', të ndryshuar*", ku përcaktohet se: "*Mos përmbushja dhe mosrespektimi i kushteve të vendimit për VNM-në paraprake ose deklaratës mjedisore nga zhvilluesi i projektit*", ndërsa sipas komenteve subjekti 4A. ka raportuar pranë AKM vetëm në përfundim të punimeve dhe jo në mënyrë periodike. Për këto shkelje, në seksionin e kundërvajtjeve administrative është vendosur dënimi administrativ kryesor *"Paralajmërim*". Nga shqyrtimi i Vendimit Përfundimtar të Inspektimit konstatohet se seksioni i gjetjeve dhe ai i kundërvajtjeve administrative është i njëjtë me atë të pasqyruar në procesverbalin e inspektimit dhe ndaj subjektit është vendosur dënimi administrativ kryesor "*Paralajmërim".*

Nga auditimi konstatohet se në VNM me nr. AN150620210003, datë 19.08.2021**,** pika 3.27 citon se subjekti duhet të paraqesë pranë AKM-së si më poshtë:
- informacion në momentin e fillimit të punimeve;
- raportimin periodik për parametrat që do të monitorohen, sipas datës së raportimit / çdo 6 muaj;
- informacion në përfundim të punimeve, lidhur me punimet rehabilituese të territorit përreth, shoqëruar edhe me foto.

Për sa më sipër, bazuar në pikat 1, 2 dhe 3, neni 25/1, ligjit nr. 10440/2011 *"Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"*, i ndryshuar, përcaktohet se:
"1. AKM-ja përcakton llojin e parametrave që monitorohen dhe kohëzgjatjen e monitorimit, në raport me natyrën, vendndodhjen dhe madhësinë e projektit, si dhe me ndikimet e rëndësishme të tij në mjedis, të cilat parashikohen në vendimin për VNM-në paraprake apo në deklaratën mjedisore."
"2. Zhvilluesi, gjatë fazës së zbatimit të projektit, kryen vetë monitorimin e ndikimeve të rëndësishme të projektit në mjedis dhe i raporton AKM-së për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit."
"3. Struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e mjedisit inspekton ndikimet në mjedis nga zbatimi i projektit, si dhe kushtet e monitorimit të përcaktuara në vendimin për VNM-në paraprake apo në deklaratën mjedisore."
Nga auditimi konstatohet se, pavarësisht mos përmbushjes së detyrimeve për informim dhe raportim periodik pranë AKM-së, ndaj subjektit nuk është aplikuar dënimi administrativ me gjobë, në kundërshtim me gërmën "b (i)", të pikës 1, neni 26, të ligjit nr. 10440/2011 *"Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"*, i cili përcakton se:
"Shkeljet e këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë: b) mos përmbushja dhe mosrespektimi i kushteve nga zhvilluesi i projektit:

i) për vendimin për VNM-në paraprake dënohet me gjobë nga 65,000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë deri në 260,000 (dyqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë."
Në këto kushte, shkelja e konstatuar përbën kundërvajtje administrative të përcaktuar shprehimisht në legjislacionin e sipërcituar. Për rrjedhojë, vendosja e masës administrative *"paralajmërim"* ndaj subjektit rezulton e pajustifikuar dhe e paargumentuar nga pikëpamja ligjore, pasi bie ndesh me dispozitat e ligjit të posaçëm që parashikon detyrimisht sanksionin me gjobë për këtë lloj shkeljeje.
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: J. Sh, A. M.

4. Subjekti V. I. I me NIPT L.....J, Inspektimi me nr. AKM-LE-2022-000037, me objekt inspektimi: "*Urdhër nga Drejtori i Përgjithshëm nr. 25 datë 07.02.2022 "Për ngritjen e grupeve të punës për evidentimin e problematikave mjedisore të veprimtarive minerare me karrierë (guroret) në territor"*, Inspektorët: N. D, Sh. C.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit janë evidentuar mangësitë si në vijim: subjekti nuk ka vënë në dispozicion dokumentacionin që vërteton pagesën e tarifës vjetore për lejen e mjedisit për vitin 2021 dhe nuk ka paraqitur dokumentacion për pagesën e kësaj tarife për vitin 2022, ndërkohë që për këtë të fundit ndodhet ende brenda afatit të përcaktuar deri më 31 mars 2022, sipas VKM nr. 417, datë 25.06.2014. Gjithashtu, në lidhje me zbatimin e kushteve të lejes mjedisore, rezulton se subjekti nuk ka paraqitur planin e çmontimit dhe rehabilitimit të rishikuar për vitin e fundit, të miratuar pranë AKM-së, në kundërshtim me kushtin 14 *"Çmontimi, rehabilitimi dhe kontrolli pas ndërprerjes së operacioneve".* Nga procesverbali konstatohet se këto shkelje bien në kundërshtim me gërmën "b/(i)", të pikës 1, të nenit 29, të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 "*Për lejet e mjedisit"*, i ndryshuar, ku përcaktohet se: "*Mos përmbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipave A apo B nga operatori i një instalimi; për lejet e mjedisit të tipit B dënohet me gjobë*", si dhe me pikën 1, të nenit 48, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*", ku përcaktohet se: *"Kur konstatohet shkelje e kërkesave ligjore, që përbën kundërvajtje administrative, por që është e një rëndësie të vogël, apo për të cilën ligji i posaçëm nuk parashikon dënimin përkatës administrativ, subjekti i inspektimit dënohet me 'paralajmërim'. Paralajmërimi është dënim administrativ kryesor*". Në procesverbal janë vendosur dy dënime administrative kryesore "*Gjobë"* në vlerën 300,000 lekë, si dhe dënimi administrativ kryesor "*Paralajmërim",* ndërsa nga shqyrtimi i Vendimit Përfundimtar të Inspektimit konstatohet se këto masa nuk përputhen me procesverbalin, pasi dënimi administrativ "*Gjobë"* është hequr dhe është lënë vetëm masa *"Paralajmërim".*
Nga verifikimi i procesverbalit të inspektimit me nr. AKM-LE-2022-000037-2, datë 09.03.2022, konstatohet se paraqiten mangësi në plotësimin dhe pasqyrimin e komenteve mbi gjetjet e konstatuara gjatë inspektimit, në lidhje me zbatimin e pikës 1, të nenit 48, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, ku përcaktohet se: *"Kur konstatohet shkelje e kërkesave ligjore, që përbën kundërvajtje administrative, por që është e një rëndësie të vogël, apo për të cilën ligji i posaçëm nuk parashikon dënimin përkatës administrativ, subjekti i inspektimit dënohet me 'paralajmërim'."*
Megjithatë, nga përmbajtja e procesverbalit rezulton se trupa inspektuese nuk ka evidentuar dhe argumentuar shprehimisht karakterin e *"shkeljes së rëndësisë së vogël"* të konstatuar gjatë inspektimit, duke mos justifikuar në mënyrë të arsyetuar vendosjen e masës administrative *"paralajmërim"*.
Me shkresën nr. 2027 prot., datë 15.03.2022, subjekti ka dorëzuar në AKM planin e rehabilitimit. Nga auditimi i praktikës së administruar rezulton se dokumentacioni i depozituar nga subjekti është përgatitur dhe paraqitur pas konstatimit të shkeljeve nga ana e trupës inspektuese dhe, për

rrjedhojë, nuk mund të konsiderohet si element që përjashton apo zbut përgjegjësinë administrative për shkeljet e konstatuara gjatë inspektimit.
Gjithashtu, gërma "b/(ii)", e pikës 1, të nenit 29, të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 *"Për lejet e mjedisit, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: "Mos përmbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipit A, B apo C nga operatori i një instalimi; për lejet e mjedisit të tipit B dënohet me gjobë në vlerën nga 300,000 deri në 500,000 lekë."*
Kjo dispozitë ligjore është e qartë dhe nuk parashikon hapësirë diskrecioni për organin inspektues në lidhje me zëvendësimin e gjobës me një masë tjetër administrative. Për rrjedhojë, vendosja e masës administrative *"paralajmërim"* nga trupa inspektuese nuk është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, pasi shkeljet e konstatuara janë të parashikuara shprehimisht nga ligji si kundërvajtje administrative dhe duhet të ndëshkohen me masën administrative të gjobës, sipas intervalit të përcaktuar në ligj
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: N. D, Sh. C.

5. Subjekti C me NIPT L.....H, Inspektimi me nr. AKM-LE-2022-000008, me objekt inspektimi: "*Informacion/Indicio nga palët e treta*", Inspektorët: N. D, Sh. C.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit janë evidentuar mangësitë si në vijim: subjektit i është lënë detyrë që me fillimin e operacioneve të hartojë dhe dorëzojë raportin vjetor të mjedisit pranë AKM-së, ndërkohë që për një sërë kushtesh të lejes mjedisore (kushtet 10, 11, 12 dhe 13) nuk evidentohet asnjë e dhënë në listëverifikim, çka tregon paplotësi të dokumentimit të kontrollit. Gjithashtu, në lidhje me kushtin 14 "*Çmontimi, rehabilitimi dhe kontrolli pas ndërprerjes së operacioneve",* nuk rezulton informacion nëse subjekti ka paraqitur planin e çmontimit dhe rehabilitimit të rishikuar dhe të miratuar pranë AKM-së. Nga procesverbali konstatohet se, megjithëse subjekti ka pezulluar aktivitetin për shkak të kushteve atmosferike, janë lënë detyrime për përfundimin e rehabilitimit të shkallës së parë të karrierës dhe për njoftimin me shkrim të AKM-së mbi ecurinë e punimeve rehabilituese dhe ndërprerjen apo rifillimin e aktivitetit. Këto gjetje janë trajtuar në kuadër të nenit 48, pika 1 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "*Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë*", duke u konsideruar si shkelje me rëndësi të vogël, për të cilat është vendosur dënimi administrativ kryesor "*Paralajmërim".* Nga shqyrtimi i Vendimit Përfundimtar të Inspektimit konstatohet se gjetjet dhe masa administrative janë të njëjta me ato të procesverbalit, duke u vendosur ndaj subjektit dënimi kryesor "*Paralajmërim".*
Nga verifikimi i vendimit përfundimtar të inspektimit me nr. AKM-LE-2022-000008-5, datë 18.02.2022, rezulton se data e marrjes së këtij vendimi përkon me datën e mbajtjes së procesverbalit të inspektimit. Ligji nr. 10433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", në nenin 45, pika 4, përcakton se: *Procesverbali i inspektimit përmban, gjithashtu, informacion për të drejtën e subjektit të inspektimit që të paraqesë me shkrim apo me gojë shpjegimet apo kontestimet e tij për faktet dhe rrethanat e konstatuara në procesverbal, brenda një afati të përcaktuar nga inspektori, por jo më të shkurtër se 8 ditë nga data e njoftimit të procesverbalit, për paraqitjen e këtyre komenteve, si dhe organin ku paraqiten këto komente. Pas kalimit të këtij afati, vendimi përfundimtar mund të merret pa qenë i nevojshëm dëgjimi i mëtejshëm i subjektit të inspektimit. Shpjegimet apo kontestimet e subjektit të inspektimit janë pjesë e dosjes.* Në këto kushte, rezulton se subjektit të inspektimit nuk i është lënë hapësira ligjore për të paraqitur shpjegime apo kontestime ndaj procesverbalit të inspektimit, siç parashikohet shprehimisht nga dispozitat ligjore të sipërcituara, duke cenuar të drejtën e tij për t'u dëgjuar dhe për të ushtruar të drejtën e ankimit në fazën procedurale përkatëse.

- Nga auditimi i listës së verifikimit, procesverbalit të inspektimit dhe vendimit përfundimtar të inspektimit konstatohet se inspektimi i kryer ndaj subjektit nuk ka qenë i plotë, i argumentuar dhe i dokumentuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe kushtet e përcaktuara në lejen mjedisore.
- Sipas lejes së mjedisit me nr. identifikimi 2675, datë 16.08.2017, kushti 11, pika 11.3, përcakton detyrimin e operatorit për të raportuar çdo 6 muaj mbi ecurinë e punimeve rehabilituese. Ky detyrim lidhet drejtpërdrejt me gjetjet e konstatuara nga trupa inspektuese dhe përbën shkelje të kushteve të lejes mjedisore, e cila nuk mund të trajtohet si shkelje e një rëndësie të vogël.
- Gjithashtu, nga listëverifikimi t dhe procesverbali nuk evidentohet zbatimi i kushtit 12 të lejes mjedisore, lidhur me dokumentimin dhe raportimin, ku në pikën 12.2 përcaktohet detyrimi i subjektit për të mbajtur regjistër mbi sasinë e mbetjeve të gjeneruara, rikuperuara dhe magazinuara, si dhe për raportimin e këtyre të dhënave çdo 6 muaj pranë AKM-së. Mungesa e verifikimit dhe dokumentimit të këtij kushti tregon se inspektimi nuk ka qenë i plotë dhe nuk ka siguruar prova të mjaftueshme për të konfirmuar nivelin real të përputhshmërisë së subjektit me kushtet e lejes mjedisore.
- Po ashtu, kushti 14 i lejes mjedisore, pika 14.2, përcakton se planet për çmontim dhe rehabilitim duhet të rishikohen çdo vit dhe të paraqiten për miratim në AKM. Në këtë kontekst, vendosja e masës administrative *"paralajmërim",* pa u verifikuar dhe dokumentuar përmbushja e këtij detyrimi, krijon mospërputhje midis gjetjeve faktike, kushteve të lejes dhe masës administrative të aplikuar.

Neni 29, pika 1, shkronja "b", nënndarja "ii", të ligji nr. 10448, datë 14.07.2011, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se mos përmbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipit A, B apo C nga operatori i një instalimi përbën kundërvajtje administrative dhe, konkretisht, për lejet e mjedisit të tipit B, ndëshkohet me gjobë në vlerën nga 300,000 deri në 500,000 (treqind mijë deri në pesëqind mijë) lekë.

Kjo dispozitë ligjore është e qartë, e drejtpërdrejtë dhe nuk parashikon asnjë hapësirë diskrecioni për organin inspektues në lidhje me zëvendësimin e gjobës me një masë tjetër administrative. Për rrjedhojë, vendosja e masës administrative "paralajmërim" nga trupa inspektuese nuk është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, pasi shkeljet e konstatuara janë të parashikuara shprehimisht nga ligji si kundërvajtje administrative dhe duhet të ndëshkohen me masën administrative të gjobës, sipas intervalit të përcaktuar në ligj.

Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: N. D, Sh. C.

6. Subjekti R me NIPT L.....A, Inspektimi me nr. AKM-LE-2023-000177, me objekt isnpektimi: "*Inspektim mbi zbatueshmërinë e kushteve te VNM Paraprake"*, Inspektorët: N.D, K. U.

Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit janë evidentuar mangësitë si në vijim: nuk është plotësuar rubrika që lidhet me verifikimin e kryerjes së vetëmonitorimit dhe raportimit të tij pranë AKM-së gjatë fazës së zbatimit të projektit, duke sjellë një pasqyrim të paplotë të të dhënave dhe pamundësi për të evidentuar në mënyrë të qartë përmbushjen e këtij detyrimi nga subjekti. Nga procesverbali konstatohet se subjekti nuk i ka vënë në dispozicion trupës inspektuese raportet e vetëmonitorimit të dorëzuara në AKM, në kundërshtim me kërkesat e gërmës "b", të nenit 26 të ligjit nr. 128/2020 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10440,* datë 07.07.2011 'Për vlerësimin e ndikimit në mjedis', të ndryshuar", ku përcaktohet se "Mos përmbushja dhe mosrespektimi i kushteve të vendimit për VNM-në paraprake ose deklaratës mjedisore nga zhvilluesi i projektit". Për këto shkelje, në seksionin e kundërvajtjeve administrative është vendosur dënimi administrativ kryesor "*Paralajmërim".* Nga shqyrtimi i Vendimit Përfundimtar

të Inspektimit konstatohet se seksioni i gjetjeve dhe ai i kundërvajtjeve administrative është i njëjtë me atë të pasqyruar në procesverbalin e inspektimit dhe ndaj subjektit është vendosur dënimi administrativ kryesor *"Paralajmërim".*
Nga auditimi konstatohet se në VNM me nr. AN130420210010, datë 29.06.2021, pika 3.27 citon se subjekti duhet të sjellë pranë AKM-së si më poshtë:
- informacion në momentin e fillimit të punimeve;
- raportimin periodik për parametrat që do të monitorohen, sipas datës së raportimit/çdo 6 muaj.
- informacion në përfundim të punimeve, lidhur me punimet rehabilituese të territorit përreth, shoqëruar edhe me foto.
Për sa më sipër, bazuar në ligjin nr. 10440/2011 *"Për vlerësimin e ndikimit në mjedis",* i ndryshuar, neni 25/1 *"Monitorimi dhe vlefshmëria"*, pikat 1, 2 dhe 3, përcakton se:
1. AKM-ja përcakton llojin e parametrave që monitorohen dhe kohëzgjatjen e monitorimit, në raport me natyrën, vendndodhjen dhe madhësinë e projektit, si dhe me ndikimet e rëndësishme të tij në mjedis, të cilat parashikohen në vendimin për VNM-në paraprake apo në deklaratën mjedisore.
2. Zhvilluesi, gjatë fazës së zbatimit të projektit, kryen vetë monitorimin e ndikimeve të rëndësishme të projektit në mjedis dhe i raporton AKM-së për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit.
3. Struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e mjedisit inspekton ndikimet në mjedis nga zbatimi i projektit, si dhe kushtet e monitorimit të përcaktuara në vendimin për VNM-në paraprake apo në deklaratën mjedisore.
Nga auditimi konstatohet se, pavarësisht mos përmbushjes së detyrimeve për informim dhe raportim periodik pranë AKM-së, ndaj subjektit nuk është aplikuar dënimi administrativ me gjobë, në kundërshtim me gërmën "b/(i)", e pikës 1, të nenit 26, të ligjit nr. 10440/2011 *"Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"*, i ndryshuar, i cili përcakton se: *Shkeljet e këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:*
b) mos përmbushja dhe mosrespektimi i kushteve nga zhvilluesi i projektit:
i) për vendimin për VNM-në paraprake dënohet me gjobë nga 65 000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë deri në 260 000 (dyqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë.
Në këto kushte, shkelja e konstatuar përbën kundërvajtje administrative të përcaktuar shprehimisht në legjislacionin e sipërcituar. Për rrjedhojë, vendosja e masës administrative *"paralajmërim"* ndaj subjektit rezulton e pajustifikuar dhe e paargumentuar nga pikëpamja ligjore, pasi bie ndesh me dispozitat e ligjit të posaçëm, i cili parashikon shprehimisht aplikimin e sanksionit me gjobë për këtë lloj shkeljeje.
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: N. D, K. U.

7. Subjekti E me NIPT J.....Ŵ, Inspektimi me nr. AKM-LE-2023-000173, me objekt onspektimi:"*Inspektim mbi zbatueshmërinë e kushteve të Vendimit për VNM paraprake me nr. AN080120210001, datë 23.02.2021 për projektin " Stabilizimi i rrëshqitjeve në segmentin rrugor Milot-Rrëshen, rruga e vjetër"*, Inspektorët: J.Sh, A.M, K.H.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit janë evidentuar mangësitë si në vijim: subjekti nuk i ka vënë në dispozicion trupës inspektuese asnjë dokumentacion justifikues që vërteton respektimin e kushteve të Vendimit për VNM Paraprake, pavarësisht njoftimit paraprak me shkresë nr. 1026 prot., datë 24.11.2023, duke pamundësuar verifikimin e kryerjes së vetëmonitorimit, raportimit pranë AKM-së dhe zbatimit të kushteve të vendimit për VNM. Gjithashtu, nuk ka qenë e mundur të konstatohet nëse zhvilluesi ka informuar AKM-në për mundësinë e një kërcënimi të drejtpërdrejtë për mjedisin dhe nëse janë marrë masat parandaluese përkatëse. Nga procesverbali konstatohet se këto shkelje bien në kundërshtim me nenin 69 të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 *"Për mbrojtjen e mjedisit",* pika "e", ku parashikohet detyrimi për informimin e AKM-së dhe respektimin e kushteve mjedisore, ndërsa subjekti nuk ka paraqitur asnjë

dokument justifikues mbi zbatueshmërinë e tyre. Për këto shkelje, në seksionin e kundërvajtjeve administrative janë vendosur dy dënime administrative kryesore "Gjobë" në vlerën 1,000,000 lekë, si dhe dënimi administrativ kryesor "*Paralajmërim".* Nga shqyrtimi i Vendimit Përfundimtar të Inspektimit konstatohet se këto masa nuk përputhen me procesverbalin, pasi dënimi administrativ "*Gjobë*" është hequr dhe ndaj subjektit është vendosur vetëm dënimi kryesor "*Paralajmërim*".

Nga auditimi i listës së verifikimit, procesverbalit të inspektimit, vendimit përfundimtar të inspektimit dhe dokumentacionit të administruar në praktikë, grupi i auditimit vlerëson se vendimmarrja administrative e marrë ndaj subjektit nuk është e argumentuar në mënyrë të plotë dhe nuk përputhet me kërkesat e legjislacionit të posaçëm për mbrojtjen e mjedisit.

Me shkresën nr. 1026/2 prot., datë 19.12.2023, subjekti ka paraqitur kontestimet e tij lidhur me gjetjet e pasqyruara në procesverbalin e inspektimit nr. AKM-LE-2023-000173-2, datë 05.12.2023. Nga auditimi i praktikës rezulton se dokumentacioni i depozituar nga subjekti është paraqitur pas konstatimit të shkeljeve nga ana e trupës inspektuese dhe, për rrjedhojë, nuk mund të konsiderohet si element që përjashton apo zbut përgjegjësinë administrative për shkeljet e konstatuara gjatë inspektimit. Grupi i auditimit vlerëson se heqja e dënimit administrativ "*Gjobë*" në vlerën 1,000,000 lekë, të vendosur në procesverbalin e inspektimit për shkelje të nenit 69, pika e), të ligjit nr. 10431/2011, nuk është e argumentuar ligjërisht dhe nuk mbështetet në dokumentacion faktik të administruar në dosje. Nga praktika e inspektimit rezulton se subjekti nuk ka raportuar pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit sipas kushteve të Vendimit për VNM Paraprake dhe nuk ka vënë në dispozicion dokumentacion që të vërtetojë njoftimin e AKM-së për rrezikun e mundshëm të një dëmi në mjedis. Këto fakte përmbushin elementët e kundërvajtjes administrative të parashikuar në nenin 69, pika e), të këtij ligji, në lidhje me nenin 50, pika 6.

Ligji i posaçëm për mbrojtjen e mjedisit parashikon shprehimisht sanksionin me gjobë nga 1,000,000 lekë deri në 2,000,000 lekë për këtë lloj shkeljeje dhe nuk parashikon mundësinë e zëvendësimit të saj me masën administrative *"paralajmërim".* Për rrjedhojë, trajtimi i shkeljes si shkelje e një rëndësie të vogël dhe aplikimi i vetëm masës *"paralajmërim"* nuk gjen mbështetje në legjislacionin në fuqi.

Gjithashtu, nga auditimi rezulton se trupa inspektuese nuk ka marrë në konsideratë dhe nuk ka zbatuar dispozitat përkatëse të ligjit nr. 10440/2011, konkretisht nenin 25/1 dhe nenin 26, të cilat parashikojnë detyrimet për vetë monitorim, raportim pranë AKM-së dhe sanksionimin me gjobë në rast të mos përmbushjes së këtyre detyrimeve.

Në këto kushte, grupi i auditimit konstaton vendimi përfundimtar i inspektimit nuk përmban arsyetim ligjor dhe faktik të mjaftueshëm mbi arsyet e moszbatimit të dispozitave të sipërcituara dhe mbi heqjen e masës administrative me gjobë. Për rrjedhojë, vendosja e masës administrative *"paralajmërim"* ndaj subjektit është e pajustifikuar dhe e paargumentuar nga pikëpamja ligjore, pasi bie ndesh me dispozitat e ligjit të posaçëm që parashikon detyrimisht sanksionin me gjobë për këtë lloj shkeljeje.

Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: J. Sh, A. M, K. H.

8. Subjekti: L.C me NIPT L.....C, Inspektimi me nr. AKM-LE-2025-000035, me objekt inspketimi: *Inspektim mbi zbatueshmërinë e kushteve te lejes mjedisore me PN-1528-11-202,* Inspektorët: J. Sh, K. H dhe N. D.

Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit janë evidentuar mangësitë si në vijim: është konstatuar pengim i inspektimit për shkak të mos caktimit të një përfaqësuesi nga ana e subjektit gjatë inspektimit në terren, pavarësisht njoftimit zyrtar, në kundërshtim me nenin 36 dhe i sanksionueshëm sipas nenit 54 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, "*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar. Nga procesverbali konstatohet se këto shkelje bien në kundërshtim me nenin 36 "*Detyrimet e subjektit të inspektimit*" dhe nenin 54 "*Kundërvajtjet administrative*", pika

a) dhe b), të po këtij ligji, pasi subjekti "*L. C*", për lejen mjedisore me PN-1528-11-2022, nuk ka caktuar apo autorizuar asnjë përfaqësues për komunikim me trupën inspektuese dhe nuk ka bashkëpunuar gjatë inspektimit, duke e bërë të pamundur kryerjen e veprimeve inspektuese dhe verifikimin e zbatueshmërisë së kushteve të lejes mjedisore. Për këto shkelje, në seksionin e kundërvajtjeve administrative është vendosur dënimi administrativ kryesor "*Paralajmërim".*
Nga auditimi i dokumentacionit të inspektimit konstatohet se ndaj subjektit është vendosur vetëm masa administrative kryesore *"Paralajmërim",* pa u argumentuar në mënyrë të arsyetuar pse shkeljet e konstatuara janë konsideruar si shkelje të një rëndësie të vogël, sipas parashikimeve të nenit 48 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, i ndryshuar.
Për më tepër, në vendimin e inspektimit dhe në procesverbal është referuar neni 54 i ligjit nr. 10433, i cili përcakton se: "*Prishja e shenjave dalluese të ndalimit të veprimtarisë apo bllokimit të pajisjeve a instalimeve, si dhe çdo shenjë tjetër, të vendosura nga inspektorët, si dhe pengimi i inspektimit, nëse nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë në vlerën nga 10,000 deri në 100,000 lekë*."
Sa më sipër, konstatohet se masa administrative e vendosur nuk është në përputhje me dispozitën ligjore të përcaktuar në procesverbal dhe në Vendimin Përfundimtar të inspektimit, pasi ligji parashikon shprehimisht masën e gjobës dhe jo paralajmërimin për këtë lloj shkeljeje.
Në këto kushte, grupi i auditimit vlerëson se vendosja e masës *"Paralajmërim"* është e paargumentuar dhe në mospërputhje me shkeljen konkrete të evidentuar gjatë inspektimit dhe me kërkesat e ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, i ndryshuar
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: J. Sh, K.H dhe R. D.

9. Subjekti: L.C me NIPT L.....C (çështja 034), me objekt inspektimi: "*Inspektim mbi zbatueshmërinë e kushteve te lejes mjedisore me PN-1528-11-202."*, Inspektorët: A. L, K. U dhe B. L.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit janë evidentuar mangësitë si në vijim: subjekti nuk ka njoftuar AKM-në dhe ARM Lezhë për mos ushtrimin e aktivitetit në adresën për të cilën disponon Leje Mjedisore aktive të tipit B, pavarësisht se në terren është konstatuar mungesa e aktivitetit dhe e instalimeve, në kundërshtim me detyrimet ligjore për informimin e autoritetit kompetent mbi ndryshimin e gjendjes faktike të ushtrimit të aktivitetit. Nga procesverbali konstatohet se subjekti nuk ka sqaruar nëse ka kryer njoftimin përkatës pranë AKM/ARM për pezullimin e përkohshëm apo të përhershëm të aktivitetit, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 108/2024, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011, "*Për lejet e mjedisit*", i ndryshuar, konkretisht neni 29, pika 1, shkronja b). Nga shqyrtimi i Vendimit Përfundimtar të Inspektimit konstatohet se gjetja nuk është formuluar në mënyrë eksplicite, por është dhënë vetëm referenca ligjore përkatëse, ndërsa në seksionin e kundërvajtjeve administrative është vendosur dënimi administrativ kryesor "*Paralajmërim*" dhe është lënë detyrimi që subjekti të njoftojë AKM/ARM për mos ushtrim të përkohshëm apo të përhershëm të aktivitetit.
Nga auditimi i dokumentacionit të inspektimit konstatohet se ndaj subjektit është vendosur vetëm dënimi administrativ kryesor *"Paralajmërim"*, pa u argumentuar në mënyrë të arsyetuar pse shkeljet e konstatuara janë konsideruar si shkelje të një rëndësie të vogël, sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 48, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar.
Nga verifikimi i kushteve të Lejes Mjedisore të tipit B nr. 4311, datë 22.11.2022, rezulton se:
- Kushti 6.2 parashikon se operatori duhet të njoftojë me shkrim autoritetin kompetent, sa më shpejt të jetë e mundur, në rastet e:

6.2.1. ndërprerjes së përhershme të operimit të ndonjë pjese ose të gjithë instalimit për të cilin është dhënë leja;
6.2.2. ndërprerjes së operimit të ndonjë pjese ose të gjithë instalimit për një periudhë që ka gjasa të tejkalojë një vit. Gjithashtu, kushti 6.3 i lejes përcakton se operatori duhet të njoftojë me shkrim autoritetin kompetent brenda 5 ditëve nga ndodhja e ngjarjes, ndër të tjera, për:
6.3.1. çdo ndryshim të emrit tregtar, emrit të regjistruar ose adresës së zyrave të regjistruara, në përputhje me të dhënat e regjistruara në Ekstraktin e Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB). Sa më sipër, mosnjoftimi i AKM-së dhe ARM-së për mosushtrimin e aktivitetit dhe për ndryshimin e gjendjes faktike të ushtrimit të aktivitetit përbën shkelje të kushteve të Lejes Mjedisore.
Sipas gërmës "b/(ii)", të pikës 1, të nenit 29, të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011, *"Për lejet e mjedisit"*, i ndryshuar me ligjin nr. 108/2024, përcaktohet se: *"Mos përmbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipit B dënohet me gjobë në vlerën nga 300,000 deri në 500,000 lekë."*
Në këto kushte, rezulton se ndaj subjektit duhej të ishte aplikuar masa administrative *"Gjobë"* në vlerën nga 300,000 deri në 500,000 lekë dhe jo masa *"Paralajmërim"*.
Për më tepër, konstatohet se brenda vitit 2025 ndaj subjektit janë vendosur dy masa administrative *"Paralajmërim"*, pa arritur përmirësim të situatës apo përmbushje të detyrimeve ligjore, pasi subjekti vijon të jetë pothuajse në të njëjtat kushte. Kjo tregon se masa e aplikuar rezulton joefektive dhe jo parandaluese, duke cenuar parimin e proporcionalitetit dhe qëllimin përmirësues të masave administrative.
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: Al. L, K. U dhe B. L.

10. Subjekti: R. 2002 me NIPT K.....Q, Inspektimi me nr. AKM-LE-2021-000156, me objekt inspektimi: "*Inspektim mbi zbatueshmërinë e kushteve të lejes mjedisore"*, Inspektorët: J.Sh, K. H dhe R. D.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit janë evidentuar mangësitë si në vijim: megjithëse nga lista e verifikimit nuk janë konstatuar problematika, nga procesverbali rezulton se subjekti nuk ka realizuar rishikimin e kushteve të Lejes Mjedisore të tipit B, me ID 1468, nr. 343/22 prot., viti 2013, në kundërshtim me nenin 4, pika 3 të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar, si dhe VKM nr. 419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave për shqyrtimin e lejeve të mjedisit". Në procesverbal, si bazë për vendosjen e masës administrative është referuar pika 1 e nenit 48 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 *"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë*", duke u vendosur dënimi administrativ kryesor "*Paralajmërim*". Gjithashtu, është lënë detyrimi që subjekti të realizojë rishikimin e kushteve të lejes mjedisore në përputhje me kuadrin ligjor përkatës. Nga shqyrtimi i Vendimit Përfundimtar të Inspektimit konstatohet se gjetjet dhe masat administrative janë të njëjta me ato të pasqyruara në procesverbalin e inspektimit, çka evidenton mospërputhje ndërmjet listëverifikimit dhe procesverbalit lidhur me evidentimin e shkeljeve.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistem rezulton se dokumenti i pagesës është i datës 13.09.2021, pra jashtë afatit të përcaktuar në Lejen Mjedisore të tipit B nr. PN-5513-07-2017, datë 21.07.2017. Në kundërshtim me Vendimin nr. 417, datë 25.06.2014, "*Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit*", tarifa përkatëse duhet të paguhet brenda tremujorit të parë të vitit.
Për rrjedhojë, pagesa e kryer në datën 13.09.2021 rezulton jashtë afatit të përcaktuar dhe nuk përputhet me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi, duke qenë në mospërputhje edhe me përgjigjet e pasqyruara në listën e verifikimit.
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: Sh. C, E. Gj, I. D.

11. Subjekti K. K me NIPT L.....V, Inspektimi me nr. AKM-LE-2021-000125, me objekt inspektimi:*"Informacion/Indicio nga palët e treta"*, Inspektorët: Sh. C, E. Gj, I. D.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit janë evidentuar mangësitë si në vijim: në momentin e inspektimit është konstatuar mungesa e një personi të autorizuar për përfaqësimin e subjektit dhe për vënien në dispozicion të dokumentacionit mjedisor, si dhe prania në vendndodhje e një impianti për fraksionim inertesh/prodhim të produkteve abrazive, ndërkohë që nga verifikimi në faqen zyrtare të QKB rezulton se subjekti nuk është i pajisur me Leje Mjedisore të Tipit B për këtë aktivitet, në kundërshtim me pikën 3.10 të Shtojcës 1 të ligjit nr. 52/2020, që ndryshon ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 "*Për lejet e mjedisit",* i ndryshuar. Nga procesverbali konstatohet e njëjta gjetje, konkretisht ushtrimi i aktivitetit "*Prodhim i produkteve abrazive*" pa leje mjedisore të tipit B. Për këto shkelje, në seksionin e kundërvajtjeve administrative, referuar pikës 1/a, ii të nenit 29 të ligjit nr. 10448/2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar, është vendosur dënimi administrativ kryesor "Gjobë" në shumën 500,000 lekë, si dhe dënimi administrativ plotësues "*Pezullimi i aktivitetit të impiantit të fraksionimit deri në momentin e pajisjes me leje mjedisore përkatëse të tipit B*". Nga shqyrtimi i Vendimit Përfundimtar të Inspektimit nr. AKM-LE-2021-000125–5, datë 11.08.2021, konstatohet se gjetjet dhe masat administrative janë të njëjta me ato të përcaktuara në procesverbalin e inspektimit.
Nga auditimi konstatohet se nga ARM Lezhë nuk është planifikuar dhe nuk është kryer ri-inspektim në terren për të verifikuar nëse subjekti ka korrigjuar shkeljet e konstatuara gjatë inspektimit të mëparshëm. Si pasojë, nuk është ndjekur zbatimi i masave administrative të vendosura, duke dobësuar efektivitetin e procesit inspektues. Ky konstatim është verifikuar edhe në portalin *e-Inspektime*, sipas të dhënave si më poshtë:

Nipt	Numri i Cështjes	Data e hapjes së çështjes	Data e mbylljes së çështjes
L********V	AKM-LE-2021-000125	29/07/2021	11/08/2021

Gjithashtu, grupi i auditimit verifikoi në Regjistrin Kombëtar të Licencave, nga ku u evidentua se aktualisht subjekti nuk është pajisur ende me leje mjedisore të tipit B.

Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: Sh. C, E. Gj dhe I. D.

12. Subjekti E. C &E – M I. me NIPT L.....J, Inspektimit nr. AKM-LE-2022-000053, me objekt inspektimi: "*Inspektim mbi trajtimin e shkresës "Delegim për kompetencë", me nr.1654/3, prot., datë 24.03.2022, përcjellë nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, shkresë e cila trajton problematiken e ngritur nga banorët e fshatit Mjekërbardhë, Tropojë, Informacion/Indicio nga palët e treta."*, Inspektorët: N. D, Sh. C.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit janë evidentuar mangësitë si në vijim: subjekti nuk ka paguar tarifën vjetore të lejes mjedisore për vitet 2020–2021 dhe ushtron aktivitetin në kundërshtim me kushtin 1 të lejes mjedisore, duke operuar jashtë koordinatave të përcaktuara, çka sjell rrezik për burimin e ujit të pijshëm në zonë. Gjithashtu, subjekti nuk ka zbatuar kushtet kryesore të lejes mjedisore, përfshirë mungesën e raportimit, monitorimit, menaxhimit të mbetjeve, dokumentimit dhe planifikimit të rehabilitimit. Nga procesverbali konstatohet se subjekti nuk ka zbatuar asnjë nga kushtet e lejes mjedisore të tipit B me nr. ID 2952, datë 29.03.2019, me PN-8344-04-2019. Për këto shkelje, në mbështetje të nenit 29 të ligjit nr. 10448/2011, i ndryshuar, është vendosur dënimi administrativ kryesor "*Gjobë"* në vlerën 500,000 lekë dhe dënimi administrativ plotësues "*Pezullimi i plotë i aktivitetit deri në rikthimin e mjedisit në gjendjen e mëparshme".* Nga shqyrtimi i Vendimit Përfundimtar të Inspektimit konstatohet se masat administrative janë të njëjta me ato të procesverbalit.

Në lidhje me problematikat e konstatuara gjatë inspektimit, përveç shkeljeve të kushteve të lejes mjedisore në kundërshtim me nenin 29, pika 1/b të legjislacionit në fuqi, janë evidentuar edhe shkelje që përbëjnë pjesë të ligjeve të posaçme.
Konkretisht, në lidhje me kushtin 8 të lejes mjedisore, subjekti nuk ka zbatuar detyrimet e përcaktuara, pasi:
- nuk ka mbajtur regjistër për sasinë e mbetjeve të gjeneruara;
- nuk ka hartuar dhe zbatuar planin e menaxhimit të mbetjeve;
- nuk ka dorëzuar planin e menaxhimit të mbetjeve pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit brenda afatit prej 6 muajsh nga marrja e lejes mjedisore.
Nga verifikimet e kryera, grupi i auditimit konstaton se mos raportimi pranë AKM-së për regjistrin e mbetjeve spitalore është në kundërshtim me pikën 6 të nenit 55 të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 *"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve",* ku përcaktohet se: *"Personat fizikë dhe juridikë, të përmendur në pikën 1 të këtij neni, vënë në dispozicion të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Inspektoratit për Mjedisin ose zotëruesit të mëparshëm të mbetjes, në bazë të kërkesës së tyre me shkrim, evidenca të dokumentuara që tregojnë se operacionet e menaxhimit janë kryer".*
Në lidhje me këtë shkelje, pika 33 e nenit 62 *"Kundërvajtjet dhe sanksionet"* e të njëjtit ligj përcakton se: *"Çdo person që angazhohet me mbetjet spitalore jo në përputhje me nenin 35 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1,000,000 (një milion) deri në 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë".*
Në këto kushte, grupi i auditimit gjykon se ndaj subjektit duhej të ishte aplikuar masa administrative përkatëse si kundërvajtje, bazuar në ligjin specifik nr. 10463, datë 22.09.2011 *"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve",* dhe jo trajtimi i kësaj shkeljeje thjesht si mosrespektim i një prej kushteve të lejes mjedisore, duke qenë se subjekti ka qenë nuk ka respektuar asnjë prej kushteve të lejes mjedisore.
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: N.D, Sh. C.

13. Subjekti G me NIPT J.....J, Inspektimi nr. AKM-LE-2023-000209, Inspektorët: Sh. C, A. L, Sh. F.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit janë evidentuar mangësitë si në vijim: subjekti nuk ka kryer vetëmonitorimin e ndikimeve në mjedis dhe nuk ka raportuar pranë AKM-së për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit, si dhe nuk ka zbatuar kushtet e përcaktuara në Vendimin për VNM Paraprake, konkretisht nuk është realizuar monitorimi dhe raportimi periodik sipas pikës 3.29 të kushtit 3, nuk janë kryer monitorimet e zhurmave, vibracioneve dhe shkarkimeve në ajër, si dhe nuk është dërguar informacion në AKM në momentin e fillimit të punimeve. Nga procesverbali konstatohet se këto shkelje bien në kundërshtim me nenin 26 të ligjit nr. 128/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10440, datë 07.07.2011 'Për vlerësimin e ndikimit në mjedis', të ndryshuar", pika b), i), duke evidentuar mos përmbushjen e kushteve të vendimit për VNM Paraprake me nr. AN251020210003, datë 16.11.2021. Për këto shkelje, në seksionin e kundërvajtjeve administrative është vendosur dënimi administrativ kryesor "*Gjobë"* në vlerën 50,000 lekë, pa parashikuar dënim plotësues apo masa korrigjuese. Nga shqyrtimi i Vendimit Përfundimtar të Inspektimit konstatohet se gjetjet dhe masa administrative janë të njëjta me ato të procesverbalit, duke u vendosur ndaj subjektit dënimi kryesor "*Gjobë"* në vlerën 50,000 lekë.
Nga auditimi konstatohet se në vendimin përfundimtar të inspektimit nuk janë përcaktuar masa për korrigjimin e shkeljeve të konstatuara dhe nuk janë vendosur detyrime konkrete për subjektin për përmbushjen e kushteve të Vendimit për VNM Paraprake. Në këto kushte, grupi i auditimit konstaton se trajtimi administrativ i shkeljeve nga ana e trupës inspektuese nuk është i plotë, pasi, megjithëse është vendosur masa administrative *"Gjobë"*, nuk janë përcaktuar masa konkrete për

korrigjimin e shkeljeve të konstatuara dhe për sigurimin e zbatimit të kushteve të Vendimit për VNM Paraprake, duke dobësuar efektivitetin e procesit inspektues dhe ndjekjen e përmbushjes së detyrimeve ligjore nga ana e subjektit.

14. Subjekti: K. K. me NIPT M.....R, Inspektimi nr. AKM-LE-2023-000188, me objekt isnpektimi: "*Inspektim mbi zbatueshmërinë e kushteve të Vendim për VNM Paraprake me nr. AN200820210001*", Inspektorët: N. D, K. U.

Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit janë evidentuar mangësitë si në vijim: nuk është plotësuar rubrika që lidhet me verifikimin e kryerjes së vetëmonitorimit të ndikimeve në mjedis gjatë fazës së zbatimit të projektit dhe raportimit të tyre pranë AKM-së, duke sjellë një pasqyrim të paplotë të të dhënave në listëverifikim dhe pamundësi për të vlerësuar përmbushjen e këtij detyrimi nga subjekti. Nga procesverbali konstatohet se subjekti nuk i ka vënë në dispozicion trupës inspektuese raportet e vetëmonitorimit të dorëzuara në AKM, në kundërshtim me kërkesat e nenit 26 të ligjit nr. 128/2020 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10440, datë 07.07.2011 'Për vlerësimin e ndikimit në mjedis', të ndryshuar*", pika b), që parashikon mos përmbushjen dhe mosrespektimin e kushteve të vendimit për VNM-në paraprake ose deklaratës mjedisore nga zhvilluesi i projektit. Për këto shkelje, në seksionin e kundërvajtjeve administrative është vendosur dënimi administrativ kryesor "*Paralajmërim".* Nga shqyrtimi i Vendimit Përfundimtar të Inspektimit konstatohet se gjetjet dhe masa administrative janë të njëjta me ato të procesverbalit, duke u vendosur ndaj subjektit dënimi kryesor *"Paralajmërim".*

Nga auditimi konstatohet se në Vendimin për VNM Paraprake me nr. AN200820210001, datë 23.11.2021, pika 3.27 përcakton detyrimin e subjektit për të dorëzuar pranë AKM-së informacionin në momentin e fillimit të punimeve, raportimin periodik çdo 6 muaj për parametrat e monitorimit, si dhe informacionin në përfundim të punimeve, të shoqëruar me dokumentacion përkatës. Në zbatim të ligjit nr. 10440/2011 *"Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"*, i ndryshuar, neni 25/1 "*Monitorimi dhe vlefshmëria",* pikat 1, 2 dhe 3, përcakton se:

1. AKM-ja përcakton llojin e parametrave që monitorohen dhe kohëzgjatjen e monitorimit, në raport me natyrën, vendndodhjen dhe madhësinë e projektit, si dhe me ndikimet e rëndësishme të tij në mjedis, të cilat parashikohen në vendimin për VNM-në paraprake apo në deklaratën mjedisore.

2. Zhvilluesi, gjatë fazës së zbatimit të projektit, kryen vetë monitorimin e ndikimeve të rëndësishme të projektit në mjedis dhe i raporton AKM-së për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit.

3. Struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e mjedisit inspekton ndikimet në mjedis nga zbatimi i projektit, si dhe kushtet e monitorimit të përcaktuara në vendimin për VNM-në paraprake apo në deklaratën mjedisore. Nga auditimi konstatohet se, pavarësisht mos përmbushjes së detyrimeve për informim dhe raportim periodik pranë AKM-së, ndaj subjektit nuk është aplikuar dënimi administrativ me gjobë, në kundërshtim me pikën nenin 26 *"Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet"*, pikën 1/b(i), të ligjit nr. 10440/2011, i cili përcakton se: "*Shkeljet e këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë: b) mos përmbushja dhe mosrespektimi i kushteve nga zhvilluesi i projektit: i) për vendimin për VNM-në paraprake dënohet me gjobë nga 65,000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë deri në 260,000 (dyqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë".*

Në këto kushte, shkelja e konstatuar ka kundërvajtje të përcaktuar shprehimisht në legjislacionin e sipërcituar. Për rrjedhojë, vendosja e masës administrative "*paralajmërim*" ndaj subjektit është e pajustifikuar dhe e paargumentuar nga pikëpamja ligjore, pasi bie ndesh me dispozitat e ligjit të posaçëm që parashikon detyrimisht sanksionin me gjobë për këtë lloj shkeljeje.

Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: N. D, K. U.

15. Subjekti K. C me NIPT L.....R, Inspektimit nr. AKM-LE-2023-000187, me objekt isnpektimi: "*Inspektim mbi zbatueshmërinë e kushteve të Vendim për VNM Paraprake me AN011020210001*", Inspektorët: N. D, K. U, Sh. F.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit janë evidentuar mangësitë si në vijim: subjekti nuk i ka vënë në dispozicion trupës inspektuese dokumentacion mbi raportimin pranë AKM-së për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit dhe zbatimin e kushteve të Vendimit për VNM Paraprake, duke pamundësuar verifikimin e përmbushjes së këtyre detyrimeve. Nga procesverbali konstatohet se subjekti nuk ka paraqitur raportet e vetëmonitorimit dhe as dokumentacion mbi masat e ndërmarra për parandalimin e dëmit në mjedis, në kundërshtim me nenin 26 të ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 "*Për vlerësimin e ndikimit në mjedis*", të ndryshuar, dhe nenin 69 të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 "*Për mbrojtjen e mjedisit*", të ndryshuar. Për këto shkelje, në procesverbal janë parashikuar dënimi administrativ kryesor "*Paralajmërim"* si dhe *"Gjobë*" në vlerën 1,000,000 lekë. Nga shqyrtimi i Vendimit Përfundimtar të Inspektimit konstatohet se masat administrative nuk përputhen me procesverbalin, pasi dënimi me gjobë është hequr dhe ndaj subjektit është vendosur vetëm dënimi administrativ kryesor "*Paralajmërim".*
Nga auditimi i dokumentacionit të praktikës së inspektimit, përkatësisht listëverifikimit, procesverbalit të inspektimit dhe vendimit përfundimtar të inspektimit, konstatohet mospërputhje thelbësore ndërmjet gjetjeve të konstatuara nga trupa inspektuese dhe masës administrative të vendosur në vendimin përfundimtar. Konkretisht, ndonëse në procesverbalin e inspektimit shkeljet e konstatuara janë kualifikuar si kundërvajtje administrative në mbështetje të ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011, *"Për vlerësimin e ndikimit në mjedis",* të ndryshuar, neni 26, si dhe ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011, *"Për mbrojtjen e mjedisit*", të ndryshuar, neni 69, duke parashikuar si dënim administrativ kryesor gjobën në vlerën 1,000,000 (një milion) lekë, në vendimin përfundimtar të inspektimit kjo masë është hequr dhe ndaj subjektit është vendosur vetëm masa administrative *"Paralajmërim",* pa asnjë argumentim ligjor apo faktik. Grupi i auditimit vlerëson se heqja e dënimit administrativ kryesor *"Gjobë"* në vlerën 1,000,000 lekë është e paargumentuar dhe e pajustifikuar, pasi bie në kundërshtim me dispozitat e shprehura të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011*"Për mbrojtjen e mjedisit",* të ndryshuar, neni 69, pika ë, e cila parashikon shprehimisht se: *"ë) mos informimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit nga operatori se me gjithë masat e marra në përputhje me përcaktimin e bërë në pikën 6 të nenit 50 të këtij ligji, kërcënimi i drejtpërdrejtë i dëmit në mjedis nuk është shmangur, sipas përcaktimit të bërë në pikën 7 të nenit 50 të këtij ligji, pavarësisht nga detyrimi i tij për të siguruar paraprakisht fondet për kompensimin e një dëmi të mundshëm ndaj mjedisit apo për eliminimin e një kërcënimi të pashmangshëm për dëme në mjedis, sipas përcaktimit të nenit 53 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 lekë deri në 2 000 000 lekë."* Po ashtu, neni 50, pikat 6 dhe 7 të ligjit nr. 10431/2011, përcakton qartë përgjegjësitë e operatorit për marrjen e masave parandaluese dhe detyrimin për informimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit në rast rreziku të drejtpërdrejtë për dëme në mjedis.
Fakti që kjo shkelje është konstatuar dhe dokumentuar nga trupa inspektuese në listë verifikim dhe procesverbal inspektimi, nuk mund të zhbëhet në vendimin përfundimtar pa një analizë të arsyetuar ligjore dhe faktike. Gjithashtu, nga shqyrtimi i kontestimeve të paraqitura nga subjekti me shkresën nr. 26/2 prot., datë 26.01.2024, rezulton se subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion provues mbi përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga vendimi për VNM-në, por vetëm një marrëveshje me një subjekt privat për depozitimin e një sasie rëre, e cila nuk përbën provë për përmbushjen e detyrimeve ligjore për informim dhe raportim pranë AKM-së. Në këto kushte, edhe në rast se trupa inspektuese do të kishte vlerësuar pranimin e kontestimeve të subjektit, rezulton se nuk janë

zbatuar dispozitat e ligjit nr. 10440/2011*"Për vlerësimin e ndikimit në mjedis",* i ndryshuar, neni 25/1 *"Monitorimi dhe vlefshmëria",* pikat 1, 2 dhe 3, të cilat përcaktojnë detyrimet për monitorim, vetë monitorim dhe raportim periodik pranë AKM-së, si dhe kompetencën e strukturës inspektuese për kontrollin e zbatimit të këtyre detyrimeve.
Nga auditimi gjithashtu, konstatohet se, pavarësisht mos përmbushjes së detyrimeve për informim dhe raportim periodik pranë AKM-së, ndaj subjektit nuk është aplikuar dënimi administrativ me gjobë, në kundërshtim me nenin 26 *"Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet",* pika 1, shkronja b, nënshkronja i, të ligjit nr. 10440/2011, i cili parashikon shprehimisht sanksionin me gjobë për mos përmbushjen dhe mosrespektimin e kushteve të vendimit për VNM-në paraprake.
Për rrjedhojë, grupi i auditimit vlerëson se vendosja e masës administrative *"Paralajmërim"* ndaj subjektit është e pajustifikuar dhe e paargumentuar nga pikëpamja ligjore, pasi bie në kundërshtim me dispozitat e ligjit të posaçëm, i cili parashikon detyrimisht aplikimin e sanksionit administrativ me gjobë për shkeljet e konstatuara.
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: N. D, K. U, Sh. F.

Nga auditimi i kryer u konstatua se rastet nr. 13, 14 dhe 15, ndonëse paraqesin të njëjtat kushte dhe të njëjtën natyrë shkeljesh nga ana e trupës inspektuese, janë trajtuar në mënyrë të ndryshme. Ky trajtim i pabarabartë tregon qartë përdorimin e një standardi të dyfishtë në qëndrimin dhe vendimmarrjen e mbajtur, duke cenuar parimin e barazisë dhe të trajtimit të njëjtë të rasteve të ngjashme.

16. Subjekti B me NIPT J.....Q, Inspektimi nr. AKM-LE-2023-000174, me objekt inspektimi: "*Inspektim mbi zbatueshmërinë e kushteve te "Vendim për VNM Paraprake" AN220520210001",* Inspektorët: N. D, K. U.
Nga listëverifikimi dhe procesverbali i inspektimit janë evidentuar mangësitë si në vijim: megjithëse në listëverifikim nuk është evidentuar asnjë mangësi, nga procesverbali rezulton se subjekti nuk i ka vënë në dispozicion trupës inspektuese raportet e vetëmonitorimit të dorëzuara pranë AKM-së. Kjo gjetje bie në kundërshtim me pikën 1/b (i) të nenit 26 të Ligjit nr. 128/2020, "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10440, datë 07.07.2011, Për vlerësimin e ndikimit në mjedis, i ndryshuar"*. Në seksionin e kundërvajtjeve administrative është përcaktuar se, në mbështetje të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, nenit 26, pika 1, b), i), shkelja klasifikohet si kundërvajtje administrative dhe është vendosur dënimi administrativ kryesor "*paralajmërim*". Nga shqyrtimi i Vendimit Përfundimtar të Inspektimit konstatohet se gjetjet dhe masa administrative janë identike me ato të pasqyruara në procesverbal, duke u vendosur ndaj subjektit dënimi administrativ kryesor "*paralajmërim*", çka evidentohet një mospërputhje ndërmjet listëverifikimit dhe procesverbalit në lidhje me evidentimin e shkeljeve.
Grupi i auditimit verifikoi dokumentacionin bashkëlidhur çështjes së inspektuar dhe konstatoi se gjetjet e pasqyruara në procesverbal nuk janë evidentuar dhe nuk janë reflektuar në listë verifikim. Gjithashtu, nga gjetja e konstatuar në procesverbal, lidhur me mos vendosjen në dosje të raporteve të vetë monitorimit nga trupa inspektuese, rezulton se ky veprim, sipas përcaktimeve të procesverbalit dhe të vendimit përfundimtar të inspektimit, përbën mos përmbushje të një prej kushteve të VNM-së paraprake. Konkretisht, në VNM-në paraprake me nr. AN220520210001, datë 29.06.2021, për subjektin B, në Tabelën 2 të pikës 14 *"Baza ligjore e monitorimit*", përcaktohet se monitorimi i zbatimit të kushteve të Vendimit paraprak të VNM-së raportohet çdo 6 (gjashtë) muaj pranë ekspertit mjedisor dhe inspektoratit përkatës. Nga auditimi konstatohet se, pavarësisht mos përmbushjes së detyrimeve për informim dhe raportim periodik pranë AKM-së, ndaj subjektit nuk është aplikuar dënimi administrativ me gjobë, në kundërshtim me nenin 26

"Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet", pika 1, shkronja b, i, të ligji nr. 10440/2011, i cili përcakton se: *"b) mos përmbushja dhe mosrespektimi i kushteve nga zhvilluesi i projektit:*
i) për vendimin për VNM-në paraprake dënohet me gjobë nga 65,000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë deri në 260,000 (dyqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë."
Në këto kushte, shkelja e konstatuar ka kundërvajtje të përcaktuar shprehimisht në legjislacionin e sipërcituar. Për rrjedhojë, vendosja e masës administrative *"paralajmërim*" ndaj subjektit është e pajustifikuar dhe e paargumentuar nga pikëpamja ligjore, pasi bie ndesh me dispozitat e ligjit të posaçëm që parashikon detyrimisht sanksionin me gjobë për këtë lloj shkeljeje.
Gjithashtu, nuk ka asnjë evidencë që raportet e vetë monitorimit të jenë dorëzuar apo raportuar. Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM), ku përfshihet edhe tabela e referuar, mban datën 17.10.2020.
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: N. D, K. U.

Grupi i auditimit i është drejtuar Agjencisë Rajonale Mjedisore (ARM) Lezhë me kërkesë me email-in e datës 12.01.2026 dhe 19.01.2026, për vënien në dispozicion të informacionit lidhur me:
- Gjobat dhe masat plotësuese të vendosura gjatë periudhës objekt auditimi;
- Masat administrative të ankimuara në Gjykatë, sipas statusit të tyre;
- Masat administrative të vendosura nga ARM Lezhë, por të pa ekzekutuara, për periudhën objekt auditimi;
- Masat administrative të llojit "paralajmërim", për periudhën objekt auditimi.

Në lidhje me pikën që ka të bëjë me gjobat dhe masat plotësuese të vendosura, informacioni i kërkuar nuk u vendos në dispozicion të grupit të auditimit. Për pasojë, grupi i auditimit nuk ishte në gjendje të nxirrte konkluzione mbi çështje të tilla si: numri i masave administrative kryesore dhe vlera e tyre për çdo vit, niveli i arkëtimit të gjobave, përqindja e masave administrative të ankimuara pranë AKM-së, si dhe numri i masave me status përfunduar.
Po ashtu, në lidhje me masat administrative të vendosura nga ARM Lezhë, por të pa ekzekutuara gjatë periudhës objekt auditimi, nuk u vendos në dispozicion informacion. Si rrjedhojë, grupi i auditimit nuk mundi të nxirrte përfundime mbi çështje të tilla si: *subjektet ndaj të cilave janë vendosur masa administrative kryesore gjobë të pa ekzekutuara dhe vlera përkatëse e tyre, ekzistenca e kërkesave apo vendimeve për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, si dhe përmbaruesi përgjegjës për ndjekjen e çështjeve.*

Mbi masat administrative "paralajmërim", të vendosura në ARM Lezhë gjatë vitit 2025.
Grupi i auditimit, nga lista totale e kundërvajtjeve administrative "*Paralajmërim*", të dhëna nga trupa inspektuese e ARM Lezhë, përzgjodhi inspektimet me datë vendimi pas datës 13.05.2025.
Për këto raste u krye verifikimi i shkeljeve të evidentuara nga trupa inspektuese në listë verifikim dhe në procesverbalet përkatëse të inspektimit, si dhe u vlerësuan gjetjet e konstatuara nga trupa inspektuese me referencat ligjore përkatëse dhe në ligjet e posaçme në fuqi. Situata e konstatuar paraqitet si më poshtë në tabelën e më poshtë:
Tabela nr. x: "Paralajmërime me datë vendimi pas 13.05.2025"

Numri i çështjes	Subjekti	NIPT	Shkelja e konstatuar	Gjykimi I grupit të KLSH-së			Nr. i inspektimeve në sistem
				Referenca ligjore	Masa administrative	Shuma (lekë)	
AKM-LE-2025-000111	S	L********O	Pengim inspektimi	Neni 57, i ligjit nr. 99/2024	Gjobë	50,000-100,000	2
AKM-LE-2025-000047	J	J********L	Asnjë raportim.	Pika b"ii" e nenit 29. te ligjit 10448/2011	Gjobë	300,000-500,000	3
AKM-LE-2025-000043	C. F	L********A	Kushti 2 të LM[18], tarife tej afati.	Pika b"ii" e nenit 29. te ligjit 10448/2011	Gjobë	300,000-500,000	13

[18] LM- Leje mjedisore.

AKM-LE-2025-000041	S. C	L9********V	Shkelje e kushtit 6 të LM	Pika b"ii" e nenit 29. te ligjit 10448/2011	Gjobë	300,000-500,000	2
AKM-LE-2025-000034	L. C	L********C	Shkelje e kushtit 6.3.1 të LM.	Pika b"ii" e nenit 29. te ligjit 10448/2011	Gjobë	300,000-500,000	4

Burimi: *AKM, përpunoi Grupi Auditimit.*

Masa administrative e vendosur ndaj subjekteve të mësipërme, të inspektuara ka qenë në të gjitha rastet *"paralajmërim",* pavarësisht llojit të veprimtarisë së subjekteve, natyrës së shkeljeve të konstatuara dhe sanksioneve të parashikuara në ligjet e posaçme mjedisore. Kjo praktikë tregon se trupat inspektuese kanë zbatuar në mënyrë uniforme dhe automatike masën e paralajmërimit, duke u mbështetur kryesisht në interpretimin e pikës 1 të nenit 44 të ligjit nr. 99/2024 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* pa kryer një vlerësim të individualizuar të shkeljeve dhe pa aplikuar masat administrative të përcaktuara shprehimisht në legjislacionin e posaçëm për mjedisin, çka e bën këtë praktikë jo në përputhje me parimin e ligjshmërisë dhe me hierarkinë e normave juridike. Subjektet e mësipërme nga verifikimi në sistemin e-inspektime rezulton se nuk janë paralajmërime të vendosura nga inspektime për herë të parë.

Nga auditimi konstatohet se, gjatë periudhës objekt auditimi, ligji nr. 10433, datë 16.06.2011, *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* ka pësuar ndryshime që lidhen me mënyrën e vendosjes së masave administrative ndaj subjekteve të inspektimit.

Në formën e tij para ndryshimeve, ligji nr. 10433/2011, në nenin 48 "*Shkelja e kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit"*, parashikonte shprehimisht se:

1. Kur konstatohet shkelje e kërkesave ligjore, që përbën kundërvajtje administrative, por që është e një rëndësie të vogël, apo për të cilën ligji i posaçëm nuk parashikon dënimin përkatës administrativ, subjekti i inspektimit dënohet me 'paralajmërim'. Paralajmërimi është dënim administrativ kryesor.

2. Subjekti i inspektimit mund të dënohet drejtpërdrejt me një dënim tjetër kryesor administrativ, më të rëndë, të parashikuar në ligjin e posaçëm, kur:

a) nuk zbaton plotësisht dhe brenda afatit të përcaktuar urdhërimin e parashikuar në pikën 4 të këtij neni;

b) përsërit shkeljen e kërkesave ligjore;

c) shkelja e konstatuar apo pasojat e saj janë të rënda.

Ky formulim ligjor e lidhte drejtpërdrejt zbatimin e masës administrative me përcaktimet e ligjit të posaçëm dhe nuk lejonte përdorimin e masës *"paralajmërim"* në rastet kur shkelja ishte e parashikuar shprehimisht si kundërvajtje administrative me sanksion konkret.

Me miratimin e ligjit nr. 99/2024 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* kjo dispozitë është riformuluar dhe aktualisht përfshihet në nenin 44 "*Dënimi administrativ kryesor",* i cili parashikon se:

16. Paralajmërimi është dënimi administrativ kryesor në inspektimin e parë të trupës së inspektimit.

17. Në të gjitha rastet kur konstatohen shkelje të kërkesave ligjore, që përbëjnë kundërvajtje administrative, subjekti i inspektimit dënohet me paralajmërim.

18. Paralajmërimi, si masë administrative kryesore, vendoset edhe për rastet kur për shkelje të lehta ligji i posaçëm nuk parashikon dënimin përkatës administrativ.

19. Dënimi administrativ kryesor me paralajmërim nuk zbatohet në rastet e shkeljeve të rënda për të cilat parashikohet masa e pezullimit të aktivitetit, sipas ligjit të posaçëm.

20. Dënimi administrativ kryesor me paralajmërim shoqërohet me urdhërimin e subjektit për të korrigjuar shkeljet e konstatuara dhe për të eliminuar pasojat e tyre, duke përcaktuar edhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim.

Nga auditimi konstatohet se kjo dispozitë është interpretuar nga AKM-ja dhe strukturat e saj rajonale në kuptimin se, për çdo subjekt të inspektuar për herë të parë pas hyrjes në fuqi të ligjit

nr. 99/2024, masa administrative që duhet të vendoset është vetëm "paralajmërim", pavarësisht llojit të shkeljes dhe pavarësisht sanksioneve të parashikuara në ligjet e posaçme.
Sipas vlerësimit të grupit të auditimit, ky interpretim nuk është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, pasi ligji i inspektimit ka karakter të përgjithshëm dhe procedural, ndërsa ligjet e posaçme mjedisore përcaktojnë shprehimisht shkeljet dhe masat administrative përkatëse.
Në këtë kuadër, aplikimi i masës administrative "paralajmërim", pa marrë në konsideratë llojin dhe rëndësinë e shkeljes dhe pa zbatuar sanksionet e përcaktuara në ligjet e posaçme, bie në mospërputhje me:
Ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011, *"Për lejet e mjedisit",* neni 29;
Ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011, *"Për mbrojtjen e mjedisit",* neni 69;
Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011*, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve",* neni 62;
Ligjin nr. 29/2024 "Për burimet ujore", neni 169.
Për rrjedhojë, nga auditimi konstatohet se vendosja e masës administrative *"paralajmërim"* nga trupat inspektuese gjatë vitit 2025, në rastet kur ligjet e posaçme parashikojnë sanksione konkrete administrative, nuk është në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi dhe nuk garanton zbatimin e plotë dhe efektiv të legjislacionit mjedisor.

Referuar edhe ndryshimit të dispozitave ligjore gjatë vitit 2025, janë marrë me përzgjedhje për auditimin inspektimet si në vijim:

1. Subjekti S. C me NIPT L.....V, me adresë Lac, lagjia nr. 3. (dy çështje)

Nga auditimi në sistemin e inspektime ka rezultuar se ky subjekt për vitin 2025 është inspektuar 2 herë nga ARM Lezhë dhe në të dy rastet ka marrë dënim administrativ kryesor "paralajmërim". Çështjet e inspektimit paraqiten si më poshtë:

Numri i Çështjes	Data e hapjes se çështjes	Data e mbylljes se çështjes	Krijuar nga	Inspektor1	Inspektor2
AKM-LE-2025-000041-SHKRESORE	7/31/2025	26/08/2025	B. L	B. L	K. U
AKM-LE-2025-000079	2/28/2025	07/04/2025	B. F	N. D	J. Sh

Burimi: ARM Lezhë, përpunoi Grupi Auditimit.

Në çështjen AKM-LE-2025-000079, bazuar në listëverifikimi n dhe Procesverbalin e Inspektimit, rezulton se gjatë inspektimit është konstatuar se subjekti nuk ka bashkëpunuar me trupën inspektuese për kryerjen e plotë të procedurës së inspektimit, duke penguar realizimin normal të veprimeve inspektuese. Megjithatë, si në procesverbalin e inspektimit ashtu edhe në vendimin përfundimtar të tij, ndaj subjektit është vendosur dënimi administrativ kryesor "Paralajmërim", ndonëse neni 54 i ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, *"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar nuk parashikon këtë masë administrative për shkeljen e konstatuar, por sanksionon shprehimisht se pengimi i inspektimit, në rast se nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe ndëshkohet me gjobë.
Gjithashtu, nga lista e verifikimit rezulton se subjekti është shënuar si i inspektuar për herë të parë, fakt i evidentuar në rubrikën përkatëse me shënimin "0".
Në çështjen AKM-LE-2025-000041-shkresore konstatohet gjithashtu se në listë verifikim është shënuar se inspektimi është kryer për herë të parë, megjithëse nga verifikimet rezulton se ky fakt nuk qëndron. Po ashtu, nga inspektimi rezulton se lista e verifikimit nuk është plotësuar në të gjitha rubrikat përkatëse.
Në rubrikën lidhur me pagesën e tarifës vjetore është shënuar se, nga inspektimi i kryer pranë subjektit *"S. C"* sh.p.k., rezulton se subjekti nuk ushtron aktivitetin për të cilin është i pajisur me

leje mjedisi të tipit B me nr. PN-1780-05-2023, për shkak se leja minerare e shfrytëzimit për mineralin gur gëlqeror është e revokuar. Ky fakt është verifikuar dhe vërtetuar edhe përmes hulumtimit në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit.
Në këto kushte, konstatohet se subjekti nuk ka përmbushur detyrimin për të njoftuar autoritetin kompetent për mos fillimin e punimeve, detyrim i parashikuar shprehimisht në kushtin 6 të lejes së mjedisit "Njoftimet", sipas të cilit subjekti duhet të njoftojë AKM/ARM Lezhë në rast të mos fillimit të aktivitetit. Gjetjet e konstatuara janë në kundërshtim me kushtet e lejes së mjedisit dhe me kërkesat ligjore për informimin e autoritetit përgjegjës në rast të ndryshimit të statusit të aktivitetit të autorizuar.
Në zbatim të ligjit nr. 99, datë 12.09.2024, *"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, neni 44, pikat 1 dhe 2, ndaj subjektit është vendosur dënimi administrativ kryesor "Paralajmërim", duke u argumentuar se aktiviteti nuk është ushtruar dhe se shkelja konsiston në mos njoftimin e autoritetit kompetent.
Megjithatë, neni 44 i ligjit nr. 99/2024 përcakton se paralajmërimi është dënimi administrativ kryesor vetëm në rastin e inspektimit të parë të trupës së inspektimit dhe se, në të gjitha rastet kur konstatohen shkelje që përbëjnë kundërvajtje administrative, subjekti dënohet me paralajmërim. Në këto kushte, duke qenë se inspektimi AKM-LE-2025-000041-shkresore nuk rezulton të jetë inspektim i parë, ndaj subjektit nuk duhej të aplikohej masa administrative "Paralajmërim", por masa e gjobës, në përputhje me nenin 29, pika 1, shkronja "b", nënndarja "ii", të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011, si shkelje e një prej kushteve të lejes mjedisore, konkretisht e kushtit 6, të lejes mjedisore.

2. Subjekti D me NIPT L.....F, me adresë: Njësia Administrative Bërdicë Shkodër zonë kadastrale 1158, Vol 3 faqe 209 me nr pasurie 476/3.
Nga auditimi konstatohet se dokumentacioni i inspektimit është:
- Autorizim Inspektimi me nr. AKM-LE-2025-000014-1, datë 16.01.2025.
- Proces–verbali i inspektimit me nr. AKM-LE-2025-000014-2, datë 27.01.2025.
- Lista e verifikimit nr. AKM-LE-2025-000014-2/1, datë 27.01.2025.
- Vendimi Përfundimtar i Inspektimit nr. AKM-LE-2025-000014-5, datë 10.02.2025.

Inspektorët: N.D, J. Sh dhe K. H.
Objekti i inspektimit: Inspektim mbi zbatueshmërinë e kushteve të lejes mjedisore me PN-1482-11-2022.
Nga lista e verifikimit janë konstatuar si më poshtë:
Gjatë inspektimit të programuar në subjektin "D", për lejen mjedisore me PN-1482-11-2022, datë 11.2022, rezultoi e pamundur kryerja e plotë e procedurës së inspektimit në terren. Kjo për arsye se subjekti, megjithëse ishte njoftuar me shkresë zyrtare me nr. 57 prot., datë 17.01.2025, nuk kishte caktuar një përfaqësues për të komunikuar me trupën inspektuese gjatë inspektimit, si dhe nuk ishte prezent asnjë person, në kundërshtim me parashikimet e nenit 36 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "*Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar. Në këto kushte, grupi i inspektimit mori vendimin për fillimin e procedurës për pengim inspektimi, bazuar në nenin 54 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 *"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë*".
Nga procesverbali janë konstatuar gjetjet si më poshtë:
Gjetjet e konstatuara në këtë procesverbal bien në kundërshtim me kërkesat ligjore të parashikuara në:
-Nenin 36 "*Detyrimet e subjektit të inspektimit*" dhe nenin 54 "*Kundërvajtjet administrative***"**, pika a) dhe b), të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, për mos-caktimin e një përfaqësuesi për komunikim me inspektorin gjatë inspektimit

dhe për mosbashkëpunim, duke penguar kryerjen e veprimeve të inspektimit. Inspektimi i programuar në terren pranë subjektit "D", për lejen mjedisore me PN-1482-11-2022, rezultoi i pamundur të kryhej, pasi subjekti nuk kishte caktuar apo autorizuar asnjë përfaqësues për të komunikuar me trupën inspektuese dhe për të dhënë shpjegime lidhur me zbatueshmërinë e kushteve të lejes mjedisore.
Në seksionin e Kundërvajtjeve Administrative është vendosur, dënim administrativ kryesor "*Paralajmërim".*
Nga auditimi i dokumentacionit të inspektimit konstatohet se ndaj subjektit është vendosur vetëm masa administrative kryesore "*Paralajmërim*", pa u argumentuar në mënyrë të arsyetuar pse shkeljet e konstatuara janë konsideruar si shkelje me rëndësi të vogël, sipas parashikimeve të nenit 48 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, i ndryshuar. Për më tepër, në vendimin e inspektimit dhe në procesverbal është referuar neni 54 i ligjit nr. 10433, i cili përcakton se: *"Prishja e shenjave dalluese të ndalimit të veprimtarisë apo bllokimit të pajisjeve a instalimeve, si dhe çdo shenjë tjetër, të vendosura nga inspektorët, si dhe pengimi i inspektimit, nëse nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë në vlerën nga 10,000 deri në 100,000 lekë*."
Sa më sipër, konstatohet se masa administrative e vendosur nuk është në përputhje me dispozitën ligjore të përcaktuar në procesverbal dhe në Vendimin Përfundimtar të inspektimit, pasi ligji parashikon shprehimisht masën e gjobës dhe jo paralajmërimin për këtë lloj shkeljeje.
Në këto kushte, grupi i auditimit vlerëson se vendosja e masës "Paralajmërim" është e paargumentuar dhe në mospërputhje me shkeljen konkrete të evidentuar gjatë inspektimit dhe me kërkesat e ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, i ndryshuar
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: N. D, J. Sh dhe K. H.

3. Subjekti I 02 me NIPT L.....A, me adresë: Tirane, Njësia Bashkiake nr. 8, rruga Bajram Curri.
Nga auditimi konstatohet se dokumentacioni i inspektimit është:
- Autorizim Inspektimi me nr. AKM-LE-2025-000030-1, datë 29.01.2025.
- Proces–verbali i inspektimit me nr. AKM-LE-2025-000030-2, datë 05.02.2025.
- Lista e verifikimit nr. AKM-LE-2025-000030-2/1, datë 05.02.2025.
- Vendimi Përfundimtar i Inspektimit nr. AKM-LE-2025-000030-5, datë 21.02.2025.

Inspektorët: N. D, J. Sh dhe K. H.
Objekti i inspektimit: Inspektim mbi zbatueshmërinë e kushteve te lejes mjedisore me PN-7171-04-2014.
- Subjekti "I.N.G-02" nuk kishte caktuar përfaqësues për komunikim me trupën inspektuese.
- Nuk u siguruan sqarime dhe dokumentacioni i nevojshëm për kryerjen e plotë të procedurës së inspektimit.
- Mungesë bashkëpunimi gjatë inspektimit, në kundërshtim me nenin 36 të ligjit nr. 10433/2011.

Nga procesverbali janë konstatuar gjetjet si më poshtë:
Gjetjet e konstatuara në këtë procesverbal bien në kundërshtim me kërkesat ligjore të parashikuara në:
- Nenin 36 "*Detyrimet e subjektit të inspektimit*" dhe nenin 54 "*Kundërvajtjet administrative***"**, pika a) dhe b), të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për mos-caktimin e një përfaqësuesi për komunikim me inspektorin gjatë inspektimit dhe për mosbashkëpunim, duke penguar kryerjen e veprimeve të inspektimit. Inspektimi i programuar në terren pranë subjektit "I. 02", për lejen mjedisore me PN-1771 04-2014, rezultoi i pamundur të kryhej, pasi subjekti nuk kishte caktuar apo autorizuar asnjë përfaqësues për të

komunikuar me trupën inspektuese dhe për të dhënë shpjegime lidhur me zbatueshmërinë e kushteve të lejes mjedisore.
Në seksionin e Kundërvajtjeve Administrative është vendosur, dënim administrativ kryesor "*Paralajmërim".*
Nga auditimi i dokumentacionit të inspektimit konstatohet se ndaj subjektit është vendosur vetëm masa administrative kryesore "*Paralajmërim*", pa u argumentuar në mënyrë të arsyetuar pse shkeljet e konstatuara janë konsideruar si shkelje me rëndësi të vogël, sipas parashikimeve të nenit 48 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, i ndryshuar. Për më tepër, në vendimin e inspektimit dhe në procesverbal është referuar neni 54 i ligjit nr. 10433, i cili përcakton se: *"Prishja e shenjave dalluese të ndalimit të veprimtarisë apo bllokimit të pajisjeve a instalimeve, si dhe çdo shenjë tjetër, të vendosura nga inspektorët, si dhe pengimi i inspektimit, nëse nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë në vlerën nga 10,000 deri në 100,000 lekë*."
Sa më sipër, konstatohet se masa administrative e vendosur nuk është në përputhje me dispozitën ligjore të përcaktuar në procesverbal dhe në Vendimin Përfundimtar të inspektimit, pasi ligji parashikon shprehimisht masën e gjobës dhe jo paralajmërimin për këtë lloj shkeljeje.
Në këto kushte, grupi i auditimit vlerëson se vendosja e masës "Paralajmërim" është e paargumentuar dhe në mospërputhje me shkeljen konkrete të evidentuar gjatë inspektimit dhe me kërkesat e ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, i ndryshuar
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: N. D, J. Sh dhe K. H.

4. Subjekti B. C me NIPT K.....R, me adresë: Rruga Koplik, Bajze, Malësi e madhe, Koplik.
Objekti i inspektimit: Inspektim mbi zbatueshmërinë e kushteve të lejes mjedisore të tipit B.
Nga auditimi konstatohet se dokumentacioni i inspektimit është:
- Autorizim Inspektimi me nr. AKM-LE-2025-000002-1, datë 13.01.2025.
- Proces–verbali i inspektimit me nr. AKM-LE-2025-000002-2, datë 20.01.2025.
- Lista e verifikimi nr. AKM-LE-2025-000002-2/1, datë 20.01.2025.
- Vendimi Përfundimtar i Inspektimit nr. AKM-LE-2025-000002-5, datë 31.01.2025.

Inspektorët: N. D, J. Sh, K. H.
Nga lista e verifikimit janë konstatuar si më poshtë:
Nga inspektimi i programuar në subjektin *"B. C",* lidhur me lejen mjedisore me PN 5740-06-2014, rezultoi e pamundur kryerja e procedurës së plotë të inspektimit në terren. Kjo për arsye se subjekti, ndonëse ishte njoftuar paraprakisht me shkresë zyrtare nr. 32 prot., datë 13.01.2025, nuk kishte caktuar një përfaqësues për të komunikuar me trupën inspektuese gjatë zhvillimit të inspektimit dhe as nuk ishte prezent asnjë person në ambientet e subjektit, në kundërshtim me kërkesat e parashikuara në nenin 36 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar.
Në këto kushte, trupa inspektuese ka vendosur fillimin e procedurës për pengim inspektimi, në mbështetje të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* neni 54. *Nga procesverbali janë konstatuar gjetjet si më poshtë:*
Gjetjet e konstatuara në këtë procesverbal bien në kundërshtim me kërkesat ligjore të parashikuara në nenin 36, *"Detyrimet e subjektit të inspektimit"* dhe nenit 54 *"Kundërvajtjet administrative",* të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar, sipas të cilit subjekti i inspektimit ka detyrimin: a) të caktojë një përfaqësues për të komunikuar me inspektorin gjatë inspektimit dhe b) të bashkëpunojë dhe të mos pengojë kryerjen e veprimeve të inspektimit, rezulton se inspektimi i programuar në subjektin *"B. C"* për lejen mjedisore me

PN-5740-06-2013 rezultoi i pamundur për t'u kryer, për shkak se në subjekt nuk u gjet askush për të komunikuar me trupën inspektuese.
- Në seksionin e Kundërvajtjeve Administrative është lënë dënimi administrativ kryesor *"Paralajmërim".*
Në vendimin përfundimtar të inspektimit, seksioni i gjetjeve dhe i kundërvajtjeve administrative rezulton të jetë i njëjtë me atë të pasqyruar në procesverbalin e inspektimit, pasi është vendosur vetëm një dënim kryesor *"Paralajmërim".*
Nga auditimi i dokumentacionit të inspektimit konstatohet se ndaj subjektit është vendosur vetëm masa administrative kryesore "*Paralajmërim*", pa u argumentuar në mënyrë të arsyetuar pse shkeljet e konstatuara janë konsideruar si shkelje me rëndësi të vogël, sipas parashikimeve të nenit 48 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, i ndryshuar. Për më tepër, në vendimin e inspektimit dhe në procesverbal është referuar neni 54 i ligjit nr. 10433, i cili përcakton se: *"Prishja e shenjave dalluese të ndalimit të veprimtarisë apo bllokimit të pajisjeve a instalimeve, si dhe çdo shenjë tjetër, të vendosura nga inspektorët, si dhe pengimi i inspektimit, nëse nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë në vlerën nga 10,000 deri në 100,000 lekë*."
Sa më sipër, konstatohet se masa administrative e vendosur nuk është në përputhje me dispozitën ligjore të përcaktuar në procesverbal dhe në Vendimin Përfundimtar të inspektimit, pasi ligji parashikon shprehimisht masën e gjobës dhe jo paralajmërimin për këtë lloj shkeljeje.
Në këto kushte, grupi i auditimit vlerëson se vendosja e masës "Paralajmërim" është e paargumentuar dhe në mospërputhje me shkeljen konkrete të evidentuar gjatë inspektimit dhe me kërkesat e ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, i ndryshuar.
Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektorët: N. D, J. Sh, K. H.
Për problematikat e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi inspektorët sipas rasteve të trajtuara në këtë material, përgjegjësi i sektorit të Inspektimeve Mjedisore dhe Drejtori i ARM Lezhë, sipas periudhave që kanë mbuluar në pozicionet përkatëse.

Drejtor i ARM Lezhë: B. F; *Përgjegjës Sektori i Inspektimeve Mjedisore:* A. U, J. Sh, N. D; *Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Natyrore:* I. D, B. Sh; *Inspektorët e përmendur në këtë material.*

Mbi dënimin administrativ kryesor "gjobë" gjatë inspektimeve

AKM

Grupi i auditimit për periudhën objekt auditimi ka kërkuar të dhëna në lidhje me totalin e gjobave të vendosura nga trupat inspektuese, por nuk i është vënë në dispozicion një databazë e plotë me të gjithë gjobat e vendosura në nivel ARM-je.
Nga Agjencitë Rajonale (përveç Lezhës) janë dërguar të dhënat në lidhje me gjobat e vëna nga trupat inspektuese dhe nuk rakordojnë në numër dhe në vlerë me të dhënat e vëna në dispozicion nga AKM.
Të dhënat e konsoliduara nga ARM-të që kanë paraqitur informacion mbi gjobat paraqiten si më poshtë:
Tabela "Gjobat për periudhën objekt auditimi sipas të dhënave nga ARM-të."

Fier					
Viti	**Shuma Masa administrative kryesore**	**Numri i masave administrative kryesore**	**Numri i masave të ankimuara në AKM**	**Shuma e masave të arkëtuara**	**Numri i masave me status përfunduar**

2021	8,090,000	21	10	2,238,000	4
2022	4,700,000	25	6	2,100,000	5
2023	26,400,000	38	14	16,400,000	14
2024	11,210,000	27	10	2,010,000	6
2025	8,650,000	9	4	0	0
Total I	**59,050,000**	**120**	**44**	**22,748,000**	**29**
Berat					
Viti	**Shuma Masa administrative kryesore**	**Numri i masave administrative kryesore**	**Numri i masave të ankimuara në AKM**	**Shuma e masave të arkëtuara**	**Numri i masave me status përfunduar**
2021	3,610,000	17	7	1,610,000	10
2022	4,850,000	14	10	1,430,000	9
2023	9,750,000	18	14	4,900,000	11
2024	6,650,000	10	6	3,330,000	7
2025	1,000,000	1	1		
Total II	**25,860,000**	**60**	**38**	**11,270,000**	**37**
Tiranë					
Viti	**Masa administrative kryesore**	**Nr. i masave adm. Kryesore**	**Nr. i masave të ankimuara në AKM**	**Shuma e masave të arkëtuara**	**Nr. i masave me status përf.**
2021	8,100,000	11	8	2,800,000	4
2022	12,710,000	23	12	3,105,000	7
2023	2,900,000	8	5	1,700,000	4
2024	1,650,000	8	5	300,000	3
2025	1,860,000	5	2	0	0
Total III	**27,220,000**	**55**	**32**	**7,905,000**	**18**
Total (I+II+III)	**112,130,000**	**235**	**114**	**41,923,000**	**84**

Burimi: ARM-të, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga AKM, konkretisht përmes emailit të datës 09.12.2025, mbi masat administrative të vendosura nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Agjencitë Rajonale të Mjedisit për periudhën 2023–2025, [19]situata paraqitet si më poshtë vijon:

Tabela "Krahasimi i të dhënave mbi gjobat sipas ARM-ve dhe AKM-së"

Raportimi	**AKM**	**ARM-Berat**	**ARM Tiranë**	**ARM Lezhë**	**ARM - Fier**	**Total i**
Sipas AKM	36	30	15	86	80	247
Sipas ARM-ve respective	Nuk ka paraqitur të dhëna	29	21	Nuk ka paraqitur të dhëna	74	
Diferenca	?	-1	6	?	-6	

Burimi: AKM/ARM, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga auditimi mbi vendosjen e masës administrative kryesore *"gjobë"* gjatë inspektimeve për periudhën objekt auditimi rezulton se nuk ekziston një databazë e plotë, e unifikuar dhe e konsoliduar në nivel kombëtar mbi gjobat e vendosura nga trupat inspektuese.
Grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion informacion i konsoliduar **mbi shumën totale të gjobave që kanë mbetur në fuqi gjatë periudhës objekt auditimi, numrin e masave administrative të paekzekutuara, rastet që ndodhen aktualisht në proces përmbarimor, si dhe ecurinë e ndjekjes së tyre nga strukturat përgjegjëse, çka kufizon vlerësimin e plotë të nivelit real të detyrimeve dhe efektivitetit të mekanizmave të ekzekutimit të tyre.**
Të dhënat e dërguara nga Agjencitë Rajonale të Mjedisit (me përjashtim të ARM Lezhë dhe Drejtorisë Qendrore) nuk rakordojnë në numër dhe në vlerë me informacionin e vënë në dispozicion nga AKM, duke evidentuar mospërputhje në raportim dhe mungesë harmonizimi ndërmjet nivelit qendror dhe atij rajonal.

[19] Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) ka vënë në dispozicion të dhëna për periudhën 2023–2025, në përputhje me periudhën objekt auditimi, ndërsa veprimtaria e inspektimit mbulon periudhën 2021–2025.

Për sa më sipër, veprimet e konstatuara gjatë auditimit lidhur me gjobat e paekzekutuara dhe ndjekjen e tyre për arkëtim rezultojnë në mospërputhje me kërkesat e kuadrit ligjor përkatës, konkretisht:

Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 "*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* neni 53 parashikon se: *"Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë ligj, dispozitat e këtij kreu plotësohen me dispozitat e ligjit për kundërvajtjet administrative",* çka nënkupton se vendosja dhe ndjekja e gjobave administrative duhet të realizohet në përputhje me rregullat që garantojnë ekzekutimin e tyre.

Në këtë kuadër, Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 *"Për kundërvajtjet administrative",* në nenin 22 përcakton se: *"Vendimi për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënimin me gjobë… përbëjnë titull ekzekutiv dhe për ekzekutimin e tyre ngarkohet shërbimi përmbarimor…",* duke e konsideruar gjobën një detyrim financiar që duhet të ndiqet aktivisht për zbatim.

Po ashtu, lidhur me arkëtimin e detyrimeve, në nenin 30 të këtij ligji parashikohet se *"Gjoba dhe shumat, që duhet të paguhen sipas vendimit për kundërvajtjen administrative… paguhen nga kundërvajtësi brenda 10 ditëve…", ndërsa "Pas kalimit të këtij afati, për çdo ditë vonesë paguhet kamatë…",* çka tregon se ligji kërkon ndjekje të menjëhershme dhe sistematike të ekzekutimit të gjobave.

Gjithashtu Ligji nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar. Neni 29, pika 12 përcakton se: "Çdo masë administrative e marrë në zbatim të këtij ligji ekzekutohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative."

Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar. Pjesa e Katërt "Ekzekutimi i detyrueshëm", Titulli i "Dispozita të përgjithshme", nenet 510 e vijues, të cilat rregullojnë titujt ekzekutivë dhe procedurat për ekzekutimin e detyrueshëm të detyrimeve nga organet përmbarimore.

Në përfundim, mungesa e një sistemi të unifikuar evidentimi dhe monitorimi të gjobave administrative, si dhe mospasja e informacionit të plotë mbi statusin e tyre, tregon se ndjekja dhe ekzekutimi i gjobave nuk realizohet në mënyrë efektive dhe në përputhje me kërkesat ligjore. **Kjo situatë dobëson kontrollin mbi detyrimet në fuqi, rrit rrezikun për mosarkëtim të të ardhurave dhe cenon besueshmërinë e procesit të inspektimit.**

Për sa i përket DQ në AKM, nga të dhënat e dërguara nga subjekti me email-in e datës 16.02.2026, rezulton si në vijim:

Nr.	Emri i subjektit	Numri i vendimit të përfundimtar te inspektimit	Informacion ne cilën faze është masa administrative	Shuma e paarkëtuar
1	L.C	AKM-DQ-2023-000029-5	Ne fazën e ekzekutimit te detyrueshëm	400,000
2	M. D	AKM-DQ-2023-000047-5	Në fazën e ekzekutimit te detyrueshëm	500,000
4	C	AKM-DQ-2024-000346-5	Ne pritje për lëshimin e titullit Ekzekutiv	300,000
5	C	AKM-DQ-2024-000344-5	Ne pritje për lëshimin e titullit Ekzekutiv	1,000,000
6	A. R	AKM-DQ-2024-000343-5	Ne pritje për lëshimin e titullit Ekzekutiv	390,000
8	E ShPK	AKM-DQ-2024-000384-5	Ne pritje për lëshimin e titullit Ekzekutiv	500,000
9	S Shpk	AKM-DQ-2024-000345-5	Ne pritje për lëshimin e titullit Ekzekutiv	1,300,000
12	B. P. L	AKM-DQ-2024-000450-5	Ne pritje për lëshimin e titullit Ekzekutiv	500,000
15	E. C. F	AKM-DQ-2025-000070 - 5	Ne pritje titullit Ekzekutiv &ne pro gjyq.	1,300,000
16	F-K C. F	AKM-DQ-2025-000077 - 5	Ne pritje titullit Ekzekutiv &ne proc gjyq.	1,300,000
17	G	AKM-DQ_2024-000532-5	Në fazën e ekzekutimit te detyrueshëm	650,000
18	S-Ŵ	AKM-DQ-2024-000480-5	Ne pritje për lëshimin e titullit Ekzekutiv	650,000
19	D-05	AKM-DQ-2024-000387-5	Rrëzimin e kërkesës si te pabazuar ne prova	300,000
20	P. A	AKM-DQ-2024-000382-5	Ne pritje për lëshimin e titullit Ekzekutiv	300,000
22	B	AKM-DQ-2024-000354-5	Ne pritje për lëshimin e titullit Ekzekutiv	300,000
23	3A	AKM-DQ-2024-301-5	Ne pritje për lëshimin e titullit Ekzekutiv	500,000
Totali				**10,190,000**

Burimi: AKM

Për sa më sipër, këto raste përfaqësojnë gjoba të pa arkëtuara në vlerën totale prej 10,190,000 lekë mënyrë vullnetare nga subjektet, për të cilat pritet ekzekutimi nëpërmjet përmbaruesit.

AGJENCIA RAJONALE MJEDISORE TIRANË, DURRËS DIBËR

Në ARM Tiranë, gjobat dhe masat plotësuese për periudhën objekt auditimi paraqiten si në tabelën më poshtë:

Viti	Masa administrative kryesore	Nr. i masave adm. Kryesore	Nr. i masave të ankimuara në AKM	Shuma e masave të arkëtuara	Nr. i masave me status përf.
2021	8,100,000	11	8	2,800,000	4
2022	12,710,000	23	12	3,105,000	7
2023	2,900,000	8	5	1,700,000	4
2024	1,650,000	8	5	300,000	3
2025	1,860,000	5	2	0	0
Total	**27,220,000**	**55**	**32**	**7,905,000**	**18**

Burimi: *ARM Tiranë, përpunuar nga grupi i auditimit*

Të dhënat e paraqitura në tabelën e mësipërme tregojnë një volum të lartë të masave administrative të vendosura gjatë periudhës 2021–2025, me një total prej 27,220 mijë lekësh gjoba. Megjithatë, nga auditimi konstatohen disa problematika lidhur me ekzekutimin, ankimin dhe ndjekjen pasuese të masave të vendosura.

1. Nivel i ulët i arkëtimit të gjobave

Nga totali prej 27,220,000 lekësh gjoba të vendosura, janë arkëtuar vetëm 7,905,000 lekë, ose rreth **29%** e vlerës. Kjo tregon se më shumë se gjysma e gjobave mbeten të pa ekzekutuara, duke krijuar detyrime dhe duke reduktuar efektivitetin ndëshkues të masave administrative.

2. Përqindje e lartë e masave që ankimohen në AKM

Gjatë periudhës objekt auditimi janë ankimuar 32 masa, nga 55 masa administrative gjithsej, pra **58,1% e tyre**.

Për vitin 2021, nga 11 masa administrative kryesore të vendosura, janë shfuqizuar 2 prej tyre. Për vitin 2022, nga 23 masa administrative kryesore të vendosura, janë shfuqizuar 5 dhe 1 është pezulluar. Për vitin 2023, nga 8 masa administrative kryesore të vendosura janë shfuqizuar 2 prej tyre. Për vitin 2024, nga 8 masa administrative kryesore të vendosura janë shfuqizuar 4 prej tyre. Për 2025, nga 5 masa administrative kryesore të vendosura, nuk është shfuqizuar asnjë prej tyre. Pra, në total për periudhën objekt auditimi, nga 52 masa administrative kryesore të vendosura, janë shfuqizuar 13 prej tyre.

Si konkluzion, analiza e tabelës tregon se vlerat e gjobave të vendosura nga ARM Tiranë janë të konsiderueshme, por niveli i arkëtimit mbetet i ulët. Kjo situatë rrit rrezikun që subjektet të mos i konsiderojnë sanksionet administrative si detyrim të menjëhershëm dhe, për pasojë, cenon efektivitetin e mekanizmave të kontrollit mjedisor dhe arritjen e objektivave të mbrojtjes së mjedisit.

Masat administrative të ankimuara në Gjykatë, sipas statusit të tyre, paraqiten si në vijim:

Përshkrimi	Numri i rasteve
Në proces gjyqësor	9
Pranim kërkesë-padie	5
Rrëzim kërkesë-padie	2
Jo në proces gjyqësor	38
Total	**54**

Burimi: *AKM Tiranë, përpunuar nga grupi i auditimit*

Nga auditimi konstatohet se nga gjithsej 54 masa administrative të vendosura, 16 prej tyre lidhen me procese ankimimi në gjykatë ose me vendime gjyqësore. Konkretisht, 9 raste janë ende në

proces gjyqësor. Ndërkohë, 5 raste janë pranuar nga gjykata për shqyrtim (pranim kërkesë-padie), ndërsa në 2 raste gjykata ka rrëzuar kërkesë-paditë, duke lënë në fuqi vendimet administrative të vendosura. Më shumë se gjysma e masave administrative janë ankimuar, ndërsa 23 masa administrative, nuk janë ankimuar në gjykatë, duke përbërë rreth 41% të totalit.

Sipas evidencës së masave administrative të vendosura nga Agjencia Rajonale Mjedisore Tiranë por të pa ekzekutuara për periudhën objekt auditimi, konstatohet si në vijim:

në lekë

Nr.	Emri i subjektit	Data e vendimit	Masa administ	Kërkesa/Vendimi për lëshim urdhri ekz.	Përmbaruesi
1	B ShPK	24.06.2021	1,500,000	Kërkesë Gjykatës për urdhër ekzekutim nr. 199 datë 11.02.2022/ Vendim për lëshim urdhri ekz. Nr. 436 datë 05.04.2022	"E"
2	K. K A	14.07.2021	500,000	Kërkesë për urdhër ekzekutim Gjykatës nr.112 datë 27.01.2022/ Vendim për lëshim urdhri ekz. Nr.238 datë. 04.02.2022	B. S. E.H
3	B. c. S. A	08.02.2021	1,000,000	Kërkesë për urdhër ekzekutim Gjykatës nr.221 datë 215.02.2022/ Vendim për lëshim urdhri ekz. Nr. 314 datë 23.02.20	"E"
4	O. Gj.	25.11.2021	300,000	Kërkesë për urdhër ekzekutim Gjykatës nr. 390 prot datë 08.03.2022/ Vendim për lëshim urdhri ekz. Nr. 677 dt 13.05.2022 ri drg 1126 dt 09.09.2022	"E"
5	J. P (b. b)	17.06.2022	5,000	Kërkesë për urdhër ekzekutim Gjykatës nr.1566 datë 23.12.2022/ Vendim për lëshim urdhri ekz. Nr.2776 datë 28.04.2023	"D.M"
6	B.K	03.02.2022	500,000	Kërkesë për urdhër ekzekutim Gjykatës nr. prot. 1135 datë 24.102023 Vendim për lëshim urdhri ekz. Nr.762 datë 06.06.2022	"E"
7	E. c	15.09.2022	500,000	Kërkesë për urdhër ekzekutim Gjykatës nr. prot. 1394 dt 07.11.2022 Vendim për lëshim urdhri ekz. 2344 dt 14.11.2022	"D. M"
8	P	01.04.2022	5,0000	Kërkesë për urdhër ekzekutim Gjykatës nr. 7635 dt 06.06.2022/ Vendim për lëshim urdhri ekz. Vendim për lëshim urdhri ekz. 2344 dt 14.11.2022	B. S. E.H
9	E. K.	09.05.2022	500,000	Kërkesë për urdhër ekzekutim Gjykatës Nr. 1011 prot dt 08.08.2022	"E"
10	R. P. H. G	19.08.2022	1,000,000	Kërkesë për urdhër ekzekutim Gjykatës port. Nr.134 dt. 13.07.2024 Vendim për lëshim urdhri ekz Nr. 1132 dt. 16.02.2023	"E"
11	P. R.	12.08.2022	1,000,000 + 1,000,000	Kërkesë për urdhër ekzekutim Gjykatës port. Nr.154 dt. 15.02.2023 Vendim për lëshim urdhri ekz Nr. 163dt. 24.07.2024	"D. M"
12	M. ShPK	30.03.2022	500,000	Kërkesë për urdhër ekzekutim Gjykatës nr. prot. 971 datë 27.07.2022 Vendim për lëshim urdhri ekz Nr. 1208 datë 28.06.2022	B. S E.H
13	R	02.10.2024	300,000	Kërkesë për lëshim urdhri ekzekutimi nga Gjykata me shkresë nr. 136 prot., date 13.02.2025.	"E"
14	R. C	17.02.2025	300,000	Kërkesë për urdhër ekzekutim Gjykatës nr. prot nr.562/1 prot., datë 10.10.2025	"E"
15	S. B. E	27.02.2025	390,000	Kërkesë për urdhër ekzekutim nr. prot nr. 563/1 prot., datë 10.10.2025	"E"
16	K	19.12.2024	390,000	Kërkesë për urdhër ekzekutim nr. prot nr.1066 prot., datë 09.10.2025	"E"
17	D. G	17.02.2025	390,000	Kërkesë për urdhër ekzekutim nr. prot. 1290 datë 24.12.2025	"E"
18	M. Y	16.01.2025	390,000	Kërkesë për urdhër ekzekutim nr. prot. 933 datë. 23.09.2025	"E"
19	E. A. P. O	26.10.2022	300,000	Kërkesë për urdhër ekzekutim Gjykatës 37 dt 11.01.2023	Në proces në Apel
Totali			**10,815,000**		

Burimi: *ARM Tiranë, përpunuar nga grupi i auditimit*

AGJENCIA RAJONALE MJEDISORE Fier Vlorë, Gjirokastër

Në ARM Fier, gjobat dhe masat plotësuese për periudhën objekt auditimi paraqiten si në tabelën më poshtë:

në lekë

Viti	Shuma Masa administrative kryesore	Numri i masave administrative kryesore	Numri i masave të ankimuara në AKM	Shuma e masave të arkëtuara	Numri i masave me status përfunduar
2021	8,090,000	21	10	2,238,000	4
2022	4,700,000	25	6	2,100,000	5
2023	26,400,000	38	14	16,400,000	14
2024	11,210,000	27	10	2,010,000	6
2025	8,650,000	9	4	0	0
Total	**59,050,000**	**120**	**44**	**22,748,000**	**29**

Burimi: *ARM Fier, përpunuar nga grupi i auditimit*

Të dhënat e paraqitura në tabelën e mësipërme tregojnë një volum të lartë të masave administrative të vendosura gjatë periudhës janar 2021– shtator 2025, me një total prej 59,050 mijë lekësh gjoba. Megjithatë, nga auditimi konstatohen disa problematika lidhur me ekzekutimin, ankimin dhe ndjekjen pasuese të masave të vendosura.

1. Nivel i ulët i arkëtimit të gjobave

Nga totali prej 59,050,000 lekësh gjoba të vendosura, janë arkëtuar vetëm 22,748,000 lekë, ose rreth **38.5%** e vlerës. Kjo tregon se më shumë se gjysma e gjobave mbeten të pa ekzekutuara, duke krijuar detyrime dhe duke reduktuar efektivitetin ndëshkues të masave administrative. Vitet 2021, 2022 dhe 2024 paraqesin nivelet më problematike, ku diferenca mes gjobave të vendosura dhe atyre të arkëtuara është shumë e lartë. Gjithashtu, për periudhën janar – shtator 2025 nuk është arkëtuar asnjë masë.

2. Përqindje e lartë e masave që ankimohen në AKM

Gjatë periudhës objekt auditimi janë ankimuar 44 masa, nga 120 masa administrative gjithsej, pra **36,6% e tyre**.

Si konkluzion, analiza e tabelës tregon se vlerat e gjobave të vendosura nga ARM Fier janë të konsiderueshme, por niveli i arkëtimit mbetet i ulët. Kjo situatë rrit rrezikun që subjektet të mos i konsiderojnë sanksionet administrative si detyrim të menjëhershëm dhe, për pasojë, cenon efektivitetin e mekanizmave të kontrollit mjedisor dhe arritjen e objektivave të mbrojtjes së mjedisit.

Masat administrative të ankimuara në Gjykatë, sipas statusit të tyre, paraqiten si në vijim:

Përshkrimi	Numri i rasteve
Në proces gjyqësor	16
Pranim kërkesë-padie	10
Rrëzim kërkesë-padie	3
Jo në proces gjyqësor	6
Total	**35**

Burimi: *AKM Fier, përpunuar nga grupi i auditimit*

Nga auditimi konstatohet se nga gjithsej 35 masa administrative të vendosura, 29 prej tyre lidhen me procese ankimimi në gjykatë ose me vendime gjyqësore. Konkretisht, 16 raste janë ende në proces gjyqësor. Ndërkohë, 10 raste janë pranuar nga gjykata për shqyrtim (pranim kërkesë-padie), ndërsa në 3 raste gjykata ka rrëzuar kërkesë-paditë, duke lënë në fuqi vendimet administrative të vendosura. Pjesa më e madhe, e masave administrative janë ankimuar, ndërsa 6 masa administrative, nuk janë ankimuar në gjykatë, duke përbërë rreth 17% të totalit.

Sipas evidencës së masave administrative të vendosura nga Agjencia Rajonale Mjedisore Fier por të pa ekzekutuara për periudhën objekt auditimi, konstatohet si në vijim:

në lekë

Nr	Emri subjektit	Dt. Vendimit	Masa administ	Kërkesa/Vendimi për lëshim urdhri ekz.	Përmbaruesi
1	D. F. SHPK	30/06/2021	10,000	nr. 194, dt.09.05.2023 (03.07.2023)	" Z. P. P. E "
2	F. SHPK	29/07/2021	300,000	nr. 405, dt.15.12.2022 (18.01.2023)	"B. S. E.H"
3	F. B	30/09/2021	300,000	nr. 369, dt.05.05.2022	"B. S. E.H"
4	D. F. SHPK	16/12/2021	300,000	Nr.370, dt. 25.10.2022(03.07.2023)	"B. S. E.H"
5	B. V (D. L)	29/08/2022	500,000	Nr. 179, dt. 20.04.2023 (03.07.2023)	"B. S. E.H"
6	A. O. & G. SHA	28/09/2022	500,000	Nr.270, dt. 12.09.2023 (11.10.2023)	"D. M"
7	A.GJ	07/10/2022	300,000	nr.79,(844) dt 07.09.2023 (21.09.2023)	"D. M"
8	R. L	15/11/2022	300,000	Nr. 80 (849) dt. 11.09.2023 (11.10.2023)	"B. S. E.H"
9	E-O A. SHPK	02/02/2023	500,000	Nr. 402, dt 06.02.2024, nr 154, dt. 20.02.2024	"D. M"
10	R SHPK	29/06/2023	100,000	Nr. 1120 prot., dt 25.04.2024, nr.282, dt 19.07.2024	"B. S. E.H"
11	D I. SHPK	14/07/2023	300,000	Nr.85, dt 14.01.2025, nr.22 dt. 05.03.2025	"D. M"
12	A. SHA	16/01/2024	1,500,000	Nr.575, dt. 25.02.2025; nr. 89-2025-521/54, dt 21.03.2025	" Z. P. P. E "
13	T.S SHA	05/04/2024	1,000,000	Nr.2077 prot., dt 04.08.2025; nr. 325, dt 18.09.2025	P. sh. F
14	A. H SHA	19/11/2024	300,000	Nr.2178 prot. 19.08.2025; nr. 335, dt. 18.09.2025	P. sh. F
15	U. T SHA	10/12/2024	1,500,000	Nr.2195, dt 22.08.2025; nr 394, dt 17.09.2025	P. sh. F
Totali			**7,710,000**		

Burimi: *ARM Fier, përpunuar nga grupi i auditimit*

AGJENCIA RAJONALE MJEDISORE Berat, Elbasan, Korçë

Në ARM Berat, gjobat dhe masat plotësuese për periudhën objekt auditimi paraqiten si në tabelën më poshtë:[20]

në lekë

Viti	Shuma Masa administrative kryesore	Numri i masave administrative kryesore	Numri i masave të ankimuara në AKM	Shuma e masave të arkëtuara	Numri i masave administrative plotësuese	Numri i masave me status përfunduar
2021	3,610,000	17	7	1,610,000	1	10
2022	4,850,000	14	10	1,430,000	3	9
2023	9,750,000	18	14	4,900,000	3	11
2024	6,650,000	10	6	3,330,000	3	7
2025	1,000,000	1	1		1	
Total	**25,860,000**	**60**	**38**	**11,270,000**	**11**	**37**

Burimi: *ARM Berat, përpunuar nga grupi i auditimit*

Të dhënat e paraqitura në tabelën e mësipërme tregojnë një volum të lartë të masave administrative të vendosura gjatë periudhës 2021–2025, me një total prej 25,860 mijë lekësh gjoba dhe 60 masa administrative kryesore. Megjithatë, nga auditimi konstatohen disa problematika lidhur me ekzekutimin, ankimin dhe ndjekjen pasuese të masave të vendosura.

1. Nivel i ulët i arkëtimit të gjobave

Nga totali prej 25,860,000 lekësh gjoba të vendosura, janë arkëtuar vetëm 11,270,000 lekë, ose rreth **43.6%** e vlerës. Kjo tregon se më shumë se gjysma e gjobave mbeten të pa ekzekutuara, duke krijuar detyrime dhe duke reduktuar efektivitetin ndëshkues të masave administrative. Vitet 2021, 2022 dhe 2023 paraqesin nivelet më problematike, ku diferenca mes gjobave të vendosura dhe atyre të arkëtuara është shumë e lartë.

2. Përqindje e lartë e masave që ankimohen në AKM

Gjatë periudhës objekt auditimi janë ankimuar 38 masa, nga 60 masa administrative gjithsej, pra **63% e tyre**. Kjo tregon se subjektet kundërshtojnë në masë vendimet e ARM Berat, çka sinjalizon dy mundësi:

-subjektet përdorin ankimimin si mjet shtyrjeje të pagesës;

-dokumentimi i gjetjeve dhe argumentimi ligjor nga strukturat inspektuese nuk është i mjaftueshëm për të qëndruar në instancat e ankimimit;

Si konkluzion, analiza e tabelës tregon se vlerat e gjobave të vendosura nga ARM Berat janë të konsiderueshme, por niveli i arkëtimit mbetet i ulët, ndërsa një pjesë e madhe e masave administrative ankimohen. Kjo situatë rrit rrezikun që subjektet të mos i konsiderojnë sanksionet administrative si detyrim të menjëhershëm dhe, për pasojë, cenon efektivitetin e mekanizmave të kontrollit mjedisor dhe arritjen e objektivave të mbrojtjes së mjedisit.

Masat administrative të ankimuara në Gjykatë, sipas statusit të tyre, paraqiten si në vijim:

Përshkrimi	Numri i rasteve
Në proces gjyqësor	7
Pranim kërkesë-padie	8
Rrëzim kërkesë-padie	8
Jo në proces gjyqësor	37
Total	**60**

Burimi: *AKM Berat, përpunuar nga grupi i auditimit*

[20] *Nga databaza e gjobave të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, rezultoi se në dy raste në qelizat përkatëse të masës administrative kryesore paraqiten dy gjoba të vendosura për të njëjtin subjekt. Për qëllime verifikimi dhe për të siguruar pasqyrim të saktë të vlerave, grupi i auditimit ka konsideruar shumën totale të të dyja gjobave gjatë validimit të të dhënave.*

Nga auditimi konstatohet se nga gjithsej 60 masa administrative të vendosura, 23 prej tyre lidhen me procese ankimimi në gjykatë ose me vendime gjyqësore. Konkretisht, 7 raste janë ende në proces gjyqësor. Ndërkohë, 8 raste janë pranuar nga gjykata për shqyrtim (pranim kërkesë-padie), ndërsa në 8 raste gjykata ka rrëzuar kërkesë-paditë, duke lënë në fuqi vendimet administrative të vendosura. Pjesa më e madhe, konkretisht 37 masa administrative, nuk janë ankimuar në gjykatë, duke përbërë rreth 62% të totalit.

Sipas evidencës së masave administrative të vendosura nga Agjencia Rajonale Mjedisore Berat por të pa ekzekutuara për periudhën objekt auditimi, konstatohet si në vijim:

në lekë

Nr	Emri subjektit	Dt. Vendimit	Masa administ	Kërkesa për lëshim urdhri ekz.	Vendimi i Gjyk. Për Lëshimin e UE	Përmbaruesi
1	A	11/08/2021	100,000	nr. 594/3, dt.19.11.2021	nr. 377, dt. 03.03.2021	"B.S. E.H"
2	B. C	27/08/2021	300,000	nr. 573/4, dt.19.11.2021	nr. 821/3, dt. 25.09.2023	"Z. P. P. E"
3	S	30/09/2021	20,000	nr. 23, dt.10.01.2022	nr. 61, dt. 08.02.2022	"B.S. E.H"
4	A-Do	08/11/2021	20,000	nr. 624/1, dt.30.05.2022	nr. 277, dt. 04.11.2022	"Z. P. P. E"
5	F	25/11/2021	20,000	nr.144/2, dt.12.05.2022	nr. 231, dt. 27.03.2023	"B.S. E.H""
6	A. l	16/12/2021	20,000	nr. 810, dt. 26.07.2022	nr. 234, dt. 27.03.2023	"Z.P. Gj. P. D. M"
7	A	14/12/2021	20,000	nr. 511/1, dt.12.05.2022	nr. 269, dt. 29.06.2022	"B.S. E.H"
8	S. T	17/08/2022	500,000	nr. 998/3, dt.14.10.2022	nr. 233, dt. 27/03/2023	Z.P. Gj. P. D. M"
9	K. m. P	05/10/2023	1,000,000	nr. 741, dt. 05.06.2024	nr. 1452, dt. 16.10.2024	"Z. P. P. E "
10	U. k	02/10/2023	300,000	nr. 1002, dt. 23.07.2024	nr. 1451, dt. 16.10.2024	"B.S. E.H"
11	B. K	28/12/2023	50,000	nr. 1074, dt. 01.08.2024	nr. 1449, dt. 16.10.2024	"B.S. E.H"
12	A. D	11/07/2024	300,000	nr. 1689, dt. 04.12.2024	nr. 780, dt. 14.05.2025	"B.S. E.H"
13	K. m P	02/12/2024	20,000	nr. 236, dt. 06.02.2025	nr. 781, dt. 14.05.2025	"Z. P. P. E "
14	G	21/02/2025	1,000,000	nr. 910, dt. 09.06.2025	nr. 1781/3, dt. 08.10.2025	Z.P. B
Totali			**3,670,000**			

Burimi: *ARM Berat, përpunuar nga grupi i auditimit*

Nga auditimi i praktikave të ndjekura nga ARM Berat në lidhje me ekzekutimin e masave administrative me gjobë, rezultoi se për asnjë prej rasteve të evidentuara me gjoba të papaguara brenda afatit ligjor, nuk është ndjekur procedura e detyrueshme për pezullimin e lejes mjedisore, në kundërshtim me kërkesat e parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi, konkretisht:

- pikën 5, nenin 25, të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar, ku përcaktohet se: "*Ministria i kërkon QKB-së shfuqizimin e lejes përkatëse të mjedisit të tipave A ose B, në rast se operatori i këtij instalimi nuk ka kryer pagimin e tarifës përkatëse në zbatim të këtij ligji".*

- shkronjën b dhe d, nenin 27 ku përcaktohet se: *"Ministri, për lejet e mjedisit të tipave A dhe B, mund të pezullojë ose të shfuqizojë lejen e mjedisit kur:*

b) mbajtësi i lejes nuk përmbush kushtet e parashikuara në lejen e mjedisit;

d) mbajtësi i lejes nuk ka paguar gjobat administrative, të vëna në bazë të këtij ligji apo të çdo akti tjetër normativ mjedisor.

- pikën 7 dhe 8, nenin 29, ku përcaktohet se:

7. Gjoba paguhet brenda një periudhe prej 30 ditësh kalendarike.

8. Ministri, me propozimin e strukturës përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit, në rastet kur gjoba nuk është paguar brenda afatit të përcaktuar, vendos pezullimin e lejes përkatëse të mjedisit për të gjithë veprimtarinë ose pjesë të saj deri në pagesën e gjobës. Vendimi i pezullimit publikohet menjëherë në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe i dërgohet zyrtarisht QKB-së.

- pikën 6, 7, 8, neni 63, i ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 *"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve",* ku përcaktohet se:

6. Kundërvajtësi paguan gjobën administrative brenda 35 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, me përjashtim të rastit kur vendimi për gjobën është pezulluar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7. Kur gjoba administrative nuk është paguar brenda datës së caktuar në pikën 6 të këtij neni, autoriteti përkatës ka të drejtë të pezullojë apo të revokojë lejen e mjedisit, licencën apo autorizimin derisa gjoba të paguhet.
8. Subjekti, ndaj të cilit është vendosur pezullimi apo revokimi i lejes, licencës apo autorizimit, ka të drejtë të ankohet te ministri, në përputhje me legjislacionin në fuqi
- pikën 7, 8, neni 69, të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 *"Për mbrojtjen e mjedisit"*, ku përcaktohet se:
7. Gjoba paguhet brenda periudhës së përcaktuar në nenin 30 të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative".
8. Ministri, me propozimin e inspektoratit, në rastet kur gjoba nuk është paguar brenda afatit të përcaktuar në pikën 7 të këtij neni, pezullon lejen përkatëse mjedisore deri në pagesën e gjobës.

Dispozitat e cituara më sipër përcaktojnë qartë se pezullimi i lejes mjedisore është një detyrim ligjor i detyrueshëm në çdo rast mos-pagesë të gjobës brenda afateve të përcaktuara, dhe se inicimi i procedurës së pezullimit bëhet vetëm me propozimin e inspektoratit.
Nga auditimi rezulton se, pavarësisht numrit prej 14 masash administrative të papaguara në sistem në shumën 3,670 mijë lekë, ARM Berat nuk ka dërguar asnjë kërkesë apo propozim për pezullimin e lejes mjedisore, as për pezullim të pjesshëm dhe as të plotë të veprimtarisë, duke mos zbatuar dispozitat e detyrueshme të ligjeve të sipërcituara. Mungesa e këtyre propozimeve përbën shkelje materiale dhe proceduriale, e cila ka sjellë moszbatim të sanksioneve të parashikuara nga ligji dhe ka reduktuar efektivitetin e masave administrative mjedisore. Mungesa e propozimeve të detyrueshme për pezullim të lejes mjedisore në rastet e mos-pagesës së gjobave ka sjellë moszbatim real të masave administrative, duke mos krijuar detyrim për operatorët që të përmbushin penalitetet ligjore brenda afateve. Për pasojë:
- gjobat e vendosura nuk kanë prodhuar efektin ndëshkues dhe korrigjues të parashikuar;
- subjektet kanë vijuar aktivitetin pa u përballur me pezullimin e parashikuar në ligj;
- masat administrative të vendosura kanë mbetur vetëm në nivel formal dhe jo të ekzekutuara.
Kjo situatë ka krijuar një risk të lartë për:
- uljen e efektivitetit të sanksioneve mjedisore, pasi mungesa e pezullimit i nxit subjektet të mos paguajnë gjobat;
- rënien e besueshmërisë së sistemit të kontrollit mjedisor;
- dekurajimin e zbatimit të ligjit nga ana e operatorëve mjedisorë, pasi mosrespektimi nuk ka pasoja;
- vijimin e mundshëm të veprimtarive me ndikim negativ në mjedis, duke qenë se subjektet me shkelje të rënda nuk penalizohen me pezullim;
- të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit, pasi mos-ekzekutimi i gjobave ul të ardhurat në buxhet.

Për sa i përket masave administrative të vendosura, konstatohet se mungon një metodologji e përcaktimeve të dënimeve administrative, në kundërshtim me pikën 7 dhe 8, të nenit 48 të ligjit nr. Nr.10 433, datë 16.6.2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"* ku citohet se:
7. Këshilli i Ministrave miraton rregulloren e përgjithshme të metodologjisë së përcaktimit të dënimeve administrative, në përputhje me parimin e proporcionalitetit.
8. Çdo inspektoriat shtetëror apo vendor harton rregulloren e metodologjisë së përcaktimit të dënimeve, në fushën e tij të inspektimit. Rregullorja miratohet nga ministri përgjegjës për inspektoratet shtetërore dhe organi ekzekutiv i njësisë vendore për inspektoratet vendore.

Mungesa e një metodologjie të miratuar, sjell riskun që inspektorët të vendosin masa administrative bazuar në interpretimin e tyre personal. Kjo krijon hapësirë që masat të jenë të pa unifikuara dhe jo në përpjesëtim me shkeljen e kryer, duke sjellë në këtë mënyrë dënime tepër të ashpra ose tepër të lehta, të cilat cënojnë standardet ligjore dhe krijojnë precedentë të gabuar në praktikë.

Mbi veprimtarinë e Sektorit të Ankimimeve (Apelim, Ekzekutim dhe Trajtim i Penaliteteve)
Bazuar në rregulloren nr. 120, datë 12.01.2021 "Rregullore e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit", Sektori i Ankimimeve (Apelim, Ekzekutim dhe Trajtim i Penaliteteve) ka një rol të rëndësishëm në shqyrtimin e ankimimeve, ekzekutimin e penaliteteve dhe administrimin e masave administrative, me qëllim garantimin e respektimit të legjislacionit mjedisor dhe përgjegjësisë ligjore të subjekteve që kryejnë shkelje. Ky sektor shqyrton ankimimet e depozituara nga subjektet kundrejt masave administrative dhe gjobave të vendosura, si dhe ndjek procesin e ekzekutimit të detyrimeve monetare nga subjektet e gjobitura, me synimin final të arkëtimit të fondeve në favor të institucionit. Veprimtaria e sektorit mbështet zbatimin korrekt të ligjit mjedisor dhe garanton parimet e transparencës, drejtësisë dhe llogaridhënies në procesin e vendosjes dhe trajtimit të sanksioneve administrative.

Përgjegjësi i Sektorit të Ankimimeve ushtron funksion drejtues dhe mbikëqyrës në administrimin e procedurave të shqyrtimit të ankimimeve dhe ekzekutimit të gjobave, duke siguruar zbatimin e legjislacionit, koordinimin me sektorët e tjerë, hartimin dhe monitorimin e planeve të punës, miratimin e metodikave për përcaktimin e vlerës së gjobave dhe administrimin e databazave të kundërvajtjeve dhe borxheve. Në të njëjtën linjë, inspektorët e sektorit kryejnë shqyrtimin praktik të ankimimeve dhe ndjekin ekzekutimin e detyrimeve financiare, zbatojnë aktet ligjore e nënligjore, bashkërendojnë me strukturat e brendshme dhe kontribuojnë në përditësimin e databazave, duke evidentuar problematika dhe propozuar zgjidhje për të siguruar një proces të drejtë, transparent dhe efektiv të trajtimit të penaliteteve administrative.

Nga verifikimi i databazës së ankimimeve të shqyrtuara pranë Sektorit të Apelimeve për periudhën objekt auditimi dhe vendimeve të marra rezultoi si, më poshtë:
Tabela "Ankimimet dhe statusi i shqyrtimit të tyre për periudhën objekt auditimi"

Statusi i vendimit	2023	2024	2025	Totali
Lënë në fuqi	28	30	8	66
Mospranim jashtë afatit	1			1
Ndryshuar		2		2
Pranim i pjesshëm i ankimit		1		1
Shfuqizuar	11	15	10	36
Totali	**40**	**48**	**18**	**106**

Burimi: AKM, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Nga verifikimi i databazës së ankimimeve të shqyrtuara pranë Sektorit të Apelimeve për periudhën objekt auditimi dhe vendimeve të marra, rezultoi se gjatë kësaj periudhe janë shqyrtuar gjithsej 106 ankime. Nga këto, në 66 raste janë lënë në fuqi masat administrative të marra nga Sektori i Inspektimeve, në 36 raste vendimet janë shfuqizuar, që përbëjnë rreth një të tretën e totalit të rasteve të shqyrtuara, ndërsa në 2 raste vendimi është ndryshuar, në 1 rast është pranuar pjesërisht dhe në 1 rast tjetër nuk është pranuar për shkak të paraqitjes, së tij jashtë afatit ligjor.
Tabela "Vlerat e dënimeve administrative periudha objekt auditimi"

Dënimi Administrativ	2023	2024	2025	Total
Lënë në fuqi	16,350,000	17,840,000	7,990,000	42,180,000
Mospranim jashtë afatit	1,000,000			1,000,000

Ndryshim mase		1,600,000		1,600,000
Pranim i pjesshëm i ankimit		1,000,000		1,000,000
Shfuqizuar	10,230,000	7,750,000	4,170,000	22,150,000
Total	**27,580,000**	**28,190,000**	**12,160,000**	**67,930,000**

Burimi: AKM, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Nga verifikimi i të dhënave financiare të vendimeve të shqyrtuara pranë Sektorit të Apelimeve për periudhën objekt auditimi, rezulton se vendime të lëna në fuqi, kanë një vlerë totale prej 42,080,000 lekësh dhe vendime të shfuqizuara kanë një vlerë prej 21,180,000 Lekë ose 31.5 % e vendimeve të shqyrtuara.

Afatet e ankimimit

Nga shqyrtimi i praktikave të trajtimit të ankimimeve rezulton se procesi i shqyrtimit administrativ nuk është zhvilluar gjithmonë brenda afateve ligjore të përcaktuara. Verifikimi i dokumentacionit evidentoi një numër të konsiderueshëm rastesh ku Komisioni i Shqyrtimit të Ankimimeve ka tejkaluar afatet e parashikuara për marrjen dhe njoftimin e vendimit përfundimtar, duke krijuar devijime nga kërkesat e ligjit "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe Kodit të Procedurave Administrative.

Nga auditimi konstatohet se në **13 raste**, **Komisioni i Shqyrtimit të Ankimimeve ka marrë vendim përfundimtar pas afateve të përcaktuara**, duke tejkaluar kufijtë kohorë [21]të parashikuar në pikën 1, neni 51 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*", ku përcaktohet se: *"Ankimi administrativ kundër vendimeve përfundimtare në fushën e inspektimit paraqitet dhe shqyrtohet sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative"* dhe në nenin 140 të ligjit nr. 44/20151 "Kodi i Procedurave Administrative i RSH", ku përcaktohet se: *"Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, akti administrativ që zgjidh ankimin nxirret dhe i njoftohet palës brenda 30 ditëve nga paraqitja e ankimit*".

Rastet e evidentuara pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Tabela 1: *"Subjekte me vendim përfundimtar në tejkalim afatesh"*

Nr.	Emri i subjektit	Data e vendimit të dënimit administrativ	Vlera e gjobës lekë	Ankimuar në AKM	Vendimi i Komisionit te Ankimit Nr/Vendimi data	Test Vendimi komision-Dt e Ankimimit	Numri I ditëve të tejkaluara
1	K. I	21/11/2023	1,500,000	19/12/2023	12/02/2024	55	25
2	A	04/12/2023	1,000,000	20/12/2023	12/02/2024	54	24
3	S. R. F	04/10/2023	300,000	23/10/2023	14/12/2023	52	22
4	V. H	03/06/2024	1,000,000	03/04/2024	24/05/2024	51	21
5	W. P	14/09/2023	500 000	13/10/2023	30/11/2023	48	18
6	A. K	10/09/2024	300,000	30/09/2024	14/11/2024	45	15
7	A	05/10/2023	2,000,000	06/11/2023	15/12/2023	39	9
8	A	03/10/2023	300,000	06/11/2023	15/12/2023	39	9
9	A. K	08/08/2023	1,000,000	04/10/2023	10/11/2023	37	7
10	H.L	07/09/2023	500 000	04/10/2023	08/11/2023	35	5
11	M. E	07/09/2023	500 000	05/10/2023	08/11/2023	34	4
12	E. M. N	08/09/2023	300 000	05/10/2023	08/11/2023	34	4
13	B B&B	02/10/2023	500,000	27/10/2023	30/11/2023	34	4

Burimi: AKM, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Gjithashtu konstatohet se ka një mospërputhje mes akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për zbatimin e afateve të ankimimit midis pikës 1 të nenit 51 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*", e cila e bazon afatin në nenin 140 të ligjit nr. 44/2015 *"Kodi i Procedurave Administrative i RSH",* dhe pikave 50 e 51 të kreut V, të Urdhrit nr. 25, datë

[21] Grupi i auditimit mori si afat 35 ditë për të përfshirë dhe rastet kur ka ditë pushimi.

10.08.2018, "*Për miratimin e rregullores për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ*", i ndryshuar, ku përcaktohet se:
Pika 50 *"Trupa inspektuese njofton procesverbalin e inspektimit dhe vendimin përfundimtar brenda 24 orëve, nëpërmjet dorëzimit personal ose me postë në adresën e subjektit të inspektuar.* ***Brenda 15 ditëve*** *nga nënshkrimi i procesverbalit të inspektimit dhe vendimit përfundimtar, subjekti ka të drejtë të ankohet me shkrim kundër vendimit përfundimtar te Komisioni i Shqyrtimit të Ankimimeve pranë inspektoriatit përkatës".*
Pika 51 *"Komisioni i Shqyrtimit të Ankimimit shqyrton ankimin, brenda 15 ditëve nga data e depozitimit, por jo më vonë se 30 ditë nga data e nënshkrimit të procesverbalit dhe vendimit përfundimtar. Shqyrtimi i ankimimit detyrimisht kryhet në prani të subjektit ankimues..."*

Për verifikimin e respektimit të afateve të ankimimit nga subjektet, grupi i auditimit ka llogaritur numrin e ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit të dënimit deri në datën e paraqitjes së ankesës. Nga ky verifikim rezultoi se, për periudhën objekt auditimi, në 11 raste ankesat e paraqitura nga subjektet janë depozituar në tejkalim të afateve të ankimimit, në kundërshtim me kërkesat e pikës 50, Kreu V, të Urdhrit nr. 25, datë 10.08.2018. Për 106 rastet e shqyrtuara, situata paraqitet si në tabelën më poshtë:
Tabela 2 "Paraqitja e ankesës në tejkalim afatesh"

Nr.	Emri i subjektit	Data e vendimit të dënimit administrativ	Vlera e gjobës lekë	Ankimuar në AKM	Vendimi i Komisionit te Ankimit Nr/Vendimi data	Test datë Ankimim - datë e Vendimit përfundimtar	Nr i ditëve tej afati
1	A. K	08/08/2023	1,000,000	04/10/2023	10/11/2023	57	27
2	G. T. M	05/12/2023	200,000	25/01/2024	22/02/2024	51	21
3	P.M	14/12/2023	500,000	26/01/2024	22/02/2024	43	13
4	B. P. L	14/11/2024	500,000	26/12/2024	23/01/2025	42	12
5	A SHA	16/10/2024	1,000,000	25/11/2024	12/12/2024	40	10
6	B. X	23/12/2022	500,000	26/01/2023	24/02/2023	34	4
7	A. S. P	21/07/2023	1/000/000	24/08/2023	12/09/2023	34	4
8	A	03/10/2023	300,000	06/11/2023	15/12/2023	34	4
9	B. G	19/01/2024	200,000	22/02/2024	13/03/2024	34	4
10	I SH/P/K	06/11/2024	1,000,000	10/12/2024	07/01/2025	34	4
11	U. T	10/12/2024	1,500,000	13/01/2025	05/02/2025	34	4

Burimi: AKM, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Të dhëna të paplota

Nr.	Emri i subjektit	Data e vendimit të dënimit administrativ	Vlera e gjobës lekë	Ankimuar në AKM	Vendimi i Komisionit te Ankimit Nr/Vendimi data	Test datë Ankimim - datë e Vendimit përfundimtar
1	B. S shpk	11/08/2023	50,000	10/08/2023	12/09/2023	-1
2	A shpk	03/07/2023	30,000		18/08/2023	-45110
3	V. H	03/06/2024	1,000,000	03/04/2024	24/05/2024	-61

Burimi: AKM, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Në tre raste të konstatuara, në bazën e të dhënave paraqiten mangësi, konkretisht:
- Për subjektin "B. S" sh.p.k., data e ankimimit rezulton më e hershme se data e Vendimit Administrativ;
- Për subjektin "A" sh.p.k., mungon data e ankimimit; ndërsa
- Për subjektin "V. H", data e ankimimit rezulton rreth dy muaj para datës së vendimit përfundimtar.

Këto mangësi paraqesin risk në drejtim të saktësisë dhe besueshmërisë së të dhënave.

Nga auditimi, për periudhën 2023-30.09.2025 u konstatuan 106 raste ankimimesh si në vijim që

janë shqyrtuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Komisionit dhe janë shfuqizuar 36, si në vijim:

Në lekë

Nr.	Emri i subjektit	Vlera e gjobës	Vendimi i Komisionit të Ankimit
1	O-P shpk	300,000	nr. 7397 prot., datë 12.09.2023
2	A shpk	30,000	nr.6510 prot., datë 18.08.2023
3	SH	500,000	nr. 7396 prot., datë 12.09.2023
4	D shpk	300,000	nr. 7395 prot., datë 12.09.2023
5	D. E	500,000	nr.7867 prot datë 26.09.2023
6	N	2,000,000	nr. 8631 prot., datë 17.10.2023
7	R. B	1,000,000	nr. 8630 prot., datë 17.10.2023
8	M	300,000	nr. 8632 prot., datë 17.10.2023
9	E shpk	Paralajmërim	Mungon
10	D	300,000	nr. 9930/1 prot datë 01.12.2023
11	T. S	5,000,000	nr. 10162 prot datë 06.12.2023
12	SH. U	200,000	nr.2551 prot., datë 01.03.2024
13	O. I S. T T	100,000	nr.3024 prot., datë 13.3.2024
14	D	200,000	nr.3908 prot., datë 04.04.2024
15	A. M	50,000	nr. 3909 prot., datë 04.04.2024
16	A	500,000	nr.6492 prot., datë 14.06.2024
17	H.K.H. G. 2	1,000,000	nr. 9110 prot., datë 30.08.2024
18	A. K	300,000	nr. 12061 prot., datë 14.11.2024
19	E-S	500,000	nr. 12270 prot., datë 20.11.2024
20	Sh. sh.p.k	300,000	nr. 12268 prot., datë 20.11.2024
21	A	300,000	nr. 12607 prot., datë 02.12.2024
22	B. P. A L	1,300,000	nr.12605 prot., datë 02.12.2024
23	B-3 sh.p.k	1,000,000	nr. 12611 prot., datë 02.12.2024
24	A SHA	1,000,000	nr. 13020 prot., datë 12.12.2024
25	T. A T &M	500,000	nr. 13018 prot., datë 12.12.2024
26	M.K	500,000	nr. 13385 prot., datë 18.12.2024
27	C. F SH.P.K	500,000	nr. 40 prot., datë 06.01.2025
28	B. M. E M.	650,000	nr. 697 prot., datë 23.01.2025
29	T. M A SH.P.K	400,000	nr. 699 prot., datë 23.01.2025
30	Q. S	650,000	nr. 695 prot., datë 23.01.2025
31	D	400,000	nr. 1253 prot., datë 05.02.2025
32	E-06	390,000	nr 5742 prot., datë 19.05.2025
33	S. SHPK	390,000	nr. 5738 prot., datë 19.05.2025
34	T. A T & M	390,000	nr. 5740 prot., datë 19.05.2025
35	A-B shpk	Paralajmërim	nr. 6359 prot., datë 09.06.2025
36	O	400,000	nr. 6361 prot., datë 06.06.2025

Burimi: AKM, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Të ndara në nivel Agjencie Rajonale Mjedisore, rezultojnë si në vijim:

Agjencia Rajonale Berat	Agjencia Rajonale Fier	Agjencia Rajonale Lezhe	Agjencia Rajonale Tiranë	Drejtoria Qendrore	Grand Total
2	**11**	**11**	**5**	**7**	**36**

Burimi: AKM, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Grupi i auditimit përzgjodhi rastet si në vijim:

1. Subjekti O-P shpk me NIPT L.....B, me objekt aktiviteti *"Prodhim i produkteve plastike*", me leje Mjedisit Tipi B me PN-1551-12-2022, ka marrë masë administrative gjobë në vlerën 300,000 lekë, nëpërmjet vendimit përfundimtar të inspektimit nr. AKM-TR-2023-000069-5, datë 01.08.2023, për shkak të shkeljeve të konstatuara gjatë inspektimit. Konkretisht, janë evidentuar: mosparaqitja e planit të përputhshmërisë sipas kushteve të lejes mjedisore; menaxhimi i pakontrolluar i ujërave të përdorura për ftohje, të cilat shkarkoheshin në sipërfaqe duke rrezikuar ndotjen e mjedisit dhe sigurinë e punonjësve; si dhe mungesa e një vendi të përcaktuar për grumbullimin e mbetjeve. Subjekti ka paraqitur ankim, duke pretenduar se problematika e ujërave është korrigjuar pas inspektimit dhe se mbetjet menaxhohen nëpërmjet një kontrate me një subjekt të licencuar, ndërsa një pjesë e tyre trajtohen si lëndë e parë për riciklim. Komisioni i shqyrtimit

të ankimimit ka vlerësuar se subjekti ka marrë masa korrigjuese dhe ka paraqitur prova mbështetëse, duke arritur në përfundimin se shkaku ligjor për vendosjen e masës administrative është ezauruar dhe, për rrjedhojë, ka vendosur shfuqizimin e gjobës.
Nga auditimi konstatohet se ky vendim nuk mbështetet në prova dhe argumente të mjaftueshme ligjore. Konkretisht, në listë-verifikimin e inspektimit është konstatuar se subjekti nuk kishte një vend të përcaktuar për depozitimin e mbetjeve dhe ato ishin të shpërndara në ambient, duke krijuar rrezik për ndotjen e tokës dhe ujërave sipërfaqësorë. Paraqitja e mëvonshme e një kontrate për menaxhimin e mbetjeve nuk e rrëzon këtë konstatim faktik të bërë në terren në momentin e inspektimit.
Për rrjedhojë, shfuqizimi i masës administrative në vlerën 300,000 lekë është kryer në kundërshtim me nenin 137, pika 2 të Kodit të Procedurës Administrative, ku citohet se: "Organi epror, me akt administrativ refuzon ankimin nëse ai rezulton të jetë i papranueshëm apo i pabazuar".
Komisioni i shqyrtimit të ankimimit, i përbërë nga: znj. A. D Kryetar, z. K. A Anëtar, zj. N. N Anëtar, znj. J. B Anëtar, znj. E. M Anëtar.

2. Subjekti S. shpk me NIPT K.....E, me objekt aktiviteti *"Ndërtime civile. Aktivitet minerar, nxjerrje dhe përpunim minerale, import - eksport",* me leje Mjedisi Tipi B me PN-5660-08-2017, ka marrë masë administrative gjobë në vlerën 390,000 lekë, nëpërmjet vendimit përfundimtar të inspektimit nr. AKM-LE-2025-000087-5, datë 28.03.2025, për shkak të shkeljeve të konstatuara gjatë inspektimit. Konkretisht, janë evidentuar: mosplotësimi i detyrimeve për pagesën e tarifës vjetore të lejes mjedisore dhe mungesa e dokumentacionit justifikues (raporte vetëmonitorimi, raport vjetor, mandat-pagesa); mosparaqitja e raporteve vjetore për periudhën e ushtrimit të aktivitetit; si dhe mungesa e dokumentacionit lidhur me monitorimin, dokumentimin dhe raportimin sipas kushteve 11 dhe 12 të lejes mjedisore.
Subjekti ka paraqitur ankim, duke pretenduar se nuk është bërë njohja me Urdhrin dhe Planin e Kontrollit sipas kërkesave të Kodit të Procedurës Administrative dhe se inspektimi nuk është kryer në terren, por nga zyra. Gjithashtu, ka pretenduar se leja minerare është transferuar te subjekti "V" sh.p.k., sipas akt-marrëveshjes noteriale datë 27.07.2023 dhe akt-miratimit nr. 3194 prot., datë 08.04.2024, duke kaluar edhe detyrimet përkatëse sipas nenit 6 të kësaj marrëveshjeje, ku citohet: "Subjekti i cili kërkon t'i transferohet leja minerare, pra V. shpk, pranon së bashku me transferimin e lejes minerare, përgjegjësitë për të gjitha detyrimet kundrejt shtetit apo palëve të treta të cilat rrjedhin nga leja minerare që transferohet sipas përcaktimeve të ligjit minerar i ndryshuar nr. 10304, datë 15.07.2010". Për periudhën pararendëse, subjekti pretendon se ka dorëzuar raportin e vetëmonitorimit.
Komisioni i shqyrtimit të ankimimit ka vlerësuar se procedura e inspektimit nuk është zhvilluar në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* duke argumentuar se dokumentacioni i inspektimit nuk është mbajtur në vendin e ushtrimit të aktivitetit dhe, për rrjedhojë, ka vendosur shfuqizimin e masës administrative.
Nga auditimi konstatohet se ky vendim nuk mbështetet në prova dhe argumente të mjaftueshme ligjore.
Neni 33 i ligjit nr. 10433/2011 parashikon shprehimisht se: "1. Vendi i inspektimit përcaktohet me autorizim. Vendi i inspektimit mund të jetë:
a) kudo ku kryen veprimtarinë e tij subjekti i inspektimit dhe ndodhen faktet që lidhen me respektimin apo mosrespektimin e kërkesave ligjore;
b) në zyrat e organit inspektues, nëse nga natyra e inspektimit është i mundur të kryhet inspektimi.
2. Në rastin e parashikuar në shkronjën "b", të pikës 1 të këtij neni, subjekti i inspektimit ftohet, nëpërmjet njoftimit paraprak, të paraqitet në zyrat e inspektoratit. Nëse është e nevojshme,

inspektori mund të kërkojë paraqitjen e dokumenteve, të sendeve apo të dhënave të tjera, të nevojshme për kryerjen e inspektimit në zyrat e tij".
Gjithashtu, neni 45 i po këtij ligji parashikon se: *"...nëse përfundimi në vendin e inspektimit nuk është i mundur, ai përfundohet në zyrat e inspektoriatit dhe njoftohet brenda 5 ditëve nga data e përfundimit të inspektimit".*
Në këto kushte, komisioni është fokusuar vetëm në vendin e zhvillimit të inspektimit, pa analizuar dhe argumentuar ligjërisht shkeljet materiale të konstatuara në lidhje me monitorimin, raportimin dhe pagesën e tarifës vjetore gjatë periudhës kur subjekti "S" ka qenë aktiv.
Për rrjedhojë, shfuqizimi i masës administrative në vlerën 390,000 lekë është kryer në kundërshtim me nenin 137, pika 2 të Kodit të Procedurës Administrative, i ndryshuar, ku citohet se: *"Organi epror, me akt administrativ refuzon ankimin nëse ai rezulton të jetë i papranueshëm apo i pabazuar".*
Komisioni i shqyrtimit të Ankimimit, i përbërë nga: znj. A. D Kryetar, z. D. S, Anëtar, znj. E. O, Anëtar, z. E. P, Anëtar, znj. A. Z, Anëtar.

3. Subjekti D me NIPT K.....Q, ka marrë masë administrative gjobë në vlerën 300,000 lekë, nëpërmjet vendimit përfundimtar të inspektimit nr. AKM-DQ-2023-000250-5, datë 02.10.2023, për shkak të shkeljeve të konstatuara gjatë inspektimit.
Konkretisht, janë evidentuar: mosparaqitja e raportit vjetor të mjedisit, raportit të vetëmonitorimit, planit të çmontimit/rehabilitimit, planit të përputhshmërisë dhe planit të menaxhimit të mbetjeve; si dhe mosmbajtja e dokumentacionit mjedisor në vendin e ushtrimit të aktivitetit, duke e bërë të pamundur vënien e tij në dispozicion të trupës inspektuese.
Subjekti ka paraqitur ankim, duke pretenduar se, si institucion shtetëror, nuk ka qenë në dijeni të detyrimit për dorëzimin e raporteve mjedisore dhe se, pas njoftimit nga trupa inspektuese, ka marrë masa për përmbushjen e detyrimeve përmes angazhimit të një studioje mjedisore.
Komisioni i shqyrtimit të ankimimit ka vendosur shfuqizimin e masës administrative, duke u bazuar në nenet 45 dhe 46 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".*
Nga auditimi konstatohet se ky vendim nuk mbështetet në prova dhe argumente të mjaftueshme ligjore. Neni 45 "Mbajtja dhe njoftimi i procesverbalit" citon: *"Procesverbali i inspektimit përmban, gjithashtu, informacion për të drejtën e subjektit të inspektimit që të paraqesë me shkrim apo me gojë shpjegimet apo kontestimet e tij për faktet dhe rrethanat e konstatuara në procesverbal, brenda një afati të përcaktuar nga inspektori, por jo më të shkurtër se 8 ditë nga data e njoftimit të procesverbalit, për paraqitjen e këtyre komenteve, si dhe organin ku paraqiten këto komente. Pas kalimit të këtij afati, vendimi përfundimtar mund të merret pa qenë i nevojshëm dëgjimi i mëtejshëm i subjektit të inspektimit. Shpjegimet apo kontestimet e subjektit janë pjesë e dosjes".*
Ndërsa neni 46 "Shqyrtimi dhe marrja e vendimit përfundimtar" citon: *"Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm, vendimi përfundimtar i inspektimit merret nga inspektori apo inspektorët që kanë kryer inspektimin, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të procesverbalit subjektit të inspektimit".*
Nga auditimi rezulton se këto afate janë respektuar, pasi procesverbali nr. AKM-DQ-2023-000250-2 është mbajtur në datë 04.09.2023 dhe vendimi përfundimtar nr. AKM-DQ-2023-000250-5 është marrë në datë 02.10.2023.
Gjithashtu, evidentohet se masat e marra nga subjekti, të reflektuara në raportin e vetëmonitorimit dhe raportin vjetor të paraqitur, janë ndërmarrë pas konstatimit të shkeljeve dhe mbajtjes së procesverbalit, në kuadër të inspektimit me objekt "Zbatimi i kushteve të lejes mjedisore". Në këtë

kontekst, këto masa nuk mund të shërbejnë si argument për shfuqizimin e masës administrative, pasi neni 4, pika 2 e ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, parashikon se qëllimi i inspektimit është vlerësimi i respektimit të kërkesave ligjore nga subjekti në momentin e inspektimit, dhe jo korrigjimi i shkeljeve pas faktit.
Për rrjedhojë, shfuqizimi i masës administrative në vlerën 300,000 lekë është kryer në kundërshtim me nenin 137, pika 2 të Kodit të Procedurës Administrative, i ndryshuar, ku citohet se: *"Organi epror, me akt administrativ refuzon ankimin nëse ai rezulton të jetë i papranueshëm apo i pabazuar".*
Komisioni i shqyrtimit të Ankimimit, i përbërë nga: znj. A.D Kryetar, z. K. A, Anëtar, znj. N. N, Anëtar, znj. A. Z, Anëtar, znj. J. B, Anëtar.

4. Subjekti D. shpk me NIPT K.....M, me objekt aktiviteti *"Shërbim lavanderie, pastrim kimik, tregtim mallrash shumicë-pakicë detergjentë, pastrim kimik, hidrosanitare etj.*, me leje Mjedisi Tipi B me PN-1400-09-2022, ka marrë masë administrative gjobë në vlerën 300,000 lekë, nëpërmjet vendimit përfundimtar të inspektimit nr. AKM-TR-2023-000039-5, datë 22.08.2023, për shkak të shkeljeve të konstatuara gjatë inspektimit.
Konkretisht, janë evidentuar: mosparaqitja e dokumentacionit për zbatimin e kushteve të 3-mujorit të parë pas miratimit të lejes mjedisore; mungesa e raportit 6-mujor të vetëmonitorimit; mungesa e dokumentacionit mbi trajtimin paraprak të ujërave të ndotura; mungesa e planit të menaxhimit të mbetjeve; mosmbajtja e dokumentacionit për menaxhimin e mbetjeve në ambientet e aktivitetit; si dhe mungesa e dokumenteve të transferimit për mbetjet jo të rrezikshme.
Subjekti ka paraqitur ankim, duke pretenduar se shkeljet lidhen me mosdorëzimin e raporteve dhe se janë marrë masa për përmbushjen e detyrimeve, si dhe se aktiviteti i tij nuk shkakton ndotje mjedisore për shkak të teknologjisë së përdorur dhe zhvillimit në ambiente të mbyllura.
Komisioni i shqyrtimit të ankimimit ka konstatuar se subjekti ka paraqitur dokumentacion shtesë, përfshirë raportin e vetëmonitorimit (datë 28.07.2023), faturën e pagesës së tarifës vjetore, planin e menaxhimit të riskut dhe programe të menaxhimit mjedisor. Gjithashtu, subjekti ka dhënë shpjegime mbi mënyrën e trajtimit të ujërave të ndotura. Në këtë bazë, komisioni ka vendosur shfuqizimin e masës administrative duke u mbështetur në nenet 45 dhe 46 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".
Nga auditimi konstatohet se ky vendim nuk mbështetet në prova dhe argumente të mjaftueshme ligjore, pasi shkeljet e konstatuara janë në kundërshtim me nenin 21 të ligjit nr. 10463 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", nenin 48 të ligjit nr. 10433 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe nenin 29 të ligjit nr. 10448 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar. Për këto kundërvajtje administrative parashikohen masa si paralajmërim, gjobë 1,000,000 lekë dhe gjobë 300,000 lekë, ndërkohë që në vendimin përfundimtar është aplikuar vetëm masa e gjobës 300,000 lekë.
Përsa i përket raportit të vetëmonitorimit, rezulton se subjekti e ka dorëzuar në datë 28.07.2023 pranë AKM dhe ARM Tiranë, pra përtej afatit të përcaktuar në lejen mjedisore (data 08.03.2023). Në këto kushte, masat e marra nga subjekti pas konstatimit të shkeljeve nuk e rrëzojnë shkeljen në momentin e inspektimit dhe nuk përbëjnë bazë ligjore për shfuqizimin e masës administrative.
Për rrjedhojë, shfuqizimi i masës administrative në vlerën 300,000 lekë është kryer në kundërshtim me nenin 137, pika 2 të Kodit të Procedurës Administrative, i ndryshuar, ku citohet se*: "Organi epror, me akt administrativ refuzon ankimimin nëse ai rezulton të jetë i papranueshëm apo i pabazuar".*
Anëtari znj. E. M ka mbajtur qëndrim kundër, duke firmosur "lënë në fuqi".
Komisioni i shqyrtimit të Ankimimit, i përbërë nga: znj. A. D, Kryetar, z. K. A, Anëtar, znj. N. N,

Anëtar, znj. J. B, Anëtar, znj. E. M, Anëtar.

5. Subjekti T. M Al me NIPT L.....K, me objekt aktiviteti *"Import-eksport, shitje me pakicë dhe shumicë e mineraleve metarore dhe jometarore përfshirë metalet e çmuara dhe jo të çmuara, kërkim, zbulim, eksplorim...."* me leje Mjedisi Tipi B me PN-8480-04-2019, ka marrë masë administrative gjobë në vlerën 400,000 lekë, nëpërmjet vendimit përfundimtar të inspektimit nr. AKM-LE-2024-000218-5, datë 10.12.2024, për shkak të shkeljeve të konstatuara gjatë inspektimit.

Konkretisht, janë evidentuar: mosdorëzimi dhe mosprotokollimi në AKM i Regjistrit për shkarkimin dhe transferimin e ndotësve; si dhe mosraportimi i të dhënave në regjistrat e mbetjeve. Subjekti ka paraqitur ankim, duke pretenduar se mosdorëzimi i regjistrit ka qenë një gabim njerëzor dhe se dokumentacioni është dorëzuar më pas me shkresën nr. 1375, datë 19.11.2024 pranë ARM Lezhë. Gjithashtu, subjekti pretendon se gjatë periudhës së referuar nuk ka gjeneruar mbetje, pasi ka rifilluar aktivitetin në datë 15.05.2025.

Komisioni i shqyrtimit të ankimimit ka vlerësuar se procedura e inspektimit nuk është zhvilluar në përputhje me legjislacionin në fuqi, konkretisht me Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm nr. 25, datë 10.08.2018 "Rregullore për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ", i ndryshuar, duke argumentuar se inspektimi nuk është kryer në sistemin elektronik "e-inspektimi". Në këtë bazë, komisioni ka vendosur shfuqizimin e masës administrative duke u mbështetur në nenet 45 dhe 46 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

Nga auditimi konstatohet se ky vendim nuk mbështetet në prova dhe argumente të mjaftueshme ligjore. Kuadri ligjor në fuqi për procedurën e inspektimit është përcaktuar drejtpërdrejtë nga ligji nr. 10433/2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë". Konkretisht, Kreu VI i këtij ligji, përmes nenit 45 "Mbajtja dhe njoftimi i procesverbalit" dhe nenit 46 "Shqyrtimi dhe marrja e vendimit përfundimtar", rregullon në mënyrë të plotë mënyrën e mbajtjes së procesverbalit, vendin e hartimit të tij, njoftimin e subjektit, afatet për paraqitjen e kundërshtimeve, si dhe afatin për marrjen e vendimit përfundimtar të inspektimit. Këto dispozita parashikojnë se procesverbali, si rregull, mbahet në vendin e inspektimit, por mund të përfundohet edhe në zyrat e inspektoratit kur kjo nuk është e mundur, duke u njoftuar subjekti brenda afateve ligjore, ndërsa vendimi përfundimtar merret brenda 30 ditëve nga njoftimi i procesverbalit.

Sa më sipër, ligji nuk e kushtëzon vlefshmërinë e procesit të inspektimit me përdorimin e një mjeti të caktuar teknik apo elektronik, por me respektimin e elementëve thelbësorë proceduralë të parashikuar në nenet 45 dhe 46 të tij.

Nga ana tjetër, edhe në observacionet e paraqitura është theksuar se Urdhri nr. 25, datë 10.08.2018, për aq sa bie ndesh me ligjin mbi bazën e të cilit është nxjerrë, është i pazbatueshëm për pjesët përkatëse, në respekt të parimit të hierarkisë së akteve normative. Në këtë drejtim, Kreu VII i këtij urdhri rezulton në mospërputhje me ligjin nr. 10433/2011 dhe me Kodin e Procedurave Administrative.

Referuar nenit 116 të Kushtetutës, rendi juridik është hierarkik dhe aktet nënligjore duhet të jenë në përputhje me aktet më të larta juridike, si në formë ashtu edhe në përmbajtje. Në këtë kuadër, aktet nënligjore nuk mund të vendosin kërkesa procedurale shtesë që cenojnë ose kufizojnë dispozitat e ligjit.

Në këto kushte, mbështetja në një dispozitë të Urdhrit nr. 25 për të shpallur të pavlefshëm vendimin përfundimtar të inspektimit, ndërkohë që janë respektuar kërkesat e neneve 45 dhe 46 të ligjit nr. 10433/2011, nuk rezulton e bazuar ligjërisht dhe nuk ndryshon përfundimet e auditimit.

Gjithashtu, konstatohet se vendimi për shfuqizimin e masës administrative është marrë pa shumicën e kërkuar të votave, pasi është miratuar vetëm me votën e dy anëtarëve, konkretisht nga znj.F. M dhe znj. E. Gj, ndërsa kryetari i komisionit ka firmosur "lënë në fuqi".
Për rrjedhojë, shfuqizimi i masës administrative në vlerën 400,000 lekë është kryer në kundërshtim me nenin 137, pika 2 të Kodit të Procedurës Administrative, i ndryshuar, ku citohet se: *"Organi epror, me akt administrativ refuzon ankimin nëse ai rezulton të jetë i papranueshëm apo i pabazuar".*
Komisioni i shqyrtimit të Ankimimit, i përbërë nga: znj. A. D, Kryetar, z. D. S, Anëtar, znj. F. M, Anëtar, znj. E. Gj, Anëtar, znj. A. Z, Anëtar.

6. Subjekti A me NIPT J.....U, me objekt aktiviteti *"Nxjerrja e naftës dhe gazit natyror"* me leje Mjedisi Tipi B me PN-6733-07-2018, ka marrë masë administrative gjobë në vlerën 1,000,000 lekë, nëpërmjet vendimit përfundimtar të inspektimit nr. AKM-FR-2024-000203-5, datë 16.12.2024, për shkak të shkeljeve të konstatuara gjatë inspektimit.
Konkretisht, janë evidentuar: mosplotësimi i kërkesave të lejes mjedisore; shkarkime të pakontrolluara të ujërave të përziera me lëndë hidrokarbure në puset e nxjerrjes dhe në sektorin e dekantimit, si pasojë e teknologjisë së amortizuar; prani e mbetjeve hidrokarbure të shpërndara në sipërfaqe; si dhe mungesa e dokumentacionit mjedisor për menaxhimin e mbetjeve.
Subjekti ka paraqitur ankim, duke pretenduar se gjendja mjedisore është e trashëguar nga ish-kontraktori "Ph" ltd, se procesi teknologjik është i mbyllur dhe ujërat teknologjike injektohen në shtresë nëpërmjet pusit të injektimit Am44, si dhe se eventualisht ndodhin grumbullime të përkohshme të fluidit në gropat e avarisë, të cilat menaxhohen dhe transportohen me mjete teknologjike pa dalë jashtë territorit të aktivitetit. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar kryerjen e vetëmonitorimit mjedisor dhe dorëzimin e raporteve përkatëse, si dhe pagesën e tarifave mjedisore për vitin 2024.
Komisioni i shqyrtimit të ankimimit ka vlerësuar se procedura e inspektimit është kryer në kundërshtim me Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm nr. 25, datë 10.08.2018 "Rregullore për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ", i ndryshuar, dhe në këtë bazë ka vendosur shfuqizimin e masës administrative duke u mbështetur në nenet 45 dhe 46 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".
Nga auditimi konstatohet se ky vendim nuk mbështetet në prova dhe argumente të mjaftueshme ligjore. Nga auditimi rezulton se procesverbali i inspektimit nr. AKM-FR-2024-000203-2 është mbajtur në datë 18.09.2024 dhe vendimi përfundimtar nr. AKM-FR-2024-000203-5 është marrë në datë 16.12.2024, pra brenda afateve ligjore të përcaktuara në nenet 45 dhe 46 të ligjit nr. 10433/2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë". Konkretisht, neni 45 "Mbajtja dhe njoftimi i procesverbalit" citon: *"Procesverbali i inspektimit përmban, gjithashtu, informacion për të drejtën e subjektit të inspektimit që të paraqesë me shkrim apo me gojë shpjegimet apo kontestimet e tij për faktet dhe rrethanat e konstatuara në procesverbal, brenda një afati të përcaktuar nga inspektori, por jo më të shkurtër se 8 ditë nga data e njoftimit të procesverbalit, për paraqitjen e këtyre komenteve, si dhe organin ku paraqiten këto komente. Pas kalimit të këtij afati, vendimi përfundimtar mund të merret pa qenë i nevojshëm dëgjimi i mëtejshëm i subjektit të inspektimit. Shpjegimet apo kontestimet e subjektit janë pjesë e dosjes".*
Ndërsa neni 46 "Shqyrtimi dhe marrja e vendimit përfundimtar" citon: *"Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm, vendimi përfundimtar i inspektimit merret nga inspektori apo inspektorët që kanë kryer inspektimin, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të procesverbalit subjektit të inspektimit".*

Kuadri ligjor në fuqi për procedurën e inspektimit është përcaktuar drejtpërdrejtë nga ligji nr. 10433/2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë". Konkretisht, Kreu VI i këtij ligji, përmes neneve 45 dhe 46, rregullon në mënyrë të plotë elementët procedurialë të inspektimit, duke përfshirë mbajtjen dhe njoftimin e procesverbalit, vendin e hartimit të tij, të drejtën e subjektit për kundërshtime, si dhe afatin për marrjen e vendimit përfundimtar.
Sa më sipër, ligji nuk e kushtëzon vlefshmërinë e procedurës së inspektimit me përdorimin e një mjeti teknik apo elektronik të caktuar, por me respektimin e elementëve thelbësorë proceduralë të parashikuar në nenet 45 dhe 46 të tij.
Në këto kushte, pretendimi për pavlefshmëri të procedurës së inspektimit, i bazuar vetëm në shkelje të Urdhrit nr. 25/2018, nuk qëndron, pasi aktet nënligjore nuk mund të prevalojnë mbi ligjin. Në përputhje me nenin 116 të Kushtetutës, aktet nënligjore duhet të jenë në përputhje me ligjin dhe nuk mund të vendosin kërkesa shtesë që kufizojnë apo ndryshojnë dispozitat ligjore.
Për rrjedhojë, shfuqizimi i masës administrative në vlerën 1,000,000 lekë është kryer në kundërshtim me nenin 137, pika 2 të Kodit të Procedurës Administrative, i ndryshuar, ku citohet se: *"Organi epror, me akt administrativ refuzon ankimin nëse ai rezulton të jetë i papranueshëm apo i pabazuar".*
Komisioni i shqyrtimit të Ankimimit, i përbërë nga: znj. A. D Kryetar, z. D. S (pa firmë) Anëtar, znj. F.M, Anëtar, znj. E.Gj, Anëtar, znj. A. Z, Anëtar.

7. Subjekti A me N J.....U, me objekt aktiviteti *"Riparim dhe mirëmbajtje e makinerive dhe pajisjeve kryesisht reparti i tornerisë dhe reparti i avolzhimit"* me leje Mjedisi Tipi B me PN-6484-05-2018, ka marrë masë administrative gjobë në vlerën 300,000 lekë, nëpërmjet vendimit përfundimtar të inspektimit nr. AKM-FR-2024-000168-5, datë 03.10.2024, për shkak të shkeljeve të konstatuara gjatë inspektimit.
Konkretisht, janë evidentuar: mosplotësimi i kërkesave të lejes mjedisore; shkarkime të pakontrolluara të ujërave të përziera me lëndë hidrokarbure në puset e nxjerrjes dhe në sektorin e dekantimit, si pasojë e teknologjisë së amortizuar; prani e mbetjeve hidrokarbure të shpërndara në sipërfaqe; si dhe mungesa e dokumentacionit mjedisor për menaxhimin e mbetjeve.
Subjekti ka paraqitur ankim, duke pretenduar se gjendja mjedisore është e trashëguar nga ish-kontraktori "Ph" ltd, se procesi teknologjik është i mbyllur dhe ujërat teknologjike injektohen në shtresë nëpërmjet pusit të injektimit Am44, si dhe se eventualisht ndodhin grumbullime të përkohshme të fluidit në gropat e avarisë, të cilat menaxhohen dhe transportohen me mjete teknologjike pa dalë jashtë territorit të aktivitetit. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar kryerjen e vetëmonitorimit mjedisor dhe dorëzimin e raporteve përkatëse, si dhe pagesën e tarifave mjedisore për vitin 2024.
Komisioni i shqyrtimit të ankimimit ka vlerësuar se procedura e inspektimit është kryer në kundërshtim me Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm nr. 25, datë 10.08.2018 "Rregullore për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ", i ndryshuar, dhe në këtë bazë ka vendosur shfuqizimin e masës administrative duke u mbështetur në nenet 45 dhe 46 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".
Megjithatë, sipas KLSH, ky vendim nuk mbështetet në prova dhe argumente të mjaftueshme ligjore. Nga auditimi rezulton se procesverbali i inspektimit nr. AKM-FR-2024-000203-2 është mbajtur në datë 18.09.2024 dhe vendimi përfundimtar nr. AKM-FR-2024-000203-5 është marrë në datë 16.12.2024, pra brenda afateve ligjore të përcaktuara në nenet 45 dhe 46 të ligjit nr. 10433/2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".
Konkretisht, neni 45 "Mbajtja dhe njoftimi i procesverbalit" citon: *"Procesverbali i inspektimit përmban, gjithashtu, informacion për të drejtën e subjektit të inspektimit që të paraqesë me shkrim*

apo me gojë shpjegimet apo kontestimet e tij për faktet dhe rrethanat e konstatuara në procesverbal, brenda një afati të përcaktuar nga inspektori, por jo më të shkurtër se 8 ditë nga data e njoftimit të procesverbalit, për paraqitjen e këtyre komenteve, si dhe organin ku paraqiten këto komente. Pas kalimit të këtij afati, vendimi përfundimtar mund të merret pa qenë i nevojshëm dëgjimi i mëtejshëm i subjektit të inspektimit. Shpjegimet apo kontestimet e subjektit janë pjesë e dosjes".

Ndërsa neni 46 "Shqyrtimi dhe marrja e vendimit përfundimtar" citon: *"Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm, vendimi përfundimtar i inspektimit merret nga inspektori apo inspektorët që kanë kryer inspektimin, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të procesverbalit subjektit të inspektimit".*

Kuadri ligjor në fuqi për procedurën e inspektimit është përcaktuar drejtpërdrejt nga ligji nr. 10433/2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë". Konkretisht, Kreu VI i këtij ligji, përmes neneve 45 dhe 46, rregullon në mënyrë të plotë elementët procedurialë të inspektimit, duke përfshirë mbajtjen dhe njoftimin e procesverbalit, vendin e hartimit të tij, të drejtën e subjektit për kundërshtime, si dhe afatin për marrjen e vendimit përfundimtar.

Sa më sipër, ligji nuk e kushtëzon vlefshmërinë e procedurës së inspektimit me përdorimin e një mjeti teknik apo elektronik të caktuar, por me respektimin e elementëve thelbësorë proceduralë të parashikuar në nenet 45 dhe 46 të tij.

Në këto kushte, pretendimi për pavlefshmëri të procedurës së inspektimit, i bazuar vetëm në shkelje të Urdhrit nr. 25/2018, nuk qëndron, pasi aktet nënligjore nuk mund të prevalojnë mbi ligjin. Në përputhje me nenin 116 të Kushtetutës, aktet nënligjore duhet të jenë në përputhje me ligjin dhe nuk mund të vendosin kërkesa shtesë që kufizojnë apo ndryshojnë dispozitat ligjore.

Për rrjedhojë, shfuqizimi i masës administrative në vlerën 1,000,000 lekë është kryer në kundërshtim me nenin 137, pika 2 të Kodit të Procedurës Administrative, i ndryshuar, ku citohet se: *"Organi epror, me akt administrativ refuzon ankimin nëse ai rezulton të jetë i papranueshëm apo i pabazuar".*

Komisioni i shqyrtimit të Ankimimit, i përbërë nga: znj. A. D, Kryetar, z. D. S Anëtar, znj. F. M, Anëtar, znj. E. Gj, Anëtar, znj. A. Z, Anëtar.

8. Subjekti T. S (ish T. G) me NIPT L.....I, me objekt aktiviteti *"Për shfrytëzim nafte"* me leje Mjedisi Tipi B me PN-4139-09-2012, ka marrë masë administrative gjobë në vlerën 5,000,000 lekë, nëpërmjet vendimit përfundimtar të inspektimit nr. AKM-FR-2023-000156-5 datë 26.10.2023, për shkak të shkeljeve të konstatuara gjatë inspektimit.

Sipas Procesverbalit nr. AKM-FR-2023-000156-2, datë 26.10.2023, Listës së Verifikimit nr. FR-2023-000156-2/1, datë 26.10.2023, dhe Vendimit Përfundimtar të Inspektimit nr. AKM-FR-2024-000168-5, datë 03.10.2024, ka rezultuar se gjatë inspektimit në zonën e Lumit Gjanica, në vendin e quajtur "Ofiçina e Vjetër Visokë", është konstatuar shkarkim i lëndëve hidrokarbure së bashku me ujë teknologjik të gjeneruar nga procesi i dekantimit të hidrokarbureve. Ky shkarkim është evidentuar përgjatë përroit dhe dokumentuar me foto dhe video, duke përfunduar në lumin Gjanica, në kundërshtim me ligjin nr. 111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", neni 30, pika 7.

Subjekti ka ankimuar vendimin me shkresën nr. 9221 prot., datë 06.11.2023, depozituar pranë AKM-së, duke pretenduar se nga aktiviteti i tij nuk janë kryer shkarkime në përroin që derdhet në lumin Gjanica, se nuk është mbajtur procesverbal në vend dhe se nuk është vënë në dijeni për konstatimet e inspektimit.

Komisioni i shqyrtimit të ankimimit, në vlerësim të ankimimit të subjektit, ka arritur në përfundimin se procedura e inspektimit është në kundërshtim me nenin 43 pika 4 dhe pika 9, si

dhe me nenet 45 dhe 46 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", duke konstatuar mungesë të njoftimit dhe të garantimit të të drejtës së subjektit për shpjegime. Në këtë bazë, Komisioni ka vendosur shfuqizimin e masës administrative.
Nga auditimi konstatohet se vendimi i Komisionit të Ankimimit për shfuqizimin e masës administrative ndaj subjektit "T. O. S" është i pambështetur në prova, i paargumentuar juridikisht dhe në kundërshtim me detyrimet që burojnë nga legjislacioni mjedisor, kushtetues dhe procedural.
Në objektin e ankesës së subjektit pretendohet se nuk është mbajtur procesverbal në vend dhe se nuk është vënë në dijeni për konstatimet e inspektimit, pra nuk pretendohet cenim i së drejtës së ankimimit pas vendimit të ndërmjetëm. Nëse subjekti do të ngrinte një pretendim të tillë, juridiksioni për shqyrtimin e tij do t'i përkiste Agjencisë Rajonale Mjedisore Fier, pasi sipas nenit 44, pika 2 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, citohet se: *"Si rregull, ankimi i veçantë shqyrtohet drejtpërdrejt nga drejtuesi i degës territoriale. Nëse ligji i posaçëm parashikon që vendimi i ndërmjetëm të merret nga drejtuesi i degës territoriale apo një komision i posaçëm ose nëse inspektorati nuk ka degë territoriale, ankimi shqyrtohet drejtpërdrejt nga kryeinspektori".*
Pra, në thelb, Komisioni i Ankimimit nuk ka shqyrtuar objektin e ankesës së paraqitur nga "T. O. S" dhe nuk ka analizuar shkeljen thelbësore të konstatuar në terren.
Në Ankesën Administrative të depozituar pranë AKM-së me nr. 9221 prot., datë 06.11.2023, subjekti ka pretenduar moskryerjen e shkarkimeve dhe mungesën e procesverbalit në vend, pa ngritur pretendime konkrete lidhur me afatet procedurale të vendimit të ndërmjetëm.
Nga inspektimi i datës 26.10.2023 rezulton se është mbajtur procesverbal dhe janë administruar prova fotografike dhe filmike, ku konstatohet shkarkim i ujërave industriale të përziera me lëndë hidrokarbure në përroin që derdhet në lumin Gjanica. Kjo përbën shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 30, pika 3 dhe 7 të ligjit nr. 111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", i cili detyron subjektet të trajtojnë ujërat industriale sipas parimit "Ndotësi paguan" dhe ndalon shkarkimet e pakontrolluara në mjedisin ujor.
Shkeljet e konstatuara përbëjnë rrezik të drejtpërdrejtë për mjedisin dhe shëndetin publik, duke kërkuar ndërhyrje të menjëhershme në funksion të mbrojtjes së interesit publik dhe zbatimit të parimit "ndotësi paguan", si dhe në përputhje me detyrimin kushtetues të shtetit për mbrojtjen e mjedisit, sipas nenit 59, pika dh të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
Gjithashtu, grupi i auditimit vlerëson se Komisioni nuk ka interpretuar drejt dispozitat e ligjit nr. 10433/2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", pasi ky ligj nuk parashikon që mungesa e njoftimit të afatit të ankimimit të vendimit të ndërmjetëm sjell pavlefshmërinë e masave përfundimtare, veçanërisht në rastet kur janë konstatuar shkelje me ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis. Për më tepër, subjekti ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit përfundimtar brenda afateve ligjore, duke mos u cenuar e drejta e tij procedurale.
Për rrjedhojë, grupi i auditimit vlerëson se vendimi i Komisionit të Ankimimit është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me ligjin nr. 111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore" dhe me vetë misionin e AKM-së për mbrojtjen e mjedisit dhe interesit publik.
Shfuqizimi i masës administrative ka sjellë jo vetëm heqjen e gjobës, por edhe dobësimin e masës urgjente për ndalimin e shkarkimeve dhe rehabilitimin e zonës së ndotur, duke vënë në rrezik mjedisin, shëndetin publik dhe interesin e komunitetit. Në këtë kuadër, një mospërmbushje procedurale nuk mund të prevalojë mbi mbrojtjen e mjedisit dhe interesit publik, të cilët mbrohen me ligj dhe Kushtetutë.
Për sa më sipër, shfuqizimi i masës administrative në vlerën 5,000,000 lekë është kryer në kundërshtim me pikën 2 të nenit 137 të Kodit të Procedurës Administrative, i ndryshuar, ku citohet

se: *"Organi epror, me akt administrativ refuzon ankimin nëse ai rezulton të jetë i papranueshëm apo i pabazuar".*
Komisioni i shqyrtimit të Ankimimit, i përbërë nga: znj. A. D Kryetar, z. K. A Anëtar , znj. N. N Anëtar , znj. A. Z Anëtar , znj. J. B, Anëtar.

9. Subjekti M. K me NIPT L.....O, me leje Mjedisi Tipi B me PN-1934-09-2023, ka marrë masë administrative gjobë në vlerën 500,000 lekë, nëpërmjet vendimit përfundimtar të inspektimit nr. AKM-TR-2024-000249-5, datë 11.11.2024, ku janw konstatuar problematika në drejtim të mosparaqitjes së raportit të monitorimit mjedisor nga subjekti në momentin e inspektimit, si dhe referuar informacionit të ardhur nga palë të treta dhe verifikimeve të kryera në terren nga inspektorët e ARM Tiranë, janë marrë mostra për analizë të ujërave në kanalin kullues që derdhet në det në zonën e Golemit, në kuadër të dyshimeve për ndotje të mundshme. Subjekti ka ankimuar vendimin me shkresën nr. 12285 prot., datë 21.11.2024, depozituar pranë AKM-së. Nga ana e subjektit pretendohet se ujërat e aktivitetit trajtohen në gropa septike të ndërtuara sipas kushteve të kërkuara dhe se largimi i tyre kryhet me subjekt të licencuar "G. W", në bazë të kontratës së bashkëpunimit të vënë në dispozicion.
Ky komision në vlerësim të ankimimit të subjektit, citon se: "...për procedurën e ndjekur nga grupi i inspektimit, konstatohet se procedura e Inspektimit, nuk është mbajtur sipas legjislacionit në fuqi për inspektimet, sipas të cilës, procedura e inspektimit kryhet me tabletë, online në sistemin "e Inspektimi". Komisioni i Ankimit vlerëson se procedura e inspektimit, është në kundërshtim me Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm, nr.25, datë 10.08.2018. **Kryetari dhe z. D. S. kanë nënshkruar "lënë në fuqi" në procesverbal.**
Nga auditimi konstatohet se ky vendim nuk mbështetet në prova dhe argumente të mjaftueshme ligjore. Nga auditimi rezulton se procesverbali i inspektimit nr. AKM-FR-2024-000203-2 është mbajtur në datë 18.09.2024 dhe vendimi përfundimtar nr. AKM-FR-2024-000203-5 është marrë në datë 16.12.2024, pra brenda afateve ligjore të përcaktuara në nenet 45 dhe 46 të ligjit nr. 10433/2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".
Konkretisht, neni 45 "Mbajtja dhe njoftimi i procesverbalit" citon: *"Procesverbali i inspektimit përmban, gjithashtu, informacion për të drejtën e subjektit të inspektimit që të paraqesë me shkrim apo me gojë shpjegimet apo kontestimet e tij për faktet dhe rrethanat e konstatuara në procesverbal, brenda një afati të përcaktuar nga inspektori, por jo më të shkurtër se 8 ditë nga data e njoftimit të procesverbalit, për paraqitjen e këtyre komenteve, si dhe organin ku paraqiten këto komente. Pas kalimit të këtij afati, vendimi përfundimtar mund të merret pa qenë i nevojshëm dëgjimi i mëtejshëm i subjektit të inspektimit. Shpjegimet apo kontestimet e subjektit janë pjesë e dosjes".*
Ndërsa neni 46 "Shqyrtimi dhe marrja e vendimit përfundimtar" citon: *"Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm, vendimi përfundimtar i inspektimit merret nga inspektori apo inspektorët që kanë kryer inspektimin, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të procesverbalit subjektit të inspektimit".*
Kuadri ligjor në fuqi për procedurën e inspektimit është përcaktuar drejtpërdrejt nga ligji nr. 10433/2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë". Konkretisht, Kreu VI i këtij ligji, përmes neneve 45 dhe 46, rregullon në mënyrë të plotë elementët procedurialë të inspektimit, duke përfshirë mbajtjen dhe njoftimin e procesverbalit, vendin e hartimit të tij, të drejtën e subjektit për kundërshtime, si dhe afatin për marrjen e vendimit përfundimtar.
Sa më sipër, ligji nuk e kushtëzon vlefshmërinë e procedurës së inspektimit me përdorimin e një mjeti teknik apo elektronik të caktuar, por me respektimin e elementëve thelbësorë proceduralë të parashikuar në nenet 45 dhe 46 të tij.

Në këto kushte, pretendimi për pavlefshmëri të procedurës së inspektimit, i bazuar vetëm në shkelje të Urdhrit nr. 25/2018, nuk qëndron, pasi aktet nënligjore nuk mund të prevalojnë mbi ligjin. Në përputhje me nenin 116 të Kushtetutës, aktet nënligjore duhet të jenë në përputhje me ligjin dhe nuk mund të vendosin kërkesa shtesë që kufizojnë apo ndryshojnë dispozitat ligjore.
Për sa më sipër shfuqizimi i masës administrative në vlerën 500,000 lekë është kryer në kundërshtim me pikën 2, nenin 137 të Kodit të Procedurës Administrative, i ndryshuar, ku citohet se: *"Organi epror, me akt administrativ refuzon ankimin nëse ai rezulton të jetë i papranueshëm apo i pabazuar".*
Komisioni i shqyrtimit të Ankimimit, i përbërë nga: znj. A. D, Kryetar, z. D. S, Anëtar, znj. A. Z, Anëtar, znj. F. M, Anëtar, znj. E. G, Anëtar.

10. Subjekti N me NIPT K.....I, me objekt aktiviteti *"Hoteleri-Turizëm"* me leje Mjedisi Tipi B me PN-7945-09-2014, ka marrë masë administrative gjobë në vlerën 2,000,000 lekë, nëpërmjet vendimit përfundimtar të inspektimit nr. AKM-FR-2023-000117-5 datë 31.08.2023, ku janë konstatuar problematika në drejtim të menaxhimit dhe shkarkimit të ujërave të ndotura në mjedisin ujor pritës, konkretisht në zonën bregdetare, ku është evidentuar shkarkim i ujërave të ndotura në det në afërsi të gropës septike, i dokumentuar me foto, video dhe deklarime në vend të personit përgjegjës të subjektit.
Subjekti ka ankimuar vendimin me shkresën nr. 8-28 prot., datë 29.09.2023, depozituar pranë AKM-së, duke pretenduar se disponon një sistem të plotë trajtimi të ujërave të ndotura përmes një gropë septike të betonizuar me disa nivele filtrimi, ku realizohet ndarja e pjesës së ngurtë dhe trajtimi i ujërave përpara shkarkimit në mjedisin ujor pritës. Gjithashtu, subjekti pretendon se kontrolli është kryer në mënyrë të parregullt dhe përtej kompetencave ligjore, duke argumentuar se për vlerësimin e ndotjes kërkohen analiza laboratorike dhe jo konstatime vizuale, si dhe duke iu referuar Urdhrit nr. 29, datë 30.05.2023 të Inspektoriatit Qendror.
Komisioni i shqyrtimit të ankimimit citon se: *"...subjekti ka paraqitur dokumentacion shtesë, konkretisht planimetrinë e gropës septike dhe kontratën për shërbimin e pastrimit me shoqërinë Baitel, datë 10.06.2022. Për sa i përket pretendimit të subjektit për mungesë provash mbi ndotjen, rezulton se grupi i inspektimit nuk ka arritur të dokumentojë në mënyrë të qartë dhe të mjaftueshme me foto dhe video elementin e ndotjes. Përsa i përket pretendimit për mungesë tagri ligjor të inspektorëve, ky pretendim nuk qëndron pasi grupi i inspektimit legjitimohet për kryerjen e inspektimeve në të gjitha subjektet, pavarësisht statusit të tyre në lidhje me lejen mjedisore, me qëllim mbrojtjen e mjedisit ujor."*
Në përfundim, Komisioni ka vendosur shfuqizimin e masës administrative, duke u bazuar në pikën 4 të nenit 137 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë".
Nga auditimi konstatohet se nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e inspektimit, konkretisht listës së verifikimit nr. AKM-FR-2023-000117-2/1, datë 31.08.2023, rezulton se trupa inspektuese ka konstatuar shkarkim të ujërave të ndotura në det në afërsi të gropës septike, i shoqëruar me deklarime në vend të përfaqësuesit të subjektit, si dhe me foto dhe video të realizuara gjatë inspektimit. Pretendimi i Komisionit se mungojnë provat filmike nuk qëndron, pasi ekzistenca e tyre konfirmohet në dokumentacionin zyrtar të inspektimit.
Nga analiza e procedurës së shqyrtimit të ankimimit rezulton se Komisioni nuk ka verifikuar dhe nuk ka analizuar në thelb provat materiale të administruara nga trupa inspektuese në terren, por është mbështetur në një vlerësim formal të pretendimeve të subjektit lidhur me mjaftueshmërinë e dokumentimit.

Në këto kushte, shfuqizimi i masës administrative është kryer në kundërshtim me pikën 2 të nenit 137 të Kodit të Procedurës Administrative, i ndryshuar, ku citohet se: *"Organi epror, me akt administrativ refuzon ankimin nëse ai rezulton të jetë i papranueshëm apo i pabazuar".*
Komisioni i shqyrtimit të Ankimimit, i përbërë nga: znj. A. D, Kryetar, z. K. A, Anëtar , znj. N. N, Anëtar, znj. A. Z, Anëtar, znj. J. B, Anëtar.

Për problematikat e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e Komisionit të Shqyrtimit dhe Kryetari (Titullari i AKM) sipas rasteve të trajtuara në këtë material, konkretisht: *znj. A. D Kryetar, z. K. A Anëtar, znj. N. N Anëtar, znj., J. B Anëtar, znj. E. M Anëtar, z. D. S, Anëtar, znj. E. O, Anëtar, z. E. P, Anëtar, znj. A. Z, Anëtar, znj. F. M, znj. E. Gj.*

Nga AKM, konkretisht firmosur nga znj. A. Z dhe z. N. P, është dërguar observacion pa nr prot., dhe pa datë, protokolluar në KLSH me nr. 769/90 prot., datë 27.04.2026, dhe gjithashtu observacioni me nr. prot 3983/4 datë 27.04.2026 protokolluar në KLSH me nr. 769/91 prot., datë 08.05.2026, firmosur nga znj. A. Z dhe znj. N. N, me të njëjtën përmbajtje, si në vijim:
Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimin për afatet e ankimimit dhe mosrespektimin e afatit të shqyrtimit ashtu si edhe është përmendur në Observacionin mbi Akt Konstatimin nr. 6 me nr. 2564/1 prot., datë 06.02.2026, Referuar Kodit të procedurave Administrative: Neni 56 Llogaritja e afateve 1. Përveç kur parashikohet ndryshe nga ligji, afatet caktohen në ditë, muaj ose vite. Përfundimi i afatit mund të përcaktohet edhe me një datë të caktuar kalendarike. 2. Kur afati caktohet në ditë, në llogaritjen e tij përjashtohet dita kur ka ndodhur ngjarja, nga e cila fillon të ecë afati. 3. Afati i përcaktuar në muaj ose vite mbaron me kalimin e asaj dite, atij muaji apo atij viti të fundit, që ka të njëjtin numër me atë të ditës, në të cilën ka ndodhur ngjarja nga e cila ka filluar të ecë afati. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit, afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji. 4. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e 1 punës që vjen pas saj. 1. 2. Neni 91 Afati për përfundimin e procedurës administrative 1. Procedura administrative, e nisur me kërkesë, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, përfundon sa më shpejt të jetë e mundur dhe brenda afatit të përcaktuar nga ligji i posaçëm. Neni 92 Zgjatja e afatit të procedurës 1. Përveç kur ndalohet shprehimisht nga ligji, në raste të justifikuara, për shkak të kompleksitetit të çështjes, organi publik mund të zgjasë vetëm një herë afatin e përcaktuar sipas nenit 91 të këtij Kodi. 2. Zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar. Neni 132 Afatet e ankimit administrativ ndaj aktit administrativ 1. Ankimi administrativ ndaj aktit administrativ duhet të paraqitet brenda 30 ditëve nga data kur ankuesi ka marrë njoftim për nxjerrjen ose refuzimin e nxjerrjes së aktit administrativ. Neni 155 Njoftimi nëpërmjet postës 1. Njoftimi me postë bëhet nëpërmjet postës së thjeshtë apo të porositur. 2. Për efekt të këtij Kodi, një shkresë, dërguar me postë të thjeshtë apo të porositur, vlerësohet e njoftuar në ditën e tretë nga data e postimit të dokumentit për adresat brenda Republikës së Shqipërisë, dhe ditën e pestë për adresat jashtë territorit të vendit. 3. Pika 2, e këtij neni, nuk zbatohet nëse marrësi provon se dokumenti nuk është marrë, apo është marrë në një ditë të mëvonshme. Ligji nr.19433 / 2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" Neni 51 Ankimi ndaj vendimit përfundimtar të inspektimit Ankimi administrativ kundër vendimeve përfundimtare në fushën e inspektimit paraqitet dhe shqyrtohet sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm "Organi epror", sipas Kodit të Procedurave Administrative, është një njësi apo trupë kolegjiale ankimi, posaçërisht e krijuar brenda inspektoratit shtetëror, organit të varësisë, pjesë e të cilit është inspektorati shtetëror, apo njësisë vendore përkatëse dhe që ka në përbërje nëpunës të pavarur nga ata të përfshirë në marrjen e vendimit të ankimuar. 3. Organizimi i organit epror, sipas pikës 2 të këtij neni; për çdo inspektorat shtetëror përcaktohet nga Këshilli i Ministrave. Për inspektimet në juridiksionin e qeverisjes vendore, përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, organizimi i organit epror përcaktohet nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore përkatëse. 2 4. Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji i posaçëm, paraqitja e ankimit administrativ pezullon ekzekutimin e vendimit përfundimtar të ankimuar, por nuk cenon ekzekutimin e masave urgjente të marra sipas nenit 43 të këtij ligji. Referuar kuadrit ligjor përmendur sa më lart, për llogaritjen e afateve të marrjes/pranimit të ankimit dhe marrjes në shqyrtim të ankimimeve administrative ndaj Vendimit Përfundimtar të Inspektimit (VPI) nga AKM dhe Komisioni i Ankimimeve (KA) janë respektuar dispozitat ligjore pasi janë verifikuar dokumentet si praktika e inspektimit, njoftimet zyrtare, letër marrjet nga posta që vërtetojnë marrjen dijeni të subjektit si dhe çdo dokument tjetër shtesë që AKM dhe KA, ka vlerësuar të domosdoshëm sipas çështjes konkrete. Referuar tabelës me 13 subjekte/çështje të konstatuara në mosrespektim të këtyre afateve faqe 408, sqarojmë se: Në çdo rast nga Komisioni është argumentuar

shtyrja e afatit dhe nuk e ka kaluar afatin maksimal 60 ditë nga ankimimi. KPA është respektuar dhe kjo është e dokumentuar me procesverbalet që gjenden në dosjen e shqyrtimit (bashkëlidhur këtij observacioni si dokument provues "V. H", "K. I", "A", "W. P", "B B&B", "A. K", "A. K", "S. R. F", etj). Në përfundim, sqarojmë se në çdo rast nga Komisioni është respektuar kuadri ligjor në fuqi dhe në asnjë rast nuk janë tejkaluar afatet për shqyrtimin e ankimeve. Gjithashtu, sqarojmë se: Zbatimi i Urdhrit nr. 25, datë 10.08.2018, "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ", i ndryshuar, për sa kohë bie ndesh me ligjin mbi bazën e të cilit është nxjerrë, për atë pjesë që bie ndesh është i pazbatueshëm në raport me besueshmërinë, sigurinë juridike dhe ligjshmërinë e dispozitave të një ligji. Urdhri nr. 25 në Kreun VII bie ndesh me Ligjin nr.10433/2011 dhe KPA. Në lidhje me zbatueshmërinë e ligjit për inspektimin dhe përputhja me aktet nënligjore është detyrë e institucioneve qendrore dhe rregullatorë të proceseve administrative (Inspektorati Përgjithshëm, Ministria etj). Këto institucione vendosin rregullat për zbatimin e legjislacionit dhe mjetet/pajisjet e përshtatshme për inspektorët për ta realizuar procesin në mënyrë optimale dhe transparente për subjektin dhe organin publik, me qëllim rritjen e performancës për një proces të rregullt administrativ. Referuar nenit 116 të Kushtetutës, korniza e akteve normative (aktet ligjore që miratohen nga Parlamenti dhe shpallen me Dekret Presidenti), të renditura sipas rëndësisë dhe hierarkisë janë: Kushtetuta, Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, Ligjet, Aktet normative të Këshillit të Ministrave.

Rendi juridik është një sistem hierarkik dhe përbëhet nga nivele të ndryshme vlefshmërie dhe në secilin prej këtyre niveleve qëndron një normë / grup normash duke përftuar edhe fuqinë e caktuar juridike. Piramida e akteve normative, e kryesuar nga Kushtetuta, përcakton marrëdhëniet midis normave juridike të cilat bazohen në raportin e mbi/nën vendosjes së tyre dhe shërben si burim për aktet e tjera juridike.

Aktet nënligjore të nxjerra nga institucionet përputhje me aktet më shtetërore të autorizuara me ligj duhet të jenë të larta juridike në formë dhe në përmbajtje (kuptimi material). Për subjektin "V. H" shqyrtimi i ankimit është realizuar brenda afateve (bashkëlidhur). Në tabelë paraqitja e është ankimit paraqitur data gabim, pasi data e vendimit të inspektimit është 6.3.2024 dhe është brenda afateve ligjore (3:4.2024).

Në lidhje me konstatitmet e grupit të auditimit për Subjektet "A" "M. K" "S" "T. O. S" "N", për të cilat nga Komisioni janë konstatuar parregullsi në zbatimin e legjislacionit për sa i përket procedurës dhe akteve të mbajtura nga grupi i inspektimit sqarojmë pari: Kuptimi dhe roli i procedurës administrative Procedura administrative përbën mekanizmin ligjor përmes të cilit administrata publike ushtron funksionet e saj vendimmarrëse, duke garantuar respektimin e ligjit, transparencën dhe mbrojtjen e shtetit të drejtave të subjekteve. Ajo nuk *ë*shtë një formalitet teknik, por një garanci thelbësore e të së drejtës. Zbatimi i saktë i procedurës administrative siguron që: vendimmarrja administrative të jetë e ligjshme dhe e arsyetuar; subjektet e interesuara të kenë mundësi reale për të marrë pjesë në proces; administrata të shmangë arbitraritetin dhe diskrecionin e pakufizuar. Procedura administrative është mjeti përmes të cilit parimet kushtetuese dhe ligjore përkthehen në veprim konkret administrativ.

Parimet themelore që realizohen përmes procedurës administrative.

Zbatimi korrekt i procedurës administrative garanton respektimin e disa parimeve themelore, ndër më kryesoret:

Parimi i ligjshmërisë – çdo veprim apo akt administrativ duhet të mbështetet në ligj;

Parimi i drejtësisë dhe barazisë - subjektet trajtohen në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim; Parimi i pjesëmarrjes - palët kanë të drejtë të dëgjohen dhe të paraqesin prova apo pretendime; Parimi i transparencës dhe i arsyetimit - vendimi duhet të jetë i qartë, i kuptueshëm dhe i motivuar; Parimi i proporcionalitetit - masa administrative duhet të jetë e përshtatshme dhe domosdoshme ndaj qëllimit të ndjekur.

Mosrespektimi i këtyre parimeve e bën vendimmarrjen administrative të cënueshme ligjërisht. Rëndësia e nxjerrjes së aktit administrativ Akti administrativ është produkti përfundimtar i procedurës administrative dhe mjeti kryesor përmes të cilit administrata shpreh vullnetin e saj juridik. Rëndësia e tij qëndron në faktin se: krijon, ndryshon ose shuan të drejta dhe detyrime për subjektet; ka efekte juridike të drejtpërdrejta dhe konkrete; përfaqëson përgjegjësinë ligjore të organit që e nxjerr. Nxjerrja e aktit administrativ duhet të jetë rezultat i një procedure të rregullt, pasi akti nuk mund të shkëputet nga procedura që e ka prodhuar.

Procedura administrative dhe akti administrativ janë të lidhura organikisht: një akt i marrë pa ndjekur procedurën e parashikuar nga ligji konsiderohet i paligjshëm; shkeljet procedurale (mungesë njoftimi, mosdëgjim i palëve, mungesë arsyetimi, tejkalim kompetence, etj) janë shkak për pavlefshmëri ose shfuqizim të aktit; gjykatat administrative dhe organet e mbikëqyrjes i kushtojnë rëndësi qendrore respektimit të procedurës. Pra, edhe nëse qëllimi i aktit është i drejtë, mungesa e procesit të rregullt administrativ cënon vlefshmërinë e tij.

Pasojat e moszbatimit të procedurës administrative:

Mosrespektimi i procedurës administrative sjell pasoja serioze, si: anulimi ose shfuqizimi i aktit administrativ nga organet më të larta apo gjykata; krijimi i barrës financiare për institucionin (dëmshpërblime, procese gjyqësore); cenimi i besimit të qytetarëve tek administrata; rrezik për përgjegjësi disiplinore dhe administrative të punonjësve publikë.

Moszbatimi i procedurës administrative ndikon drejtpërdrejt dhe thelbësisht në cilësinë, ligjshmërinë dhe vlefshmërinë

e vendimmarrjes administrative. Procedura administrative është pjesë përbërëse e ligjshmërisë së veprimit administrativ. Kur ajo nuk zbatohet vendimi merret në kundërshtim me ligjin; tejkalohen apo ushtrohen gabimisht kompetencat; akti administrativ humbet bazën e tij juridike. Vendimmarrja bëhet formalisht dhe materialisht e paligjshme, edhe nëse qëllimi ka qenë i drejtë. Vendimi mund të rrëzohet edhe pa u shqyrtuar përmbajtja e tij. Subjektet, preken drejtpërdrejt në të drejtat e tyre dhe vendimmarrja perceptohet si e padrejtë, edhe nëse formalizon interesin publik. Këto pasoja tregojnë se respektimi i procedurës është edhe një mjet mbrojtës për vetë administratën. Në praktikën e përditshme institucionale, zbatimi korrekt i procedurës administrative dhe nxjerrja e rregullt e akteve administrative: rrit cilësinë e vendimmarrjes; forcon sigurinë juridike; krijon standarde të qëndrueshme dhe të parashikueshme; minimizon konfliktet administrative dhe gjyqësore. Procedura administrative garanton mbledhjen dhe vlerësimin e fakteve, provave dhe pretendimeve të palëve. Kur ajo nuk zbatohet, vendimi merret mbi informacion të pjesshëm ose të paplotë, nuk peshohen interesat publike dhe private, rritet rreziku i vendimmarrjes arbitrare. Pra, Vendimmarrja humbet objektivitetin dhe balancën ligjore. Në rastin konkret, në fusha të ndjeshme si inspektimi, respektimi i procedurës është kusht thelbësor për legjitimitetin e çdo ndërhyrjeje administrative. Në përfundim, procedura administrative dhe akti administrativ janë shtyllat kryesore të veprimtarisë së administratës publike. Respektimi i procedurës nuk është një pengesë, por një garanci për ligjshmëri, drejtësi dhe efikasitet. Çdo akt administrativ i nxjerrë në zbatim të rregullt të procedurës përforcon shtetin e së drejtës, mbron interesin publik dhe siguron mbrojtjen e të drejtave të individëve. Anëtarët e Komisionit të Ankimeve në vlerësimin e tyre individual janë referuar tek këto arsyetime dhe argumente si dhe tek provat e administruara duke i dhënë zbatimit të procedurës administrative një rëndësi të veçantë, e cila është paraqitur rast pas rasti në procesverbalet që arsyetojnë dhe shoqërojnë vendimmarrjen e Komisionit, por edhe në observacionet e paraqitura mbi Akt Konstatimin nr. 6 me nr. 2564/1 prot, datë 06.02.2026, qëndrime të cilat vlerësoj duhet të merren parasysh. Referuar Rekomandimeve nr. 10, 11, 12 në Projekt Raport ju bëj me dije gjithashtu se me hyrjen në fuqi (Maj të vitit 2025) të ligjit nr. 99/2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM Nr. 407, datë 16.7.2025 *"Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisionit të shqyrtimit të ankimit"* Komisioni i Ankimimeve në AKM nuk e ushtron më veprimtarinë, dhe si rezultat në muajin Qershor 2025 është mbajtur Komisioni i fundit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Observacioni i paraqitur është i njëjti i dërguar mbi akt konstatimin, për të cilin grupi i auditimit e ka sqaruar qëndrimin me detaje dhe e ka trajtuar në Projekt Raport. Për sa më sipër duke qenë se nuk ka ndryshime apo evidenca të reja, trajtimi i materialit mbetet i njëjtë në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ndryshimet e miratuara me ligjin nr. 99/2024 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"* kanë sjellë mospërputhje me legjislacionin e posaçëm mjedisor, në lidhje me vendosjen e masave administrative. Konkretisht, në ligjin nr. 10433/2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* në nenin 48, parashikohej se masa *"paralajmërim"* zbatohej vetëm në rastet e shkeljeve me rëndësi të vogël ose kur ligji i posaçëm nuk parashikonte sanksion përkatës, ndërsa në rastet e tjera zbatoheshin drejtpërdrejtë masat administrative të përcaktuara në ligjet e posaçme.

Ndërkohë, me ligjin nr. 99/2024*"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, neni 44 *"Dënimi administrativ kryesor"* parashikon vendosjen e masës *"paralajmërim"* si masë kryesore në inspektimin e parë, në të gjitha rastet e konstatuara si kundërvajtje administrative, duke kufizuar aplikimin e drejtpërdrejtë të sanksioneve të tjera, përveç rasteve të shkeljeve të rënda.

Në këto kushte, aplikimi i kësaj dispozite në mënyrë të përgjithshme bie në kundërshtim me ligjet e posaçme mjedisore, të cilat parashikojnë masa konkrete administrative për shkelje të caktuara, si: ligji nr. 10448/2011 *"Për lejet e mjedisit",* neni 29; ligji nr. 10431/2011 *"Për mbrojtjen e mjedisit"*, neni 69; ligji nr. 10463/2011 *"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"*, neni 62; ligji nr. 29/2024 *"Për burimet ujore",* neni 169.

Për rrjedhojë, mungesa e harmonizimit ndërmjet ligjit të përgjithshëm të inspektimit dhe legjislacionit të posaçëm krijon paqartësi në zbatim, rrezik për interpretim të gabuar nga strukturat zbatuese dhe cenon zbatimin efektiv të masave administrative në fushën e mjedisit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 163-303 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
1.1 Rekomandim: Ministria përgjegjëse për Mjedisin, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për inspektimin, të marrë masa për rishikimin dhe harmonizimin e dispozitave ligjore apo nënligjore, me qëllim që vendosja e masave administrative të mos kufizohet vetëm në "*paralajmërim*" në inspektimin e parë, por të garantohet zbatimi i sanksioneve të përcaktuara në ligjet specifike sipas natyrës dhe rëndësisë së shkeljes.
Gjithashtu, të saktësohet në mënyrë të qartë në kuadrin ligjor dhe/ose në akte nënligjore interpretimi dhe zbatimi i kësaj dispozite, duke përcaktuar raportin ndërmjet ligjit të përgjithshëm të inspektimit dhe ligjeve të posaçme, me qëllim shmangien e interpretimeve të ndryshme dhe sigurimin e një zbatimi të njëtrajtshëm nga strukturat inspektuese.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi, konstatohet mospërputhje ndërmjet dispozitave të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"* dhe akteve nënligjore përkatëse në lidhje me afatet e shqyrtimit të ankimimeve. Konkretisht, neni 51, pika 1 e këtij ligji parashikon se ankimi administrativ ndaj vendimeve përfundimtare shqyrtohet sipas dispozitave të ligjit nr. 44/*2015 "Kodi i Procedurave Administrative i RSH",* i ndryshuar, i cili në nenin 140 përcakton një afat deri në 30 ditë nga paraqitja e ankimit për nxjerrjen dhe njoftimin e aktit që zgjidh ankimin, me mundësi shtyrjeje në raste të justifikuara.
Në kundërshtim me këtë përcaktim, Urdhri nr. 25, datë 10.08.2018 *"Për miratimin e rregullores për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ",* parashikon se procesverbali dhe vendimi përfundimtar njoftohen brenda 24 orëve, ndërsa subjekti ka të drejtë të paraqesë ankim brenda 15 ditëve nga nënshkrimi i tyre. Gjithashtu, Komisioni i Shqyrtimit të Ankimimit e shqyrton ankimin brenda 15 ditëve nga depozitimi, por jo më vonë se 30 ditë nga data e nënshkrimit të procesverbalit dhe vendimit përfundimtar.
Kjo mospërputhje ndërmjet akteve ligjore dhe nënligjore ka krijuar paqartësi në zbatimin e afateve procedurale, duke sjell rrezik për interpretim të ndryshëm nga autoritetet administrative, si dhe mund të cenojë të drejtat e subjekteve të inspektuara në procesin e ankimit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 163-303 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
2.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me qëllim rishikimin dhe harmonizimin e Urdhrave me aktet nënligjore në fuqi lidhur me afatet e shqyrtimit të ankimimeve, me qëllim eliminimin e mospërputhjeve dhe garantimin e një kuadri të qartë dhe të unifikuar për zbatimin e procedurave administrative.

Menjëherë

C. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i procedurës së shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për pajisje me leje mjedisore nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për një kampion prej 10 praktikash të dhënies së lejeve mjedisore të tipit A dhe B gjatë periudhës objekt auditimi, u konstatuan mangësi në plotësinë e dokumentacionit të paraqitur nga subjektet dhe në verifikimin e tij nga strukturat përgjegjëse. Konkretisht, në plotësinë e dokumentacioneve sipas shtojcave 1 dhe 2 të VKM-së nr. 419, datë 25.06.2014 "*Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e*

kërkesave për leje mjedisi të tipave A dhe B", i ndryshuar, u konstatuan këto mangësi:
- Në 1 rast, konkretisht shoqëria *"F. P"* SHPK me Nipt: L.....O, në kundërshtim me shtojcën 2, pika 2 të formularit për leje mjedisi tipi B "*Përshkrimi i instalimit, njësitë e tij teknike dhe aktivitetet/veprimtaritë e lidhura drejtpërdrejtë me të*", ka bashkëlidhur kontratën e qirasë me nr. 887 rep dhe nr. 665/3 kol, datë 19.07.2017, e cila rezultoi e përfunduar në periudhën e shqyrtimit dhe vendimmarrjes për dhënien e lejes mjedisore, duke mos provuar të drejtën e përdorimit të instalimit gjatë procesit të aplikimit;
- Në 3 raste, konkretisht nga subjektet *"F. P"* SHPK me Nipt: L.....O, *"B. P. L"* me Nipt: K.....L, *"N. dhe M"* me Nipt: K.....V, në kundërshtim me kërkesat e pikës 10 "*Programi i përmirësimit*", në propozimin për programin e përmirësimit të funksionimit të instalimit dhe mbrojtjen e mjedisit nuk janë parashikuar vlerësimet financiare për masat e propozuara;
- Në 1 rast, nga subjekti *"F. P"* SHPK me Nipt: L.....O, në kundërshtim me kërkesat e Aneksit 12, nuk është bashkëlidhur asnjë masë ekzistuese apo e propozuar për reduktimin e ndikimit në mjedis pas ndërprerjes së aktivitetit në instalim, duke përfshirë masat për menaxhimin e mbetjeve të mundshme ndotëse pas mbylljes së instalimit;
- Në 2 raste, konkretisht nga subjektet *"T. O. S"* me Nipt: L.....I dhe *"B. A"* me Nipt: L.....G në kundërshtim me shtojcën 1, pika 5.2 "*Menaxhimi i mbetjeve të ngurta*", nuk është plotësuar tabela *"5.2.1 Rikuperimi/Asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme";*
- Në 1 rast, konkretisht nga subjekti *"T. O. S"* me Nipt: L.....I, nuk rezultoi e plotësuar tabela 6.1.4 *"Shkarkimet kryesore në ajër",* sipas kërkesave të formularit të aplikimit;
- Në 3 raste, konkretisht nga subjektet *"B. P. L"* me Nipt: K.....L, *"V. C"* SHPK me Nipt: L.....U dhe *"B. A"* me Nipt: L.....G në kundërshtim me shtojcën 1, pika 4 "*Substancat e rrezikshme*", në tabelën 4.1.1 nuk janë specifikuar kodet e riskut për secilën substancë të rrezikshme;
- Në 2 raste, konkretisht nga subjektet *"N. dhe M"* me Nipt: K.....V dhe *"Gl"* me Nipt: L.....B, në kundërshtim me kërkesat e aneksit të formularit "*Përshkrimi i instalimit, njësitë e tij teknike dhe aktivitetet/veprimtaritë e lidhura drejtpërdrejtë me të*", nuk janë bashkëlidhur skicat e instalimit;
- Në 1 rast, konkretisht nga subjekti *"G"* me Nipt: L.....B plani/projekti i paraqitur mban datë 08.06.2018, pra rreth 5 vite para paraqitjes së kërkesës për pajisje me leje mjedisore tipi B, ç'ka ngre dyshime mbi aktualitetin e dokumentacionit teknik të paraqitur;
- Në 1 rast, në pikën 5 "*Menaxhimi i materialeve*", subjekti *"B. D"* me Nipt K.....O ka deklaruar se ka lidhur kontratë për evadimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore me subjektin "*V. R*" SHPK, e nënshkruar në datë 10.01.2022, por në dokumentacionin e bashkëlidhur mungon afati i përfundimit të kontratës.

Mangësitë e konstatuara tregojnë se strukturat përgjegjëse të AKM nuk kanë kryer në mënyrë të plotë dhe efektive verifikimin administrativ dhe teknik të dokumentacionit të paraqitur nga subjektet gjatë shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore. Si pasojë, krijohet risk që vendimmarrja për pajisjen me leje mjedisore të mbështetet në dokumentacion të paplotë ose jo të përditësuar, duke dobësuar besueshmërinë dhe efektivitetin e procesit të vlerësimit mjedisor.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 65-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisore pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit të marrë masa për forcimin e procesit të verifikimit administrativ dhe teknik të dokumentacionit të paraqitur nga subjektet gjatë shqyrtimit të kërkesave për pajisje me leje mjedisore, duke garantuar që praktikat e aplikimit të jenë të plota, të përditësuara dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe teknike në fuqi, përpara paraqitjes së tyre për vendimmarrje në komision.

1.2 Rekomandimi: Drejtoria e Inspektimit dhe Kontrollit të marrë masa për përfshirjen në planin vjetor të inspektimeve të subjekteve për të cilat janë evidentuar mangësi gjatë procesit të dhënies

së lejeve, me qëllim verifikimin në terren të respektimit të kushteve të lejes dhe identifikimin e ndikimeve apo parregullsive të mundshme në zbatim.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi shlyerjen e tarifave të subjekteve të pajisura me leje mjedisore të tipit A dhe B, u konstatua se nuk disponohet një databazë e plotë, e unifikuar dhe e besueshme për evidencën e subjekteve dhe detyrimeve përkatëse. Nga verifikimet e kryera mbi të dhënat e paraqitura nga AKM, rezultuan pasaktësi dhe mangësi, duke përfshirë regjistrime të dubluara, mospërputhje me informacionin e sektorëve të tjerë, si dhe raste ku pagesat e kryera nuk reflektoheshin në listën e debitorëve, në kundërshtim me pikën c të nenit 5, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2017 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar.
Në mungesë të një sistemi të konsoliduar, u analizua databaza e shkresave të dërguara nga AKM email-in e datës 21.01.2026, nga e cila rezultoi se për 748 njoftime për një vlerë totale prej 12,640 mijë lekë janë likuiduar 1,235 mijë lekë. Megjithatë, nga këto vetëm 666 NIPT-e rezultojnë unike, ndërsa 82 raste janë të dubluara, çka tregon mungesë kontrolli mbi cilësinë dhe integritetin e të dhënave. Në këto kushte, të dhënat nuk përfaqësojnë në mënyrë të besueshme gjendjen reale të subjekteve debitorë dhe krijojnë risk për raportim jo të saktë të detyrimeve. Mungesa e një databaze të integruar kufizon aftësinë e AKM për të monitoruar në mënyrë efektive pagesën e tarifave dhe për të identifikuar në kohë rastet e mos pagesës, duke riskuar mos zbatimin e masave ligjore për pezullimin apo shfuqizimin e lejeve mjedisore.
Veprime këto në kundërshtim me VKM nr.417, datë 25.6.2014, *"Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit"* dhe nenin 27, pika 1/1, shkronja (d) të ligjit nr. 10448/2011 "*Për lejet e mjedisit*", të ndryshuar, sipas të cilit mos pagesa e tarifës së lejes së mjedisit përbën shkak për pezullimin e lejes, duke krijuar riskun që masat administrative të parashikuara nga ligji, deri në pezullim apo shfuqizim të lejes, të mos aplikohen në mënyrë të plotë dhe në kohë ndaj subjekteve që nuk përmbushin detyrimet përkatës.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3. faqet nr. 65-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
2.1. Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit nëpërmjet strukturës së Financës, të ngrejë një grup pune për verifikimin dhe rakordimin e plotë të databazës së subjekteve me leje mjedisore të tipit A dhe B, me qëllim evidentimin e saktë të subjekteve debitorë, eliminimin e rasteve të dubluara, rakordimin e detyrimeve me pagesat e kryera dhe krijimin e një evidence të unifikuar dhe të besueshme për monitorimin e tarifave të lejeve mjedisore.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të administrimit dhe verifikimit të raporteve të vetë monitorimit për zbatimin e kushteve të lejeve mjedisore rezultoi se administrimi dhe ndjekja e të dhënave nuk kryhet në mënyrë të plotë dhe të standardizuar. Të dhënat mbahen manualisht në formate Excel të pa unifikuara ndërmjet sektorëve dhe nuk përmbajnë elementët bazë për ndjekjen e detyrimeve ligjore të subjekteve, si afatet e raportimit, statusin e dorëzimit, rastet e vonesave apo mos raportimit dhe masat administrative të ndërmarra.
Gjithashtu, u konstatuan mospërputhje në evidentimin e lejeve mjedisore aktive ndërmjet sektorit të lejeve mjedisore dhe sektorit të monitorimit, duke krijuar pasaktësi në identifikimin e detyrimeve të subjekteve dhe rrezik në planifikimin e inspektimeve. Mungon evidencë e plotë mbi masat administrative në rastet e vonesave apo mos raportimit, duke pamundësuar verifikimin e ndjekjes së njëtrajtshme dhe në kohë të shkeljeve.
Kjo situatë është në kundërshtim me pikën 2 të nenit 23 të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 "*Për lejet e mjedisit*", i ndryshuar, sipas të cilit informacioni që i jepet Agjencisë Kombëtare të Mjedisit

nga operatorët nëpërmjet procesit të vetë monitorimit duhet të administrohet në mënyrë të tillë që të mund të përdoret për evidentimin e përgjegjësisë administrative apo ligjore të operatorëve. Nga auditimi rezultoi gjithashtu se mungon informacioni mbi masat administrative të marra në rast vonese ose mos raportimi, duke krijuar pamundësi për të verifikuar nëse rastet e shkeljeve janë ndjekur në mënyrë të njëtrajtshme dhe në kohë.
Si pasojë e mungesës së një databaze të unifikuar dhe të strukturuar, informacioni mbi raportet e vetë monitorimit rezulton i pakoordinuar dhe i pa standardizuar ndërmjet sektorëve, çka e bën të vështirë krahasimin dhe analizën e të dhënave. Në këto kushte dobësohet gjurmueshmëria e procesit të monitorimit, kufizohet aftësia e institucionit për të kryer analiza të sakta të riskut dhe rritet risku për planifikim jo efektiv të inspektimeve ndaj subjekteve që nuk përmbushin detyrimet e raportimit. Për rrjedhojë, databazat e përdorura nuk përmbushin funksionin e tyre si instrument bazë për ndjekjen e detyrimeve ligjore, vlerësimin e riskut dhe mbështetjen e vendimmarrjes institucionale.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3. faqet nr. 65-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
3.1. Rekomandim: Sektori i Shqyrtimit dhe Monitorimit të Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve, të marrë masa për krijimin dhe funksionimin e një databaze të unifikuar dhe të përditësuar për lejet mjedisore aktive dhe raportet e vetë monitorimit, e cila të përmbajë elementët bazë të ndjekjes së detyrimeve (afatet e raportimit, statusin e dorëzimit, rastet e vonesave/mos raportimit dhe masat administrative).

Brenda vitit 2026

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të verifikimit të raporteve të vetë monitorimit të subjekteve të pajisura me leje mjedisore të tipit A dhe B rezultoi se nuk sigurohet ndjekje e plotë dhe efektive e përmbushjes së detyrimeve të raportimit. U konstatuan raste të mosdorëzimit të dokumentacionit të kërkuar, si dhe raporte të paplota ose me mangësi formale dhe në përmbajtje. Nga verifikimi i komunikimeve shkresore rezultoi se AKM ka njoftuar 56 subjekte, sipas tabelës nr. 7, Aneksi nr. 1, për mosdorëzim të dokumentacionit ose të raporteve të vetë monitorimit,
Gjithashtu, u evidentuan mangësi konkrete në cilësinë e raportimit, përfshirë raste ku raportet vjetore nuk përmbanin të dhëna të plota mbi menaxhimin e mbetjeve, dokumentacion i dorëzuar në format CD pa përmbajtjen e raporteve të vetë monitorimit, si dhe pasaktësi në identifikimin e lejeve mjedisore të subjekteve raportuese.
Si pasojë e këtyre mangësive dobësohet gjurmueshmëria e procesit të vetë monitorimit, kufizohet mundësia për evidentimin në kohë të shkeljeve, rritet rreziku për planifikim jo efektiv të inspektimeve dhe për ushtrim jo të plotë të funksionit mbikëqyrës ndaj subjekteve që nuk përmbushin detyrimet e tyre të raportimit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3. faqet nr. 65-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
4.1. Rekomandim: Sektori i Shqyrtimit dhe Monitorimit të Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve të marrë masa për garantimin e ndjekjes sistematike dhe të dokumentuar të përmbushjes së detyrimeve të raportimit nga subjektet e pajisura me leje mjedisore, si dhe për administrimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të informacionit mbi rastet e mos raportimit apo raportimit të paplotë. Në të gjitha rastet kur raportet dorëzohen të paplota, të njoftohet Drejtoria e Inspektimit dhe Kontrollit dhe të iniciohen inspektime për verifikimin e përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në lejen mjedisore dhe legjislacionin në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, në dokumentacionin e administruar nga Sektori i Monitorimit të Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve, nuk evidentohej informacion mbi zbatimin e

kushtit nr. 8 “Menaxhimi i mbetjeve” nga subjektet e pajisura me leje mjedisore të tipit A dhe B, me argumentin se ndjekja e këtij kushti nuk përfshihet në detyrat e veta funksionale.
Nga shqyrtimi i kuadrit rregullator rezultoi se ky qëndrim nuk është i bazuar, pasi sipas Rregullores nr. 120, datë 12.01.2021 “*Rregullore e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit*”, Sektori i Monitorimit të Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve ka detyrimin të ndjekë mirëmbajtjen dhe përditësimin e databazës së dokumentacionit të dorëzuar nga subjektet e lejeve mjedisore, të menaxhojë dokumentacionin e dërguar nga subjektet dhe të hartojë informacion për subjektet që nuk raportojnë sipas kushteve të lejes mjedisore, ndërsa sipas Urdhrit nr. 92, datë 02.05.2024 “*Për procedurën e dorëzimit/pranimit të dokumenteve dhe raporteve të vetë monitorimit për subjektet e pajisura me vendim për VNM paraprake, Deklaratë Mjedisore, Leje Mjedisi të Tipit A ose B”* ky sektor ka detyrimin të kontrollojë dhe verifikojë dokumentacionin dhe raportet e vetë monitorimit në përputhje me kushtet e aktit të miratuar, të kërkojë plotësim dokumentacioni në rast mangësish dhe të mos pranojë për shqyrtim dokumentacionin që nuk përmbush kërkesat e përcaktuara.
Nga verifikimet në sistemin e-inspektimit rezultoi se për 19 subjekte, sipas sipas tabelës nr. 8, Aneksi nr. 1, të njoftuara për mos raportim nuk është planifikuar inspektim në terren brenda vitit të konstatimit apo në vitin pasardhës, duke mos u garantuar verifikimi i zbatimit të kushtevetë lejes mjedisore.
Në këto kushte, mos administrimi dhe mosvënia në dispozicion e informacionit mbi zbatimin e këtij kushti përbën mos përmbushje të funksioneve të përcaktuara në kuadrin rregullator dhe veprime në mospërputhje me procedurat në fuqi, duke krijuar mungesë gjurmueshmërie të informacionit, dobësim të mekanizmave institucionalë të kontrollit dhe rrezik për mos identifikimin në kohë të mospërputhjeve nga subjektet e pajisura me leje mjedisore.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3. faqet nr. 65-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
5.1. Rekomandim: Titullari i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit të vlerësojë problematikën e konstatuar lidhur me mosadministrimin dhe mosverifikimin sistematik të të dhënave mbi zbatimin e kushtit nr. 8 *“Menaxhimi i mbetjeve”* nga Sektori i Monitorimit të Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve, si dhe të marrë masa për forcimin e mekanizmave të brendshëm të kontrollit, qartësimin e përgjegjësive funksionale dhe garantimin e zbatimit efektiv të detyrave të përcaktuara në kuadrin rregullator në fuqi.
5.2 Rekomandim: Drejtoria e Inspektimit dhe Kontrollit të marrë masa për planifikimin dhe kryerjen e inspektimeve në terren ndaj subjekteve të konstatua me mosraportim të të dhënave, me qëllim verifikimin e zbatimit të kushteve të lejes mjedisore.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi administrimin dhe raportimin e transfertave të mbetjeve për subjektet e pajisura me licencë III.2.B., sipas të dhënave të vendosura në dispozicion nga AKM, konstatohet se procesi i raportimit dhe ndjekjes së këtij aktiviteti paraqet mangësi. Nga analiza e regjistrit të transfertave rezultoi nivel i ulët raportimi nga subjektet, konkretisht: në vitin 2023, nga 272 subjekte kanë raportuar vetëm 41; në vitin 2024, nga 297 subjekte kanë raportuar 152; ndërsa në vitin 2025, nga 346 kode unike kanë raportuar 265 operatorë, ndërkohë që pjesa tjetër nuk ka raportuar ose ka deklaruar mungesë aktiviteti. Kjo situatë është në kundërshtim me nenin 20, pikat 6 dhe 10, si dhe nenin 26, pikat 1 dhe 6 të ligjit nr. 10463/2011 *“Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”,* i ndryshuar. Pavarësisht këtyre problematikave, nuk rezultoi të jenë planifikuar apo realizuar inspektime për këto subjekte gjatë periudhës objekt auditimi, duke dobësuar mekanizmat e kontrollit dhe verifikimit të zbatimit të detyrimeve ligjore.

Gjithashtu, u konstatua se regjistri kombëtar i transfertave nuk është përcjellë pranë ministrisë përgjegjëse brenda afateve të përcaktuara, në kundërshtim me kërkesat procedurale për administrimin dhe raportimin e këtij informacioni.
Kjo situatë është në kundërshtim me Urdhrin nr. 123, datë 25.04.2017 *"Për miratimin e formatit të regjistrit të transfertave individuale dhe të regjistrit kombëtar të transfertave si dhe mënyrën e administrimit të tyre",* pika 6, dhe Urdhrin nr. 135, datë 16.04.2015 *"Për miratimin e formatit të regjistrit të transfertave individuale dhe të regjistrit kombëtar të transfertave si dhe mënyrën e administrimit të tyre*", pika 6.
Në këto kushte, dobësohen ndjeshëm mekanizmat e monitorimit dhe kontrollit mbi transfertat e mbetjeve, duke krijuar rrezik të lartë për raportim të paplotë, mungesë gjurmueshmërie dhe mos ndjekje në kohë të shkeljeve nga subjektet përkatëse.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3. faqet nr. 65-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
6.1. Rekomandimi: Sektori i Informacionit, GIS dhe Regjistrave Mjedisorë në AKM të marrin masa për sigurimin e raportimit të plotë dhe të saktë të informacionit mbi transfertat e mbetjeve nga subjektet e pajisura me licencë III.2.B. Gjithashtu, të garantohet përditësimi dhe dërgimi brenda afatit të përcaktuar i Regjistrit Kombëtar të transfertave pranë ministrisë përgjegjëse, në përputhje me kërkesat e akteve rregullatore në fuqi.
6.2 Rekomandim: Drejtoria e Inspektimit dhe Kontrollit të marrë masa për identifikimin dhe përfshirjen në planet e verifikimit/inspektimit të subjekteve të pajisura me licencë III.2.B që nuk kanë raportuar transfertat e mbetjeve, me qëllim kryerjen e kontrolleve dokumentare dhe/ose fizike në terren për verifikimin e respektimit të detyrimeve ligjore mbi administrimin dhe raportimin e transfertave të mbetjeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i praktikës së pajisjes me leje mjedisore të tipit A për subjektin "T. O. S" sh.a., me NIPT L.....I, i cili ka paraqitur kërkesë më datë 24.11.2022 për aktivitetin *"Kërkim i naftës dhe i gazit natyror dhe nxjerrja e naftës dhe gazit natyror",* u konstatua se procesi i shqyrtimit dhe miratimit të lejes mjedisore është kryer mbi bazën e një aplikimi të paplotë dhe jo të saktë në lidhje me gjenerimin dhe menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme.
Konkretisht, në formularin e aplikimit për leje mjedisore të tipit A, në Shtojcën 1, pika 5.2 *"Menaxhimi i mbetjeve të ngurta",* nuk është plotësuar tabela 5.2.1 *"Mbi rikuperimin/asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme",* ndërsa subjekti ka deklaruar se nga zhvillimi i aktivitetit nuk gjenerohen mbetje. Ky deklarim nuk qëndron në raport me natyrën e aktivitetit, pasi sipas Vendimit nr. 402, datë 30.06.2021 *"Për miratimin e katalogut të mbetjeve",* në shtojcën 1, grupi 05 përcakton qartë se nga aktivitetet e kërkimit dhe nxjerrjes së naftës dhe gazit natyror gjenerohen mbetje të rrezikshme.
Në vijim, nga verifikimi i dokumentacionit të raportimit në sistemin e-inspektime (çështja nr. AKM-FR-2024-000261), rezultoi se gjatë ushtrimit të aktivitetit subjekti gjeneron një sërë mbetjesh të rrezikshme me kode përkatëse *(01 05 05*, 13 05 02*, 16 03 03*, 16 07 08*, 19 13 01* etj.),* duke rrëzuar në mënyrë të qartë deklarimin e bërë në fazën e aplikimit. Gjithashtu, evidentohet se këto mbetje janë grumbulluar përkohësisht, pasi subjekti nuk disponon kontratë të lidhur me operatorë të licencuar për menaxhimin e tyre në momentin e zhvillimit të aktivitetit.
Kjo situatë është në kundërshtim pikën 9/e, Kreu II të VKM nr. 419, datë 25.06.2014 *"Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja",* si dhe me kërkesat e Shtojcës 1, pika 5.2 të kësaj VKM-je.

Për rrjedhojë, konstatohet se leja mjedisore është miratuar nga komisioni përkatës në mungesë të një informacioni të plotë dhe të verifikuar mbi gjenerimin dhe menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme, duke cenuar cilësinë e vlerësimit mjedisor dhe duke krijuar risk që aktiviteti të zhvillohet pa masa të qarta dhe të garantuara për trajtimin dhe asgjësimin e këtyre mbetjeve.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3. faqet nr. 65-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
7.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Mjedisit të kryejë verifikim të mëtejshëm për subjektin *"T. O. S"* sh.a. lidhur me përmbushjen e detyrimeve për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme dhe, në rast konstatimi të deklarimeve të pasakta ose mosrespektimit të kushteve të lejes mjedisore, të marrë masat administrative të parashikuara në legjislacionin mjedisor në fuqi, duke përfshirë rishikimin e kushteve të lejes mjedisore, pezullimin ose propozimin për revokimin e saj.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i administrimit dhe përditësimit të të dhënave mbi lejet mjedisore në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit u konstatua se bazat e të dhënave mbi lejet mjedisore aktive të administruara nga drejtoritë përkatëse nuk janë të unifikuara dhe nuk përputhen ndërmjet tyre. Nga informacioni i përcjellë nga QKB më datë 17.11.2025 rezulton se, për periudhën nga viti 2009 e në vijim, janë evidentuar gjithsej 3,745 leje dhe veprimtari të lidhura me ndikimin në mjedis, konkretisht 173 leje mjedisi të tipit A; 2,988 leje mjedisi të tipit B dhe 584 veprimtari profesionale të lidhura me ndikimin në mjedis. Nga verifikimi i të dhënave të administruara në AKM rezultoi gjithashtu se në regjistrin e lejeve ekzistojnë 778 leje me format të vjetër me status aktiv. Gjithashtu, nga auditimi i databazës së lejeve mjedisore dhe i dokumentacionit të praktikave të administruara nga AKM u konstatua se për të njëjtin instalim dhe për të njëjtin subjekt janë evidentuar dy ose më shumë leje mjedisore të lëshuara në periudha të ndryshme, ndërkohë që pas miratimit të lejes së re nuk është kryer revokimi apo çaktivizimi i lejes së mëparshme për një periudhë të konsiderueshme kohe. Si pasojë, në databazën e lejeve mjedisore evidentohen raste të mbivendosjes së lejeve për të njëjtin instalim, duke krijuar pasaktësi në evidentimin e lejeve aktive dhe në administrimin e informacionit mbi subjektet e pajisura me leje mjedisore.
Situata e konstatuar është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 *"Për lejet e mjedisit"*, i ndryshuar, konkretisht me nenin 8, pika 2 dhe nenin 20, pika 2, sipas të cilave një leje mjedisi mund të lejojë funksionimin e më shumë se një instalimi të të njëjtit operator vetëm kur ato ndodhen në të njëjtën vendndodhje, ndërsa instalimet e operatorëve të ndryshëm ose instalimet e të njëjtit operator në vendndodhje të ndryshme kërkojnë leje të veçanta sipas kategorisë përkatëse. Gjithashtu, situata nuk është në përputhje me nenin 30, pika 1 dhe 2 të të njëjtit ligj, i cili përcakton detyrimin që instalimet ekzistuese të tipit A dhe B të përputhen me kërkesat e ligjit dhe që operatorët të kërkojnë rishikimin e kushteve të lejeve ekzistuese në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
Nga analiza e databazës së lejeve mjedisore të administruar nga AKM, dokumentacionit të praktikave të lejeve dhe informacionit të përcjellë nga QKB, rezultoi se kjo situatë lidhet me mungesën e përditësimit sistematik të regjistrit të lejeve mjedisore dhe me mungesën e verifikimit të plotë të mbivendosjeve të mundshme të lejeve për të njëjtin instalim.
Si pasojë, krijohet një pasqyrë jo e plotë dhe jo e saktë mbi lejet mjedisore aktive, duke dobësuar gjurmueshmërinë e instalimeve të pajisura me leje dhe duke krijuar rrezik për administrim jo efektiv të procesit të licencimit dhe monitorimit mjedisor. Në këto kushte rritet rreziku për pasaktësi në identifikimin e subjekteve aktive, mbivendosje të lejeve për të njëjtin instalim dhe dobësim të mekanizmave institucionalë të kontrollit dhe mbikëqyrjes së aktiviteteve që kanë ndikim në mjedis.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3. faqet nr. 65-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
8.1. Rekomandim: Drejtoria e Vlerësimit të Impaktit dhe Licencimit, në bashkëpunim me QKB-në dhe strukturat përkatëse brenda AKM, të marrë masa për verifikimin dhe unifikimin e databazës së lejeve mjedisore, duke siguruar revokimin ose ç'aktivizimin në regjistër të lejeve të mëparshme në rastet kur është miratuar një leje e re për të njëjtin instalim, me qëllim garantimin e një regjistri të saktë dhe të përditësuar të lejeve mjedisore aktive.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i zbatimit dhe respektimit të afateve procedurale gjatë shqyrtimit të ankimimeve për periudhën objekt auditimi, u analizuan 106 praktika ankimimi, duke kryer testime mbi përputhshmërinë e afateve të ndjekura në procesin e shqyrtimit të tyre.
- *Nga krahasimi i datës së paraqitjes së ankimimit me datën e vendimit përfundimtar* të Komisionit të Shqyrtimit të Ankimimeve, rezultuan 13 raste në të cilat vendimi është marrë përtej afatit 30-ditor të përcaktuar në pikën 1 të nenit 51 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* me tejkalime nga 4 deri në 25 ditë, sipas tabelës nr. 1 *"Subjekte me vendim përfundimtar në tejkalim afatesh"*, në RPA.
Kjo situatë tregon mangësi në ndjekjen dhe monitorimin e respektimit të afateve procedurale nga strukturat përgjegjëse, duke sjellë vonesa në përfundimin e procesit administrativ për subjektet e ankimuara.
- Në vijim, nga verifikimi i respektimit të afatit të paraqitjes së ankimimit, përmes *krahasimit të datës së marrjes së vendimit të dënimit me datën e depozitimit të ankesës*, rezultoi se në 11 raste ankesat janë paraqitur përtej afatit ligjor njëmujor, në kundërshtim me pikën 1, shkronja "a", të nenit 140 të Kodit të Procedurave Administrative, i cili përcakton se ankimi administrativ bëhet brenda 1 muaji nga dita kur ankuesi merr njoftim për aktin ose për mos nxjerrjen e tij, sipas tabelës nr. 2 *"Paraqitja e ankesës në tejkalim afatesh"*, trajtuar në RPA. Pranimi dhe shqyrtimi i ankimimeve të paraqitura jashtë afatit ligjor evidenton mangësi në verifikimin e afateve gjatë administrimit të procedurës së pranimit të ankimimeve dhe krijon risk për moszbatim korrekt të kërkesave procedurale të legjislacionit administrativ.
- Gjithashtu, gjatë verifikimit të dokumentacionit dhe të dhënave të administruara në sistem, u *konstatuan mangësi dhe mospërputhje në databazën e të dhënave* në 3 raste nga 106 praktikat e verifikuara. Konkretisht, për subjektin *"B. S"* SHPK, data e ankimimit rezultoi më e hershme se data e vendimit administrativ; për subjektin *"A"* SHPK, mungon data e ankimimit; ndërsa për subjektin *"V. H"* data e ankimimit rezultoi rreth dy muaj para datës së vendimit përfundimtar. Këto mospërputhje lidhen me mangësi në administrimin dhe përditësimin e të dhënave në databazë dhe krijojnë risk në drejtim të saktësisë dhe besueshmërisë së informacionit të administruar për procesin e shqyrtimit të ankimimeve.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5. faqet nr. 163-303 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
9.1 Rekomandimi: Struktura përgjegjëse për shqyrtimin e ankimimeve të marrë masa për forcimin e monitorimit dhe respektimit të afateve procedurale, me qëllim shmangien e vonesave në përfundimin e procesit administrativ.
9.2 Rekomandimi: Të përmirësohen procedurat e verifikimit dhe administrimit të ankimimeve, duke garantuar që ankimimet të pranohen dhe të shqyrtohen vetëm kur janë paraqitur brenda afatit ligjor të përcaktuar, si dhe të vendosen mekanizma kontrolli për evidentimin dhe refuzimin e ankimimeve të paraqitura jashtë afatit.
9.3 Rekomandimi: Të merren masa për përmirësimin e administrimit dhe saktësisë së të dhënave në databazën e administruar nga AKM mbi shqyrtimet, përmes verifikimit dhe përditësimit periodik të të dhënave të regjistruara për procesin e shqyrtimit të ankimimeve, me qëllim sigurimin

e besueshmërisë dhe integritetit të informacionit të administruar.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i raportimit të kodeve të mbetjeve dhe zbatimit të kushtit nr. 8 *"Menaxhimi i mbetjeve"* për subjektet e pajisura me leje mjedisore të tipit A dhe B, u konstatuan mangësi të konsiderueshme në dokumentimin, raportimin dhe monitorimin e transfertave të mbetjeve.
Konkretisht, nga verifikimi i 592 rasteve, rezultoi se në 211 raste raportimet janë të paplota, pasi subjektet nuk kanë deklaruar sasinë e mbetjeve dhe nuk kanë bashkëlidhur kontratat me operatorë të licencuar, ndërsa në 283 raste mungojnë kontratat me transportuesit e mbetjeve; vetëm në 90 raste është paraqitur informacion i plotë dhe i saktë. Gjithashtu, nga analiza e regjistrave të transfertave u konstatuan parregullsi në raportimin e kodeve të mbetjeve, mospërputhje midis dorëzuesit dhe transportuesit, mungesë e përcaktimit të destinacionit përfundimtar, si dhe deklarime kontradiktore mbi kryerjen e transfertave.
Këto veprime nuk janë në përputhje me nenin 20, pikat 6 dhe 10 dhe nenin 26, pikat 1 dhe 6 të ligjit nr. 10463/2011 *"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"*, të ndryshuar, të cilat parashikojnë detyrimin për dokumentimin dhe raportimin e plotë dhe periodik të transfertave të mbetjeve.
Nga auditimi u konstatua gjithashtu se, pavarësisht evidentimit të këtyre problematikave përmes memos nr. 1274 prot., datë 05.02.2025, nga strukturat përgjegjëse nuk janë ndërmarrë veprime efektive për verifikim në terren, nuk është kërkuar plotësimi i dokumentacionit mungues dhe nuk janë iniciuar procedura për vendosjen e masave administrative, në kundërshtim me nenin 56 të ligjit nr. 10463/2011, që parashikon detyrimin për inspektim dhe kontroll të aktivitetit.
Në vijim, nga 211 rastet me raportime të paplota, u përzgjodhën 5 raste me risk të lartë, nga të cilat rezultoi: në 1 rast *(subjekti E. R)* mungesë e informacionit mbi sasinë e mbetjeve të trajtuara; në 1 rast *(subjekti P. G)* mungesë e dorëzimit të raporteve vjetore; në 1 rast *(subjekti B. P)* paqartësi në destinacionin përfundimtar të mbetjeve; në 1 rast *(V. R)* mospërputhje ndërmjet raportimeve dhe raportim i pjesshëm; si dhe në të gjitha rastet mungesë e verifikimit në terren dhe e ndjekjes nga strukturat përgjegjëse.
Këto mangësi kanë ardhur si pasojë e mungesës së ndjekjes sistematike të raportimeve nga subjektet, mos koordinimit ndërmjet strukturave përgjegjëse për informacionin, monitorimin dhe inspektimin, si dhe moszbatimit të detyrimeve për kontroll dhe ndëshkim të shkeljeve.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 65-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
10.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa për verifikimin e plotë të rasteve me raportime të paplota të evidentuara nga auditimi, duke kërkuar plotësimin e dokumentacionit mungues, verifikimin në terren të gjurmueshmërisë së mbetjeve dhe të destinacionit përfundimtar të tyre, si dhe aplikimin e masave administrative të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për subjektet që nuk kanë përmbushur detyrimet ligjore për raportimin, dokumentimin dhe menaxhimin e mbetjeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në shumicën e procedurave për Deklaratat Mjedisore dhe Vlerësimet e Ndikimit në Mjedis, institucionet e konsultuara (Bashkitë, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, etj.) shpesh nuk kanë dhënë mendim, duke u pranuar si "Miratim në heshtje". Vendimet rezultojnë kryesisht formale, të mbështetura në referenca ligjore.
Numri i verifikimeve në terren nga grupet e punës të Agjencive Rajonale mbi aplikimet e zhvilluesve për Deklaratë Mjedisore ose VNM Paraprake është shumë i ulët.

Konsultimet publike kanë pasur pjesëmarrje të kufizuar dhe shpesh kanë munguar përfaqësuesit e strukturave përgjegjëse për pyjet dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, në kundërshtim me pikën 6) të VKM nr. 686/2015 *"Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore".*

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 108-163 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marri masa për:

- Forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, duke kërkuar në mënyrë të detyrueshme dhënien e mendimeve nga institucionet e përfshira.
- Udhëzimin e Agjencive Rajonale të Mjedisit që, bazuar në një analizë risku për projektet e propozuara, të rrisin numrin e verifikimeve në terren, me qëllim që vendimmarrja të mbështetet në fakte dhe verifikime praktike, dhe jo vetëm në referenca ligjore
-Të përmirësojë procesin e konsultimit publik, duke garantuar pjesëmarrje më të gjerë të komunitetit lokal dhe strukturave përgjegjëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i administrimit të licencave III.2.B, kodeve unike dhe raportimit të regjistrave të transfertave të mbetjeve, konstatohet se për periudhën 2012-2025 rezultojnë 743 licenca të kategorisë III.2.B, nga të cilat 39 me status jo aktiv/pezulluar/revokuar dhe 704 aktive. Nga këto, 80 licenca rezultojnë të përsëritura për të njëjtat subjekte, duke çuar në një total prej 616 subjektesh aktive. Nga këto subjekte, vetëm 285 janë të pajisura me kod unik, ndërsa 239 subjekte rezultojnë pa kod unik, çka evidencon mangësi në administrimin dhe organizimin e regjistrit përkatës. Gjithashtu, nga verifikimi i kodeve unike rezultoi se janë miratuar gjithsej 346 kode unike, ndërkohë që subjektet aktive të pajisura me kod unik janë 285, si dhe janë identifikuar 38 subjekte të pajisura me më shumë se një kod unik, në kundërshtim me pikën 16 të VKM nr. 229 datë 23.04.2014*, "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit"* të ndryshuar.

Po ashtu, u konstatua se për periudhën objekt auditimi nuk është realizuar asnjë inspektim për subjektet me licencë III.2.B, në kundërshtim me nenin 56 të ligjit nr. 10463/2011 *"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve",* i ndryshuar, si dhe me dispozitat e ligjit nr. 10431/2011 *"Për mbrojtjen e mjedisit"*.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 65-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1 Rekomandimi: Drejtoria e Shqyrtimit dhe Monitorimit të Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve të ndërmarrë masa të menjëhershme për rishikimin dhe sistemimin e plotë të regjistrit të licencave III.2.B dhe të kodeve unike, duke eliminuar përsëritjet, duke verifikuar statusin real të subjekteve dhe duke siguruar që çdo subjekt të pajiset me një kod unik të vetëm, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Gjithashtu, të merren masa për sistemimin dhe përditësimin e evidencave administrative mbi licencat III.2.B, kodet unike dhe inspektimet e kryera, si dhe për realizimin dhe dokumentimin e inspektimeve periodike ndaj subjekteve të licencuara, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Sektorit të Laboratorit, Teknologjisë dhe Infrastrukturës Mjedisore, u konstatuan mangësi në ndjekjen institucionale të rezultateve laboratorike dhe në lidhjen e tyre me funksionin inspektues.

Konkretisht, nga të dhënat e vendosura në dispozicion nga AKM, nga 51 raste në të cilat janë kryer

analiza laboratorike për mostrat e marra në instalimet e subjekteve me ndikim në mjedis, në 40 raste rezultatet kanë evidentuar tejkalim të normave të lejuara mjedisore, por nuk rezultoi të jenë iniciuar inspektime mbi bazë indiciesh nga titullari i institucionit, ndërsa vetëm në 11 raste ndjekja ka ardhur me kërkesë nga ARM-të. Nuk evidentohet informim sistematik i strukturave të inspektimit mbi rezultatet laboratorike.
Këto veprime nuk janë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10448/2011 *"Për lejet e mjedisit"*, ligjit nr. 111/2012 *"Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore"*, ligjit nr. 10463/2011 *"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"* dhe ligjit nr. 10433/2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*.
Gjithashtu, në 1 rast konkret (subjekti *"N")*, megjithëse analizat laboratorike (3 mostra) kanë evidentuar tejkalim të konsiderueshëm të parametrave ndotës sipas VKM nr. 177, datë 31.03.2005, është vendosur masë administrative "Paralajmërim", në kundërshtim me nenin 23 dhe 24 të ligjit nr. 9115/2003 *"Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura"*.
Këto mangësi kanë bërë që rastet e ndotjes së evidentuar të mos trajtohen në kohë dhe në mënyrë të plotë, duke reduktuar rolin parandalues dhe ndëshkues të inspektimit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 65-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
13.1 Rekomandimi: Drejtoria e Inspektimit dhe Kontrollit të marrë masa për kryerjen e inspektimeve dhe verifikimeve përkatëse në terren, me qëllim trajtimin në kohë të rasteve të ndotjes dhe marrjen e masave administrative në përputhje me natyrën dhe rëndësinë e shkeljeve të konstatuara.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i 89 procedurave të inspektimeve për periudhën objekt auditimi, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencitë Rajonale të Mjedisit, u konstatuan mangësi procedurale nga trupa inspektuese, në kundërshtim me kërkesat e kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi, si më poshtë:
- Mangësi në plotësimin e listë verifikimeve në **6 raste** *(subjekti "A-S" me... Nipt J.....Ŵ në AKM, subjektet "P" me Nipt K.....A dhe "F. 2020" me Nipt M.....U në ARM Tiranë, subjekti "A" me Nipt K.....I në ARM Fier dhe subjektet "T. E" me Nipt J.....G dhe "K. I" SH.A në ARM Berat),* në kundërshtim me pikën 26, Kreu V të Urdhrit nr. 25, datë 10.08.2018 *"Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ"*, duke sjellë si pasojë pasqyrim jo të plotë të kontrollit të kryer në terren;
- Mangësi në plotësimin e procesverbaleve dhe rubrikave përkatëse në **36 raste**, sipas tabelës nr. 9, Aneksi nr. 1, (1 rast AKM, 9 raste ARM Tiranë, 2 raste ARM Lezhë, 8 raste ARM Fier dhe 16 raste ARM Berat), në kundërshtim me pikën 3 të nenit 45 të ligjit nr. 10433/2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, duke sjellë si pasojë mungesë informacioni të plotë mbi gjetjet dhe vështirësi në gjurmimin dhe mbështetjen e vendimmarrjes.
- Vendosje e datës së vendimit përfundimtar të njëjtë me datën e procesverbalit në **3 raste** (subjektet *"S. U"* me Nipt J.....Q dhe *"C"* me Nipt L.....H në ARM Lezhë dhe subjekti *"T. B"* me Nipt L.....F në ARM Berat), në kundërshtim me nenin 45 të ligjit nr. 10433/2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, duke sjellë si pasojë mosrespektim të afatit për paraqitjen e shpjegimeve nga subjekti.
- Mospërputhje ndërmjet procesverbalit dhe vendimit përfundimtar të inspektimit në **15 raste,** sipas tabelës nr. 10, Aneksi nr. 1, (8 raste AKM, 5 raste ARM Tiranë dhe 2 raste ARM Berat), si pasojë e ndryshimit të masave administrative, pa argumentuar ose mbështetur me evidenca.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5. faqet nr. 163-303 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
14.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa për standardizimin dhe

forcimin e kontrollit të procedurave të inspektimit, duke siguruar plotësimin e saktë të dokumentacionit dhe mbështetjen me evidenca përkatëse në rastet e ndryshimit të fakteve nga procesverbali deri në daljen e vendimit përfundimtar të inspektimit.

14.2 Rekomandimi: Drejtoria e Inspektimit dhe Kontrollit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe në Agjencitë Rajonale Mjedisore të marrë masa për kryerjen e inspektimeve dhe verifikimeve përkatëse në terren, me qëllim verifikimin dhe trajtimin e problematikave të konstatuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i procedurave të inspektimit për periudhën objekt auditimi, u konstatuan mangësi në përcaktimin dhe ndjekjen e afateve për korrigjimin e shkeljeve, si dhe në realizimin e ri-inspektimeve për verifikimin e tyre, si më poshtë:

- Mos përcaktim i afatit konkret për korrigjimin e shkeljeve dhe mosrealizim i ri-inspektimit për verifikimin e tyre në **8 raste** *(subjekti "T. S" me Nipt L.....I AKM, subjektet "F.2020" me Nipt M.....U, "R" SHPK me Nipt J.....E, "L-E" me Nipt K.....O dhe "S. U. i T" me Nipt L.....E në ARM Tiranë dhe subjektet "T. S" me Nipt L.....I, "A" SHA me Nipt J.....U, "J" SHPK, me Nipt K.....V në ARM Fier),* në kundërshtim me pikën 14, Kreu IV të Urdhrit nr. 25, datë 10.08.2018 *"Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ"*, duke sjellë si pasojë mungesë verifikimi të zbatimit të detyrimeve dhe dobësim të efektivitetit të inspektimit.
- Përcaktim i afateve për përmirësimin e shkeljeve të njëjta me datën e vendimit në **4 raste në ARM Berat** *(subjektet B. K me Nipt K.....G, K. I SHA me Nipt K.....T, T. E me Nipt J.....G dhe D me Nipt L.....U),* në kundërshtim me pikën 14, Kreu IV të Urdhrit nr. 25, datë 10.08.2018 *"Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ"*, duke sjellë si pasojë pamundësi praktike për zbatimin e detyrimeve nga subjekti;
- Mosrealizim i ri-inspektimeve për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve në **6 raste** *(subjekti "P" me Nipt K.....A në ARM Tiranës, subjektet "T. S" me Nipt L.....I dhe "A. I. C" me Nipt K.....Q në ARM Fier dhe subjektet "E. C. F" me Nipt J.....B, "P. G" me Nipt M.....B dhe "T. E" me Nipt J.....G në ARM Berat),* në kundërshtim me pikat 15–17, Kreu IV të Urdhrit nr. 25, datë 10.08.2018 *"Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ"*, duke sjellë si pasojë mungesë ndjekjeje të zbatimit të detyrimeve të lëna.

Mangësitë në përcaktimin e afateve dhe mosrealizimi i ri-inspektimeve kanë sjellë mungesë të verifikimit të zbatimit të detyrimeve të lëna, duke dobësuar efektivitetin e procesit inspektues. Si pasojë, rritet risku për mos korrigjim të shkeljeve dhe përsëritje të tyre, me ndikim negativ në funksionin kontrollues dhe parandalues të inspektimit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5. faqet nr. 163-303 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1 Rekomandimi: Drejtoria e Inspektimit dhe Kontrollit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe në Agjencitë Rajonale Mjedisore të marrë masa për garantimin e përcaktimit të afateve reale dhe të zbatueshme për korrigjimin e shkeljeve, si dhe për realizimin në kohë të ri-inspektimeve për verifikimin e tyre, në përputhje me kërkesat e kuadrit nënligjor në fuqi, me qëllim rritjen e efektivitetit të procesit të inspektimit dhe sigurimin e ndjekjes së plotë të detyrimeve nga subjektet.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i procedurave të inspektimit për periudhën objekt auditimi u konstatuan raste të mos administrimit të provave dhe dokumentacionit mbështetës në sistemin e-inspektimi në 4 raste *(në 2 raste subjekti "E. C" me Nipt J.....B dhe "K. I" SHA me Nipt K.....T në ARM Berat, dhe 1 rast në ARM Fier, subjekti: "I. T. Ŵ.T" me Nipt L.....F),* në kundërshtim me nenin 41 të ligjit nr. 10433/2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*,

duke sjellë dobësim të bazës provuese të gjetjeve të konstatuara, e cila cenon gjurmueshmërinë dhe transparencën e procesit të inspektimit, si dhe rrit riskun për mos mbështetje të qëndrueshme ligjore të vendimeve administrative dhe për kontestim apo anulim të tyre.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5. faqet nr. 163-303 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
16.1 Rekomandim: Drejtoria e Inspektimit dhe Kontrollit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe në Agjencitë Rajonale Mjedisore të marrë masa për administrimin e plotë dhe sistematik të provave dhe dokumentacionit mbështetës në sistemin e-inspektimi, në përputhje me kërkesat ligjore, me qëllim forcimin e bazës provuese të gjetjeve, garantimin e gjurmueshmërisë së procesit të inspektimit dhe rritjen e qëndrueshmërisë ligjore të vendimeve administrative.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i procedurave të inspektimit për periudhën objekt auditimi u konstatuan raste të marrjes në konsideratë nga trupat inspektuese të dokumentacionit të paraqitur nga subjektet pas kryerjes së inspektimit, konkretisht në 23 raste, sipas tabelës nr. 11, Aneksi nr. 1, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10433/2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".*
Nga shqyrtimi i praktikave rezultoi se dokumentacioni i depozituar nga subjektet është përgatitur dhe paraqitur pas konstatimit të shkeljeve nga ana e trupave inspektuese dhe, për rrjedhojë, nuk përbën element që përjashton apo zbut përgjegjësinë administrative për shkeljet e evidentuara gjatë inspektimit. Në këto kushte, kjo praktikë cenon integritetin dhe objektivitetin e procesit të inspektimit, dobëson efektin ndëshkues dhe parandalues të masave administrative, si dhe krijon precedent për trajtim jo të njëtrajtshëm të subjekteve dhe shmangie të përgjegjësisë administrative për shkeljet e konstatuara.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5. faqet nr. 163-303 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
17.1 Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Agjencitë Rajonale të Mjedisit të marrin masa për përcaktimin dhe zbatimin e një praktike të unifikuar, sipas së cilës dokumentacioni i paraqitur nga subjektet pas inspektimit të merret në konsideratë vetëm në rastet kur provohet pamundësia objektive e subjektit për ta paraqitur atë gjatë inspektimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se për subjektin "V. R." SHPK, gjatë inspektimit nr. AKM-DQ-2023-000521, me objekt *"Menaxhimi i mbetjeve të rrezikshme",* janë evidentuar mospërputhje me kushtet e lejes mjedisore Tipi A nr. PN-8024-01-2019, pasi në vendndodhjen e ushtrimit të aktivitetit rezultoi i instaluar vetëm një incenerator, ndërkohë që sipas lejes specifikohen dy të tillë.
Sipas kontestimeve të subjektit "V. R" SHPK, një prej tyre ka qenë jashtë funksionit, pa u njoftuar AKM brenda afatit ligjor, në kundërshtim me pikat 2 dhe 3 të nenit 16 të ligjit nr. 10448/2011 *"Për lejet e mjedisit",* i ndryshuar.
Subjekti ushtron aktivitet në menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme, ku kapaciteti i plotë i inceneratorëve është thelbësor për përballimin e sasisë së mbetjeve të marra në përpunim në bazë të kontratave me subjektet gjeneruese. Mosfunksionimi i një inceneratori ul ndjeshëm kapacitetin përpunues dhe krijon risk real për mos menaxhim të sigurt të mbetjeve të rrezikshme. Për rrjedhojë, mos informimi mbi problematikën dhe mos aplikimi i masës së duhur ndëshkuese dobëson efektivitetin e kontrollit institucional, krijon precedent për tolerim të shkeljeve në aktivitete me risk të lartë mjedisor dhe rrit rrezikun për ndotje të mjedisit dhe cenim të shëndetit publik.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5. faqet nr. 163-303 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1 Rekomandimi: Drejtoria e Inspektimit dhe Kontrollit, të planifikojë dhe realizojë inspektime të mëtejshme ndaj subjektit "V. R" SHPK, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së aktivitetit me kushtet e lejes mjedisore, funksionalitetin e kapaciteteve të trajtimit të mbetjeve të rrezikshme dhe zbatimin e detyrimeve ligjore për njoftimin e ndryshimeve apo avarive në instalime, duke marrë masat administrative përkatëse në rast konstatimi të shkeljeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për subjektin *"I. T. Ŵ. T. F",* gjatë inspektimeve të kryera në vitet 2024 dhe 2025, janë evidentuar mangësi të përsëritura në zbatimin e kushteve të lejes mjedisore, si dhe në dokumentimin dhe ndjekjen e aktivitetit të landfillit.
Konkretisht, për periudhën nën administrimin e AAPSK dhe më tej nga bashkitë e Qarkut Fier, nuk rezultoi i disponueshëm asnjë dokumentacion provues mbi monitorimin, raportimin dhe kontrollin e mbetjeve, ndërkohë që nga procedura e inspektimit nuk provohet nëse mbetjet janë menaxhuar në përputhje me kërkesat për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik.
Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se procesverbalet e inspektimit paraqesin mangësi në plotësimin e rubrikave, ndërsa në një rast është shënuar *"Nuk ka shkelje",* megjithëse vetë përmbajtja e listë verifikimit evidenton mungesë informacioni dhe kontrolli mbi veprimtarinë e landfillit. Në vijim, edhe në inspektimin e vitit 2025 konstatohet se nuk është plotësuar asnjë prej kushteve të lejes mjedisore, nuk është paraqitur dokumentacion për raportim, monitorim, pagesa tarifash apo funksionim të impianteve përkatëse, ndërkohë që impianti i trajtimit të lëngjeve kulluese nuk rezulton funksional dhe mungon çdo provë mbi kontrollin e ndikimeve në ajër, ujë dhe tokë.
Në këto kushte, veprimtaria e zhvilluar në landfill përbën operim në mospërputhje me lejen mjedisore dhe kërkesat ligjore për menaxhimin e mbetjeve, duke përmbushur elementët e kundërvajtjes administrative sipas nenit 62, pika 45 të ligjit nr. 10463/2011 *"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve",* i ndryshuar. Megjithatë, pavarësisht natyrës së të përsëritur të shkeljeve, trupa inspektuese ka vendosur në të dy rastet vetëm masën administrative "Paralajmërim", duke krijuar precedent për tolerim të shkeljeve në një aktivitet me risk të lartë mjedisor. Mungesa e kontrollit efektiv dhe e dokumentimit të plotë për një landfill në funksion, ku depozitohen mbetje urbane në shkallë rajonale, rrit ndjeshëm rrezikun për ndotje të mjedisit, dëmtim të burimeve natyrore dhe cenim të shëndetit publik, si dhe dobëson ndjeshëm rolin mbikëqyrës dhe disiplinues të institucioneve përgjegjëse.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5. faqet nr. 163-303 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
19.1.Rekomandimi: Drejtoria e Inspektimit dhe Kontrollit të marrë masa për vlerësimin e procedurës së ndjekur gjatë inspektimeve të subjektit "I. T.W. T. F", duke garantuar dokumentim të plotë të konstatimeve, verifikim të plotë të zbatimit të kushteve të lejes mjedisore dhe administrim të provave mbi funksionimin e landfillit dhe impianteve përkatëse. Gjithashtu, në rastet e evidentimit të shkeljeve të përsëritura dhe mungesës së dokumentacionit mbi monitorimin dhe menaxhimin e mbetjeve, të sigurohet ndjekje e plotë procedurale dhe administrative në përputhje me kërkesat e legjislacionit mjedisor në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në vitin 2023, Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë me propozim të AKM ka miratuar 33 Deklarata Mjedisore, por vetëm 19 prej tyre figurojnë në databazë me detyrim për raportim. Në vitin 2024 janë miratuar 23 Deklarata Mjedisore, nga të cilat vetëm 5 raste kanë detyrim për raportim. Në vitin 2025 (deri më 30.09.2025) janë miratuar 3 Deklarata Mjedisore, por asnjëra nuk përmban detyrim për raportim, ndonëse sipas

ligjit dhe praktikës duhet të përfshihen në planin e monitorimit të vitit pasardhës. Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka nxjerrë një numër të lartë vendimesh për VNM paraprake (806 në vitin 2023, 909 në vitin 2024 dhe 396 deri më 30.09.2025). Sipas ligjit dhe praktikës, këto vendime duhet të shtoheshin në planin e monitorimit brenda 6 muajve pas hyrjes në fuqi. Nga databaza e vënë në dispozicion rezulton se për raportim dhe monitorim janë regjistruar vetëm 320 raste në vitin 2023, 72 raste në vitin 2024 dhe 13 raste në vitin 2025. Deri në fund të vitit 2025, institucioni ka administruar të dhënat përmes databazave në Excel, për shkak të mungesës së një sistemi të integruar elektronik. Aktualisht është në proces zbatimi Sistemi i Integruar i Monitorimit (SIM), i cili pritet të bëhet funksional gjatë të vitit 2026 dhe do të përfshijë edhe procedurat e monitorimit për Vlerësimet e Ndikimit në Mjedis. Megjithatë, regjistri i mbajtur deri më 31.12.2025, në lidhje me subjektet e pajisura me VNM që mbartin detyrim për raportim dhe që nuk kanë raportuar pranë Agjencia Kombëtare e Mjedisit, nga auditimi rezultoi i pasaktë, i paplotë dhe në kundërshtim me kërkesat e nenit 25/1 të ligjit nr. 10440/2011, *"Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis"* i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4. faqet nr. 108-163 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

20.1 Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa që:

- çdo Deklaratë Mjedisore dhe VNM Paraprake të pasqyrohet në databazë në mënyrë të saktë dhe të plotë.
- në këtë databazë të përcaktohet qartësisht detyrimi për raportim për secilin vendim të miratuar.
- deri në funksionimin e SIM, të sigurohet që vendimet të përfshihen në planin e monitorimit, duke garantuar monitorim për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Menjëherë dhe në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit me objekt "Shërbimi i riparimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve të instaluara në stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit urban" për vitin 2025, u konstatua se:

Autoriteti Kontraktor në PBA 2025–2027 për mirëmbajtjen e pajisjeve të ajrit ka parashikuar një fond prej 8,583,333 lekë pa TVSH, ndërkohë që nga testimi i tregut vlera rezultoi rreth 25,000,000 lekë, dhe në planifikimin vjetor 2025 rezultoi 30,000,000 lekë pa TVSH. Këto diferenca janë bërë pa argumentim financiar, në kundërshtim me nenin 35 të ligjit nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*"

Përllogaritja e fondit limit 29,874,560 lekë (pa TVSH) nga Komisioni i Testimit të Tregut nuk përputhet me rezultatet e testimit të tregut sipas ofertave të paraqitura dhe nuk është dokumentuar apo argumentuar në mënyrë të plotë, pasi numri i moduleve dhe shërbimet e përcaktuara nuk janë në përputhje me studimin e tregut, veprim në kundërshtim me nenin 76 të VKM nr. 285/2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar.

Komisioni për Hartimin e Specifikimeve Teknike, në Proces Verbalin nr. 124/1 prot., datë 22.01.2025 dhe DST (shtojca 5), nuk ka përcaktuar numrin e moduleve për ofrimin e shërbimit dhe mungon referimi në manualin teknik, në kundërshtim me nenin 36, pika b) dhe c) të ligjit nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, i cili kërkon përshkrim të qartë dhe referencë ndaj standardeve përkatëse.

Njësia e prokurimit në përcaktimin e kriterit specifik për xhiron minimale vjetore nuk ka përcaktuar "*pa tejkaluar dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit*", veprim në kundërshtim me pikën 2.b të nenit 43 të VKM-se Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, rekomanduar edhe nga APP.

Analiza e periudhës së deklarimit të listëpagesave të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore zhvendoset me një muaj nga periudha prill 2024-prill 2025 në maj 2024-maj 2025. Ky ndryshim konsiderohet i pajustifikuar dhe në kundërshtim me nenin 41, pika 2 të VKM nr. 285/2021 "*Për*

miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, pasi kriteret duhet të jenë të mirëargumentuara. Në PV nr. 6149/1 prot., datë 04.06.2025 dhe në DST, Njësia e Prokurimit ka kërkuar si kriter të detyrueshëm disponimin e dy profileve profesionale specifike (1 inxhinier elektronik/informatik/telekomunikacioni dhe 1 kimist/inxhinier mjedisi), duke kërkuar kontrata pune, diploma dhe certifikata trajnimi nga prodhuesit. Ky kriter nuk është në përputhje me nenin 41, pika 4 të VKM nr. 285/2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar, i cili kërkon që kërkesat të lidhen me licencimin profesional dhe personelin kryesor sipas legjislacionit në fuqi.
Shkresa nr. 7134/1 prot., datë 03.07.2025, nuk është firmosur nga i gjithë grupi i punës, në kundërshtim anëtarësinë e komisionit të përcaktuar në Urdhrin e Titullarit nr. 05, datë 08.01.2025. Me këtë shkresë sqaruese është shtuar numri i moduleve për shërbim, pa qenë i parashikuar më parë në specifikimet teknike (PV nr. 6149/1 prot.). Mungon argumentimi për ndryshimet e bëra ne dokumentacionin e procedurës së prokurimit, në kundërshtim me nenin 36 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" si dhe "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar,. Shkresa nuk përmban subjektin/palën të cilës i drejtohet, duke shkelur kërkesat e Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", i cili kërkon që akti administrativ të përcaktojë qartë marrësin.
Nga auditimi rezultoi se operatori ekonomik ka depozituar pasqyrat financiare për vitet 2022, 2023 dhe 2024 pranë DRT Tiranë më datë 27.06.2025, por jo pranë QKB, në kundërshtim me nenin 43, pika 3, shkronja "a" të ligjit nr. 9723/2007. Gjithashtu në listëpagesën e majit 2024 rezultojnë vetëm 4 punonjës, ndërkohë që kërkohen të paktën 5. OE ka deklaruar automjeti Mercedes Benz (AA***TI), i cili nuk figuron në inventarin e vitit 2024. Në inventar figuron një automjet tjetër (Golf AA***ZY**)**, duke krijuar mospërputhje me kërkesat e DST.
Plani i zbatimit të kontratës sipas shkresës nr. 7680/1 prot., datë 21.07.2025) nuk përfshin sasinë dhe grafikun e ofrimit të shërbimeve, në kundërshtim me DST dhe nenin 3, pika 5 të kontratës. Gjithashtu nuk janë mbajtur procesverbale për dorëzimin e shërbimeve dhe pjesëve të përdorura; Mungojnë fletë-hyrjet për pjesët e këmbimit. Dorëzimi është bërë me "Letër Tip" pa numër protokolli hyrës në AKM, në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit në fuqi për dokumentimin e veprimeve administrative dhe financiare, si dhe me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".
Nga auditimi i procedurës së prokurimit "Shërbimi i mirëmbajtjes së pajisjeve të instaluara në stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit urban", me fond limit prej 6,831,067 lekë dhe operator fitues "K" SHPK për vitin 2023, u konstatuan disa parregullsi të rëndësishme.
Grupi i Punës për Hartimin e Specifikimeve Teknike, në shkresën nr. 2713/1 Prot, datë 06.04.2023, ka përcaktuar se shërbimi i mirëmbajtjes do të kontraktohet vetëm për pajisjet që janë në gjendje pune. Autoriteti Kontraktor, në përcaktimin e fondit limit pa TVSH në vlerën 6,831,067 lekë, nuk ka kryer më parë vlerësimin e gjendjes së aktiveve, duke vepruar në kundërshtim me paragrafin 102 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" Kërkesa për disponimin e një inxhinieri elektronik/informatikë/telekomunikacion dhe një kimisti ose inxhinieri mjedisi, me kontrata pune dhe certifikata nga prodhuesit, nuk është në përputhje me nenin 41, pika 4 të VKM nr. 285/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Procesverbalin e miratimit të specifikimeve teknike nr. 2713/1, datë 06.04.2023 nuk është nënshkruar nga gjithë anëtarëve të grupit të punës, miratuar me Urdhër Titullari nr. 08, datë 10.03.2023, nr. prot., 1763, datë 10.03.2023. Komisioni i Vlerësimit pranoi certifikatat ISO 9001:2015 dhe ISO 14001:2015 pa verifikuar autenticitetin e tyre, në kundërshtim me nenin 79 të ligjit nr. 162/2020 dhe nenin 44 të VKM nr. 285/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Plani i zbatimit të kontratës nuk përmban grafikun e shërbimeve dhe

periodicitetin e tyre, në kundërshtim me nenin 74, pika 4, germa "d" të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik. Komisioni i zbatimit të kontratës nuk ka hartuar raportin narrativ të zbatimit, në kundërshtim me nenin 2, germa "ll" të nr. 285/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Procesverbalet e pranimit të shërbimit nuk përmbajnë fletë-hyrje në magazinë për pjesët e zëvendësuara, nuk kanë nënshkrim nga operatori ekonomik dhe mungon protokolli hyrës, duke shkelur kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

21.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor të sigurojë që përcaktimi i fondit limit të mbështetet në një analizë të plotë dhe të dokumentuar të tregut, si dhe në një argumentim financiar të qartë për çdo ndryshim apo shtesë fondi. Njëkohësisht, strukturat përgjegjëse të Autoritetit Kontraktor të garantojnë që specifikimet teknike të jenë të plota, të argumentuara dhe të mbështetura në dokumentacion teknik dhe standarde përkatëse, duke përcaktuar qartë elementët e shërbimit. Njësia e prokurimit të rishikojë dhe përshtatë kriteret e kualifikimit me objektin e kontratës, duke siguruar që ato të jenë proporcionale, të lidhura drejtpërdrejt me nevojat e shërbimit dhe të fokusohen në kapacitetet reale profesionale të nevojshme për zbatimin e tij.

Autoriteti Kontraktor dhe strukturat përgjegjëse të garantojnë që çdo ndryshim në specifikimet teknike të jetë i argumentuar dhe i dokumentuar plotësisht. Gjithashtu, të sigurohet që dokumentacioni i hartuar nga grupet e punës të jetë i plotë dhe i nënshkruar nga të gjithë anëtarët, duke garantuar vlefshmëri dhe transparencë në procesin e prokurimit dhe administrimit të dokumentacionit përkatës. Strukturat e vlerësimit të ofertave të forcojnë kontrollin mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë, për të shmangur mospërputhjet në vlerësim. Në fazën e zbatimit, të sigurohet planifikimi i qartë i shërbimeve dhe mallrave, dokumentimi i rregullt i dorëzimeve të mallrave dhe shërbimeve, si dhe administrimi i plotë i dokumentacionit përkatës (përfshirë magazinën dhe protokollimin), me qëllim garantimin e gjurmueshmërisë dhe kontrollit administrativ e financiar.

Menjëherë dhe në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit me objekt "Blerje reagentësh dhe materiale laboratori" për vitin 2023, me fond limit 2,700,090 lekë pa TVSH, si dhe për vitin 2024, me fond limit 2,363,616 lekë pa TVSH, për subjektin "K", me NIPT K.....A u konstatua se:

- Në *argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta për kualifikim*" dhe në DST, komisioni përkatës nuk ka përdorur shprehjen "ose ekuivalenti i tij/saj", nuk ka përcaktuar kriterin mbi afatin minimal të skadencës së mallrave në momentin e lëvrimit, veprim në kundërshtim me nenin 36, pika 3/c të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
- Procesverbalet e marrjes në dorëzim të mallit nuk përmbajnë të dhëna lidhur me dokumentacionin shoqërues për procedurat e pranimit të mallit, si certifikatat e origjinës, testimet dhe analizat e mallrave, si dhe certifikatat e cilësisë së materialeve/mallrave, veprim është në kundërshtim me nenin 13 "Paketimi dhe dokumentet" dhe nenin 16 "Inspektimet dhe testet" të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK), si dhe me nenin 3 "Inspektimet dhe Testet" dhe nenin 8 "Paketimi dhe Dokumentet" të Kushteve të Veçanta të Kontratës të Kontratës nr. 1327/3, datë 05.06.2023.
- Autoriteti Kontraktor ka vendosur si kriter të detyrueshëm zotërimin nga operatori ekonomik të profileve profesionale specifike si inxhinier elektronik, informatikë, telekomunikacioni, kimist ose inxhinier mjedisi gjë që nuk është në përputhje me nenin 41, pika 4, të VKM nr. 285/2021, të ndryshuar. Ky nen parashikon që për kontratat e shërbimeve, autoriteti kontraktor duhet të

referohet në kriteret e licencimit profesional të lëshuara nga autoritetet shtetërore kompetente dhe/ose në paraqitjen e një liste të personelit kryesor të domosdoshëm për zbatimin e objektit të prokurimit.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në procesin e vlerësimit të ofertave dhe në procesverbalin përfundimtar, nuk ka verifikuar nëse certifikatat e lëshuara nga L përbëjnë certifikata të lëshuara nga një organ i pavarur i njohur nga sistemet e standardizimit ndërkombëtar, nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, apo nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, në kundërshtim me Dokumentet Standarde të Tenderit, nenin 79 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, si dhe nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik.
- Nga auditimi u konstatua se procesverbalet për marrjen në dorëzim të mallit nuk janë firmosur nga dorëzuesi i mallit dhe nuk përmbajnë të dhëna mbi datën e skadencës, sipas kritereve të përcaktuara në DST, në kundërshtim me nenin 36.3.b të ligjit nr. 162/2020, të ndryshuar, si dhe nenin 2 të VKM nr. 285/2021, të ndryshuar. Gjithashtu, aktet e dorëzimit të datave 05.12.2024 dhe 24.12.2024, të pranuara nga grupi i zbatimit të kontratës, nuk janë firmosur nga përfaqësuesi i operatorit ekonomik dhe nuk kanë numër protokolli hyrës në institucion, në mospërputhje me kërkesat Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
22.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor të marrë masa për hartimin e specifikimeve teknike dhe dokumenteve të tenderit në mënyrë të qartë dhe gjithëpërfshirëse, duke garantuar përdorimin e termit "ose ekuivalenti i tij/saj" dhe përcaktimin e kërkesave mbi cilësinë dhe afatin e përdorimit të mallrave.
Njëkohësisht, të sigurohet administrimi i plotë dhe i dokumentuar i procesit të pranimit të mallrave, si dhe rishikimi i kritereve të kualifikimit dhe forcimi i verifikimit të dokumentacionit të operatorëve ekonomikë, me qëllim garantimin e përputhshmërisë dhe cilësisë së furnizimeve.
Në vijim, të garantohet që dokumentacioni shoqërues dhe aktet e dorëzimit të jenë të plota, të nënshkruara dhe të protokolluara, në funksion të sigurimit të gjurmueshmërisë, transparencës dhe kontrollit në procesin e prokurimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Inspektimit dhe Kontrollit nuk ka realizuar një vlerësim të mirëfilltë dhe të vazhdueshëm të riskut për kategorizimin e subjekteve të inspektimit. Baza e të dhënave për pajisjet me leje mjedisi është e paplotë dhe me mospërputhje, ndërsa faktorët e riskut janë përcaktuar por mungon rregullorja për zbatimin e tyre. Nuk janë marrë parasysh risqet e përgjithshme mjedisore, burimet në dispozicion, historiku dhe performanca e operatorëve. Programi vjetor i inspektimit është hartuar sipas fushave të veprimtarisë që pajisen me leje mjedisi, por pa u bazuar në vlerësimin e riskut, në kundërshtim me nenin 24 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*".
Gjithashtu nga auditimi i realizimit të programeve vjetore të inspektimit u konstatua se, në total për periudhën objekt auditimi, është realizuar vetëm rreth 50% e numrit të inspektimeve të planifikuara, duke ulur efektivitetin e funksionit mbikëqyrës dhe duke rritur riskun për mungesë kontrolli të plotë mbi subjektet që duhet të inspektohen. Mungesa e një vlerësimi të mirëfilltë të riskut dhe planifikimi i inspektimeve pa u bazuar në këtë qasje, së bashku me mosrealizimin e plotë të programeve vjetore të inspektimit, kanë dobësuar ndjeshëm efektivitetin e funksionit mbikëqyrës të institucionit. Si pasojë, rritet risku për mosidentifikim dhe mosadresim në kohë të

subjekteve me ndikim më të lartë mjedisor, duke ulur cilësinë e kontrollit dhe duke rritur mundësinë e shkeljeve të pazbuluara dhe ndikimeve negative në mjedis.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5. faqet nr. 163-303 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
23.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa për hartimin dhe zbatimin e një metodologjie të unifikuar të vlerësimit të riskut për planifikimin e inspektimeve, të miratojë rregulloren përkatëse për faktorët e riskut dhe të përditësojë bazën e të dhënave për subjektet me leje mjedisi.

Menjëherë dhe në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i praktikave të inspektimit për çështjen nr. AKM-BR-2024-000157 të subjektit K. I. SH.A rezultoi se, megjithëse në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit është vendosur masa administrative plotësuese "pezullim aktiviteti", nga ana e Agjencisë Rajonale Mjedisore Berat nuk evidentohet dokumentim i njoftimit zyrtar me shkrim për këtë masë, të arsyetuar dhe të komunikuar, si subjektit ashtu edhe autoritetit licencues, në kundërshtim me pikën 1 dhe 2 të nenit 66 të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 "*Për mbrojtjen e mjedisit*", i ndryshuar.
Mungesa e dokumentimit dhe gjurmueshmërisë së zbatimit të masës së "pezullim aktiviteti" ka sjellë pasiguri në zbatueshmërinë praktike të vendimit dhe dobësim të kontrollit mbi masat e vendosura. Si pasojë, cenohet efektiviteti i masave inspektuese dhe rritet risku për moszbatim real të vendimmarrjeve administrative.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5. faqet nr. 163-303 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
24.1 Rekomandimi: Titullari i AKM-së në bashkëpunim me Agjencitë Rajonale Mjedisore të marrë masa për sigurimin dhe zbatimin e plotë të procedurës së "pezullim aktiviteti", në çdo rast të vendosjes së kësaj mase, duke garantuar formalizimin, nxjerrjen dhe komunikimin e njoftimit me shkrim të arsyetuar ndaj subjektit dhe autoritetit licencues, si dhe forcimin e ndjekjes dhe verifikimit të zbatimit të saj brenda afateve të përcaktuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se autoriteti përgjegjës për funksionimin e inspektimit mjedisor nuk ka hartuar dhe miratuar metodologjinë për përcaktimin e masave administrative, veprim në kundërshtim me nenin 48, pikat 7 dhe 8 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".
Mungesa e kësaj metodologjie nuk garanton ekzistencën e një kuadri të standardizuar dhe të dokumentuar për përcaktimin e masave administrative nga inspektorët, duke krijuar risk për trajtim jo të unifikuar të rasteve të ngjashme dhe për moszbatim të njëtrajtshëm të legjislacionit gjatë procesit inspektues.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5. faqet nr. 163-303 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
25.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa për hartimin dhe zbatimin e një metodologjie të unifikuar për vendosjen e masave administrative, me qëllim standartizimin e praktikave dhe sigurimin e trajtimit të njëjtë të subjekteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i strukturave dhe organikave të AKM dhe ARM rezultoi se, gjatë periudhës objekt auditimi, janë evidentuar pozicione vakante krahasuar me numrin e miratuar në organikë, konkretisht: në vitin 2021, në ARM Berat 3 pozicione, në ARM Fier 1, në ARM Lezhë 5 dhe në ARM Tiranë 6; në vitin 2022, në ARM Berat 3, në ARM Fier 4, në ARM Lezhë 7 dhe në ARM Tiranë 6; në vitin 2023, në AKM 3, në ARM Berat 4, në ARM Fier 5, në ARM Lezhë 5 dhe në ARM Tiranë 2; në vitin 2024, në AKM 3, në ARM Berat 6, në ARM Fier 5,

në ARM Lezhë 4 dhe në ARM Tiranë 3; ndërsa në vitin 2025, në AKM 2, në ARM Fier 2, në ARM Lezhë 3 dhe në ARM Tiranë 1, krahasuar me numrin e miratuar në organikë, në kundërshtim me: Urdhrin nr. 23, datë 03.02.2020 të Kryeministrit *"Për miratimin e strukturës dhe të organikës së AKM-së"*; Urdhrin nr. 187, datë 15.11.2022 të Kryeministrit për *"Miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit"*; Urdhrin nr. 29, datë 13.02.2024 të Kryeministrit *"Për miratimin e strukturës dhe të organikës së AKM-së"* dhe Urdhrin nr. 194, datë 04.10.2024 të Kryeministrit *"Për miratimin e strukturës dhe të organikës së AKM-së"*, skemat 1/2 dhe 2/2, duke sjellë për pasojë ulje të efektivitetit dhe eficiencës të këtyre sektorëve.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5. faqet nr. 163-303 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
26.1 Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Agjencitë Rajonale Mjedisore të marrin masa për plotësimin e pozicioneve vakante në përputhje me strukturën dhe organikën e miratuar, me qëllim rritjen e kapaciteteve institucionale dhe përmirësimin e efektivitetit dhe eficiencës së funksionimit të strukturave përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Agjencitë Rajonale Mjedisore nuk kanë dorëzuar në mënyrë periodike Analizat Vjetore në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, konkretisht: ARM Tiranë nuk ka dorëzuar Analizën Vjetore për vitin 2023; ARM Lezhë nuk ka raportuar Analizë Vjetore për tre vite radhazi, përkatësisht 2021, 2022 dhe 2023; ARM Fier nuk ka përmbushur këtë detyrim për vitet 2021 dhe 2022; ndërsa ARM Berat rezulton të mos ketë dërguar Analizën Vjetore për periudhën 2022–2024, në kundërshtim me nenin 22 dhe 23 të Rregullores së Brendshme *"Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit".* Mungesa e dorëzimit të Analizave Vjetore nga Agjencitë Rajonale sjell dobësim të procesit të monitorimit, reduktim të transparencës dhe vështirësi në identifikimin në kohë të problematikave dhe masave korrigjuese, duke ndikuar negativisht në planifikimin dhe vendimmarrjen strategjike në fushën e mbrojtjes së mjedisit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5. faqet nr. 163-303 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
27.1 Rekomandim: Agjencitë Rajonale Mjedisore të marrin masa për përgatitjen dhe dërgimin e analizave vjetore të veprimtarisë, në përputhje me kërkesat ligjore, si dhe të forcojë mekanizmat e monitorimit dhe raportimit për respektimin e këtij detyrimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

28. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të inspektimeve të kryera për subjektin K. I. SH.A. për periudhën 2021–2025, ku janë shqyrtuar gjithsej 10 çështje inspektimi, rezultoi se trupat inspektuese nuk është siguruar një mbulim i plotë dhe i dokumentuar i zbatimit të kushteve të lejeve mjedisore që lidhen me veprimtarinë e subjektit, pavarësisht se ai ushtron aktivitet me ndikim të lartë mjedisor.
Nga verifikimi i dosjeve të inspektimit evidentohet se dokumentimi i konstatimeve është i paplotë dhe në disa raste i pambështetur në prova të mjaftueshme dhe të verifikueshme. Gjithashtu, mungon një gjurmueshmëri e qartë e veprimeve të kryera gjatë inspektimeve, duke e bërë të vështirë vlerësimin e plotë të procesit inspektues dhe të arsyetimit të konkluzioneve të arritura.
Gjithashtu, u konstatua se nuk është siguruar ndjekje efektive dhe sistematike e masave dhe detyrave të lëna nga inspektimet e mëparshme. Detyrat e lëna nuk janë monitoruar deri në përmbushje, ndërsa nuk është aplikuar qasje përshkallëzuese në rastet e përsëritjes së shkeljeve, veçanërisht në fushën e menaxhimit të mbetjeve dhe në përmbushjen e detyrimeve dokumentare mjedisore, në kundërshtim me pikat 15-17, kreu IV të Urdhrit e Inspektoratit Qendror nr. 25, datë

10.08.20218, për miratimin e rregullores *"Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve si një proces i rregullt administrativ".*
Këto mangësi janë të lidhura me dobësi në analizën e riskut, në planifikimin e inspektimeve dhe në ndjekjen e tyre në kohë, si dhe me mungesë të njëtrajtshmërie në interpretimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor nga strukturat inspektuese, në kundërshtim me pikën 3, nenin 45 të ligjit nr. 10433/2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.*
Si rezultat i këtyre mangësive, procesi i inspektimit nuk ka arritur të garantojë një kontroll efektiv dhe të vazhdueshëm mbi respektimin e kërkesave mjedisore nga subjekti. Përsëritja ndër vite e të njëjtave problematika pa ndërhyrje korrigjuese efektive ka ulur ndikimin parandalues dhe korrigjues të inspektimeve, duke rritur riskun për ndikime negative në mjedis dhe duke dobësuar efektivitetin e zbatimit të legjislacionit mjedisor.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5. faqet nr. 163-303 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
28.1 Rekomandimi: Drejtoria e Inspektimit dhe Kontrollit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe në Agjencitë Rajonale Mjedisore të marrë masa për kryerjen e inspektimeve të mëtejshme ndaj subjektit "K. I" SH.A., me fokus verifikimin e zbatimit të kushteve të lejes mjedisore, dokumentimin e plotë të konstatimeve dhe ndjekjen e përmbushjes së detyrave të lëna nga inspektimet e mëparshme. Në rastet e konstatimit të shkeljeve të përsëritura ose moszbatimit të masave të kërkuara, të merren masat administrative të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.
28.2 Rekomandimi: Drejtoria e Inspektimit dhe Kontrollit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe në Agjencitë Rajonale Mjedisore të marrë masa për forcimin e procedurave të monitorimit dhe riinspektimit të subjekteve me risk të lartë mjedisor, duke siguruar dokumentim të plotë të veprimeve inspektuese, ndjekje sistematike të detyrave të lëna dhe zbatim të një qasjeje të njëtrajtshme dhe përshkallëzuese ndaj rasteve të përsëritura të mosrespektimit të kërkesave mjedisore.

Menjëherë dhe në vijimësi

29. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i parashikimit dhe zbatimit të buxhetit për periudhën objekt auditimi, u konstatua se është i pranishëm risku i kryerjes së parashikimeve të pabazuara të cilat reflektohen në përqindje të ulët realizimi dhe në rialokime përgjatë vitit.
-Në vitin 2023 për llogarinë 602 "Mallra dhe shërbime" është kërkuar shtesë fondi me shkresën nr. 4895 prot., 29.06.2023 në shumën 4,200,000 lekë duke treguar nën-planifikim fillestar. Në të njëjtin vit për llogarinë 606 "Transferta për individë" nuk ka pasur planifikim fillestar, por gjatë vitit u alokuan 520 mijë lekë. Kjo lidhet me dalje në pension, që nuk ishte parashikuar me saktësi në PBA. Transferimet korente janë realizuar në masën 67% me një diferencë prej 3,264 mijë lekë, që vjen për shkak të ndryshimit të nevojave gjatë vitit buxhetor dhe pasqyron planifikim jo të saktë. Kategoria e mallra shërbimeve ka realizim të pjesshëm në masën 67%. Gjithashtu, në lidhje me investimet u konstatua se pavarësisht se janë planifikuar, ato nuk kanë kaluar në fazën e zbatimit, për shkak të mungesës së fondeve të alokuara në buxhetin vjetor. Kjo situatë tregon mungesë koherence midis planifikimit afatmesëm dhe buxhetimit vjetor operativ, duke sjellë si rezultat mosrealizimin e plotë të projekteve të investimeve për vitin 2023.
-Për vitin 2024 niveli i realizimit ka pësuar rënie në rreth 83–85%, si pasojë e reduktimit të fondeve gjatë rishikimit buxhetor dhe shtyrjes së disa shpenzimeve. Gjithashtu, transferimet korente janë me realizim 80%, pra mbeten të papërdorura rreth 955 mijë lekë.
-Për vitin 2025 niveli i realizimit pëson rritje në masën 91%, por me fokus të ulët te investimet. Për llogarinë 231 janë kërkuar në PBA 2025-2027 542,044 mijë lekë, por fondi nuk është alokuar, përveç shumës 2,000 mijë lekë. Gjithashtu, vihet re realizim më i ulët, konkretisht në masën 78% për llogarinë 602 "Mallra dhe Shërbime" dhe llogarinë 606 "Shpenzime fondi i veçantë".

Kjo bie në kundërshtim me Ligjin nr.9963 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, neni 3, pika 29, neni 4 pika a dhe c.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 12-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
29.1. Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa që strukturat përgjegjëse për programimin dhe planifikimin buxhetor të kryejnë analizat e nevojshme për një parashikim dhe zbatim buxheti të suksesshëm, duke patur parasysh nevojat reale gjatë vitit buxhetor.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NÉ ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së shqyrtimit të ankimimit dhe vendimmarrjes për shfuqizimin e masës administrative ndaj subjektit "O.-P" SHPK, me NIPT L.....B, konstatohet se: subjekti është ndëshkuar me vendimin përfundimtar të inspektimit nr. AKM-TR-2023-000069-5, datë 01.08.2023 në vlerën 300,000 lekë, për moszbatim të kushteve të lejes mjedisore, ndër të cilat edhe mos menaxhimi i mbetjeve dhe ujërave të përdorura në procesin teknologjik. Nga verifikimet në terren, sipas listës së verifikimit, rezultoi se subjekti nuk kishte të përcaktuar një vend të posaçëm për grumbullimin e mbetjeve, duke sjellë shpërndarjen e tyre në ambient dhe rrezik për ndotje të tokës dhe ujërave sipërfaqësore.
Pavarësisht këtyre konstatimeve, Komisioni i Shqyrtimit të Ankimimit ka vendosur shfuqizimin e masës administrative, duke u mbështetur në dokumentacionin dhe provat e paraqitura nga subjekti pas kryerjes së inspektimit, përfshirë kontratën e datës 24.06.2023 për menaxhimin e mbetjeve dhe pretendimet për korrigjimin e situatës. Megjithatë, këto prova nuk rrëzojnë konstatimin faktik të bërë në momentin e inspektimit dhe nuk provojnë përmbushjen e plotë të detyrimeve në kohën e verifikimit.
- Nga auditimi i procedurës së shqyrtimit të ankimimit dhe vendimmarrjes për shfuqizimin e masës administrative ndaj subjektit "S" SHPK, me NIPT K.....E, konstatohet se: subjekti është ndëshkuar me vendimin përfundimtar të inspektimit nr. AKM-LE-2025-000087-5, datë 28.03.2025, në vlerën 300,000 lekë, për moszbatim të detyrimeve të lejes mjedisore, përfshirë mungesën e raportimit vjetor, mungesën e dokumentacionit të vetë monitorimit, si dhe mos pagesën e tarifës vjetore gjatë periudhës së ushtrimit të aktivitetit. Nga verifikimet rezulton se gjatë kohës që subjekti ka qenë aktiv nuk ka paraqitur dokumentacionin përkatës dhe nuk ka përmbushur detyrimet ligjore që rrjedhin nga leja mjedisore.
Pavarësisht këtyre shkeljeve substanciale, Komisioni i Shqyrtimit të Ankimimit ka vendosur shfuqizimin e masës administrative, duke u mbështetur vetëm në një element procedural që lidhet me vendin e kryerjes së inspektimit. Megjithatë, sipas nenit 33 dhe nenit 45 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* inspektimi mund të kryhet edhe në ambientet e organit inspektues kur kjo është e mundur nga natyra e inspektimit, duke mos përbërë shkelje procedurale që cenon vlefshmërinë e aktit.
Gjithashtu, komisioni nuk ka kryer një analizë të plotë mbi shkeljet e konstatuara në drejtim të monitorimit, raportimit dhe pagesës së tarifës vjetore gjatë periudhës kur subjekti "S" ka qenë aktiv, duke e bazuar vendimmarrjen vetëm në pretendime procedurale dhe jo në përmbajtjen e shkeljeve.
Për rrjedhojë, konstatohet se shfuqizimi i masave administrative është kryer në kundërshtim me nenin 137, pika 2 të ligjit nr. 44/2015 *"Kodi i Procedurave Administrative i RSH",* i ndryshuar,

sipas të cilit ankimi refuzohet kur rezulton i pabazuar, pasi në rastin konkret nuk provohet eliminimi i shkeljeve në momentin e inspektimit.
Kjo situatë tregon për vlerësim jo të plotë dhe jo të drejtë të provave nga ana e komisionit, duke sjellë anulimin e një mase administrative të vendosur në mënyrë të ligjshme nga trupa inspektuese. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5. faqet nr. 163-303 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
1.1 Rekomandimi: Autoriteti përgjegjës për shqyrtimin e ankimimeve të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për vlerësimin e praktikave të ndjekura në shqyrtimin e ankimimeve administrative dhe përcaktimin e përgjegjësive institucionale dhe individuale që kanë shkaktuar efekt financiar në vlerën 300,000 lekë, me qëllim identifikimin e masave korrigjuese dhe parandaluese për garantimin e ligjshmërisë, rritjen e efektivitetit dhe përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes administrative.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, si rezultat i ndryshimit të kuadrit ligjor në vitin 2025, konkretisht nenit 44 të ligjit nr. 99/2024 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* i cili parashikon "paralajmërimin" si masë administrative kryesore në rastin e inspektimit të parë, strukturat e AKM dhe ARM-ve kanë aplikuar në mënyrë të njëtrajtshme këtë masë për të gjitha subjektet e inspektuara.
Si pasojë, në nivel të strukturave rajonale, përkatësisht në ARM Lezhë, Berat, Fier dhe Tiranë, janë evidentuar 15 raste ku, pavarësisht natyrës së shkeljeve të konstatuara, është aplikuar masa "paralajmërim" në vend të masave administrative të parashikuara.
Nga analiza e kryer rezultoi se ky interpretim nuk ka qenë i saktë, pasi në një pjesë të rasteve subjektet nuk ndodheshin në kushtet e inspektimit për herë të parë, ndërkohë që dispozita e nenit 44 të ligjit nr. 99/2024 nuk mund të interpretohet në kundërshtim me ligjet e posaçme mjedisore. Ligji i inspektimit ka karakter të përgjithshëm dhe procedural, ndërsa ligjet e posaçme, si ligji nr. 10448/2011 "*Për lejet e mjedisit*", ligji nr. 10431/2011 "*Për mbrojtjen e mjedisit*", ligji nr. 10463/2011 "*Për menaxhimin e integruar të mbetjeve*" dhe ligji nr. 29/2024 "*Për burimet ujore*", përcaktojnë në mënyrë të qartë shkeljet dhe masat administrative konkrete.
Për rrjedhojë, zbatimi automatik dhe i njëtrajtshëm i masës "paralajmërim", pa verifikuar në mënyrë të saktë nëse subjekti ndodhej realisht në inspektim të parë dhe pa marrë në konsideratë natyrën, rëndësinë e shkeljes, si dhe pa aplikuar sanksionet e parashikuara në ligjet e posaçme, ka sjellë devijim nga kuadri ligjor material. Si rezultat, ky interpretim dhe zbatim jo i saktë i nenit 44 të ligjit nr. 99/2024 ka ndikuar në uljen e efektit ndëshkues dhe parandalues të veprimtarisë inspektuese në nivel të strukturave rajonale.
Konkretisht, nga auditimi i inspektimeve të kryera nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe strukturat rajonale, u konstatua se:
- në 32 raste (12 AKM, 6 ARM Tiranë, 3 ARM Lezhë, 4 ARM Fier dhe 7 ARM Berat) është vendosur masë administrative *"Paralajmërim",* ndonëse subjektet kanë qenë në shkelje të kushteve të lejes mjedisore të tipit B, në kundërshtim me nenin 29, pika 1/b (ii) të ligjit nr. 10448, datë 07.07.2011 *"Për lejet e mjedisit",* i ndryshuar, i cili parashikon vendosjen e masës administrative gjobë në vlerën nga 300,000 deri në 500,000 lekë për këto shkelje.
- në 1 rast, konkretisht në ARM Berat është vendosur administrative *"Paralajmërim",* ndonëse subjektet kanë qenë në shkelje të kushteve të lejes mjedisore të tipit A, në kundërshtim me nenin 29, pika 1/b (i) të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 *"Për lejet e mjedisit",* i ndryshuar, i cili parashikon vendosjen e masës administrative gjobë në vlerën nga 1,000,000 deri në 2,000,000 lekë për këto shkelje.

- në 1 rast, konkretisht në AKM është vendosur masë administrative paralajmërim, ndonëse subjektet kanë qenë në shkelje të pikave 2-3 të nenit 16 të ligjit nr. 10448, datë 14.07.20111 "Për lejet e mjedisit" i ndryshuar, i cili parashikon vendosjen e masës administrative gjobë në vlerën nga 1,000,000 deri në 2,000,000 lekë për këto shkelje.

Në këto kushte, vendosja e masës *"Paralajmërim"* në vend të masës administrative gjobë përbën zbatim jo të drejtë të legjislacionit në fuqi dhe trajtim jo proporcional të shkeljeve të konstatuara, duke mos reflektuar ashpërsinë e kundërvajtjes administrative.

Mosaplikimi i masës së duhur administrative ka sjellë mosndëshkimin e plotë të shkeljeve, duke dobësuar efektin parandalues dhe korrektues të inspektimeve. Mosaplikimi i masës së duhur administrative ka sjellë mosndëshkimin e plotë të shkeljeve, duke dobësuar efektin parandalues të inspektimeve në intervalin e vlerave nga 11,600,000 lekë deri në 20,000,000 lekë.

Gjithashtu, kjo praktikë rrit riskun e përsëritjes së shkeljeve dhe cenon efektivitetin e zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit.

Në mënyrë analitike subjektet përkatëse paraqiten në tabelën nr. 1, Aneksi nr. 1.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5. faqet nr. 163-303 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Inspektimit dhe Kontrollit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe në Agjencitë Rajonale Mjedisore të marrë masa për zbatimin rigoroz të kuadrit rregullator në fuqi, duke siguruar që në rastet e moszbatimit të kushteve të lejes mjedisore apo mosrespektimin e detyrimeve të tjera, të aplikohet masa administrative përkatëse dhe jo masa më e lehtë "Paralajmërim".

Gjithashtu, të forcohen mekanizmat e kontrollit dhe mbikëqyrjes së brendshme mbi vendimmarrjen e trupave inspektuese, me qëllim garantimin e një trajtimi të njëtrajtshëm të shkeljeve dhe rritjen e efektivitetit parandalues të masave administrative.

2.2 Rekomandimi: Titullari i AKM-së të ngrejë një grup pune për shqyrtimin e problematikave të konstatuara nga auditimi, evidentimin e shkeljeve dhe përcaktimin e përgjegjësive institucionale dhe individuale që kanë shkaktuar efekt financiar nga vlera 11,600,000 lekë deri në 20,000,000 lekë, me qëllim identifikimin e masave korrigjuese dhe parandaluese për garantimin e ligjshmërisë, rritjen e efektivitetit dhe përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes administrative.

2.3 Rekomandimi: Drejtoria e Inspektimit dhe Kontrollit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe në Agjencitë Rajonale Mjedisore të përfshijë në planet vjetore të inspektimeve subjektet e evidentuara me problematika, me qëllim verifikimin në terren të respektimit të kushteve të lejes dhe identifikimin e ndikimeve të mundshme në mjedis.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i inspektimeve të kryera nga Agjencia Rajonale e Mjedisit Berat konstatohet se në 2 raste, përkatësisht për subjektet "E" me Nipt K.....C dhe "C. E" me Nipt K.....T, është vendosur masë administrative *"Paralajmërim",* ndonëse subjektet kanë qenë në shkelje të kushteve të lejes mjedisore dhe të legjislacionit për burimet ujore. Konkretisht, shkeljet e konstatuara në procesverbal janë në kundërshtim me nenin 41 dhe të sanksionuara sipas pikës 3 të nenit 97 të ligjit nr. 111/2012 *"Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore",* i ndryshuar, për të cilat parashikohet masë administrative gjobë në intervalin 500,000-1,000,000 lekë. Pavarësisht kësaj, është vendosur masë *"Paralajmërim",* në kundërshtim me parashikimet ligjore. Gjithashtu, në 1 rast tjetër, për subjektin "I." me Nipt M.....C, është vendosur masë *"Paralajmërim"* e paargumentuar, ndërkohë që shkelja rezulton në kundërshtim me nenin 137 të ligjit nr. 29/2004, dhe sanksioni përkatës parashikohet sipas pikës 9 të nenit 169 të ligjit nr. 29/2004 *"Për burimet ujore",* ku për këto kundërvajtje parashikohet gjobë në intervalin 1,000,000-2,000,000 lekë.

Në këto kushte, vendosja e masës *"Paralajmërim"* në vend të gjobës përbën zbatim jo të drejtë të legjislacionit në fuqi dhe trajtim jo proporcional të shkeljeve të konstatuara. Mosaplikimi i masave administrative sipas parashikimeve ligjore në intervalin e vlerave nga 2,000,000 deri në 4,000,000 lekë, duke rritur gjithashtu riskun e përsëritjes së shkeljeve dhe cenimin e mbrojtjes së burimeve ujore. *Në mënyrë analitike subjektet paraqiten në tabelën nr. 2, Aneksi nr. 1.*
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5. faqet nr. 163-303 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
3.1 Rekomandim: Drejtoria e Inspektimit dhe Kontrollit të marrë masa për aplikimin korrekt të masave administrative, duke siguruar që në rastet e shkeljes së kushteve të lejes mjedisore dhe të legjislacionit për burimet ujore të vendoset masa administrative gjobë sipas parashikimeve ligjore dhe jo *"Paralajmërim".* Gjithashtu, të garantohet arsyetimi i plotë dhe i dokumentuar i çdo vendimmarrjeje, në mënyrë që të shmanget trajtimi jo proporcional i shkeljeve dhe të rritet efektiviteti parandalues i inspektimeve.
3.2 Rekomandimi: Titullari i AKM-së të ngrejë një grup pune për shqyrtimin e problematikave të konstatuara nga auditimi, evidentimin e shkeljeve dhe përcaktimin e përgjegjësive institucionale dhe individuale që kanë shkaktuar efekt financiar nga vlera 2,000,000 lekë deri në 4,000,000 lekë, me qëllim identifikimin e masave korrigjuese dhe parandaluese për garantimin e ligjshmërisë, rritjen e efektivitetit dhe përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes administrative.
3.3 Rekomandimi: Drejtoria e Inspektimit dhe Kontrollit të përfshijë në planet vjetore të inspektimeve subjektet e evidentuara me problematika, me qëllim verifikimin në terren të respektimit të kushteve të lejes dhe identifikimin e ndikimeve të mundshme në mjedis.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i inspektimeve të kryera nga AKM dhe strukturat rajonale u konstatua zbatim jo i drejtë i masave administrative, pasi në disa raste është vendosur masa "Paralajmërim" në kundërshtim me parashikimet ligjore që sanksionojnë vendosjen e gjobës. Konkretisht:
- në 1 rast në ARM Berat për subjektin "P-G" me Nipt M.....B, për shkelje në kundërshtim me nenin 58 të ligjit nr. 10463/2011 *"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve",* ku për të cilën në pikën 58, të nenit 62 të po këtij ligji parashikohet dënim administrativ "gjobë" në shumën 1,000,000-1,500,000 lekë.
- në 1 rast në ARM Fier për subjektin "I. T. W. T" me Nipt L.....F, për shkelje në kundërshtim me nenin 45 të ligjit nr. 10463/2011 *"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve",* ku për të cilën në pikën 45 të nenit 62 të po këtij ligji për të cilën parashikohet dënim administrativ "gjobë" në shumën nga 1,000,000 deri në 1,500,000 lekë, është hequr gjoba e vendosur dhe është lënë masa "Paralajmërim";
- në 5 raste në AKM, përkatësisht subjektet "B" me Nipt K.....F, "Ch. C" me Nipt L.....D, "K" me Nipt K.....D, "B" me Nipt J.....S, "Z" me Nipt K.....M, për shkelje në kundërshtim me nenin 61 të ligjit nr. 10463/2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", ku për të cilat në pikën 61 të nenit 62 të po këtij ligji për të cilën parashikohet dënim administrativ "gjobë" në shumën nga 500,000 deri në 1,000,000 lekë, është hequr gjoba e vendosur dhe është lënë masa "Paralajmërim";
- në 2 raste në ARM Tiranë, përkatësisht subjekti "K" me Nipt K.....F dhe "Pastrimi Dentar" me Nipt J.....H, për shkelje në kundërshtim me nenin 21 të ligjit nr. 10463/2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", ku për të cilat në pikën 6 të nenit 62 të po këtij ligji për të cilën parashikohet dënim administrativ "gjobë" në shumën nga 1,000,000 deri në 1,500,000 lekë, është hequr gjoba e vendosur dhe është lënë masa "Paralajmërim".
- në 1 raste në ARM Lezhë subjekti "S.U." me Nipt J.....Q, për shkelje në kundërshtim me nenin 21 të ligjit nr. 10463/2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", ku për të cilat në pikën 8-9-

10 të nenit 62 të po këtij ligji për të cilën parashikohet dënim administrativ "gjobë" në shumën nga 300,000 deri në 500,000 lekë, është hequr gjoba e vendosur dhe është lënë masa "Paralajmërim". Në këto kushte, vendosja e masës "Paralajmërim" në vend të gjobës përbën zbatim jo të drejtë të legjislacionit në fuqi dhe trajtim jo proporcional të shkeljeve të konstatuara. Mosaplikimi i sanksioneve të parashikuara ka sjellë mosndëshkimin e plotë të shkeljeve në intervalin e vlerave nga 6,800,000 lekë deri në vlerën 11,500,000 lekë, si dhe rrit riskun e përsëritjes së shkeljeve në fushën e menaxhimit të mbetjeve.

Në mënyrë analitike subjektet paraqiten në tabelën nr. 3, Aneksi nr. 1.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5. faqet nr. 163-303 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandim: Drejtoria e Inspektimit dhe Kontrollit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe në Agjencitë Rajonale Mjedisore të marrë masa për zbatimin e saktë dhe të njëtrajtshëm të kuadrit ligjor, duke siguruar që në rastet e shkeljeve të konstatuara në fushën e menaxhimit të mbetjeve të aplikohet masa administrative përkatëse sipas parashikimeve ligjore dhe jo masa "Paralajmërim".

4.2 Rekomandimi: Titullari i AKM-së të ngrejë një grup pune për shqyrtimin e problematikave të konstatuara nga auditimi, evidentimin e shkeljeve dhe përcaktimin e përgjegjësive institucionale dhe individuale që kanë shkaktuar efekt financiar nga vlera 6,800,000 lekë deri në 11,500,000 lekë, me qëllim identifikimin e masave korrigjuese dhe parandaluese për garantimin e ligjshmërisë, rritjen e efektivitetit dhe përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes administrative.

4.3 Rekomandimi: Drejtoria e Inspektimit dhe Kontrollit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe në Agjencitë Rajonale Mjedisore të përfshijë në planet vjetore të inspektimeve subjektet e evidentuara me problematika, me qëllim verifikimin në terren të respektimit të kushteve të lejes dhe identifikimin e ndikimeve të mundshme në mjedis.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i inspektimeve të kryera nga AKM dhe strukturat rajonale konstatohet zbatim jo i drejtë i masave administrative, pasi në 7 raste është vendosur masa "Paralajmërim" në kundërshtim me parashikimet ligjore që sanksionojnë vendosjen e gjobës. Konkretisht:

- në 5 raste në ARM Lezhë, përkatësisht subjektet "A...C" me Nipt K.....Q, "E. B" me Nipt K.....B, "R" me Nipt L.....A, "K. K" me Nipt M.....R, "L. I" me Nipt J.....P dhe 2 raste në ARM Fier, subjekti "A." me Nipt K.....L dhe "B" me Nipt J.....Q, për shkelje në kundërshtim me pikat 1, 2, 3 të nenit 25/1 të ligjit 10440 *"Për ndikimin në mjedis"*, i ndryshuar, ku sipas nenit 26 të po këtij ligji parashikohet dënim administrative "gjobë" në shumën 65,000-260,000 lekë.

Në këto kushte, vendosja e masës "Paralajmërim" në vend të gjobës përbën zbatim jo të drejtë të legjislacionit në fuqi dhe trajtim jo proporcional të shkeljeve të konstatuara.

Mosaplikimi i sanksioneve të parashikuara ka sjellë mosndëshkimin e plotë të shkeljeve, duke dobësuar efektin parandalues të inspektimeve, në vlerën nga 455,000 lekë deri në vlerën 1,820,000 lekë si dhe rrit riskun e përsëritjes së shkeljeve në fushën e ndikimit të vlerësimit në mjedis.

Në mënyrë analitike subjektet paraqiten në tabelën nr. 4, Aneksi nr. 1.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5. faqet nr. 163-303 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandim: Drejtoria e Inspektimit dhe Kontrollit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe në Agjencitë Rajonale Mjedisore të marrë masa për zbatimin e saktë dhe të njëtrajtshëm të kuadrit ligjor, duke siguruar që në rastet e shkeljeve të konstatuara në fushën e vlerësimit të ndikimit në mjedis të aplikohet masa administrative përkatëse gjobë sipas parashikimeve ligjore dhe jo masa "Paralajmërim".

5.2 Rekomandimi: Titullari i AKM-së të ngrejë një grup pune për shqyrtimin e problematikave të konstatuara nga auditimi, evidentimin e shkeljeve dhe përcaktimin e përgjegjësive institucionale

dhe individuale që kanë shkaktuar efekt financiar nga vlera 455,000 lekë deri në 1,820,000 lekë, me qëllim identifikimin e masave korrigjuese dhe parandaluese për garantimin e ligjshmërisë, rritjen e efektivitetit dhe përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes administrative.
5.3 Rekomandimi: Drejtoria e Inspektimit dhe Kontrollit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe në Agjencitë Rajonale Mjedisore të përfshijë në planet vjetore të inspektimeve subjektet e evidentuara me problematika, me qëllim verifikimin në terren të respektimit të kushteve të lejes dhe identifikimin e ndikimeve të mundshme në mjedis.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i inspektimeve të kryera nga AKM dhe strukturat rajonale konstatohet zbatim jo i drejtë i masave administrative, pasi në 3 raste, subjekti *"K. I"* SHA me NIPT K.....T, *"E"* me Nipt J.....W, subjekti *"K. C"* me Nipt L.....R, është vendosur masa "Paralajmërim" në kundërshtim me me pikën 6 të nenit 50 të ligjit 10431 datë 09.06.2011 *"Për mbrojtjen e mjedisit",* i ndryshuar, ku sipas nenit 69 të po këtij ligji parashikohet dënim administrative "gjobë" në shumën 1,000,000-2,000,000 lekë.
Në këto kushte, vendosja e masës "Paralajmërim" në vend të gjobës përbën zbatim jo të drejtë të legjislacionit në fuqi dhe trajtim jo proporcional të shkeljeve të konstatuara. Mosaplikimi i sanksioneve të parashikuara ka sjellë mosndëshkimin e plotë të shkeljeve, duke dobësuar efektin parandalues të inspektimeve në vlerën nga 3,000,000 lekë deri në 6,000,000 lekë si dhe rrit riskun e përsëritjes së shkeljeve në fushën e mbrojtjes së mjedisit.
Në mënyrë analitike subjektet paraqiten në tabelën nr. 5, Aneksi nr. 1.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5. faqet nr. 163-303 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
6.1 Rekomandim: Drejtoria e Inspektimit dhe Kontrollit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe në Agjencitë Rajonale Mjedisore të marrë masa për zbatimin e saktë dhe të njëtrajtshëm të kuadrit ligjor, duke siguruar që në rastet e shkeljeve të konstatuara në fushën e mbrojtjes së mjedisit të aplikohet masa administrative përkatëse gjobë sipas parashikimeve ligjore dhe jo masa "Paralajmërim".
6.2 Rekomandimi: Titullari i AKM-së të ngrejë një grup pune për shqyrtimin e problematikave të konstatuara nga auditimi, evidentimin e shkeljeve dhe përcaktimin e përgjegjësive institucionale dhe individuale që kanë shkaktuar efekt financiar nga vlera 3,000,000 lekë deri në 6,000,000 lekë, me qëllim identifikimin e masave korrigjuese dhe parandaluese për garantimin e ligjshmërisë, rritjen e efektivitetit dhe përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes administrative.
6.3 Rekomandimi: Drejtoria e Inspektimit dhe Kontrollit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe në Agjencitë Rajonale Mjedisore të përfshijë në planet vjetore të inspektimeve subjektet e evidentuara me problematika, me qëllim verifikimin në terren të respektimit të kushteve të lejes dhe identifikimin e ndikimeve të mundshme në mjedis.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së shqyrtimit të ankimimit dhe vendimmarrjes për shfuqizimin e masës administrative ndaj subjektit "D", me NIPT K.....Q, konstatohet se vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankimimit për shfuqizimin e gjobës në vlerën 300,000 lekë nuk mbështetet në prova dhe argumente të plota ligjore.
Konkretisht, subjekti është ndëshkuar me vendimin përfundimtar të inspektimit nr. AKM-DQ-2023-000250-5, datë 02.10.2023, për moszbatim të detyrimeve të lejes mjedisore, përfshirë mungesën e raportit vjetor të mjedisit, raportit të vetëmonitorimit, planit të përputhshmërisë, planit të menaxhimit të mbetjeve dhe dokumentacionit mjedisor në vendin e ushtrimit të aktivitetit.
Nga auditimi i procedurës rezulton se trupa inspektuese ka respektuar afatet procedurale të

parashikuara në nenet 45 dhe 46 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, pasi procesverbali është mbajtur në datë 04.09.2023 dhe vendimi përfundimtar është marrë në datë 02.10.2023, brenda afatit ligjor.
Pavarësisht kësaj, Komisioni i Shqyrtimit të Ankimimit ka vendosur shfuqizimin e masës administrative, duke u bazuar në pretendimet e subjektit dhe në dokumentacionin e paraqitur pas inspektimit. Megjithatë, këto masa janë marrë pas konstatimit të shkeljeve dhe nuk rrëzojnë situatën faktike të evidentuar në momentin e inspektimit. Në përputhje me nenin 4, pika 2 të ligjit nr. 10433/2011, qëllimi i inspektimit është vlerësimi i respektimit të kërkesave ligjore në momentin e verifikimit dhe jo korrigjimi i tyre pas faktit. Për rrjedhojë, konstatohet se shfuqizimi i masës administrative është kryer në kundërshtim me nenin 137, pika 2 të ligjit nr. 44/2015 *"Kodi i Procedurave Administrative i RSH",* i ndryshuar, pasi ankimi rezulton i pabazuar dhe nuk provohet eliminimi i shkeljeve në momentin e inspektimit.
-Nga auditimi i procedurës së shqyrtimit të ankimimit dhe vendimmarrjes për shfuqizimin e masës administrative ndaj subjektit *"D"* SHPK, me NIPT K.....M, konstatohet se vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankimimit për shfuqizimin e gjobës në vlerën 300,000 lekë nuk mbështetet në prova dhe argumente të plota ligjore.
Konkretisht, subjekti është ndëshkuar me vendimin përfundimtar të inspektimit nr. AKM-TR-2023-000039-5, datë 22.08.2023, për moszbatim të detyrimeve të lejes mjedisore, përfshirë mosparaqitjen e raporteve të vetëmonitorimit brenda afateve, mungesën e dokumentacionit për trajtimin e ujërave të ndotura, mungesën e planit të menaxhimit të mbetjeve, si dhe mungesën e dokumentacionit për transferimin e mbetjeve.
Nga auditimi rezulton se dokumentacioni i paraqitur nga subjekti në kuadër të ankimimit, përfshirë raportin e vetëmonitorimit të dorëzuar më datë 28.07.2023, është dorëzuar në tejkalim të afateve të përcaktuara në lejen mjedisore (tabela 12.1.1), dhe si i tillë nuk rrëzon shkeljet e konstatuara në momentin e inspektimit. Gjithashtu, për trajtimin e ujërave të ndotura nuk janë paraqitur dokumente justifikuese, por vetëm shpjegime, të cilat nuk përbëjnë prova të mjaftueshme për përmbushjen e detyrimeve ligjore.
Pavarësisht këtyre konstatimeve, Komisioni i Shqyrtimit të Ankimimit ka vendosur shfuqizimin e masës administrative duke u bazuar në nenet 45 dhe 46 të ligjit nr. 10433/2011, pa kryer një analizë të plotë të shkeljeve substanciale dhe pa marrë në konsideratë tejkalimin e afateve dhe mungesën e dokumentacionit përkatës.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5. faqet nr. 163-303 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
7.1 Rekomandimi: Autoriteti përgjegjës për shqyrtimin e ankimimeve të vlerësojë shkeljet e konstatuara në momentin e inspektimit, pa marrë në konsideratë dokumentacion të paraqitur pas këtij momenti si bazë për shfuqizimin e masave administrative, kur ky dokumentacion nuk ndryshon situatën faktike të konstatuar.
7.2 Rekomandimi: Titullari i AKM-së të ngrejë një grup pune për shqyrtimin e problematikave të konstatuara nga auditimi, evidentimin e shkeljeve dhe përcaktimin e përgjegjësive institucionale dhe individuale që kanë shkaktuar efekt financiar për 2 raste në vlerën 600,000 lekë, me qëllim identifikimin e masave korrigjuese dhe parandaluese për garantimin e ligjshmërisë, rritjen e efektivitetit dhe përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes administrative.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të shqyrtimit të ankimimeve rezultoi se në 4 raste Komisioni i Shqyrtimit të Ankimimeve ka vendosur shfuqizimin e masave administrative të vendosura nga trupa inspektuese (subjektet: T. M. Al, A. sh.a. (2 raste) dhe M. K), në vlerat përkatëse 400,000 lekë, 1,000,000 lekë, 300,000 lekë dhe 500,000 lekë, duke argumentuar

parregullsi procedurale lidhur me moskryerjen e inspektimit nëpërmjet sistemit "e-inspektimi".
Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se ky arsyetim nuk është i bazuar në prova dhe argumente ligjore të mjaftueshme, pasi Komisioni nuk ka vlerësuar në themel gjetjet dhe shkeljet e konstatuara nga trupa inspektuese, si dhe nuk ka marrë në konsideratë provat e administruara gjatë inspektimit, përfshirë dokumentacionin përkatës dhe rezultatet e analizave të mostrave të marra në terren.
Referuar ligjit nr. 10433/2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* konkretisht neneve 45 dhe 46, vlefshmëria e procedurës së inspektimit lidhet me respektimin e elementeve procedurale thelbësore (mbajtja e procesverbalit, njoftimi i subjektit dhe afatet për marrjen e vendimit), dhe nuk kushtëzohet nga përdorimi i një pajisjeje apo sistemi të caktuar elektronik. Në këtë kuadër, mbështetja në mos përdorimin e sistemit "e-inspektimi", si arsye e vetme për shfuqizimin e masës administrative, nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore në fuqi.
Gjithashtu, në zbatim të parimit të hierarkisë së akteve normative, të përcaktuar në nenin 116 të Kushtetutës, aktet nënligjore, si Urdhri nr. 25, datë 10.08.2018, nuk mund të prevalojnë mbi ligjin dhe nuk mund të shërbejnë si bazë e vetme për të shpallur të pavlefshëm një akt administrativ të nxjerrë në përputhje me ligjin.
Për rrjedhojë, shfuqizimi i masave administrative në këto raste, pa një vlerësim të plotë të shkeljeve materiale dhe provave përkatëse, është kryer në kundërshtim me pikën 2 të nenit 137 të Kodit të Procedurave Administrative, duke cenuar ligjshmërinë e vendimmarrjes, dobësuar efektivitetin e masave administrative dhe krijuar precedent për interpretim të gabuar të kuadrit ligjor në procesin e shqyrtimit të ankimimeve.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5. faqet nr. 163-303 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
8.1 Rekomandimi: Autoriteti përgjegjës për shqyrtimin e ankimimeve të garantojë zbatimin e drejtë të kuadrit ligjor, duke respektuar parimin e hierarkisë së akteve normative, në mënyrë që aktet nënligjore të mos përdoren si bazë për shfuqizimin e masave administrative kur bien në kundërshtim me dispozitat ligjore, si dhe të shmangen praktikat që cenojnë qëndrueshmërinë ligjore dhe efektivitetin e vendimmarrjes administrative.
8.2 Rekomandimi: Titullari i AKM-së të ngrejë një grup pune për shqyrtimin e problematikave të konstatuara nga auditimi, evidentimin e shkeljeve dhe përcaktimin e përgjegjësive institucionale dhe individuale që kanë shkaktuar efekt financiar për 4 raste në vlerën 2,200,000 lekë, me qëllim identifikimin e masave korrigjuese dhe parandaluese për garantimin e ligjshmërisë, rritjen e efektivitetit dhe përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes administrative.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së ankimimit për subjektin "N" SHPK, me NIPT K.....I, rezultoi se Komisioni i Shqyrtimit të Ankimimeve ka vendosur shfuqizimin e masës administrative në vlerën 2,000,000 lekë, pa kryer një vlerësim të plotë dhe në themel të provave të administruara nga trupa inspektuese gjatë inspektimit.
Referuar dokumentacionit të inspektimit (procesverbali, lista e verifikimit dhe vendimi përfundimtar), rezulton se shkelja është konstatuar në terren dhe mbështetur në deklarimet e përfaqësuesit të subjektit, si dhe në prova fotografike dhe video të administruara gjatë kontrollit.
Megjithatë, nga shqyrtimi i procedurës së ankimimit nuk rezulton që Komisioni të ketë verifikuar këto prova, por ka bazuar vendimmarrjen kryesisht në pretendimin për mungesë dokumentimi të mjaftueshëm dhe në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti pas inspektimit.
Në këtë kuadër, pretendimi i subjektit për ekzistencën e një sistemi funksional të trajtimit të ujërave të ndotura dhe dokumentacioni i paraqitur në fazën e ankimit (planimetri, kontratë pastrimi, etj.) nuk përjashtojnë faktin e konstatuar gjatë inspektimit në terren dhe nuk rrëzojnë gjetjen e trupës

inspektuese mbi shkarkimin e ujërave të ndotura në mjedisin ujor.
Gjithashtu, ligji nr. 10433/2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"* nuk e kushtëzon vlefshmërinë e konstatimit të shkeljes me kryerjen e analizave laboratorike, pasi inspektorët kanë të drejtë të dokumentojnë shkeljet edhe nëpërmjet konstatimeve në terren dhe provave të tjera administrative.
Për rrjedhojë, shfuqizimi i masës administrative nga Komisioni, pa një verifikim të plotë të provave dhe pa vlerësuar në themel shkeljen e konstatuar, është kryer në kundërshtim me pikën 2 të nenit 137 të ligjit nr. 44/2015 *"Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë",* duke cenuar ligjshmërinë e vendimmarrjes dhe dobësuar efektivitetin e masave administrative në mbrojtje të mjedisit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5. faqet nr. 163-303 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
9.1 Rekomandimi: Autoriteti përgjegjës për shqyrtimin e Ankimimeve të marrë masa për forcimin e kontrollit mbi vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankimimeve, duke siguruar që çdo vendim për shfuqizimin e masave administrative të mbështetet në verifikim të plotë të provave dhe në analizë në themel të shkeljeve të konstatuara, me qëllim garantimin e ligjshmërisë dhe efektivitetit të masave në mbrojtje të mjedisit.
9.2 Rekomandimi: Titullari i AKM-së të ngrejë një grup pune për shqyrtimin e problematikave të konstatuara nga auditimi, evidentimin e shkeljeve dhe përcaktimin e përgjegjësive institucionale dhe individuale që kanë shkaktuar efekt financiar në vlerën 2,000,000 lekë, me qëllim identifikimin e masave korrigjuese dhe parandaluese për garantimin e ligjshmërisë, rritjen e efektivitetit dhe përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes administrative.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së shqyrtimit të ankimimit për subjektin "T. S" SHPK, me NIPT L.....I, rezultoi se Komisioni i Shqyrtimit të Ankimimeve ka vendosur shfuqizimin e masës administrative në vlerën 5,000,000 lekë, pa kryer një vlerësim të plotë dhe në themel të shkeljeve dhe provave të administruara gjatë inspektimit.
Referuar dokumentacionit të inspektimit (procesverbali, lista e verifikimit dhe materialet filmike), rezulton se gjatë kontrollit në terren është konstatuar dhe dokumentuar shkarkim i ujërave industriale të përziera me lëndë hidrokarbure në përroin që derdhet në lumin Gjanica, në kundërshtim me nenin 30, pikat 3 dhe 7 të ligjit nr. 111/2012 *"Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore".* Kjo shkelje përbën rrezik të drejtpërdrejtë për mjedisin dhe shëndetin publik dhe kërkon ndërhyrje të menjëhershme administrative.
Megjithatë, Komisioni i Shqyrtimit të Ankimimeve ka bazuar vendimin e shfuqizimit të masës administrative kryesisht në pretendime procedurale, konkretisht në mosinformimin për afatin e ankimimit të vendimit të ndërmjetëm, pa e pasur këtë pretendim pjesë të ankimit të subjektit dhe pa analizuar në themel shkeljen e konstatuar dhe provat përkatëse.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se subjekti ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit përfundimtar brenda afatit ligjor, çka tregon se e drejta procedurale nuk është cenuar. Gjithashtu, ligji nr. 10433/2011 parashikon në nenin 44 se ankimi i veçantë shqyrtohet drejtpërdrejtë nga drejtuesi i degës territoriale. Në këto kushte, ndërhyrja e komisionit në këtë proces rezulton jashtë kompetencës së tij. Për më tepër, konstatimi i një mangësie procedurale nuk mund të sjellë automatikisht pavlefshmërinë e masës administrative, veçanërisht në rastet kur shkeljet e evidentuara paraqesin rrezik të rëndë për mjedisin.
Në këto kushte, shfuqizimi i masës administrative vetëm mbi elemente proceduriale, pa vlerësuar shkeljen materiale dhe rrezikun mjedisor, bie në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit, parimin "ndotësi paguan", si dhe me detyrimin kushtetues për mbrojtjen e mjedisit, sipas nenit 59

të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
Për rrjedhojë, vendimi i Komisionit rezulton i pambështetur në prova dhe argumente ligjore dhe në kundërshtim me pikën 2 të nenit 137 të ligjit nr. 44/2015 *"Kodi i Procedurave Administrative",* duke cenuar ligjshmërinë e vendimmarrjes, dobësuar efektivitetin e masave administrative dhe krijuar precedent për shmangie të përgjegjësisë në raste me rrezik të lartë mjedisor.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5. faqet nr. 163-303 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
10.1 Rekomandimi: Autoriteti përgjegjës për shqyrtimin e ankimimeve të marrë masa që gjatë shqyrtimit të ankimimeve për shkelje me ndikim mjedisor, të vlerësojë në thelb konstatimet dhe provat e administruara gjatë inspektimit, duke garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe interesit publik në përputhje me kërkesat ligjore.
10.2 Rekomandimi: Titullari i AKM-së të ngrejë një grup pune për shqyrtimin e problematikave të konstatuara nga auditimi, evidentimin e shkeljeve dhe përcaktimin e përgjegjësive institucionale dhe individuale që kanë shkaktuar efekt financiar në vlerën 5,000,000 lekë, me qëllim identifikimin e masave korrigjuese dhe parandaluese për garantimin e ligjshmërisë, rritjen e efektivitetit dhe përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes administrative.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave mbi masat administrative "*gjobë"* për periudhën objekt auditimi rezultoi se nuk ekziston një databazë e plotë, e unifikuar dhe e konsoliduar mbi gjobat e vendosura dhe statusin e tyre, si dhe janë evidentuar mospërputhje ndërmjet të dhënave të raportuara nga strukturat rajonale dhe atyre të konsoliduara në nivel qendror. Konkretisht, sipas të dhënave të raportuara nga ARM-të (Berat, Fier dhe Tiranë), rezulton se janë vendosur gjithsej 235 masa administrative me vlerë totale 112,130,000 lekë, nga të cilat janë arkëtuar 41,923,000 lekë.
Në nivel rajonal:
- ARM Fier: 120 masa, në vlerë 59,050,000 lekë;
- ARM Berat: 60 masa, në vlerë 25,860,000 lekë;
- ARM Tiranë: 55 masa, në vlerë 27,220,000 lekë.

Ndërkohë, sipas të dhënave të AKM-së raportohen 247 masa administrative, duke evidentuar mospërputhje me të dhënat e ARM-ve. Konkretisht:
- për ARM Berat rezulton 1 rast më pak i raportuar nga ARM krahasuar me AKM;
- për ARM Tiranë rezultojnë 6 raste më shumë të raportuara nga ARM krahasuar me AKM;
- për ARM Fier rezultojnë 6 raste më pak të raportuara nga ARM krahasuar me AKM;
- për disa struktura mungon raportimi i plotë i të dhënave.

Gjithashtu, rezulton se një pjesë e konsiderueshme e gjobave mbeten të paarkëtuara dhe të pakontabilizuara, përfshirë edhe rastet në nivel qendror me vlerë 10,190,000 lekë, në faza të ndryshme ndjekjeje. Kjo situatë është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10433/2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"* dhe ligjit nr. 10279/2010 *"Për kundërvajtjet administrative",* të cilat kërkojnë evidentim, ndjekje dhe ekzekutim të rregullt të gjobave administrative. Mungesa e një sistemi të unifikuar të të dhënave dhe mosrakordimi ndërmjet nivelit qendror dhe atij rajonal ka ardhur si pasojë e mungesës së koordinimit dhe kontrollit mbi raportimin dhe administrimin e gjobave, duke sjellë si pasojë pasqyrim jo të saktë të detyrimeve në fuqi, vështirësi në ndjekjen e tyre për arkëtim dhe rritje të riskut për mosarkëtim të të ardhurave.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5. faqet nr. 163-303 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
11.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit, të marrë masa për evidentimin, regjistrimin dhe pasqyrimin e plotë kontabël të masave administrative me gjobë, nëpërmjet krijimit dhe mirëmbajtjes së një databaze të unifikuar ndërmjet nivelit qendror dhe atij rajonal, me qëllim

sigurimin e gjurmueshmërisë së plotë të detyrimeve dhe mundësimin e ndjekjes efektive të tyre për arkëtim.
11.2 Rekomandimi: Sektori i financës të kryejë rakordime periodike të të dhënave mbi gjobat e vendosura, të arkëtuara dhe ato në ndjekje, si dhe të marrë masa për ndjekjen administrative dhe ligjore të gjobave të paarkëtuara, me qëllim minimizimin e riskut për mosmbledhjen e të ardhurave dhe pasqyrimin e saktë të detyrimeve në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i praktikave të ndjekjes së zbatimit të detyrave të lëna nga trupa inspektuese, konstatohet se nuk janë vendosur masa administrative ndaj subjekteve që nuk kanë përmbushur detyrimet brenda afatit të përcaktuar në 8 raste ARM Berat, përkatësisht:
Në këto raste, subjektet nuk kanë përmbushur detyrimet e lëna në procesverbalet e inspektimit, por nuk rezulton të jenë marrë masa administrative nga strukturat përgjegjëse, në kundërshtim me nenin 48, pikat 4, 5 dhe 6 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* i cili parashikon vendosjen e gjobës në vlerë nga 10,000 deri në 100,000 lekë në rast të moszbatimit të detyrimeve brenda afatit, pra në total vlera e masave administrative duhet të ishte në kufirin nga vlera 80,000 lekë deri në 800,000 lekë. Kjo situatë tregon për mangësi në ndjekjen dhe zbatimin e kompetencave të organeve inspektuese, duke mos garantuar zbatimin e plotë të kërkesave ligjore në fuqi.Mosvendosja e masave administrative ndaj subjekteve në shkelje sjell mosndëshkim të tyre, dobëson efektin parandalues dhe korrektues të inspektimeve, si dhe krijon precedent negativ në zbatimin e legjislacionit, duke rritur riskun e përsëritjes së shkeljeve dhe cenimit të standardeve mjedisore. *Në mënyrë analitike subjektet paraqiten në tabelën nr. 6, Aneksi nr. 1.*
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5. faqet nr. 163-303 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
12.1 Rekomandimi: Drejtoria e Inspektimit dhe Kontrollit të marrë masa për forcimin e ndjekjes së zbatimit të detyrimeve të lëna nga inspektimet, duke siguruar vendosjen në kohë të masave administrative ndaj subjekteve që nuk i përmbushin këto detyrime brenda afateve të përcaktuara, në përputhje kuadrin rregullator në fuqi.
12.2 Rekomandimi: Titullari i AKM-së të ngrejë një grup pune për shqyrtimin e problematikave të konstatuara nga auditimi, evidentimin e shkeljeve dhe përcaktimin e përgjegjësive institucionale dhe individuale që kanë shkaktuar efekt financiar nga vlera 80,000 lekë deri në 800,000 lekë, me qëllim identifikimin e masave korrigjuese dhe parandaluese për garantimin e ligjshmërisë, rritjen e efektivitetit dhe përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes administrative.
12.3 Rekomandimi: Drejtoria e Inspektimit dhe Kontrollit të përfshijë në planet vjetore të inspektimeve subjektet e evidentuara me problematika, me qëllim verifikimin në terren të respektimit të kushteve të lejes dhe identifikimin e ndikimeve të mundshme në mjedis.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, germat "b", "c" dhe "ç"; bazuar në nenin 58 dhe 59 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" të ndryshuar, si dhe në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", **i rekomandojmë Ministrit të Mjedisit** që bazuar në performancën e Drejtuesit të AKM-së për periudhën objekt auditimi, të evidentuar me shkelje në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë dhe të sigurojë

marrjen e masave disiplinore përkatëse dhe **Titullarit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit** t'i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe drejtues të evidentuar me shkelje në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT